




Gjykata Supreme e  
Republikës së Kosovës



# UDHËZUES I PËRGJITHSHËM PËR MATJEN E DËNIMIT

---

Botimi II

Prishtinë  
Nëntor, 2024

# **Udhëzues i përgjithshëm për matjen e dënimit**

---



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Udhëzuesit të Përgjithshëm për Matjen e Denimit në Kosovë, në bazë të nenit 25 dhe 26 të Ligjit Për Gjykatat Nr. 06/L - 054, më datë 8 nëntor 2024, në mënyrë unanime miratoi:

**UDHËZUESIN E PËRGJITHSHËM PËR MATJEN E DENIMIT NË KOSOVË**

Udhëzuesi hyn në fuqi në ditën e publikimit në faqen zyrtare të Gjykatës Supreme, dhe i njëjti shfuqizon Udhëzuesin e Politikës Ndëshkimore të vitit 2018.

**A r s y e t i m**

Në vitet e fundit, legjislacioni penal në Kosovë ka kaluar nëpër një fazë të rëndësishme reformimi, me miratimin e ri të Kodit Penal (KPRK) dhe Kodit të Procedurës Penale (KPP), dispozita të shumta ligjore kanë ndryshuar. Këto ndryshime, të cilat synojnë përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të gjykatave, kanë ndikuar dukshëm në praktikën e politikës ndëshkimore duke sjellë edhe sfida të reja, përfshirë mangësi në mënyrën se si gjykatat i qasen caktimit të dënimeve, si profesionalizmin e gjykatave në nxjerrjen e vendimeve mbi të akuzuarit.

Në këtë kontekst, ka lindur nevoja për rishikim të Udhëzuesit të Politikës Ndëshkimore, të miratuar në vitin 2018 nga Gjykata Supreme, si dhe hartimin e një udhëzues të ri që të sigurojë një qasje më të qëndrueshme dhe të harmonizuar në caktimin e dënimeve. Ky revidim synon


të përmirësojë metodologjinë e përdorur nga gjykatat dhe të ofrojë një kuadër të qartë ligjor për trajtimin e drejtë të çdo çështjeje penale.

Udhëzuesi i politikës ndëshkimore, edhe pse nuk ka karakter detyrues ligjor, ka për qëllim të mbështesë gjykatat në krijimin e vendimeve që mbështeten në parimet themelore të shtetit të së drejtës, duke shmangur dallimet e paarsyetuara si dhe shmangies së divergjencave të panevojshme në politikën ndëshkimore.

Rëndësia e udhëzuesit të politikës ndëshkimore është thelbësore për rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë penale dhe për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Duke ofruar një përmbajtje të qartë dhe të strukturuar për caktimin e dënimeve, ky udhëzues ndihmon në parandalimin e arbitraritetit dhe rrit mundësinë që vendimet gjyqësore të jenë të njëtrajtshme dhe të drejta, duke garantuar kështu që çdo individ të trajtohet në mënyrë të barabartë para ligjit.

Implementimi i këtij udhëzuesi, luan një rol të rëndësishëm në sigurinë juridike, zbatimin në praktik i këtij dokumenti do t'i shërbejë poashtu rritjes së transparencës dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor, duke kontribuar kështu në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe instrumentet ndërkombëtare.

**Fejzullah Rexhepi**



**Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

# Tabela e përmbajtjes

Hyrje .....	1
I. Pjesa e përgjithshme .....	3
I. Matja e dënimit në Kosovë-problemet e identifikuara.....	4
1. <i>Pabarazia apo dallimi në dënime</i> .....	4
2. <i>Zbatimi i parimit të proporcionalitetit</i> .....	7
3. <i>Vlerësimi joadekuat i rrethanave dhe mungesa e Arsytimit</i> .....	8
4. <i>Transparenca, ligjshmëria dhe besueshmëria e opinionit publik</i> .....	10
II. Aspekte procedurale të matjes së dënimit .....	13
1. <i>Risitë e Kodit të procedurës penale</i> .....	13
2. <i>Standardi i të provuarit</i> .....	14
3. <i>Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë</i> .....	16
III. Dënimet kryesore sipas KPRK-së.....	18
1. <i>Dënimi me burgim</i> .....	18
2. <i>Dënimi me burgim të përjetshëm</i> .....	19
3. <i>Dënimi me gjobë</i> .....	20
IV. Caktimi i dënimit sipas parimeve të Nenit 69 të KPRK-së .....	21
1. <i>Qëllimi i Dënimit</i> .....	21
2. <i>Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit</i> .....	24
V. Ashpërsimi dhe zbutja sipas Nenit 70 të KPRK-së.....	32
1. <i>Çështje të përgjithshme të matjes së dënimit</i> .....	32
2. <i>Rrethanat rënduese sipas Nenit 70 të KPRK-së</i> .....	34
3. <i>Rrethanat lehtësuese nga Neni 70 i KPRK-së</i> .....	58
4. <i>Rrethanat tjera lehtësuese të marra në konsideratë gjatë praktikës</i> .....	77
VI. Fazat e matjes së dënimit .....	80
1. <i>Çështje të përgjithshme</i> .....	80
2. <i>Pikënisja</i> .....	80
3. <i>Caktimi i peshës së rrethanave</i> .....	82
4. <i>Serioziteti i veprës penale</i> .....	83
5. <i>Rrethanat që tregojnë për shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit</i> .....	83
6. <i>Rrethanat që kanë ndikim në nivelin e dëmit</i> .....	84
7. <i>Rëndësia relative dhe qëllimet e dënimit</i> .....	85

8.	<i>Ndalimi i llogaritjes së dyfishtë të rrethanave</i> .....	86
9.	<i>Zbutja e dënimit</i> .....	88
10.	<i>Lirimi nga dënimi</i> .....	91
11.	<i>Ashpërsimi për recidivizëm të shumëfishtë</i> .....	91
12.	<i>Dënimi për bashkim të veprave penale</i> .....	92
13.	<i>Vendimet e trupit gjykues për caktimin e dënimit</i> .....	93
VII.	<b>Zbatimi i dënimeve alternative, plotësuese dhe tjera</b> .....	<b>94</b>
1.	<i>Dënimi me kusht</i> .....	94
2.	<i>Urdhri për punë në dobi të përgjithshme/Gjysmëliria</i> .....	100
3.	<i>Dënimet plotësuese</i> .....	100
4.	<i>Masat e trajtimit të detyrueshëm</i> .....	104
5.	<i>Vërejtja gjyqësore</i> .....	104
6.	<i>Urdhri ndëshkimor</i> .....	105
VIII.	<b>Arsyetimi i aktgjykimit</b> .....	<b>106</b>
IX.	<b>Shqyrtimi nga shkalla e dytë</b> .....	<b>108</b>
1.	<i>Diskrecioni i Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e dënimit</i> .....	108
2.	<i>Eliminimi i dallimeve apo pabarazive</i> .....	108
3.	<i>Standardi i ‘gabimit të dukshëm’</i> .....	109
II.	<b>Pjesa e veçantë</b> .....	<b>112</b>
I.	<b>Kapitulli XIV Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës</b> .....	<b>113</b>
1.	<i>Rendi kushtetues dhe siguria</i> .....	114
2.	<i>Veprat penale të terrorizmit dhe veprat që ndërliken me to</i> .....	117
II.	<b>Kapitulli XV Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare</b> .....	<b>135</b>
III.	<b>Kapitulli XVI Veprat penale kundër jetës dhe trupit</b> .....	<b>146</b>
IV.	<b>Kapitulli XVII Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut</b> .....	<b>152</b>
V.	<b>Kapitulli XVIII Veprat penale kundër të drejtave të votimit</b> .....	<b>161</b>
VI.	<b>Kapitulli XIX Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës</b> . 169	
VII.	<b>Kapitulli XX Veprat penale kundër integritetit seksual</b> .....	<b>171</b>
VIII.	<b>Kapitulli XXI Veprat penale me bazë gjinore, kundër martesës dhe kundër familjes</b> 181	
IX.	<b>Kapitulli XXII Veprat penale kundër shëndetit publik</b> .....	<b>191</b>
X.	<b>Kapitulli XXIII Veprat penale të narkotikëve</b> .....	<b>198</b>
XI.	<b>Kapitulli XXIV Krimi i organizuar</b> .....	<b>216</b>
XII.	<b>Kapitulli XXIV/A Krimet kibernetike</b> .....	<b>221</b>
XIII.	<b>Kapitulli XXV Veprat penale kundër ekonomisë</b> .....	<b>228</b>
XIV.	<b>Kapitulli XXVI Veprat penale kundër pasurisë</b> .....	<b>235</b>

<b>XV. Kapitulli XXVII Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore .....</b>	<b>244</b>
<b>XVI. Kapitulli XXVIII Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë</b>	<b>255</b>
<b>XVII. Kapitulli XXIX Veprat penale të armëve .....</b>	<b>259</b>
<b>XVIII. Kapitulli XXX - Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik .....</b>	<b>266</b>
<b>XIX. Kapitulli XXXI - Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike .....</b>	<b>270</b>
<b>XX. Kapitulli XXXII Veprat penale kundër rendit publik .....</b>	<b>280</b>

# Hyrje

Praktika e matjes së dënimit nëpër gjykatat e Kosovës gjithnjë e më tepër po i nënshtrohet një kontrolli më thelbësor duke pasur në konsideratë dispozitat e Kodit Penal<sup>1</sup> (KPRK ose “Kodi”) dhe sidomos Kodit të Procedurës Penale<sup>2</sup> (KPPRKP). Përpyekjet e para për rregullimin e politikës ndëshkimore në vend kanë filluar qysh në vitin 2013 kur janë paraqitur iniciativat fillestare për hartimin e një dokumenti udhëzues, i cili do të adresonte problematikën e larmisë së qasjes në matjen e dënimit. Këto iniciativa kulmuan në shkurt të vitit 2018, kur Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme miratoi Udhëzuesin e parë për politikë ndëshkimore. Vetëm disa muaj më pas, më saktësisht në gusht të po të njëjtit vit, u themelua edhe Komisioni këshillëdhënës për politikë ndëshkimore i përbërë nga gjyqtarë të të gjitha instancave të gjyqësorit, përfaqësues të prokurorisë, Akademisë së Drejtësisë dhe Odës së Avokatëve. Që nga themelimi, ky Komision ka vazhduar të punojë në hulumtime, analiza dhe takime me përfaqësues të ndryshëm me qëllim të sensibilizimit dhe konsultimeve sa më të gjera për përmirësimin e politikës ndëshkimore në vend. Po i njëjti Komision, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë ka vijuar punën në hartimin e Udhëzuesve tjerë, të cilët më pas edhe janë miratuar nga Gjykata Supreme. Kështu, përpos Udhëzuesit të përgjithshëm janë zhvilluar dhe më pas janë miratuar edhe udhëzuesit në vijim:

***Udhëzuesi specifik për caktimin e gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës***, miratuar në Shkurt 2020 dhe pasuar nga zhvillimi i Kalkulatorit për llogaritjen e gjobës penale.

***Udhëzuesi për Korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare***, miratuar në qershor 2021 dhe zhvilluar pas një seri konsultimesh me sistemin gjyqësor në të gjitha nivelet.

Versioni aktual i Udhëzuesit të përgjithshëm ka pësuar disa ndryshime në aspektin e trajtimit të çështjeve, duke u bazuar në sugjerimet e aktorëve të ndryshëm dhe pas konsultimeve të vazhdueshme, por edhe bazuar në observimet e brendshme të sistemit të drejtësisë, si dhe të gjeturat nga raportet e ndryshme të jashtme. Pas miratimit të KPRK-së në vitin 2019 dhe KPPRK-së në vitet 2022 dhe 2023, është paraqitur si domosdoshmëri edhe revidimi i Udhëzuesit të përgjithshëm, për të adresuar risitë në këto dy ligje bazë, por edhe më gjerë.

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është që të ofrojë pikëpamje të zgjeruar të legjislacionit penal në fuqi, si dhe praktikave pozitive e negative brenda Kosovës, por edhe atyre ndërkombëtare. E tërë kjo bëhet me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve adekuate për një qasje më uniforme nga të gjitha gjykatat me rastin e matjes së dënimeve. Duke pasur parasysh publikimin në masë të aktgjykimeve,

---

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 08/L-032, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17, 22 Gusht 2022, Prishtinë.



si asnjëherë më parë, paraqitet nevoja e ndikimit në cilësinë e atyre aktgjykimeve duke ndikuar këtu edhe në besimin e publikut në vendimmarrjen e gjykatës.

Lexuesi duhet ta ketë të qartë se Udhëzuesi nuk përcakton rregulla detyruese gjatë matjes së dënimit. Megjithatë, duke marrë parasysh se dallimet e pa arsyeuara dhe perceptimet e padrejtësisë mund ta sjellin sistemin e drejtësisë penale në pikëpyetje, Këshilli i Evropës në rekomandimet e tij mbi konsistencën e politikës ndëshkimore këshillon shtetet, që duke marrë parasysh parimet e tyre kushtetuese dhe traditat juridike dhe në veçanti pavarësinë e gjyqësorit, të marrin masat e nevojshme për të shmangur dallimet e pa arsyeuara në caktimin e dënimeve. Andaj këto udhëzime paraqiten si mjet, në këtë drejtim dhe nuk do të duhej që të cilësohen si ndërhyrje në diskrecion. Thelbi i udhëzuesit është që të strukturohet diskrecioni gjyqësor e jo që të hiqet ai. Në fund të fundit, caktimi i dënimit, gjithmonë kërkon një element të gjyqimit personal, por ai gjykim do të duhej të ushtrohej në kuadër të një kornize të parimeve që është e qartë, koncize dhe e parapërcaktuar. Kjo rezulton në qasje dhe rezultate konsistente, të cilat janë arsyeshëm të parashikueshme.

Ky Udhëzues paraqet një mjet të dobishëm për gjykatën në vlerësimin e një sërë rrethanash individuale të të pandehurve, si dhe një kornizë për vlerësimin e vendimit mbi dënimin. Udhëzuesi paraqet një udhërrëfyes nga gjykata e instancës më të lartë, e cila përmes dispozitës së nenit 26 të Ligjit mbi Gjykatat është mandatuar për hartimin e Udhëzuesve të tillë, të cilët synojnë harmonizimin e praktikave të gjykatave të Kosovës. Udhëzuesi, thënë më saktë jep shembuj dhe shpjegime për qasjen dhe metodologjinë e zbatimit të dispozitave përkatëse të Kodit që kanë të bëjnë me matjen e dënimit dhe arsyetimin e vendimit. Edhe pse Udhëzuesi është përqendruar kryesisht në dënimet e parapara sipas KPRK-së, megjithatë parimet e përfshira janë të vlefshme edhe për të gjithë legjislacionin tjetër penal në fuqi.

Udhëzuesi përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë, e cila paraqet ripunim të Udhëzuesit të përgjithshëm të vitit 2018 dhe i cili zbërthen parimet e përgjithshme të matjes së dënimit; dhe Pjesa e dytë, e cila përmban shtjellimin e kapitujve të Kodit penal veç e veç duke përfshirë karakteristikat rreth matjes së dënimit për kapitujt nga pjesa e posaçme e KPRK-së.

Falënderojmë Ambasadën Amerikane, respektivisht Departamentin Amerikan të Drejtësisë (OPDAT), dhe përfaqësuesit e saj, Benina Kusari për kontributin e jashtëzakonshëm, si dhe John Hanley dhe Erin Cox për mbështetjen e vazhdueshme në përpilimin e këtij Udhëzuesi.

Po ashtu, shprehim mirënjohjen për kontributin e anëtarëve të Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore, Agim Maliqi – gjyqtar në Gjykatën Supreme, Bashkim Hyseni – gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Agron Qalaj – Zëvendëskryeprokuror, Albina Shabani Rama – kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Enver Fejzullahu – Drejtor i Akademisë së Drejtësisë, gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Mejreme Memaj, Afrim Shala, Valdete Daka si dhe gjyqtarin e Gjykatës së Apelit, Skender Çoçaj.

# **I. Pjesa e përgjithshme**

# I. Matja e dënimit në Kosovë-problemet e identifikuar

## 1. Pabarazia apo dallimi në dënime

Sundimi i ligjit, në rend të parë, nënkupton ekzistimin dhe zbatimin efektiv të ligjeve jo diskriminuese. Për këtë qëllim, është detyrë e secilit shtet për të themeluar institucione të cilat mbrojnë rendin juridik, përfshirë gjykatat, prokuroritë dhe policinë. Këto institucione edhe vetë janë të detyruara për të respektuar të drejtat e garantuara të njeriut, ashtu siç parashihen në traktatet universale dhe rajonale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç janë: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike (KNDCP), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe konventat e traktatet tjera ndërkombëtare. Një prej parimeve themelore të Kartës së Madhe (Magna Karta) për gjyqtarët thotë: "*Gjyqësori është një nga tri pushtetet e cilitdo shteti demokratik. Misioni i tij është që të garantojë sundimin e ligjit dhe, rrjedhimisht, të sigurojë zbatimin e duhur të ligjit në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe efektive*".<sup>3</sup>

E drejta për gjykim të drejtë ndërlidhet me administrimin e drejtësisë në kontekst civil dhe penal. Është me rëndësi të kuptohet, që në fillim, se administrimi i duhur i drejtësisë ka dy aspekte: institucional (p.sh. pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave) dhe procedural (p.sh. korrektësia në seancë dëgjimore). Parimi i gjykimit të drejtë nënkupton një mori të drejtash individuale, të cilat garantojnë proces të drejtë ligjor që nga momenti i ngritjes së dyshimit e deri në ekzekutimin e aktgjykimit. Të gjithë personat duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë para gjykatave dhe tribunaleve dhe kanë të drejtë të gëzojnë garancitë minimale të gjykimit të drejtë në mënyrë plotësisht të barabartë.<sup>4</sup>

Rastet identike që i shkaktojnë dëm shoqërisë duhet të nxisin reagime identike në emër të shoqërisë, si pjesë e konceptit të barazisë para ligjit. Pabarazitë krijojnë pasiguri dhe dëmtojnë qartësinë në zbatimin e kontrollit shoqëror-juridik dhe inkurajojnë kryerjen e veprave penale. Kontrolli shoqëror-juridik zbatohet në mënyrë efektive vetëm kur individët e kanë të qartë dhe e dinë me siguri se çfarëdo dëmi ndaj shoqërisë, do të trajtohet në mënyrë adekuate dhe të përpjesëtueshme. Kur individit e din se kryerja e veprës penale, do të pasojë me një procedurë penale e cila do të ketë një përfundim të caktuar, ai mund të sprapset nga kryerja e saj.

Vendimet e ndryshme nga gjykatat, në raste të ngjashme shpien në një kulturë shoqërore ku zbatimi i ligjit *de jure* dallon nga zbatimi *de facto*. Kur një panel gjykues është jashtëzakonisht i butë me të pandehurit, ndërsa paneli tjetër shqipton dënime të ashpra, në këtë mekanizëm i cili parandalon të pandehurit nga përsëritja e veprës, identiteti i panelit bëhet faktor dhe të pandehurit do të bëjnë përpjekje për t'u gjykuar nga njëri panel e jo nga tjetri.<sup>5</sup>

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në vendosjen e një prej rasteve të saj, kishte gjykuar si në vijim:

*"Vendimmarrja nga gjykatat e rregullta në çështje ligjore që janë tërësisht të njëjta dhe pa mundësia dhe mungesa e dëshirës për ta krijuar një praktikë gjyqësore konsistente cenon rëndë parimin e sigurisë juridike, si një nga parimet bazë të sundimit të së drejtës, prandaj nuk ka dyshim*

<sup>3</sup> Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian, Karta e Madhe e Gjyqtarëve, Parimet Themelore, Sundimi i Ligjit dhe Drejtësia, Strasburg, 17 nëntor 2010.

<sup>4</sup> Kuptimi i të drejtave të njeriut, redaktuar nga Qendra Evropiane për Trajnim dhe Hulimtim për të Drejtat e Njeriut Uofgang Benedek, Manuali për Edukimin mbi të Drejtat e Njeriut (fq. 205)

<sup>5</sup> Hallevy, Gabriel. E drejta për t'u dënuar: dënimi modern doktrinal. Springer Science & Business Media, 2012.

*që vendimmarrja në këto rrethana përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 31 të Kushtetutës (shih: Rasti Beian kundër Rumanisë, 30658/05, 2007, GJEDNJ)".<sup>6</sup>*

Në kontekst të dënimeve, pabarazia para ligjit manifestohet përmes pabarazisë apo dallimeve në dënime. Pabarazia ndaj të pandehurve përkufizohet si formë e trajtimit të pabarabartë pa shpjeguar arsyet dhe si pasojë është e papërshtatshme, e padrejtë dhe e pafavorshme. Thënë shkurt, koncepti është mjaft i thjeshtë – "në përgjithësi, të pandehurit do të duhej të prisnin që veprat me rëndësi të njëjtë, të kryera në rrethana të ngjashme nga të pandehurit e ndryshëm, të bartnin pasoja të njëjta".<sup>7</sup> Në kontekst të parimeve juridike, trajtimi i pabarabartë i individëve të inkriminuar cenon Kushtetutën e Kosovës dhe bie ndesh me një mori të garancive universale dhe themelore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Fatkeqësisht, ky parim vazhdon të mos respektohet. Kritikat e vazhdueshme, lidhur me dënimet, tregojnë se të pandehurit po dënohen bazuar në kulturat lokale apo rajonale. Rrjedhimisht, gjykata të ndryshme shqiptojnë dënime dukshëm të ndryshme për veprën e njëjtë. Jo rrallëherë, paraqiten dallime të mëdha, madje edhe brenda të njëjtës gjykatë. Kjo ka për pasojë trajtimin e pabarabartë të të pandehurve para ligjit.

Që nga miratimi i Udhëzuesit të parë në vitin 2018, Gjykata Supreme ka vijuar praktikën e hartimit të udhëzuesve, por duke u përqendruar në tematika të caktuara. Kështu në aspektin e matjes së dënimit deri më tani janë miratuar edhe dy udhëzues të veçantë të cilët trajtojnë tema specifike:

**Udhëzuesi për llogaritjen e gjobës**, i cili ekskluzivisht flet dhe zbërthen llogaritjen e gjobës në pajtim me dispozitat e KPRK-së, në atë formë që edhe gjoba të paraqitet si një mjet efektiv për dënimin e kryesve. Kjo për faktin se, për dallim prej dënimit me burgim ku parashihet që dënimet duhet të jenë të njëjta për të gjithë, tek Udhëzuesi i gjobave kërkohet që gjoba ti përshtatet gjendjes financiare të të pandehurit ashtu siç e përcakton edhe vet paragrafi 5 i Nenit 69 i KPRK-së. Në këtë mënyrë arrihet edhe qëllimi i dënimit që gjoba të mos godasë njësoj të pandehurit me gjendje financiare të ndryshme.

**Udhëzuesi i veçantë për veprat penale të korrupsionit dhe detyrës zyrtare** (tutje Udhëzuesi i korrupsionit) i cili, përtej synimit të rregullimit sa më adekuat të shkallës së dënimit, është zgjeruar edhe me dy elemente, të cilat e përcaktojnë shkallën e dënimit: elementi i dashjes në kryerjen e veprës dhe elementi i Personit zyrtar. Udhëzuesi i korrupsionit jep një perspektivë shumë interesante sa i përket përcaktimit të shkallës së përgjegjësisë dhe dëmit, i cili jo çdo herë është i kuantifikueshëm në aspektin monetar. Edhe tabelat e parapara për secilën vepër penale, në kuadër të këtij kapitulli, bëjnë të qartë faktin se sa më e madhe është përgjegjësia që i është ngarkuar një personi, aq më i lartë është edhe dënimi i paraparë.

Udhëzuesi i përgjithshëm i vitit 2018, por edhe udhëzuesit pasues të përmendur më sipër, ofrojnë një listë indikative të rrethanave që duhet të shfrytëzohen nga gjyqtarët për zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, së bashku me një shtjellim të peshës që rrethanat e tilla, do të duhej të kishin në dënimin përfundimtar. Nëse ndiqen këto udhëzime, jo vetëm që, do të ndikojnë në profesionalizmin e gjykatave, por ato do ta përmirësojnë edhe respektimin e të drejtave të njeriut në gjykatat e Kosovës, në përgjithësi.

Zhvillimi dhe miratimi i Udhëzuesit të përgjithshëm dhe udhëzuesve të tjerë pasues, është hap thelbësor në arritjen e qëllimit të harmonizimit më të madh të dënimeve. Megjithatë, se deri në çfarë mase mund ta arrijnë këtë qëllim udhëzuesit, varet nga zbatimi në praktikë i konsistencës në qasje. Në formën aktuale të legjislacionit ekzistues me të cilin parashihen dënimet, dispozitat

<sup>6</sup> Aktgjykim, Prishtinë, 20 korrik 2012, Nr.Ref: AGJ 285/12, Rasti nr. KI 04/12, Parashtruesi Esat Kelmendi (par.26).

<sup>7</sup> Departamenti i Drejtësisë, "Konsultimi mbi mekanizmin e udhëzuesit të dënimeve", 2010.

janë shumë të gjera dhe ofrojnë pak, apo nuk ofrojnë fare udhëzime. Në vend të kësaj, gjykatës i janë dhënë kufij të gjerë të dënimit të mundshëm pa ndonjë udhëzim lidhur me pikënisjen, rrethanat e përgjithshme rënduese dhe lehtësuese për tu marrë parasysh, pa ndonjë udhëzim se si t'i vlerësojë, peshojë dhe/ose krahasojë ato; dhe mundësia për t'i korigjuar dënimet. Derisa, kjo i jep gjykatave diskrecion të konsiderueshëm, është dëshmuar se një gjë e tillë nuk e përmirëson harmonizimin. Udhëzuesit e miratuar nga Gjykata Supreme, që nga viti 2018 e tutje, kanë për qëllim të adresojnë, pikërisht këtë mangësi.

Në anën tjetër, përcaktimi i një qasjeje të definuar më ngushtë me inkurajim të fuqishëm të gjykatave për ta ndjekur atë, e ngushton fushën e dënimeve të mundshme. Ajo, sërish lejon variacion në dënime, por vetëm kur gjykata është në gjendje të artikulojë qartë rrethanat të cilat janë përtej rrethanave tipike apo të zakonshme të të pandehurit dhe që arsyetojnë një shmangie të tillë. Roli i udhëzuesve nuk qëndron në eliminimin e diskrecionit të gjykatës, por në strukturimin e qasjes duke përdorur të njëjtën metodologji. Rezultati përfundimtar është një sërë dënimesh, të cilat janë të përafërta për një veprë të caktuar të kryer në rrethana të ngjashme, ndërsa në situatat të cilat nuk janë të ngjashme gjykata prapë e ka mundësinë që të lëvizë, sipas nevojës, brenda kufijve të dënimit të paraparë.

Në rastin Muçiq dhe të tjerë, Trupi Gjykses kishte dhënë një deklaratë shumë të plotë lidhur me arsyen për konsistencë në caktimin e dënimit: *"Një prej elementeve themelore në çdo sistem të arsyeshëm dhe të drejtë të drejtësisë penale është konsistenca në dënime. Ky është një reflektim i rëndësishëm i nocionit të drejtësisë së barabartë. Përvoja e shumë juridiksioneve vendore përgjatë viteve ka qenë e tillë që besimi i publikut mund të zbehet nëse këto institucione krijojnë perceptimin e padrejtësisë duke lejuar mospërputhje të konsiderueshme në dënimin e kryesve të ndryshëm, kur rrethanat e veprave të ndryshme dhe të kryesve janë mjaftueshëm të ngjashme sa që dënimi i shqiptuar do të pritej të ishte gjithashtu i ngjashëm. Kjo nuk nënkupton se trupi gjykses është i detyruar të shqiptojë të njëjtin dënim në një rast sikurse dënimin e shqiptuar në rastin tjetër vetëm për shkak të ngjashmërisë së rrethanave ndërmjet tyre. Me rritjen e numrit të dënimeve të shqiptuara nga Tribunali, eventualisht do të paraqiten edhe kufij apo struktura të dënimeve të shqiptuara në raport me personat kur rrethanat e tyre apo rrethanat e veprave të tyre janë kryesisht të ngjashme. Kur të paraqitet një kufi apo strukturë e tillë, trupi gjykses do të jetë i obliguar që t'i shqyrtojë ata kufij apo atë strukturë të dënimeve, pa qenë i detyruar nga ajo, në mënyrë që të sigurojë se dënimi që shqipton të mos prodhojë pabarazi të paarsyetuar e cila mund të zbehë besimin e publikut në integritetin e administrimit të drejtësisë penale nga ana e Tribunalit".*<sup>8</sup>

Përfundimisht, Udhëzuesit ofrojnë më shumë qartësi mbi metodën më të mirë për matjen e dënimit dhe ofrojnë mjetin për nxjerrjen e rezultateve të ngjashme në rrethana të ngjashme. Konsistenca në qasje, kërkon që të ketë një qasje unike dhe të njëtrajtshme në caktimin e dënimeve në të gjitha rastet. Prandaj, diskrecioni në caktimin e dënimit duhet të ushtrohet në mënyrë parimore. Duhet të ketë një qasje koherente gjyqësore në ushtrimin e diskrecionit, në caktimin e dënimit, e cila kërkon që të gjitha dënimet të bazohen në standarde të përbashkëta – parimet themelore të përgjithshme, të cilat zbatohen në mënyrë uniforme ndaj fakteve të secilit rast.<sup>9</sup> Trajtimi i këtyre pabarazive apo dallimeve është i nevojshëm për të qenë në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe për të përmbushur obligimet që dalin nga ajo në raport me instrumentet

<sup>8</sup> Rasti Nr.IT-96-21-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zejnil Delalic, Adravko Mucic, Hazim Delic dhe Esad Landzo, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (20 shkurt 2001), par.756-757.

<sup>9</sup> Ashworth. A., Drejt standardeve evropiane të dënimit, *Revista Evropiane për Politika Penale dhe Hulumtim*, 1994, fq. 9.

ndërkombëtare. Neni 53 parasheh se “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Në juridiksionet ku fillimisht ka pasur hezitime dhe shqetësime lidhur me kufizimin e pavarësisë, gjykatat shpesh e kanë përqafuar këtë praktikë. Për shembull, në lidhje me Udhëzimet për Caktimin e Dënimit të Gjykatave të instancës së parë të Mbretërisë së Bashkuar, një gjyqtar ka komentuar: “Jeta si gjyqtar pa udhëzime për caktimin e dënimit tani duket e paimagjinueshme. Më tepër se çfarëdo tjetër, ato ia mundësojnë të gjithëve në gjykatë – përfshirë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij – që të shohin një proces transparent të caktimit të dënimit... Këto udhëzime, me qasjen e tyre të strukturuar ndaj seriozitetit të veprës, fajësisë dhe dëmit, [janë] të paçmueshme në sqarimin e çështjeve”.<sup>10</sup>

Kuptimi i vërtetë i parimit të pavarësisë gjyqësore është që me caktimin e dënimit në secilin rast, gjyqtari duhet të administrojë ligjin pa frikë, favorizim, dhembshuri apo keqdashje. Nuk duhet toleruar asnjë presion mbi gjyqtarin që të vendosë në një mënyrë apo tjetër. Brenda kornizave të caktuara nga Parlamenti, diskrecioni nuk duhet ushtruar mbi baza personale apo politike: duhet të vjen vetëm si ushtrim i gjykimit në pajtim me parimin e ligjshmërisë.<sup>11</sup>

## 2. Zbatimi i parimit të proporcionalitetit

Parimi i proporcionalitetit dhe domosdoshmëria e respektimit të tij me rastin e caktimit të sanksionit penal është paraparë me vet dispozitën e parë të Kodit Penal sipas së cilës theksohet:

*“Parashikimi i veprave penale si dhe llojet e masave dhe lartësia e sanksioneve penale për kryesit e veprave penale bazohen në domosdoshmërinë e sanksionit penal-juridik dhe proporcionalitetit të shkallës dhe natyrës së rrezikshmërisë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqërore.”*<sup>12</sup>

Ky nen bën të qartë që dënimi i shqiptuar duhet të merr në konsideratë pikërisht shkallën e rrezikshmërisë ndaj individit por edhe vlerave shoqërore. Fatkeqësisht, jo rrallëherë, ky parim shkelet nga gjykatat duke shqiptuar dënime përtej minimumit të paraparë ligjor dhe pa marrë në konsideratë qëllimin e ligjvënësit me rastin e caktimit të minimeve dhe maksimeve ligjore. Edhe pse vet ligjet e aplikueshme në Kosovë lejojnë diskrecionin e gjykatës në vendimmarrje, ky diskrecion, gjithmonë duhet të jetë në kuadër të parimit të proporcionalitetit.

Derisa në shtetet e zhvilluara, si në SHBA, ekziston një sistem tabelar me rrethanat me ndikim për matjen e dënimit të përfshira në kuadër të matjes tabelare, mënyra se si KPRK i Kosovës është i ndërtuar shumë nga këto rrethana që i referohen rrezikshmërisë dhe shkallës së dëmit ato tashmë janë të inkorporuara në kuadër të vet dispozitave dhe sanksioneve të parapara për veprat e ndryshme penale veç e veç. Megjithatë, ajo që zakonisht mungon në ligjet e Kosovës

<sup>10</sup> Tiede Lydia Brashar, OSBE Shkup, Maqedoni, Analizë e politikave ndëshkimore të Maqedonisë dhe rekomandime për të ardhmen: Drejt një sistemi më të harmonizuar, (Dhjetor 2012), Shtojca 6: Përdorimi i udhëzuesve për dënime nga Anglia dhe Uells. Fq. 40.

<sup>11</sup> Andrew Ashworth, Matja e dënimit dhe drejtësia penale; Pjesa 2 Matja e dënimit dhe Kushtetuta; 2.1 Ndarja e pushteteve në matjen e dënimit fq.58 [Sentencing and Criminal Justice; Part 2 Sentencing and the Constitution; 2.1 The separation of powers in sentencing], Botimi i gjashtë, Cambridge University Press, 2015.

<sup>12</sup> Kodi Nr.06/L-074 Penal I Republikës së Kosovës, Neni 1, Bazat dhe kufijtë e sanksioneve penale, par.2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

apo edhe në ligje të tjera në regjion e më gjerë është një zbrërthim i mëtutjeshëm i mënyrës se si përcaktohet parimi i proporcionalitetit për të caktuar dënimin adekuat për rastet veç e veç.

Një shembull interesant i një zbrërthimi më të detajuar në kuadër të legjislacionit penal paraqitet me reformën në matjen e dënimit të zhvilluar në Izrael në 2012 ku Kodi Penal i këtij vendi ka qartësuar se si arrihet deri te ky parim.

Parimi bazë në matjen e dënimit është proporcionaliteti në mes seriozitetit të veprës së kryer nga i pandehuri dhe shkalla e përgjegjësisë së tij, si dhe lloji dhe lartësia e dënimit të tij.<sup>13</sup> Sipas po të njëjtit ligj, margjina proporcionale e dënimit caktohet duke marrë në konsideratë vlerat shoqërore të dëmtuara me vepër, shkalla e dëmit, praktika e dënimeve për atë vepër dhe, me peshë të veçantë, rrethanat që kanë të bëjnë me veprën e kryer. Vetëm pasi të caktohen kufijtë adekuat të dënimit, atëherë gjykata mund të marrë parasysh edhe rrethana tjera që nuk lidhen domosdoshmërisht me veprën, por që më shumë kanë të bëjnë me të pandehurin.<sup>14</sup>

### ***3. Vlerësimi joadekuat i rrethanave dhe mungesa e Arsyetimit***

Një problem tjetër ka të bëjë me dështimin e gjykatave që të përshkruajnë në mënyrë adekuate arsyet për shqiptimin e dënimit të caktuar. Kjo përfshin si procesin e ndjekur nga gjykata ashtu edhe arsyetimin lidhur me gjetjen apo ekzistimin e rrethanës së caktuar lehtësuese apo rënduese. Siç theksohet nga Këshilli i Evropës, “*gjykatat duhet, në përgjithësi, të cekin arsye konkrete për shqiptimin e dënimeve*”.<sup>15</sup>

Në kuptim të gjerë, Neni 6 i KEDNJ-së kërkon që gjykatat të nxjerrin aktgjykime të arsyetuara në procedurë civile dhe penale. Gjykatat nuk janë të detyruara që të japin përgjigje të detajuara në secilën pyetje, por nëse një parashtrësë është thelbësore për rezultatin përfundimtar të rastit, atëherë gjykata duhet ta trajtojë atë në mënyrë specifike në aktgjykimin e saj.

Për shembull, në rastin *HiroBalani kundër Spanjës*,<sup>16</sup> parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar një parashtrësë në gjykatë për të cilën kërkohet përgjigje specifike dhe e menjëhershme. Duke mos trajtuar çështjen në mënyrë adekuate dhe specifike, ishte e pamundur që të përcaktohet nëse gjykata thjeshtë kishte neglizhuar trajtimin e çështjes apo nëse kishte për qëllim që ta hedhte poshtë. Qoftë edhe nëse qëllimi kishte qenë që ta hedhte poshtë, pala e kishte të pamundur t'i kuptonte shkaqet për hedhje. Në këtë rast ishte konstatuar se kishte shkelje të nenit 6 (1).

Mund të thuhet se, përveç vendimit lidhur me fajësinë, për gjykatën nuk mund të ketë vendim më të rëndësishëm sesa vendimi mbi dënimin. Andaj, është kërkesë absolute që të jepet shpjegim i mjaftueshëm lidhur me atë se si gjykata ka arritur deri te dënimi i shqiptuar në mënyrë

---

<sup>13</sup> Julian V Roberts and Oren Gazal-Ayal, *Reforma ligjore në matjen e dënimit në Izrael: Duke eksploruar Ligjin mbi matjen e dënimit 2012* [Statutory Sentencing Reform in Israel: Exploring the Sentencing Law of 2012], Shtojca A Ligji penal i Izraelit [Annex A Israeli Penal Law] (Amendment No 113) 2012, 2337 LSI 17065, Strukturimi i Diskrecionit gjyqësor në matjen e dënimit, 40b Parimet bazë: Proporcionaliteti [Structuring Judicial Discretion In Sentencing, 40b The Guiding Principle: Proportionality], *Israel Law Review* 46(3) 2013, pp 455–479. © Cambridge University Press and The Faculty of Law, The Hebrew University of Jerusalem, 2013. doi:10.1017/S0021223713000162

<sup>14</sup> Mu aty. 40c Përcaktimi i dënimit proporcional/ Përcaktimi i dënimit [Determining the Proportionate Sentence Range/Determining the Sentence].

<sup>15</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R(92)17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare Lidhur me Harmonizimin e Dënimeve, 19 tetor 1992.

<sup>16</sup> Rita Hiro Balani kundër Spanjës, Appl. Nr. 18064/91, Aktgjykimi i datës 9 dhjetor 1994; citohet gjithashtu edhe në Mendimin Mospajtues të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin Nr.KI 55/09, Shqyrtimi Kushtetues i Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 2407/2006, 30 shtator 2009, paragrafi 26.

që të njoftohet i pandehuri dhe të mbrohen të drejtat e tij. Për më tepër, në këtë mënyrë parandalohet çfarëdo pretendimi për trajtim diskriminues. Siç theksohet nga GJEDNJ-ja në rastin Lithgov:<sup>17</sup> “për qëllim të nenit 14, dallimi diskriminues në trajtim është diskriminues nëse ky dallim nuk ka arsytim objektiv apo të arsyeshëm, pra nëse nuk ndjek ndonjë qëllim legjitim”.

Edhe pse kanë kaluar pesë vjet nga miratimi i Udhëzuesit të përgjithshëm nga Gjykata Supreme, ende vazhdojnë të mbizotërojnë të njëjta problematika përkundër asaj se shihet që ka përmirësime:

- Në përgjithësi, gjykatat nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme, apo në disa raste nuk kanë dhënë arsye fare, për gjetjen e ekzistimit të ndonjë rrethane lehtësuese. Gjetja e ndonjë rrethane rënduese apo lehtësuese, e cila nuk mbështetet me asnjë fakt në shkresa gjithashtu është shkelje e ligjit. Neni 8, paragrafi 2 përcakton që "Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor". Për më tepër, neni 360 qartazi thotë se "Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në fakte, prova dhe procedura në shqyrtim gjyqësor". Rrjedhimisht, dështimi i gjykatës për të paraqitur bazën faktike për vërtetimin e ndonjë rrethane të caktuar mund të shihet si aktgjykim i bazuar në fakte që nuk janë pjesë e shkresave të lëndës apo i pabazuar në fakte. Kjo rezulton në vendime të cilat duken arbitrare.
- Gjykatat shpesh caktojnë në masë të madhe dënime nën minimumin e paraparë ligjor duke u bazuar në rrethana lehtësuese të cilave u jepet peshë e tepruar në matje të dënimit në raport me pasojën e shkaktuar apo të synuar.
- Gjykatat vazhdojnë tu referohen rrethanave lehtësuese të cilat për kategori të caktuara të veprave janë plotësisht jorelevante.
- Gjykatat, si ato themelore po ashtu edhe Gjykata e Apelit, në disa raste kanë përfshirë si rrethanë lehtësuese disa aspekte dhe rrethana të cilat aspak nuk janë të përshtatshme të përfshihen si rrethana lehtësuese apo jashtëzakonisht lehtësuese kur krahasohen me peshën e veprës dhe shkallën e dëmit.
- Caktimi i gjobave penale nuk është në përputhje me gjendjen financiare, si parandalim. Do të duhej të jetë parim që caktimi i gjobës duhet të jetë në pajtim me dispozitat e kodit dhe Udhëzuesin për gjobë e jo përcaktim shabllon pa pasur në konsideratë dallimet në gjendjen financiare të kryesve të ndryshëm.
- Mosdhënia e arsytimit adekuat rreth mënyrës së llogaritjes së peshës dhe llojit të dënimit, gjithashtu është një problematikë e vazhdueshme dhe tregues se gjykata nuk e ka kryer në mënyrë adekuate detyrën e saj sipas ligjit. Nuk ka asnjë dispozitë në KPRKP e cila e liron apo e minimizon detyrimin e gjykatës për të ofruar arsytim të plotë lidhur me vendimin mbi dënimin. Përderisa shihen përmirësime të dukshme në aspektin e arsytimit, prapëseprapë vendimet me arsytime adekuate për mënyrën e vendosjes rreth dënimit dhe zbërthimi i rrethanave adekuate të marra parasysh, janë në numër të vogël krahasuar me vendimet e paarsyetuara mirë.

Këto mangësi sistematike në politikën ndëshkimore janë të rëndësishme dhe dëshmojnë një mungesë orientimi dhe kontrolli gjyqësor. Në thelbin e saj, dështimi për të shpjeguar në mënyrë adekuate bazën për caktimin e dënimit paragjykon të dyja palët. Për të akuzuarin, mosdhënia e një arsytimi të qëndrueshëm për rrethanat rënduese rezulton në një dënim të pambështetur në fakte. Kjo është padrejtësi. Gjithashtu, edhe shqiptimi i një dënimi më të ulët bazuar në rrethana

---

<sup>17</sup> Lithgov dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; 9405/81, Strasburg, 8 korrik 1986.



lehtësuese të pambështetura bën që vendimi t'i nënshtrohet ankesës e cila do të mund të shmangej dhe si rrjedhojë të pandehurit i mohohet e drejta për proces të drejtë e të shpejtë. Ngjashëm me këtë, prokurorisë dhe publikut të gjerë gjithashtu i mohohen të drejtat kryesore të shoqërisë lidhur me dënimin pasi që të pandehurit i shqiptohet dënim më i ulët se që do t'i ishte shqiptuar po t'i përmbahej gjykata detyrimit të saj për t'ia përshtatur dënimin vetëm atyre rrethanave të cilat janë provuar. Problemi rëndohet edhe më shumë kur rrethana lehtësuese të paarsyetuara përdoren për të arsyetuar një dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për atë vepër.

#### ***4. Transparenca, ligjshmëria dhe besueshmëria e opinionit publik***

Praktikat aktuale të matjes së dënimeve gjithashtu sjellin deri te ulja e transparencës, cenojnë parimin e legalitetit dhe kontribuojnë në masë të madhe në opinionin negativ për gjyqësorin. Që të tre këta faktorë e zbehin edhe më tej sundimin e ligjit.

##### **4.1 Transparenca**

Dështimi i praktikës aktuale ndikon negativisht në transparencën e përgjithshme të sistemit të drejtësisë. KPRK-ja dhe KPPRK-ja kanë paraparë kriteret e cilat e ngritin transparencën e përgjithshme të vendimmarrjes gjyqësore – siç është natyra publike e procedurave gjyqësore dhe detyrimi për shpalljen publike të aktgjykimeve. Publikimi i aktgjykimeve, procedurat e qarta për zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe kufijtë e dënimeve specifike gjithashtu luajnë një rol të madh në këtë proces. Informacionet mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe prania e publikut në procedurë gjyqësore kontribuojnë në pranueshmërinë shoqërore të gjyqësorit. Gjyqtarët sigurojnë transparencën përmes seancave publike dhe duke dhënë arsytet e tyre për vendimet e marra, njëkohësisht ruajnë konfidencialitetin e kërkuar për të respektuar të pandehurin, si dhe nevojën për rend publik.<sup>18</sup> Në përgjithësi, koncepti është se qasja dhe informimi për funksionimin e sistemit do të ndikojë në formimin e njohurive të përgjithshme për sistemin. Kjo gjithashtu përmirëson aftësinë e publikut dhe institucioneve përkatëse qeveritare për të monitoruar, vlerësuar dhe, nëse është nevoja, për të bërë ndryshimet dhe korrigjimet e duhura të sistemit juridik ekzistues.

Megjithatë, praktikat aktuale të dënimeve nuk e mbështesin transparencën, por përkundrazi ato e ulin atë. Palët, publiku dhe gjykata e instancës më të lartë, nuk mund ta kuptojnë bazën e cila ka shërbyer për caktimin e një dënimi nëse gjykata nuk i referohet fakteve përkatëse. Me dhënie të arsyeve të mjaftueshme dhe ndjekjen e procedurës së paraparë, gjykata dhe procesi bëhen më transparent dhe më të qasshëm.

##### **4.2 Parimi i legalitetit**

Vendimet mbi dënimin gjithashtu prekin edhe parimin e legalitetit. Në përgjithësi, parimi nënkupton që ligji duhet të jetë i qartë për palët, në veçanti për të pandehurin, dhe që rregullat duhet të jenë të përcaktuara paraprakisht. Sa më i qartë të jetë ligji, aq më korrekte ka gjasa të jetë procedura për palët e interesuara.

Kjo gjithashtu vë një shkallë të parashikimit të rezultatit përfundimtar dhe i mundëson të akuzuarit qasje në mekanizmat, të cilët sistemi i drejtësisë i shfrytëzon për llogaritjen e dënimeve.

---

<sup>18</sup> Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësor (RREKGJ), Raporti i Etikës Gjyqësore 2009-2010, fq. 9

Kur individi ka qasje në këtë informacion, atëherë ai mund të parashikojë natyrën dhe kohëzgjatjen e dënimit që do të ishte i përshtatshëm për veprën penale.

Parashikimi dhe parimi i legalitetit gjithashtu e rrisin efikasitetin e sistemit të drejtësisë – një gjë kjo shumë e nevojshme në Kosovë. Për shembull, KPPRK-ja është mjaft i qartë në përcaktimin e detyrimit për dorëzimin e provave të pandehurit para shqyrtimit gjyqësor. Kjo i mundëson të pandehurit për të bërë një vlerësim, relativisht adekuat lidhur me gjasën e tij për t'u liruar në shqyrtim gjyqësor. KPPRK-ja gjithashtu parasheh kufizime, sipas nenit 230, për negocimin e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë, të cilat mundësojnë procedura të përsheptuara në shkëmbim të një dënimi më të butë. I pandehuri ka mundësi të merr një dënim të njohur për të në shkëmbim të pranimit të fajësisë. Këto dy dispozita krijojnë një proces për të përmirësuar shkallën e lëndëve të kryera. Praktika aktuale nuk jep mundësi për të vlerësuar gjasën e një dënimi të caktuar në fund të një gjykimi i cili rezulton me aktgjykim dënues. **Me praktika të deritashme – siç është paqartësia se ku të përcaktohet pikënisja, shmangia nga dënimet minimale pa arsytim dhe vlerësimi i rrethanave lehtësuese të cilat nuk mbështeten nga shkresat e lëndës – nuk ka motivim për të përfituar nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.** Thjesht, nuk ka ndonjë arsye logjike për të mos shkuar në shqyrtim gjyqësor, i cili mund të rezultojë në aktgjykim lirues, apo edhe dënim më të ulët se dënimi i ofruar në marrëveshje mbi pranim të fajësisë.

Së fundi, zbehja e këtij parimi nga praktikat aktuale dëmton legjitimitetin e sistemit të drejtësisë si tërësi dhe zvogëlon në mënyrë drastike efikasitetin e gjyqësorit. Udhëzuesit ofrojnë mundësinë për ta përmirësuar situatën pa ndonjë kufizim të padrejtë. Duke sqaruar procedurat dhe duke siguruar që ato të ndiqen në mënyrë harmonike, të pandehurit dhe shoqërisë në tërësi i jepen mjetet për të kuptuar dhe "njohur" sistemin juridik, dhe rrjedhimisht përmirësohet efikasiteti i përgjithshëm i sistemit.

### 4.3 Besueshmëria e opinionit publik në vendimmarrjen e gjykatës

Problemet rreth matjes së dënimit nuk janë të kufizuara vetëm te ndikimi në palë, ato kanë implikime më të gjera për shoqërinë në përgjithësi. Një gjykatë profesionale ka ndikim përtej kufijve të gjykatores së saj. Opinionet dhe profesionalizmi i tyre do të ndikojnë në perceptimin e qytetarëve të Kosovës për gjyqësorin.

Vendimet për dënimin kanë shumë rëndësi për shoqërinë si tërësi dhe mënyra se si ajo e sheh gjyqësorin ka të bëjë më mënyrën se si ajo e sheh aftësinë e gjykatës për të ndarë drejtësi për ta, për të dashurit dhe për miqtë e tyre. Drejtësia, jo vetëm që duhet të bëhet, por edhe duhet parë se po bëhet. Me publikimin e aktgjykimeve, publiku gjithnjë e më tepër ka mundësi të vlerësojë mënyrën se si kanë vepruar gjykatat gjatë vendimmarrjes së tyre, andaj vendimet e mangëta në mënyrë serioze dëmtojnë imazhin e gjyqësorit. E kundërta, besimi në paanshmërinë e sistemit të drejtësisë në fund do të përkthehet në një ndjenjë sigurie dhe besimi dhe do të përforcojë në mënyrë të dukshme parimet e sundimit të ligjit.

Sipas Përmbledhjes së Pulsit Publik-XXII<sup>19</sup> për vitin 2024, prej më shumë se 1300 të anketuarve 27.10% ishin shprehur të kënaqur me sistemin gjyqësor dhe 26.50% me sistemin prokurorial. Sistemit të drejtësisë edhe më tej i mbetet shumë punë për të bërë, përderisa përqindja e kënaqësisë ndaj tij është më e ulët se ajo ndaj Presidencës (69%), Ekzekutivit (53.30%) dhe Legjislativit (52.10%).

---

<sup>19</sup> UNDP në Kosovë, Përmbledhja e Pulsit Publik, XXVI, fq.6, UNDP dhe USAID, Maj 2024.

Argumenti është se dënimet, të paktën për disa vepra, janë tepër të ulëta për shkak se gjykata e caktuar nuk pajtohet me lartësinë e dënimit të paraparë për atë vepër. Në thelb, kjo paraqet shmangie nga legjislacioni. Fakti që gjykata mendon, për shembull, se për veprën penale “Dhunimi” nga Neni 227 par.1 i KPRK-së dënimi prej 2 deri në 10 vjee, është i lartë, rezulton në shumë raste me shqiptimin e dënimit minimal. Kështu Raporti i EULEX-it i vitit 2022<sup>20</sup>, që ka analizuar aktgjykimet liruese, në raste të dhunimit është konstatuar se si shkas për to janë marrë:

- mungesa e provave të dhunës (duke përfshirë mungesën e lëndimeve në zonën gjenitale të viktimave);
- pamundësia e mëvonshme e paraqitur nga gjykatat për të provuar se i pandehuri e ka kryer krimin.
- tërheqjen apo ndryshimin e deklaratës nga viktimja gjatë procesit gjyqësor.
- pëlqimin e nënkuptuar të viktimës, duke u bazuar në faktin se viktimja kishte pasur marrëdhënie të mëparshme kryesin edhe më përpara
- se pala e dëmtuar kishte shkuar në vendin e krimit të pretenduar me persona të panjohur. Gjykata nga këto veprime konstatoi se viktimja në heshtje ka dhënë pëlqimin për marrëdhënie seksuale.

Në rastin Vertigo kundër Filipineve, të trajtuar në po këtë raport, janë paraqitur edhe të gjeturat e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër grave (CEDAW) si në vijim: *“Komiteti vlerësoi se gjykata i bazoi gabimisht gjetjet e saj në mitet dhe stereotipat në baza gjinore për dhunimin dhe viktimat e dhunimit, si dhe deklaroi se nuk duhet të ketë asnjë supozim në ligj apo praktikë që një grua e jep pëlqimin e saj vetëm sepse ajo nuk i reziston fizikisht sjelljes së padëshiruar seksuale. Këto mite shpesh shoqërohen me mite/supozime të tjera të zakonshme për dhunimin, si ato që lidhen me pamjen dhe karakterin e viktimës që ndikojnë në besueshmërinë e saj, si dhe kohën dhe vendin e dhunimit (d.m.th., nëse viktimja ka shkuar në një motel, ai /ajo është dashur ta dinte se çfarë e priste).<sup>21</sup>*

Praktika të tilla, fatkeqësisht janë të pranishme edhe në Kosovë. Duke arsyetuar dhunimin përmes fajësimit të viktimës, shfajësimit të kryesve apo edhe dënimit minimal të tyre, gjykata shprehimisht shfaqë mospajtimin e vet me kufijtë e paraparë ligjor për ato vepra. Duke vepruar kështu, gjykata jo vetëm që ul vlerat morale të saj, por edhe tejkalon autorizimet e saj që i takojnë në bazë të Kushtetutës.

---

<sup>20</sup> Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunimit nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, Raport i monitorimit, EULEX, Fq.26, Korrik 2022.

<sup>21</sup> Mu aty, fq.28

## II. Aspekte procedurale të matjes së dënimit

### 1. Risitë e Kodit të procedurës penale

Një nga risitë më domethënëse në KPPRK, që në masë të madhe pritet ti kontribuojë avancimit të parimeve të matjes së dënimit, në Republikën e Kosovës është përfshirja e seancës së veçantë për matjen e dënimit. Kjo seancë nga Neni 356 e përfshirë, për herë të parë, me ndryshimet e fundit të KPPRK<sup>22</sup>-së po ashtu mundëson angazhimin aktiv të palëve në procedurë. Duke mos pasur barrën e përcaktimit të fajësisë (pasi fajësia tashmë është caktuar paraprakisht), si prokurorit, po ashtu edhe mbrojtjes i mundësohet një fokus shumë më efektiv mbi atë se çfarë është me rëndësi për matjen e dënimit. Edhe pala e dëmtuar apo viktima, me këtë seancë e ka edhe një mundësi shumë të volitshme që të shprehet në aspekt të ndikimit fizik, psikologjik dhe financiar të veprës së kryer nga i pandehuri.

Nga të gjitha seancat që zhvillohen në gjykatore, asnjëra nuk është më e rëndësishme, më emocionale dhe më me ndikim sesa seanca për caktimin e dënimit. Caktimi i dënimit për të pandehurin është kulmim i hetimit dhe ndjekjes penale. Është koha kur shteti dënon kryesin për shkeljen penale të normave shoqërore.<sup>23</sup>

Kjo seancë i ngjason procesit para Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GJNP). Dispozita e paragrafit 2 të nenit 76 të Statutit të GJNP-së krijon mundësinë e një seance të ndarë të caktimit të dënimit para përfundimit të gjykimit, në mënyrë që të shqyrtohen provat shtesë apo parashtresat lidhur me caktimin e dënimit. Njësoj, sikurse edhe në rastin e GJNP-së, edhe në Kosovë, seanca nuk është e detyrueshme dhe thirret në bazë të kërkesës së palës apo gjykatës.

Për herë të parë me këtë seancë në mënyrë taksative është paraparë edhe roli i Shërbimit Sprovues në paraqitjen e raportit para ndëshkues me të dhëna vitale për vendimmarrjen korrekte të gjykatës, duke mundësuar sa më shumë individualizimin e dënimit. Edhe pse sfiduese, si praktikë e re, me kohë sistemi i drejtësisë do ta ketë mundësinë të ndërtojë një praktikë konsistente që çon drejt harmonizimit të dënimit. Në fakt, është pikërisht kjo seancë ajo që do të mundësojë një zbatim më të gjerë edhe të udhëzuesve të Gjykatës Supreme që lidhen me matjen e dënimit. Rrjedhimisht, me këtë mundësohet edhe trajtimi i barabartë i kryesve në kushte dhe rrethana të ngjashme.

Vendimi për caktimin e dënimit mund të konsiderohet i drejtë për nga dhënia e mundësive vetëm nëse lejohet paraqitje e plotë dhe e fuqishme e argumenteve dhe provave nga të gjitha palët, dhe si rrjedhojë ka më pak gjasa që të prishet apo ndryshohet sipas ankesës. Kjo gjithashtu është në pajtim me parimin e barazisë së armëve të mishëruar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,<sup>24</sup> e cila përcakton që të gjitha palët duhet të kenë mundësi të barabartë në procedurë për të paraqitur dhe komentuar mbi të gjitha provat e paraqitura para gjykatës për shqyrtim.

---

<sup>22</sup> Kodi Nr.08/L-032 i procedurës penale të Republikës së Kosovës, Neni 356, Seanca për caktimin e dënimit pas pranimit të fajësisë apo aktgjykimit dënues, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 24 / 17 Gusht 2022, Prishtinë

<sup>23</sup> Williams C.J., Matja e dënimit, Parimet dhe Strategjia [The Importance of Effective Sentencing Advocacy], Rëndësia e matjes efikase të dënimit [Sentencing Advocacy, Principles and Strategy], fq.3, McFarland & Company, Inc., Publishers, Jefferson North Carolina.

## **2. Standardi i të provuarit**

Në disa sisteme juridike standardi i të provuarit për caktimin e dënimit dallon nga standardi që kërkon shpalljen fajtor të të pandehurit për vepër penale. Në shumicën e rasteve kur ky standard është i ndarë, përfundimi i gjykatës nëse ekzistimi i fakteve që mbështesin ashpërsimin ose zbutjen e dënimit është provuar bazohet në një standard të të provuarit i cili është më i ulët se vërtetimi i fajësisë. Në disa raste kjo mund të ndahet edhe më tutje duke bërë që barra e të provuarit të ekzistimit të një rrethane rënduese të jetë barrë më e lartë se barra e të provuarit të një rrethane lehtësuese. Për shembull, lidhur me këtë të fundit, gjykata mund të zbatojë tri standarde të ndryshme: të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm për të vërtetuar fajësinë, të provuarit me prova të qarta dhe bindëse për të vërtetuar ekzistimin e rrethanës rënduese, dhe të provuarit përmes probabilitetit për të përcaktuar rrethanën lehtësuese.

Çelësi për të ngritur korrektësinë e përgjithshme të sistemit dhe për të maksimizuar parimin e legalitetit është që të sigurohet harmonizimi në zbatim. Andaj, pyetjet më të rëndësishme janë këto në vijim:

***A përmban kodë, qoftë shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar, ndonjë standard të të provuarit për të vlerësuar ekzistimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese?***

***Nëse përmban ndonjë standard të tillë, a është ky standard i njëjtë apo i ndryshëm me standardin i cili zbatohet për përcaktimin e fajësisë?***

Lidhur me pyetjen e parë, nuk ka ndonjë dispozitë konkrete se cili është standardi i të provuarit të cilin gjykata duhet ta zbatojë për të vlerësuar praninë e rrethanave rënduese apo lehtësuese. I njëjti rast është edhe me standardin për përcaktimin e fajësisë, për të cilin gjithashtu nuk ka ndonjë dispozitë konkrete. Megjithatë, ka disa standarde në kuadër të kodit të cilat japin disa udhëzime.

Në KPPRK parashihen pesë standarde të cilat zbatohen për procedura të ndryshme: (1) dyshimi i arsyeshëm, (2) dyshimi i bazuar, (3) shkak i bazuar, (4) gjasa reale, dhe (5) dyshimi i bazuar mirë. Secila prej tyre përmban komponentë të perspektivës, informacionit, dhe nivel të caktuar të bindjes se i pandehuri potencial ka kryer veprën. Kur kombinohen këta komponentë, ata formojnë një standard të qartë të të provuarit që kërkohet për të siguruar çfarëdo veprimi apo hapi që kërkohet në procedurë. Në nivelin më të lartë është koncepti i dyshimit të bazuar mirë, i cili kërkohet për ngritjen e aktakuzës, e që nënkupton prova të pranueshme të cilat do të bindnin një vëzhgues objektiv se vepra penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri. Pasi që prokurori është i detyruar ta plotësojë këtë standard për të ngritur aktakuzë dhe për të vazhduar tutje në fazën e shqyrtimit gjyqësor, atëherë rrjedh se standardi i të provuarit për gjetjen e fajësisë është për disa shkallë të të provuarit më i lartë se dyshimi i bazuar mirë. Duke marrë parasysh faktin se procedura për caktimin e dënimit është gjithashtu pjesë e këtij procesi, atëherë është e logjikshme që ky standard të jetë së paku dyshimi i bazuar mirë.

Lidhur me atë se cili standard duhet të zbatohet, KPRK-ja dhe KPPRK-ja nuk japin përgjigje definitive. Në përgjithësi, praktikat ndërkombëtare të caktimit të dënimit dhe praktika e Tribunalit të Hagës vënë një standard më të lartë të të provuarit për të vërtetuar ekzistimin e rrethanave rënduese në krahasim me ato lehtësuese. Duke marrë parasysh faktin se rrethana rënduese është e ndërtuar për të ashpërsuar dënimin e matur ndaj të pandehurit, gjykata duhet të sigurojë që provat e paraqitura të vërtetojnë ekzistimin e rrethanës rënduese përtej dyshimit të arsyeshëm. Ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese, nuk ka ndonjë konsensus, prandaj edhe standardi, siç u cek më herët, është dyshimi i bazuar mirë.

Tribunali i Hagës gjatë vendosjes për caktimin e dënimit ka trajtuar standardin e të provuarit për rrethanat rënduese dhe lehtësuese në disa prej rasteve të trajtuara nga ky Tribunal. Kështu në rastin Kunarac, Kovaç dhe Vuković, Trupi gjykues kishte deklaruar: "*Drejtesia kërkon që prokurori të provojë rrethanat rënduese përtej dyshimit të arsyeshëm, ndërsa mbrojtja duhet të provojë rrethanat lehtësuese vetëm sipas balancit të probabilitetit*".<sup>25</sup> Trupi Gjykues ngjashëm kishte ripërsëritur këtë edhe në rastin Simiq, duke thënë se: "*Rrethanat lehtësuese duhet të provohen vetëm sipas balancës së probabiliteteve e jo përtej dyshimit të arsyeshëm*".<sup>26</sup>

Një shembull se si standardi i të provuarit mund të caktohet në ligj e gjejmë në Ligjin penal në Izrael, më saktësisht në ndryshimet e këtij ligji bërë në vitin 2012. Sipas Nenit 40 paragrafi (c) i këtij Ligji<sup>27</sup> theksohet se: "*Gjykatat do të zbatojnë standardin e dyshimit të arsyeshëm për të provuar rrethanat rënduese, ndërsaq standardin e probabilitetit civil për të provuar rrethanat lehtësuese*."

Shembujt e sipërpërmendur nga praktikat dhe ligjet e vendeve tjera janë paraqitur vetëm për të ritheksuar dhe vënë theksin në atë se si mund të aplikohen standarde të ndryshme për vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese.

Duke marrë parasysh mungesën e udhëzimeve në KPRK lidhur me çështjen e caktimit të dënimit, gjykatat të cilat kanë vështirësi në miratimin e qasjes së vet sistematike mund të zbatojnë këtë formë të standardit të ndryshëm varësisht a bëhet fjalë për lehtësim apo ashpërsim të dënimit. Ndonëse gjykata mund të ketë plotësisht të drejtë të kërkojë zgjidhjet e veta për këtë mangësi, problemi është se jo secila gjykatë do të arrijë të i njëjti standard.

Kur gjykata dëshiron të merr parasysh si rrethanë rënduese ndonjë faktor që nuk është pjesë e përkufizimit të veprës penale, duhet të sigurohet që rrethana rënduese të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm, dhe para se gjykata të refuzojë të marrë parasysh ndonjë rrethanë lehtësuese, duhet të sigurohet që rrethana përkatëse nuk ekziston.<sup>28</sup>

Lloji i provave që duhet paraqitur nga palët për të vërtetuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese është mjaft i thjeshtë. Secila provë, e cila paraqitet për t'u shqyrtuar në lidhje me caktimin e dënimit, duhet t'i nënshtrohet trajtimit nga gjykata njëjtë sikurse provat e paraqitura për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit. Është veçanërisht e rëndësishme që gjykatat duhet të kërkojnë nga palët që të paraqesin prova të cilat mbështesin pretendimet lidhur me ekzistimin e një rrethane rënduese apo lehtësuese, sepse vetëm pretendimi i palëve për ekzistimin e një rrethane të tillë nuk mjafton.

Si përfundim, procedura e mësipërme do të maksimizojë transparencën e procesit të matjes së dënimit, zbatimin e parimit të legalitetit dhe barazinë e armëve. Duke artikuluar qartë pritshmërinë e gjykatës para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, të gjitha palët i kuptojnë detyrimet e

---

<sup>25</sup> Rasti Nr.IT-96-23-T&IT-96-23/1-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Dragoljub Kunarac, Radomir Kovac and Zoran Vukovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (22 shkurt 2001), Par.847.

<sup>26</sup> Rasti Nr.IT-95-9/2-S, Aktgjykimi për caktim të dënimit, Prokurori kundër Milan Simic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (17 tetor 2002), Par.40. Citohet Prokurori kundër Radislav Krstic, Rasti Nr. IT-98-33-T, Aktgjykimi ("Aktgjykimi Krstic"), para. 713.

<sup>27</sup> Penal Law (Amendment No 113) 2012, 2337 LSI 17065, Structuring Judicial Discretion in Sentencing. Marrë nga Roberts, Julian V. and Gazal-Ayal, Oren, Reforma ligjore për matjen e dëniit në Izrael: Eksplorimi i Ligjit për dënimet 2012 [Statutory Sentencing Reform in Israel: Exploring the Sentencing Law of 2012 (November 1, 2013)]. Israel Law Review, 46(3), p. 455-479, Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=3181893>

<sup>28</sup> Rekomandimi i Këshillit të Evropës Nr. R(92) 17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me konsistencën në dënime; Shtojca e Rekomandimit Nr. R(92) 17; C. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese, nënparagrafi 3.

tyre, procedurën që duhet ndjekur dhe zgjedhjet strategjike të cilat duhet t'i bëjnë. Ato po ashtu kuptojnë se cilat prova duhet paraqitur për të vërtetuar ekzistimin e ndonjë rrethane të caktuar lehtësuese apo rënduese. Në fund, procesi është uniform në zbatim dhe rezulton në vendime të cilat janë plotësisht të bazuara në pretendimet e palëve dhe në vlerësimin e gjykatës për ato pretendime e që si rrjedhojë ka më pak gjasa që të priset sipas ankesës.

### **3. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë**

Ndonëse procedurat alternative për zgjidhjen e rasteve janë relativisht të reja, ato kanë fituar popullaritet anëmbanë botës si metoda për të ruajtur dhe priorizuar burimet. Një nga procedurat më kontroverse, por që edhe pse e re ka gjetur zbatim, është marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

Ndonëse gjykata ka aftësi të kufizuar për t'u përfshirë në negocimin ndërmjet të pandehurit dhe prokurorit, megjithatë ajo e ka fjalën e fundit nëse marrëveshja mbi pranim të fajësisë do të pranohet apo jo. Dispozitat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë së të pandehurit janë të rregulluara me nenin 230<sup>29</sup> të KPPRK-së dhe dispozitat që kanë të bëjnë me dënimet në KPRK. Ka disa konsiderata të rëndësishme të cilave gjykata duhet t'iu përmbahet.

Në përgjithësi, prokurori ka mundësi të ofrojë një dënim i cili është brenda kufizimeve të parapara në Kod. Çdo dënim, ligjrisht i mundshëm, mund të ofrohet nga prokurori dhe të pranohet nga i pandehuri. Kjo nuk nënkupton që prokurori duhet ta bëjë ofertën minimale kurdo që është në dispozicion. Përcaktimi i marrëveshjes së duhur mbi pranimin e fajësisë është vendim brenda gjykimit të prokurorit që duhet t'i merrë në konsideratë një sërë rrethanash. Pavarësisht kësaj, fakti që prokurori e jep një ofertë të caktuar, NUK nënkupton që gjykata DUHET ta pranojë dhe zbatojë atë. Gjykata është përcaktuesi përfundimtar i asaj nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është e pranueshme, mirëpo duhet ta respektojë deri në masë të caktuar vendimin e prokurorit. Prokurori duhet të përfshijë në marrëveshje për pranim të fajësisë, së paku:

- Pikat e aktakuzës për të cilat i pandehuri pranon fajësinë;
- Nëse i pandehuri pranon të bashkëpunojë;
- Të drejtat nga të cilat hiqet dorë;
- Përgjegjësia e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe konfiskimi i të gjitha pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit.

Ndonëse prokurori ka mundësi për të arritur marrëveshje për pranim të fajësisë, kjo nuk nënkupton se gjykata është e detyruar ta pranojë atë. Neni 230 shpjegon se për ta pranuar marrëveshjen për pranim të fajësisë, gjykata duhet të vlerësojë pozitivisht disa rrethana, të cilat janë:

- 17.1. i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- 17.2. pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, nëse ka mbrojtës, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë;
- 17.3. pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura nga prokurori për plotësimin e

<sup>29</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 08/L-032, Neni 230 Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.24, 17 Gusht 2022, Prishtinë.

aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri, si dhe me dëshmi tjera, siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori apo i pandehuri; dhe

- 17.4. nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248, paragrafi 1 i këtij Kodi.

Padyshim se shqetësimi kryesor i gjykatës do të jetë dënimi i ofruar/rekomanduar nga prokurori dhe nëse gjykata pajtohet se ky dënim është i pranueshëm. Proceduralisht, kodi i lejon gjykatës që ta pranojë marrëveshjen dhe të shqiptojë dënimin i cili është më i lartë se dënimi i rekomanduar nga prokurori. Kjo kryesisht, bazohet në shqetësimin se pas pranimit të marrëveshjes, gjykata mund të vlerësojë nëse ka rrethana të pamjaftueshme për të arritur deri te dënimi i rekomanduar nga prokurori apo mund të ketë fakte të cilat e ndryshojnë pozitën e gjykatës në mënyrë substanciale. Ndonëse kjo i jep gjykatës fleksibilitet maksimal për të caktuar një dënim i cili arsyetohet nga faktet, shqiptimi i dënimin më të lartë se dënimi i rekomanduar do të shkatërrojë motivimin për arritjen e marrëveshjeve për pranim të fajësisë, e që në radhë të parë është siguria e dënimin të cilin e pret i pandehuri, në shkëmbim të heqjes dorë nga gjykimi i rregullt.

Për të korrigjuar këtë problem potencial, gjykata duhet që ta refuzojë marrëveshjen, në seancën për shqyrtim të marrëveshjes, nëse ka shqetësime se dënimi i propozuar nuk është i arsyeshëm. Gjykatës i lejohej ta bëjë këtë sipas paragrafit 17.1 (më lart) bazuar në argumentin se i pandehuri nuk e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes mbi pranim të fajësisë, respektivisht se atij do t'i shqiptohet dënim i cili është më i lartë se dënimi i negociuar. Nëse gjykata, tashmë, e ka pranuar marrëveshjen fillestare dhe mëson për fakte të cilat nuk do të lejojnë shqiptimin e dënimin të dakorduar në marrëveshje, ajo mund ta njoftojë të pandehurin dhe ta refuzojë marrëveshjen duke u thirrur në bazën se i pandehuri tanimë nuk i kupton pasojat e marrëveshjes.

Nuk ka ndonjë kërkesë specifike nëse të pandehurit duhet ofruar një dënim brenda kufijve të caktuar apo një dënim specifik në shkëmbim të pranimit të fajësisë. Secila i ka meritat e veta. Gjithashtu, nuk ka ndonjë kërkesë që i pandehuri ta pranojë fajësinë për secilën vepër penale të përfshirë në aktakuzë. Gjykata duhet ta vlerësojë dënimin e rekomanduar dhe akuzat në tërësinë e tyre dhe të vendosë nëse ka bazë të mjaftueshme për ta shqiptuar dënimin e propozuar. Gjykata, çdoherë duhet të kërkojë nga prokuroria dhe mbrojtja që ta arsyetojnë dënimin e propozuar.

Përfundimisht, në mënyrë që të lehtësohet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe të shpejtohet procedimi i rastit, gjykatat inkurajohen fuqishëm që t'i refuzojnë marrëveshjet për pranim të fajësisë të cilat janë të papranueshme dhe të lejojnë ri negociimin e tyre në vend se të shqiptojnë dënim jashtë dënimin të propozuar në marrëveshje dhe kështu të shmangin ankesat dhe zgjidhjen e rastit në nivel të shkallës së apelit.



### III. Dënimet kryesore sipas KPRK-së

Dënimet kryesore përbëjnë dispozitat bazike të dënimit të KPRK-së dhe janë të shpjguara në përgjithësi në nenet 40-45. Neni 40 përcakton tri llojet e dënimeve kryesore: (1) dënimi me burgim të përjetshëm, (2) dënimi me burgim, dhe (3) dënimi me gjobë. Megjithatë, jo secili prej tyre është i mundshëm dhe gjykata duhet t'i lexojë këto dispozita të përgjithshme në lidhje me dispozitat e veprave penale specifike. Kur lexohen së bashku, gjykatës i jepen këto mundësi: (1) kufijtë e dënimit me burgim prej dënimit minimal deri në dënimin maksimal; (2) nëse gjoba mund të shqiptohet si zëvendësim i dënimit me burgim; (3) nëse gjoba mund të shqiptohet krahas dënimit me burgim; dhe (4) nëse ka një shumë maksimale apo "kufi" të gjobës.

#### 1. Dënimi me burgim

Kufijtë e mundshëm të dënimeve me burgim varen nga vepra penale dhe ka një mori të frazave dhe metodave që përdoren për t'i shpjguar ato. Shumica dërmuese e dënimeve të parapara në kod parashohin një numër të caktuar të viteve si për minimumin ashtu dhe për maksimumin e dënimit. Për shembull, një prej kufijve më të shpeshtë të dënimeve në kod është dënimi prej 6 muaj si minimum deri në 5 vjet si maksimum.

Përveç kufijve definitivë, kodi parasheh edhe dënime tjera të cilat përmbajnë shprehje përshkruese për maksimumet dhe minimumet. Për dënimin minimal, Kodi përdor dy shprehje: "jo më pak se" dhe "së paku". Të dyja këto shprehje janë të ndryshueshme dhe përcaktojnë dënimin minimal por nuk e përcaktojnë maksimumin. Gjykata në raste të tilla duhet t'i referohet nenit 42 paragrafi 1 për të konstatuar maksimumin, i cili është njëzet e pesë (25) vjet.

Kodi parasheh edhe një numër të dënimeve (në 324 paragrafë të shpërndarë në 175 nene të KPRK-së) të cilat nuk përcaktojnë minimumin. Këto përdorin shprehjen "deri në" apo "jo më shumë se" periudhën prej x muajve/vjetëve. Minimumi gjithashtu përcaktohet nga neni 42 paragrafi 1 i cili thotë se dënimi minimal nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë. Prandaj kufiri i poshtëm i dënimit, për shembull për rastet kur dënimi i paraparë është "deri në 12 vjet" është 30 ditë.

KPRK-ja paraqitet mjaft e rreptë për disa nga veprat penale duke paraparë minimume mjaft të larta prej 10, 15 dhe 20 vjetësh. Këto dënime vërehen në 67 paragrafë të shpërndara në kapituj të ndryshëm të KPRK-së.

**Për dallim nga Udhëzuesi i vitit 2018 kur ishte vendosur mesatarja në mes minimumit dhe maksimumit të paraparë ligjor si pikënisje për të gjitha dënimet e parapara me Kod Penal, me revidimin e Udhëzuesit është vendosur një qasje më e ndryshme.** Edhe pse, në fakt ligjvënësi ka paraparë një minimum dhe maksimum ligjor, ka qenë mendim i përgjithshëm i gjyqtarëve që Udhëzuesi i reviduar të ketë ndryshim pikërisht në aspektin e caktimit të pikënisjes. Pikënisje të ndryshme janë dedikuar edhe brenda të njëjtit kapitull të KPRK-së dhe atë varësisht nga ajo se sa ato vepra paraqesin rrezikshmëri shoqërore, apo nga ajo se ndoshta veprat e një kategorie janë më të përhapura përgjatë një periudhe të caktuar kohore dhe është interes shtetëror që të ketë një politikë më të ashpër si në ligjvënien ashtu edhe në implementim.

**Kështu, siç do të vëreni edhe nga pjesa e veçantë për secilin kapitull të KPRK-së, janë caktuar edhe shkallë të ndryshme të pikënisjes dhe atë 1/3, 1/2 apo 2/3 varësisht nga**

**specifikat e veprave.** Përmes një shkallëzimi të tillë, Gjykata Supreme synon që Udhëzuesin ta bëjë sa më të zbatueshëm për gjyqësorin. Në përgjithësi, KPRK-ja parasheh kufij më të gjerë për vepra më të rënda penale dhe kufij më të ngushtë për vepra më pak të rënda.

## **2. Dënimi me burgim të përjetshëm**

Dënimi me burgim të përjetshëm parashihet për veprat më të rënda penale të parapara në KPRK dhe rrjedhimisht mund të shqiptohet vetëm nëse parashihet shprehimisht për atë vepër penale. Dënimi me burgim të përjetshëm parashihet si mundësi për një mori veprash penale të parapara në Kod. Sipas Neni 42 paragrafi 2, gjykatës gjithashtu i jepet mundësia që në vend të burgimit të përjetshëm të shqiptojë dënim me burgim deri në 35 vjet. Neni 41, përcakton se dënimi me burgim të përjetshëm mund të shqiptohet për veprat më të rënda penale të kryera nën "rrethana veçanërisht rënduese" ose për vepra penale që "kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda".

**Një tjetër risi e Udhëzuesit të reviduar është qartësimi se pikënisja nuk aplikohet kur gjykata shqipton dënim me burgim të përjetshëm.** Kjo për faktin se Neni 41, përcakton se dënimi me burgim të përjetshëm mund të shqiptohet për veprat më të rënda penale të kryera nën "rrethana veçanërisht rënduese" ose për vepra penale që "kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda". Kjo nënkupton që dy rrethanat përcaktuese, nëse dikujt do ti shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm, janë këto të nënvizuara më sipër. Konstatimi i ekzistimit të këtyre rrethanave bën që gjykata të shqiptojë dënim me burgim të përjetshëm.

Çështja që ka nevojë të përcaktohet ka të bëjë me rastet kur rrethanat e sipërpërmendura nuk janë të shkallës shumë të rëndë dhe rrjedhimisht nuk plotësohen kushtet për shqiptimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Në këto raste, gjykata mund të shqiptojë dënim nga minimumi i paraparë ligjor deri në maksimumin ligjor prej 35 vjetësh, siç e përcakton Neni 42 par. 2 i KPRK<sup>30</sup>-së. Andaj për të përcaktuar dënimin gjykata, përveç rrethanave tjera, duhet të ketë parasysh minimumet ligjore për atë vepër dhe maksimumin ligjor prej 35 vjetëve sipas Neni 42 paragrafi 2 i KPRK-së. KPRK-ja ka paraparë minimume të ndryshme ligjore prej 5, 10, 15 dhe 20 vjetësh. Kjo nënkupton që llogaritja e dënimit të këto vepra bëhet nga minimumet dhe maksimumet ligjore dhe atë varësisht se për cilën vepër bëhet fjalë, nga:

- 5 dhe 35 vjet
- 10 dhe 35 vjet
- 15 dhe 35 vjet
- 20 dhe 35 vjet

Një matje e tillë mundëson që të mos trajtohen njësoj rastet kur parashihet dënimi me burgim me rastet kur ligji parasheh dënimin me burgim të përjetshëm. Më pas, nëse nuk ekzistojnë kushtet sipas Neni 41, paragrafi 1 dhe kur mbizotërojnë rrethanat lehtësuese, atëherë dënimi mund të zbritet varësisht nga pesha e atyre rrethanave.

---

<sup>30</sup> Neni 42, Dënimi me burgim, paragrafi 2 thekson: "Për vepra penale për të cilat ligji parasheh dënim me burgim të përjetshëm, gjykata mund të shqiptojë dënim me burgim deri në tridhjetë e pesë (35) vjet."

### 3. Dënimi me gjobë

Çështja e gjobave, si dënime kryesore apo alternative, është e rregulluar në mënyrë të zgjeruar me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të vitit 2020.<sup>31</sup> Udhëzuesi i tillë është hartuar në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Kodit penal dhe atë se si ky kod parasheh matjen e dënimit me gjobë. Duke u bazuar edhe në dispozitat e Kodit që rregullojnë çështjen e gjobave, Udhëzuesi ka synuar jo vetëm harmonizimin e qasjes, por njëkohësisht ka synuar edhe që gjyqësorit ti ofrojë një mjet pune, i cili do të sigurohej se edhe gjoba e shqiptuar, të jetë dënim efektiv. Kjo për faktin se në pajtim edhe me dispozitën e Nenit 69 të Kodit penal, gjoba e shqiptuar do të ishte në përputhje me gjendjen financiare të të pandehurit. Qëllimi është që gjoba të ketë një ndikim të barabartë mbi të pandehurit me gjendje të ndryshme financiare. Vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet që dënimi i shqiptuar do të ishte proporcional dhe i drejtë.

Duhet të jetë e qartë se qëllimi i gjobës nuk është që të merret dobia pasurore e përfituar nga vepra penale nga i pandehuri. Kjo për shkak se gjoba është dënim dhe duhet të llogaritet në përputhje me dispozitat që vlejnë për llogaritjen e dënimit.<sup>32</sup>

Në përgjithësi KPRK-ja parasheh dy situata kur përdoret dënimi me gjobë. E para, gjoba parashihet së bashku me dënimin me burgim. Këto në kod janë të futura me lidhëzën "dhe" në përshkrimin e veprës dhe detyrojnë gjykatën që të shqiptojë gjobën së bashku me dënimin me burgim. Një zgjidhje e tillë është e paraparë në shumicën e veprave përgjatë KPRK-së. E dyta, KPRK-ja parasheh gjobën si dënim alternativ në vend të dënimit me burgim, duke përdorur lidhëzën "ose" në përshkrimin e veprës. Një zgjidhje e tillë zbatohet kryesisht për vepra më pak të rrezikshme.

Do të ishte shqetësuese nëse për vepra shumë të rënda penale, të cilat edhe përbëjnë dëm të madh për individin dhe shoqërinë, i pandehuri të mund të kalojë shumë lehtë. Kjo vlen sidomos edhe në rastet kur përpos dënimit me gjobë të pandehurit nuk i caktohet asnjë masë tjetër kufizuese apo edhe dënim plotësues për veprën e kryer (shemb. nuk caktohet dëmshpërblimi, ndonjë obligim plotësues apo edhe konfiskimi i pasurisë).<sup>33</sup>

Për shkak të hartimit të Udhëzuesit të veçantë për gjobat, Udhëzuesi i përgjithshëm nuk do të lëshohet në shtjellim të mëtutjeshëm të kësaj çështjeje. Menjëherë pas miratimit të Udhëzuesit specifik, është zhvilluar edhe një kalkulator elektronik i gjobës<sup>34</sup>, i cili është i instaluar në web faqen e secilës gjykatë. I njëjti është dizajnuar në pajtim të plotë me dispozitat e KPRK-së dhe Udhëzuesin specifik. Ajo që rekomandohet fuqishëm është angazhimi aktiv, në veçanti i palëve për ti siguruar gjykatës të dhëna të mjaftueshme për një llogaritje sa më të saktë të gjobës.

---

<sup>31</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>32</sup> Ibid: fq.2

<sup>33</sup> Ibid.fq.3

<sup>34</sup> Shih <https://supreme.gjyqesori-rks.org/kalkulatori-i-gjobes/>

## IV. Caktimi i dënimit sipas parimeve të Nenit 69 të KPRK-së

### Neni 69 i Kodit Penal:

*“1. Kur cakton dënimin për veprën penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë veprën penale. Gjukata pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin”.*

Materiali në vijim do të trajtojë secilën nga pikat e nënvizuara nga ky nen duke u ndalur në një analizë më të gjerë.

### 1. Qëllimi i Dënimit

Qëllimet e dënimit të përcaktuara në nenin 38 të KPRK-së janë:

1.1. të parandalojë të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij;

1.2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale;

1.3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe

1.4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 1.1. Parandalimi specifik/i veçantë

Neni 38 parasheh një kornizë të përgjithshme e cila do të duhej ta udhëhiqte gjykatën përgjatë procesit të caktimit të dënimit. Megjithatë, KPRK-ja nuk përcakton ndonjë strukturë hierarkike. Nuk ka ndonjë kërkesë, për shembull, që të vihet theks më i madh në rehabilitimin e të pandehurit sesa në parandalimin e përgjithshëm. Për më tepër, nuk ka ndonjë indikacion se dënimi duhet të plotësojë vetëm një nga qëllimet. Kjo mungesë e udhëzimit e vë gjykatën në pozitë veçanërisht të vështirë pasi që dy gjykatat, të ballafaquara me vepra dhe kryes të ngjashëm, mund të arrijnë në dënime shumë të ndryshme nëse zbatojnë qëllime të ndryshme. Për shembull, njëra gjykatë, e cila përqendrohet në parandalimin e përgjithshëm, mund të caktojë burgimin si dënim përfundimtar. Ndërkaq gjykata tjetër, e cila përqendrohet në rehabilitimin e të pandehurit, mund të caktojë dënim me kusht. Pa ndonjë udhëzim, secili dënim është njësoj i vlefshëm sipas ligjit. Ky problem potencial, në përgjithësi njihet si problematik ndër teoricienët e dënimeve penale pasi që rrit mospërputhjet e dënimeve dhe pjesërisht trajtohet edhe nga Këshilli i Evropës ku thuhet se:

- Në vendet ku parimet kushtetuese dhe tradita juridike e lejojnë një gjë të tillë, ligjvënësi apo organi tjetër kompetent duhet të bëjë përpjekje për të deklaruar qëllimet e dënimit.
- Sipas nevojës, dhe në veçanti kur mund të ketë konflikt në mes të qëllimeve të ndryshme, duhet dhënë udhëzime lidhur me mënyrën e përcaktimit të prioritetëve të mundshme në zbatimin e qëllimeve të tilla.
- Kurdo që është e mundur, dhe në veçanti për kategori të caktuara të veprave apo të kryesve, duhet deklaruar qëllimin primar.<sup>35</sup>

<sup>35</sup> Rekomandimi i Këshillit të Evropës Nr. R (92) 17, i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me konsistencën në dënime; Shtojca e Rekomandimit Nr. R (92) 17; A. Qëllimet e dënimit.

Ndonëse kjo çështje nuk trajtohet në mënyrë specifike në Kod, përcaktimi i pikënisjes në kombinim me këto udhëzime, së bashku me kufijtë e mundshëm të dënimeve për vepra të caktuara, në masë të madhe e zbusin problemin. Në përgjithësi, kodi parasheh që me rritjen e peshës së veprës, zvogëlohet mundësia e shqiptimit të formave alternative të dënimit. Kjo vë një theks më të madh në parandalimin specifik dhe të përgjithshëm si qëllime të përgjithshme të dënimit. Me uljen e peshës së veprës, rehabilitimi mundësohet si dënim i mundshëm. Megjithatë, duhet të theksohet se mundësia e shqiptimit të formave alternative të dënimit nuk nënkupton shfrytëzimin e domosdoshëm të tyre. Dhe në fund, konsideratat për kompensimin e viktimës duhet të jenë të pranishme në të gjitha aspektet e caktimit të dënimit. Në pjesë të madhe, rrethanat individuale me të cilat gjykata ballafaqohet në rastin e caktuar do të diktojnë se ku hyn në zbatim qëllimi i caktuar i dënimit dhe nëse duhet ti jepet prioritet njërit qëllim ndaj tjetrit.

Paragrafi 1.1 i Nenit 38 kërkon nga gjykata që të merr parasysh konceptin tradicional të parandalimit të veçantë apo specifik. Në këtë drejtim gjykata përqendrohet në individin i cili ka kryer veprën dhe shqyrton nëse dënimi parandalon atë nga kryerja e ndonjë vepre tjetër në të ardhmen. Sipas filozofisë bashkëkohore të penologjisë, dënimi duhet t'i përshtatet të pandehurit e jo vetëm veprës. Është me rëndësi që të theksohet se “individualizimi” i dënimit zbaton parimin se përgjegjësia penale është përgjegjësi individuale në fazën e caktimit të dënimit. Në këtë kuptim, individualizimi i dënimit i mbron individët e akuzuar nga dënimet të cilat nuk adresojnë në mënyrë rigorozë veprimet e tyre, dhe kështu sigurohet drejtësia. I pandehuri, nuk shihet më si një shkelës abstrakt i ligjit, por si individ i cili meriton vëmendje të veçantë.

Kjo çështje trajtohet më në tërësi në pjesën e dytë të paragrafit i cili inkorporon konceptin e rehabilitimit. Teoria e rehabilitimit, në thelb parasheh që objektivi i dënimit është që të bëhet ri integrimi i të pandehurit në shoqëri pas një periudhe të caktuar, dhe që dënimi të konstruktohet në mënyrë të tillë që të mundësojë riedukimin e të pandehurit. Këtu gjykata vërtetë duhet të përfshihet në individualizimin e dënimit pasi që nga gjykata kërkohet që të trajtojë çështje të caktuara të cilat mund të kenë qenë të ndërlydhura me kryerjen e veprës. Aftësia për ta bërë këtë gjendet në format plotësuese të dënimit të cilat mund të përfshihen në dënimin përfundimtar. Për shembull, nëse një i pandehur kryen sulm dhe është nën ndikimin e alkoolit, gjykata mund të shqiptojë një dënim me të cilin jo vetëm që parandalohet i pandehuri nga kryerja e sulmeve në të ardhmen, por e trajton edhe çështjen e mundshme të varësisë nga alkooli. Vetëm duke shikuar individin në tërësi, gjykata mund të shpresojë që të parandalojë kryerjen e veprave në të ardhmen dhe ri integrimin e të pandehurit në shoqëri si anëtar produktiv të saj.

## 1.2. Parandalimi i përgjithshëm

Paragrafi 1.2 i Nenit 38 të KPRK-së kërkon nga gjykata që të merr parasysh qëllimin e parandalimit të përgjithshëm. Në këtë koncept tradicional dënimi i shërben qëllimit të parandalimit të individëve tjerë nga kryerja e veprave penale, qoftë të natyrës së ngjashme apo të përgjithshme. Parandalimi i përgjithshëm nuk përqendrohet në individin, por në shoqërinë si tërësi. Qëllimi është që i pandehuri ta kuptojë se vepra penale “nuk shpaguehet” dhe ta ketë parasysh faktin që mund të ndëshkohet kur bën përllogaritjet nëse do ta kryejë veprën apo jo. Në rastin Naletiliq dhe Martinoviq, Trupi Gjykues kishte mbajtur qëndrimin se “*Parandalimi dhe ndëshkimi janë parime themelore në raport me caktimin e dënimit të individit nga Tribunali. Përderisa ndëshkimi*

*nënkupton një dënim proporcional për veprën e kryer, parandalimi siguron që dënimi i shqiptuar të bind të tjerët që të mos kryejnë vepra të tilla”.<sup>36</sup>*

Përderisa i pandehuri potencial mund të mos “rehabilitohet” në kuptimin tradicional, ata, thjeshtë mund të heqin dorë nga kryerja e veprës. Në rastin Muçiq kundër të tjerëve, Dhoma e Apelit kishte mbajtur qëndrimin se “*Ndonëse edhe juridiksionet nacionale dhe disa instrumente të caktuara ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut parashohin se rehabilitimi duhet të jetë çështja kryesore për gjykatën gjatë matjes së dënimit, kjo nuk mund të ketë rol mbizotërues në procesin e vendimmarrjes së Trupit Gjykes të Tribunalit*”.<sup>37</sup>

### 1.3. Viktimat dhe komuniteti

Paragrafi 1.3 i Nenit 38 të KPRK-së kërkon nga gjykata që të merr parasysh ndikimin e veprës te viktimat apo te komuniteti dhe parasheh që çdo dënim duhet të përfshijë kompensimin për humbjet e shkaktuara. Ky qëllim paraqet një zhvillim relativisht të ri në teorinë e dënimeve me të cilin njihet rëndësia e të drejtave dhe nevojave të viktimës. Nga kjo perspektivë, qëllimi kryesor i dënimit do të ishte që të sigurojë kompensimin e viktimës dhe komunitetit të gjerë nga i pandehuri për veprat penale. Kjo ka disa implikime.

**Së pari, kjo tregon për rëndësinë e të drejtave të viktimës në matjen e dënimit.** Kjo nuk është vetëm një konsideratë dytësore për gjykatën, e cila mund t’i bartet mekanizmave shoqëror të kompensimit, nëse i pandehuri ka mundësinë që ta kompensojë viktimën dhe ta zhbëjë dëmin. **Kjo duhet të jetë konsideratë parësore gjatë caktimit të dënimit.**

Së dyti, përfshirja e komunitetit në qëllimin e dënimit tregon qartazi se viktimat mund të përfshijë edhe komunitetin e gjerë. Në veprat penale ku përfshihet, për shembull, asgjësimi i pasurisë, kompensimi do të bëhet në formë të kompensimit monetar. Por, kjo nuk përfundon këtu. Ndikimi në komunitet mund të jetë edhe në formë të dëmit të përgjithshëm psikik të individëve në komunitet. Kjo mund të përfshijë ndjenjat e sigurisë dhe/ose reputacionit të komunitetit. Ndonëse këto çështje mund të jenë disi të paprekshme dhe të pamatshme në terma monetar, gjykata duhet të përplojë që t’i rikthejë ato në gjendjen e mëparshme.

### 1.4. Gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit

Paragrafi i fundit i nenit 38 është shprehje e përgjithshme e qëllimeve të dënimit dhe raportit të tyre me konceptin e përgjithshëm të sundimit të ligjit. Këtu çështja e dënimit shkon përtej individit, viktimës, dhe komunitetit dhe flet për ndikimin e dënimit në shoqërinë si tërësi. Kjo kërkon nga gjykata që të merr parasysh çështje përtej komunitetit që e rrethon dhe kërkon që të ketë harmonizim në tërë Kosovën.

---

<sup>36</sup> Rasti Nr.IT-98-34-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Mladen Naletiliq dhe Vinko Martinović, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (31 mars 2003), Par.739, citohet Aktgjykimi për Dënimin e Todorović, para 29&30; Aktgjykimi për Dënimin e Plavsiq, Par. 23.

<sup>37</sup> Rasti Nr.IT-96-21-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zejnil Delaliq, Zdravko Muciq, Hasim Deliq dhe Esad Landzo, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (20 shkurt 2001), Par.806.

## **2. Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit**

Përveç kërkesës që të merren parasysh qëllimet e dënimit, neni 69 kërkon që të merren parasysh edhe parimet e përcaktuara në atë kapitull. Ndonëse nuk ka parime specifike të përcaktuara në ndonjë nen të caktuar, parimet e përgjithshme janë të mishëruara përgjatë kapitullit kur trajtohen rrethanat e caktuara. Prandaj, gjykata nuk obligohet që të merr parasysh ndonjë parim të caktuar në vete, por kërkohet që të merr parasysh dhe të zbatojë cilindo nen që ndërlidhet me faktet e caktuara të rastit. Për shembull, sipas nenit 74, gjykata mund ta lirojë nga dënimi të pandehurin e veprës penale të kryer nga pakujdesia në rrethana të caktuara. Kjo mishëron parimin se jo të gjitha veprat e kryera nga pakujdesia meritojnë të njëjtin dënim sikurse ato të kryera me dashje. Parimet nuk janë të trajtuara në detaje individuale pasi që shumica e neneve në këtë kapitull do të zbatohen për situata të caktuara faktike. Gjukata duhet të merr parasysh secilën dispozitë që zbatohet në situatën e caktuar faktike dhe duhet të shqyrtojë veçoritë e saj.

Siç ceket në nenin 69 të KPRK-së, “Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e të pandehurit”. Në pajtim me këtë dispozitë dhe dispozitat tjera në Kod, me rastin e caktimit të dënimit gjykata duhet të merr parasysh nivelin e veprës. Vlerësimi i tillë duhet bërë në pajtim me paragrafin 3 të nenit 69 i cili kërkon nga gjykata që të merr parasysh një mori rrethanash. Këto rrethana, në masë të madhe, janë kategori të përgjithshme në kuadër të të cilave hyjnë rrethanat e caktuara lehtësuese dhe rënduese. Megjithatë, ato gjithashtu mund të konsiderohen si parime të përgjithshme sipas të cilave gjykata duhet të udhëhiqet e ato janë:

- 2.1. shkalla e përgjegjësisë penale;
- 2.2. motivet për kryerjen e veprës;
- 2.3. intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur;
- 2.4. rrethanat në të cilat është kryer vepra;
- 2.5. sjellja e mëparshme e kryesit;
- 2.6. pranimi i fajit; dhe
- 2.7. rrethanat personale të kryesit dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale.

### **2.1. Shkalla e përgjegjësisë penale**

Shkalla e përgjegjësisë penale, në përgjithësi përcaktohet duke u bazuar në shkallën e përgjegjshmërisë, shkallën e fajësisë së tëpandehurit dhe rrethanat tjera që tregojnë për një përgjegjësi më të lartë apo më të ulët. Parimi i përgjithshëm është se shkalla e përgjegjësisë penale e individit do të ndikojë drejtpërdrejt në dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit.

Në përcaktimin e shkallës së përgjegjësisë, gjykata duhet të merr parasysh nëse vepra është kryer në gjendje të përgjegjësisë dukshëm të zvogëluar apo të zvogëluar. Kjo mund të merr disa trajta dhe kërkon një vlerësim të mirëfilltë të pjesëmarrjes në kryerjen e veprës. Koncepti i përgjithshëm është se sa më e vogël të jetë përgjegjësia e individit ndaj kryerjes së drejtpërdrejtë të veprës aq më e madhe është mundësia për zvogëlimin e dënimit.

Shkalla e fajësisë duhet të vlerësohet duke marrë parasysh llojin e fajësisë (me dashje apo nga pakujdesia), ashtu siç kërkohet me ligj për atë vepër të caktuar penale. Në përcaktimin e shkallës së fajësisë, në rastet e veprave të kryera me dashje, gjykata duhet të merr parasysh nëse ekziston dashja e drejtpërdrejtë apo eventuale, si dhe nëse në rastin specifik mund të identifikohet

prania e ndonjërës prej llojeve të veçanta të dashjes, e cila mund të jetë tregues i shkallës më të ultë apo më të lartë të fajësisë. Në përcaktimin e niveleve të ndryshme të fajësisë për vepra të kryera nga pakujdesia, gjykata duhet të merr parasysh nëse vepra është rezultat i pakujdesisë së vetëdijshme apo të pavetëdijshme dhe gjithashtu nëse vepra përfshin ndonjë formë të veçantë të pakujdesisë.

## 2.2. Motivet për kryerjen e veprës

Gjykata, gjithnjë kur është i ditur dhe mund të nxirret edhe nga deklaratimet e palëve, duhet të merr në konsideratë motivin për kryerjen e veprës penale në rastet kur i njëjti tashmë nuk është i përfshirë si element i veprës penale.

**Motivi mund të jetë i natyrës pozitive, siç është dhënia e ndihmës personit tjetër, arsyet humane apo shkaqet tjera të dobishme shoqërore dhe i natyrës negative, siç është urrejtja, poshtërimi, lakmia, interesi vetjak, zilia, apo shkaqet tjera të dëmshme shoqërore.**

Koncepti që veprat e kryera për motive altruiste apo me qëllim që t'i sjellin dobi anëtarëve të tjerë të shoqërisë, kryesisht konsiderohen se meritojnë dënime më të buta, bazohet në teorinë se veprat e kryera për shkak të “dhembshurisë së fortë njerëzore” janë më pak të urryera. Për shembull, shoqëria në përgjithësi konsideron se i pandehuri, i cili vjedh para për të blerë barna për trajtimin e anëtarit të sëmurë të familjes meriton dënim më të butë se ai i cili kryen vjedhje për qëllime të pastra të përfitimit material. Për dallim, ato vepra të cilat kryhen për motive të papranueshme apo të urryera lehtësisht meritojnë dënime më të ashpra.

Sidoqoftë, është me rëndësi që gjykata të zbatojë me kujdes këto parime pasi që për nga natyra ato mund të jenë shumë personale. Andaj, gjykata rrezikon që të imponojë parimet e saj personale në përcaktimin e dënimit që mund të mos konsiderohen si parime universale apo t'i jep rëndësi më të madhe një vlere të caktuar sesa që i jepet vlerës së përgjithshme. Kjo, në veçanti gjen zbatim të zbutja e dënimit bazuar në shkaqe siç janë nacionalizmi apo i ashtuquajtur “nder” i individit apo familjes.

## 2.3. Intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur

Gjatë përcaktimit të nivelit të veprës së caktuar, gjykata duhet të merr parasysh seriozitetin e veprës së kryer. Me rastin e identifikimit të seriozitetit duhet të përfshihet vlerësimi i intensitetit të dëmit të pasojave të veprës. Kur çështja ka të bëjë kryesisht me rrezikimin e vlerës, atëherë vlerësimi duhet të përqendrohet në të drejtën e mbrojtur dhe probabilitetin e kryerjes.

Në vlerësimin e seriozitetit të rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, gjykata në veçanti duhet të merr parasysh elementet e mëposhtme:

- natyrën e veprës penale, se a bëhet fjalë për vepër penale kundër pasurisë, jetës e trupit dhe trafikut publik;
- duhet të bëhet dallimi edhe në mes veprave që rrezikojnë dhe që dëmtojnë;
- seriozitetin dhe kohëzgjatjen e pasojës;
- a është vepër e kryer apo e ngelur në tentativë;
- numrin e palëve të dëmtuara apo viktimave;
- a është rrezikuar shëndeti apo jeta e personit apo pasuria e tij,
- vlerën e dobisë pasurore të fituar me vepër apo dëmin e shkaktuar; dhe



- rrethanat tjera të cilat në rastin specifik tregojnë pasojë më të lartë apo më të ultë të veprës në të drejtën, vlerën apo interesin e caktuar.

Kjo çështje do të jetë më pak e rëndësishme kur serioziteti i veprës përfshihet në formulimin e vet veprës penale, e cila diskutohet më në hollësi në pjesët në vijim të këtij udhëzuesi.

Shembulli 1:

Në një nga rastet e trajtuara në Kosovë, për veprën Marrja e ryshfetit nga neni 421 paragrafi 1 i KPRK-së dënimi i shqiptuar, në këtë rast, nga gjykata ishte 1 vit burgim dhe 3000€ gjobë. Me rastin e arsytimit të aktgjyqimit gjykata ka vlerësuar si në vijim:

*“Gjykata me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe lartësisë së tij, bazuar në nenin 69 të KPRK-së, mori për bazë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori: se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, sjelljen e më hershme të akzuarit, sinqeritetin e treguar gjatë seancës, kushtet në të cilat jeton i akuzuari, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, nuk ka pasur pasojë nga vepra penale.”*

Në lëndën e mësipërme, mund të konkludohet se të gjitha rrethanat, me përjashtim të pranimit të fajësisë, janë të paqarta për faktin se të njëjtat vetëm janë listuar, por nuk janë arsytuar pse janë relevante në rastin konkret. Pra, nuk është e qartë se si kanë ndikuar ato rrethana në uljen e dënimit. Kështu nëse marrim :

- ***sjelljen e më hershme të akzuarit***, nuk sqarohet sjellja e tij dhe jeta e tij e mëparshme;
- ***sinqeritetin e treguar gjatë seancës***, nuk është theksuar se si është manifestuar ky sinqeritet;
- ***kushtet në të cilat jeton i akuzuari***, nuk është potencuar se në çfarë kushte jeton i dënuari që kanë ndikuar në zbutje të dënimit;
- ***intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur***, përkundër faktit se në realitet marrja e ryshfetit pikërisht për shkak të efektit shkatërrues që ka për një shtet duhet të konsiderohet vepër me rrezikshmëri të lartë këtu është llogaritur si rrethanë lehtësuese. Për më tepër, në rastin konkret, vlera e marrjes së ryshfetit ka qenë 12.000 € dhe nga kjo del se arsytimi në këtë pikë është në tërësi i paqëndrueshëm.
- ***nuk ka pasur pasojë nga vepra penale***, si arsytohet ky deklaram kur të kemi parasysh faktin se vepra penale hyn në kategorinë e veprave penale kundër detyrës zyrtare, atëherë konsiderojmë se ky arsytim, edhe në këtë aspekt, është i paqëndrueshëm.

Shembulli 2:

Në një tjetër aktgjykim lidhur me veprën penale, Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143<sup>38</sup> paragrafi 2 i KPRK-së gjykata kishte shqiptuar dënimin prej 3 vjet e 8 muaj.

Me rastin e vlerësimit të rrethanave të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, gjykata ka vlerësuar si lehtësuese rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit, përkatësisht faktin që i njëjti është i martuar, baba i 2 fëmijëve të mitur, të cilët jetojnë në gjendje të dobët ekonomike, marrë parasysh edhe faktin që për disa vjet kanë jetuar në shtetin e Sirisë dhe se punësimi i tij është burimi i vetëm i ekzistencës së tyre. Po ashtu, qëndrimi i të pandehurit afër fëmijëve të tij, në përpjekjet e tij për tu ri përshtatur në kushtet e Kosovës, pas kthimit nga jashtë, është qenësor, në mirërritjen dhe

<sup>38</sup> Vepra e trajtuar sipas Kodit Nr.04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.19, 13 korrik 2012, Prishtinë.

mirëqenien e tyre, pasi që, përveç nënës, i pandehuri si baba i tyre është mbështetja e vetme e tyre. Po ashtu, si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar edhe sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale dhe kthimit në Kosovë. I pandehuri, fillimisht në deklaratën e dhënë në polici, ka përshkruar në tërësi natyrën e angazhimit të tij në Siri dhe duke qenë i vetëdijshëm për natyrën e gabuar të veprimeve të tij, ka shprehur pendim. Edhe përkundër mospranimit të fajësisë, sjellja dhe qëndrimi i tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qenë korrekt, duke manifestuar me heshtje një lloj pendese, përkundëjt veprimeve të tij, por pa pranuar shprehimisht fajin për ndonjërin nga veprat penale me të cilat është ngarkuar. Ndërsa nuk janë gjetur rrethana rënduese. Andaj, bazuar në këto rrethana, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 75 paragrafi 1 pika 1.2 të KPRK-së, për zbutjen e dënimit, me çka mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe në raste të tilla gjykata mund ta zbusë dënimin edhe nën minimumin e paraparë me ligj.

Konsiderojmë se në këtë aktgjykim të gjitha rrethanat lehtësuese të paraqitura nuk pasqyrojnë një faktor përcaktues për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Kështu gjykata ka marrë si rrethanë lehtësuese me rëndësi faktin që i pandehuri ka dy fëmijë të mitur dhe se qëndrimi i tij pranë tyre është i domosdoshëm për mirëqenien e tyre. Sakaq, gjykata ka lënë anash fare faktin se, pikërisht është i pandehuri ai që ka vënë në rrezik familjen e tij me shkuarjen për të jetuar në Siri, e cila paraqitet si një rrethanë rënduese me peshë jashtëzakonisht të madhe në matje të dënimit. Për më tepër, bashkëngjitja në grupe të tilla terroriste paraqet një kërcënim për paqen globale dhe është për tu habitur se si niveli i rrezikut që paraqesin këto vepra është anashkaluar me rastin e vlerësimit të lartësisë së dënimit. Shtuar këtu edhe faktin se gjykata përmend pendimin e të pandehurit, por edhe vet në zberthim përmend se i pandehuri ka vendosur të mbrohet në heshtje dhe asnjëherë nuk ka pranuar fajësinë për veprën që i ngarkohet.

#### 2.4. Rrethanat në të cilat është kryer vepra

Gjatë përcaktimit të nivelit të veprës, gjykata duhet të merr parasysh të gjitha rrethanat të cilat e karakterizojnë veprën penale specifike dhe kushtet në të cilat është kryer. Kjo përfshin një vlerësim gjithëpërfshirës të të gjitha fakteve specifike të veprës të cilat mund edhe të mos ndikojnë drejtpërdrejtë në përcaktimin e fajësisë, por që mund të ndikojnë në dënimin përfundimtar.

Këto përfshijnë por nuk kufizohen në:

- kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës;
- mjetet e përdorura për kryerjen e veprës;
- këmbënguljen për kryerjen e veprës;
- vështirësitë dhe pengesat të cilat i pandehuri është dashur t'i tejkalojë gjatë kryerjes së veprës;
- rrethanat e veçanta në të cilat është gjendur i pandehuri, të cilat i ka shfrytëzuar apo nga të cilat ka përfituar në mënyrë që ta kryejë veprën më lehtë;
- personalitetin dhe karakterin e viktimës;
- keqpërdorimin e marrëdhënies së veçantë të besimit reciprok me viktimën;
- llojin dhe formën e pjesëmarrjes në veprën e kryer;
- kryerja e veprës gjatë katastrofave natyrore (vërshimeve, tërmetejeve etj);
- nëse vepra ka mbetur në tentativë apo është kryer; dhe
- rrethanat tjera objektive apo subjektive të cilat kanë ekzistuar para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës dhe të cilat mund të ndikojnë në llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit.

## 2.5. Sjellja e mëparshme e të pandehurit

Sjellja e mëparshme tregon përshtatshmërinë e kryesit dhe përshtatja e tij brenda normave ligjore dhe shoqërore. Kjo kategori e përgjithshme ka të bëjë me sjelljen e mëparshme të të pandehurit, e cila mund të ndikojë në caktimin e dënimit qoftë përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të dispozitave tjera të kodit apo përmes ndryshimit gradual të dënimit përfundimtar, varësisht nëse këto rrethana mund të cilësohen si rrethana lehtësuese apo rënduese, megjithëse më shumë e gjejmë të shprehur në lehtësim sesa në ashpërsim. Duhet përjashtuar nga kjo kategori sjellja e mirë në gjykatë, si rrethanë lehtësuese me qëllim të pandehuri ka detyrim për sjellje brenda kornizës ligjore. Ndërkaq, nëse në anën tjetër i pandehuri i shmanget ftesës së prokurorit apo gjykatës atëherë kjo paraqet indikacion të sjelljes jo të duhur të të pandehurit dhe mosrespektim të autoriteteve/institucioneve andaj edhe do të duhej marrë parasysh në ashpërsim.

### Sjellja e mëparshme si rrethanë në ashpërsim:

- personi është i diagnostikuar me ndonjë varësi apo nëse shfaq sjellje që janë të ngjashme me varësitë e tilla;
- personi është i dhunshëm apo shfaq sjellje të ngjashme;
- personi i shmanget ftesës së policisë, prokurorisë, gjykatës, qendrës për punë sociale etj.
- sjelljet jo sociale;
- reputacionin negativ në shoqëri, më saktë në komunitetin në të cilin jeton; dhe
- faktet tjera të cilat mund të shërbejnë si indikatorë të jetës dhe karakterit të mëparshëm të pandehurit para kryerjes së veprës, të cilat mund të ndikojnë në caktimin e dënimit.

### Sjellja e mëparshme si rrethanë në lehtësim:

- keqardhja,
- pendimi i sinqertë, menjëherë pas veprës, i përcjellë me veprime konkrete përkujdesjeje për viktimën apo familjen e saj.
- sjellja e të pandehurit në rrethin ku jeton dhe vepron, relacioni me personat e tjerë dhe mënyra e jetesës, puna në komunitet, puna vullnetare etj.

Në praktikë, në shumicën e rasteve, vazhdojmë të hasim sjelljen e mirë të të pandehurit si rrethanë lehtësuese dhe atë shpesh pa u sqaruar fare se pse një “sjellje” e tillë është relevante në atë rast. Kjo rrethanë, shumë shpesh gjendet e dyfishuar apo edhe katërfishuar me rrethanat tjera nga Neni 70. Disa nga referencat që bëhen në këtë rrethanë në aspekt të lehtësimit janë p.sh. nëse i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, nëse i pandehuri është i arsimuar apo në një pozitë/funksion me rëndësi, etj. Gjykata duhet gjithnjë të ketë kujdes të shtuar në përdorimin e kësaj rrethane në lehtësim. Përderisa Kodi lejon aplikimin e kësaj rrethane për matjen e dënimit, gjykata duhet ta ketë parasysh gjithnjë parimin e proporcionalitetit në mes veprës së kryer, pasojës së shkaktuar, rrezikshmërisë që paraqet ajo vepër dhe i pandehuri dhe aplikimit të rrethanës në zbutje.

Duhet pasur parasysh, se këto rrethana nuk barazohen me recidivizmin, por më tepër kanë të bëjnë me sjelljet specifike të të pandehurit të cilat tregojnë për afinitetin e tij p.sh. për dhunë, rrezikshmërinë që i njëjti mund të paraqesë për individë apo mjedis të caktuar apo për shoqërinë në përgjithësi. Dënimi për një person me një histori të dhunshme p.sh. nuk duhet vlerësuar vetëm në kontekst të veprimeve të tij për atë vepër, por edhe se sa i njëjti paraqet rrezik, nëse lirohet apo dënohet me një dënim të butë dhe pa u rehabilituar kthehet në shoqëri.

## 2.6. Pranimi i fajësisë

Çështja e zbutjes së dënimit në rast të pranimit të fajësisë rregullohet me dispozitat e KPRK-së dhe KPPRK-së. Gjykata duhet të ketë kujdes të veçantë në rastet kur bën zbutjen e dënimit bazuar në pranimin e fajësisë pasi që mungesa e strukturës së parapërcaktuar në këtë fushë mund dhe në fakt shkakton shmangie të konsiderueshme në situata të ngjashme faktike.

Për më tepër, kur kemi të bëjmë me pranim të fajësisë, një përcaktim adekuat i dënimit përfundimtar duhet të përfshijë edhe vlerësimin e një numri të rrethanave tjera që kanë të bëjnë me pranimin e fajësisë. Këto përfshijnë çështje, siç është pranimi i vërtetë i fajit, shfaqja e pendimit nga i pandehuri, sjellja e përgjithshme e të pandehurit në raport me viktimën.

Sipas dispozitave të përgjithshme të KPRK-së:

*“Gjykata **mund** të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit:*

*1.3 në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.”<sup>39</sup>*

Dispozita e sipërpërmendur përfshin fjalën **“mund”**. **Kjo nënkupton që gjykata duhet shmangur zbatimin me automatizëm të zbutjes së dënimit nën minimumin ligjor nëse rrethanat tjera rreth mënyrës së kryerjes së veprës penale apo shkallës së dëmit të shkaktuar të jenë aq të rënda sa që vetëm pranimi i fajësisë nuk e arsyeton zbutjen nën minimum apo një dënim alternativ.** Jo më kot, pranimi i fajësisë është në fund të listës së rrethanave për shqyrtim nga gjykata me rastin e matjes së dënimit (rrethana e gjashtë me radhë në Nenin 69 dhe e 10-ta në Nenin 70). Thënë më qartë, pranimi i fajësisë nuk mund të konsiderohet si bazë e mjaftueshme që dënimin të zbutet nën minimumin ligjor me automatizëm. Kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të shprehur në Nenin 69 paragrafi 2 i KPRK-së i cili thekson se:

*“Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit.”*

Po ashtu, është me rëndësi të bëhet diferencimi në mes pranimit të fajësisë në fazat e hershme të procedurës me pranimin në fazën e shqyrtimit gjyqësor. Sa më herët që bëhet pranimi i fajësisë, aq më shumë peshë mund ti jepet pranimit të fajësisë në matjen e dënimit.

## 2.7. Rrethanat personale të të pandehurit dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale.

Rrethanat individuale/personale të të akuzuarit mund të jenë rënduese apo lehtësuese. Përderisa zbutja, zakonisht përqendrohet në vetë të pandehurin dhe karakteristikat dhe rrethanat personale të tij, ashpërsimi më shumë merr parasysh rolin e të pandehurit në kryerjen e veprës dhe rrethanat e ndërlidhura me vetë veprën.

---

<sup>39</sup> Kodi Nr.06/L-074 Penal I Republikës së Kosovës, Neni 71 Zbutja e dënimeve, par.1.3, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

### *Rrethanat personale lehtësuese*

Rrethanat lehtësuese personale janë një mori konsideratash të ndërlikuara për gjykatën. Ato mund të jenë ngatërruese dhe ndonjëherë mund të bien në kundërshtim me bindjet personale të një gjyqtari të caktuar. Atë që një gjyqtar e konsideron si rrethanë personale lehtësuese, një gjyqtar tjetër mund ta konsiderojë si rrethanë personale rënduese. Rrethanave të tilla, gjithashtu mund t'u jepen nivele të ndryshme të rëndësisë varësisht nga qëllimi i dënimit me të cilin udhëhiqet vendimi i gjykatës.

Praktika ndërkombëtare në këtë fushë, ndonëse e njeh rëndësinë e kësaj kategorie të individualizimit të dënimit, nuk ka përcaktuar rregulla të qarta lidhur me rrethanat të cilat gjithnjë duhet të merren si rrethana lehtësuese. Në shumë aspekte, zbutja personale mund të përcaktohet nga kultura e autoritetit që cakton dënimin apo nga zhvillimet shkencore. Për shembull, zhvillimi i psikologjisë dhe hulumtimit ka sjellë deri te një sërë rrethanash personale lehtësuese, të cilat përqendrohen në gjendjen psikologjike të të pandehurit dhe ndikimit të saj në fajësinë e tij. Në disa kultura, këto zhvillime janë konsideruar si të përshtatshme dhe janë përfshirë si rrethana specifike lehtësuese për shqyrtim, ndërsa në kultura tjera janë refuzuar.

Në përgjithësi, rrethanat personale lehtësuese kanë të bëjnë me të pandehurin dhe jo me veprën, dhe mund të përfshijnë:

- të kaluarën e të pandehurit (p.sh. karakterin e mirë, jetën produktive, të kaluarën e vështirë);
- rrethanat e të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës (p.sh. presionet financiare, problemet psikiatrike, kufizimet intelektuale, papjekuria);
- sjellja e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale dhe gjatë ndjekjes penale (p.sh. pendimi, kompensimi, kërkimi i ndihmës për problemet që kanë kontribuar në kryerjen e veprës, bashkëpunimi me policinë dhe prokurorinë);
- gjasat për rehabilitimin e tanishëm dhe në të ardhmen të të pandehurit (p.sh. përgjegjësitë familjare, partneri mbështetës, kapaciteti për të trajtuar problemet që kanë çuar deri te sjellja kriminale);
  - Ato gjithashtu mund të kategorizohen edhe në një numër rrethanash siç janë:
- rrethanat të cilat tregojnë fajësi të zvogëluar, siç është mosha e re apo problemet me shëndetin mendor, nevojat urgjente, karakteri i mirë i mëparshëm dhe rrethanat të cilat tregojnë rrezik të ulët të përsëritjes së veprës, që ndërlidhen me pendimin dhe përpjekjet për të bërë kompensimin, rrethanat e të pandehurit, apo hapat e ndërmarrë drejt rehabilitimit.
- rrethanat të cilat kërkojnë ndjeshmëri në matjen e dënimit për shkak të rrethanave të ndryshme, për shembull përgjegjësitë familjare, kur familjarët janë të varur thellësisht nga përkujdesi i tij/saj dhe 'dëmi kolateral' që burgimi do ti shkaktonte familjes pikërisht për atë shkak, apo kontributi shoqëror i bërë nga i pandehuri.

Duke marrë parasysh natyrën potencialisht kundërtëuese të këtyre rrethanave, gjykatat duhet të jenë veçanërisht të vetëdijshme nëse këto rrethana janë përfshirë në mënyrë specifike në legjislacion për vlerësim apo nëse atyre ligji vetëm u referohet në mënyrë të përgjithshme. Referimi i përgjithshëm në rrethanat personale të të pandehurit apo mundësimi i konsideratave tjera nga gjykata duhet të rrisë nivelin e shqyrtimit të kujdesshëm nga gjykata të ndonjë rrethane të caktuar personale dhe provave të ekzistimit të saj.

### *Rrethanat personale rënduese*

Siç u cek më parë, rrethanat personale rënduese kanë të bëjnë më pak me cilësitë e qenësishme të individit dhe më shumë janë të përqendruara në faktet rreth vet veprës penale dhe rolit të të akuzuarit në kryerjen e saj.

Rrethanat dhe faktorët për tu marrë në konsideratë përfshijnë:

- nivelin e pjesëmarrjes së të pandehurit në kryerjen e veprës,
- nëse i pandehuri ka pasur rol udhëheqës,
- nëse i pandehuri ka qenë në pozitë eprore në strukturën hierarkike,
- situatën familjare apo marrëdhënien ndërmjet viktimës dhe të pandehurit;
- nëse viktimja ka qenë në pozitë të varësisë në raport me të pandehurin;
- nëse i pandehuri ka qenë në pozitë të besimit në raport me viktimën;
- nëse i pandehuri ka shfaqur motivime në baza fetare, etnike, politike, diskriminuese dhe/apo të hakmarrjes,
- sjellja e mëparshme kriminale, pavarësisht nëse është e llojit të njëjtë apo të ngjashëm, dhe
- mungesa e pendimit.

Siç mund të shihet, disa nga rrethanat apo konceptet e cekura më lartë janë thjeshtë e kundërta e rrethanave të cekura në rrethanat personale lehtësuese. Ky është një shembull tjetër i asaj se sa të ngatërruara dhe të papërcaktuara janë aspektet personale lehtësuese dhe rënduese.

## V. Ashpërsimi dhe zbutja sipas Nenit 70 të KPRK-së

### 1. Çështje të përgjithshme të matjes së dënimit

Zanafilla e debatit lidhur me rrethanat të cilat mund të ndikojnë në dënim mund të gjurmohet qysh në shekullin XII, kur dënimet ishin të përcaktuara në mënyrë aq të ngurtë dhe shpesh ishin aq të ashpra sa që studiuesit e drejtësisë filluan të mbështesin nevojën për përshkallëzimin e dënimit sipas situatës së caktuar faktike të rastit. Dënimi i paraparë për një veprë të caktuar do të njihej si *poena ordinaria*, që nënkuptonte dënimin e përcaktuar nga ligjvënësi në lidhje me veprën e caktuar të kryer në rrethana normale të rastit; për më tepër, gjyqtari gjithashtu do të kishte të drejtën për t'u distancuar nga dënimi i paraparë me ligj, duke e zbutur apo ashpërsuar atë, nëse kishte arsye apo rrethana të caktuara të cilat do të ndikonin në 'normalitetin' e rastit. Larmia dhe numri i rrethanave të tilla, që ndikojnë në dënim duhet të vlerësohen lidhur me 'dënimin e zakonshëm', me fjalë tjera, dënimin e zakonshëm që do të rezultonte nga ligji. Në kuadër të këtij procesi teorik të ndërlikuar dhe evolues u zhvilluan një numër i rrethanave të përbashkëta lehtësuese dhe rënduese. Përdorimi i shtuar i këtyre rrethanave solli deri te kodifikimi i procesit të individualizimit të dënimit dhe te zhvillimi i një sërë ndryshimesh rrënjësore të përbashkëta.

Në rastin Muçiq dhe të tjerët, Dhoma e Apelit kishte theksuar: "Trupi Gjykses ka gjetur, në shqyrtimet e tij të përgjithshme para trajtimit të rrethanave relevante për secilin individ të akuzuar, se konsiderata më e rëndësishme, e cila mund të cilësohet si testi i 'litmusit' për dënimin adekuat, është pesha e veprës penale. Dënimi i shqiptuar duhet të reflektojë peshën e qenësishme të sjelljes penale të të akuzuarit. ***Përcaktimi i peshës së veprës kërkon shqyrtim të rrethanave të veçanta të rastit, si dhe formën dhe shkallën e pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës... Dhoma e Apelit përsërit mbështetjen e atyre deklaratave dhe konfirmon pranimin nga ana e saj të parimit se pesha e veprës është konsiderata primare në caktimin e dënimit.***"<sup>40</sup>

Në shumë raste gjyqtarëve iu mungon të kuptuarit e drejtë se si rrethanat e ndryshme mund, apo si do të duhej të ndikonin në vendimin mbi dënimin. Ndonëse llojet e mundshme të rrethanave lehtësuese dhe rënduese janë mjaft të gjera, he gjykatat kanë diskrecionin për të vendosur lidhur me mënyrën e zbatimit e tyre në caktimin e dënimit, ka disa rrethana të caktuara të cilat qartazi duhet apo nuk duhet të merren parasysh. Rrethana lehtësuese apo rënduese duhet të jetë relevante për veprën penale apo për rrethanat personale të të pandehurit. Referimi standard apo cekja e rrethanave lehtësuese apo rënduese, ndonjëherë sjell deri te referimi në rrethana të cilat nuk janë relevante për rastin specifik.

Dispozitat për zbutje në KPRK janë mjaft të përgjithësuara. Deri në një shkallë kjo i atribuohet faktit se është e pamundur të parashihet çdo lloj rrethane e cila mund të paraqitet para gjyqtarit apo të vendoset në mënyrë autoritative se si duhet të zbatohet një rrethanë. Por, ndonëse kjo qasje lejon fleksibilitet më të madh, ajo ofron shumë pak udhëzime dhe rrjedhimisht rrit gjasat e ndërimit të praktikave divergjente ndëshkimore. Kjo pastaj kontribuon në mosharmonizimin e dënimeve, zvogëlon sigurinë juridike dhe rrit kritikën ndaj gjyqësorit. Në kuptim të caktimit të dënimit, KPRK-ja jep udhëzime të pakta lidhur me "individualizimin ligjor" dhe udhëzime të mjaftueshme të "individualizimit gjyqësor".

Rezultati përfundimtar i analizimit të rrethanave të kryerjes së veprës dhe rrethanave tjera të parapara me KPRK-në është që të arrihet në një dënim i cili është “në përpjesëtim me peshën e veprës dhe sjelljen dhe rrethanat e të pandehurit” ashtu siç ceket në nenin 69 të KPRK-së.

Neni 70 i KPRK-së përcakton këto rrethana të cilat gjykata duhet t’i merr parasysh:

**2. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese:**

- 2.1. shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale;
- 2.2. shkallën e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar, përfshirë çfarëdo prove të paramendimit;
- 2.3. praninë e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale;
- 2.4. nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore;
- 2.5. nëse vepra penale përfshin disa viktima;
- 2.6. nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme;
- 2.7. moshën e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar;
- 2.8. shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes të viktimës apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimës ose familjes së saj;
- 2.9. çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale;
- 2.10. dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar;
- 2.11. nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal dhe/ose;
- 2.12. nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo veprë penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë status tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale;
- 2.13. ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar.
- 2.14. nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjare.

**3. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme lehtësuese:**

- 3.1. rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore;
- 3.2. dëshmia për provokim nga ana e viktimës;
- 3.3. rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar;
- 3.4. dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale;
- 3.5. fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër;
- 3.6. moshën e personit të dënuar, i ri apo i moshuar;
- 3.7. dëshmia që personi i dënuar ka bërë dëmshpërblimin apo kompensimin e viktimës;
- 3.8. bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar;
- 3.9. bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale;



3.10. pranimin e fajit;

3.11. keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar;

3.12. sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit; dhe/apo

3.13. në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 169, 191 ose 193 të këtij Kodi, kontributi në mënyrë efektive për lëshimin ose për ta sjellë të gjallë personin e rrëmbyer, marrë apo ndalur ose dhënia vullnetare e informatave që kontribuojnë në identifikimin e përgjegjësve të tjerë për veprën penale.

3.14 në lidhje me veprat penale të terrorizmit të përcaktuara në këtë Kod, fakti që i pandehuri i veprës penale heq dorë nga veprimtaria terroriste para se të ketë pasoja të rënda prej saj dhe i ofron policisë, prokurorëve ose autoriteteve gjyqësore informata të cilat ato nuk do të kishin mundësi t'i siguronin; ndihmon në parandalimin ose zbutjen e efekteve të veprës penale; identifikon me detaje të mjaftueshme për të lejuar arrestimin ose ndjekjen penale të ndonjë terroristi apo grupi terrorist; gjen prova apo parandalon vepra të tjera terroriste.

Gjykatat obligohen të marrin parasysh rrethanat e cekura në KPRK, por “nuk kufizohen” vetëm në rrethanat e shprehura në mënyrë taksative. Prandaj gjykata është e lirë për të marrë parasysh dhe për të inkorporuar çfarëdo rrethane tjetër, sipas bindjes së saj, gjithnjë përderisa të njëjtat janë relevante për rastin konkret. Sërish, ndonëse kjo është padyshim një praktikë ndërkombëtare e rregullt dhe legjitime, megjithatë ofron udhëzime të pakta për të udhëhequr diskrecionin e gjykatës në ndonjë mënyrë domethënëse. Gjykatat duhet ta shohin shfrytëzimin e rrethanave të papërcaktuara si diçka që duhet rezervuar për situata shumë të rralla në të cilat rrethana është qartazi e përshtatshme për t'u marrë parasysh dhe e mbështetur fuqishëm nga provat.

Secila rrethanë rënduese dhe lehtësuese e përcaktuar në nenin 70 të Kodit Penal të Kosovës do të shtjellohet në hollësi në materialet në vijim.

## **2. Rrethanat rënduese sipas Nenit 70 të KPRK-së**

Pjesët në vijim i ofrojnë gjykatës një qasje më specifike ndaj secilës rrethanë rënduese dhe shembuj të asaj se çfarë mund të përfshijë secila nga to në raste konkrete por edhe vlerësim të asaj se kur duhet të përjashtohet një rrethanë. Aty, gjithashtu flitet lidhur me atë se ç'rëndësi duhet të ketë një rrethanë në vlerësimin e përgjithshëm të gjykatës dhe cilat fakte mund ta ndryshojnë atë vlerësim dhe/apo cilat pyetje duhet të parashtrihen.

### **2.1. Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale<sup>41</sup>**

Vlerësimi i drejtë i pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale duhet të bëjë dallimin ndërmjet formave të ndryshme të përgjegjësisë individuale. Rrethanat që ndërlidhen me pozitën dhe rolin e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale (siç është ‘pozita superiore’, ‘keqpërdorimi i autoritetit apo besimit’) gjithnjë duhet të merren si rrethana të rëndësishme rënduese. Megjithatë, rrethana e ‘pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë’ është faktor që ndërlidhet më shumë me elementet e veprës dhe pjesëmarrjen e të akuzuarit në të.

---

<sup>41</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70, paragrafi 2.1, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë

Kjo rrethanë është ngushtë e lidhur me dispozitën e nenit 69 paragrafi 3.1, shkallën e përgjegjësisë penale e cila shumë mirë është shpjeguar për veprat e korrupsionit, në Udhëzuesin e veçantë për korrupsion i miratuar nga Gjykata Supreme në vitin 2021. Ky Udhëzues, ka bërë një trajtim më ndryshe të kësaj rrethane duke e kombinuar atë me rrethanën nga par. 2.2 dhe 2.11. Qëllimi i asaj qasjeje ka qenë, që përgjithësisht të grumbullohen e më pas të zërthehen rrethanat të cilat janë shumë të ngjashme mes veti në mënyrë që ato të sqarohen më lehtë. Është shumë me interes që për çështjet që kanë të bëjnë me korrupsionin zyrtar dhe veprat e natyrës së ngjashme, gjykata, por edhe palët, të referohen tek ai Udhëzues.<sup>42</sup>

Vlerësimi i rrethanës në fjalë varet nga disa çështje. E para, që në kryerjen e veprës të kenë marrë pjesë të paktën dy individë. E dyta, që të ketë një shkallë të pjesëmarrjes nga njëri prej këtyre personave e cila konsiderohet si më e “lartë” se tjetra.

Ndonëse faktori i parë është mjaft i thjeshtë, i dyti është më sfidues dhe kërkon shqyrtim të kujdesshëm nga gjykata, siç është rasti me shumë dispozita lidhur me caktimin e dënimit, kjo nuk është rrethanë për të cilën ofrohen udhëzime të qarta për gjykatën lidhur me mënyrën se si duhet ta zbatojë atë. Sidoqoftë, ka dy vlerësime në të cilat gjykata duhet të përqendrohet gjatë shqyrtimit të ekzistimit të kësaj rrethane rënduese. E para është që të shqyrtojë skenarin faktik të veprës penale dhe kontributin e secilit pjesëmarrës në të. E dyta është që të shqyrtojë rolin e të pandehurit dhe nëse ai mund të konsiderohet udhëheqës.

#### *Krahasimi i veprimeve individuale*

Sa i përket vlerësimit të parë, gjykata duhet të shqyrtojë kontributin individual të secilit pjesëmarrës në raport me njëri tjetrin. Megjithatë, ajo që është e qartë nga gjuha e përdorur në ligj është se gjykata nuk lëshohet në vlerësim të detajuar të asaj nëse një i pandehur thjeshtë ka marrë pjesë më shumë se tjetri. Në të shumtën e rasteve, pas konstatimit të nivelit të duhur të fajësisë, të gjithë të pandehurit do të konsiderohen se kanë marrë pjesë “mesatarisht” në kryerjen e veprës. Prandaj, dallimet e vogla në pjesëmarrje të cilat mund të shpien në përfundimin se njëri pjesëmarrës është përfshirë në më shumë “veprime” sesa tjetri, në përgjithësi nuk duhet të konsiderohen si të mjaftueshme për të arsyetuar aplikimin e kësaj rrethane rënduese.

Në vend të kësaj, gjykata duhet të shqyrtojë nëse dallimi në pjesëmarrje është domethënës dhe nëse sjellja është shumë më e rëndësishme se suksesi i veprës. Faktet nuk duhet lënë asnjë dyshim në mendjen e gjykatës se pjesëmarrja e një aktori të caktuar është qartazi më e rëndësishme se pjesëmarrja e aktorëve tjerë dhe rrjedhimisht meriton dënim më të ashpër.

#### *Organizimi dhe drejtimi*

Çështja e dytë në të cilën gjykata duhet të përqendrohet është roli udhëheqës i të pandehurit në organizimin dhe drejtimin e përgjithshëm të veprës penale. Ky vlerësim mund të ndahet në dy kategori kryesore.

Së pari, gjykata duhet të vlerësojë rolin e të pandehurit në veprimet përgatitore të cilat kanë çuar deri te kryerja e veprës penale. Në të shumtën e rasteve, ngjarjet të cilat çojnë deri te kryerja e veprës do të kenë ndikim të fortë në vlerësimin e gjykatës. Kjo do të jetë posaçërisht relevante në kryerjen e veprave të ndërlikuara ku vepra përfundimtare në vete është si rezultat i një sërë hapave të cilët mund të mos jenë vepra penale në vetvete, por janë të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale përfundimtare. Ato gjithashtu mund të jenë të pranishme edhe në veprat më pak të ndërlikuara. Në rastin e lartpërmendur, njëri i pandehur mund të ketë siguruar planet e ndërtesës

---

<sup>42</sup> Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Gjykata Supreme, fq.33, Qershor 2021, Prishtinë.

apo armët ose ta ketë vëzhguar atë vend. Të gjitha këto mund të jenë bërë disa javë para kryerjes së veprës apo vetëm disa orë më parë. Pavarësisht kohës kur janë bërë, ato mund të kontribuojnë në shkallën e pjesëmarrjes nga i pandehuri në kryerjen e veprës dhe ndikojnë në ashpërsimin e dënimit.

Së dyti, gjykata duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet apo faktet të cilat tregojnë se i pandehuri ka kontrolluar apo drejtuar individët tjerë. Kjo mund të bëhet para kryerjes së veprës gjatë fazës përgatitore dhe gjatë veprimeve aktuale që përbëjnë vetë veprën penale. Në rastin e kësaj të fundit, i pandehuri mund t'iu tregojë pjesëmarrësve tjerë se si të sillen, çfarë të bëjnë gjatë grabitjes dhe të drejtojnë veprimet e tyre gjatë zhvillimit të ngjarjes. Në të dyja rastet, gjykata gjithashtu mund të shqyrtojë nëse ka marrëdhënie, qofshin ato formale apo joformale, të cilat tregojnë drejtimin nga njëri prej tyre. Këto mund të jenë marrëdhënie aktuale apo të së kaluarës. Shembujt përfshijnë marrëdhëniet familjare, strukturat e punës (punëdhënës/punonjës), kontratat, marrëdhëniet e mëparshme ushtarake dhe/apo afariste.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Sikurse me vepra tjera, është veçanërisht e rëndësishme që të vlerësohet nëse akuza e inkorporon rolin e personit. Me këtë rrethanë gjithashtu ka rrezik të konsiderueshëm të dyfishimit me kategoritë tjera, veçanërisht kur gjykata merr parasysh planifikimin e veprës si dhe ekzistimin e organizatës. Kur gjykata vlerëson një situatë në të cilën ka para planifikim të konsiderueshëm, rrethana 2.2 lidhur me shkallën e lartë të dashjes mund të vihet në funksion. Është plotësisht e mundur që para planifikimi të përfshijë edhe një shkallë të paramendimit si dhe të ndajë një të pandehur nga të tjerët në kuptim të shkallës së lartë të pjesëmarrjes. Ngjashëm me këtë, mund të ketë dyfishim kur ka strukturë të organizuar e cila përfshin një strukturë më formale siç janë organizatat qeveritare apo ushtarake në të cilat i pandehuri është udhëheqës formal. Në atë rast është e mundur që të zbatohet rrethana 2.9 pasi që përfshihet një lloj i “keqpërdorimit të pushtetit ose pozitës zyrtare”. Varësisht nga faktet, keqpërdorimi i pushtetit mund ta shtyjë të pandehurin në shkallë të lartë të pjesëmarrjes në kryerjen e veprës.

Gjykata duhet të jetë e vetëdijshme për mundësinë e ndërveprimit ndërmjet këtyre rrethanave dhe të shqyrtojë me kujdes rëndësinë e secilës rrethanë në rezultatin përfundimtar. Gjykata nuk duhet që t'i jep peshë maksimale secilës rrethanë, thjeshtë sepse ekziston, por duhet që me kujdes ta shpërndajë peshën e tyre në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra. Kjo nuk është detyrë e lehtë, por duke marrë parasysh ndikimin që mund ta ketë në ashpërsimin e dënimit duhet të shqyrtohet me shumë kujdes. Pavarësisht kësaj, kur ka dyfishim të të tre faktorëve, kjo është një tregues për gjykatën se ka nevojë për ashpërsim.

#### *Entuziazmi në pjesëmarrje*

Kjo rrethanë gjithashtu nuk kërkon vlerësimin e “entuziazmit” për të marrë pjesë në kryerjen e veprës. Ndonëse disa struktura të caktimit të dënimit e konsiderojnë të nevojshme ashpërsimin e dënimit kur gjendja mendore e të pandehurit tregon zell të veçantë për ta kryer veprën, Kodi Penal i Kosovës nuk e parasheh një gjë të tillë. Me të arritur nivelin e kërkuar të gjendjes mendore për ta mbajtur të pandehurin penalisht përgjegjës, nuk ka ndonjë ashpërsim për të pandehurin i cili shfaq dëshirë të zjarrtë për ta kryer veprën penale. Ngjashëm me këtë, mungesa e dëshirës për të marrë pjesë në kryerjen e veprës veç është marrë parasysh në *mens rea* lidhur me veprën. Kjo shtjellohet, më në hollësi, në pjesën e rrethanave lehtësuese.

*Konsideratat e përgjithshme përfshijnë:*

Veprimet të cilat në mënyrë të konsiderueshme janë më të mëdha sesa ato të pjesëmarrësve tjerë.

- Planifikimi i aktiviteteve për të shtuar gjasat për përfundimin me sukses të veprës penale.
- Rekrutimi dhe financimi i pjesëmarrësve tjerë.
- Drejtimi i aktiviteteve për të tjerët.
- Sigurimi i mjeteve për ta përfunduar veprën.
- Ndërmarrja e hapave gradual për ta çuar tutje veprën.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka qenë i pandehuri në pozitë hierarkike?
- A ka qenë struktura formale apo joformale?
- A ka qenë i pandehuri udhëheqës në strukturë apo në grup?
- A ka qenë roli i të pandehurit i rëndësishëm në planifikimin e veprës?
- A ka kontribuar pozita e të pandehurit në kryerjen e veprës?
- A e kanë rritur seriozitetin e veprës veprimet apo pozita e të pandehurit?
- A do të ishte kryer me sukses vepra pa pjesëmarrjen e të pandehurit?

2.2. Shkalla e lartë e dashjes nga ana e personit të dënuar<sup>43</sup>

Dashja paraqitet si element i veprës penale i përfshirë shprehimisht në shumicën e veprave penale, me përjashtim të atyre ku ligji shprehimisht ka paraparë se vepra mund të kryhet edhe nga pakujdesia. Përcaktimi i shkallës së dashjes, nga ana tjetër, është një prej çështjeve në caktimin e përgjegjësisë së individit e rrjedhimisht edhe ndikon në lartësinë e dënimit. Është po ashtu një proces mjaft sfidues si për prokurorinë për të dëshmuar nivelin më të lartë të dashjes ashtu edhe për palën mbrojtëse e cila tradicionalisht lobon për përfshirje të nivelit të ulët të dashjes nga ana e të pandehurit. Duke e ditur vështirësinë që shumë shpesh paraqitet në praktikë në gjetjen e provave të drejtpërdrejta për këtë, KPRK-ja në nenin 22 ka paraparë shprehimisht se

*“Dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike”.*

Pikërisht nga ky nen rezulton edhe detyrimi për palët për prezantim të provave për dhe kundër dhe detyrimin të gjykatës në vlerësimin e këtyre provave me rastin e matjes së dënimit. Udhëzuesi, përgjatë zbrërthimit të rrethanave të ndryshme në tërë tekstin e vet, jep shpjegime e analiza për rrethana të ndryshme ku shumë prej tyre mund të merren në konsideratë si prova rrethore në përcaktimin e shkallës së dashjes. Më poshtë janë dhënë disa indikatorë që mund të ndihmojnë në përcaktimin e dashjes. Megjithatë duhet pasur parasysh gjithnjë se indikatorë të tillë mund të gjenden përgjatë tërë tekstit të këtij Udhëzuesi, por edhe udhëzuesve tjerë të veçantë, siç është edhe rasti me Udhëzuesin për veprat penale të korrupsionit.

---

<sup>43</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë Kodi Penal, neni 70, par.2.2

### *Paramendimi*

Paramendimi konsiderohet si planifikim para kryerjes së veprës penale. Edhe pse me ndryshimin e KPRK-së është hequr paramendimi shprehimisht nga rrethana para. 2.2, kjo nuk nënkupton se nuk duhet të merret në konsideratë si indikator për përcaktimin e shkallës së dashjes. Kryerja e veprës me paramendim konsiderohet si shkallë më e lartë e rrezikut për shoqërinë pasi që kjo, në esencë paraqet sulm ndaj vlerave shoqërore dhe tregon angazhim e ndoshta edhe vazhdimësi më të madhe sesa veprat spontane. Rreziku i tyre ndaj shoqërisë, në radhë të parë, është i rrënjosur në konceptin që angazhimi më i lartë për të kryer veprën tregon se gjasat për rehabilitim të suksesshëm mund të jenë më të ulëta.

Paramendimi është faktor i cili potencialisht mund të zbatohet në disa kategori. Në përgjithësi, konsiderohet si rrethanë e cila mund t'i atribuohet drejtpërdrejt veprimeve të të pandehurit dhe shkallës së përgjegjësisë së tij. Megjithatë paramendimi, parashihet me ligj si formë e cilësuar e veprës, duke e rritur nivelin e dënimit të paraparë. Paramendimi, gjithashtu mund të shihet edhe si element i veprës penale që rrjedhimisht e bën këtë vepër të kualifikuar. Gjykata duhet të merr parasysh shkallën e planifikimit dhe veçanërisht kohën e përfshirë në përgatitjen e veprës.

Sa i përket situatës së parë, paramendimi mund të jetë faktor për t'u konsideruar qoftë si rrethanë rënduese apo lehtësuese në matjen e dënimit. Për shembull, kur vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën për të cilën akuzohet me ftohtësi dhe me paramendim të kalkuluar, për shkak të hakmarrjes ndaj viktimës individuale apo grupit të cilit i takon viktima, rrethanat e tilla imponojnë shqiptimin e dënimit më të ashpër. Situata klasike do të mund të përshkruhej si vepër e motivuar nga hakmarrja apo ruajtja e “nderit”. Në këto raste, vlerësimi relevant do të përqendrohet në kohën dhe në mundësinë që i pandehuri e ka pasur për të reflektuar lidhur me rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për hakmarrje. Në anën tjetër, nëse vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën për të cilën akuzohet me hezitim dhe nën ndikimin e presionit të grupit dhe, përveç kësaj, ka treguar dhembshuri ndaj viktimës apo grupit të cilit i takon viktima, këto padyshim se janë rrethana lehtësuese të cilat gjyqtarët duhet t'i marrin parasysh gjatë caktimit të dënimit.

### *Mungesa e pendimit*

Rastet kur i pandehuri qartazi nuk shfaq shenja të pendimit mund të merret si indikator i përcaktimit të dashjes e jo, domosdo, si rrethanë e veçantë rënduese. Kjo jo vetëm që shpërfaq mungesë të respektit për viktimën, por gjithashtu tregon mungesë të përgjithshme të respektit për ligjin, si dhe jep një pasqyrim të një individi i cili ka predispozita për sjellje asociale dhe të rrezikshme për shoqërinë. I pandehuri, i cili nuk pendohet paraqet një tregues të fuqishëm se rehabilitimi mund të dështojë.

### *Rrethanat tjera sipas Udhëzuesit për veprat penale të korrupsionit*

Për shkak të rëndësisë së matjes së shkallës së dashjes, në këtë paragraf, do të përmenden vetëm kalimthi disa nga specifikat të cilat më në detaje janë përfshirë në Udhëzuesin për veprat penale të korrupsionit. Kështu, përveç paramendimit dhe planifikimit i cili tanimë është zberthyer më sipër, Udhëzuesi përmend si rrethana edhe:

- Vepra e kryer për të lehtësuar aktivitetin tjetër kriminal;
- Veprat e natyrës trans-nacionale;
- Përfshirja e të tjerëve përmes presionit.

### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Ekzistimi i shkallës së lartë të dashjes apo paramendimit mund të përkojë me rrethanën 2.1, veçanërisht në situatat kur përfshihen disa kryes. Në përpjekje për të shmangur llogaritjen e dyfishtë, gjykata duhet t'ia atribuojë planifikimin kësaj rrethane. Kjo bazohet në faktin se planifikimi është vetëm një nga disa çështjet që mund të ndikojnë në shkallën e pjesëmarrjes. Ndërsa ekzistimi i planifikimit është provë e drejtpërdrejtë e paramendimit.

Edhe te shkelja e urdhrave të gjykatës, duhet pasur kujdes që të mos përfshihet si rrethanë rënduese nëse si pjesë e akuzës është përfshirë edhe vepra nga Neni 393, Mospërfillja e gjykatës.

### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka pasur hakmarrje apo fyerje të pretenduar të të pandehurit?
- Sa kohë ka kaluar ndërmjet fyerjes së pretenduar dhe veprës?
- Çfarë planifikimi ka pasur në kryerjen e veprës?
- Sa kanë qenë të ndërlukuara përgatitjet për kryerjen e veprës?
- A ka qenë e mundur të kryhet vepra pa planifikim?
- A i ka blerë mjetet i pandehuri për ta kryer veprën?
- Nëse ka pasur viktimë, a ka qëndruar i pandehuri në pritë para kryerjes së veprës?

### 2.3. Prezenca e dhunës apo kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale<sup>44</sup>

Vlerësimi i rrethanave përqendrohet në përdorimin apo kanosjen për përdorim të dhunës në kryerjen e veprës penale. Në të shumtën e rasteve, përdorimi i dhunës apo kanosjes është element i veprës penale. Për shembull, përdorimi i dhunës apo kanosjes e cilëson vjedhjen e thjeshtë në grabitje. Në këto raste, rrethana rënduese duhet të mos merret parasysh nga gjykata. Zbatimi i kësaj rrethane kufizohet vetëm për ato vepra në të cilat dhuna apo kanosja mungon nga kualifikimi ligjor i veprës penale. Në përgjithësi, dhuna duhet të konsiderohet si rrethanë më rënduese sesa kanosja me dhunë.

Një çështje që gjykata duhet ta merr parasysh është përfshirja e palëve të treta. Mund të ketë situata në të cilat kanosja me dhunë nuk i drejtohet viktimës së veprës, por palës së tretë. Në këto raste, gjykata duhet të shqyrtojë tërësinë e rrethanave dhe raportin ndërmjet veprës dhe kanosjes. Nëse kanosja ka ndonjë lidhje me veprën e përgjithshme, atëherë gjykata duhet ta konsiderojë si rrethanë rënduese, edhe nëse kanosja nuk i është drejtuar viktimës. Kjo rrethanë nuk bën dallim ndërmjet viktimës së krimit dhe palës së tretë. Andaj, nuk duhet të ketë zbutje të peshës së rrethanës vetëm për shkak se kanosja i është drejtuar palës së tretë.

Në kontekst të veprave të dhunës në familje, gjykata në veçanti duhet të bëjë kujdes lidhur me kanosjen me dhunë dhe përdorimin e mundshëm të saj ndaj palëve të treta.

### *Përsëritja e dhunës dhe kanosjeve për përdorim të dhunës*

E kaluara e dëshmuar e dhunës apo kanosjeve nga i pandehuri është faktor kyç në vlerësimin e peshës së veprës. Dëshmitë për përsëritje të vazhdueshme të sjelljeve të njëjta apo të ngjashme të dhunshme apo kanosjes me dhunë paraqesin indikator si për karakterin e të pandehurit, ashtu edhe për një nivel të rritur të rrezikshmërisë.

---

<sup>44</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.3, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

### Dyfishimi dhe kujdesi

Gjykata duhet të ketë kujdes që të mos bëjë dyfishim të pranisë së dhunës kur e njëjta është shprehur si element i veprës. Edhe kur flasim rreth aspektit të pranisë së armës vlen i njëjti parim që të shmangët dyfishimi nëse posedimi apo përdorimi i armës është përfshirë si vepër e veçantë nga kapitulli XXIX<sup>45</sup>.

#### Pyetjet relevante përfshijnë:

- A është përdorur dhuna?
- A ka pasur instanca tjera të dhunës apo kërcënim për dhunë?
- A është përfshirë arma?
- Cila ka qenë natyra dhe shkalla e lëndimeve?
- A ka qenë përdorimi/kanosja e dhunës e nevojshme për kryerjen e veprës?
- Nëse ka pasur kanosje, a ka pasur mundësi i pandehuri që ta realizojë atë?
- A ka qenë përdorimi/kanosja e dhunës e drejtuar ndaj palës së tretë?
- A ka qenë kanosja e dukshme dhe e qartë?
- A ka qenë kanosja e nënkuptuar?

#### 2.4. Kombinimi i rrethanave lidhur me viktimat

Koncepti themelor i kësaj është se shprehja viktimë për qëllim të këtij vlerësimi mund të përfshijë një numër më të gjerë sesa ato të përfshira në konceptet tradicionale të viktimës. Gjykata mund të merr parasysh ndikimin e veprës në të gjithë ata të cilët mund të jenë prekur nga kryerja e veprës. Për shembull, dëshmitarët e veprës dhe anëtarët e familjes apo më të dashurit e tyre të gjithë mund të konsiderohen si viktimat të veprimeve të drejtpërdrejta të të pandehurit, varësisht nga natyra dhe ndikimi i tyre.

KPRK-ja përmban një mori rrethanash që kanë të bëjë me “viktimizimin” dhe të njëjtat ngërthejnë në vete, si shkallën e dëmit të shkaktuar viktimës ashtu edhe rrethanat e ndryshme dhe karakteristikat personale të viktimës. Rrethanat 2.4, 2.5, 2.6, 2.7 dhe 2.8 nga neni 70 të gjitha i referohen viktimave dhe rrethanave specifike të cilat do ta ashpësojnë dënimin. Fakti që pesë prej rrethanave rënduese përqendrohen në viktimat është dëshmi e rëndësisë që ky vlerësim luan në përcaktimin e dënimit. Rrethanat e tilla gjithnjë duhet të konsiderohen si rrethana të rëndësishme rënduese të cilat çojnë në shqiptimin e dënimeve më të ashpra dhe që janë të rëndësishme për të përcaktuar rëndësinë e përgjithshme të veprës. Ngjashëm me rrethanat personale të të pandehurit, rrethanat që kanë të bëjnë me viktimën i mundësojnë gjykatës që të merr parasysh veçoritë e viktimës, gjë që i mundëson të shqiptojë një dënim i cili reflekton ndikimin e veprës te viktimat.

Në shumë prej skemave të dënimit, ka një lidhje të drejtpërdrejtë në mes të ndikimit në viktimën dhe peshës së përgjithshme të veprës, dhe këto dyja shpesh konsiderohen si rrethanat më të rëndësishme që duhet marrë parasysh. Me rritjen e seriozitetit të veprës në këtë mënyrë, rritet edhe nevoja për ta mbrojtur publikun përmes parandalimit të përgjithshëm dhe kompensimit të viktimave për dëmin e shkaktuar me vepër.

Rëndësia e trajtimit të viktimave është e mishëruar në Direktivën e BE 2012/29/EU e cila në mënyrë të saktë thotë se “viktimat e krimit duhet të mbrohen nga ri viktimizimi, frikësimi dhe

---

<sup>45</sup> Kodi Penal, Kapitulli XXIX, Veprat penale të armëve.

hakmarrja, atyre duhet dhënë ndihmën e nevojshme për të lehtësuar shërimin e tyre dhe duhet ofruar qasje të mjaftueshme në drejtësi”.<sup>46</sup> Kjo shtjellohet edhe më tej në direktivë ku thuhet se “Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që viktimat të dëgjohen gjatë procedurës penale dhe të kenë mundësi të paraqesin prova”.<sup>47</sup> “Kur gjykata konsideron se vlerësimi individual i viktimës dhe rrethanave të veprës duhet të merr parasysh karakteristikat personale të viktimës siç janë mosha, gjinia, identiteti apo shprehja gjinore, etniteti, raca, feja, orientimi seksual, shëndeti, aftësitë e kufizuara, statusi i vendbanimit, vështirësitë në komunikim, marrëdhënia apo varësia nga i pandehuri dhe përvojat e mëparshme të pësimit nga krimi. Ato gjithashtu duhet të marrin parasysh llojin apo natyrën dhe rrethanat e veprës siç janë: nëse vepra është krim i urrejtjes, krim i paragjyqimit apo vepër e kryer me motive diskriminuese, të dhunës seksuale, dhunës në marrëdhënie të afërt, nëse i pandehuri ka qenë në pozitë të kontrollit, nëse vendbanimi i viktimës është në një zonë ku ka shkallë të lartë të kriminalitetit ose ku ka banda, apo nëse vendi i prejardhjes së viktimës nuk është Shteti në të cilin është kryer vepra”.<sup>48</sup> Përfundimisht, “drejtësia nuk mund të arrihet në mënyrë efektive nëse viktimat nuk mund të shpjegojnë në mënyrë adekuate rrethanat e veprës dhe nëse nuk kanë mundësi për të paraqitur provat e tyre në mënyrën e cila është e kuptueshme për organet kompetente”.<sup>49</sup>

Ndonëse qëllimi primar i direktivës është që të themelojë shërbime dhe detyrime bazë të cilat secili shtet anëtar duhet t’ua ofrojë viktimave, megjithatë kjo qartazi përcakton detyrimin e gjykatave për ta konsideruar viktimën në mënyrë gjithëpërfshirëse përgjatë procedurës. Kjo nuk përfshin vetëm të drejtën për të paraqitur prova dhe për t’u dëgjuar nga gjykata, por edhe detyrimin e gjykatës që të merr parasysh rrethanat individuale dhe statusin e viktimës.

Këto parime janë të mishëruara qartazi në KPRK dhe KPPRK. Siç u diskutua më herët, KPRK-ja parasheh që njëri nga qëllimet kryesore të dënimit është kompensimi i viktimave dhe komunitetit për humbjet dhe dëmet e shkaktuara nga vepra penale.<sup>50</sup> Kjo nuk duhet parë si diçka që kufizohet vetëm në humbjet materiale apo pasurore në kuptimin më tradicional të fjalës, por duhet të parasheh një shkallë të caktuar të drejtësisë dëmshpërblyese, të zhdëmtojë viktimën. Në këtë drejtim, KPRK-ja i ofron viktimave mekanizmat përmes mundësisë për të marrë pjesë në gjykim dhe për të paraqitur prova. Kjo përfshin kontributin në paraqitjen e provave dhe dëshmimeve për vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese nga gjykata gjatë matjes së dënimit. Është me rëndësi të mbahet në mend se disa prej rrethanave mund të përfshijnë konsiderata të cilat në rrethana të zakonshme nuk do të paraqiteshin nga prokurori për të vërtetuar rastin “prima facie” kundër të pandehurit. Prandaj, gjykata duhet t’i japë liri veprimi paraqitjes së provave nga viktima në mënyrë që të vlerësojë drejt dhe në mënyrë adekuate shtrirjen e plotë që këto rrethana mund të kenë në përcaktimin e dënimit më të ashpër.

Shkalla e lartë e viktimizimit natyrisht është një element shumë i rëndësishëm dhe, shumë shpesh, një tregues domethënës i peshës së veprës. Kjo në përgjithësi përfshin një numër rrethanash dhe faktorësh, siç janë:

- numri i viktimave,
- koha gjatë së cilës është kryer vepra,

---

<sup>46</sup> Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 25 tetor 2012 për përcaktimin e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, e cila zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/22/JHA (9).

<sup>47</sup> Po aty, Neni 10 Paragrafi 1.

<sup>48</sup> Po aty (56).

<sup>49</sup> Po aty (34).

<sup>50</sup> Kodi Penal i Kosovës, Neni 38, paragrafi 1.3.



- nëse vepra është kryer në vazhdimësi ndaj viktimës së njëjtë,
- shkallën e vuajtjes dhe poshtërimin të shkaktuar,
- rritja e qëllimshme dhe çnjerëzore e vuajtjeve të viktimave,
- ndjeshmëria dhe/ose pamundësia e mbrojtjes së viktimës;
- dëmi, trauma dhe niveli i vuajtjes së shkaktuar ndaj viktimës;
- mosha – foshnje apo mosha e re e viktimës;
- kryerja e veprës me keqpërdorim të pozitës së superioritetit mbi viktimën apo përmes keqpërdorimit të besimit;
- traumat fizike dhe mendore të përjetuara nga i mbijetuari si pasojë e veprës;
- kryerja e veprës për shkak të motivit të diskriminimit në baza racore, etnike, fetare, gjinore apo ndonjë forme tjetër të paragjykitimit.

Gjykata gjithnjë duhet të ketë parasysh se nëse dënimi është i drejtë dhe në përpjesëtim me peshën e veprës penale, atëherë viktimja, familja e miqtë e viktimës dhe publiku i përgjithshëm do të jenë të kënaqur që ligji është zbatuar dhe nuk do të ketë dëshirë për hakmarrje të mëtejshme private.

#### *2.4.1 Nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore<sup>51</sup>*

Mizoria është koncept i përbashkët në sistemet e caktimit të dënimit kur kemi të bëjmë me viktimja. Ka një pajtim universal se veprimet e kryera ndaj viktimës të cilat përfshijnë ndonjë formë të mizorisë duhet të dënohen më ashpër në raport me dënimin që do të shqiptohej për veprën “mesatare”. Si e tillë, prania e saj shpesh përfshihet si faktor ashtu që viktimja dhe rrethanat personale të saj do të jenë faktor i rëndësishëm në caktimin e dënimit. Pavarësisht nëse është element i veprës penale apo rrethanë rënduese, gjykata duhet të merr parasysh brutalitetin, zellin, mizorinë apo sadizmin e përdorur nga i pandehuri në kryerjen e veprës apo veprave. Megjithatë është me rëndësi që gjykata ta ketë parasysh se ashpërsimi në këto situata është i kufizuar vetëm për ato raste në të cilat mizoria arrin nivelin “posaçërisht” mizor. Shkaktimi i vuajtjeve përmes mizorisë drejtpërdrejt i atribuohet individit i cili e shkaktonte atë. Përdorimi i mizorisë në mënyrë të vazhdueshme duhet të cilësohet si rrethanë e rëndësishme rënduese që ndërlikohet me rolin e të akuzuarit në kryerjen e veprës dhe që demonstron keqdashje të veçantë ndaj viktimës.

KPRK-ja nuk parashihet ndonjë përkufizim të asaj se çfarë përbën mizorinë. Koncepti në përgjithësi konsiderohet të jetë veprim i cili shkaktonte dhimbje apo vuajtje ndaj tjetrit pa kurrfarë konsiderate apo brengje lidhur me shkaktimin e kësaj gjendjeje apo ndikimit të saj në viktimën. Prandaj, çështjet kryesore për shqyrtim janë elementet që kërkohen për kryerjen e veprës në lidhje me veprimet e të pandehurit, siç është niveli i lëndimit dhe dashja e të pandehurit për t’i shkaktuar ato lëndime.

Çdo lëndim, përtej asaj që kërkohet për të plotësuar elementet e veprës penale apo, që zakonisht ndërlikohet me veprën natyrisht se në vete përmban një shkallë të caktuar të mizorisë. Në situatat tjera, cilësimi i lëndimit përtej asaj që kërkohet për ta kryer veprën është më i vështirë. Për shembull, në vrasje, përqendrimi do të jetë në veprimet e të pandehurit të cilat tregojnë se ka pasur gjymtim dhe/apo vuajtje përtej asaj që është e nevojshme për të shkaktuar vdekjen dhe që i pandehuri ka dashur të shkaktonte dhunë të tillë të tepruar.

<sup>51</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

Nëse niveli i mizorisë e arrin nivelin “posaçërisht” mizor kërkon një shqyrtim më të thellë të rrethanave të përgjithshme, përfshirë ndikimin e veprës në viktimën e caktuar. Mënyra posaçërisht mizore, do të ekzistojë kur vepra përfshin shkaktimin e paarsyeshëm të dhembjes dhe mizorisë dukshëm përtej asaj që zakonisht përdoret në kryerjen e veprës së tillë. Në rrethana normale, niveli i lëndimit, krahasuar me nivelin që kërkohet për të përmbushur elementet e veprës, do të jetë një tregues bindës kur shikohet së bashku me dashjen e të pandehurit. Deri në një shkallë kjo do të përfshijë vlerësimin e veprës nga gjykata në dritë të përvojave dhe ekspozimit të saj të mëparshme ndaj situatave të ngjashme. Nuk ka ndonjë formulë apo qasje kuantitative për të përcaktuar nëse kjo rrethanë është e pranishme.

#### *Ndikimi psikologjik*

Vlerësimi adekuat i kësaj rrethane kërkon prova të mjaftueshme për të dëshmuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve. Kjo nuk duhet të kufizohet vetëm në lëndimet fizike, por duhet të përfshijë edhe lëndimet e natyrës psikologjike. Kjo mund të përfshijë edhe implikimet psikologjike afatshkurtra apo afatgjata dhe aftësinë e viktimës së caktuar për t’u rimëkëmbur pas veprës.

#### *Ndikimi në palët e treta*

Gjykata, gjithashtu mund të merr parasysht ndikimin e lëndimit të personat tjerë. Për shembull, një rast i vrasjes në të cilin i pandehuri e varros trupin e viktimës në një lokacion të panjohur mund të ketë ndikim të thellë psikologjik në familjen e viktimës. Këto rrethana mund të konsiderohen si prova shtesë të mungesës së konsideratës së të pandehurit për pasojat e veprës së tij.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Sikurse me rrethanat tjera, gjykata duhet të jetë e vetëdijshme për mundësinë e dyfishimit. Megjithatë, gjykata nuk duhet të hezitohet në grumbullimin apo kombinimin e disa rrethanave të cilat individualisht nuk mund të merren si rrethana të ndara rënduese. Për shembull, kur i pandehuri kryen ndonjë vepër të dhunshme kundër viktimës dhe ka indikacione që vepra është kryer në mënyrë mizore. Megjithatë, gjykata nuk është e bindur se ka shkaqe të mjaftueshme për ta konsideruar vërtetë si mënyrë posaçërisht mizore. Pas shqyrtimit të mëtutjeshëm, gjykata arrin në përfundim se, ngjashëm me këtë, ka indikacione që viktima ka qenë e pambrojtur, por jo edhe aq e pambrojtur sa të arrijë në përfundim se viktima ka qenë posaçërisht e pambrojtur sipas rrethanës nga paragrafi 2.6. Në këtë situatë, është e arsyeshme që këta dy faktorë të trajtohen së bashku në mënyrë që të arrihet deri te gjetja e rrethanës rënduese nga paragrafi 2.4 të mënyrës posaçërisht mizore.

Çelësi për të arritur deri te ky përfundim është se këto dy çështje janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Në shumë aspekte, është vështirë për t’i izoluar tërësisht në konsiderata të ndara. Çdo gjetje që viktima është e pambrojtur/e ndjeshme, natyrisht se do ta shtyjë gjykatën të besojë se një shkallë e caktuar e mizorisë është shkaktuar ndaj viktimës. Ky është rasti, veçanërisht kur ndjeshmëria e viktimës është menjëherë e dukshme për një vëzhgues të arsyeshëm. Megjithatë, nëse baza për gjetjen e një niveli të caktuar të mizorisë varet tërësisht nga përfundimi i gjykatës se viktima ka qenë e pambrojtur, atëherë nuk duhet të ketë ashpërsim.

Në fund, nuk ka ndonjë vepër në Kod për të cilën ligji parasheh formë të cilësuar të dënimit bazuar në elementin e kryerjes së veprës në mënyrë posaçërisht mizore. Megjithatë, ka disa vepra për të cilat parashihet dënim i cilësuar në rastet kur ekziston çfarëdo mizorie. Nëse vepra e caktuar përfshin elementin e mizorisë për gjetjen e fajësisë, atëherë nuk duhet të ketë ashpërsime për këtë rrethanë pasi që e njëjta konsiderohet si element i veprës.

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A kanë qenë lëndimet përtej atyre që kërkohen për të plotësuar elementet ligjore të veprës penale?
- A ka lëndime tjera përveç lëndimit kryesor të cilat plotësojnë kërkesën ligjore të nivelit të lëndimit?
- A ka indikatorë që i pandehuri ka dashur të shkaktojë atë nivel të lëndimeve?
- A ka efekte anësore afatgjata të lëndimeve?
- A ka lëndime mendore të përfshira, qoftë si rezultat i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i veprës penale? Nëse po, a janë ato të përhershme apo afatgjate?
- A ka lëndime apo implikime psikologjike për anëtarët e familjes? Cila është natyra dhe shkalla e tyre?
- A ka indikacione të qarta të shkakimit të paarsyeshëm të lëndimeve?
- A ka indikacione se i pandehuri ka kryer veprën ndaj viktimës me zell apo kënaqësi?
- A e ka lënë i pandehuri viktimën në gjendje të paaftë?

#### 2.4.2. Nëse vepra penale përfshin disa viktimas<sup>52</sup>

Qëllimi parësor i kësaj rrethane është që të kodifikojë parimin se i pandehuri, i cili kryen veprën të dhunshme apo veprën që ka gjasë t'i shkaktojë dëm disa personave, është më i fajshëm se i pandehuri i cili i shkakton dëm vetëm një personi. Në situatë të tillë, dënimi mesatar i pandehurit nuk është i mjaftueshëm për të treguar se secila viktimë individuale është marrë parasysh nga gjykata në shqiptimin e dënimit të përgjithshëm. Varësisht nga natyra e veprës dhe numri i viktimave, gjykata duhet të përshtatë kufijtë e dënimit në mënyrë që të reflektojë në mënyrë adekuate faktin e fajësisë më të madhe të të pandehurit. Është me rëndësi të mos harrohet se kjo rrethanë mund të zbatohet në situatat të cilat nuk i përshtaten bindjeve tradicionale të asaj se çfarë mund të cilësohet si viktimë – më saktësisht bindjes se viktimat ekzistojnë vetëm kur ka ndonjë akuzë formale për veprën penale dhe viktimas formalisht merr statusin e “viktimës”.

Ka dy situata kryesore kur kjo rrethanë do të luajë rol në rritjen e dënimit përfundimtar. E para, është kur ka viktimë lëndimet e së cilës janë shkakuar nga vepra, por nuk ka akuza lidhur me viktimën. E dyta është kur akuza përfshin disa viktimas, por nuk bën ndonjë dallim bazuar në numrin e tyre.

Në situatën e parë, viktimas zakonisht është palë e tretë e cila nuk është lënduar fizikisht, por i është nënshtruar ndonjë formë të lëndimit emocional apo psikologjik. Kjo zakonisht është e pranishme kur ka një shkallë të konsiderueshme të mizorisë apo dhunës së përdorur në kryerjen e veprës. Kjo mund të shkaktohet me një veprim të vetëm apo përgjatë një periudhe më të gjatë kohore. Këto lëndime, ndonëse formalisht nuk ndiqen si veprën penale nga prokuroria, në praktikat ndërkombëtare gjithnjë e më shumë po trajtohen si lëndime të cilat kontribuojnë në dëmin e përgjithshëm të shkakuar nga vepra dhe personat e prekur konsiderohen si viktimas.

Situata e dytë përfshin akuzat penale në të cilat ka më shumë se një viktimë, por dënimi nuk është i përshtatur proporcionalisht në raport me numrin e viktimave. Kjo situatë, më së shpeshti ndodh në krime ekonomike apo masakra të shkallës së madhe. Për shembull, ndonëse

---

<sup>52</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.5, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

neni 283 i KPRK-së për dëmtimin e kreditorëve apo debitorëve e rrit nivelin e dënimit kur dëmi i përgjithshëm ndryshon nga 5,000 në 250,000 Euro, ai nuk merr parasysh numrin e viktimave. Zbatimi i kësaj rrethane në dënimin përfundimtar merr parasysh në mënyrë adekuate numrin e viktimave të përfshira.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Ashpërsimi bazuar në numrin e viktimave është qartazi rrethanë rënduese dhe gjithnjë duhet të merret parasysh. Sidoqoftë, për shkak të seriozitetit potencial të kësaj konsiderate, asaj duhet qasur me kujdes dhe vetëm pas gjetjeve të mjaftueshme nga gjykata.

Një çështje që duhet marrë parasysh është nëse ka pasur akuza të ndara për veprat ndaj secilës viktimë. Nëse viktimat janë të reflektuara në mënyrë të ndarë në akuzat individuale, atëherë kjo rrethanë në kushte normale nuk do të merret parasysh. Rasti i vetëm kur gjykata duhet ta merr parasysh këtë është gjatë ashpërsimit të dënimit për dënimin unik sipas nenit 76 në të cilin ka veprime të ngjashme kundër disa viktimave. Ndonëse gjykata, fillimisht shpall dënime për secilën vepër penale, paragrafi 2.2 ndalon mbledhjen e të gjitha dënimeve individuale dhe kërkon një dënim më të ultë se shuma e të gjitha dënimeve individuale. Nëse gjykata është e prirur për të shqiptuar një dënim përfundimtar, dukshëm më të ultë se shuma e të gjitha dënimeve individuale, atëherë duhet të japë arsyetim për këtë dhe të shpjegojë se përse ekzistimi i disa viktimave nuk e justifikon ashpërsimin e dënimit deri në afërsi të shumës totale të dënimeve.

Përveç kësaj, gjykata nuk mund ta merr parasysh këtë rrethanë rënduese nëse prokuroria nuk arrin të provojë se vepra është kryer ndaj viktimës së caktuar apo statusin e tyre si viktimë. Në thelb, kjo nënkupton që gjykata nuk mund ta përdorë viktimën e cila ka qenë subjekt i aktgjykimit lirues si viktimë për qëllim të ashpërsimit të dënimit për ndonjë vepër tjetër. Ngjashëm me këtë, nëse gjykata ka dyshime të mjaftueshme lidhur me faktet të cilat e përshkruajnë personin si viktimë, atëherë nuk duhet që t'i marrë në konsideratë për qëllim të ashpërsimit të dënimit.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka pasur dëshmitarë apo të tjerë të pranishëm në atë kohë?
- A është e përfshirë ndonjë marrëdhënie familjare?
- A ka pasur lëndime jo fizike të cilat u janë shkaktuar personave tjerë siç janë lëndimet psikologjike, emocionale, etj?
- A është marrë parasysh mjaftueshëm numri i viktimave?
- A mund të cilësohet ndryshe vepra bazuar në numrin e viktimave?
- A është aktiviteti i natyrës së tillë që sa më i madh të jetë numri i viktimave aq më i madh të jetë niveli i dënimit?

#### *2.4.3. Nëse viktimë e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme<sup>53</sup>*

Ndjeshmëria apo mosmbrojtja e viktimës është një rrethanë tjetër e cila gjithmonë duhet të shqyrtohet nga gjykata dhe të merret parasysh gjatë caktimit të dënimit. Nocioni se ata të cilët janë në disavantazh për shkak të karakteristikave personale apo rrethanave të caktuara meritojnë mbrojtje më të madhe është një parim i përgjithshëm sikurse që është edhe koncepti se i pandehuri i cili shfrytëzon këtë situatë apo pozitë meriton dënim më të ashpër. Rëndësia që i jepet konceptit

<sup>53</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.6, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

të viktimës së ndjeshme/të pambrojtur në KPRK është argument shtesë për rëndësinë e kësaj rrethane gjatë caktimit të dënimit. Kjo rrethanë, jo vetëm që konsiderohet si rrethanë rënduese gjatë matjes së dënimit, por shërben edhe për të cilësuar kufijtë e dënimit për veprat e caktuara më shpesh se cilido faktor tjetër. Qëllimi i ligjvënësit, qartazi është që kjo rrethanë të jetë e mirënjohur. Kjo rrethanë, sikurse ajo paraprake është po ashtu e paraparë me Nenin 46 të Konventës së Stambollit ku përfshihet si rrethanë rënduese rasti kur “*vepra penale është kryer kundër një personi të pambrojtur për shkak të rrethanave të veçanta*”.<sup>54</sup>

Ndoshta konsiderata kryesore për gjykatën duhet të jetë niveli i mosmbrojtjes/ndjeshmërisë së viktimës dhe aftësia e të pandehurit për ta perceptuar këtë status të viktimës. Me fjalë tjera, a ndikon aftësia e të pandehurit për ta perceptuar këtë status të viktimës në zbatimin e kësaj rrethane dhe rëndësinë e saj? Në përgjithësi, viktima konsiderohet ashtu siç e gjen i pandehuri dhe aftësia e tyre për ta kuptuar këtë gjendje është e parëndësishme. Kjo mbështetet nga gjuha e përdorur në këtë rrethanë e cila thjeshtë kërkon vetëm që viktima të ketë qenë e pambrojtur apo e ndjeshme dhe nuk përmend fare nëse i pandehuri duhet të ketë njohuri për këtë gjendje apo jo. Pranimi i kësaj rrethane nuk duhet të varet nga aftësia e të pandehurit për ta perceptuar ndjeshmërinë. Por, gjykata pavarësisht kësaj duhet që ta shqyrtojë këtë gjatë vlerësimit të shkallës që do t’ia atribuojë kësaj rrethane rënduese. Nëse gjendja është e dukshme dhe lehtë për t’u perceptuar, gjykata mund ta rrisë dënimin në një shkallë më të madhe bazuar në faktin se i pandehuri qartazi dhe me dije e ka shpërfillur gjendjen e viktimës kur e ka kryer veprën. Kjo duhet të vlerësohet nga pikëpamja e personit të zakonshëm për të gjitha konsideratat sipas kësaj rrethane.

Përkufizimi i Viktimës së ndjeshme ka pësuar ndryshime rrënjësore me Kodin penal të vitit 2019. Sipas Nenit 113 paragrafi 39 Viktima e ndjeshme “*është viktima e veprës penale e cila është fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë, i/e moshuar ose person marrëdhënie apo varësia e të cilit ndaj të pandehurit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur*”.

Me një përkufizim të tillë është përfshirë në mënyrë shumë më shpjeguese çfarë nënkuptojmë me ndjeshmëri dhe konceptin e një personi të pambrojtur. Mund të thuhet lirisht se ekzistojnë dy përkufizime brenda një përkufizimi të vetëm duke synuar që të plotësojnë njëri-tjetrin. Kjo është arritur në atë formë që përkufizimi përfshin dy elemente:

Karakteristikat personale të një personi që përfshin moshën apo gjendjen fizike; ose

Ndjeshmërinë dhe varësinë e personit ndaj të pandehurit për shkak të arsyeve të ndryshme që mund të ekzistojnë në raste të caktuara.

Përkufizimi përfshin lidhësen “ose” që nënkupton se të dyja veç e plotësojnë njëra-tjetrën, por mund të ekzistojnë edhe si të ndara. Revidimi i këtij përkufizimi është mjaft domethënës ngase me përkufizimin e mëparshëm, përqendrimi ka qenë vetëm në pjesën e parë të përkufizimit. Dallimi i përkufizimit me KPRK aktual me përkufizimin e mëparshëm është se derisa me KPRK-në evjetër ka kualifikuar ndjeshmërinë kryesisht bazuar në raportin familjar të viktimës me të pandehurin dhe gjendjen fizike, ky i fundit ndryshon qasjen duke shtuar disa karakteristika (të cilat jo domosdoshmërisht vlejnë vetëm për viktima në marrëdhënie familjare), për shkak të të cilave viktima ka predispozita të jetë shumë më e ndjeshme apo më e cenueshme.

Vlen të theksohet se KPRK-ja ka përdorur shprehjen “veçanërisht” para shprehjes e ndjeshme, që nënkupton se gjetja e thjeshtë e të qenit i ndjeshëm nuk mjafton për ta konsideruar këtë si rrethanë rënduese. Ndonëse është e pamundur për ta kuantifikuar saktësisht se çka

---

<sup>54</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Neni 46, pika c., Stamboll, 11 maj 2011.

nënkuptohet me të, kjo duhet të shihet si diçka që tejkalon konceptin tradicional në kontekst të viktimës, siç është mungesa e armës apo mjeteve adekuate për ta mbrojtur veten nga sulmi. Kjo ka të bëjë me një nivel të mosmbrojtjes që është, pakëz përtej mesatares apo që del nga ndonjë ndjeshmëri tjetër e përkohshme apo e përhershme.

I vetmi vlerësim i cili mbetet për t'u bërë është niveli i rrethanës rënduese që ekziston në situatën e caktuar. Kjo mund të ndodhë për shkak të shkallës së lartë të mosmbrojtjes apo ndonjë aspekti tjetër të ndjeshmërisë. Sikurse i pandehuri në përgjithësi, ata të cilët kryejnë vepra në marrëdhënie familjare i bëjnë ato ndaj individëve të ndjeshëm dhe të pambrojtur. Për më tepër, i pandehuri e din se ata persona të cilët janë të pambrojtur kanë më pak gjasë të vetëmbrohen. Për shembull, *mosha* (shumë i vjetër, shumë i ri), *paafësia* (psikologjike, mendore, fizike), shtatzënia apo lehonja, *statusi i imigrimit apo vendbanimit* (i pa dokumentuar, pa letra), përkatësia *komuniteteve etnike pakicë* (Romë) *apo komuniteteve fetare apo orientimi seksual* (homoseksual) të gjithë këta janë faktorë që mund të rrisin rrezikun e varësisë së viktimës nga i pandehuri. Këta faktorë mund ta bëjnë të vështirë apo të pamundur që viktimat të kërkojnë ndihmë, ta raportojnë dhunën apo të largohen nga marrëdhënia abuzive.<sup>55</sup>

Në rastet kur i pandehuri e ka shfrytëzuar ndjeshmërinë e viktimës (për shembull, kur rrethanat janë shfrytëzuar nga i pandehuri për të penguar viktimën nga kërkimi dhe sigurimi i ndihmës), kjo rrethanë, zakonisht do ta ashpërsojë dënimin. Ngjashëm me këtë, marrëdhëniet familjare të cilat përfshijnë periudha të zgjatura të keqtrajtimit mendor dhe fizik rrisin pambrojtjen e viktimës e me të edhe gjasat për gjetjen e rrethanave rënduese.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Kjo rrethanë lehtë mund të përkojë me ndonjë tjetër dhe të llogaritet dy herë. Gjykata duhet të sigurohet që vetë vepra të mos jetë cilësuar duke u bazuar në ndjeshmërinë e viktimës. Këto janë veçanërisht të pranishme në veprat penale seksuale. Gjithashtu, ka mundësi të konsiderueshme për dyfishim pasi që shumë kategori mund të ndikojnë në nivelin e ndjeshmërisë dhe mosmbrojtjes. Për shembull, rrethana 2.7 mosha e viktimës, ka ndikim të drejtpërdrejtë në ndjeshmëri.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A e plotëson viktimja ndonjë nga kushtet e përfshira në përkufizimin e viktimës së ndjeshme sipas nenit 113 paragrafi 39?
- A ka ndonjë marrëdhënie në mes të viktimës dhe të pandehurit? Cila është natyra dhe struktura e marrëdhënies?
- A shfaq kjo marrëdhënie veti të varësisë dhe kontrollit?
- A janë kushtet e ndjeshmërisë të dukshme dhe lehtësisht të dallueshme?

#### *2.4.4. Mosha e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar<sup>56</sup>*

Ndonëse kjo rrethanë fillimisht mund të duket e lehtë për t'u zbatuar, nuk ka ndonjë përkufizim të qartë për t'i dhënë përgjigje pyetjes së natyrshme se kur përfundon mosha “e re” dhe kur fillon mosha “e vjetër”. Përderisa kjo i jep fleksibilitet maksimal gjykatave për të vlerësuar

<sup>55</sup> DCAF, Doracaku i Gjyqtarëve, Konsideratat për vlerësimin e dhunës në familje në Bosnjë dhe Hercegovinë, Sarajevë (2014), fq. 20.

<sup>56</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.7, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

rrethanat, ajo mund të ndikojë në shmangie nga praktikat e dënimit për shkak të interpretimeve të ndryshme. Ndonëse kjo nuk do të paraqesë ndonjë problem kur mosha qartazi bie në këtë kategori (për shembull, fëmija i moshës 5 vjeçare) ajo bëhet më e vështirë kur mosha botërisht nuk konsiderohet në këtë kategori. Fakti se “fëmija” është i definuar në kod në nenin 113 paragrafin 22 si person i cili nuk i ka mbushur 18 vjet mund të jetë deri diku definitiv në kualifikimin e viktimës si “i ri”, posaçërisht duke marrë parasysh faktin se “madhori” përkufizohet në paragrafin 24 si person i cili i ka mbushur 18 vjet. Megjithatë, kjo nuk duhet të konsiderohet autoritative. Siç diskutohet më vonë, në mënyrë të detajuar, në pjesën e rrethanave lehtësuese lidhur me moshën e të pandehurit, praktika ndërkombëtare për krime të luftës ndonjëherë ka konsideruar individin si “i ri” ndonëse kanë qenë të rritur sipas standardeve të pranuar. Në përgjithësi, gjykata duhet të konsiderojë viktimat nën moshën 18 si të rinj, ndërsa ata që janë mbi këtë moshë duhet t’i konsiderojë si të tillë me skepticizëm.

Fatkeqësisht, nuk ka situatë të ngjashme për vlerësimin e statusit “i moshuar”. Gjykatës i lihet tërësisht në diskrecion të saj për të përcaktuar zbatimin e kësaj rrethane. Si pikënisje mund të merret mosha e pensionimit të detyrueshëm për shërbyesit publik si dhe qasja e përgjithshme në përfitimet e pensionimit dhe pensionet. Vështirësia në rritje për të vlerësuar këtë rrethanë duhet të fillojë të ndikojë në nivelin e ashpërsimit, i cili zbatohet bazuar në këtë rrethanë dhe në një fazë të caktuar duhet të eliminohet plotësisht.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Veprat penale seksuale apo veprat penale kundër fëmijëve janë, kryesisht ato raste në të cilat vepra merr formën e cilësuar për shkak të moshës së viktimës. Si në të gjitha rastet, ashpërsimi sipas kësaj rrethane nuk duhet të bëhet nëse mosha tashmë është e përfshirë në elementet e veprës.

Siç u diskutua te rrethana 2.6, koncepti i moshës shpesh ndikon në nivelin e ndjeshmërisë së viktimës. Megjithatë, gjykata duhet ta ketë parasysh se kjo rrethanë mund të zbatohet si rrethanë rënduese vetëm bazuar në moshën e viktimës – pa pasur nevojë që të konstatohet se viktima ka qenë e ndjeshme. Vetë përfshirja në këtë kategori mjafton për të shqiptuar një nivel më të lartë të dënimit.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A është viktima nën moshën 18 vjeçe?
- A është viktima mbi moshën 65 vjeçe?
- A ka ndonjë konstatim se viktima ka qenë e ndjeshme? Nëse po, deri në ç’masë ka kontribuar mosha e viktimës në atë gjetje?
- A mundet mosha e viktimës të ndahet tërësisht nga gjetjet e rrethanave tjera që kanë të bëjnë me viktimën?

#### *2.4.5. Shkalla e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përherëshëm, transmetimin e sëmundjes të viktimës apo çfarëdo dëmi tjetër që i është shkaktuar viktimës ose familjes së tij<sup>57</sup>*

Ndonëse shkalla e dëmit të shkaktuar ndaj viktimës, pothuajse gjithnjë do të merret parasysh gjatë përcaktimit të nivelit të veprës, ka ende hapësirë të konsiderueshme për ta rritur dënimin në kuadër të kufijve të paraparë. Kjo rrethanë e bën të qartë se gjykata shqyrton në tërësi

<sup>57</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.8, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

të gjitha lëndimet, pavarësisht se a bien ato në sferën më tradicionale të lëndimeve fizike apo në sferat e zgjeruara që duhen konsideruar.

Ashpërsimi duhet të përfshijë dëmtimin e rëndë të menjëhershëm fizik dhe/apo psikologjik i cili paraqet rrezik serioz për jetën e viktimës. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë ashpërsimin për vuajtjet afatgjata të shkaktuara nga lëndimi i përhershëm apo pasojat e ngjitjes së sëmundjes si dhe ndikimin psikologjik afatgjatë siç është çrregullimi post-traumatik. Gjykata duhet të kuptojë nga viktima dhe/apo eksperti mjekësor ndikimin e veprës në jetën e viktimës në kuptimin afatshkurtër dhe afatgjatë.

Është shumë me rëndësi për të përmendur se zbërthimi dhe vlerësimi i rrethanës nga par. 2.8 duhet të shikohet edhe nga prizmi se për cilën kategori të veprave bëhet fjalë, kjo për faktin se kjo rrethanë nuk ka të bëjë vetëm me aspektin e lëndimit fizik apo shëndetësor të dëmit të shkaktuar viktimës, pasi pjesa e parë e fjalisë “Shkalla e dëmit të shkaktuar...” ngërthen në vete edhe elementin e dëmit material, emocional apo ndonjë ndikim tjetër të çfarëdo lloji. Kështu në Udhëzuesin e veçantë për veprat penale të korrupsionit<sup>58</sup> gjatë sqarimit të kësaj rrethane (e cila në atë Udhëzues është grupuar me rrethanat nga par. 2.3. dhe 2.5. për shkak të ngjashmërisë mes rrethanave) është marrë një qasje mjaft interesante duke bërë lidhshmërinë mes korrupsionit dhe shkallës së dëmit duke e lidhur dhe sqaruar këtë rrethanë në kontekst jo domosdoshmërisht monetar, por më tepër me ndikimin në mjedis, shëndetin publik, apo në kategoritë e ndjeshme të shoqërisë apo fondeve. Andaj, për vepra nga Kapitulli XXXIII por edhe të tjera të natyrës së ngjashme, rekomandohet referimi në atë Udhëzues pasi jep sqarime në mënyrë më specifike.

Shkalla e dëmit të shkaktuar si rrethanë nga par. 2.8, është ngushtësisht e lidhur me rrethanën e intensitetit të rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur sipas Nenit 69, par. 3.3. të KPRK-së, për faktin se e njëjta i referohet dëmit të shkaktuar apo të rrezikuar e që është njëjtë me atë që flet rrethana nga par. 2.8. e Nenit 70. Kështu në Udhëzuesin për korrupsion paraqiten një mori rrethanash të cilat janë të klasifikuara sipas kategorive duke përfshirë jo vetëm vlerën e dëmit monetar siç ndahet me paragrafët 31-34 të Nenit 113 të KPRK-së, por edhe dëmin tjetër siç është shpjeguar më lart.<sup>59</sup>

Një tjetër çështje me vlerë për tu trajtuar është edhe çështja e përcaktimit të lartësisë së dëmit financiar. Kjo zakonisht ka të bëjë sidomos me veprat nga sfera e ekonomisë, prokurimit e të ngjashme kur kërkohet të përcaktohet lartësia e dëmit apo përfitimit financiar. Në këto raste duhet siguruar llogaritjen e dëmit aktual e jo të vlerës totale të kontratës.

### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Ndoshta asnjë rrethanë tjetër rënduese nuk ka më shumë potencial për të përkuar me rrethana tjera dhe për t’u llogaritur dyfish për faktin se, jo rrallë herë, kjo rrethanë përbën edhe element të veprës penale. Si e tillë është e domosdoshme të shmanget dyfishimi duke iu referuar edhe si rrethanë rënduese. Megjithatë, vlerësimi nuk mbaron aty dhe praktikant ndërkombëtare vazhdimisht kanë tentuar që të zgjerojnë fushat të cilat merren parasysh për vlerësim. Njësoj është vepruar edhe me Udhëzuesin e veçantë për veprat penale të korrupsionit. Në shumë aspekte, kjo është një rrethanë që kërkon nga gjykata që të shikojë të gjitha aspektet e ndikimit në viktimën dhe t’i shqyrtojë ato para se të arrijë në dënimin përfundimtar – duke e përshtatur dënimin për të reflektuar në mënyrë të saktë të gjithë ndikimin në viktimën.

<sup>58</sup> Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Gjykata Supreme, fq.34-38, 10 qershor 2021, Prishtinë.

<sup>59</sup> Ibid.fq.47



*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- Cilat janë lëndimet e drejtpërdrejta fizike afatshkurtra? A ka kushte/paafhtësi/ndikime afatgjata që ndërliken me to?
- A është shkalla e lëndimit më e lartë se minimumi që kërkohet për të plotësuar elementet e veprës penale?
- A ka ngjitje të sëmundjes? A ka ndikime afatgjata nga sëmundja?
- A kanë qenë të pranishëm anëtarët e familjes gjatë kohës së veprës? A e kanë parë veprën? A ka lëndim psikologjik afatshkurtër dhe/apo afatgjatë?
- A ka pasur humbje të shërbimeve për anëtarët e familjes si rezultat i veprës? Sa kanë zgjatur?
- A ka vdekur viktimja si rezultat i veprës? Cila ka qenë afërsia? Cili ka qenë ndikimi në anëtarët e familjes në kuptim financiar dhe psikologjik?
- A ka ndonjë dëm tjetër përveç lëndimeve fizike apo psikologjike ndaj viktimës si rezultat i viktimit?
- A ka mjete tjera të mbështetjes financiare? A është i pandehuri në gjendje për ta bërë kompensimin? A i mënjanon kjo disa forma të lëndimit dhe nëse po deri në çfarë mase?
- Dëmi i shkaktuar a ka pasur ndikim në masë më të gjerë të njerëzve? Deri në çfarë mase është ky dëm?
- Konsiderata tjera siç janë sqaruar tek Udhëzuesi i veçantë për veprat penale të korrupsionit, ku është me rëndësi shkalla e dëmtimit të ambientit, shëndetit publik, fondet e ndjeshme etj.

2.5. *Çfarëdo keqpërdorimi i pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale; dhe dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar*<sup>60</sup>

Rrethanat 2.9 dhe 2.10, ndonëse trajtohen ndaras në kod, ato kanë disa elemente të rëndësishme të përbashkëta. E njëjta qasje e kombinimit të këtyre dy rrethanave është përdorur edhe në Udhëzuesin e veçantë për veprat penale të korrupsionit. Që të dyja këto rrethana, në thelb përfshijnë marrëdhënien ndërmjet viktimës dhe të pandehurit në të cilën i pandehuri e ka pushtetin mbi viktimën apo aftësinë për të ushtruar kontroll mbi viktimën apo pasurinë e saj. Ky pushtet mund t'i jetë deleguar nga viktimja apo mund të ekzistojë si rezultat i normave shoqërore, marrëdhënies apo ndonjë strukture më formale të pushtetit. Pavarësisht mënyrës se si është krijuar ky mosbalancim, vepra rezulton në tërësi apo pjesërisht nga ushtrimi i paligjshëm i këtij pushteti apo nga përfitimi prej kësaj pabarazie.

Koncepti i dytë i përbashkët është se marrëdhëniet e ndërthurura nga këto dyja janë të rëndësishme për funksionimin e shoqërisë. Kur ndodhin thyerje apo keqpërdorime, ato u shkaktojnë dëm më shumë se një viktime; ato dëmtojnë besimin kolektiv të shoqërisë për të hyrë apo për të besuar në këto marrëdhënie në të ardhmen. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur marrëdhëniet ka qenë baza kryesore për kryerjen e veprës. Për shembull, kur zbatuesit e ligjit përdorin pozitën e tyre për të kryer vepra penale, kjo ndikon si në viktimën ashtu edhe në tërë shoqërinë. Qytetarët të cilët dëgjojnë për vepra penale ka më pak gjasë që të bashkëpunojnë me hetimet e organeve të zbatimit të ligjit në të ardhmen apo t'u binden kërkesave legjitime ligjore.

<sup>60</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.9 dhe 2.10, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

Kjo degradon tërë stabilitetin e shoqërisë. Si e tillë, një lloj ashpërsimi i dënimit mbi këtë bazë bëhet për të promovuar dhe/ose rikthyer besimin në këto struktura dhe për të parandaluar keqpërdorimet në të ardhmen.

Gjykata duhet të ketë parasysh se nuk ka ndonjë nivel minimal në të cilin keqtrajtimi apo shkelja duhet të kontribuojë për kryerjen me sukses të veprës penale. Vetë fakti se marrëdhënia ka ekzistuar dhe është shkelur mjafton për të arritur deri te kjo gjetje. Niveli i kontributit është më i zbatueshëm për peshën që do ta ketë kjo rrethanë në ashpërsimin e dënimit, brenda kufijve të paraparë, sesa nëse kjo rrethanë ekziston apo jo.

### *2.5.1. Keqpërdorimi i pushtetit apo pozitës zyrtare*

Rrethana 2.9 specifikon keqpërdorimin e pushtetit apo pozitës zyrtare në kuadër të kufijve të paraparë për veprën bazë. Keqpërdorimi i pushtetit (apo autoritetit) tradicionalisht konsiderohet si ushtrim i funksioneve përkatëse shtetërore, politike apo administrative në kuadër të strukturës legjitime të formalizuar. Kjo mund të jetë ushtrim i papërshtatshëm i pushtetit shtetëror brenda kontekstit të pozitës së individit apo mund të nënkuptojë shfrytëzimin e pushtetit në mënyrë të tërthortë i cili mund të mos jetë i ndërlidhur me autoritetin e qenësishëm brenda pozitës, por bazuar në perceptimin e viktimës së pushtetit të dhënë të të pandehurit.

Është shumë me vlerë të potencohet edhe qasja e Udhëzuesit për veprat penale të korrupsionit mbi atë se si e zbërthen këtë rrethanë në kontekst të veprave penale kundër detyrës zyrtare dhe korrupsionit, duke qenë se vet cilësia si person zyrtar është element i shumicës së veprave nën këtë kategori. Udhëzuesi, e lidh jo vetëm faktin se një person është person zyrtar, por me atë se sa më e lartë të jetë pozita e një personi aq më e lartë duhet të jetë edhe përgjegjësia. Në bazë të këtij koncepti, Udhëzuesi për secilën veprë veç e veç ka paraparë edhe shkallën e përgjegjësisë.<sup>61</sup> Për përkufizimin se kush konsiderohet “Person Zyrtar” shih më shumë Udhëzuesin për veprat penale të korrupsionit.<sup>62</sup>

### *2.5.2. Keqpërdorimi i besimit*

Keqpërdorimi i besimit, sipas rrethanës 2.9, duhet të konsiderohet si një strukturë më pak e formalizuar e pushtetit. Këto bien në konceptet më tradicionale të keqpërdorimit të besimit në të cilat ka një marrëdhënie të mirëbesimit ndërmjet viktimës dhe të pandehurit. Kjo mund të jetë marrëdhënie në të cilën të pandehurit me vullnet i është dhënë diskrecioni nga viktimë. Edhe pse tradicionalisht keqpërdorimi i besimit mund të konsiderohet se qëndron vetëm në rastet e marrëdhënieve familjare, përkundrazi ky është një koncept shumë më i gjerë. Shembull konkret mund të jetë edhe marrëdhënia financiare dhe besueshmëria që mund të ekzistojë qoftë në mes të partnerëve afarist apo edhe keqpërdorimi i besimit ana e kontabilistit apo zyrtarit financiar të cilit i janë besuar financat e një biznesi. Në këto raste është me rëndësi të bëhet diferencimi në mes shkallës së keqpërdorimit të besimit, nga rasti në rast, pasi në këtë mënyrë më së miri mund të arrihet individualizimi i dënimit të të pandehurit.

### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Sikurse që është rasti edhe me rrethanat tjera, shqetësimi kryesor është që kjo rrethanë të mos llogaritet dyfish, pra të mos merret edhe si element i veprës penale edhe si rrethanë rënduese. Gjykata duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë formulimit në ligj lidhur me dallimin ndërmjet

<sup>61</sup> Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Gjykata Supreme, fq. 38, 46, 59-73; 10 qershor 2021, Prishtinë.

<sup>62</sup> Mu aty, faqe 3-9.

tyre, ndonëse, siç u tha më lartë, jo gjithmonë këto do të jenë formalisht të dallueshme. Sa i përket keqpërdorimit të detyrës zyrtare, konsiderojmë se Udhëzuesi i veçantë për veprat penale të korrupsionit, jep shembuj të mjaftueshëm lidhur me kujdesin për mos dyfishim. Ndërkaq, kur flitet në kontekstin e Nenit 330, keqpërdorimi i besimit paraqet vetëm një nga ata shembuj kur gjykata duhet të ketë kujdes që të mos bëjë dyfishim duke e përfshirë edhe si rrethanë rënduese. Ky nen i referohet dëmtimit të interesave pasurore dhe përveç tjerash përfshin edhe keqpërdorimin e besimit nga ana e kujdestarit, avokatit apo ndonjë personi tjetër që ka detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë.

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka ndonjë marrëdhënie apo pabarazi në pushtet ndërmjet të pandehurit dhe viktimës?
- A ka ndonjë marrëdhënie formale të mirëbesimit apo kuazi-mirëbesimit ndërmjet të pandehurit dhe viktimës?
- A ka viktima i pandehuri ndonjë detyrim financiar apo personal ndaj viktimës?
- A është viktima e varur nga i pandehuri për kujdes apo mbështetje financiare?
- A ka ndonjë shkallë të lartë të varësisë emocionale nga viktima?
- A është varur vepra nga ekzistimi i marrëdhënies apo keqtrajtimit? Nëse jo, a ka qenë faktor në suksesin e përgjithshëm të veprës?
- A ka qenë marrëdhënia apo besimi i arsyeshëm duke marrë parasysh situatën?
- A ka ndikuar dhuna në shkallën e dëmit të shkaktuar ndaj viktimës?

## 2.6. Nëse v.p. është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal<sup>63</sup>

Rrethana rënduese 2.11 konsideron funksionimin e grupit të organizuar kriminal si rrethanë rënduese në përcaktimin e dënimit përfundimtar. Kur aktiviteti kriminal bëhet më i strukturuar dhe më i shtjelluar, ai paraqet rrezik më të madh për funksionimin efektiv të shoqërisë. Ai e zbeh besimin shoqëror në sundimin e ligjit, pengon zhvillimin ekonomik dhe kontribuon në shkallën e përgjithshme të krimit pasi që strukturat e organizuara janë më të afta për arritje të konsiderueshme. Për shkak të rrezikut, gjetja e kësaj rrethane nga gjykata duhet të ketë ndikim të rëndësishëm në dënimin përfundimtar. Në situatat kur më shumë se një person ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale kundër një viktime të vetme, është domethënës fakti se viktima me gjasë do të jetë në gjendje të frikësimit më të madh dhe do të ketë një ndjenjë të mosmbrojtjes.

Për përcaktimin e kësaj rrethane është thelbësore ekzistimi i “grupit të organizuar kriminal” i cili përkufizohet në mënyrë specifike në nenin 113 paragrafin 13 të Kodit Penal si “*bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore*”. Kjo shtjellohet edhe më tej në përkufizimin e “bashkimit të strukturuar” në paragrafin 14, i cili përkufizohet si “*bashkim i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij bashkimi të kenë role formalisht të përcaktuara, vazhdimësi të anëtarësisë së tyre apo strukturë të ndërtuar*”. Përkufizimi nuk kërkon që çështja për të cilën janë bashkuar të jetë edhe çështja për të cilën

<sup>63</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.11, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

grykohen para gjykatës. Të pandehurit munden, për shembull, ta kenë formuar grupin më parë me qëllim të kryerjes së veprës së rëndë penale, por në fakt janë shpallur fajtor vetëm për veprën për të cilën gjykojnë. Dhe kërkesa e fundit është që grupi të ketë ekzistuar për një kohë të caktuar. Aspektet shtesë të cilat duhet nënvizuar janë kërkesa që grupi të përbëhet nga tre apo më shumë persona, që të ketë si qëllim kryerjen e një apo më shumë veprave të rënda penale dhe që të ekzistojë për një kohë të caktuar. Kërkesa numerike është e thjeshtë.

Kodi penal përmban një mori referencash dhe përkufizimesh kur është fjala për grupe të organizuara apo të strukturuar, andaj, shpesh mund të ketë edhe konfuzion se cila nga to është e aplikueshme nëse nuk jepet referenca e saktë. Derisa par. 14 i nenit 113 definon “bashkimin e strukturuar”, par. 5 i nenit 128 përkufizon “grupin e strukturuar” e që në thelb të dyja janë pothuajse plotësisht të njëjta në brendësi. Përpos përkufizimeve të sipërpërmendura, Neni 277 sanksionon pjesëmarrjen ose organizimin e grupit kriminal të organizuar si nen të veçantë për veprat penale të dënueshme me së paku 4 vjet, ndërkaq nenet 127 dhe 136 sanksionojnë organizime në grup kriminal për kryerjen e veprave të veçanta, në rastin e parë bashkimin për veprimtari kundër kushtetuese, ndërkaq në të dytin organizimin dhe pjesëmarrjen në grup terrorist.

Ka disa elemente të kësaj rrethane rënduese të cilat duhet të shqyrtohen me kujdes nga gjykata. E para është se duhet të ketë bashkim të strukturuar i cili “nuk është formuar rastësisht” por pa pasur nevojë për vazhdueshmërinë e bashkimit apo të ndonjë strukture më të formalizuar hierarkike. Një shembull i mirë i formimit të rastësishëm për kryerjen e menjëhershme të veprës penale do të ishte kur kalimtarët e rastit, të cilët shohin një rrahje dhe vendosin të marrin pjesë në të. Në këtë situatë, ndonëse ata janë të organizuar deri në atë masë sa të gjithë personat marrin pjesë në vepër (dhe mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat e përkufizimit), ata janë organizuar për qëllim të kryerjes së veprës, mirëpo të pandehurit janë formuar rastësisht për ta kryer veprën andaj edhe në këtë rast kemi të bëjmë me ndonjë nga format tjera të bashkëpunimit të paraparë me kod por jo grup të organizuar. Ata, rrjedhimisht nuk përbëjnë bashkim të strukturuar.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Edhe pse pjesëmarrja në grup të organizuar kriminal është një rrethanë me peshë mjaft të madhe në matje të dënimit, megjithatë gjykata duhet gjithnjë të ketë kujdes për atë se kur e njëjta mund të përfshihet si rrethanë rënduese. Kjo për faktin se siç u potencua edhe më lart, bashkimi në një grup kriminal parashihet ose me nene të veçanta, ose si vepër e cilësuar, andaj duhet shmangur dyfishimi me rrethanë rënduese. Më konkretisht, duhet shmangur përdorimi në raport me nenin 34, 127, 136 dhe 277, por edhe të gjitha veprat tjera ku pjesëmarrja e tillë përbën vepër të cilësuar, e raste të tilla ka shumë në nenet e KPRK-së.

Përndryshe, mungesa e akuzës për krim të organizuar apo lirimi nga akuza për këtë vepër nuk e përjashton automatikisht aplikimin e saj si rrethanë rënduese. Konsiderata parësore do të jetë nëse dashja dhe qëllimi i pjesëmarrjes në vepër ka qenë thjeshtë kryerja e veprës penale apo mundësimi i mëtejshëm i ekzistimit dhe prosperitetit të grupit të organizuar kriminal.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka ekzistuar grupi në ndonjë shkallë para kryerjes së veprës?
- A kanë kontribuar veprimet e secilit anëtar të grupit në kryerjen e veprës?
- A ka qenë qëllimi i grupit për të kryer vepër me qëllim të përfitimit të dobisë financiare apo pasurore (drejtpërdrejt apo tërthorazi)?
- A është hedhur poshtë akuza për krim të organizuar? Nëse po, cila ka qenë baza për këtë?

- A ka kontribuar vet ekzistimi i grupit në shkallën e dëmit apo a ka luajtur ndonjë rol në përfundimin e suksesshëm të veprës penale?
- A ka pasur ndonjë hierarki të strukturuar apo të gjysmë-strukturuar?

## 2.7. Nëse vepra penale është akt i urrejtjes...<sup>64</sup>

Me ndryshimet e KPRK-së kjo rrethanë është zgjeruar për të përfshirë edhe disa kategori të tjera. Gjykata duhet ta bëjë dallimin në mes të motivit dhe *mens rea* (dashjes). E para ka të bëjë me arsyet që e shtyjnë personin të veprojë, ndërsa e dyta ka të bëjë me elementin mendor apo dashjen kriminale që kërkohet për veprën e caktuar. Në këtë situatë, gjykata në mënyrë specifike do të gjejë se motivi që e ka shtyrë të pandehurin të kryejë veprën është fakti se viktimia bën pjesë në grupin e caktuar të mbrojtur. Vlen të theksohet se nuk ka ndonjë kërkesë të theksuar qartë që gjykata të përcaktojë se personi apo grupi i personave, në fakt janë anëtar të grupit të mbrojtur. Kjo nuk duhet të jetë objekt shqyrtimi nga gjykata. Mjafton fakti që i pandehuri ka pasur bindje të arsyeshme se viktimia i përket ndonjërisë prej kategorive të mbrojtura.

Kjo rrethanë gjithashtu përfshin motivet për afinitetin e individit me grupin e mbrojtur. Edhe në këtë rast, nuk ka ndonjë kërkesë specifike që personi në fakt të ketë afinitet me grupin, mjafton që i pandehuri të ketë besuar se ekziston afiniteti i tillë dhe kjo të ketë ndikuar në motivin për kryerjen e veprës. Afiniteti është një kategori e gjerë e cila shkon përtej marrëdhënieve më formale siç janë martesë apo lidhjet familjare. Kjo mund të përfshijë miqësitë, njohjet, apo vullnetin e mirë në përgjithësi.

Përcaktimi i motivit të të pandehurit është çështje e shqyrtimit të gjitha rrethanave. Ndonëse shprehja e motivit nga i pandehuri gjatë kryerjes së veprës apo gjatë intervistimeve të mëvonshme mjafton për ta vërtetuar këtë rrethanë, kjo nuk është e nevojshme. Gjykata mund të përdorë çfarëdo veprimi, sjellje dhe/apo qëndrimi të kaluar në raport me grupin për të vërtetuar ekzistimin e kësaj rrethane.

### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Shqetësimi kryesor lidhur me këtë rrethanë ka të bëjë mundësinë e dyfishimit të vepra të veçanta apo edhe rasteve kur paraqitet si formë e cilësuar e veprës penale. Shembull: te vepra penale Vrasje e rëndë nga Neni 173 par. 1.10. Kryesisht, kjo ndodh edhe te krimet kundër njerëzimit, më saktësisht shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës nga Neni 190 apo nxitja e përçarjes dhe mosdurimit nga Neni 141. Ndonëse këto vepra kryesisht përqendrohen në grupe racore, fetare dhe etnike, vendi i tyre si vepra penale specifike në kod nuk e zbeh rëndësinë e grupeve tjera të mbrojtura. Andaj, ashpërsimi i dënimit për një vepër të motivuar nga orientimi seksual i viktimës meriton të njëjtën shkallë të ashpërsimit sikurse veprat e motivuara nga përkatësia etnike e viktimës. Gjithashtu, nuk ka ndonjë dallim ndërmjet viktimizimit të bazuar në faktin që viktimia bën pjesë në grupin e caktuar dhe afinitetit për grupin e caktuar – niveli i ashpërsimit është i njëjtë.

Mund të ketë dyfishim në vlerësimin e shkallës së seriozitetit, si dhe në numrin e viktimave. Posaçërisht, në situata kur vepra shihet si shumë e gjerë dhe motivi është i lidhur më qartë me veprën. Vepra e cila kryhet në vend të hapur publik dhe është qëllimisht dhe haptas e ndërlydhur

<sup>64</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.12, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

me kategorinë mund të përfshijë më shumë viktime dhe/ose mund të shkaktojë nivel më të lartë të dëmit.

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka prova se vepra është motivuar nga anëtarësia apo afiniteti për anëtarët e njëres nga kategoritë e mbrojtura?
- A ka bërë i pandehuri ndonjë deklaratë para, gjatë apo pas kryerjes së veprës në të cilën e tregon motivin?
- A janë të përfshira disa kategori të mbrojtura?
- A ka sjellje apo deklaratë të mëparshme të të pandehurit të cilat tregojnë shënjestrimin e kategorisë së mbrojtur?
- A ka qenë vepra qëllimisht e paraparë që të prek një numër të madh personash përveç viktimës së caktuar?
- A ka i pandehuri ndonjë të kaluar apo predispozita të ndërveprimit negativ me kategorinë?

#### 2.8. Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar<sup>65</sup>

Kjo rrethanë njihet bindjen e përgjithshme se individët të cilët kanë kryer vepra penale në të kaluarën duhet të dënohen më ashpër sesa ata që nuk kanë kryer. Ajo gjithashtu pranon se dënimet e mëparshme kanë dështuar në rehabilitimin apo reformimin e të pandehurit. Në esencë, qëllimi i dënimit fillon të shmangët nga perspektiva e rehabilitimit në drejtim të konceptit të parandalimit të veprave të të pandehurit në të ardhmen.

Në këto raste gjykata duhet të shqyrtojë sjelljen e mëparshme dhe të merr parasysh një mori të faktorëve, përfshirë:

- numrin e dënimeve të mëparshme;
- peshën e veprave të mëparshme;
- natyrën e veprave dhe ngjashmërinë e tyre me veprën e tanishme (veprat e ngjashme për nga natyra janë tregues i sjelljes së vazhdueshme si dhe i dështimit të dënimit të mëparshëm për të parandaluar të pandehurin nga kryerja e veprave;
- kohën që ka kaluar ndërmjet dënimeve (një kohë më e gjatë ndërmjet dënimit të mëparshëm dhe dënimit aktual është më pak relevante sesa dënimi i mëparshëm); dhe
- dënimet e shqiptuara për veprat e mëparshme (veprat të cilat kanë rezultuar në dënim minimal me burgim apo dënime alternative janë më pak relevante sesa ato që kanë rezultuar me kohëzgjatje të konsiderueshme në burg).

Është me rëndësi të theksohet se kjo është një konsideratë e ndarë nga ashpërsimi i dënimit për recidivizëm të shumëfishtë nga neni 75. Për dallim nga neni 75, i cili parasheh kualifikime shumë të qarta lidhur me konsiderimin e dënimeve të mëparshme, kjo rrethanë rënduese nuk parasheh dispozita të tilla.

Kjo rrethanë rënduese duhet të merret parasysh kur i pandehuri është dënuar më parë për vepra penale, veçanërisht për vepra të natyrës së ngjashme. Për shkak të natyrës së dhunës në familje, e cila përsëritet, kjo rrethanë është posaçërisht e rëndësishme në vlerësimin e natyrës së përgjithshme të marrëdhënies dhe të nevojës për dënim më të lartë. Në mënyrë që të parandalohet

---

<sup>65</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.13, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

vazhdimi i ciklit të dhunës, prania e dënimeve të mëparshme që kanë lidhje të arsyeshme me mbajtjen apo ushtrimin e kontrollit mbi viktimën duhet të rezultojnë në dënime dukshëm më të ashpra.

Në raste të recidivizmit (përsëritjes së veprës), është e qartë se viktima e dhunës në familje, si rregull, ka ndërmarrë veprime konkrete për të kërkuar ndihmë nga sistemi i drejtësisë penale dhe nga institucionet përkatëse. Andaj, recidivizmi është tregues i dështimeve të vazhdueshme të institucioneve të cilat ligjërisht janë të detyruara që të ofrojnë mbrojtje (dhe drejtësi) për viktimën. Në raste të recidivizmit, parandalimi si një nga qëllimet e synuara të sanksionit qartazi nuk është arritur. Për më tepër, recidivizmi mund të tregojë një sjellje të vazhdueshme të dhunës në familje apo të rrahjes, posaçërisht në kombinim me format tjera të sjelljes së dhunshme (dominimi ekstrem, xhelozia obsesive, etj).<sup>66</sup> Në përgjithësi, gjetja e kësaj rrethane rënduese duhet të rezultojë me një dënim më të ashpër për të pandehurin.

Neni 69 paragrafi 4 i Kodit Penal parasheh që kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata merr parasysh nëse i pandehuri më parë ka kryer veprë penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dyja veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur apo i falur. Kjo pjesë e Kodit i lejon gjykatës që ta përshtatë dënimin maksimal të paraparë me ligj duke shtuar jo më shumë se gjysmën e maksimumit të dënimit. Ndonëse çdo veprë penale e mëparshme mund të merret parasysh në matjen e dënimit, nëse gjykata has në vepra që zakonisht ndërlidhen me situatat e dhunës në familje, rekomandohet fuqishëm që të zbatohet kjo dispozitë në mënyrë që të ashpërsohet niveli i përgjithshëm i veprës.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Shqetësimi kryesor me këtë rrethanë është potenciali për konflikt ndërmjet saj dhe nenit 69 lidhur me recidivizmin. Megjithatë, është e mundur që i pandehuri të jetë subjekt edhe i ashpërsimit të dënimit për shkak të recidivizmit si dhe i ashpërsimit në kuadër të kufijve të veprës së cilësuar. Rasti i tillë duhet të plotësojë në mënyrë të pavarur kushtet e parapara për të dyja këto situata pa aplikuar ndonjërin nga veprat ndaj të dy kritereve.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A i plotëson dënimi i mëparshëm kushtet nga neni 69 për aplikimin e ashpërsimit për recidivizëm?
- A janë dënimet e mëparshme të natyrës së ngjashme edhe nëse nuk janë ndaj të njëjtës viktimë?
- A tregon dënimi i mëparshëm sjellje të vazhdueshme kriminale?
- A ka pasur dënime të mëparshme të natyrës dhe kohëzgjatjes së ngjashme me dënimin e propozuar?
- Sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm dhe vepra e tanishme? Çfarë ka qenë sjellja e të pandehurit gjatë kësaj kohe?
- A është dënimi i mëparshëm relevant për përcaktimin se a duhet bërë ashpërsimi i dënimit?

---

<sup>66</sup> Rasti nr.IT-95-9/1-S, Aktgjykimi për Caktimin e Dënimit, Prokurori kundër Stevan Todorovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (31 korrik 2011), Par. 61, gjithashtu citohet Aktgjykimi i Apelit në rastin Aleksovski, par. 183; Aktgjykimi i Apelit në rastin Celebici, par.745.

## 2.9. Nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjare<sup>67</sup>

Marrëdhënia familjare paraqet rrethanën më të re të shtuar në KPRK-në e 2019-ës. Neni 113 paragrafi 25 i KPRK-së detajon se cilat raporte bien në kuadër të marrëdhënies familjare.

Përfshirja e kësaj rrethane vë në pah edhe më shumë mbrojtjen shtesë që ligjvënësi mundohet ti jep ruajtjes së familjes si celula kryesore e shoqërisë. Përfshirja e kësaj rrethane ka për qëllim që po ashtu të përcjellë mesazhin tek ata që ende vazhdojnë të operojnë me botëkuptimet e vjetra se familja duhet të ruhet me çdo kusht pa marrë parasysh se sa të dëmtuara janë raportet brenda asaj familjeje. Kjo rrethanë po ashtu përcjell mesazhin i cili bazohet në shumë hulumtime bashkëkohore se një marrëdhënie familjare jo e shëndoshë ndikon në masë të madhe në zhvillimin dhe psikologjinë e fëmijëve të rritur në atë rreth, andaj ata që prishin këtë balancë meritojnë dënim më të ashpër. Andaj, gjykatat në të gjitha rastet kur cilado vepër e paraparë sipas KPRK-së, kryhet brenda marrëdhënies familjare duhet ta marrin parasysh këtë rrethanë, gjithnjë përderisa e njëjta nuk paraqet edhe element të veprës penale. Sa i përket peshës që kjo rrethanë duhet të ketë në raport me rrethanat tjera rënduese një gjë e tillë nuk është se mund të përcaktohet në mënyrë precize. Kjo për faktin se gjithnjë varet edhe për cilën vepër bëhet fjalë, peshën dhe rrezikshmërinë e veprimeve të të pandehurit, por edhe se më saktësisht për cilin raport familjar bëhet fjalë. Kështu p.sh. nëse i kthehemi prapë përkufizimit të marrëdhënies familjare sipas Nenit 113 par. 25, shohim se në fakt janë dy kategori kryesore të marrëdhënieve:

- ato marrëdhënie që dalin nga raportet e ngushta të qiftit: bashkëshortët/ish-bashkëshortët, personat në bashkëjetesë apo që kanë bashkëjetuar më parë dhe fëmijët nga këto raporte; dhe
- ato marrëdhënie që kanë të bëjnë kryesisht me lidhje gjaku apo krushqie: prindërit, gjyshërit, nipat, mbesat, hallat, tetet, dajallarët, axhallarët dhe kushërinjtë.

Derisa KPRK-ja sanksionon dhe dënon të gjitha marrëdhëniet e sipërpërmendura, kur flitet për peshën që kanë rrethana e marrëdhënies familjare, gjykata me rastin e peshimit të tyre duhet pothuajse gjithnjë të peshojë shumë më tepër kur vepra kryhet në kuadër të kategorisë së parë të marrëdhënieve. Megjithatë edhe kjo nuk është gjithnjë shumë precize, kjo pasi gjithmonë raportet e sipërpërmendura duhen analizuar edhe në raport me lidhjen dhe varësinë që mund të ketë i pandehuri me viktimën. Kështu p.sh. gjersa kryesi mund të jetë gjyshi apo gjyshja dhe viktima të jetë nip apo mbesë, nëse viktima p.sh. ka qenë i/e mitur, person me aftësi të kufizuar, person i cili i është besuar në përkujdesje, atëherë rrethana ka peshë shumë më të madhe pasi p.sh. në shembullin e dhënë viktima hyn edhe në kuadër të përkufizimit të “viktimitës së ndjeshme” sanksionuar me Nenin 113 paragrafi 39 i KPRK-së. E njëjta vlen edhe për raportin e kundërt kur i pandehuri është nip apo mbesë dhe viktima është person i moshuar (gjysh, gjyshe, hallë, teze apo axhë etj.) i cili është i varur nga kujdesi i të pandehurit. Edhe në këtë rast viktima e moshuar mund të hyjë në kuadër të përkufizimit të viktimitës së ndjeshme pasi “... *varësia ndaj kryesit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur.*”<sup>68</sup> Andaj edhe rrethana e marrëdhënies familjare e kombinuar me cilësimin si viktimitë e ndjeshme e dyfishon peshën e kësaj rrethane.

<sup>67</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 2.14, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>68</sup> Përkufizimi i Viktimës së ndjeshme sipas Nenit 113 paragrafi 39, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.



### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Padyshim se rrethana e marrëdhënies familjare është një nga rrethanat më domethënëse që lidhen me viktimat dhe viktimizimin. Njëkohësisht, kjo rrethanë ka edhe potencialin më të madh për dyfishim në veprat e KPRK-së ku paraqitet si element i veprës penale.<sup>69</sup> Fatkeqësisht në praktikën tonë gjyqësore, raste të tilla të dyfishimit të kësaj rrethane, janë mjaft të shpeshta. Gjykatat duhen bërë përpjekje që të eliminohen këto dyfishime pasi paraqet shkelje procedurale.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A është marrëdhënia familjare element i veprës penale qoftë në veprën bazë apo si vepër e cilësuar?
- A ka rrethana tjera rënduese që lidhen me viktimat dhe në çfarë mase shprehen ato?
- Sa është i madh rreziku i përsëritjes së veprës qoftë për shkak të precedentëve të mëparshëm të të pandehurit qoftë për shkak të qasjes së lehtë që i pandehuri mund të ketë te viktimat?

### **3. Rrethanat lehtësuese nga Neni 70 i KPRK-së**

#### Çështje të përgjithshme

Për dallim nga rrethanat rënduese, të cilat përqendrohen në viktimën dhe peshën e veprës penale, rrethanat lehtësuese priren për të zbutur dënimin bazuar në vetitë pozitive të të pandehurit siç është pranimi i përgjegjësisë apo bashkëpunimi, rrethanat përtej kontrollit të të pandehurit, dhe faktet të cila e zvogëlojnë fajësinë. Ato i përshtaten konceptit të përpjestueshmërisë, si dhe qëllimeve të rehabilitimit. Sikurse me rrethanat rënduese, gjykata duhet të kërkojë mbështetje faktike para se të përfundojë se ekziston një rrethanë e caktuar, veçanërisht kur kërkohet mendimi i ekspertit, për të shmangur shqyrtimin dhe aplikimin e dyfishtë.

Për dallim nga rrethanat rënduese, në të cilat disa rrethana mund të përbëjnë element të veprës penale, ka shumë më pak raste kur rrethanat lehtësuese janë të përfshira si vepër e veçantë apo e cilësuar. Pasi që shumica e rrethanave lehtësuese kanë të bëjnë me personin apo ndërveprimin e tyre me organet e zbatimit të ligjit, ato interpretohen gjerësisht për t'u zbatuar në çfarëdo situatë. Ka pak shqetësime lidhur me llogaritjen e dyfishtë të tyre dhe gjykata mund të përqendrohet kryesisht që të mos ketë përputhje ndërmjet rrethanave të caktuara.

Çështja kryesore për gjykatën do të jetë kur hyn në fusha apo rrethana të zbutjes të cilat janë të diskutueshme. Kjo mund të ndodh brenda ndonjë rrethane të caktuar që parashihet në kod apo në kuadër të ndonjë rrethane që nuk është e përcaktuar në mënyrë specifike në kod. Pavarësisht, për dallim prej rrethanave rënduese, të cilat janë të përkufizuara në mënyrë relativisht të ngushtë dhe gjerësisht të pranuar nga komuniteti ndërkombëtar, rrethanat lehtësuese janë koncept më fluid i cili vazhdimisht evoluon. Kategoritë e gjera e bëjnë vlerësimin edhe më të vështirë. Për shembull, rrethanat personale mund të përfshijnë pothuajse çdo gjë që ndërlidhet me jetën e të pandehurit. Ndonëse kjo është e rëndësishme për t'u siguruar që gjykata të mos caktojë

---

<sup>69</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Nenet 163(par.3), 173(par.1.3), 182(par.2), 227(par.4.9), 229(par.3.9) dhe 230(par.3.9), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

ndonjë dënim që është më i rëndë se që është e nevojshme, kjo e rrit në mënyrë të konsiderueshme potencialin që preferencat apo bindjet personale të gjykatës të ndikojnë në dënim. Rrjedhimisht, kjo rrit mundësinë e shqiptimit të dënimeve të pa harmonizuara për vepra të ngjashme pasi që dy gjykata mund të mos pajtohen nëse një situatë e caktuar është lehtësuese apo jo. Përfundimisht, gjykata duhet të vlerësojë me kujdes nëse rrethana është vërtetë lehtësuese dhe në pajtim me standardet përkatëse, apo nëse është bindje personale e gjykatës që ka ndikime më të mëdha në praktikata e përgjithshme të dënimit. Në vlerësimin e fakteve dhe vendimeve gjyqtari gjen një mes ndërmjet ndjeshmërisë, dhembshurisë, mirësisë, disiplinës dhe ashpërsisë në mënyrë që zbatimi i ligjit nga ai të perceptohet si i ligjshëm dhe i drejtë.<sup>70</sup>

#### 3.4. Rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësive penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore<sup>71</sup>

Kjo rrethanë lehtësuese varet nga rrethanat që zvogëlojnë përgjegjësinë penale, siç janë disa gjendje mendore të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësive penale. Ndonëse kjo kategori nuk është e kufizuar dhe rrethanat tjera diskutohen shkurtimisht në vijim, referimi specifik në aftësinë e zvogëluar mendore reflekton qëllimin për t'u përqendruar në shëndetin mendor si mjet primar në bazë të të cilit ekziston kjo rrethanë. Të pandehurit pretendojnë se ndonëse e kanë shkelur ligjin, ata nuk duhet të mbahen plotësisht të përgjegjshëm penalisht për atë veprim pasi që aftësia e tyre mendore ka qenë e zvogëluar apo e kufizuar. Megjithatë, në praktikë hasim edhe raste të tilla kur kjo rrethanë keqinterpretohet në atë masë sa të shpie në lirimin e të pandehurit nga përgjegjësia që në fakt ky nuk është qëllimi i ligjvënësit, por qëllimi është që pikërisht për shkak të gjendjes mendore, i pandehuri të dënohet më butë pasi i njëjti e ka shumë më vështirë t'i konceptojë veprimet e tij/saj.

Kjo përkufizohet më gjerësisht në nenin 18 paragrafin 2 të KPRK-së:

Personi i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni. **Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.**<sup>72</sup>

Referenca në paragrafin 1 kërkon që aftësia e zvogëluar mendore të burojë nga ndonjë “sëmundje mendore e përkohshme apo e përhershme, çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij mendor”.<sup>72</sup>

Lexuar së bashku, gjykata duhet të vlerësojë dy fakte para se të vendosë për zbutje. Së pari, që aftësia e të pandehurit për të kuptuar natyrën e veprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar. Dhe së dyti, që aftësia e zvogëluar është drejtpërdrejt e lidhur me gjendjen mendore në ndonjë formë.

Përfundimisht, konsiderata e kërkuar nga gjykata sipas nenit 18 plotësohet nga kjo rrethanë lehtësuese dhe nuk duhet të ketë zbutje të mëtutjeshme të dënimit për shkak të gjendjes mendore sipas ndonjë rrethane apo teorie tjetër të përgjegjësive së zvogëluar. Si e tillë, gjetja e kësaj rrethane

<sup>70</sup> Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësor (RREKJ), Raporti i etikës gjyqësore 2009-2010, fq. 12.

<sup>71</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.1, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>72</sup> Ibid. par. 2.

mund të rezultojë në zbutje të konsiderueshme të dënimit. Megjithatë, për shkak të natyrës teknike të gjetjes së tillë, gjykata duhet të mbështetet në dëshminë mjekësore apo mendimin e ekspertit në konkludimin se gjendja e tillë ekziston dhe është thelbësore.

Teoritë tjera lidhur me këtë rrethanë lehtësuese përfshijnë mundësinë e zbutjes së dënimit bazuar në përgjegjësinë e zvogëluar sipas Kapitullit II varësisht nga rrethanat.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Ka pak gjasa të dyfishimit të kësaj kategorie dhe rrethanave tjera lehtësuese, ndonëse, nëse shëndeti mendor bëhet çështje thelbësore për rastin, atëherë mund të dyfishohet me rrethanat personale të të pandehurit. Ndonëse shëndeti mendor do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në masat e trajtimit të detyrueshëm apo urdhrat tjerë të përfshirë në dënimin përfundimtar, nuk ka ndonjë veprë për të cilën ulet kategoria apo niveli i veprës për shkak të aftësisë mendore si element.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka pasur ndonjë kontroll mjekësor për ta bërë këtë konstatim?
- Cili është serioziteti i gjendjes mjekësore?
- A ka ndonjë histori të diagnostikimit të gjendjes apo diagnoza ka ardhur vetëm pas kryerjes së veprës?
- A është aftësia e të pandehurit për të kuptuar pasojat apo natyrën e veprimeve të tij esencialisht e zvogëluar apo vetëm pjesërisht? A është e mundur të bëhet një konstatim i tillë?
- A është i pandehuri plotësisht i paafte për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij?
- A është konkluzioni në harmoni me standardet e pranuar përgjithësisht nga komuniteti mjekësor?
- A do të përmirësohet gjendja mendore e të pandehurit apo është e natyrës permanente?
- A është gjendja e përkohshme e krijuar nga i pandehuri?
- A e ka kryer veprën për shkak të tejkalimit të nevojës ekstreme por dëmi i shkaktuar ka tejkaluar të keqen e kanosur?
- A është krijuar tejkalimi nga pakujdesia e të pandehurit?
- A është kryer vepra nën ndikimin e kanosjes së përbalueshme e cila menjëherë është lajmëruar te organet kompetente? Cili ka qenë niveli i kanosjes me dhunë?
- A është kryer vepra në përpjesëtim me kanosjen?
- A ka qenë perceptimi/realiteti i kanosjes i arsyeshëm duke marrë parasysh rrethanat e pranishme?
- A është kryer vepra nën shtrëngim, por nga i pandehuri mund të pritët që ta pranojë rrezikun?
- A është kryer vepra nën shtrëngim, por i pandehuri e ka krijuar apo shkaktuar rrezikun dhe ka qenë i detyruar ligjërisht që të ballafaqohet me rrezikun?

### *3.5. Dëshmia për provokim nga ana e viktimës<sup>73</sup>*

Çështja e provokimit është ndoshta çështja që ngjall më së shumti diskutime nga të gjitha rrethanat lehtësuese të pranishme në ligj. Është rrethanë e cila në disa nga nenet paraqitet si element

---

<sup>73</sup> Ibid., par.3.2

i veprës penale kurse në rastet tjera mund të përdoret si rrethanë lehtësuese, por vetëm në parakushtet e caktuara. Provokimi është çështje thellësisht emocionale që shpeshherë përfshin marrëdhëniet njerëzore dhe ndikimin e xhelozisë, hidhërimit dhe frikës. Pasi që shumica e rasteve, në të cilat pretendohet si rrethanë lehtësuese, përfshijnë dinamika të marrëdhënieve gjinore dhe seksuale, ajo pashmangshëm do të përfshijë vlera shoqërore, kulturore dhe morale. Mund të jetë që qasja e gjyqtarit të caktuar ndaj vlerave sociale dhe morale të ndikojë fuqishëm në vendimin nëse gjykata do t'i konsiderojë veprimet e caktuara të viktimës si “provokim” dhe deri në një masë të caktuar, të arsyetojë veprimet e të pandehurit. Si e tillë, gjykata duhet të bëjë kujdes në këtë drejtim në mënyrë që të sigurohet që bindjet personale të saj të mos mjegullojnë përdorimin e duhur të kësaj rrethane.

Provokimi nga viktimia tradicionalisht përshkruhet si humbje e vetëkontrollit nga i pandehuri. Megjithatë, teoritë bashkëkohore kanë ngritur pikëpyetje rreth kësaj qasjeje pasi që ajo përqendrohet në reagimin emocional të të pandehurit. Qasjet më të reja vlerësojnë edhe sjelljen e viktimës dhe shkaqet prapa reagimit të të pandehurit. Kjo qasje përqendrohet në aspektin nëse veprimet e viktimës kanë qenë të mjaftueshme për t'i dhënë të pandehurit ndjenjën se i është bërë shumë e padrejtë. Dhe që reagimi i të pandehurit ka qenë i arsyeshëm. Për të ardhur deri te ky përfundim, gjykata duhet të përqendrohet në çështjet në vijim:

- Natyrën, shkallën dhe kontekstin e provokimit.
- Kohëzgjatjen dhe shkallën e veprimeve në përgjigje ndaj provokimit.
- Nëse reagimi nuk ka qenë në përpjesëtim me provokimin.

Në situata ekstreme, siç janë vrasjet, gjykatat duhet të gjejnë nivele të ngjashme ekstreme të provokimit. Për shembull, gjykatat kanë marrë parasysh provokimin kur viktimia ka pranuar se ka keqtrajtuar fëmijët e të pandehurit apo viktimia qëllimisht ka lënduar fëmijët e të pandehurit për një periudhë të zgjatur kohore.

#### *Veprat në afekt*

Në disa rrethana gjykatat kanë përfunduar se një incident i vetëm mjafton për të nxitur reagimin e të pandehurit. Në këto raste duhet të ketë një ngjarje menjëherë të identifikueshme e cila ka nxitur veprimet e të pandehurit. Për më tepër, ngjarja që e nxit veprimin duhet të jetë ekstreme dhe të ndryshojë përshtatshëm për të mënjeluar veprën e kryer nga i pandehuri. Rrjedhimisht, sa më i madh të jetë niveli i reagimit nga i pandehuri aq më ekstreme duhet të jetë ngjarja provokuese.

#### *Provokimi në kontekst të abuzimit familjar*

Abuzuesit shpesh thirren në provokim si rrethanë lehtësuese. Gjukata duhet të shqyrtojë me kujdes pretendimin e provokimit në kontekst të dhunës në familje, duke marrë parasysh faktin se abuzuesit shpeshherë e konsiderojnë si provokim çfarëdo kërcënimi të aftësisë së tyre për të kontrolluar viktimën. Megjithatë, duke qenë se sjellja çnjerëzore apo e vrazhdë nuk është paraparë edhe në veprat tjera në Kod, kjo nuk nënkupton se nuk mund të merret si rrethanë lehtësuese nëse ka bazë.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- Cila është natyra e marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe të pandehurit?
- A janë të panjohur apo familjar?
- A ka marrëdhënie intime në mes tyre?
- A është e përfshirë ndonjë palë e tretë?

- A ka qenë provokimi kriminal në natyrë – qoftë i akuzuar formalisht apo jo? Sa serioze ka qenë vepra?
- A ka ndodhur provokimi në mënyrë të përsëritur apo vetëm një herë?
- A ka ndodhur provokimi gjatë një periudhe të konsiderueshme kohore?
- A ka kaluar ndonjë periudhë e konsiderueshme kohore ndërmjet aktit të provokimit dhe reagimit?
- A ka pasur dhunë apo kanosje me dhunë?
- A kanë qenë aktet provokuese apo kanosjet e vërteta apo të perceptuara?
- A kanë qenë aktet provokuese kërkesa për të drejta të barabarta në marrëdhënie, siç është fillimi apo fundi i një marrëdhënieje, kërkimi i shkollimit, kërkimi i punësimit, etj.?
- Cili ka qenë ekuilibri i pushtetit ndërmjet të pandehurit dhe provokuesit?
- A ka qenë veprimi kriminal në përpjesëtim me provokimin?
- A ka qenë i ngjashëm në natyrë?
- Nëse ka pasur disa ngjarje më të vogla, kur bëhen bashkë a e arrijnë nivelin e mjaftueshëm?
- A e tund ndërgjegjen reagimi pas provokimit?
- A do ta konsideronte aktin si provokim një person i arsyeshëm i ndodhur para së njëjtës situatë?

### 3.6. Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar<sup>74</sup>

Rrethanat personale dhe karakteri i mirë i personit të dënuar në përgjithësi janë rrethana lehtësuese në strukturat e dënimit në mbarë botën. Në fakt, shumë studime të matjes së dënimeve përfundojnë se rrethanat personale janë një nga rrethanat lehtësuese që citohen më së shpeshti dhe ndikimi i tyre në dënimin përfundimtar mund të jetë mjaft domethënës. Ato shpesh konsiderohen si mënyra më e mirë për të arritur deri te individualizimi i dënimit, i cili merr parasysh të gjitha aspektet e jetës dhe rrethanave të të pandehurit.

Fakti nëse një rrethanë e caktuar personale vlen të konsiderohet apo jo si rrethanë lehtësuese, shpeshherë është vendim subjektiv dhe në masë të madhe mund të varet nga mendimi personal i gjyqtarit. Ajo që konsiderohet nga një gjyqtar si rrethanë lehtësuese, mund të mos konsiderohet si e tillë nga një tjetër, e madje nga një i tretë mund të konsiderohet si rrethanë rënduese. Referimi i përgjithësuar i Kodit në “rrethanat personale” i jep mbështetje nocionit se një listë botërisht e pranuar e rrethanave personale lehtësuese është jo ekzistuese. Diskutimet në vijim janë një përpjekje e përgjithshme për të përshkruar në mënyrë të arsyeshme disa faktorë të cilët paraqiten shpesh.

#### *Karakteri*

‘Karakteri’ apo personaliteti pozitiv i të akuzuarit mund të konsiderohet relevant në matjen e dënimit pasi që tregon se sjellja kriminale nuk përputhet me sjelljen e zakonshme të të akuzuarit. Kjo rrethanë mund të ndërlidhet me rrethana tjera siç janë pranimi i fajësisë, bashkëpunimi me organet, dorëzimi vullnetar, pendimi, ndihma ndaj viktimave, etj. Janë këto rrethana që kanë ndikim në peshën e rrethanës ‘Karakteri i mirë’. Gjatë matjes së dënimit duhet pasur kujdes në lidhje me këtë rrethanë dhe peshën e dhënë varësisht nga ajo nëse karakteri i mirë është treguar pas veprës apo një karakter i tillë është vetëm në paraqitjen para gjyqtarit.

<sup>74</sup> Kodi Penal, neni 74, par 3.2

Në disa vendime të Gjykatës së Apelit, në Britaninë e Madhe dëshmi të karakterit të mirë janë marrë parasysh me rastin e vendosjes së gjykatës. Kështu në rastin Reid, Gjykata e Apelit ka ulur dënimin për vjedhje me thyerje, bazuar në sjelljen e të pandehurit në pritje të gjykimit, duke tentuar të shpëtojë tre fëmijë nga një shtëpi që kishte marrë flakë. Kjo sjellje, sipas Gjykatës, mund të justifikojë konkluzionin që “ankuesi ka qenë anëtar shumë më i mirë dhe më i vyer i shoqërisë sesa reflektohet nga aktiviteti i tij kriminal. Ka edhe vendime tjera të ngjashme lidhur me veprime si p.sh, shpëtimi i një fëmije nga përmbytja, shpëtimi i jetës së një personi në hekurudhë, parandalimi i ikjes së të burgosurve.<sup>75</sup>

#### *Varësia nga droga apo alkooli*

Në rastet kur vepra është kryer për të siguruar mjetet për të financuar varësinë nga droga, kjo mund të trajtohet si rrethanë lehtësuese apo rënduese, varësisht nëse gjyqtari e sheh këtë si manifestim të fajësisë së zvogëluar apo të rritur.

#### *Punësimi apo shkollimi*

Në disa raste, puna stabile e të pandehurit apo përfshirja në studime ose trajnim profesional mund të jetë rrethanë lehtësuese. E kaluara e mirë në punë mund të ketë më shumë ndikim në veprat e lehta për shkak të shkatërrimit të perspektivës ekonomike afatgjate të të pandehurit nëse dërgohet në burg për një periudhë të shkurtër kohore. Në përgjithësi, punësimi nga i pandehuri tregon një formë përgjegjësie dhe lë të kuptohet se ai është person i organizuar për dallim nga shumica e atyre që paraqiten para gjykatës dhe ka më pak gjasë që sërish të kryejnë veprë.

Në të kundërtën, disa gjykata mund ta konsiderojnë këtë rrethanë të parëndësishme pasi e njëjta duhet të konsiderohet edhe në raport me detyrimet që i ka. Gjykata mund të argumentojë, veçanërisht kur ka shkallë të mjaftueshme të fajësisë, se i pandehuri ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për dënimin e mundshëm që mund të rezultojë nga kryerja e veprës, përfshirë humbjen e vendit të punës, dhe prapëseprapë ai ka vendosur që t'i shpërfillë pasojat. Një argument shtesë mund të jetë se marrja parasysh e punësimit në raste të rënda, në fakt i penalizon ata të cilët janë të papunë – ndoshta pa fajin e tyre për shkak të rrethanave të vështira ekonomike.

Së fundi, me rritjen e seriozitetit të veprës, gjykatat duhet t'i japin më pak vlerë kësaj rrethane. Kjo vlen posaçërisht për krimet e dhunshme.

#### *Gjendja personale dhe familjare*

Në përgjithësi, gjykatat rregullisht e kanë marrë parasysh “gjendjen familjare” të të akuzuarit dhe ndikimin që burgimi do ta kishte në të tjerët. Në veçanti, fëmijët e vegjël apo numri i madh i fëmijëve të të akuzuarit, shpesh janë konsideruar si rrethanë lehtësuese, ashtu siç është konsideruar edhe të qenit prind i vetëm ku burgimi do ta çonte fëmijën në përkujdesje të ndonjë të afërmi tjetër. Konsideratat specifike mund të përfshijnë rrethanat në vijim:

- Numrin dhe moshën e fëmijëve.
- Nëse i pandehuri është mbajtësi i vetëm i familjes.
- Nëse i pandehuri kujdeset për të tjerët.
- Nëse i pandehuri është prind i vetëm.
- Shëndeti i personave nën përkujdesje të të pandehurit.
- Të gjitha rrethanat tjera jetësore të të pandehurit të cilat mund të ndikojnë në dënim.

---

<sup>75</sup> Andrew Ashworth dhe Rory Kelly, Matja e dënimit dhe e drejta penale [Sentencing and Criminal Justice], 5.4.2 Kontributet shoqërore me vlerë, fq.162, Botimi 7, Bloomsbury Publishing, 2021.

Nëse gjykata vendos për të marrë parasysh rrethanat familjare në zbutje, atëherë përqendrimi duhet të jetë në ndikimin specifik që ndarja do të kishte në familje. Në praktikë, përdorimi i saj duhet të kufizohet vetëm në ato rrethana të cilat prekin familjen në mënyrë të konsiderueshme për shkak të rrethanave të caktuara. Për shembull, nëse fëmijët kanë mbështetje të kufizuar nga të tjerët në rast se i pandehuri dërgohet në burgim. Zbutja dekurajohet bazuar në shkakun e vetëm të ekzistimit të familjes.

Një arsye tjetër përse gjykatat duhet, që në parim, t'i marrin në konsideratë "shqetësimet familjare" si rrethanë lehtësuese është parimi i drejtësisë rehabilituese ku gjendja personale dhe familjare e të pandehurit mund të bëjë gjyqtarët që të besojnë në gjasat e të akuzuarit për rehabilitim. Në parim, kujdesi i të pandehurit për familjen e tij tregon disa tipare pozitive personale të cilat mund ta parandalojnë nga kryerja e veprave tjera. Dikush që kujdeset për vartës të ndjeshëm mund të thuhet se po bën punë për komunitetin dhe kjo duhet të merret parasysh gjatë caktimit të dënimit për personin e tillë, pasi që "ne të gjithë u kemi borxh atyre që kujdesen për të tjerët".

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që gjykata ta shqyrtojë rolin e të gjithë anëtarëve të familjes në vepër. Nëse ndonjë anëtar i familjes është viktimë e veprës së të pandehurit, atëherë **NUK** duhet të ketë zbutje për rrethanat familjare të cilat kanë të bëjnë me viktimën apo të cilat vënë anëtarët tjerë të familjes në rrezik. Për shembull, nëse i pandehuri ka kryer veprë penale të cenimit të integritetit seksual të të miturit, atij nuk duhet zbutur dënimin, sepse duhet të kujdeset për fëmijën, e as për faktin se duhet të kujdeset për fëmijët tjerë në shtëpi.

Së fundi, çdo zbutje bazuar në rrethanat familjare duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të kujdesshëm i të gjitha rrethanave të të pandehurit dhe një vlerësimi të kujdesshëm nëse zbutja është përfitim apo rrezik. Gjykata nuk duhet të merr parasysh vetëm, për shembull, nëse ka fëmijë të vegjël, por nëse i pandehuri është duke u kujdesur për mirëqenien e tyre dhe nëse është duke ndihmuar në rritjen e tyre? Nëse ka të afërm tjerë të sëmurë në shtëpi, a është duke u kujdesur i pandehuri për ta në ndonjë mënyrë domethënëse dhe produktive? Nëse i pandehuri ka kryer veprë të dhunshme, a ka rrezik për lëndimin e anëtarëve të familjes nëse kryen veprë sërish?

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Mund të ketë dyfishim nëse merret parasysh shëndeti i të pandehurit kur ka probleme mendore të cilat kontribuojnë në aftësinë e zvogëluar mendore.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- Sa serioze është vepra dhe cilat janë lëndimet nëse ka të tilla?
- A është i pandehuri i punësuar? Cila është natyra dhe lloji i punësimit?
- A ka anëtarë të familjes të cilët varen nga ai? Nëse po, çfarë është moshja e tyre?
- Cili është niveli i varësisë së anëtarëve të familjes nga i pandehuri?
- A është ndonjë anëtar i familjes i përfshirë si viktimë?

### *3.7. Dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël ...<sup>76</sup>*

Që të dy rrethanat lehtësuese në 3.4 dhe 3.5 përqendrohen në rolin e të pandehurit dhe fajësinë e tyre në vetë veprën penale. Në shumë aspekte, kjo rrethanë është e kundërta e rrethanës rënduese 2.1. Rrethana 3.4 është e ngjashme për kah natyra me rrethanën 3.5, mirëpo fokusi i 3.4

<sup>76</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.4 dhe 3.5, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

është më tepër në pjesëmarrjen në veprë penale, e jo në ofrimin e ndihmës në kryerjen e veprës penale. Një shembull i 3.4 do të ishte veprimi i bërjes roje gjatë kryerjes së një grabitjeje. Derisa dënimi i paraparë dhe akuza është e njëjtë, rrethana e përcakton që bërja e rojës është nivel më i ulët i fajësisë dhe meriton dënim më të ulët.

Rrethana 3.5 është adresuar edhe në nenin 33, i cili e përshkruan ndihmën në kryerjen e veprës penale. Ky nen, në mënyrë specifike, parasheh dënim më të butë kur një individ, për shembull, i vë në dispozicion mjetet për kryerjen e veprave, i krijon kushtet apo i mënjanon pengesat për kryerjen e veprës ose bën përgatitje paraprake për fshehjen e provave të kryerjes së veprës, të pandehurin apo identitetin e të pandehurit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale apo përfitimin që rrjedh nga kryerja e veprës penale. Kriteret e nenit 33 për dënim më të butë për ata që japin ndihmë, përmbushet duke e përdorur rrethanën 3.5 dhe duke shqiptuar dënim më të butë se për ata që marrin pjesë më formalisht. Në nenin 33 nuk ka kërkesë për zvogëlim më të madh në nivel të veprës përmes zbutjes së dënimit përveç nëse kjo është e duhur.

Është e rëndësishme që gjykata ta mbajë në mend që konstatimi i rrethanës rënduese nga pika 2.1, që i pandehuri ka pasur shkallë të lartë të pjesëmarrjes, nuk kërkon që të pandehurit tjerë të kenë shkallë të ulët të pjesëmarrjes sipas 3.4. apo ndihmës sipas 3.5. Po ashtu, as konstatimi që i pandehuri ka qenë kryes i nivelit të mesëm nuk nënkupton që njëri apo të pandehurit tjerë kanë qenë pjesëmarrës të nivelit të ulët.

Për sa i përket rolit të ulët, çdo përfundim që pjesëmarrësi ka pasur rol të ulët do të nënkuptojë konstatimin nga gjykata që i pandehuri ka kontribuar minimalisht në kryerjen e krimit, së pari për sa i përket plotësimit të elementeve të veprës penale dhe së dyti në krahasim me të pandehurit tjerë. Nëse kontributi i të pandehurit do të mund të hiqej me ndikim minimal në kryerjen e krimit, gjykata mund të konkludonte me një nivel të sigurisë që rrethana 3.4 ka qenë e pranishme.

Rrethana 3.5 kërkon që gjykata ta vlerësojë jo vetëm nivelin e pjesëmarrjes ndërmjet të pandehurit dhe pjesëmarrësve tjerë, por do të kërkojë edhe një vlerësim të afërsisë së të pandehurit dhe sa i drejtpërdrejtë ka qenë kontributi i tij në kryerjen e veprës penale. Ka më shumë gjasa që gjykata ta konstatojë ekzistimin e pikës 3.5 kur i pandehuri nuk është i pranishëm në vendin e ngjarjes. Një tregues tjetër do të jetë periudha kohore e kontributit të të pandehurit. Nëse kontributi i të pandehurit ka qenë afër kohës së kryerjes përfundimtare të veprës penale atëherë, ai ka gjasa që të konsiderohet si pjesëmarrës ndihmës.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Nuk duhet të ketë brenga rreth dyfishimit përveç ndërmjet rrethanës 3.4 dhe 3.5. Gjukata nuk duhet ta konstatojë praninë e të dyja rrethanave në të njëjtën kohë. Siç është përmendur më herët, rrethana 3.4 duhet të kufizohet vetëm në ato situata ku i pandehuri është fizikisht i pranishëm dhe merr pjesë në vetë kryerjen e veprës penale, por në rol më të vogël. Ndryshe nga rrethana 3.5 ku kontributi ka ndodhur para apo pas dhe ka ngjarë në rol mbështetës apo planifikues. Presioni dhe ngurrimi i të pandehurit për kryerjen e veprës penale nuk duhet të vlerësohet në kuadër të rrethanës 3.4 apo 3.5 pasi që ajo është mbuluar në mënyrë më të duhur në rrethanën 3.1.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka pasur i pandehuri ndonjë shkathtësi apo specializim të nevojshëm për planifikimin apo kryerjen e veprës penale?
- A e ka planifikuar apo a ka kontribuar i pandehuri me informatat apo materialet e nevojshme për kryerjen e veprës penale?



- A ka qenë kontributi i të pandehurit në aspektin kohor i largët nga kryerja e vetë veprës penale (para ose pas)?
- A ka pasur një kryes që ka kontribuar pjesërisht apo ka dominuar në kryerjen e veprës penale?
- A ka qenë i pandehuri fizikisht i pranishëm në vendin e ngjarjes?
- A do të kishte mundur të ndodhte krimi pa kontributin e të pandehurit? A ka qenë kontributi shumë i rëndësishëm për suksesin e veprës penale?
- A mund të izolohen dhe llogariten veprimet e të pandehurit në krahasim me ato të kryesve tjerë?

### 3.8. Mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar<sup>77</sup>

Mosha është ndër ‘rrethanat personale’ klasike që duhet marrë parasysh në përcaktimin e dënimit për të pandehurin. Në përgjithësi, janë dy rrethana kryesore që duhet të konsiderohen si rrethana lehtësuese: **mosha e re** e të pandehurit dhe **mosha e vjetër** e të pandehurit. Derisa që të dyja janë të ndërlidhura me moshën, ato dallojnë për sa i përket logjikës së zbutjes. Për të pandehurit e rinj, zbutja zakonisht i atribuohet papjekurisë së të pandehurit. Këtu i pandehuri, deri në një masë ka qenë shumë i ri apo i zhvilluar në mënyrë joadekuate për ta kuptuar si duhet natyrën e sjelljes së vet. Andaj, dënimi duhet zvogëluar. Për sa i përket të moshuarve, koncepti është që shëndeti i të pandehurit mund të vihet në rrezik apo kohëzgjatja e dënimit mund të jetë e tillë që lë pak gjasa që i pandehuri të kthehet në shoqëri.

Të dy situatat e kanë logjikën e njëjtë për sa i përket aftësisë së të pandehurit për ta përballuar dënimin. Një arsytim shtesë, që shpesh përmendet për marrjen në konsideratë të moshës në zbutje të dënimit është koncepti që për të rinjtë dhe të moshuarit, dënimi mund të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në të pandehurin e caktuar. Këtu dënimi brenda një kufiri “normal” mund të jetë veçanërisht i vështirë për t’u përballuar. Në këto situata, brenga është që dënimet duhet të kenë përafërsisht të njëjtin ndikim mbi të gjithë të pandehurit dhe kur i pandehuri bie në këtë kategori atëherë shkelet ky parim.

Vështirësia me të dyja këto rrethana është që nuk ka përkufizim të qartë të asaj që e përcakton si **të ri** apo **të moshuar** si rrethanë lehtësuese. Andaj, gjykata duhet t’i qaset zbatimit të kësaj rrethane me kujdes të madh dhe fokus në zbatimin uniform të saj. Në të dyja situatat, fundi ekstrem i këtyre kufijve është më pak i vështirë për t’u trajtuar dhe është më pak kontrovers nëse thjeshtë shikohet mosha dhe përcaktohet që duhet të zbatohet zbutja. Kur mosha bëhet më kontroverse, gjykatës do t’i duhet që gjithnjë e më shumë të mbështetet në vlerësimin e arsytimit për zbutje në rend të parë. Për shembull, për ta vlerësuar si duhet rrethanën e “moshës së re” i zbaton elementet si personaliteti i brishtë, pa përvojë, i papjekur apo naiv duhet të merren parasysh; ngjashëm me këtë, rrethana e ‘moshës së vjetër’ duhet të vlerësohet në lidhje me shëndetin, pafuqinë, sëmundjen e kështu me radhë. Me rritjen e moshës, gjykatës do t’i duhet të ofrojë gjithnjë e më shumë arsytim për paaftësinë e të pandehurit për të kuptuar natyrën e veprimeve të tij, që do të mund ta arsyetonte aftësinë e zvogëluar mendore.

Kur të merret parasysh zbatimi i rrethanës së moshës ‘së vjetër’, **nuk** duhet të merret në konsideratë aftësia e të pandehurit për t’i kuptuar veprimet e tyre apo natyrën e tyre, p.sh. pleqëria

<sup>77</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.6, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

apo aftësia e kufizuar. Nëse ka brenga rreth të kuptuarit, kjo trajtohet në mënyrë më adekuate të rrethana e aftësisë së zvogëluar. Për ta aplikuar këtë rrethanë, gjykata duhet të vlerësojë gjendjen e përgjithshme shëndetësore të të pandehurit dhe aftësinë për ta vuajtur dënimin në mënyrë adekuate. Teoria tradicionale të ky zvogëlim është që për shkak të moshës së shtyrë të të pandehurit, dënimi do të ketë efekt jo përpjestimisht të rëndë, në krahasim me një kryes më të ri i cili e ka pranuar dënimin e njëjtë. Gjykata gjithsesi se mund ta heq këtë rrethanë nëse ekzistojnë prova që kjo gjendje është shfrytëzuar nga i pandehuri për ta kryer veprën penale.

#### *Dyfishimi dhe Kujdesi*

Siç është diskutuar më parë, kjo rrethanë mund të ketë dyfishim të konsiderueshëm me aftësinë e zvogëluar, në veçanti kur të zbatohet kjo rrethanë në kontekst të paaftësisë për t'i kuptuar pasojat.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka qenë i pandehuri nën moshën 18 vjeçare apo mbi moshën 65 vjeçare?
- A ka pasur i pandehuri moshë të mjaftueshme për ta kuptuar natyrën e veprimeve të tij?
- A ka fakte apo prova që tregojnë se i pandehuri në fakt i ka kuptuar veprimet e tij përkundër moshës së tij?
- A ka prova që i pandehuri i ka adresuar apo me vetëdije i ka shpërfillur rezultatet e mundshme negative të veprimeve të tij?
- A është duke vuajtur i pandehuri nga ndonjë sëmundje akute? A do ta mbijetojë i pandehuri dënimin e menduar?
- A ka ndonjë sëmundje mendore që kontribuon në paaftësinë për t'i menduar veprimet e të pandehurit?
- A e ka shfrytëzuar i pandehuri me vetëdije këtë rrethanë për kryerjen e veprës penale?
- A janë diagnostikuar nga autoritetet mjekësore sëmundjet përkatëse për ta plotësuar këtë zbutje?
- A ka ekzistuar kjo sëmundje para kryerjes së veprës penale?

### 3.9. Rrethanat që tregojnë pendim dhe bashkëpunim nga i pandehuri<sup>78</sup>

Rrethanat 3.7 deri 3.12 janë grupuar së bashku për ta paralajmëruar gjykatën për mundësinë e fortë të dyfishimit ndërmjet rrethanave. Nëse nuk qaset me konsideratë të kujdeshme dhe me maturi, ekziston gjasë e fuqishme që i pandehuri të marrë një masë të zbutjes më të butë se që ka të drejtë.

Që të gjashtë këto rrethana hyjnë në konceptin e drejtësisë rehabilituese. Pra, që i pandehuri ta ketë pranuar deri në një masë që ka bërë diçka të keqe, e ka pranuar përgjegjësinë dhe është i gatshëm që ta korrigjojë atë. Duke theksuar këtë, përqendrimi i gjykatës duhet të jetë në ri integrimin e të pandehurit në shoqëri në vend të largimit të tij me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë. Pasi që secila nga këto rrethana mund të luajë rol të rëndësishëm në përcaktimin e dënimin të përgjithshëm, duke u konsideruar tregues të fuqishëm të mundësisë së rehabilitimit, Gjykata nuk duhet të lejojë që faktet që vlejnë për një rrethanë ta mbështesin edhe një tjetër.

<sup>78</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.7-3.12, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

Asnjë fushë tjetër nuk është më e ngatërruar dhe me mundësi dyfishimi se sa koncepti i pendimit. Secili faktor në këtë pjesë mund ta mbështesë konstatimin e pendimit dhe t'i rrisë mundësitë e rehabilitimit të të pandehurit.

- Dëmshpërblimi i viktimës mund të konsiderohet tregues i pendimit.
- Bashkëpunimi me gjykatën mund të konsiderohet pranim i përgjegjësisë dhe pendim.
- Bërja e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë mund të konsiderohet pranim i përgjegjësisë dhe pendim.

Në skemat e caktimit të dënimit dhe ndoshta edhe historikisht asnjë rrethanë tjetër nuk është më e rëndësishme për zbutjen se sa koncepti i pendimit. Ka ndikim emocional mbi gjyqtarët, prokurorët bile edhe viktimat për ta zvogëluar gjykimin e tyre dhe kërkesat e tyre për burgim. Për shkak të potencialit të një ndikimi të tillë të dukshëm, për t'u siguruar përfundimisht që dënimet të jenë të njëtrajtshme për të gjithë të pandehurit dhe për t'u siguruar që zbutja të mos fryhet në mënyrë jo të duhur, është absolutisht imperativ që Gjykata ta interpretojë kuptimin e rrethanave 3.7-3.12 në mënyrë të ngushtë dhe të mos lejojë zbatim të përgjithshëm. Kështu në një nga vlerësimet e gjykatave në Kosovë, gjykata ka vërejtur se: *“Ndërsa, si rrethana rënduese gjykata mori: jo sinqeritetin e të pandehurit për të shprehur keqardhje për veprimet e tij edhe atë i njëjti vetëm sa për lehtësim kërkoi falje për veprimet e tij, por, që gjykata gjatë zhvillimit të procedurës vërejtë se kërkim falja që bëri i pandehuri nuk ishte e sinqertë, e sidomos duke pasur parasysht faktin se, gjyqtarja vërejtë të pandehurin duke qeshur, derisa e dëmtuara deklaronte lidhur me rastin...”*

Një vlerësim i tillë i bërë nga gjykata lidhur me sinqeritetin e shprehur të pandehurit paraqet pikërisht një nga shembujt mbi atë se si gjykata duhet të jetë vigjilente për pendimin e shprehur tek i pandehuri, pikërisht për shkak se është rrethanë shumë subjektive dhe vështirë e matshme. Andaj, në çdo rast kërkohet vlerësim sa më real të mundshëm mbi sinqeritetin e të pandehurit dhe nëse një rrethanë e tillë duhet të merret parasysht për uljen e dënimit.

### 3.10. Dëshmia që personi i dënuar ka bërë restituimin apo kompensimin e viktimës<sup>79</sup>

Koncepti te kjo rrethanë është që është e dobishme që viktima të jetë dëmshpërblyer, se paku financiarisht, në një gjendje të përafërt me atë para kryerjes së veprës penale. Përveç kësaj, duhet të shikohet që veprimet të konsiderohen meritore për sa i përket kontributit për qëllimet e drejtësisë penale pasi që do ta aktivizojë legjislacionin shtetëror për ofrimin e kompensimit për viktimën. Kjo është veçanërisht e duhur në rast se dëmshpërblimi ndodh pa u nxitur nga gjykata.

Mirëpo, nëse gjykata e zbaton kompensimin e viktimës në këtë rrethanë, nuk mund ta zbatojë atë edhe për dëshmitë për pendim. Jo vetëm që ekzistojnë brenga që zbutja do të llogaritet dy herë, por ekzistojnë brenga që i pandehuri është duke u përpjekur që të përfitojë nga zbritja pa u angazhuar me të vërtetë në atë akt e jo për shkak se është “gjëja e duhur” për ta bërë.

Një fushë tjetër brengosëse është nëse kjo rrethanë përqendrohet në mundësinë për të paguar, andaj, a është e duhur që të shpërblehet me zbutje thjeshtë një palë e caktuar për shkak se ka mundësi që të paguajë? Kjo brengë është më e dukshme kur kemi të bashkëpandehur, që të dy e kanë dëshirën për të paguar mirëpo, vetëm njëri e ka mundësinë. Në atë situatë, Gjykata duhet ta shqyrtojë nëse, në fakt është duke e penalizuar të pandehurin i cili nuk ka para dhe duke e

<sup>79</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.7, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

shpërblyer atë që ka. Kjo nuk nënkupton që ky koncept nuk ka merita, në veçanti kur varet nga mundësia e shtetit për të dhënë kompensim në rast se i pandehuri nuk ka mundësi. Fakti që në një rast të caktuar viktima ka mundësi që t'i paguajë faturat e mjekimit apo pagat e humbura është definitivisht një përfitim. Kjo thjeshtë nënkupton që gjatë përcaktimit nëse do ta zbusë dënimin dhe në çfarë niveli, Gjykata duhet t'i vlerësojë të gjitha rrethanat. Gjykata, në veçanti duhet ta merr parasysh mundësinë e të pandehurit për të paguar në përpjesëtim me shumën e paguar.

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A është bërë dëmshpërblimi para arrestit apo intervenimit formal nga policia?
- A ka qenë në dijeni i pandehuri se sa i fortë është rasti kundër tij në kohën kur e ka bërë dëmshpërblimin?
- A është bërë dëmshpërblimi si rezultat i ndonjë marrëveshjeje me viktimën në lidhje me ndërmarrjen/mbështetjen e ndjekjes së rastit?
- A ka qenë mundësia e të pandehurit për pagesë të përpjesëtueshme me shumën e paguar? A ka pasur të bashkëpandehur me mundësi të ndryshme për të paguar?
- A është kthyer në gjendjen e mëparshme viktima si rezultat i dëmshpërblimit?
- A është konsideruar nga dëmshpërblimi që i pandehuri është penduar për veprimet e tij? A është shqyrtuar dëmshpërblimi në mbështetje të ndonjë rrethane tjetër lehtësuese?
- A është bërë kompensimi/dëmshpërblimi në ndonjë formë tjetër jo monetare?

### 3.11. Bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar<sup>80</sup>

Rrethana 3.8 përqendrohet në sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale; në veçanti në ndërveprimin ndërmjet të pandehurit dhe gjykatës. Kjo pashmangshëm do të përqendrohet në sjelljen e të pandehurit gjatë procesit gjyqësor dhe përfundimisht do të bazohet në perceptimin e Gjykatës. Kjo nuk është dhe nuk duhet të konsiderohet pjesë e bashkëpunimit me prokurorinë e cila është e rezervuar në mënyrë specifike për rrethanën nga paragrafi 3.9.

Dorëzimi vullnetar i të pandehurit mund të ketë implikime për procesin e caktimit të dënimit dhe aftësinë e gjykatës për ta përmbyllur procesin andaj edhe është konsideruar si rrethanë në zbutjen e dënimit. Gjykatat gjithashtu supozojnë që dorëzimi, paraqitja vullnetare në proces ka implikime më të mëdha dhe mund t'i frymëzojë edhe të pandehurit tjerë që të veprojnë në të njëjtën mënyrë, duke e përmirësuar kështu efektshmërinë e përgjithshme të punës së gjykatave. Dorëzimi vullnetar zbehet **substancialisht** kur procedurat janë të natyrës familjare.

Pavarësisht se a varet procedura nga tribunalet vendore apo ndërkombëtare, çështja kryesore për gjykatën duhet të jetë nëse është e duhur që ta shqyrtojë këtë si rrethanë apo jo. Shpërblimi me zbutje për bashkëpunim me gjykatën, në esencë është sjellje shpërblyese që duhet të pritët nga i pandehuri. Një qasje më e duhur do të ishte që të rezervohet zbutja për aktivitete që shkojnë përtej sjelljes që është e pritshme apo e duhur në përgjithësi. Në vend të kësaj, shumë tribunale e kanë refuzuar shpërblimin e zbutjes për sjellje dhe kanë zgjedhur që ta dënojnë sjelljen e keqe me ashpërsim të dënimit. Shembujt përfshijnë sjelljen që është përçarëse dhe që është në skaj të vetëdijes për peshën e veprës penale, kërcënimin apo frikësimin e dëshmitarit dhe mungesën e përgjithshme të respektit për solemnitetin e procesit gjyqësor.

<sup>80</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.8, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A është bërë dorëzimi pranë tribunalit apo pranë prokurorisë?
- A është bërë dorëzimi për shkak të përgatitjes së ndonjë intervenimi të policisë?
- A është dorëzuar i pandehuri nga një lokacion ndërkombëtar apo vendor?
- A është kjo sjellje përgjithësisht e pritshme nga Gjykata për të pandehurin? A ka qenë thjeshtë mungesë e sjelljes së keqe nga i pandehuri?
  - A ka qenë dorëzimi apo bashkëpunimi i rëndësishëm në thelb për zgjidhjen e rastit nga Gjykata? A ka kontribuar në mbylljen e çështjes?

### 3.12. Bashkëpunim vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale<sup>81</sup>

Bashkëpunimi mund të merr forma të ndryshme nga lehtësimi i paraqitjes së rastit nga prokurori, dhënia e dëshmisë dhe dhënia e provave për rastet tjera, zbulimi i informatave të reja apo verifikimi i informatave të njohura, si dhe kontributi në identifikimin e kryerësve tjerë të veprave penale. Kjo mund të jetë edhe bashkëpunimi me policinë gjatë fazës së hetimeve.

Është shumë me rëndësi që Gjykata ta mbajë këtë rrethanë të ndarë dhe ta dallojë atë nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë apo bashkëpunimi formal. Aty ku ekziston strukturë formale, ajo në mënyrë të qartë i përvijon kushtet e zbutjes, kufizimet e saj dhe pritjet e prokurorisë. Gjykata duhet të supozojë, përderisa nuk sugjerohet ndryshe nga prokurori, që bashkëpunimi i plotë në të gjitha nivelet e çështjes para gjykatës është llogaritur në marrëveshje. Gjykata nuk duhet ta përdorë këtë faktor për reduktim të mëturjes në një dënimi të dakorduar pasi që zvogëlimi i saj do t'i minojë marrëveshjet në të ardhmen dhe do të rezultojë në llogaritje të dyfishtë të bashkëpunimit.

Vlerësimi i bashkëpunimit të të pandehurve varet si nga sasia ashtu edhe cilësia e informatës që ata e japin. Ai gjithashtu varet edhe në spontanitetin dhe vetëmohimin në bashkëpunim. Gjykata duhet ta vlerësojë nëse informata është ndarë pa pritjen e diçkaje si kthim dhe vullnetarisht, apo vetëm pa dëshirë në bazë të një veprimi të pashmangshëm të suksesit të policisë apo prokurorisë. Gjykata do të mund ta përdorte autoritetin e saj për të mësuar nga prokurori apo policia nivelin e rëndësisë apo përfitimit që nxirret nga bashkëpunimi me të pandehurin.

Nëse gjykata e përcakton që bashkëpunimi ka qenë substancial, kjo rrethanë në përgjithësi konsiderohet si e rëndësishme për zbutje pasi që e ndihmon një gjykim ekspeditiv. Në anën tjetër, kur gjyqtarët e përcaktojnë që bashkëpunimi është bërë me ngurrim, ishte sporadik apo i ndërlikuar me ndonjë faktor të jashtëm, zbutja do të jetë më e vogël.

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ekziston marrëveshje formale mbi pranimin e fajësisë apo bashkëpunimit? Nëse po, a janë cekur kushtet zbutjes në mënyrë të qartë?
- Nëse ekziston marrëveshja, a ka siguruar i pandehuri informata më shumë se ato që janë paraparë brenda marrëveshjes?
- A janë dhënë informatat në pritje të zvogëlimit të dënimit?
- A ka ofruar i pandehuri bashkëpunim që është substancialisht i rëndësishëm për zgjidhjen e çështjes?

---

<sup>81</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.9, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

- A e ka pranuar i pandehuri kryerjen e veprës penale?
- A ka dhënë i pandehuri dëshmi inkriminuese kundër ndonjë të pandehuri tjetër gjatë hetimit dhe/apo gjykimit?
- A janë gjetur provat në mbështetje të dënimit si rezultat i bashkëpunimit të të pandehurit?

### 3.13. Pranimi i fajit<sup>82</sup>

Për pranimin e fajit është folur më sipër në kuadër të rrethanave të përgjithshme për matjen e dënimit sipas Nenit 69. Pranimi i fajit ka qenë për një kohë të gjatë burim i zbutjes së dënimit për shumë arsye. Disa argumentojnë duke e theksuar pranimin nga ana e të pandehurit, të veprimeve të tij, gatishmërinë për t'u rehabilituar dhe integruar, gatishmërinë për t'u dënuar për krimet e tyre dhe një shenjë e pendimit ndaj viktimës dhe shoqërisë. Mirëpo, zbatimi kuturu i kësaj rrethane shpie në rrethana të llogaritura dy herë në zbutjen dhe tej vlerësimin e zbritjes përfundimtare. Praktika aktuale në Kosovë e mbështetë fuqishëm atë kur është e pranishme, kjo rrethanë është jo përpjestimisht e rëndësishme në krahasim me rrethanat tjera – që tregojnë edhe për llogaritjen e dyfishtë dhe mbivendosjen. Për më tepër, ka pak dëshmi për të sugjeruar që zbatimi i gjerë i pranimit të fajit në rrethanat tjera është i arsyeshëm. Duke e pasur parasysh që secila rrethanë që mund ta mbështetë pranimi i fajësisë mund të vlerësohet në mënyrë të pavarur dhe pranimit të fajësisë ti jepet vlerësimi i vet i matur. ***Më e rëndësishmja është që pranimi i fajësisë të mos bëjë që me automatizëm të ulët dënimi nën minimumin ligjor.*** Gjykata duhet të përqendrojë vlerësimin e saj vetëm në faktin që i pandehuri e ka pranuar fajin. Nuk duhet të lëshohet në pranimin e fajësisë si mbështetje për pendimin, bashkëpunimin apo ndonjë rrethanë tjetër.

Janë disa përfitime që burojnë në mënyrë të qenësishme nga pranimi i fajit që e formojnë bazën për zbutje. Arsyeja kryesore ndërlidhet me përfitimet e shoqërisë që dalin nga shmangia e gjykimit. Pranimi i fajësisë i parandalon shpenzimet që ndërlidhen me dhënien e dëshmisë nga dëshmitarët, sigurimin e pranisë së të pandehurve nga policia, ofrimin e sigurisë për procesin, ndoshta edhe koston e përkthimit dhe përqendrimit e disa gjyqtarëve në një rast në dëm të shumë rasteve tjera. Ka edhe përfitim psikologjik pasi që viktimat nuk kalojnë nëpër stresin e madh mendor e të qenit të pranishëm dhe dhënie të dëshmisë në gjykim. Dhe vetë sistemi mund t'ia përqendrojë kohën dhe vëmendjen e tij rasteve që janë ndoshta më të vlefshme për burimet e kufizuara financiare të shoqërisë. Përfundimisht, deri në një masë të kufizuar, zbutja e dënimit për ata që vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë iu çon mesazh të tjerëve që ata do të trajtohen në mënyrë të drejtë, i inkurajon të tjerët që të lajmërohen, qoftë si kryerës të paraqitur tashmë apo si të panjohur.

Akti i pranimit të fajit duhet në parim, të shpie në një formë të zvogëlimit të dënimit që i pandehuri do ta kishte marrë. Mirëpo, masa e vlerës zbutëse të pranimit të fajësisë varet shumë nga momenti në të cilin është pranuar faji. Pranimit të hershëm të fajit i jepet më shumë peshë se atij që vjen më vonë, pasi që përfitimet për sistemin dhe ekonomizimin e gjykimit janë në kulmimin e tyre. Gjithashtu, besohet në përgjithësi si më i vërtetë dhe më spontan se sa për shembull përpjekja e minutës së fundit për të minimizuar dënimin në një gjykim ku të pandehurit nuk po i shkon mirë. Me përparimin e procesit gjyqësor, zbutja e mundshme duhet të zvogëlohet

<sup>82</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.10, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

përpjesëtimisht. Mirëpo, posa të fillojë gjykimi, duhet të ketë zvogëlim të dukshëm të zbutjes së dhënë pasi që përfitimi i shmangies së gjykimit tashmë është humbur në masë të madhe – në veçanti nëse viktimat janë thirrur për të dëshmuar. Nëse faji pranohet në mes të gjykimit gjykata duhet seriozisht ta merr parasysh që të jep zbutje minimale apo fare.

Është me rëndësi që të mbahet mend që ky zvogëlim i dukshëm në zbutjen e dënimit pas fillimit të gjykimit nuk është ndëshkim për shfrytëzimin e të drejtës për gjykim. Është thjeshtë njohje që shpërblimi kryesor për pranimin e fajësisë vjen në rast të shmangies së kostos për shoqërinë. Përfundimisht, i pandehuri i cili e shfrytëzon të drejtën e tij për gjykim e ka një mundësi të cilën nuk e ka i pandehuri i cili e pranon fajësinë dhe ajo është që të shpallet i pafajshëm dhe ta heq dënimin tërësisht.

Përfundimisht, kjo rrethanë nuk duhet të ngatërrohet me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Ato janë konsiderata krejtësisht të ndryshme. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë i përfshinë të gjitha palët që pajtohen për dënimin përfundimtar për të pandehurin dhe nuk ka zvogëlim shtesë në bazë të kësaj rrethane pasi që do të paraqiste llogaritje të dyfishtë. Vetë marrëveshja duhet të paraqesë në mënyrë adekuate kursimet për shoqërinë si dhe të gjitha rrethanat tjera lehtësuese që janë të duhura. Kjo rrethanë është e rezervuar vetëm për ato situata ku i pandehuri e pranon fajësinë pa marrëveshje me prokurorin.

Nëse gjykata ballafaqohet me situatë ku negociatat janë mbajtur por kanë dështuar, mirëpo i pandehuri në fund e ka pranuar fajin në Gjykatë pa marrëveshje, gjykata duhet ta merr parasysh dënimin e ofruar nga prokurori që ishte refuzuar nga i pandehuri. Nëse gjykata konstaton që rrethanat në lidhje me negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë tregojnë që i pandehuri e ka refuzuar ofertën për marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me shpresë që do të marrë dënim më të ulët nga Gjykata, ajo duhet ta merr parasysh ndikimin e mundshëm nëse Gjykata vendos që ta shqiptojë dënim më të ulët. Shqiptimi i dënimit më të ulët se ai që është ofruar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë pa dhënë arsytim, mund ta dekurajojë mbajtjen e negociatave të ardhshme për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A e ka pranuar i pandehuri fajin në mundësinë më të hershme të mundshme?
- A ka pasur i pandehuri mundësi për t'i vlerësuar të gjitha provat e propozuara dhe dëshminë e propozuar para se ta pranojë fajësinë?
- A ka filluar gjykimi formalisht? A është dhënë dëshmia?
- A ka dëshmuar viktimat?

3.14. Keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar<sup>83</sup>

Në mesin e rrethanave tjera që kanë të bëjnë me personin e akuzuar, 'pendimi' tradicionalisht ka qenë konsideratë e rëndësishme për zbutjen e dënimit në pothuajse secilin sistem. Idealisht përfaqëson një njohje të vuajtjes së viktimave, njohje që vepra ka qenë gabim, marrjen e përgjegjësisë dhe gatishmërinë për t'i pranuar pasojat. Kur pendimi të bashkohet me më shumë se shprehje të keqardhjes, por me ndonjë vepër të vërtetë që demonstroi pendimin, ky është argument për zbutje. Në situata të tilla, i pandehuri i ka shfaqur të gjitha tiparet e rehabilitimit të suksesshëm dhe ri-integrim sipas modelit rehabilitues të dënimit.

<sup>83</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.11, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

Par ta pranuar pendimin si rrethanë lehtësuese për caktimin e dënimit, gjyqtari duhet të jetë i bindur që pendimi i shprehur është i sinqertë. Ky vlerësim është qartazi i vështirë, duke e pasur parasysh që kjo rrethanë është e natyrës subjektive, besueshmëria e së cilës varet vetëm nga i pandehuri. Kërkon nga gjykata që t'i merr parasysh jo vetëm fjalët e të pandehurit, por edhe provat rrethore dhe konkludimet që mund të nxirren nga veprimet dhe sjellja. Këto tradicionalisht kanë përfshirë gjëra si:

- Deklaratat specifike të bëra nga i pandehuri që shfaqin pendim dhe keqardhje.
- Veprimet pozitive të drejtpërdrejta drejt viktimës si kërkim-falja.
- Nëse ka pasur lëndim të viktimës, kërkimi apo ofrimi i menjëhershëm i ndihmës mjekësore.
- Emocionet e të pandehurit të vështruara nga viktimja, i pandehuri dhe/apo Gjykata.
- Nëse veprimet e të pandehurit janë shkaktuar apo ashpërsuar nga ndonjë gjendje e jashtme, si përdorimi i alkoolit apo narkotikëve, kërkimi i trajtimit mjekësor.
- Sjellja e mëvonshme e të pandehurit si p.sh në gjykatore, me rastin e dorëzimit në polici, gjatë bashkëpunimit me prokurorinë.
- Pranimi i fajit në momentin më të hershëm të mundshëm.

Fatkeqësisht gjejmë raste në praktikën tonë gjyqësore që përkundër ekzistimit të rrethanave të shumta rënduese që lidhen me mënyrën e kryerjes së veprës, veprimeve shumë të rënda të të pandehurit, prapëseprapë gjykata merr si rrethanë jashtëzakonisht lehtësuese “pendimin” dhe “premtimin e të pandehurit”. Kështu në një nga rastet e shumta nga praktika, e cila brenda më pak se një viti ka përfunduar me fatalitet, Gjykata kishte marrë si rrethanë posaçërisht lehtësuese dhe kishte ulur dënimin nën minimumin ligjor duke e zëvendësuar dënimin me burgim me dënim me gjobë, përkundër faktit se në vet aktgjykimin në fjalë janë dhënë indikacione të shkallës së lartë të rrezikshmërisë së të pandehurit “... i njëjti, fillimisht i kërkon djalit t’i përcjellë situatën në shtëpi se kush po hynte e dilte dhe kur ai nuk pajtohet, i urdhëron për tu kthyer te familja ....., me ç’rast edhe vendoset në përcjellje në afërsi të shtëpisë së prindërve të saj për të kontrolluar se kur po kthehet...”<sup>84</sup> Në raste të tilla, por edhe në çdo rast tjetër, pranimi i fajësisë duhet peshuar gjithnjë në raport me rrethanat e kryerjes së veprës dhe përgjegjësisë së të pandehurit e jo si e izoluar.

#### *Dyfishimi dhe kujdesi*

Siç është diskutuar në fillim të rrethanave 3.7-3.12, shumë nga to shfaqin potencial të fuqishëm për t’u dyfishuar me njëra tjetrën. Siç mund të shihet nga lista e cekur më lartë, shumica e këtyre rrethanave citohen tradicionalisht si prova rrethore për ta mbështetur konstatimin për pendimin e të pandehurit, duke rezultuar kështu në zbutje të dukshme. Mirëpo, koha dhe përvoja kanë treguar që shfrytëzimi i këtyre rrethanave si tregues është duke rënë. Me përdorim gjithnjë e më të madh të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe pranimin të fajësisë, caktimi modern i dënimit e ka njohur që veprimet që tradicionalisht iu kanë atribuuar pendimit të të pandehurit ndoshta konsiderohen në mënyrë më të duhur si zgjidhje të llogaritura për zvogëlimin e ekspozimit të madh ndaj dënimit. Kodi penal e njeh këtë konsideratë duke ua caktuar shumicës nga to nga një rrethane specifike. Kjo nënkupton që Gjykata duhet ta kufizojë konsideratën e saj vetëm në ato fakte dhe rrethana që nuk i atribuohen drejtpërdrejt një rrethane tjetër.

Derisa pendimi mund të jetë rrethanë e rëndësishme dhe detyruese për zbutje, mungesa e pendimit nuk duhet të konsiderohet si rrethanë rënduese. Kjo vlen edhe për situatat në të cilat ekziston marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

<sup>84</sup> Cituar nga një Aktgjykim nga praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës.



Në përgjithësi, deklaratat apo kërkim faljet nga i pandehuri duhet të shikohen me skepticizëm pasi që pendimi i rrejshëm mund të jetë pjesë përbërëse e ciklit të dhunës së pranishme në marrëdhëniet e dhunës në familje.

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- Nëse kemi të bëjmë me lëndim të viktimës a ka ofruar i pandehuri trajtim mjekësor? Gjatë kohës në fjalë?
- A i ka shprehur i pandehuri pendim të drejtpërdrejtë viktimës apo dëshmitarëve?
- A ka ndërmarrë i pandehuri hapa për të shfaqur pendim apo pranim të përgjegjësisë?
- A ka shprehur i pandehuri emocion që e mbështetë pendimin?
- A ka kërkuar i pandehuri ndihmë mjekësore/psikologjike pas kryerjes së veprës penale? Në cilën periudhë kohore? A e ka bërë i pandehuri këtë kur e ka parë që nuk mund t'i shmanget kapjes apo pas fillimit të procesit?
- A ka shfaqur aktiviteti apo veprimi pendim të vërtetë apo kjo është bërë për ta zvogëluar përgjegjësinë dhe dënimin?
- A ka shfaqur i pandehuri pendim si përpjekje për ta bindur viktimën që të llobojë për zvogëlim apo heqje të dënimit? Në rast se është situatë e dhunës në familje?
- A i ka zbutur i pandehuri dëmet apo potencialin për shpërndarje të viktimat tjera nëse kjo është e mundshme?

### 3.15. Sjellja e personit të dënuar pas konfliktit<sup>85</sup>

Kjo rrethanë është në shumë aspekte dispozitë që i përfshinë shumë nga rrethanat tjera, prandaj edhe kemi dështim të saj për të dhënë shembuj apo hollësi të mëtutjeshme. Nëse gjykata konstaton që sjellja e të pandehurit ka merituar një masë të zbutjes, por nuk mund ta zbatojë atë te asnjë rrethanë tjetër, Gjykata mund ta zbatojë atë te kjo rrethanë. Kjo mund të përfshijë qëndrimin, sjelljen, veprimet, pranimet, apo çfarëdo sjelljeje tjetër sipas rastit.

Në disa aspekte, përqendrimi në sjelljen pas konfliktit mund të sigurojë më shumë mbështetje për ashpërsim të dënimit sesa në zbutje. Kjo mund të përfshijë:

Shkatërrimi i ndonjë gjurme apo prove të veprës penale (përveç nëse kjo përbën vepër të veçantë penale);

Ndërmarrja e veprimeve të caktuara për t'i bërë presion dëshmitarit dhe ekspertit në cilësi të dëshmitarit për të dhënë dëshmi të rrejshme apo premtimi i ndonjë shpërblimi për arritjen e atij qëllimi (përveç nëse kjo përbën vepër të veçantë penale);

*Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A është sjellja e tillë për ta merituar zbutjen?
- A e mbështetë sjellja aplikimin e ndonjë rrethane tjetër lehtësuese?
- A duket sjellja e ndërlidhur apo si reagim i ndonjë veprimi policor apo zyrtar të bërë rishtazi?

---

<sup>85</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.12, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

3.16. Në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 169, 191 ose 193 të këtij Kodi,... <sup>86</sup>

Rrethana 3.13 do të jetë e zbatueshme për gjykatën vetëm në rrethana të kufizuara. Në mënyrë specifike, kur kemi të bëjmë me veprat penale që ndërlidhen me rrëmbimin, si Marrja e Pengjeve (169), Rrëmbimi (191) dhe Privimi i Kundërligjshëm i Lirisë (193). Në këto rrethana të kufizuara, Gjykatës do t'i duhet t'i vlerësojë të gjitha rrethanat rreth tyre për ta përcaktuar nëse kjo rrethanë do të aplikohet. Në disa aspekte, rrethana tregon një masë të pendimit nga i pandehuri apo së paku një veprim afirmativ në lidhje me viktimën në përpjekje për të siguruar kthim të sigurt. Ajo gjithashtu parasheh zbutje në rrethanat kur i pandehuri ofron informata për identifikimin e të tjerëve, pra bashkëpunon me policinë. Qëllimi është që të sigurohet lehtësim kur një pjesë e veprës penale braktiset që ka pasur gjasa të përfundojë me pasoja më të rënda.

Përveç që bien në njërën nga veprat e cekura, ekzistojnë disa kritere shtesë para se gjykata të mund merr në konsideratë zbutjen. Për zbutje, në lidhje me viktimën, kodi është i qartë që viktima duhet në fakt të mbijetojë. I pandehuri duhet të ofrojë kontribut efektiv për kthim të sigurt të viktimës. Kjo duhet të jetë më shumë se dorëzimi i personit tek autoritetet policore, vepra e dështuar apo ngjarje aksidentale. Duhet të ketë prova që veprimet janë dizajnuar apo formuluar me qëllim të kthimit të viktimës, që kur të vlerësohet tërësia e rrethanave të shihet se ato kanë ndihmuar në sjelljen e rezultatit.

Për zbutje në situatën e dytë, do të kërkohet sigurim vullnetar i informatave në lidhje me bashkë të pandehurit. Masa e zbutjes do të varet në vlerësimin e gjykatës për vullnetarizmin e kontributit të të pandehurit. Nëse i pandehuri, vullnetarisht e braktis veprën penale dhe ofron informata në lidhje me bashkë të pandehurit para përfshirjes së policisë, do të ketë të drejtë për më shumë zbutje se sa kur informatat ofrohen në fund të një intervistimi të gjatë nën kërcënimin e një periudhe të gjatë të burgimit.

#### *Dyfishimi dhe Kujdesi*

Siç është cekur shkurtimisht më lartë, ekziston potencial për dyfishim të kësaj rrethane me rrethanat tjera lehtësuese. Një veprim pozitiv nga ana e të pandehurit që kontribuon në lirimin e sigurt të viktimës e mbështetë teorinë që i pandehuri pjesërisht e ka braktisur qëllimin e tij fillestar dhe po kërkon që ta zbusë rezultatit përfundimtar. Gjykata mund të vjen në përfundim që kjo shfaqë një nivel të pendimit prandaj ka mundësi për dyfishim. Ngjashëm me këtë, ofrimi vullnetar i informatave që ndërlidhet me bashkë të pandehurit dyfishohet në konceptin e bashkëpunimit me policinë. Duke qenë se rrethanat janë aq të ngushta për aplikimin e kësaj rrethane, çdo provë që e mbështetë konstatimin duhet të përqendrohet në këtë rrethanë.

#### *Pyetjet relevante përfshijnë:*

- A ka mbijetuar viktima?
- A janë veprimet e të pandehurit përgjegjëse për kthim të sigurt të viktimës? Nëse jo tërësisht, deri në çfarë mase? A ka qenë kontributi i papërfillshëm?

---

<sup>86</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.13, Në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 169, 191 ose 193 të këtij Kodi,... kontributi në mënyrë efektive për lëshimin ose për ta sjellë të gjallë personin e rrëmbyer, marrë apo ndalur ose dhënia vullnetare e informatave që kontribuojnë në identifikimin e përgjegjësve të tjerë për vepër penale; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

- A do të kthehej viktima e sigurt pa kontributin e të pandehurit?
- A ka qenë kthimi i sigurt i viktimës, qëllimi i veprimeve?
- A ka qenë qëllimi i veprimeve kthimi i sigurt i viktimës?
- A kanë qenë veprimet të motivuara nga intervenimi policor?
- A ka qenë dështimi i veprës penale i afërt me momentin e kontributit?
- A ka qenë policia e vetëdijshme për veprën penale
- A ka qenë kontributi i bazuar në ndonjë masë në braktisjen vullnetare nga i pandehuri?
- A ka qenë i pandehuri në paraburgim kur i ka dhënë informatat apo kontributin?
- A ka rezultuar identifikimi në kapje të kryerësve tjerë?
- A ka qenë kontributi më i madh se sa identifikimi i kryesve tjerë?

### 3.17. Në lidhje me veprat penale të terrorizmit të përcaktuara në këtë Kod...<sup>87</sup>

Rrethana e re e përfshirë me ndryshimet e KPRK-së lidhet me veprat penale të terrorizmit. Kjo rrethanë, në masë të madhe, ka të bëjë me kontributin e të pandehurit në ndihmë organeve të drejtësisë. Sanksionimi i veprave të terrorizmit dhe që ndërliiden me to është i shpërndarë në tre ligje bazike:

- Kodi penal i Republikës së Kosovës<sup>88</sup>
- Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit<sup>89</sup>
- Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.<sup>90</sup>

Siç shihet më sipër, mund të thuhet se ligjvënësi është munduar që të përfshijë kriminalizimin e të gjitha formave të këtyre veprave, pikërisht për shkak të shkallës së lartë të rrezikshmërisë vendore dhe globale. Andaj, për shkak të natyrës së këtyre veprave dhe pasojave që ato mund të bartin, është i pamundur zberthimi i elementeve lidhur me vepra të kësaj natyre dhe rrethanave relevante për to. Megjithatë, një udhëzues i veçantë do të mund të jepte një analizë më të saktë duke ndërthurur të gjitha rrethanat e zbatueshme si në zbutje ashtu edhe në ashpërsim.

Përderisa u tha më lartë se ligjvënësi i ka kushtuar rëndësi të veçantë këtyre veprave, duket qartë se me përfshirjen e rrethanës lehtësuese, si kjo në fjalë, pikërisht për këto vepra paraqet një indikacion se sa është me rëndësi dhe sa vlerësohet zbulimi i hershëm apo edhe parandalimi i këtyre veprave, për të shmangur masivitetin e pasojave që mund të shkaktojnë ato. Për më shumë detaje rreth kësaj rrethane do të flitet edhe në Kapitullin e ndarë që trajton veprat e terrorizmit.

<sup>87</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 paragrafi 3.14, Në lidhje me veprat penale të terrorizmit të përcaktuara në këtë Kod, fakti që kryesi i veprës penale heq dorë nga veprimtaria terroriste para se të ketë pasoja të rënda prej saj dhe i ofron policisë, prokurorëve ose autoriteteve gjyqësore informata të cilat ato nuk do të kishin mundësi t'i siguronin; ndihmon në parandalimin ose zbutjen e efekteve të veprës penale; identifikon me detaje të mjaftueshme për të lejuar arrestimin ose ndjekjen penale të ndonjë terroristi apo grupi terrorist; gjen prova apo parandalon vepra të tjera terroriste, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>88</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>89</sup> Ligji Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 18 / 15 qershor 2016, Prishtinë.

<sup>90</sup> Ligji Nr. 05/L -002 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 7 / 02 prill 2015, Prishtinë.

#### 4. *Rrethanat tjera lehtësuese të marra në konsideratë gjatë praktikës*

Ashtu si rrethanat rënduese, nuk ka kufizime që gjykata të thirret vetëm në ato rrethana të numëruara në Kod. Mirëpo, lista është e përgjithshme dhe e zgjeruar sa duhet sa që shumë gjendje faktike që dëshmojnë nga rrethanat lehtësuese tradicionale do të bien në kuadër të njëres nga këto rrethana. Para se ta lë jashtë këtyre kufijve, Gjykata duhet që me kujdes ta vlerësojë nëse rrethana e menduar është në pajtim me praktikën e caktimit të dënimit e jo thjeshtë e bazuar në mendim personal. Lehtësimi i nënshtrohet shumë më shumë vlerave, normave dhe zakoneve shoqërore se sa ashpërsimi dhe lehtë mund ta pengojë qëllimin për zvogëlimin e dallimeve në dënime.

##### - *Kalimi i kohës*

Një rrethanë tjetër lehtësuese që gjykata mundet në raste të rralla dhe shumë specifike ta merr parasysh nëse kalimi i një periudhe të gjatë kohore ndërmjet kryerjes së veprës dhe kohës kur çështja është duke u trajtuar përfundimisht nga gjykata ka ndonjë vlerë në zbutje. Teoria prapa kësaj rrethane të mundshme i ka disa aspekte. Ndoshta gjykata e ka para vetes një individ i cili pas kryerjes së veprës ka jetuar jetë shembullore, ka prosperuar dhe ka shfaqur indikacione të braktisjes së çdo gjëje që i ngjason jetës kriminale, duke e shmangur nevojën për parandalim personal. Ndoshta gjykata beson që çështja është zbehur sa duhet nga mendjet e publikut dhe që nuk ekziston më kërkesa e menjëhershme për drejtësi apo nevojë të perceptuar për parandalim të përgjithshëm. Apo ndoshta rasti është shumë i vjetër si rezultat i lënies pas dore apo situatës së mëparshme politike.

Cilado nga këto që u cekën më lartë mund të duken arsye të mundshme për zbutjen e dënimit për të pandehurin, mirëpo gjykata duhet t'i qaset kësaj rrethane më një dozë skepticizmi. Ndoshta gjykata nuk është e obliguar që t'i shqyrtojë vetëm rrethanat lehtësuese të cekura në kod, ajo prapëseprapë duhet të veprojë me kujdes, pasi që nëse del përtej mundësive, rrethana mund të jetë kontroverse apo së paku më pak e pranueshme përgjithësisht. Pavarësisht kësaj, gjykata duhet t'i mbajë merr parasysh disa konsiderata.

Së pari, vetë kalimi i kohës nuk është i mjaftueshëm për të zbutur dënimin. Legjislacioni i ka ofruar gjykatave afate procedurale mjaft specifike për seancat si dhe afate të parashkrimit për vepra të caktuara. Këto kontrolle procedurale janë vendosur me qëllim të përcaktimit se kur drejtësia nuk është më e mundshme për shkak të vonesave të vazhdueshme. Për më tepër, metodat alternative ndaj burgimit gjithashtu i shërbejnë qëllimit të ndikimit në minimizimin apo parandalimin e të pandehurit gjatë çdo vonese. Ofrimi i një lloji të zbutjes, qoftë edhe të përshkallëzuar për shkak të vonesave, krijon nxitjen e mbrapshtë të vonesës së proceseve edhe më tutje me shpresë të nxjerrjes së përfitimeve akoma më të mëdha.

Çfarëdo konsiderate e përfitimit të zbutjes për të pandehurin nuk duhet të jepet pa vlerësim të duhur të veprimeve të të pandehurit, posaçërisht nëse vetë veprimet e të pandehurit kanë kontribuar në ndonjërin vonesë apo kalim të kohës për të cilën gjykata po kërkon të jep zbutje (në çfarëdo cilësie). Nëse i pandehuri ka marrë pjesë aktive në krijimin e vonesave, apo shmangien e zbulimit apo identifikimit, gjykata nuk duhet të ketë kurrfarë konsiderate, në asnjë masë, të zbutjes së bazuar në këtë teori. Gjykata duhet ta vlerësojë kontributin e mundshëm të të pandehurit në mënyrë liberale, pasi që sjellja e vazhdimit të qetë të jetës sikur nuk ka ndodhur asgjë, përgjatë një periudhe të gjatë kohore, tregon mungesë të njohjes dhe pranimit që sjellja ka qenë kriminale. Në fakt, ka një logjikë në argumentin që nëse ka kaluar një periudhë e madhe kohore dhe i pandehuri

nuk ka bërë gjëra, si dëmshpërblimi i viktimës, dorëzimi apo bashkëpunimi me gjykatën, kjo në fakt paraqet sjellje të mungesës së rehabilitimit apo pendimit.

Ngjashëm me këtë, gjykata duhet ta rishikojë procesin dhe të vlerësojë nëse ka pasur trajtim jo të duhur të rastit gjatë hetimit apo ndjekjes penale që ka shkaktuar vonesë të padrejtë. Se a do të meritohet zbutje për këtë është çështje kontroverse është e vështirë për t'u vlerësuar. Pavarësisht rrethanave, duhet të ketë prova të qarta të trajtimit të gabuar, përveç thjeshtë kalimit të kohës.

- *Urdhri i lartë*

Në lidhje me mundësinë e pretendimit tradicional të urdhrit nga lartë për të akuzuarin i cili është dashur ta zbatojë atë urdhër (p.sh. një formë e detyrimit), Neni 16 në mënyrë specifike e ndalon përjashtimin e plotë përveç në rrethana shumë të ngushta. Për sa i përket aplikimit të tij si rrethanë lehtësuese, një vlerësim i tillë do të varet shumë nga faktet dhe është i mundshëm vetëm në situata ekstreme, e veçanërisht jo kur ka prova që i pandehuri ka qenë pjesëmarrës me vullnet në kryerjen e veprës penale. Në një situatë të rrallë ku rrethanat mund të çojnë në zbatim të zbutjes, Gjykata duhet ta marrë parasysh nëse do të kategorizohet më mirë në Rrethanën lehtësuese 3.1.

- *Krimet e nderit*

Gjyqtarët nuk duhet ta marrin parasysh zvogëlimin e dënimit për veprat penale të kryera nga anëtari i familjes në bazë të pretendimit të të pandehurit për veprim nga respekti për kulturën, traditën, fenë, apo për kthim të të ashtuquajturit “nder”. Gjykatat duhet të sigurohen që ndalimi i këtyre arsytiveve, asnjëherë nuk konsiderohet si kufizim i të drejtave dhe lirive kulturore a fetare të të pandehurit. Kjo është thelbësisht e rëndësishme në shoqëritë ku jetojnë së bashku komunitete të ndryshme etnike e fetare dhe në të cilat qëndrimet mbizotëruese për pranimin e dhunës në familje dallojnë varësisht nga historiku kulturor apo fetar. Në fakt, neni 46 i Konventës së Stambollit<sup>91</sup> kërkon dënim më të ashpër nëse vepra penale kryhet nga anëtari i familjes apo nga dy e më shumë persona që veprojnë së bashku.

- *Sjellja e mëparshme seksuale e viktimës*

Në shumë shtete, historia e mëparshme seksuale e viktimës vazhdon të përdoret me qëllim që në mënyrë jo të duhur të zhvendoset vëmendja nga i pandehuri te viktima. Historia e kaluar e viktimës nuk është relevante për besueshmërinë e saj. Nuk duhet të jetë as arsye për zvogëlimin e dënimit të pandehurit.<sup>92</sup> Përfundimisht, provat për historinë seksuale të ankueses/të mbijetuarës nuk duhet të merren parasysh për zbutjen e dënimit të të pandehurit.

- *Mbështetja nga viktima*

Dëshirat e viktimës apo familjes së viktimës për trajtim më të butë të të pandehurit nganjëherë merren parasysh për zbutjen e dënimit. Nëse gjykata është duke e shqyrtuar një zvogëlim të tillë, duhet të jetë e vëmendshme për disa çështje. E para, dëshirat e viktimës (dhe dëmshpërblimi), ndonëse shumë të rëndësishme, janë vetëm një komponentë e dënimit të përgjithshëm. Edhe nëse gjykata i heq konsideratat e viktimës në bazë të dëshirës së saj, prapë duhet të japë dënim i cili i plotëson nevojat e shoqërisë për sa i përket drejtësisë, parandalimit etj. Rrethana nuk duhet të jetë vendimtare me rastin e përcaktimit të dënimit përfundimtar. Kur

<sup>91</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunën në familje, e hapur për nënshkrim më 11 maj 2011 në Stamboll, Turqi. Konventa ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2014.

<sup>92</sup> Doracaku për gjyqtarë e prokurorë mbi dhunën në familje, Historiku i viktimës, par.10.7.3 Prishtinë (2016), fq.78.

viktimizimi është i bazuar në pronë apo humbje financiare, dëshirat e viktimës mund të merren në konsideratë më tepër në dënimin përfundimtar. Mirëpo, dënimi i shqiptuar për veprën e dhunës duhet të përcaktohet në bazë të ashpërsisë së veprës, e jo nga dëshirat e shprehura të viktimës.

Së dyti, gjykata duhet të veprojë me shumë maturi nëse vepra ka indikacione të dhunës në familje. Për të bërë zbutje Gjykata duhet të sigurohet që viktima nuk do të ekspozohet ndaj rrezikut të lartë të dhunës së mëtuajtshme. Kjo është detyrë shumë e vështirë në shumicën e rasteve të dhunës në familje. Pajtimi është pjesë themelore e ciklit të dhunës në rastet e dhunës në familje dhe në shumë situata ekzistojnë periudha ku viktima do të vendosë të heqë dorë nga parashtrimi i padisë apo do t'ia falë të pandehurit. Për çdo kërkesë të tillë, historia e mëparshme e marrëdhënies duhet të vlerësohet në mënyrë të detajuar, në veçanti për të parë nëse ka pasur situata të ngjashme më parë ku viktima e ka hequr dorë nga ndjekja. Ekzistojnë një numër i arsyeve të ngjashme përse arsyet shtesë mund të jenë veçanërisht e rëndësishme që ky parim të respektohet në rastet e dhunës në familje.<sup>93</sup>

Nuk duhet që viktima të ndjehet përgjegjëse për dënimin e shqiptuar. Ekziston rreziku që lutja për mëshirë e bërë nga viktima ka qenë e nxitur nga kërcënimet e bëra apo nga frika nga i pandehuri. Pranimi i kërkesave të tilla do t'i rrisë gjasat e përsëritjes së veprës në të ardhmen dhe i tregon të pandehurit dhe abuzuesve tjerë që ata mund ta kontrollojnë rezultatin duke e kontrolluar viktimën.

---

<sup>93</sup> Po aty. Dëshirat e viktimës dhe efekti i tyre në dënim, fq.79.


## VI. Fazat e matjes së dënimit

### 1. Çështje të përgjithshme

Secili nga titujt e mëposhtëm i dedikohet fazave të ndryshme për matjen e dënimit. Në përgjithësi, kjo kornizë ndjek, për aq sa është e mundur, dispozitat e nenit 69.1 të KPRK-së, i cili thotë: *"Kur cakton dënimin për veprë penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë veprë penale. Gjykata pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin."*

Vlerësimi dhe matja e dënimit zhvillohet sipas hapave në vijim:

- Konstatimi i dënimit të paraparë me ligj për atë veprë.
- Përcaktimi i pikënisjes.
- Vlerësimi i qëllimit dhe parimeve të dënimit.
- Vlerësimi i argumenteve të palëve për rrethanat rënduese dhe lehtësuese.
- Caktimi i peshës së rrethanave dhe të siguruarit që të njëjtat nuk paraqesin element të veprës penale..
- Përcaktimi nëse janë të mundshme, proporcionale dhe adekuate dënimet alternative dhe/apo plotësuese për atë veprë.
- Caktimi i dëmshpërblimit/ kompensimit.
- Konfiskimi i përfitimeve apo dobisë së fituar me veprë penale.
- Arsyetimi hap pas hapi i konsideratave me rastin e matjes së dënimit.



### 2. Pikënisja

Rekomandimi i Këshillit të Evropës lidhur me harmonizimin e dënimeve thotë: *"Kurdo që është e përshtatshme për kushtetutën dhe traditat e sistemit juridik, mund të merren parasysh disa teknika shtesë për rritjen e harmonizimit të dënimeve. Dy teknika të tilla të cilat janë përdorur në*

*praktikë janë "orientimet në caktimin e dënimit" dhe "pikënisjet". Orientimet në caktimin e dënimit nënkuptojnë kufij të dënimeve për forma të ndryshme të një veprë, varësisht nga prania apo mungesa e rrethanave të ndryshme rënduese apo lehtësuese, por gjykatave u mbetet diskrecioni për t'u shmangur nga orientimet. **Pikënisjet nënkuptojnë një dënim bazik për forma të ndryshme të një veprë, prej të cilës gjykata mund të lëvizë poshtë apo lart për të reflektuar rrethanat rënduese apo lehtësuese.** Në veçanti, për vepra penale të kryera shpesh apo për vepra penale më pak të rrezikshme apo për vepra që janë të përshtatshme, duhet marrë parasysh inkuadrimitin e ndonjë forme të orientimeve apo pikënisjeve për caktimin e dënimit si një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të dënimeve”<sup>94</sup>*

Pikënisjet e përcaktojnë pozitën brenda shkallës së kategorisë prej të cilës duhet filluar llogaritja e dënimit. Me të përcaktuar pikënisjen, gjykata duhet të merr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe dënimet e mëparshme për ta përshtatë dënimin brenda kufijve. Pikënisjet dhe kufijtë zbatohen për të gjithë të pandehurit, pavarësisht nëse kanë pranuar fajësinë apo janë shpallur fajtor pas shqyrtimit gjyqësor. Lehtësimet për pranimin e fajësisë merren parasysh vetëm pasi të jetë identifikuar dënimi përkatës.

**Për dallim nga Udhëzuesi i vitit 2018 kur ishte vendosur mesatarja në mes minimumit dhe maksimumit të paraparë ligjor, si pikënisje për të gjitha dënimet e parapara me Kod Penal, me revidimin e Udhëzuesit është vendosur një qasje më e ndryshme. Kështu, siç do të vëreni edhe nga pjesa e veçantë për secilin Kapitull të KPRK-së, janë caktuar edhe shkallë të ndryshme të pikënisjes dhe atë 1/3, 1/2 apo 2/3 në mes minimumit dhe maksimumit të paraparë ligjor.** Edhe pse, në fakt ligjvënësi ka paraparë një minimum dhe maksimum ligjor, ka qenë mendim i përgjithshëm i gjyqtarëve që Udhëzuesi i reviduar të ketë ndryshim pikërisht në aspektin e caktimit të pikënisjes. Pikënisje të ndryshme janë dedikuar edhe brenda të njëjtit kapitull të KPRK-së dhe atë varësisht nga ajo se sa ato vepra paraqesin rrezikshmëri shoqërore, apo nga ajo se ndoshta veprat e një kategorie janë më të përhapura përgjatë një periudhe të caktuar kohore, dhe është interes shtetëror që të ketë një politikë më të ashpër si në ligjvënien ashtu edhe në implementim. Përmes një shkallëzimi të tillë, Gjykata Supreme synon që Udhëzuesin ta bëjë sa më të zbatueshëm për gjyqësorin.

Në përgjithësi, KPRK-ja parasheh kufij më të gjerë për vepra më të rënda penale dhe kufij më të ngushtë për vepra më pak të rënda. Njëkohësisht, përpos vendimmarrjes brenda kornizës ligjore të sanksionit, KPRK-ja, në raste të caktuara, varësisht nga rrethanat i jep diskrecionin gjykatës që të vendosë dënim nën minimumin apo mbi maksimumin ligjor.

Përcaktimi i pikënisjes prek një numër të çështjeve të identifikuar më herët:

- **Së pari, e përcakton një nivel bazë të caktimit të dënimit i cili është lehtë i kuptueshëm nga publiku dhe forcon ligjshmërinë e procesit të matjes së dënimit.** Nuk kontestohet se publiku është i pavetëdijshëm për lartësinë e dënimit, së paku në fillim. Kjo i jep mbështetje argumentit se komponenti primar i çfarëdo niveli efektiv të preventivës së përgjithshme është ndërgjegjësimi për llojin dhe lartësinë e dënimit për secilën veprë.
- Së dyti, kjo e vë sistemin dhe të pandehurin në një pozitë më të mirë për të negociuar marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, për të pranuar fajësinë apo zgjidhjet tjera alternative. **I pandehuri i cili e di se gjykata, në mungesë të rrethanave lehtësuese apo rënduese, do të shqiptojë një dënim sipas pikënisjes, vlerëson më mirë nëse është në interesin e tij që t'i**

<sup>94</sup> Rekomandimi Nr. R (92) 17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me konsistencën në dënime (Miratuar nga Këshilli i Ministrave më 19 tetor 1992).



**konsiderojë zgjidhjet e sipërpërmendura në vend se ti nënshtrohet një gjykimi të gjatë e të mundimshëm. Kjo do të rrisë efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.**

- **Së fundi, kjo zvogëlon larminë e politikës ndëshkimore.** Derisa ndikimi i larmisë është relativisht minimal kur kufiri në dispozicion të gjykatës është i vogël, sa më i gjerë të jetë kufiri në mes minimumit dhe maksimumit, aq më i madh është ndikimi i pikënisjes së pa harmonizuar. Me përcaktimin e pikënisjes, të gjitha gjykatat e fillojnë procesin matjes së dënimit njësoj dhe rrjedhimisht edhe rezultojnë në trajtim të ngjashëm të kryesve për vepra të ngjashme.

Në fund të këtij hapi, gjykata do t'i ketë identifikuar informacionet bazë të cilat i nevojiten për të bërë individualizimin e dënimit të të pandehurit të caktuar duke vlerësuar rrethanat e pranishme rënduese dhe lehtësuese. Gjykata i ka kufijtë minimal dhe maksimal të dënimeve, pikënisjen dhe mundësinë eventuale për të shqiptuar gjobën, si dënim kumulativ apo si zëvendësim i plotë. Këto informacione duhet të trajtohen nga gjykata si informata pre supozuese lidhur me caktimin e dënimit. Kjo nënkupton që gjykata, në shumicën apo në rrethana "normale", do të vendos për caktimin e dënimit në kuadër të këtyre informacioneve. Gjykata mund të shmangët nga kjo bazë vetëm kur arrin në përfundimin se ka rrethana të mjaftueshme jashtë normës apo të pandehurit "të zakonshëm" për të arsyetuar shmangien e tillë. Kjo është në pajtim me paragrafin 1 të nenit 70 lidhur me rregullat e përgjithshme të zbutjes dhe të ashpërsimit të dënimit i cili thotë se "kryesit të veprës penale i shqiptohet dënimi i paraparë për veprën e kryer penale, ndërsa dënimi më i butë ose më i rëndë mund të shqiptohet vetëm në pajtim me kushtet e parapara me këtë Kod".

### ***3. Caktimi i peshës së rrethanave***

Porsa gjykata t'i ketë vlerësuar si duhet të gjitha rrethanat e mundshme rënduese dhe lehtësuese, mbështetjen e tyre faktike dhe nëse ato janë relevante apo jo, ajo duhet të angazhohet në vlerësim kuantitativ. Hapi i 4-t përfshinë vlerësimin dhe caktimin e peshës për secilën rrethanë të pranishme, duke i krahasuar dhe baraspeshuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe duke vlerësuar nëse ka në dispozicion rregullime shtesë.

Caktimi i peshës së rrethanave kërkon nga gjykata që të angazhohet në një proces me dy hapa. I pari, vlerësimi i secilës rrethanë ka rëndësi të brendshme. I dyti, gjykata duhet ta përcaktojë seriozitetin e përgjithshëm të veprës. Derisa në vendet si SHBA dhe Britani e Madhe ekziston një formulë pothuajse matematikore në përcaktimin e peshës së rrethanave, në Republikën e Kosovës një matje e tillë është e kufizuar. Si një demokraci e re, e cila po përpiqet që të përqafojë praktikatat e vendeve tjera, një matje e tillë është mjaft komplekse andaj edhe te ne është përqaftuar mendimi që matja e peshës së një rrethane të lihet në diskrecion të gjykatës duke e krahasuar atë rrethanë në raport me atë se sa janë të shprehura si rrethanat lehtësuese, ashtu edhe ato rënduese.

#### *Rëndësia e brendshme e rrethanës*

Në shumë situata, vlerësimi i rrethanave do të jetë thjeshtë një vlerësim nëse ato ekzistojnë apo jo. Për ato situata ku rrethanat nuk ekzistojnë, Gjykata thjeshtë mund të kalojë në rrethanën tjetër dhe të mos e shqyrtojë atë. Mirëpo, kur një rrethanë nuk ekziston, vlerësimi nuk ndalet aty. Gjykata pastaj duhet ta vlerësojë peshën që do t'i jepet secilës rrethanë. Përcaktimi i peshës së rrethanës kërkon nga gjykata krijimin e një strukture hierarkike brenda rrethanës së caktuar dhe pastaj vlerësim të asaj se ku bie rasti i caktuar në kuadër të asaj hierarkie. Kjo do të krijojë peshë relative për atë rrethanë.

Një shembull klasik e përfshinë të pandehurin i cili e pranon fajësinë gjatë procesit gjyqësor. Vetëm për shkak se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, ai/ajo nuk ka të drejtë automatikisht që të marrë sasinë maksimale të zbutjes për shkak se e ka bërë këtë. Brenda kësaj rrethane ekzistojnë një sërë nivelesh që ndikojnë në rëndësinë e rrethanës individuale. Një i pandehur i cili e pranon fajësinë në mundësinë e parë që i jepet duhet të marrë zbutjen maksimale në dispozicion për këtë rrethanë lehtësuese. Si krahasim, i pandehuri i cili e pranon fajësinë pak para gjykimit mund të përfitojë nga zbutja, mirëpo do të jetë substancialisht më pak. i pandehuri i cili e pranon fajësinë gjatë gjykimit nuk do të marrë pothuajse asnjë përfitim nga pranimi. Nëse e konsiderojmë që përfitimi i përgjithshëm për sistemin për sa i përket shpenzimit të burimeve është qëllimi i lejimit të zbutjes për pranim të fajësisë, atëherë sa më shumë burime që të kursehen aq më shumë zbutje do të ofrohet.

Për secilën rrethanë gjykata duhet të bëjë analiza për ta përcaktuar nëse i pandehuri ka të drejtë që të ketë përfitim të plotë të rrethanës në bazë të fakteve të prezantuara. Secila rrethanë e paraqitur në pjesët e paraqitura me pjesët e mëparshme për rrethanat lehtësuese dhe rënduese i parashohin disa ndarje të mundshme për t'u marrë në konsideratë nga gjykata, mirëpo lista nuk është shteruese.

#### ***4. Serioziteti i veprës penale***

Posa gjykata ta ketë përfunduar shqyrtimin e të gjitha rrethanave, ta ketë përcaktuar praninë e tyre dhe vlerësuar vlerën e tyre të brendshme, hapi i radhës është që ta përcaktojë seriozitetin e përgjithshëm të veprës në bazë të rrethanave që janë në mënyrë taksative të numëruara në KPRK, por jo vetëm. Serioziteti është komponenti kyç i përcaktimit të dënimit përfundimtar dhe është kombinim i shqyrtimit të dy aspekteve kyçe, fajësisë së të pandehurit në kryerjen e veprës dhe dëmi i shkaktuar nga vepra penale. Në përgjithësi, sa më e lartë fajësia e të pandehurit dhe dëmi i shkaktuar, aq më i lartë duhet të jetë dënimi. Serioziteti nuk do t'i përfshijë të gjitha rrethanat e cekura në KPRK, por vetëm ato që tradicionalisht konsiderohen të duhura. Posa të jetë vlerësuar serioziteti, mund të merren në konsideratë edhe rrethanat tjera të mbetura.

Me shqyrtimin nga ana e gjykatës së këtyre dy rrethanave duhet të theksohet prapë që NUK duhet të ketë llogaritje të dyfishtë të rrethanave nëse ato janë element i veprës penale. Siç është diskutuar më herët, Kodi Penal përmban shumë vepra penale derivuese që tashmë marrin në konsideratë rrethanat e parapara në ligj të numëruara më poshtë, ato nuk mund të përdoren prapë për ta shqyrtuar seriozitetin e veprës penale. Përveç kësaj, siç është shpjeguar më herët, rrethanat e numëruara më poshtë kanë potencial për t'u dyfishuar me njëra tjetrën. Gjukata duhet të jetë e kujdesshme për të mos e marrë parasysht cilindo fakt të një rasti të caktuar për më shumë se një rrethanë.

#### ***5. Rrethanat që tregojnë për shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit***

Rrethanat në vijim janë rrethana relevante për të përcaktuar nivelin e përgjegjësisë së të pandehurit. Këto rrethana do të tregojnë që i pandehuri ka qenë pjesëmarrës me dashje dhe ka qenë kontribues i madh ose arkitekt i veprës apo, e kundërta, pjesëmarrja ka qenë minimale apo ka pasur rrethana që ndikojnë në nivelin e vlerësuar të pjesëmarrjes. Në përgjithësi, shkalla e ndryshme e përgjegjësisë do të dallojë nga niveli i një të pandehuri të zakonshëm.

**(i.) Shkallë më e lartë e përgjegjësisë**

a. Rrethanat e cekura në ligj

- 2.1 shkalla lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale;
- 2.2. shkalla e lartë e dashjes nga ana e personi të dënuar;
- 2.11. nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal;
- 2.9. çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale;
- 2.10. dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar.

b. Rrethanat që nuk janë cekur në ligj

- Nëse i pandehuri qëllimisht ka shkaktuar dëm më të madh se që ka qenë e nevojshme për kryerjen e veprës penale
- Nëse i pandehuri i ka shënjestruar viktimat për shkak të cënueshmërisë, moshës apo motive të ulëta

**(ii.) Shkallë më e ulët e përgjegjësisë**

- 3.1. rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore;
- 3.4. dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale;
- 3.5. fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër;
- 3.2. dëshmia për provokim nga ana e viktimës;
- 3.6. moshë e personit të dënuar, i ri apo i moshuar;

**6. Rrethanat që kanë ndikim në nivelin e dëmit**

Rrethanat në vijim janë rrethana relevante për të përcaktuar nivelin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Në përgjithësi këto rrethana do të tregojnë që vepra penale ka pasur shkallë më të lartë apo më të ulët se ajo e theksuar nga dispozitat specifike të veprës penale në Kod. Këto mund të përfshijnë numrin e viktimave apo shkallën e lëndimit të viktimave.

**(i.) Shkallë më e lartë e dëmit**

a. Rrethanat e cekura në ligj

- 2.3. prania e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale;
- 2.4. nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore;
- 2.5. nëse vepra penale përfshin disa viktima;
- 2.6. nëse viktimat e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme;
- 2.7. moshë e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar;
- 2.8. shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përherëshëm, transmetimin e sëmundjes te viktimat apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimës ose familjes së saj/tij;

b. Rrethanat që nuk janë cekur në ligj

- Nëse i pandehuri qëllimisht ka shkaktuar dëm më të madh se që ka qenë e nevojshme për kryerjen e veprës penale dhe niveli i dëmit nuk është cekur si rrethanë e cekur më lart.
- Niveli i dëmit jo fizik të shkaktuar apo humbja financiare ka qenë dukshëm më e madhe se që ka qenë e nevojshme apo është shkaktuar përveç dëmit fizik.

## (ii.) Shkallë më e ulët e dëmit

3.7. dëshmia që personi i dënuar ka bërë dëmshpërblimin apo kompensimin e viktimës;

### 7. Rëndësia relative dhe qëllimet e dënimit

Përveç rregullave të përgjithshme për përcaktimin e peshës së secilës rrethanë të përshkruar më lartë, Gjykata duhet t'i merr parasysh edhe aspektet në vijim për ta përshtatur edhe më tutje dënimin.

**E para është rëndësia relative.** Siç është diskutuar në tërë Udhëzuesin, jo të gjitha rrethanat duhet/do të konsiderohen të barabarta njëra me tjetrën në llogaritjen e përgjithshme. Rekomandimi i Këshillit të Evropës në lidhje me njëtrajtshmërinë e dënimeve thotë: “Kurdo që është e mundshme, ligji apo praktika duhet të bëjë përpjekje për përkufizimin edhe të këtyre rrethanave të cilat duhet të konsiderohen relevante për sa i përket veprave të caktuara.”<sup>95</sup> Në përgjithësi duhet të zbatohen parimet në vijim:

*Ashpërsimi i dukshëm:*

- Trauma/lëndimi i vuajtur nga viktimat(t)
- Cenueshmëria e viktimës(ave)
- Mizoria e shkaktuar
- Keqpërdorimi i autoritetit apo besimit
- Pjesëmarrja e shprehur

*Zbutja e dukshme:*

- Pendimi/përpjekjet për minimizim të ndikimit
- Pranimi i fajit
- Pjesëmarrja indirekte/ pjesëmarrja përmes presionit
- Bashkëpunimi me autoritetet
- Njohuria e kufizuar e veprimeve
- Konsiderata e ulët
- E kaluara kriminale (përveç nëse është recidivist)
- Mosha
- Karakteri i mirë
- Statusi familjar

**Elementi i dytë që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të rrethanave relevante rënduese dhe lehtësuese për shqiptim të dënimit është që ato duhet të jenë koherente me synimin që e ka dënimi.** Për shembull, nëse njëri nga synimet kryesore është rehabilitimi apo risocializimi, atëherë rrethanat si pendimi dhe bashkëpunimi i të pandehurit do të marrin rol dhe rëndësi qendrore në caktimin e dënimit. Ndërsa nëse qasja ndëshkuese mbizotëron në caktimin e dënimit, duhet të mbizotërojnë rrethanat që ndërlidhen me rolin e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale dhe me dëmin e shkaktuar viktimës. Kjo do të inkurajojë, për shembull, dënime më të rënda për vepra penale në të cilat është shkelur pozita e besimit apo autoritetit dhe për veprat penale të kryera me mizori, sadizëm apo të motivuara nga paragjykimi, diskriminimi apo urrejtja për viktimat veçanërisht të cenueshme dhe të shqiptojnë dënime më pak të ashpra në lidhje me rastet

ku kemi pendim dhe bashkëpunim me të akuzuarin, prokurorin dhe autoritetet gjyqësore. Ashtu si te shqyrtimi i rrethanave të rëndësishme, për hir të thjeshtësisë, sugjerohet që thjeshtë të bëhet zvogëlim deri në 25% për ato rrethana që nuk ndërlidhen drejtpërsëdrejti me qëllimet e përgjithshme të caktimit të dënimit që gjykata i ka identifikuar. Nëse gjykata e ka marrë qasjen që të gjitha qëllimet e dënimit janë njëlloj të rëndësishme, nuk do të ketë nevojë të angazhohet në këtë akordim.

Ajo që është e dukshme është që rrethanat që merren parasysh në përcaktimin e dënimeve janë të natyrës së ndryshme, por esencialisht të ndërlidhura me: qëllimet e caktuara për dënimin, ndikimin që ushtrohet nga parimet e përgjithshme, rrethanat specifike të rastit dhe aspektet e tij procedurale.

## **8. Ndalimi i llogaritjes së dyfishtë të rrethanave**

Njohja e konceptit të llogaritjes së dyfishtë të rrethanës nga ana e gjykatës është shumë e rëndësishme për vlerësimin e drejtë të rrethanave rënduese dhe lehtësuese. Ky problem ndodh në disa raste të cilat diskutohen më hollësisht në vijim.

Së pari, ekziston rreziku potencial për shkeljen e parimit *ne bis in idem* gjatë dënimit duke ndëshkuar të njëjtin të pandehur dy herë për sjelljen e njëjtë: fillimisht për përgjegjësinë e tij individuale dhe pastaj duke përdorur të njëjtat fakte për ta ashpërsuar dënimin përfundimtar duke i zbatuar ato si rrethanë rënduese. Gjykata nuk duhet t'i merr parasysh ato rrethana të cilat janë element i veprës penale edhe për ashpërsimin e dënimit, pasi që ato tashmë janë marrë në konsideratë kur ligjvënësi ka përcaktuar nivelin e kufirit të dënimit të paraparë për atë vepër.

Për shembull, për veprën penale të grabitjes nga neni 317, gjykata nuk mund ta marrë si rrethanë rënduese faktin se vepra është kryer me kanosje apo përdorim të dhunës pasi që kanosja/përdorimi i dhunës është element i veprës penale.

Në mungesë të dhunës apo kanosjes për përdorim të dhunës, vepra cilësohet si vjedhje e thjeshtë dhe bart dënimin deri në 3 vjet.

Ngjashëm, ndonëse ndodh më rrallë, nëse dënimi më i ulët (shpesh edhe nën minimumin ligjor) është bazuar në ndonjë rrethanë ligjore, të njëjtat fakte nuk mund të përdoren si rrethanë lehtësuese për uljen e mëturjeshme të dënimit. Për shembull, neni 159 i KPRK-së parasheh veprën penale të rrezikimit të sigurisë së aviacionit civil dhe parasheh se kushdo që e drejton fluturaken në mënyrë jo të rregullt dënohet me burgim prej 1-10 vjet. Paragrafi 6 i këtij neni në mënyrë specifike parasheh se nëse vepra kryhet nga pakujdesia dënimi ulet deri në 5 vjet burgim. Pasi që niveli i zvogëluar i fajësisë është zbatuar kur janë formuluar kufijtë e dënimeve për kryerjen e kësaj vepre nga pakujdesia, atëherë gjykata nuk mund t'i përdorë të njëjtat fakte për të ulur më tutje dënimin duke u thirrur në rrethanën lehtësuese nga paragrafi 3.1 si rrethanë e cila për pak nuk arrin të jetë bazë për përjashtim të përgjegjësisë penale. Ndonëse këto situata nuk janë aq të theksuara sa situatat që kanë të bëjnë me rrethanat rënduese, megjithatë gjykata duhet të ketë kujdes edhe në këto raste.

Më konkretisht, si ilustrim do marrim disa raste nga praktika gjyqësore kur është vërejtur një dyfishim i tillë:

Kështu në një rast lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 1 i KPRK-së, gjykata me rastin e matjes së dënimit, përveç tjerave, si rrethanë rënduese ka marrë edhe faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, respektivisht ndaj ish-

bashkëshortes.<sup>96</sup> Në këtë rast gjykata gabimisht ka bërë dyfishim të së njëjtës rrethanë, kjo për faktin se dhuna në familje (sipas nenit 248) si element kryesor ka kryerjen e veprës brenda marrëdhënies familjare. Këtë çështje e trajton shumë mirë Udhëzimi i Gjykatës Supreme për trajtimin e rasteve të dhunës në familje<sup>97</sup>

Në një tjetër rast gjykata duke trajtuar veprën penale Vrasje nga pakujdesia nga neni 175 si rrethanë e parë e cilësuar e përmendur është marrë fakti se “*shkalla e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar është shumë e rëndë pasi që përfshin vdekjen e viktimës*”.<sup>98</sup> Në këtë rast kemi dyfishim pasi vdekja e viktimës është element qenësor i kësaj vepre.

Një fushë tjetër ku gjykata duhet të ketë kujdes që të mos bëjë llogaritje të dyfishtë është koncepti i rrethanave që përkojnë me njëra tjetrën, të cilat mund të ndodhin si për rrethanat lehtësuese ashtu edhe për ato rënduese. Kjo ndodh pasi që Kodi parasheh një kategori të gjerë të rrethanave rënduese dhe lehtësuese të cilat gjykata mund t’i përdorë. Gjykata pashmangshëm do të ballafaqohet me ndonjë rrethanë e cila logjikisht zbatohet për më shumë se një kategori. Ndonëse reagimi fillestar mund të jetë që të njëjtën rrethanë ta merr parasysht në të dyja kategoritë dhe ta trajtojë si të tillë që përmbush dy rrethana rënduese apo lehtësuese, kjo gjithashtu përbën llogaritje të dyfishtë dhe duhet të shmanget nga gjykatat.

Për shembull, KPRK-ja parasheh pranimin e fajit si rrethanë lehtësuese në paragrafin 3.10. Kodi gjithashtu parasheh keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri si rrethanë lehtësuese në paragrafin 3.11. Mund të argumentohet se pranimi i fajësisë është provë e keqardhjes dhe rrjedhimisht mund të merret parasysht nga gjykata gjatë vlerësimit nëse vërtet ekziston keqardhja apo pendimi nga paragrafi 3.11. Logjika këtu është se i pandehuri, duke pranuar fajësinë, tregon së është duke marrë përgjegjësinë për veprimet e tij dhe se është penduar për to. Ndonëse kjo në vetvete mund të mos jetë bindëse, mund të bëhet faktor i rëndësishëm kur bëhet bashkë me prova shtesë për vlerësimin e tërësishëm të rrethanave. Ngjashëm, mund të argumentohet se i pandehuri i cili bën kompensimin sipas paragrafit 3.7 gjithashtu shfaq një lloj pendimi. I pandehuri i cili provon ta zhdëmtojë viktimën përmes kompensimit me gjasë ka marrë përgjegjësinë për veprimet e tij dhe është duke shprehur një lloj pendimi. Në të dyja rastet, gjykata duhet t’ia atribuojë faktet vetëm njërës rrethanë lehtësuese. Duke ia atribuar këtë më shumë se një rrethane lehtësuese, gjykata bën llogaritje të dyfishtë të fakteve që ka para vetes dhe në mënyrë jo të drejtë merr parasysht më shumë rrethana lehtësuese sesa që i pandehuri meriton.

E njëjta gjë vlen edhe për rrethanat rënduese. Mund të argumentohet se nëse viktimja është e re, rrethanë kjo rënduese sipas paragrafit 2.7 (mosha e viktimës), gjithashtu mund të kontribuojë në faktin se viktimja ka qenë e ndjeshme sipas paragrafit 2.6. Apo nëse gjykata arrin në përfundim se viktimja ka qenë veçanërisht e ndjeshme, kjo gjetje mund të kontribuojë në arritjen e përfundimit se vepra është kryer në “mënyrë posaçërisht mizore” sipas nenit 2.4. Logjika këtu është se niveli i lëndimit kur kemi të bëjmë me viktimja të ndjeshme shtohet dukshëm dhe mund ta çojë atë në kategorinë e “mënyrës posaçërisht mizore”. Sërisht, gjykata duhet ta kufizojë veten në dallimin e rrethanave dhe të mos i zbatojë ato në më shumë se një rrethanë. Nëse është ndonjë rrethanë diskrete e paraparë në nenin 70, atëherë duhet të mbetet konsideratë e veçantë nga gjykata.

Fusha e fundit e konfliktit potencial mund të shfaqet kur kemi të bëjmë me disa akuza për të cilat ekzistojnë fakte të cilat janë edhe element i ndonjëres vepër penale dhe gjithashtu mund të përdoren si rrethana rënduese apo lehtësuese për ndonjë vepër tjetër sipas nenit 70. Pyetja kryesore

<sup>96</sup> Cituar nga një Aktgjykim nga praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës

<sup>97</sup> Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Udhëzim lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr.113/2020, Prishtinë, 12/06/2020.

<sup>98</sup> Cituar nga një Aktgjykim nga praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës

është se çfarë ndodh kur i pandehuri lirohet nga akuza për veprën e cila e përmban atë rrethanë si element të veprës penale? Për shembull, i pandehuri akuzohet për dy vepra, ku për njëren prej tyre përdorimi i dhunës është element i veprës penale dhe e rrit automatikisht kufirin e dënimit të mundshëm, dhe për tjetrën ku përdorimi i dhunës mund të merret si rrethanë rënduese sipas neni 70. Nëse i pandehuri lirohet nga akuza për veprën e parë dhe shpallet fajtor për të dytën, gjykata duhet të përcaktojë në mënyrë specifike nëse elementi i përdorimit të dhunës ka qenë komponentë faktike e gjetjes së pafajësisë. Me fjalë tjera, a ka gjetur gjykata se nuk ka pasur përdorim të dhunës? Nëse po, atëherë gjykata në mënyrë afirmative ka konkluduar se kjo rrethanë nuk ekziston, dhe rrjedhimisht nuk mund ta përdor si rrethanë rënduese gjatë matjes së dënimit për veprën e dytë. Nëse jo, atëherë gjykata është e lirë që ta merr parasysh si rrethanë rënduese nga neni 70.

Për dallim, nëse skenari i mësipërm rezulton në shpalljen fajtor për të dyja veprat, situata do të jetë ndryshe. Në atë rast, vepra për të cilën përdorimi i dhunës është element i veprës do të konsiderohet si formë e cilësuar e veprës. Megjithatë, gjykata nuk mund të zbatojë rrethanën nga neni 70 për veprën e dytë.

Në fund, në rastet e shpalljes fajtor për disa vepra, përdorimi i rrethanave nga neni 70 duhet të bëhet në kontekst të dënimit të përgjithshëm e jo të dënimeve individuale.

## 9. Zbutja e dënimit

Ekziston për të arsyetuar që kur niveli kuantitativ dhe kualitativ i rrethanave lehtësuese e mbipeshon atë të rrethanave rënduese, kjo natyrshëm do ta vë të pandehurin në situatë jashtë normës së rasteve normale apo tipike. Andaj, gjykata duhet të jetë shumë e bindur që kjo nuk është situatë e zakonshme. Kur situata është veçanërisht e pazakonshme, kodi i parasheh disa rrethana të veçanta në të cilat fundi i poshtëm i kufirit të dënimit mund të shtyhet edhe më poshtë. Neni 71<sup>99</sup> dhe 72<sup>100</sup> ia sigurojnë gjykatës kufizimet brenda të cilave mund të bëhet edhe zbutja dhe ulja e mëturjes dhe e kufijve. Duke qenë se ky lloj i zbutjes mund të ketë ndikim shumë të rëndësishëm në dënimin përfundimtar, në veçanti për shkak se sasia nuk është rregulluar në përpjesëtim me kufijtë e dënimit fillestar, Gjykata duhet të jetë shumë e kujdesshme në zbatimin e tyre dhe t'i rezervojë ato vetëm për situatat më të përshtatshme.

Neni 71 parasheh rregullimin e fundit të poshtëm të kufijve për dënimet në 3 rrethana specifike si në vijim:

1. Gjkata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit:

- 1.1. kur ligji parasheh që dënimi i të pandehurit mund të zbutet apo të zvogëlohet;
- 1.2. kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; ose
- 1.3. në rastet kur i pandehuri pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Nëse gjykata konstaton që ekziston njëra nga rrethanat e cekura më lartë, lejohet që ta ulë fundin e poshtëm të kufijve të dënimit deri në sasinë e specifikuar në nenin 72 të kodit. Andaj, për

<sup>99</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 71 Zbutja e dënimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>100</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 72 Kufijtë e zbutjes së dënimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

shembull, të gjitha dënimet që e kanë të vendosur si minimum 10 apo më shumë vite si dënim përfundimtar, mund të zbutet në minimum të ri të dënimit prej 5 viteve. Sipas paragrafit 1, dënimet me minimum prej 5 viteve dhe më pak se 10 vjet, mund të akordohen edhe përtej kufirit të poshtëm në 3 vjet. Kjo strukturë shkon deri te mundësia e zëvendësimit me gjobë për ndonjë dënim për të cilin me ligj nuk parashihet periudha minimale e burgimit.

Nuk ka ASNJË kriter që nëse zbatohet neni 71, Gjykata duhet ta zbatojë zvogëlimin sipas nenit 72. Për më tepër, NUK kërkohet që të jepet as sasia maksimale në asnjë situatë. Është e lejueshme që Gjykata të përcaktojë se në bazë të tërësisë së rrethanave dhe duke e marrë parasysh rastin specifik, nuk do të jepet zbutja e dënimit andaj edhe nuk është bërë asnjë akordim. Gjithashtu është e lejueshme që gjykata të përcaktojë që zbutja në maksimum nuk është e përshtatshme, por vetëm e një pjese. Për shembull, i pandehuri është fajtor për kryerjen e veprës penale që bart kufijtë e dënimit prej 3-5 vjet (Kategoria V dënimi b). Nëse i pandehuri eventualisht e pranon fajësinë, atëherë gjykata mund ta merr në konsideratë zbutjen ashtu siç vlen në nenin 71 paragrafin 1.3. Sipas nenit 72, gjykata mund ta ulë dënimin në një vit. Siç është sqaruar më lartë, gjykata NUK ËSHTË E OBLIGUAR që ta zbatojë zbutjen nga neni 71 – kjo është thjeshtë një mundësi. Gjithashtu, gjykata nuk është e obliguar që të pandehurit t’ia shqiptojë dënimin prej 1 viti sipas nenit 72. Nëse për shembull i pandehuri e pranon fajësinë në momentin e fundit të mundshëm, gjykata mund të përcaktojë që ndonëse mund të zbatohet zbutja, ajo nuk është e obligueshme, apo e obligueshme në më pak se gjysmën e dënimit maksimal.

Gjykata duhet “veçanërisht” ta shqyrtojë maksimumin dhe minimumin e dënimit të paraparë në kod. Kjo dispozitë është paraparë për shkak të akordimit të qasjes së gjykatës në frymën e numrit të madh të dënimeve që përdoren në kod dhe në veçanti për shkak se maksimumi i tyre mund të jetë shumë i larmishëm. Nëse zbutja e dënimit zbatohet pro forma në çdo dënim, kjo bie në nenin 71 dhe mund të ketë ndikim shumë jo proporcional. Le ta marrim për shembull dënimin 3-5 vjet. Nëse zbutet minimumi i ri i mundshëm në një vit, i njëjti zvogëlim është në dispozicion edhe për dënimin me së paku 4 vjet. Në shkallën e parë, përfitimi maksimal i mundshëm nga zvogëlimi në një vit është 4 vjet (nga maksimumi prej 5 vjetëve). Në rastin e së paku 4 vjetëve, që nuk ka maksimum (25 vjet sipas kodit), zvogëlimi i mundshëm në dispozicion është 24 vjet.

#### *Përcaktimi i zbatueshmërisë së parimeve të zbutjes*

**Siç është përshkruar më lart, janë tri situata në të cilat Gjykata mund ta zbatojë zbutjen e paraparë në nenin 71.** Mirëpo, për t’i sistematizuar dhe zbatuar ato përpjesëtimisht, ekzistojnë disa kufizime që gjykata duhet t’i ketë parasysh.

Situata 1: Neni 71 paragrafi 1.1 parasheh që Gjykata mund ta merr parasysh zbutjen kur ligji në mënyrë specifike parasheh që dënimi mund të zbutet apo zvogëlohet. Ndonëse kjo nuk shfaqet në shumë vepra specifike brenda kodit penal, nuk ka ndonjë aplikim në Kapitullin II për përgjegjësinë penale për veprat që për pak sa nuk përbëjnë përjashtime në raste të veçanta. Këtu gjykata mund ta japë zbutjen sipas dispozitave të duhura të nenit 13 Nevoja Ekstreme, nenit 14 dhuna ose kanosja, nenit 15 veprat e kryera nën shtrëngim, nenit 18 paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore, nenit 26 lajthimi juridik, nenit 33 ndihma dhe nenit 34 bashkimi kriminal. Gjykata duhet të konstatojë që kriteret specifike të numëruara në dispozitë janë plotësuar dhe pastaj përcakton nëse duhet të caktohet zbutja.



Situata 2: Neni 71, paragrafi 1.2 është konstatim afirmativ i rrethanave “*posaçërisht*” lehtësuese që tregojnë se qëllimi i dënimit do të arrihet me dënim më të ulët. Derisa kjo nuk është përkufizuar qartë, ajo tregon për një situatë që është jashtë normës apo në nivel të një të pandehuri mesatar. Këtu gjykata duhet të jetë mjaft e qartë se cilat janë qëllimet e dënimit në lidhje me të pandehurin dhe veçantitë e të pandehurit, apo situata e tyre i tregon që ato qëllime do të realizohen me dënim më të ulët. I pandehuri, për shembull, mund të ketë shfaqur veprime të rëndësishme të pendimit dhe përpjekje për t’i bërë korrigjime viktimës që janë mbi normën që mund të konsiderohet normale. Në këto situata, Gjykata lejohet që ta zbatojë zbutjen dhe t’i rregullojë kufijtë përshtatshëm. Gjykata pastaj duhet t’i shqyrtojë rrethanat në lidhje me kufijtë e ri. Në përgjithësi, gjykata duhet ta refuzojë aplikimin e zbutjes sipas këtij neni nëse rrethanat rënduese i tejkalojnë ato lehtësuese.

Situata 3: Sipas nenit 71, paragrafit 1.3 mundësia e tretë i ka dy komponentë: Komponenti i parë është që gjykata mund t’i rregullojë kufijtë kurdo që i pandehuri e pranon fajësinë në gjykatë pa pasur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

E dyta është kur ka marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Në situatën e parë, vendimi i Gjykatës duhet të akordohet me kohën e pranimit të fajësisë. Zbutja nuk është në dispozicion për të pandehurin, thjeshtë sepse diku gjatë procesit ai vendos që ta pranojë fajësinë. Përfitimi substancial që jepet për pranim të fajësisë është i bazuar në kursimin e kostos për shoqërinë për sa i përket kohës, parave dhe shpenzimeve emocionale që ndërlihen me dëshminë dhe viktimizimin. Këto përfitime zhduken dukshëm me fillimin e gjykimit. Andaj, zbutja sipas nenit 71 nuk duhet të jetë më e zbatueshme kur të fillojë gjykimi. Nëse i pandehuri e pranon fajësinë me kohë dhe Gjykata konstaton që zbutja është e përshtatshme, ashtu si me dy kategoritë e para, gjykata prapëseprapë duhet të kalojë nëpër procesin e vlerësimit për ta përcaktuar se cilët duhet të jenë kufijtë përfundimtar dhe nëse zbutja e mëtutjeshme është e zbatueshme. Ndonëse kodi parasheh që pranimi i fajësisë mund të jetë i mjaftueshëm për të zbutur dënimin, gjuha e mëtutjeshme në kod që kërkon marrjen e mendimeve të të gjitha palëve të interesit, tregon anim të fortë kundër zbatimit të zbutjes nga neni 72 kur ka kundërshtime. Kjo ka kuptim kur e kemi parasysh që pranimi i fajësisë (jo marrëveshja mbi pranimin e fajësisë) është thjeshtë njëra nga 13 mundësitë e zbutjeve të cekura në kod. Duke e pasur parasysh që arsyeja kryesore për zbutje e bazuar në pranim të fajësisë është kursimi i burimeve, kundërshtimi nga palët i bazuar në të njëjtin arsyetim tregon që ekzistojnë konsiderata tjera që e mënjanojnë atë përfitim të dukshëm për të pandehurin. Andaj, kundërshtimi nga ndonjëra palë, në bazë të dyshimit të arsyeshëm, apo konstatimit të ndonjë rrethane rënduese, duhet të eliminojë caktimin automatik të zbutjes nga neni 76, thjeshtë në bazë të pranimit të fajësisë dhe të kërkojë konstatimin e zbutjes së jashtëzakonshme në pajtim me udhëzimet. Se a do të konsiderohen argumentet e palëve si bazë e arsyeshme për refuzim, kjo qartazi i lihet gjykatës për ta shqyrtuar.

Në situatën e dytë sipas nenit 71 paragrafit 1.3, zbutja është në dispozicion për të pandehurin i cili e ka bërë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë me prokurorin. Ndonëse marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë dhe dënimin janë diskutuar me shumë hollësi më vonë, kjo dispozitë në esencë ia lejon prokurorit që t’i bëjë negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë me kufij të zbutur në dispozicion. Andaj, në një situatë të duhur, prokurori është në gjendje që të ofrojë kufijtë e plotë të dënimeve të zbutura që janë në dispozicion sipas ligjit për Gjykatën. Kjo është e ndarë dhe e veçuar nga miratimi përfundimtar nga gjykata e dënimit të tillë. Kjo dispozitë nuk e lidh gjykatën për ta pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

## **10. Lirimi nga dënimi**

Neni 73<sup>101</sup> dhe 74<sup>102</sup> ia lejojnë gjykatës që tërësisht ta lirojnë të pandehurin nga dënimi në dy situata. Sipas nenit 73, Gjykata lejohet që ta heq dënimin kur kodi në mënyrë specifike e lejon lirim nga dënimi pavarësisht kufizimit për zbutje të paraparë në nenin 72. Ky lloj i lirit nga dënimi ndodh në dy situata. E para është lirimi nga dënimi për veprë të veçantë penale kur plotësohen kushtet e duhura. Gjykata do të duhet ta vlerësojë veprën penale specifike sipas kodit për ta përcaktuar zbatimin e nenit 73. E dyta, çdo veprë e kryer në formë të caktuara të përgjegjësisë së modifikuar penale apo bashkëpunimit ka potencial që të kualifikohet për lirim nga përgjegjësia. Këto përfshijnë nenin 12 mbrojtjen e nevojshme, nenin 13 nevojën ekstreme, nenin 29 tentativën e papërshtatshme, nenin 30 heqjen dorë vullnetare dhe nenin 34 bashkimin kriminal.

Lirimi nga dënimi nga neni 73 është specifik për veprat penale të kryera nga pakujdesia dhe me përmbushjen e dy kritereve. E para, i pandehuri duhet të preket aq rëndë nga pasojat sa që dënimi është i panevojshëm për arritjen e qëllimit të tij. E dyta, i pandehuri duhet menjëherë të bëjë përpjekje për eliminimin dhe zvogëlimin e pasojës dhe ta kompensojë dëmin e shkaktuar tërësisht apo në masë të madhe. Kriteri i parë do të kërkojë vlerësim të detajuar të ndikimit të të pandehurit. Ky nuk është vlerësim objektiv por subjektiv dhe që ndërlidhet drejtpërdrejt me të pandehurin e caktuar. Kriteri i dytë kërkon veprim të menjëhershëm për tu kualifikuar për zbutje. Kjo natyrisht që do të jetë element shumë i rëndësishëm për të përcaktuar nëse kriteri i parë është plotësuar, pasi që përpjekjet për zbutje do të ndikojnë në të pandehurin. Mirëpo, nuk kërkohet që këto përpjekje të kenë qenë të suksesshme. Ajo që kërkohet është përpjekje objektive në masë të arsyeshme për ta bërë këtë. Përfundimisht, duhet të ketë një lloj të kompensimit. Duke qenë se aftësia për të paguar mund të jetë rrethanë që e përcakton lirim nga dënimi, gjykata duhet ta kushtëzojë këtë konstatim në pagesën e menjëhershme. Nëse i pandehuri është në gjendje dhe ka vullnet për ta bërë këtë, me kalimin e kohës, Gjykata duhet ta lirojë nga dënimi pas monitorimit të pagesës së suksesshme.

## **11. Ashpërsimi për recidivizëm të shumëfishtë<sup>103</sup>**

Neni 75 e ofron mundësinë e vetme në Kod për të shtuar apo rregulluar nga lartë dënimin maksimal të paraparë me ligj për një veprë të caktuar me përjashtim të burgimit të përjetshëm. Gjykata lejohet që ta shtojë ½ e dënimin maksimal për veprën si dënim shtesë. Mirëpo, veprat e mëparshme të pandehurit duhet t'i plotësojnë disa kualifikime:

- Dy apo më shumë vepra të mëparshme që:
  - o Kanë rezultuar me një ose më shumë vjet burgim dhe
  - o Më pak se 5 vjet kanë kaluar nga përfundimi i dënimin të mëparshëm.

Posa Gjykata të përcaktojë se i pandehuri i plotëson këto rrethana, kërkohet që ta shqyrtojë në veçanti pranimin e fajësisë, motivet, rrethanat dhe ngjashmërinë e veprave të mëparshme, si dhe nevojën për shqiptim të dënimin për përmbushjen e qëllimeve të dënimin. Këto konsiderata

---

<sup>101</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 73, Lirimi nga dënimi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>102</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 74, Bazat e posaçme të lirit nga dënimi për veprat penale të kryera nga pakujdesia, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>103</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 75, Ashpërsimi për recidivizëm të shumëfishtë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

janë relevante, por nuk janë absolute për sa i përket kritereve. Prandaj, derisa është e sigurit relevanca që veprat penale të kenë qenë të ngjashme për kah natyra nuk kërkohet që ato të jenë të ngjashme para se gjykata t'i ashpërsojë kufijtë e dënimit. Sa më të ngjashme që të jenë veprat penale për nga natyra, aq më shumë gjykata duhet ta merr parasysh ashpërsimin maksimal të mundshëm pasi që kjo gjithashtu do të nënkuptojë që dënimet paraprake për të njëjtën vepër kanë dështuar që ta rehabilitojnë apo parandalojnë të pandehurin nga kryerja e serishme e veprës dhe qëllimet e dënimit do të akordohen për ta mbrojtur shoqërinë nga i pandehuri.

## ***12. Dënimi për bashkim të veprave penale***

Pasi që ndërlikueshmëria e procesit të caktimit të dënimit rritet substancialisht kur kemi disa vepra të përfshira apo ashpërsim të bazuar në recidivizëm, është shumë vështirë që procesi të paraqitet në format të diagramit. Mirëpo, posa gjykata ta ketë vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse zbutjen dhe ashpërsimin, është thjeshtë çështje e zbatimit të procesit të përshkruar më lartë për secilën vepër dhe e llogaritjes së dënimit. Kufiri përfundimtar në dispozicion, për të qenë në pajtim me dispozitat e nenit 80, është çështje e mbledhjes së dënimit si maksimum dhe përcaktimit të minimumit.

Për shembull, i pandehuri kryen tri vepra, dy kanë kufij prej 3-5 vjet dhe njëra ka kufij 1-4 vjet. Nëse gjykata e dënon të pandehurin me dy dënime nga 4 vjet dhe një dënim 3 vjet, neni 80 kërkon që dënimi përfundimtar të jetë më i lartë se secili dënim individual (p.sh. më shumë se 4 vjet) por më i ulët se shuma e totalit të dënimeve (p.sh. 11 vjet). Fatkeqësisht, kodi nuk jep shumë udhëzime përtej kësaj për të përcaktuar, se cili duhet të jetë dënimi përfundimtar për shembullin e dhënë më lart.

Një çështje e rëndësishme për ta cekur është supozimi që vlera e ashpërsimit/zbutjes ka qenë e njëjtë për të gjitha veprat. Derisa në shumë situata kjo mund të jetë e vërtetë, nuk e ndalon gjykatën që të konstatojë se vlera apo rrethana të ndryshme vlejné për veprat e ndryshme. Gjukata mund të konstatojë që i pandehuri, për shembull, është penduar shumë për kryerjen e njëres vepër, por jo për tjetrën. Njëra viktimë mund të jetë viktimë e cenueshme derisa tjetra jo. Shembulli thjeshtë e shtjellon procesin. Gjukata duhet ta vlerësojë secilën vepër individualisht.

Konsiderata shtesë që mund të përdoren nga gjykata për të rregulluar dënimin e bashkuar përfundimtar më lartë apo më poshtë dënimit të supozuar mund të përfshijnë:

- Kur secili dënim individualisht bie në spektrin e kufijve në dispozicion. Nëse ka zbutje substanciale për secilin dënim individual, dënimi përfundimtar duhet gjithashtu të përfitojë nga zbutja substanciale dhe e kundërta.
- Prevalenca e sjelljes penale në komunitet dhe nevoja për t'i parandaluar të pandehurit në të ardhmen.
- Nëse secila vepër ka përfshirë edhe viktimë tjetër përveç shtetit.
- Serioziteti i veprave penale në lidhje me njëra tjetrën (kundërvajtjet mund të kenë më pak nevojë për t'u reflektuar në dënimin unik se veprat e rënda).
- Ngjashmëria e veprave me njëra tjetrën në bazë të elementeve të tyre.
- Gjasat për rehabilitim dhe ri-integrim përballë nevojës për ta mbrojtur shoqërinë nga i pandehuri.
- A ka reflektim të mjaftueshëm për secilën vepër penale në dënimin përfundimtar ashtu që të mos ketë vepra penale të “pandëshkueshme” apo viktimë që nuk pranojnë drejtësi.

### ***13. Vendimet e trupit gjykues për caktimin e dënimit***

Një konsideratë tjetër e rëndësishme për gjykatën është se si ta përcaktojë dënimin përfundimtar kur kemi trup gjykues. Metoda e rekomanduar është që të përcaktohet vlera mesatare e dëmit nga të gjitha vendimet përfundimtare për ata gjyqtarë që e konsiderojnë të pandehurin fajtor për veprën penale. Çfarëdo konstatimi i pafajësisë duhet të eliminohet nga llogaritja përfundimtare. Sugjerohet që çdo gjyqtar, në mënyrë të pavarur, t'i vlerësojë rrethanat në gjykatë dhe ta përcaktojë vlerën përfundimtare për ashpërsim dhe zbutje.

Në situatat kur njëri gjyqtar del me rezultat dukshëm më të ndryshëm të caktimit të dënimit në krahasim me tjerët, duhet të ketë një hap shtesë në të cilin gjyqtarët konsultohen me njëri tjetrin për atë se cilat rrethana janë marrë ose jo në konsideratë apo janë ose nuk janë konstatuar për zbutje/ashpërsim. Kjo duhet të ndodhë në çdo situatë ku njëri anëtar i kolegjit del me dënim që është substancialisht i ndryshëm nga ai i gjyqtarëve tjerë. Kjo bëhet me qëllim që të sigurohemi se gjykata nuk e ka lënë anash rastësisht apo nuk e ka marrë në konsideratë një rrethanë. Është theksuar që ndonëse ky konsultim shtesë mund të ketë ndikim përfundimtar në ndryshimin e mendimit të gjyqtarit, nuk duhet të konsiderohet si qëllim kryesor i konsultimit. Ai bëhet thjesht për ta mbrojtur vendimin në nivel të apelit. Nëse vendimi mbetet i njëjtë, prapë do të merret mesatarja e secilit dënim.

## VII. Zbatimi i dënimeve alternative, plotësuese dhe tjera

Caktimi i dënimit adekuat alternativ, plotësues apo edhe detyrimeve tjera të parapara me KPRK, shpesh mund të ketë efekt shumë më të madh në të pandehurin sesa vet dënimi kryesor. Neni 46 i KPRK-së parasheh mundësinë për shqiptimin e dënimeve alternative.

### 1. Dënimi me kusht

Dënimi me kusht është ndoshta forma më e shpeshtë e dënimeve alternative të përdorur në praktikën e gjykatave. Dënimi me kusht mund të jetë shumë i dobishëm dhe t'i ruajë të drejtat e njeriut kur përdoret në situata të duhura, por mund të bëhet edhe kundërthënës sepse mund të duket pothuaj si lirim i plotë i të pandehurit nga të gjitha përgjegjësitë pa pasoja. E para dhe më e rëndësishmja, gjykata duhet të ofrojë arsyetim për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me kusht, në veçanti mbi atë se si zëvendësimi do t'i plotësojë njëlloj qëllimet e dënimit. Kriteret e nenit 47, në mënyrë të qartë, e theksojnë që dënimi me kusht është rezervuar për vepra më të lehta kur vet kërcënimi me burgim konsiderohet si i mjaftueshëm për parandalimin e mëtutjeshëm. Historiku, mentaliteti dhe qëndrimet e të pandehurit janë të një rëndësie të veçantë në procesin e vlerësimit.

Neni 50 i KPRK-së e paraqet kornizën dhe përshtatshmërinë që një dënim të pezullohet. Ekzistojnë dy udhëzime që e kontrollojnë pezullimin. E para, çdo vepër penale që mund të dënohet me më së shumti 5 vjet apo më pak mund të pezullohet. Së dyti, çdo vepër penale që mund të dënohet me burgim prej më së shumti 10 vjet apo më pak mund të pezullohet, mirëpo vetëm nëse vlejné dispozitat për zbutje. Nga këto dy udhëzime mund të konkludohet që vepra penale që mund të dënohet me më shumë se 10 vjet nuk mund të pezullohet.

Gjykata duhet të ketë parasysh se vetëm pse dënimi ka qenë fillimisht i përshtatshëm për dënim me kusht, nuk nënkupton që gjykata ka të drejtë që automatikisht ta përdorë këtë alternativë. Ajo duhet të angazhohet në vlerësim dhe përfundimisht të vjen në një dënim brenda kufijve të lejuar.

#### A. Pezullimi i dënimit në rastet me maksimum prej 5 vjetëve

Nëse gjykata ballafaqohet me një apo më shumë vepra prej më së shumti pesë vjetëve, ajo duhet ta vlerësojë secilën vepër në bazë të meritave të saj siç është cekur në këtë udhëzues dhe të arrijë në dënim brenda kufijve të paraparë.

Nëse i pandehuri është fajtor për një vepër të vetme dhe dënimi i llogaritur është dy vjet apo më pak, gjykata mund ta pezullojë dënimin sipas paragrafit 3 të nenit 50. Mirëpo, gjykata gjithashtu duhet të konstatojë që në bazë të rrethanave të cekura në Nenin 49 paragrafi 4, i cili përqendrohet në sjelljen e veçantë të pandehurit në të kaluarën si dhe rrethanat personale, a është i pandehuri i përshtatshëm për dënim me kusht dhe nëse qëllimet e dënimit janë përmbushur. Nëse dënimi është më i lartë se dy vjet, gjykata nuk mund ta pezullojë dënimin.

#### B. Pezullimi në rastet me maksimum prej 10 vjetëve

Ndryshe nga dënimet me kusht, për veprat prej më pak se 5 vjet, veprat që bartin dënim të mundshëm prej me pak se 10 vjet e kërkojnë edhe një hap shtesë. Para se të mund të merren parasysh për dënim me kusht, ato, së pari duhet ta kalojnë procesin e zbutjes. Kjo nënkupton që

ato duhet ta plotësojnë njërin nga kualifikimet nga neni 71. Ky nen thekson se gjykata MUND të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit:

- kur ligji parasheh që dënimi mund të zbutet apo të zvogëlohet;
- kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; ose
- në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Ky është vetëm hap fillestar i kualifikimit dhe nuk i jep menjëherë të drejtë gjykatës që të shqiptojë dënimin me kusht. Gjykata duhet të kalojë nëpër procesin e vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese dhe në mënyrë të pavarur të arrijë te kufijtë e dënimit që e lejojnë dënimin prej 2 ose me pak vjetëve, siç kërkohet me nenin 50. Gjithashtu, Gjykata duhet të arrijë në përfundim që në bazë të rrethanave të numëruara në Nenin 49 paragrafi 4, i cili përqendrohet në sjelljen e kaluar të veçantë të të pandehurit si dhe rrethanat personale, i pandehuri është i përshtatshëm për shqiptimin e dënimit me kusht dhe se janë përmbushur qëllimet e dënimit.

### C. Obligimet dhe kushtet e dënimeve me kusht

Për shkak se qëllimi kryesor i dënimit me kusht është shmangia e burgut efektiv kur kërcënimi i dënimit është i mjaftueshëm, Gjykata duhet të sigurohet që të pandehurit t'i jepen mjetet e duhura për të shmangur kryerjen e sërishme të veprave penale dhe për t'u ri-integruar në komunitet. Duke qenë se dënimet me kusht, në përgjithësi vlejnë për situatat ku sjellja nuk është normale, zakonisht do të ketë diçka që ka kontribuar në motivimin për ato veprime.

Dënimi me kusht, përveç ndalimit të përgjithshëm për kryerjen e sërishme të veprave, duhet të përdoret sa më rrallë dhe rezervohet vetëm për situatat me të vogla ku ka indikacione të forta të pendimit, dëmshpërblimit të ndonjë viktime dhe bashkëpunim me gjykatën dhe zbatuesit e ligjit. Në esencë nuk ka qëllim apo mjet të dukshëm në dispozicion për gjykatën. Gjykatat këshillohen fuqimisht, që dënimet me kusht, të kontrollohen me kujdes dhe mungesa e kushteve duhet të shpjegohet në mënyrë të thukët. Përfundimisht, duke i pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe të verifikueshme, dënimi me kusht që nuk ka kushte DUHET të revokohet në rastet kur shkelet.

Gjykata duhet me kujdes ta vlerësojë situatën dhe të caktojë obligime dhe kushte për dënimin të cilat e adresojnë sjelljen. Kodi i parasheh 15 kushte të mundshme në nenin 56<sup>104</sup> me mundësi të mbikëqyrjes nga shërbimi sprovues. Përveç këtyre dispozitave, dënimet plotësuese nga neni 59 janë në dispozicion dhe duhet gjithmonë të merren parasysh përveç kushteve të dënimit me kusht. Këto janë trajtuar me më shumë hollësi më poshtë.

***1.1. mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor;***

***1.2. nënshtrimi ndaj një programi për trajtim mjekësor ose rehabilitim;***

***1.3. vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;***

Kushtet 1.1-1.3 gjithmonë duhet t'i caktohen situatave ku ka probleme të shëndetit mendor apo kushte mjekësore si motivim për kryerjen e veprës penale. Kushti 1.3 duhet të përdoret me maturi nga gjykata nëse ka indikacione që shëndeti mendor mund të jetë faktor kontribues, por nuk ka diagnozë mjekësore në kohën e dënimit.

---

<sup>104</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 56, Llojet e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

**1.4. aftësimi profesional në një profesion të caktuar;**

**1.5. kryerja e aktiviteteve punuese;**

**1.6. shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave apo pasurisë tjetër për përmbushjen e detyrimeve familjare;**

Çfarëdo vepre që përfshin dështimin e ofrimit të ndonjë forme të mbështetjes financiare duhet të ketë dispozita për përmbushje të pagesave. Kjo mund të përfshijë shitjen e pronës për përmbushjen e obligimit përderisa jeta e të pandehurit nuk shkatërrohet. Nëse ka indikacione që vepra është motivuar nga mungesa e mjeteve financiare apo edhe mërzitja, Gjykata duhet që t'i caktojë kushtet që kërkojnë nga i pandehuri përvetësimin e shkathtësive për t'u bërë pjesëtar produktiv i shoqërisë.

**1.7. mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues;**

Nëse përdoret mbikëqyrja nga shërbimi sprovues, kjo duhet të jetë dispozitë e detyrueshme. Përveç kësaj, kjo dispozitë gjithmonë duhet të përdoret nëse ka indikacione që i pandehuri ka mjete/aftësi për tu zhvendosur. Qëllimi për tu zhvendosur, pa arsyetim, është tregues i mundshëm për ta vazhduar sjelljen e keqe, andaj me qëllim të parandalimit, nga ai duhet të kërkohej të njoftohej shërbimin sprovues para se të zhvendoset.

**1.8. heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;**

Çdo indikacion i abuzimit me drogë/alkool, i pranishëm në kohën e kryerjes së veprës penale, duhet të shoqërohet me kufizim të përdorimit përveç ndonjë forme të vlerësimit si në pikën 1.3. Nëse varësia nga droga apo alkooli ka qenë motivi kryesor për kryerjen e veprës penale, në nenin 54 kërkohej trajtimi i detyrueshëm i rehabilitimit.

**1.9. heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara;**

**1.10. heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar;**

Nëse vepra penale nuk ka ndodhur rastësisht, por është përqendruar më shumë në personin a vendin e caktuar, Gjykata duhet gjithmonë ta përfshijë kufizimin e frekuentimit të vendit apo personit të caktuar. Këto duhet të përdoren, në veçanti në situatat familjare ku vepra penale është drejtpërsëdrejti e lidhur me kontaktin me personin e caktuar. Duke e pasur parasysh që vetë natyra e marrëdhënies së dhunës në familje është që ta përjetësojë situatën përmes përsëritjes, ka pak **gjasa** që një suspendim i thjeshtë të jetë efektiv pa kufizime. Gjykata duhet të jetë shumë specifike në emërimin/përshkrimin e personave dhe vendeve që i pandehuri duhet t'i shmang, përfshirë ndonjë anëtar të familjes së gjerë. Shkelja e këtyre dispozitave duhet të jetë bazë e menjëhershme për revokim të dënimit me kusht. Duhet të caktohet edhe monitorimi nga shërbimi sprovues.

**1.11. heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve;**

Çdo vepër që ndërlidhet me posedimin e armës apo përdorimin e saj për ta lënduar apo frikësuar dikë, duhet të pezullohet me kufizime për bartjen apo posedimin e armëve. Kufizimi duhet të jetë i përgjithshëm për nga natyra e jo thjeshtë i kufizuar në një armë të caktuar që është përdorur. Kjo dispozitë duhet ta përfshijë edhe posedimin përveç bartjes së armës.

Nëse ka indikacione që ekziston komponenti i dhunës në familje në vepër penale, kufizimet në qasje/posedim të armës duhet të përfshihen, pavarësisht se a ndërlidhet posedimi drejtpërsëdrejti me vetë veprën penale apo jo. Vetë posedimi, si i tillë mund të jetë shtrëngim dhe frikësim për viktimën. Hulumtimet shkencore kanë treguar që prania e armës së zjarrit në posedim të të pandehurit, ushtruesit të dhunës në familje, e rritë dukshëm rrezikun e lëndimit të rëndë trupor apo

vdekjen e viktimës, fëmijëve dhe tjerëve. Si rezultat, bëhet shumë e rëndësishme për gjykatën që të bëjë pyetje dhe të urdhërojë konfiskimin e çfarëdo arme të zjarrit të qasshme për të pandehurin. Kjo është e lejueshme edhe kur abuzuesi ka posedim të ligjshëm të armës.<sup>105</sup> Prania e armës në shtëpi është shpesh komponent kritik për krijimin e frikës te viktima përmes gjendjes së vazhdueshme të rrezikut. Arma mund të jetë përdorur në ndonjë incident të mëparshëm qoftë të dhunës së vërtetë apo kërcënimit dhe prania e saj e vazhdueshme e nënkupton mundësinë e vazhdueshme që sjellja do të riprodhohet. Ajo gjithashtu shërben për ta parandaluar viktimën nga mosdenoncimi i agresorit apo i raportimit të incidenteve të mëparshme tek autoritetet. Huluntimet tregojnë që përdorimi i armës apo mjeteve të rrezikshme apo kërcënimi për përdorimin e tyre në kontekst të dhunës në familje, paraqet tregues të qartë të eskalimit dhe tregues vendimtar të rezultateve fatale.<sup>106</sup>

#### ***1.12. të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;***

Çdo dënim me kusht që përfshinë viktimë, ku i pandehuri ka mundësi apo mjete për të bërë dëmshpërblim duhet të shoqërohet me këtë kusht. Kjo do ta parandalojë nevojën për parashtrim të padisë civile, do ta lirojë shtetin nga çfarëdo obligimi që mund ta ketë dhe t'i sigurojë viktimës ndihmë të drejtpërdrejtë në të cilën ka të drejtë.

#### ***1.13. të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;***

Çdo situatë në të cilën ka dobi materiale të fituar si rezultat i veprës duhet ta përfshijë dispozitën e kthimit të asaj dobie. Nëse i pandehuri e ka konvertuar dobinë materiale në një formë tjetër, Gjykata duhet ta urdhërojë shitjen apo kthimin e formës së konvertuar nëse ende është në pronësi të vetme të të pandehurit.

#### ***1.14. të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata;***

Veprat që janë kryer përmes kompjuterit apo mjeteve tjera elektronike me qasje në internet duhet të shoqërohet nga këto kufizime. Kjo nuk duhet të kufizohet në veprat me kompjuter. Çdo veprë penale ku gjykata konstaton që përdorimi i kompjuterit ka qenë në masë të arsyeshme i ndërlidhur për kryerjen e veprës penale apo e ka lehtësuar kryerjen e veprës, duhet të ketë dispozitë të kufizimit. Nëse i pandehuri ka lidhje afariste apo përdorim legjitim jashtë kryerjes së veprave, Gjykata duhet që në mënyrë të ngushtë t'i hartojë kufizimet sipas nevojës.

#### ***1.15. të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata.***

Nëse ekziston komponenti financiar në kryerjen e veprës penale dhe/apo motivohet nga dobia financiare, kjo rrethanë duhet të caktohet. Raportet periodike janë mjet i shkëlqyeshëm për gjykatën që ta monitorojë nëse të ardhurat nga i pandehuri janë legjitime apo të ndërlidhura me ndonjë aktivitet kriminal.

Në shumë situata, do ishte mjaft efektive nëse detyrimet nga Neni 56 i KPRK-së të mos kufizoheshin vetëm me shqiptimin e dënimit me kusht por të mund të shqiptohen edhe krahas dënimeve tjera pasi efekti i këtyre detyrimeve mund të jetë shumë i madh. Megjithatë, përderisa

---

<sup>105</sup> Doracaku për gjyqtarë e prokurorë mbi dhunën në familje, Konfiskimi i mjetit të përdorur apo që mund të përdoret për të kryer dhunë, par.6.9 Prishtinë (2016) , fq.44, që është edhe citim i Ligjit nr.05/l-22 për armët, (2015) Neni 10, neni 36 dhe neni 38.

<sup>106</sup> Po aty. fq.66



një kufizim i tillë ekziston në ligjin aktual, është e qartë se të njëjtat mund të zbatohen vetëm te dënimi me kusht.

Përveç dispozitave të nenit 56, kodi i referohet vazhdimisht paragrafit 3 të nenit 48 i cili parasheh dispozitat e mundshme për dënimet me kusht. Mirëpo, vetëm një rrethanë e përmendur dallon dukshëm nga kushtet e nenit 56. Kjo nënkupton që gjykata mund të kërkojë që i pandehuri të bëjë dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar nga vepra.

Të gjitha kushtet janë dizajnuar për t'i monitoruar veprimet e të pandehurit dhe mund të përshtaten për pothuajse secilën vepër penale apo situatë. Sugjerimet e parapara për secilin kusht janë specifike për veprat penale/motivet për të cilat ato janë dizajnuar për t'i monitoruar. Mirëpo, kodi nuk e kufizon aplikimin e këtyre kushteve, dhe gjykata inkurajohet që t'i kombinojë ato siç e sheh të përshtatshme për të zhvilluar mjete efektive për monitorimin e përparimit të të pandehurit dhe të sigurojë që dënimi me kusht të përfundohet me sukses. Pavarësisht numrit të kushteve, Gjykata duhet t'i përfshijë afatet për secilin kusht me dispozita të duhura të monitorimit, të cilat do të mundësojnë akordime të kushteve.

Kur të caktohen këto kushte, Gjykata duhet të jetë e vëmendshme për kushtet dhe rrethanat në jetën e të pandehurit. Disa nga këto konsiderata janë theksuar në nenin 48, paragrafin 3 dhe tregojnë një vetëdije të përgjithshme që Gjykata nuk duhet të caktojë kushte që janë të pamundshme apo shumë të vështira për tu kryer, për shkak të rrethanave të vlefshme/relevante. Kjo nuk nënkupton që Gjykata duhet të mbështetet vetëm në fjalën e të pandehurit për ekzistimin e kushteve të tilla. Gjykata duhet të kërkojë dëshmi të rrethanave të tilla dhe nëse i pranon ato të kërkojë alternativa tjera.

#### *D. Periudha e Verifikimit*

Kodi parasheh periudhë të verifikimit apo përmbushjes së dënimit me kusht që zgjatë nga 1-5 vjet. Ndonëse Gjykata është e lirë për ta përcaktuar kohëzgjatjen e duhur, sugjerohet fuqimisht që Gjykata ta rrisë periudhën në proporcion me seriozitetin e veprës. Në vijim janë paraqitur periudhat e sugjeruara të verifikimit:

#### *E. Monitorimi nga Shërbimi sprovues*

Neni 55 ia lejon gjykatës që të caktojë monitorim nga shërbimi sprovues për dënimin me kusht. Kjo mund të jetë për monitorim aktiv të të pandehurit për respektim të kushteve të caktuara apo thjeshtë kërkesë për raportim periodik që e detyron të pandehurin që të takohet me shërbimin sprovues. Derisa disa nga kushtet e parapara në kod nuk kanë nevojë për monitorim aktiv, praktika tregon që monitorimi aktiv dhe i rregullt i përparimit drejt përmbushjes së kushteve është mënyra më efektive për të siguruar respektim të kushteve, riintegrim dhe sukses të përgjithshëm të dënimit me kusht. Së paku, i pandehuri do të jetë i vetëdijshëm për praninë e gjykatës dhe interesimin e vazhduar në rezultate, dhe rikujtohet rregullisht që dështimet do të identifikohen shpejt dhe do të dënohen. Dënimet me kusht pa kushte shtesë, kanë më shumë gjasa për të dështuar se ato që kanë kushte dhe monitorohen në mënyrë aktive. Mirëpo, Kodi lejon vetëm periudhë të monitorimit prej 6 muaj deri 3 vjet. Ndonëse në këtë periudhë nuk mund të të monitorohet e gjithë periudha verifikuese e dënimit të mundshëm me kusht prej 5 vjetëve, Gjykatat duhet ta përdorin aktivisht periudhën e lejuar. Sugjerohet fuqishëm që çdo periudhë e verifikimit prej 3 e më shumë vjetëve që përfshin obligime për të pandehurin, të shoqërohet me periudhë 3 vjeçare të monitorimit nga shërbimi sprovues.

#### *F. Revokimi i dënimit me kusht*

Revokimet janë relativisht të drejtpërdrejta në kod dhe mbulohen në përgjithësi nga nenet 50-52 të cilat i përshkruajnë kushtet për revokim pas kryerjes së veprave të reja, duke dështuar kështu që t'i plotësojnë kushtet, dhe duke u dënuar për veprën e kryer më parë.

Neni 50 kërkon revokim të detyrueshëm të dënimit me kusht kurdo që të jetë kryer veprë e re penale që rezulton në dënimin prej 2 e më shumë vjetëve burgim. Mirëpo, nëse dënimi është më pak se dy vjet apo gjobë, revokimi nuk është i detyrueshëm, mirëpo Gjykata inkurajohet që ta vlerësojë shkeljen në bazë të rrethanave, motivit dhe llojit të veprës penale. Ky nen i sugjeron gjykatës që vepra e re e kryer përkundër faktit të ekzistimit të dënimit me kusht, është tregues i fortë që dënimi me kusht ka **dështuar** ta arrijë qëllimin e tij. Revokimi duhet të **supozohet** përveç nëse ka prova bindëse nga i pandehuri për t'i arsyetuar veprimet e tilla. Nëse vepra penale është identike/e ngjashme në natyrë, me motiv e viktimit të njëjtë, revokimi duhet të jetë i menjëhershëm.

Kryerja e veprës së re penale mund të jetë dëshmi bindëse për revokim të dënimit me kusht; mirëpo, shkelja e kushteve kërkon analizë dhe konsideratë më të thukët. Neni 52 ia lejon gjykatës revokimin e dënimit me kusht dhe shqiptimin e dënimit të caktuar më parë për mospërbushje të kushteve të caktuara në bazë të paragrafit 3 të nenit 48 apo nenit 56 në tërësi. Kodi është mjaft fleksibil në lejimin e Gjykatës që të vlerësojë rrethanat në lidhje me përmbushjen e kushteve dhe ta shqyrtojë nëse revokimi është i duhur apo nëse është e arsyeshme që të vazhdohet kushti. Nëse mospërbushja e kushteve ka arsyetim, Gjykata kërkohet që ta heqë kushtin apo ta zëvendësojë atë me një kusht më të përshtatshëm. Mirëpo, çdo zgjatje e periudhës për plotësim të kushteve apo plotësim të kushteve të reja, duhet të jetë deri në fund të periudhës së përmbushjes.

Nëse Gjykata vendos që ta revokojë dënimin me kusht për mospërbushje të kushtit, sipas nenit 53 kjo duhet të bëhet brenda 1 viti të afatit të përcaktuar (dhe para skadimit të periudhës së verifikimit). Për shembull, Gjykata kërkon që i pandehuri ta përfundojë një program të rehabilitimit nga droga brenda 1 viti dhe parasheh periudhë 5 vjeçare të verifikimit. Nëse Gjykata nuk mëson për dështimin deri në vitin e 4-t, mund ta revokojë dënimin për mospërbushje të kushtit. Kjo duhet të ndodh para përfundimit të vitit të 2-të.

Këto janë konsiderata relevante për revokimin/zgjatjen e kushtit:

- Gjykata nuk duhet që thjeshtë ta shtyjë periudhën e përmbushjes vazhdimisht derisa të skadojë periudha e verifikimit. Duhet të jepet arsyetim për mospërbushjen.
- I pandehuri e bart barrën e arsyetimit të mospërbushjes së kushteve të dënimit me kusht apo duhet të tregojë që kushti duhet të zëvendësohet.
- Zëvendësimi apo heqja e kushteve duhet të jetë për shkak të mospërbushjes në bazë të rrethanave që janë jashtë kontrollit të të pandehurit (Për shembull, i pandehuri nuk është në gjendje që ta plotësojë trajnimin profesional për shkak se shkolla profesionale është mbyllur).
- Mospërbushjet që shfaqin mungesë të seriozitetit apo mos respekt të autoritetit të gjykatës, duhet të rezultojnë në revokim të dënimit me kusht. Vazhdimi i këtyre kushteve ka pak gjasa që të shpie në respektim dhe e zbehtë respektin për sistemin gjyqësor si tërësi.
- Vazhdimet e bazuara në arsyetime të diskutueshme mund të bëhen, mirëpo asnjëherë më shumë se një herë për të njëjtin arsyetim të diskutueshëm.
- Nëse nuk caktohet monitorim nga shërbimi sprovues, Gjykata në mënyrë aktive duhet t'i kontrollojë dosjet apo të mbajë seanca në periudhën e afatit përfundimtar të vendosur për kushtet, për të përcaktuar përmbushjen.

- Gjykata duhet ta mbajë, së paku një seancë diku kah fundi i periudhës verifikuese për të përcaktuar nëse të gjitha kushtet janë plotësuar dhe/apo të merr vendim përfundimtar për revokim.

Dënimet me kusht janë mjet efektiv në dispozicion të gjykatës për të minimizuar dënimin me burg efektiv dhe për ta çuar në maksimum rehabilitimin e kryesve. Mirëpo, ato nuk janë shumë efektive pa kushte të qarta, monitorim të përbushjes dhe gatishmërisë së gjykatës për t'i revokuar ato kur kushtet nuk janë plotësuar. Ato nuk duhet të përdoren si mjet për kryerjen e lëndëve që konsiderohen joserioze pasi që nuk do të shërbejnë për ndonjë qëllim të dobishëm dhe rehabilitimi do të dështojë. Gjykata duhet të jetë e gatshme që të merr kohë për të krijuar dënim efektiv me kusht në mënyrë që shoqëria të përfitojë nga to.

## ***2. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme/Gjysmëliria***

Si gjysmë liria ashtu edhe puna në dobi të përgjithshme janë mjete alternative për ta kryer një dënim me të urdhëruar nga gjykata prej një viti burgim. Që të dyja e bartin mundësinë e kushteve shtesë si pjesë e dënimit. Këto duhet të përdoren nga Gjykata për t'i adresuar çështjet kontribuuese dhe për ta dizajnuar një program për ri-integrim të duhur.

Duke qenë se puna në dobi të përgjithshme potencialisht e zëvendëson dhe zvogëlon periudhën e burgimit prej një viti në më së shumti 30 ditë pune apo 240 orë, duhet të përdoret më rrallë se gjysmë liria, e cila kërkon periudha të burgimit efektiv. Pasi që periudha e performancës nuk është më e madhe se një vit, gjykata duhet ta parashohë një periudhë fillestare me një kohëzgjatje substancialisht më të shkurtër për ta vlerësuar përbushjen dhe për t'i rritur në maksimum mundësitë e gjykatës.

## ***3. Dënimet plotësuese***

Dënimet plotësuese nga neni 59 mund të shqiptohen me ÇDO dënim kryesor apo alternativ. Ndonëse ato ndryshojnë për nga zbatimi i tyre i detyruar, gjykata duhet të vlerësojë zbatueshmërinë e tyre para se të shqiptojë dënimin përfundimtar. Kjo vlen veçanërisht për dënimin me kusht pasi që kjo rritë mundësinë e përshtatjes së dënimit nevojave të veçanta të të pandehurit dhe maksimizon perspektivën e ri-integrimit.

### ***3.1. Dënimet plotësuese me plotësim-ndryshimet e KPRK-së së vitit 2023***

Përpos dënimeve plotësuese të parapara me KPRK të vitit 2019, në vitin 2023<sup>107</sup> janë bërë edhe disa ndryshime në dënimet plotësuese me impakt kryesisht në veprat penale të dhunimit dhe dhunës në familje. Secila nga këto dënime plotësuese të shtuara, rrisin obligimin e gjykatës që të shqiptojë këto masa shtesë duke mos u fokusuar vetëm në dënimin kryesor. Duke qenë se këto dënime të reja të parapara janë specifike vetëm për disa kategori të veprave, andaj ky Udhëzues

<sup>107</sup> Ligji Nr.08/L-188 për Plotësim ndryshimin e Kodit nr, 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.23/ 23 Nëntor 2023, Prishtinë.

vetëm kalimthi do të përmendë secilën nga to, ndërkaq në zbërthimin e kapitujve përkatës<sup>108</sup> të KPRK-së, janë përfshirë më shumë detaje për secilën.

- Neni 3 paragrafi 2.9 dhe 4 - Ndalimi i të drejtës së kandidimit në pozitë publike nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, personit i cili shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje.
- Neni 3 paragrafi 2.10 dhe 5 (62A) - Ndalimi i punësimit në sektorin publik në të gjitha nivelet prej një (1) deri në pesë (5) vjet, personit i cili shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit.
- Neni 5 (62B) - Ndalimi i të drejtës për drejtimin e automjetit për çdo lloj të kategorisë nga një (1) deri në pesë (5) vjet, personit që është shpallur fajtor për veprën penale të dhunimit në kohën kur ishte në ushtrimin e profesionit të vozitësit.
- Neni 2 paragrafi 2.a.1 - Ndalimi i blerjes në ankande publike ku shiten pronat publike, asetet publike apo licencat që jepen nga një autoritet publik në çfarëdo shërbimi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
- Neni 2 paragrafi 2.a.2 - Ndalimi i aplikimit si investitor strategjik dhe çdo formë tjetër e përfitimit nga privilegjet që jepen nga legjislacioni në fuqi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

### 3.2. Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur<sup>109</sup>

Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur është dënim plotësues i detyrueshëm. Ky dënim përfshin veprat nga Kapitulli 18 (Veprat penale kundër të drejtave të votimit) dhe veprat tjera penale për të cilat është paraparë dënimi, me së paku dy vjet burgim, nëse vepra është kryer me qëllim për t'u zgjedhur. Periudha e heqjes së të drejtës është 1-4 vjet.

Gjykata duhet ta shfrytëzojë këtë dispozitë me mençuri pasi që këto vepra tregojnë një mos respekt themelor ndaj vlerave demokratike. Në përgjithësi, nëse gjykata ka shqiptuar dënim me burgim, e drejta për t'u zgjedhur duhet të shqiptohet për së paku 3 vjet. Ndërkaq në rastet kur është shqiptuar dënimi alternativ i dënimit me kusht, periudha e heqjes së të drejtës duhet të jetë së paku aq sa edhe dënimi i cili është kushtëzuar.

### 3.3. Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit<sup>110</sup>

Kjo është dispozitë e detyrueshme e cila duhet të përfshihet në çdo rast kur ka ndonjë humbje apo dëmtim të pasurisë së viktimës. Për dallim nga kompensimi për lëndimin e shëndetit apo dëmtimin fizik, kjo masë përqendrohet vetëm në humbjen pasurore. Përveç vlerës së vetë pasurisë, gjykata duhet të urdhërojë edhe humbjen e të ardhurave të cilat viktima i përjeton si rezultat i veprës. Nuk ka ndonjë kufizim të kompensimit bazuar në aftësinë e të pandehurit për të paguar apo aftësinë e viktimës për të siguruar kompensimin në ndonjë mënyrë tjetër.

---

<sup>108</sup> Kapitulli XX Veprat penale kundër integritetit seksual dhe Kapitulli XXI Veprat penale me bazë gjinore, kundër martesës dhe kundër familjes.

<sup>109</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 60, Heqja e të drejtës për tu zgjedhur Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>110</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 61, Urdhëri për kompensimin e humbjes apo dëmit, Gazeta Zyrtare e Rep ublikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

### 3.4. Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën ose në shërbimin publik<sup>111</sup>

Ky nen ka pësuar ndryshime domethënëse me KPRK të vitit 2019 duke u zgjeruar, sidomos në kategorinë e veprave për të cilat shqiptohen kjo lloj ndalesë ose në formë alternative apo si ndalesë e obligueshme. Kështu ndalesa nga paragrafët 1,3 dhe 4 paraqiten si normë imperative dhe atë si në vijim:

Par.1- kërkon ndalimin e ushtrimit të funksionit nga 1- 5 vjet për personat zyrtar që kanë keqpërdorur funksionin dhe janë dënuar me burgim.

Par. 3 – paraqitet si masë më e rreptë duke qenë se ndalesa prej 1-10 vjet i shqiptohet çdo herë personit zyrtar i cili është dënuar me burgim për ndonjë nga veprat që përfshihen në Kapitullin XXXIII të KPRK-së.

Par.4 – po ashtu paraqet një risi dhe devijim nga praktika e natyrës së kësaj ndalesë duke i dhënë rëndësi veprave të dhunës në familje dhe duke obliguar gjykatën që ndalesën prej 1-5 vjet ta shqiptojë për personin zyrtar i cili është dënuar për këtë veprë të sanksionuar me Nenin 248 të KPRK-së.

Paragrafi 2 i këtij neni ndërkaq bën dallimin me veprat e natyrës më të lehtë kur e udhëzon (por nuk e obligon gjykatën) për mundësinë e shqiptimit të kësaj ndalesë prej 1-3 vjet nëse shqiptohet dënimi me gjobë apo dënimi me kusht.

Për shqyrtimin e gjykatës është e rëndësishme që në tre paragrafët e parë të këtij neni të ketë keqpërdorim të funksioneve nga ushtrimi i funksioneve në administratën publike apo në shërbimin publik. Në përgjithësi, periudha e ndalesës së lejuar me ligj duhet të jetë proporcionale në raport me peshën e veprës.

Edhe Udhëzuesi i veçantë për veprat penale të korrupsionit përmban një zbërthim të kësaj dhe ndalesës pasuese.

### 3.5. Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës<sup>112</sup>

Kjo ndalesë i drejtohet individëve të cilët keqpërdorin autoritetin e tyre si pjesë e veprës apo drejtpërdrejt në kryerjen e veprës duke mundësuar kufizimin e aftësisë së tyre për ta ushtruar atë pozitë apo detyrat tjera të parapara në nenin 63. Kjo nuk kufizohet vetëm në pozitë në organe publike dhe nuk e kufizon gjykatën vetëm në veprat ku keqpërdorimi i pozitës është element formal. Mjafton që gjykata të gjejë apo të përcaktojë se pozita është keqpërdorur në kryerjen e veprës. Periudha e ndalesës është 1-5 vjet dhe koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e saj. Periudha e ndalesës ndryshon duke shkuar në 1-10 vjet në rast të dënimit për ndonjë nga veprat në Kapitullin XXXIII të KPRK-së, njësoj siç është vepruar edhe në paragrafin 3 të Nenit 62 më sipër.

Dispozita në paragrafin 3 ka theksuar se mosrespektimi i ndalesës paraqet bazë për revokimin e dënimit me kusht.

Paragrafi 5 i këtij neni paraqet një risi po ashtu shumë domethënëse, duke i kushtuar rëndësi të jashtëzakonshme ndalimit edhe të kontaktit me fëmijë nëse kryesi ka kryer veprën penale të Trafikimit me njerëz nga Neni 165 i KPRK-së apo cilëndo nga veprat penale nga Kapitulli XX që

---

<sup>111</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 62, Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>112</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 63, Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

kanë të bëjnë me cenimin e integritetit seksual në rastet kur si viktimë paraqiten fëmijët. Ajo që vihet re është ashpërsia e ndalesës e cila mund të jetë e përjetshme me vlerësim nga gjykata çdo 10 vjet. Kjo ndalesë, në fakt paraqet një preventivë shumë të rëndësishme pasi gjykata gjithashtu mund ta kufizojë edhe qasjen nëse ka arsye për të besuar se mund të keqpërdoret në të ardhmen. Për shembull, gjykata mund ta ndalojë punësimin e të pandehurit si mësues nëse pozita e tillë është keqpërdorur për të ngacmuar seksualisht ndonjë fëmijë. Gjykata, gjithashtu mund t'ia ndalojë të pandehurit mbikëqyrjen e fëmijëve në çfarëdo kapaciteti profesional nëse ka arsye për të besuar se autoriteti në këtë pozitë mund të rrisë gjasat e keqpërdorimit të sërishëm të këtij autoriteti.

### 3.6. Ndalimi i drejtimit të automjetit<sup>113</sup>

Kjo ndalesë përqendrohet në ato vepra të cilat përfshijnë drejtimin e automjetit në situata të cilat rrezikojnë sigurinë publike. Megjithatë, kjo nuk është e kufizuar vetëm në veprat ku vetë vepra është kryer me automjet. Kjo mjafton të ndërlihet me kryerjen e veprës në atë mënyrë që të jetë përfshirë vozitja e tillë që ka rrezikuar sigurinë publike. Sikurse me shumicën e dispozitave, kjo ndalesë duhet të jetë në proporcion të drejtpërdrejtë me rrezikun e shkaktuar, peshën e veprës dhe përgjegjësinë e të pandehurit. P.sh. shumë më e gjatë do të duhej të jetë kohëzgjatja e kësaj ndalesë nëse i pandehuri ka rrezikuar një numër më të madh të njerëzve, p.sh. vozitës i autobusit kur transporton një numër të madh pasagjerësh, apo p.sh. rasti kur bëhet fjalë për vozitësin e një cisterne naftë apo gazi i cili veprën penale e ka shkaktuar nga pakujdesia ekstreme me ç'rast ka rrezikuar një numër të madh të banorëve etj. Shembuj të tillë tregojnë për rëndësinë e shqiptimit të kësaj mase ndalesë për të evituar rreziqet në të ardhmen nga po i njëjti individ. Sipas Neni 59 paragrafi 3 të KPRK-së ky dënim plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht, vërejtjen gjyqësore ose me lirim nga dënimi.

### 3.7. Marrja e lejes së vozitjes<sup>114</sup>

Marrja e lejes së vozitjes nga neni 65 është e ngjashme për nga natyra me ndalesën nga Neni 64, megjithatë kjo mundëson marrjen e lejes apo të drejtës për marrje të lejes së vozitjes nëse vozitësi nuk ka, për cilindo automjet (e jo në mënyrë specifike ndonjë tip/model të automjetit). Rreziku është i njëjtë sikur te ndalesa paraprake në kuptimin që ka rrezik për trafikun publik. Megjithatë, gjykata është e kufizuar në veprat të cilat përfshijnë vdekjen apo lëndimin e rëndë trupor ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e të pandehurit në trafikun publik është e rrezikshme për shkak të paaftësisë së ngasësit për drejtimin e sigurt të automjetit. Ndalesa duhet të jetë në përpjesëtim me peshën e veprës. Nëse vepra shkaktonte vdekjen apo lëndimin e rëndë trupor dhe është drejtpërdrejt e lidhur me drejtimin e mjetit motorik, periudha e marrjes së lejes duhet të jetë 5 vjet.

---

<sup>113</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 64, Ndalimi i drejtimit të automjetit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>114</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 65, Marrja e lejes së vozitjes, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

### 3.8. Urdhri për publikimin e aktgjykimeve<sup>115</sup>

Neni 66 i KPRK-së lejon publikimin e aktgjykimeve kur është në interes të përgjithshëm që aktgjykimi të publikohet në një mënyrë më të hapur dhe më të qasshme sesa qasja tradicionale në regjistrat publik. Përdorimi i kësaj dispozite duhet të kufizohet veçanërisht kur rrezikohet privatësia e personave apo kur publikimi mund të identifikojë persona të cilët nuk kanë të bëjnë me kryerjen e veprës apo rrezikon fshehtësinë zyrtare. Kjo dispozitë mund të jetë posaçërisht e dobishme kur përfshihen figura publike apo kur ka implikime më të mëdha për stabilitetin e përgjithshëm.

### 3.9. Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës<sup>116</sup>

Neni 67 i KPRK-së është vetë shpjegues dhe lejon dëbimin e të huajve në kohëzgjatje prej 1-10 vjet. Gjykata duhet të merr parasysh peshën e veprës, motivet e kryerjes së veprës dhe lidhjen e të pandehurit gjatë përcaktimit të kohëzgjatjes së këtij dënimi.

## **4. Masat e trajtimit të detyrueshëm**

Kapitulli V<sup>117</sup> i KPRK-së parasheh masat e trajtimit të detyrueshëm. Këto dispozita zbatohen vetëm për të pandehurit, të cilët nuk kanë përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë mendore, kanë aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo janë të varur nga droga apo alkooli. Si të tilla këto masa janë përtej shtrirjes së Udhëzuesit për matjen e dënimit. Shumica e konstatimeve në këto raste janë gjetje faktike që vërtetojnë se i pandehuri nuk është penalisht përgjegjës apo ka pësuar nga aftësia esencialisht e zvogëluar mendore sa që trajtimi i gjendjes së tillë është i rëndësishëm parësor. Së fundi, në rastet kur ndëshkimi penal mund të zbatohet sipas udhëzimit, gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me ndonjë periudhë të caktuar të trajtimit të detyrueshëm, me kusht që vepra të jetë kryer nën ndikimin apo kryesisht si rezultat i përdorimit të drogës apo alkoolit.

## **5. Vërejtja gjyqësore**

Nenet 81 dhe 82 i japin mundësi gjykatës për të shqiptuar vërejtje gjyqësore. Vërejtja gjyqësore është në esencë zëvendësim i dënimit me burg me një paralajmërim zyrtar nga gjykata që nëse kjo sjellje përsëritet, do të ketë dënim më të ashpër. Siç është cekur në KPRK, vërejtja është në dispozicion për të gjitha veprat e dënueshme me deri një vit burgim apo dënim me gjobë, ose veprat e dënueshme deri 3 vjet që në mënyrë specifike e parashohin vërejtjen. Sipas KPRK-së, janë vetëm dy vepra ku shprehimisht është paraparë mundësia e dhënies së vërejtjes gjyqësore, në të dyja rastet kur kryesi është provokuar nga sjellja e vrazhdë apo çnjerëzore e të dëmtuarit:

- Sulmi nga Neni 184,

---

<sup>115</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 66, Urdhri për publikimin e aktgjykimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>116</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 66, Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>117</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Kapitulli V Masat e trajtimit të detyrueshëm, nenet 83-87, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

- Lëndimi i lehtë trupor nga Neni 185,

Përdorimi i vërejtjes gjyqësore për vepra që bartin dënim të mundshëm deri në një vit burgim kufizohet edhe më tutje vetëm për ato raste ku ka rrethana lehtësuese të mjaftueshme për ta bërë veprën veçanërisht të vogël. Andaj gjykata duhet të kalojë nëpër proces të vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese. Nëse gjykata e përcakton që rrethanat rënduese janë të barabarta apo më të mëdha se ato lehtësuese, nuk mund ta zëvendësojë dënimin me vërejtje gjyqësore. Për më tepër, nëse nuk ka sa duhet rrethana lehtësuese për ta bërë veprën të rëndësishme relativisht të vogël, gjykata nuk mund ta përdorë vërejtjen gjyqësore. Një metodë e vlerësimit është që të shqyrtohet se sa afër kanë qenë veprimet e të pandehurit për të mos e përmbushur kriterin për të qenë vepër penale. Lëndimet që mezi e plotësojnë këtë prag të veprës penale kanë më shumë gjasa për ta kualifikuar veprën për qortim gjyqësor. Siç është theksuar në paragrafin 5 të nenit 82, konsideratat e rëndësishme për të plotësuar nivelin e veprës së vogël janë veprimet e të pandehurit gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale. Përqendrimi i gjykatës nuk është vetëm në atë se a kualifikohen veprimet e të pandehurit si sjellje devijuese, por nëse i pandehuri e ka kuptuar sjelljen dhe ka ndërmarrë masa korigjuese.

Për fund, duhet me domosdoshmëri të vihet theksi në Nenin 93 të KPRK-së lidhur me pasojën juridike të dënimit, i cili nen thekson në mënyrë taksative se vërejtja gjyqësore nuk prodhon pasoja juridike për të pandehurin.

## ***6. Urdhri ndëshkimor***

Kapitulli 30<sup>118</sup> i KPRK-së parasheh dhënien e urdhrit ndëshkimor. Kjo i lejon prokurorit që në aktakuzë të kërkojë nga gjykata që të jep urdhër ndëshkimor për vepra penale për të cilat parashihet dënimi maksimal deri në 3 vjet burgim. Urdhër ndëshkimor nuk mund të shqiptohet në rastet e dhunës në familje. Dënimet që mund të shqiptohen janë dënimi me gjobë, dënime plotësuese të parapara me nenin 59 të KPRK-së apo vërejtja gjyqësore si dhe konfiskimi i pasurisë nëse e njëjta është e specifikuar. Ajo që është e rëndësishme për gjykatën në këtë drejtim është se nuk është i domosdoshëm pëlqimi i të pandehurit për dhënien e urdhrit ndëshkimor por të pandehurit i jepet mundësia e kundërshtimit. Gjukata mund ta refuzojë kërkesën nëse, ngjashëm si te marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, gjykata nuk bindet se masat e propozuara janë adekuate dhe/ose se nga të dhënat faktike në aktakuzë mund të pritët shqiptimi i ndonjë dënimi tjetër

---

<sup>118</sup> Kodi Nr.08/L-032 I Procedurës penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.24/ 17 gusht 2022, Prishtinë.



## VIII. Arsyetimi i aktgjykimit

Për fund, duhet të bëjmë edhe një vëzhgim mjaft domethënës. Nëse përqendrohemi te Neni 369 par. 8 i KPPRK-së, shohim se ligjvënësi ka vënë theksin në nevojën e arsyetimit më preciz kur kemi të bëjmë me raste më të rënda “...Gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim më të rëndë se dënimi i paraparë...”. Megjithatë, duhet të kemi parasysh se edhe sipas këtij neni, gjykata ka vënë theksin në rastet e ashpërsimit mbi maksimumin e paraparë ligjor e jo ashpërsim në kuadër të maksimumit. Andaj, logjikisht në këto raste, nevoja për arsyetim dhe për një standard më ndryshe tek ashpërsimi përtej maksimumit na paraqitet natyrshëm si i domosdoshëm. Po i njëjti paragraf kërkon standardin e njëjtë të arsyetimit të dënimit nëse Gjykata “...ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitues ose konfiskimin e pasurisë së fituar përmes kryerjes së veprës penale.” Duke qenë se në praktikë gjejmë shumë më tepër raste kur shqiptohen dënime nën minimum apo edhe dënime alternative, qoftë edhe për vepra kur shqiptimi i dënimeve të tilla nuk duket mjaft i arsyeshëm, Gjykata në këto raste duhet të sigurohet që në mënyrë të detajuar të jep arsyetimin për shqiptimin e dënimit të natyrës më të lehtë.

Dhënia e arsyetimit adekuat për dënimin përfundimtar është e rëndësishme parësore. Arsyetimi dhe analizimi i qartë janë kërkesa thelbësore të vendimeve gjyqësore dhe një aspekt i rëndësishëm i së drejtës për gjykim të drejtë të paraparë në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Cilësia e vendimeve gjyqësore varet kryesisht nga cilësia e arsyetimit të tyre. Arsyetimi adekuat është domosdoshmëri e cila nuk duhet neglizhuar në interes të shpejtësisë.<sup>119</sup>

Arsyetimi i qartë gjithashtu i jep të pandehurit njoftimin e duhur lidhur me arsyet e vendimit dhe ua mundëson viktimave dhe prokurorëve që ta dinë se shqetësimet dhe argumentet e tyre janë trajtuar. Për më tepër, arsyetimi i duhur u jep garancitë e nevojshme gjykatave më të larta se të gjitha dispozitat e ligjit janë shqyrtuar në mënyrë adekuate dhe kjo në mënyrë të pashmangshme do ta zvogëlojë numrin e ankesave të suksesshme bazuar në mungesën e arsyetimit apo pamundësinë e gjykatës më të lartë për të vlerësuar bazën për caktimin e dënimit. Gjyqtari sigurohet që aktgjykimet e tij të jenë të kuptueshme. Ai jep arsyet e tij për vendimin e marrë në mënyrë që të gjitha palët e përfshira ta kuptojnë logjikën në të cilën gjyqtari ka bazuar vendimin e tij.<sup>120</sup> Theksimi i arsyeve jo vetëm që e bën vendimin më të lehtë për palët që ta kuptojnë dhe pranojnë, por mbi të gjitha është garanci kundër arbitraritetit. Së pari, kjo e obligon gjyqtarin që t'i përgjigjet parashtrësive të palëve dhe të cekë arsyet të cilat e justifikojnë vendimin dhe e bëjnë të ligjshëm; së dyti, i mundëson shoqërisë që ta kuptojë funksionimin e sistemit gjyqësor.<sup>121</sup>

Ndjekja e parimeve dhe qasjes së shtruar në udhëzim do të eliminojë shumicën dërrmuese të ankesave. Megjithatë, caktimi i dënimit bazuar vetëm në kalkulimet në Udhëzues nuk paraqet zëvendësim për arsyetimin dhe shqyrtimin e duhur të një rasti dhe rrethane konkrete. Kjo nuk është askund më e debatueshme dhe më problematike se te shqyrtimi i rrethanave rënduese/lehtësuese.

<sup>119</sup> Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Opinioni Nr. 11 i KKGJE për vëmendjen e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008) nr. 3.

<sup>120</sup> Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin (RREKGJ), Raporti i etikës gjyqësore 2009-2010, Dëgjimi dhe komunikimi, fq. 14.

<sup>121</sup> Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Opinioni Nr. 11 i KKGJE për vëmendjen e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008) nr. 35.

Identifikimi i kufijve të dënimit përfundimtar është thjeshtë çështje e përcaktimit të rrethanave të përgjithshme rënduese në krahasim me ato lehtësuese, dhe shqyrtimit nëse ndonjë çështje tjetër, siç është zbutja, ka ndikuar në dënim. Me të finalizuar këtë, gjykata përcakton kufijtë e përshtatshëm dhe cakton dënimin përfundimtar brenda këtyre kufijve. Gjukata pastaj bën korrigjimet përfundimtare siç është kushtëzimi i dënimit apo përcaktimi i dënimeve alternative. Së fundi, gjykata përcakton nëse zbatohet ndonjë dënim plotësues dhe/ose kushtet e dënimit me kusht.

Përveç caktimit të dënimit përfundimtar, bazuar në rrethanat rënduese/lehtësuese dhe dispozitat tjera të zbatueshme, gjatë përpilimit të vendimit përfundimtar me shkrim, gjykata duhet të zbatojë sugjerimet në vijim:

- Çdo rrethanë për të cilën gjykata vërteton se ekziston dhe është relevante duhet të ceket qartë në aktgjykim, si rënduese ashtu edhe lehtësuese.
- Gjukata duhet të paraqesë një përmbledhje relativisht të detajuar të fakteve të cilat gjykata beson se e mbështesin dhe e arsyetojnë gjetjen e rrethanës.
- Gjukata duhet të cekë vlerën e përgjithshme që i jep secilës rrethanë pas deklaramit të fakteve në mbështetje të rrethanës.
- Gjukata duhet t'i referohet numrave të të gjitha rrethanave të cilat nuk ekzistojnë dhe të theksojë se nuk ka fakte që mbështesin rrethanën.
- Nëse ka prova të paraqitura në mbështetje të një rrethane të caktuar lehtësuese/rënduese të cilat gjykata nuk i gjen të besueshme, atëherë duhet ta theksojë këtë në mënyrë specifike dhe ta jep një arsyetim të shkurtër për këtë.
- Gjukata duhet ta theksojë qartë nëse rrethanat janë të barabarta, jo ekzistuese, mbipeshojnë apo mbipeshojnë në mënyrë të konsiderueshme.
- Dënimet me kusht duhet të përfshijnë një arsyetim specifik lidhur me atë se përse gjykata beson se kërcënimi i dënimit mjafton për ta parandaluar të pandehurin nga kryerja e ndonjë vepre tjetër.
- Nëse është aplikuar zbutja nga neni 71 duhet të përfshijë në mënyrë specifike sqarimin se në cilat dispozita të Kodit është mbështetur gjykata për zbutjen e dënimit.

Për të qenë i cilësisë së lartë, vendimi gjyqësor duhet të perceptohet nga palët dhe nga shoqëria në përgjithësi si rezultat i zbatimit adekuat të rregullave juridike, procedurës së drejtë dhe vlerësimit adekuat faktik, si dhe efektivisht i zbatueshëm. Vetëm atëherë palët do të binden se rasti i tyre është shqyrtuar në mënyrë të duhur dhe shoqëria do ta perceptojë vendimin si faktor në rivendosjen e harmonisë sociale. Për t'i arritur këto qëllime, duhet të plotësohen një varg kriteresh.<sup>122</sup>

Duke marrë parasysh se Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Nenin 53 parasheh obligimin që *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, atëherë kjo arsyeshmëri i jep mundësinë sistemit të drejtësisë që aktet e tyre, e në këtë rast në veçanti arsyetimi i aktgjykimit të bazohet në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përfshirja e citimeve të vendimeve të kësaj gjykate, për më tepër, do të shtonte edhe besueshmërinë në vendimmarrjen e gjykatës.

---

<sup>122</sup> Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGjE), Opinioni nr. 11 I KKGjE për vëmendje të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008) nr.35.

## **IX. Shqyrtimi nga shkalla e dytë**

### **1. Diskrecioni i Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e dënimit**

Siç është diskutuar, një nga qëllimet më të rëndësishme të këtij Udhëzuesi është që të zvogëlohet dallimi apo pabarazia në dënime pa hequr diskrecionin e gjyqtarëve për t'iu adaptuar situatave të veçanta. Nëse udhëzimet ndiqen siç duhet, nevoja për shqyrtim nga Apeli do të zvogëlohet dukshëm sikurse që do të zvogëlohen edhe bazat mbi të cilat gjykata duhet ta shqyrtojë vendimin e gjykatës së shkallës më të ulët.

Një shpjegim i plotë i dënimit krijon një regjistër të përhershëm të asaj që gjyqtari e konsideron të rëndësishme për rastin. Ky informacion mund të jetë i vlefshëm në një sërë aspektesh. Në përgjithësi, shpjegimet e mira bëhen një kanal nëpërmjet të cilit njohuritë dhe përvojat e veçanta të gjyqtarëve mund t'u kalojnë politikëbërësve. Kështu, pozicioni i gjyqtarit të instancës së parë mund të japë njohuri të rëndësishme për çështje të tilla si ashpërsia relative e llojeve të ndryshme të veprave penale, efektet e burgosjes mbi të pandehurit dhe familjet e të pandehurve, rëndësia e kerkimit të faljes, struktura e organizatave kriminale dhe ushtrimi i diskrecionit nga policia dhe prokurorët – që të gjitha këto janë çështje me ndikim në zgjedhjen e një dënimi të drejtë.<sup>123</sup>

Është shumë me rëndësi të potencohet se standardet e matjes së dënimit, peshimit të rrethanave dhe arsytimit që të gjitha të përfshira në KPRK, KPPRK dhe këtë Udhëzues JANË të aplikueshme në të njëjtën shkallë edhe për Gjykatën e Apelit, si instancë e dytë. Në fakt, Gjykata e Apelit duhet të shërbejë si model për gjykatën më të ulët në zbatimin e këtyre parimeve. Vetëm në këtë mënyrë arrihet harmonizimi i praktikës në matjen e dënimit.

### **2. Eliminimi i dallimeve apo pabarazive**

Një kritikë e gjithmbarshme e përcaktimit të dënimit, është pabarazia që rezulton nga dënimet në raste të cilat nuk duken të jenë shumë të ndryshme nga njëra tjetra. Në mendjen e publikut, dënimet e pabarabarta të shqiptuara ndaj të pandehurve të dënuar për të njëjtën vepër, pa ndonjë arsytim konkret, përbëjnë tejkalim të paarsyeshëm të diskrecionit të gjykatës dhe mund të shpie në humbjen e respektit për sistemin gjyqësor. Dallimet e pajustificuara në dënime gjithashtu janë të prirura për të penguar rehabilitimin e të burgosurve. Efektet e tilla të padëshirueshme të dallimeve në dënime pengojnë qëllimet e dënimit, të parandalimit dhe rehabilitimit.<sup>124</sup> Andaj, në thelbin e saj, Gjykata e Apelit ka detyrën e rëndësishme të eliminimit të dallimeve potenciale ndërmjet dënimeve, sigurimit të arsytimeve adekuate dhe zvogëlimit të arbitraritetit. Ky vlerësim duhet bazuar në parimet e vëna me KPRK, KPPRK dhe me këtë e Udhëzuesit tjerë të Gjykatës Supreme, kjo e fundit duke qenë e mandatuar, sipas Ligjit për Gjykatat, për harmonizim të praktikave gjyqësore.

---

<sup>123</sup> Michael M. O'Hear, Rishikimi i arsytimit të dënimeve nga Apeli: Duke mësuar nga përvojat federale dhe të Wisconsin [Appellate Review of Sentence Explanations: Learning from the Wisconsin and Federal Experiences], 93 Marq. L. Rev. 751 (2009). Available at: <http://scholarship.law.marquette.edu/mulr/vol93/iss2/15>

<sup>124</sup> *Dupree Julian Glenn*, Revista e së drejtës së Luizianas (Louisiana Laë Revieë), Volumi 33/No.4, ABA Standardet minimale për drejtësinë penale-A, Shqyrtimi i dënimit nga apeli, fq. 561.

Në vendet me sistem gjyqësor dukshëm të konsoliduar dhe të avancuar si p.sh. SHBA-të, vendimet e gjykatave shërbejnë si precedentë për zgjidhje të çështjeve të ngjashme nga gjykatat. Nga ana tjetër, në sistemet e së drejtës kontinentale, vendimet nuk e kanë këtë efekt por pavarësisht kësaj mund të japin udhëzime të vlefshme për gjyqtarët tjerë që merren me raste apo çështje të ngjashme, në rastet të cilat ngritin ndonjë çështje të gjerë shoqërore apo ndonjë çështje të rëndësishme ligjore. Prandaj theksimi i arsyeve, të cilat rrjedhin nga një studim i detajuar i çështjeve ligjore të trajtuara, duhet të bëhet me kujdes të veçantë në raste të tilla në mënyrë që të përmbushen pritjet e palëve dhe të shoqërisë.<sup>125</sup> Siç u bë fjalë më sipër, në Republikën e Kosovës, rastet e trajtuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund të kenë mjaft ndikim në trajtimin e lëndëve në sistemin tonë pikërisht për shkak të Nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Dallimet dëmtojnë sigurinë dhe qartësinë e zbatueshmërisë së kontrollit shoqëror-juridik dhe dëmtojnë rendin shoqëror. Kur dënime uniforme janë të përcaktuara, atëherë çdo shmangie nga dënimi i përcaktuar do të ishte e qartë dhe e dukshme dhe mund të korrigjohet brenda procesit ligjor. Në sistemet juridike bashkëkohore për trajtimin e dallimeve të tilla përdoren zgjidhje procedurale dhe rivendosi e harmonizimit të dënimeve është funksioni i Gjykatës së Apelit. Andaj, kur dy raste identike vijnë para Gjykatës së Apelit dhe për to janë shqiptuar dënime të ndryshme nga gjykatat e instancave më të ulëta, Gjykata e Apelit mund t'i zgjidhë këto dallime duke vendosur se cila gjykatë e instancës më të ultë ka pasur të drejtë apo duke shqiptuar dënime të reja identike ndaj kryesve. Megjithatë, rastet krejtësisht identike me karakteristika identike personale dhe jo personale janë shumë të rralla. Kur dallimet në dënime vijnë si rezultat i gjendjeve të ndryshme faktike të rasteve, mund të arsyetohet në aspektin social pasi që rastet e ndryshme kërkojnë trajtim të ndryshëm social. Por, kur dallimet në dënime vijnë si rezultat i përvojave të ndryshme gjyqësore apo pikëpamjeve të ndryshme të gjykatave, atëherë kjo kuptohet si një padrejtësi që kërkon korrigjim.<sup>126</sup>

Një vendim gjyqësor duhet të plotësojë një numër kërkesash në lidhje me atë se cilat parime të përgjithshme mund të identifikohen, pavarësisht karakteristikave specifike të secilit sistem gjyqësor dhe praktikave të gjykatave në vendet e ndryshme. Pikënisja është se qëllimi i vendimit gjyqësor është jo vetëm për të zgjidhur kontestin për t'u dhënë palëve siguri juridike, por shpesh edhe për të krijuar praktikën gjyqësore e cila mund të parandalojë shfaqjen e kontesteve tjera dhe të sigurojë harmoninë shoqërore. Gjyqtarët në përgjithësi duhet ta zbatojnë ligjin në mënyrë konsistente. Megjithatë, kur gjykata vendos për t'u shmang nga praktika e mëparshme gjyqësore, kjo duhet të ceket qartë në vendimin e saj. Në rrethana të jashtëzakonshme, mund të jetë e përshtatshme për gjykatën që të specifikojë se ky interpretim i ri zbatohet vetëm nga data e vendimit në fjalë apo nga data e përcaktuar në vendimin e tillë.<sup>127</sup>

### **3. Standardi i 'gabimit të dukshëm'**

Sipas Dhomës së Apelit të TNPJ-së, "*ankesa kundër dënimit është ankesë stricto sensu; është korrigjuese në natyrë dhe jo gjykim de novo (i ri). Trupat gjykues janë të autorizuar me*

<sup>125</sup> Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Opinioni Nr. 11 i KKGJE për vëmendjen e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008).

<sup>126</sup> Hallevy, Gabriel. E drejta për t'u dënuar: dënimi modern doktrinal. Springer Science & Business Media, 2012.

<sup>127</sup> Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Opinioni Nr. 11 i KKGJE për vëmendjen e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008).

diskrecion të gjerë në caktimin e dënimit të përshtatshëm, për shkak të detyrimit të tyre për të individualizuar dënimet për t'iu përshtatur rrethanave të akuzuarit dhe peshës së veprës. Si rregull, Dhoma e Apelit nuk do ta zëvendësojë dënimin e saj për atë të shqiptuar nga trupi gjykues përveç nëse pala ankimore dëshmon se trupi gjykues ka bërë "gabim të dukshëm" në ushtrimin e diskrecionit të saj apo në rast se ka dështuar për ta zbatuar ligjin e aplikueshëm. I mbetet palës e cila e kundërshton dënimin për të dëshmuar se si trupi gjykues ka tejkaluar kornizën e saj diskrecionale në shqiptimin e dënimit... Në këtë drejtim, ankuesi duhet të dëshmojë se trupi gjykues: (i) i ka dhënë peshë konsideratave të parëndësishme apo jorelevante; (ii) ka dështuar t'i jep peshë apo peshë të mjaftueshme konsideratave relevante; (iii) ka bërë gabim të qartë lidhur me faktet mbi të cilat ka ushtruar diskrecionin e tij; apo (iv) ka marrë vendim i cili është aq i paarsyeshëm apo thjeshtë i padrejtë sa që Dhoma e Apelit është në gjendje të nxjerrë përfundimin se trupi gjykues ka dështuar ta ushtrojë drejt diskrecionin e tij.<sup>128</sup>

**I njëjti parim është përdorur edhe në rastin Aleksovski dhe Tadiq:** "Në sisteme juridike kontinentale, siç janë Gjermania dhe Italia, Kodet Penale përkatëse përcaktojnë se cilat rrethana duhet t'i merr parasysh gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit. **Gjykatat e Apelit mund të ndërhyjnë në diskrecionin e gjykatave më të ulëta nëse shqyrtimet e tyre kanë shkuar përtej atyre rrethanave apo nëse kanë shkelur dënimin e paraparë minimal apo maksimal.** Dhoma e Apelit e ka ndjekur këtë praktikë të përgjithshme. Prandaj në rastin Prokurori kundër Tadiqit, Dhoma e Apelit ka mbajtur qëndrimin se **nuk duhet të ndërhyjë në ushtrimin e diskrecionit të Trupit Gjykues lidhur me dënimin përveç nëse ka ndonjë "gabim të dukshëm"...** Ky gabim konsistonte në dhënien e peshës së pamjaftueshme shkallës së sjelljes nga Parashtruesi i Ankesës dhe dështimit për ta trajtuar pozitën e tij si komandant, si rrethanë rënduese në raport me përgjegjësinë e tij sipas nenit 7(1) të Statutit".<sup>129</sup>

Si e tillë, gjykata duhet të bëjë përpjekje t'i kufizojë shqyrtimet e saj të "përshtatshmerisë" së dënimit në situatat në të cilat ka nevojë për ta zgjidhur në mënyrë definitive ndonjë çështje dhe/ose nëse ka zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit.

I njëjti rekomandim që vlen për gjykatat e instancës së parë vlen edhe për Gjykatën e Apelit, që e njëjta me rastin e vendosjes sipas ankesës të ketë parasysh në mënyrë primare peshën e veprës dhe rrethanat nën të cilat është kryer ajo veprë për të mos lejuar që një rrethanë e rëndësishme të vogël të ndikojë në uljen e dënimit. Fatkeqësisht, në praktikën tonë, ende gjejmë raste të tilla kur nuk bëhet peshimi i duhur i rrethanave. Kështu në një rast Gjykata themelore kishte shpallur fajtor të pandehurin duke i shqiptuar dënim në kohëzgjatje prej 1 viti, për shkak se i njëjti pas një mosmarrëveshje familjare kishte goditur të dëmtuarën me grusht në fytyrë duke i shkaktuar lëndime e që nga ekspertiza mjeko-ligjore konstatohet se e dëmtuara ka pësuar lëndim të lehtë trupor të sanksionuar me Nenin 185 par. 3 nën par. 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së. Në arsyetimin e vendimit të kësaj gjykate, tregohet se si e dëmtuara në shqyrtimin gjyqësor kishte ndryshuar deklaratën duke thënë se i akuzuari nuk kishte ushtruar dhunë ndaj saj. Gjykata e shkallës së parë në bazë të provove rrethanore gjeti se këtë deklaratë e dëmtuara e ka dhënë nën ndikimin e dhunës apo kanosjes të cilën e kanë ushtruar mbi të i akuzuari dhe burri i saj. Gjykata

<sup>128</sup> Rasti nr.IT-08-91-A, Aktgjykimi i Dhomës së Apelit në rastin Prokurori kundër Mico Stanisiq & Stojan Zupljanin, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (30 qershor 2016), Par.1100

<sup>129</sup> Rasti Nr.IT-95-14/1-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zlatko Aleksovski, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (24 mars 2000), Par.186-187, citohet Prokurori kundër Tadiq, Rasti Nr.: IT-94-1-A dhe IT-94-1-Abis, Aktgjykimi në ankesën ndaj dënimit.

e shkallës së dytë kishte ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket dënimit, të pandehurit i shqipton dënim me kusht në kohëzgjatje prej 1 viti, dënim ky i cili nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës 2 vjeçare. Kjo gjykatë përveç rrethanave të përshkruara nga gjykata e shkallës së parë, nga ankesa e mbrojtësit, ka gjetur si rrethanë posaçërisht lehtësuese se e dëmtuara ka hequr dorë nga ndjekja penale.

Nga analiza e dy vendimeve shihet se Gjykata e Apelit ka zbutur dënimin ndaj të pandehurit duke u thirrur në një rrethanë posaçërisht lehtësuese heqja dorë nga ndjekja penale nga e dëmtuara, edhe pse gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se e dëmtuara kishte ndryshuar deklaratën si pasojë e dhunës apo kanosjes nga i akuzuari dhe burri i saj.

## **II. Pjesa e veçantë**

# **I. Kapitulli XIV Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës**

## **Shqyrtime të përgjithshme**

Veprat e mbuluara nga ky kapitull mund të ndahen në tre grupe dhe atë në bazë të shkallës së rrezikshmërisë që paraqesin ato vepra:

1. Dënimet maksimale me minimume ligjore shumë të larta prej 5, 10, 12, 15 vjet dhe maksimume prej 20 vjet apo edhe burgim të përjetshëm.
2. Dënime mesatare deri në 10 vjet; dhe
3. Dënime të ulëta deri 6 muaj, 1, 3 dhe 5 vjet.

Vet fakti se veprat që i referohen sigurisë dhe rendit kushtetues prekin aspekte që cenojnë shtetësinë dhe stabilitetin shtetëror, tregon për arsyen pse dënimet e parapara janë kaq të larta.

Po ashtu duhet vënë theksin në faktin se në kuadër të këtij kapitulli ligjvënësi ka përfshirë edhe veprat penale të terrorizmit. Kjo kategori e veprave paraqet një dukuri më vete me karakteristikën që janë vepra të karakterit jo vetëm vendor, por vepra të dimensionit global me potencialin për kërcënime në masë. Në Republikën e Kosovës, sanksionimi i këtyre veprave është i shpërndarë në tre ligje të ndryshme<sup>130</sup> andaj edhe ky Kapitull është ndarë në analizë në dy pjesë të ndryshme ku njëra i dedikohet veprave penale të terrorizmit dhe pjesa tjetër i dedikohet veprave tjera kundër rendit kushtetues dhe sigurisë të cilat nuk kualifikohen si vepra terroriste.

---


<sup>130</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë; Ligji Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 18 / 15 qershor 2016, Prishtinë; Ligji Nr. 05/L -002 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 7 / 02 prill 2015, Prishtinë.



# 1. Rendi kushtetues dhe siguria

## A. Pikënisja

Më poshtë do të gjeni disa rekomandime për kategoritë e veprave penale për veprimtaritë kundër kushtetuese dhe kundër sigurisë së Republikës së Kosovës përjashtuar veprat e terrorizmit:



- Vlen të theksohet se për veprat e kryera si grup kriminal nuk është paraparë pikënisje e veçantë duke qenë se të njëjtat janë të sanksionuara me nenin 127<sup>131</sup> të KPRK-së.
- Po ashtu duhet bërë me dije se sa i përket veprave për të cilat si dënim është paraparë edhe burgimi i përjetshëm pikënisja NUK ZBATOHET nëse gjykata e shqipton këtë dënim. Sa i përket kësaj çështje gjyqtarët udhëzohen të shqyrtojnë Pjesën I të këtij Udhëzuesi, më saktë Pikën III-Dënimet kryesore sipas KPRK-së.

## B. Rrethanat rënduese relevante

- *Keqpërdorimi i pushtetit ose pozitës zyrtare nga par. 2.9 i Nenit 70*, duhet të merret parasysh në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me këto vepra penale, gjithnjë duke përjashtuar rastet kur kemi të bëjmë me ato nene, respektivisht paragrafë kur pozita e tillë paraqitet si element i veprës penale.
- *Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar* - Në rastet kur pozita zyrtare paraqet element të veprës penale, kjo nuk ndalon gjykatën që të merr parasysh rrethanat nga paragrafi 2.1 të Nenit 70, gjithnjë duke peshuar se në çfarë mase dhe çfarë mënyre ka qenë i përfshirë personi në kryerjen e këtyre veprave. Anasjelltas, rrethana nga paragrafi 3.5 i po këtij neni mund të ndikojë në zbutjen e dënimit. Edhe pse, parimisht si rrethanë rënduese e njëjta gjen zbatim në rastet e bashkëkryerjes. Për veprat nga ky kapitull, në rastet e bashkimit në grup të organizuar kriminal, gjen zbatim dispozita e Nenit 127 andaj duke qenë se paraqitet si element i veprës penale atëherë nuk mund të merret si rrethanë rënduese për të shmangur dyfishimin.
- *Shkalla e lartë e dashjes* - adreson këmbëngulësinë për kryerjen e veprës penale kur përmes shkallës së angazhimit të kryesit, në një mënyrë ndihmohet në përcaktimin e shkallës së dashjes

<sup>131</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 127 Bashkimi për veprimtari kundër kushtetuese, Kodi nr, 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë;

në kryerjen e veprës penale. Këmbëngulja paraqet faktor me shumë rëndësi për vendosmërinë e kryesit në kryerjen e veprës.

- Edhe rrethanat tjera rënduese të parapara me Nenin 70 të KPRK-së mund të jenë të aplikueshme në veprat sipas këtij kapitulli gjithnjë duke pasur kujdes në mosdyfishim me elementet e veprës penale. Për qëllime elaborimi po marrim *shkallën e dëmit të shkaktuar* si rrethanë rënduese e paraparë me par. 2.8<sup>132</sup> duke u siguruar për mos dyfishim me elementet e veprës penale. Kjo për faktin se Neni 126<sup>133</sup> në paragrafët 1.1-1.4 i referohet shkallës së dëmit të shkaktuar për veprat nga nenet 113-127 të këtij kapitulli. Kjo nënkupton se vet lidhja e cilësdo vepër nga nenet e sipërpërmendura me nenin 126 e pamundëson përfshirjen e rrethanës nga neni 2.8 si rrethanë rënduese.
- *Rrethanat lidhur me viktimat* - Të gjitha rrethanat nga par. 2.4-2-7 mund të jenë relevante varësisht nga lloji i veprës së kryer. Disa nga veprat e këtij kapitulli i referohen veprave të kryera ndaj përfaqësuesve të lartë shtetëror. Megjithatë, disa nga veprat kanë të bëjnë me rrezikshmërinë që mund ti shkaktohet popullsisë civile përmes shkatërrimit të infrastrukturës, objekteve apo pajisjeve etj., të cilat kanë potencialin për shkaktimin e një numri më të madh të viktimave. Shumë nga këto rrethana, që i referohen viktimave dhe shkallës më të lartë të rrezikshmërisë që i ekspozohen tashmë, janë të përfshira si element të veprës në Nenin 126<sup>134</sup> të KPRK-së, andaj duhet pasur kujdes për të mos e dyfishuar me rrethanat rënduese. Gjykatat duhet të kenë parasysh të mos bëjnë dyfishim.

### C. Rrethanat lehtësuese relevante

- *Pranimi i fajësisë apo marrëveshja mbi pranimin e fajësisë* në veprat me dënime maksimale dhe mesatare sipas këtij Kapitulli, nuk duhet të konceptohet si zbutje automatike nën minimumin ligjor në rastet kur të njëjtat nuk shoqërohen me rrethana tjera jashtëzakonisht lehtësuese.
- Duke pasur parasysh që kryerja e këtyre veprave shkakton çrregullim të ekuilibrit, jo vetëm të një rrethi të ngushtë por edhe të gjithë infrastrukturës shtetërore, gjykatat duhet pasur shumë kujdes në peshën që i japin rrethanave lehtësuese. Kjo sidomos i referohet rrethanave shumë subjektive e personale të kryesit, të cilat do të duhej të kenë peshë minimale në raport me rrethanat tjera rënduese apo edhe vetë përgjegjësinë dhe shkallën e dëmit të shkaktuar.

### D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera

- *Shqiptimi i dënimit me kusht* - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët apo mesatar, por gjithnjë duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar. Ky dënim nuk arsyetohet në rastet kur kryesi vepron si pjesë e grupit të organizuar kriminal, përveç nëse ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese.
- *Shqiptimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat arsyetojnë dënimin me burgim.

---

<sup>132</sup> Shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes te viktimat apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar ndaj viktimës ose familjes së tij;

<sup>133</sup> Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës.

<sup>134</sup> Mu aty.

- Shqiptimi i dënimit me gjobë - Neni 140<sup>135</sup> paragrafët 1 dhe 2 paraqesin kategorinë e veprave më të lehta brenda këtij kapitulli andaj edhe është paraparë si mundësi shqiptimi i dënimit me gjobë si dënim kryesor. Njësoj është edhe me veprën nga Neni 141 paragrafi 1.<sup>136</sup> Në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par .5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>137</sup>
- Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 62<sup>138</sup> apo 63<sup>139</sup>- rekomandohet të shqiptohet në të gjitha rastet kur personi zyrtar është i përfshirë në kryerjen e veprave nga ky kapitull. Në shumë raste shqiptimi i këtij dënimi plotësues do të ketë efekt më të madh dhe mund të arrijë qëllimin e dënimit krahasuar me format tjera të dënimit.
- Shqiptimi i dënimeve tjera plotësuese - mund të jetë i arsyeshëm duke pasur parasysh natyrën e veprave të këtij kapitulli. P.sh. Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës nga neni 67 i KPRK-së.
- Vërejtja gjyqësore - Në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Nenit 82 mund të shqiptohet për veprat më të lehta të këtij Kapitulli dhe nuk mund të aplikohet kur kryesi ka të kaluar kriminale.
- Lirimi nga dënimi - është paraparë si mundësi vetëm në par. 3 të Nenit 127 dhe atë nëse anëtari i grupit apo bashkimit e lajmëron grupin para kryerjes së veprës penale, gjë që është në linjë edhe me dispozitat e zbutjes nga par. 4 i Nenit 277<sup>140</sup> të KPRK-së.

---

<sup>135</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, 140 Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>136</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 141 Nxitja e përçarjes dhe mos durimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>137</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e përgjithshëm e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>138</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 62 Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>139</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 63 Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>140</sup> Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar.

## ***2. Veprat penale të terrorizmit dhe veprat që ndërlidhen me to***

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Terrorizmi në Kosovë rregullohet me tre ligje të ndryshme: Kodin Penal të Republikës së Kosovës,<sup>141</sup> Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit,<sup>142</sup> dhe Ligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.<sup>143</sup> Ndërsa këto ligje mbulojnë veprat penale të terrorizmit, fakti që tre ligje të ndryshme zbatohen në lëndët e terrorizmit mund të çojë në paqartësi se cili ligj apo cila vepër penale është e aplikueshme. Kjo është arsyeja pse caktimi i dënimit për këto vepra penale diskutohet veçmas nga veprat penale të tjera të Kapitullit XIV. Qëllimi i këtij udhëzuesi specifik për veprat penale që lidhen me terrorizmin është të ofrojë mjet pune për sistemin e drejtësisë gjatë trajtimit të lëndëve që lidhen me terrorizmin. Materiali do të përfshijë gjithashtu referime ndaj jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut lidhur me çështjet e terrorizmit.

Rezoluta 1566 (2004) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së ripohon qartë se terrorizmi në të gjitha format dhe manifestimet e tij përbën një nga kërcënimet më serioze për paqen dhe sigurinë. Rezoluta thekson se shtetet “duhet të sigurojnë që çdo masë e ndërmarrë për luftimin e terrorizmit të jetë në përputhje me të gjitha detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare dhe do të duhej të adoptojnë këto masa në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, refugjatëve dhe të drejtën humanitare”.<sup>144</sup> Kjo Rezolutë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare e bëjnë të qartë se terrorizmi është kërcënim që nuk njihet kufij dhe për këtë arsye çdo masë e ndërmarrë në përgjigje ndaj veprimeve dhe kryesve të veprave penale të terrorizmit do të duhej të konsiderohej, krahas kërcënimit global që paraqet dhe jo në mënyrë të izoluar për shtetin e caktuar. Për shkak se Kosova ka detyrimin t’i bashkohet kësaj përpjekjeje globale në luftimin e terrorizmit, sistemi i drejtësisë duhet të kuptojë se masat ndëshkuese dhe/ose parandaluese do të duhej të shihen nga perspektiva e kërcënimit të përgjithshëm.

Kryesit e veprave penale të terrorizmit nuk i përshtaten një profili të caktuar. Megjithatë, ata ndodh që të radikalizohen, fillimisht si adoleshentë dhe kanë pak ose aspak histori të sjelljes kriminale ose të dhunës së vërtetë. Zbërthimi i motiveve rrënjësore dhe kuptimi i shkallës së radikalizimit të kryesve janë faktorë që duhet të merren parasysh nga profesionistët e drejtësisë penale kur të përcaktojnë dënimin e duhur.<sup>145</sup>

---

<sup>141</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>142</sup> Ligji nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 18 / 15 qershor 2016, Prishtinë.

<sup>143</sup> Ligji nr. 05/L-002 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 7 / 02 prill 2015, Prishtinë.

<sup>144</sup> Rezoluta 1566 (2004), [për bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit], adoptuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij të 5053-të, më 8 tetor 2004.

<sup>145</sup> Kevin D.Lowry: Responding to the Challenges of Violent Extremism/Terrorism Cases for United States Probation and Pretrial Services, Journal for Deradicalization, Winter 2018/19, Nr.17, ISSN:2363-9849, Gjykata e Distriktit të Minesotas.

## A. Terrorizmi dhe të drejtat e njeriut

Terrorizmi është akt kriminal që nuk justifikohet kurrë. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e terrorizmit thotë: *“Duke njohur se veprat penale të terrorizmit dhe veprat penale sipas kësaj Konvente, pa marrë parasysh kush i ka kryer, në asnjë rrethanë nuk justifikohen me konsiderata të natyrës politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike, fetare apo të tjera të ngjashme, dhe duke kujtuar detyrimin e të gjitha palëve për të parandaluar veprat penale të tilla dhe, nëse nuk janë në gjendje për të parandaluar, atëherë, për të ndjekur penalisht dhe për të siguruar që kryesit të ndëshkohen me dënime që marrin parasysh natyrën e tyre të rëndë.”*<sup>146</sup> Grupi i instrumenteve ndërkombëtare kundër terrorizmit mbështetet në dënimin pa ekuivok të këtij lloj krimi, pa asnjë koncesion për asnjë mundësi justifikimi ideologjik.<sup>147</sup>

Qëllimet e lejuara legjitime për kufizimin e ushtrimit të disa të drejtave mund të përfshijnë sigurinë kombëtare, sigurinë publike, rendin publik, shëndetin, moralin dhe të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të të tjerëve. Në rastet që përfshijnë kërcënime terroriste, siguria publike dhe/ose siguria kombëtare janë qëllimet më të mundshme për t’u përdorur për të justifikuar masat që kufizojnë të drejta të caktuara.<sup>148</sup> Përderisa masa të tilla janë të parapara me legjislacionin penal, gjykatat do të duhej t’i përdorin ato. Ky parim është inkorporuar edhe në vet Nenin 4 të KPRK-së në të cilin theksohet se: *“ Me ekzekutimin e sanksionit penal ose masës së trajtimit të detyrueshëm, kryesit të veprës penale mund ti kufizohen të drejtat e caktuara vetëm deri në atë masë e cila i përgjigjet natyrës apo përmbajtjes së sanksionit ose masës dhe vetëm në mënyrën me të cilën sigurohet respektimi i dinjitetit njerëzor, në pajtim me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.”*<sup>149</sup>

## B. Përkufizimi i veprave penale të terrorizmit

Neni 128 paragrafi 1 i KPRK-së përkufizon terrorizmin për qëllime të veprave penale të përfshira në kapitullin XIV dhe atë si në vijim:

Terrorizëm, veprim terrorist apo vepër terroriste - nënkupton kryerjen e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me **qëllim**:

- a. të frikësimit serioz të popullsisë,
- b. të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo

---

<sup>146</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e terrorizmit, Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës Nr.196, Varshavë, 16.V.2005.

<sup>147</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, Manual mbi përgjigjet e drejtësisë penale ndaj terrorizmit, Seria e Manualeve të drejtësisë penale, f. 40, 2009.

<sup>148</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, Manual mbi përgjigjet e drejtësisë penale ndaj terrorizmit, Seria e Manualeve të drejtësisë penale, f. 20, 2009.

<sup>149</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 5, Kufizimet në ekzekutimin e sanksioneve penale dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.


- c. që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare.

Neni i mësipërm liston në vijim një sërë veprash penale sipas KPRK-së të cilat kryhen për qëllime terrorizmi duke përfshirë veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër integritetit seksual dhe veprat penale nga kapitulli XV.<sup>150</sup> Bazuar në përkufizimin e mësipërm, është e qartë se në mënyrë që një vepër penale të bie brenda përkufizimit të terrorizmit sipas KPRK-së, duhet të plotësohet një nga qëllimet specifike të renditura nën a. - c.

Vlen të përmendet se megjithëse terrorizmi paraqet vepër të kryer me dashje specifike, shpesh nuk ka prova të dukshme të dashjes së të pandehurit. Në vend të kësaj, dashja mund të duhet të provohet përmes provave rrethore (shemb. historia e kërkimit në internet të kryer nga i pandehuri, kontaktet e tyre të ngushta, etj.), njëjtë sikurse thekson edhe vet Neni 22 i KPRK-së.<sup>151</sup>

### C. Pikënisja

Është e rëndësishme të theksohet se trajtimi jo-efektiv i kryesve të veprave penale të terrorizmit mund të rezultojë në pasoja të tmerrshme dhe katastrofike që shkojnë nga lirimi i kryesve të rrezikshëm për të kryer akte terrorizmi në komunitet, deri te burgimi i panevojshëm i kryesve shumë të rinj, duke krijuar mbase mjedise afatgjata mbarështimi për terroristët në burg.



Grafiku i mësipërm tregon pikënisjet e ndryshme për lloje të ndryshme të kryesve:

<sup>150</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XV, Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>151</sup> Neni 22 i KPRK thekson: “Dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike.”

- Kryesit për herë të parë zakonisht paraqesin rrezikshmëri më të ulët për përsëritje të kryerjes në krahasim me kryesit e tjerë me të kaluar të dhunshme ose ata që veprojnë në grupe. Për këto arsye, pikënisja është më e ulët për kryesit që për herë të parë bien ndesh me ligjin. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ata nuk mund të jenë të rrezikshëm, prandaj vlerësimi i nivelit të dëmit dhe fajësisë është vendimtar për të përcaktuar dënimin e duhur.
- Pikënisjet për zyrtarët publikë të përfshirë në vepra penale të lidhura me terrorizmin janë më të larta sesa për individët e zakonshëm. Kjo për dy arsye: për faktin se janë persona të cilëve iu është besuar një autorizim publik dhe në vend të ushtrimit të detyrës të njëjtit kanë keqpërdorur besimin e dhënë; po ashtu për shkak se personat zyrtarë shpesh kanë më shumë qasje në burime publike (në varësi nga funksioni i tyre). Gjykata duhet së pari të marrë në konsideratë pikënisjen (1/2 për zyrtarët publikë) dhe më pas të marrë në konsideratë rrethanat rënduese sipas paragrafit 2.9 të nenit 70.
- Recidivistët dhe kryesit që veprojnë si pjesë e grupit të organizuar kriminal paraqesin rrezikshmëri më të lartë, kështu që pikënisja është më e larta për këto kategori. Duhet qartësuar se kategoria e fundit është e sanksionuar me Nenin 136 dhe pikënisja prej 2/3 vlen edhe për këtë nen. Po ashtu duhet bërë me dije se sa i përket veprave për të cilat si dënim është paraparë edhe burgimi i përjetshëm pikënisja NUK ZBATOHET nëse gjykata e shqipton këtë dënim. Sa i përket kësaj çështjeje gjyqtarët udhëzohen të shqyrtojnë Pjesën I të këtij Udhëzuesi, më saktë Pikën III-Dënimet kryesore sipas KPRK-së.

#### **D. Rrethanat rënduese relevante për veprat penale që lidhen me terrorizmin**

Neni 70 i KPRK-së parashikon listë jo shteruese të rrethanave rënduese për t'u konsideruar në caktimin e dënit. Është e rëndësishme të kuptohen dhe aplikohen siç duhet rrethanat më relevante në një kontekst të lidhur me terrorizmin. Më poshtë është dhënë një analizë e rrethanave të parapara me KPRK, por edhe disa tregues/indikatore<sup>152</sup> që (pikërisht për shkak se KPRK-ja parasheh listë jo shteruese) mund të shërbejnë për sqarim të rrethanave të parapara me KPRK. Shumica e treguesve të renditur më poshtë janë marrë nga udhëzuesi lidhur me veprat penale të terrorizmit që aplikohet në Mbretërinë e Bashkuar.<sup>153</sup> Analiza e mëposhtme bazohet gjithashtu në jurisprudencën e GJEDNJ-së, publikime të ndryshme dhe doracakë për këtë çështje.

Siç është theksuar disa herë në Udhëzues, gjykata nuk mund të përdorë një rrethanë rënduese e cila në të njëjtën kohë përbën element të figurës së veprës penale. Prandaj, rrethanat e përshkuara më poshtë janë të aplikueshme vetëm nëse nuk paraqiten edhe si element i figurës së veprës penale, apo edhe në rastet kur me qëllim të sqarimit të peshës së atij elementi, rrethana përdoret si pikë referente.

<sup>152</sup> Fjala indikatorë apo tregues e përdorur në tekst i referohet tre situatave të ndryshme: (1) rastit kur ai tregues mund të përdoret si rrethanë rënduese/lehtësuese duke qenë se KPRK-ja përmban një listë jo-shteruese në Nenin 70; (2) disa tregues ndihmojnë gjykatën për të konstatuar ekzistimin apo jo të një rrethane lehtësuese apo rënduese; apo (3) disa tregues i ndihmojnë gjykatës për të përcaktuar më mirë peshën e një rrethane lehtësuese/rënduese në kontekst të matjes së dënit për një vepër të caktuar.

Për dallim nga rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga Neni 70 i KPRK të cilat janë të përgjithësuara për të gjitha veprat brenda KPRK, treguesit, përqendrohen në situata rreth veprës specifike në fjalë.

<sup>153</sup> Këshilli i Caktimit të Dënimeve i Mbretërisë së Bashkuar, Veprat penale të terrorizmit, Udhëzues për Caktimin e Dënimeve, 27 prill 2018.

Është me rëndësi vendimtare që gjykatat të vlerësojnë rrethanat jo në mënyrë të izoluar, por gjithmonë duke i krahasuar me rrethana tjera rënduese dhe lehtësuese, pasi kjo i jep rrethanës vlerën e vërtetë. Çështja *Z.B. kundër Francës* është një shembull se si gjykatat franceze dhe GJEDNJ i kanë marrë në konsideratë të gjitha rrethanat rënduese relevante dhe nuk i kanë vlerësuar rrethanat në mënyrë të izoluar. Kështu në vitin 2012, njëmbëdhjetë vjet pas sulmeve të 11 shtatorit, i pandehuri i dha nipit të tij një bluzë me fjalët “*Unë jam bombë!*” në pjesën e përparme dhe “*Xhiahadi, i lindur më 11 shtator*” në anën e pasme. Një gjykatë franceze e shpalli të pandehurin fajtor për mosdënim apo pranim të atij krimi për dy arsye: Së pari, megjithëse më shumë se njëmbëdhjetë vjet ndanin sulmet e 11 shtatorit nga ngjarjet e çështjes, gjykata vuri në dukje se parullat e çështjes u shfaqën vetëm disa muaj pas sulmeve të tjera të terrorizmit fundamentalist në Francë që rezultuan me vdekjen e tre fëmijëve në një shkollë. Gjykata arsyetoi se kalimi i kohës nuk e pakëson rëndësinë e mesazhit të paraqitur në bluzë. Së dyti, gjykata arsyetoi se fakti që kërkuesi nuk kishte lidhje me asnjë grup terrorist dhe nuk kishte përqafuar ideologji terroriste po ashtu nuk mund të zbehte rëndësinë e atij mesazhi.<sup>154</sup> Në apel, GJEDNJ-ja nuk gjeti shkelje të nenit 10 në kuptim të kontekstit në të cilin ndodhi veprimi, duke përfshirë sulmet terroriste në Tuluzë në të cilat tre fëmijë ishin vrarë jashtë shkollës së tyre, si dhe në kontekstin specifik, domethënë shfrytëzimin e një fëmije trevjeçar.<sup>155</sup> Rasti i mësipërm është shembull i mirëfilltë i përcaktimit të duhur nga gjykata të peshës së secilës prej rrethanave të dhëna dhe ndërlidhjen e tyre mes vete.

Siç parashtrohet në tekstin e Udhëzuesit, rrethanat që lidhen me fajësinë dhe dëmin janë rrethanat më të rëndësishme në përcaktimin e dënimit të duhur. Për më tepër, është e rëndësishme të njihen nivelet e ndryshme të dëmit dhe fajit të përcaktuara sipas treguesve të caktuar.

*i. Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të shpallur fajtor në veprën penale<sup>156</sup> dhe shkalla e lartë e dashjes nga ana e personit të shpallur fajtor.<sup>157</sup>*

Duke qenë se dashja paraqitet si pjesë integrale e vet përkufizimit të veprës penale të terrorizmit sipas nenit 128 të KPRK-së, dashja konsiderohet tashmë se paraqet element të veprave penale të terrorizmit. Atë që kërkon par. 2.2 i Nenit 70, është përcaktimi i nivelit të asaj dashjeje. Kjo shpesh vërtetohet përmes morisë së veprimeve të kryesit por edhe përmes provave rrethanore.

Niveli i pjesëmarrjes mund të përdoret qoftë si tregues i shkallës së dashjes së kryesit, qoftë si përcaktim i rolit dhe kontributit të kryesit, prandaj këto diskutohen të dyja bashkë. Niveli i angazhimit/pjesëmarrjes së kryesit është shumë me rëndësi kur kryesi vepron si pjesë e grupit të organizuar ose në bashkëkryerje. Pësia e kësaj rrethane varet nga lloji i veprës penale të kryer dhe/ose nga mbizotërimi i rrethanave tjera rënduese. Treguesit e mëposhtëm janë të rëndësishëm

---

<sup>154</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 60Z.B. kundër Francës, Kërkesa Nr. 46883/15, (2 shtator 2021), <https://hudoc.echr.coe.int/fre?i=002-13388>

<sup>155</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Udhëzues për jurisprudencën lidhur me Konventën-Terrorizmi, Azhurnuar më 31.08.2022.

<sup>156</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 2.1., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>157</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 2.2., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.



sepse janë tregues të rrethanave të mësipërme (pjesëmarrja dhe dashja) si dhe të rrethanave tjera rënduese të renditur më poshtë.<sup>158</sup>

- a. Udhëtimi jashtë Kosovës për aktivitete të lidhura me terrorizmin. Fakti që i pandehuri ka udhëtuar dhe/ose ka marrë pjesë në aktivitete terroriste jashtë Kosovës nuk do të duhej të shihet si shenjë e dëmit më të vogël që rezulton në dënim më të ulët. Përkundrazi, përpjekja e ndërmarrë nga kryesi për të udhëtuar në vend tjetër për të marrë pjesë në aktivitete terroriste ose për t'iu bashkuar grupeve terroriste duke pasur parasysh tejkalimin e pengesave të shumta gjatë udhëtimit do të duhej të konsiderohet faktor rëndues me shumë peshë dhe si tregues i qartë i nivelit të lartë të pjesëmarrjes dhe dashjes së të pandehurit për tu përfshirë në vepra të dhunshme.
- b. Tej-identifikimi me një grup ose kauzë.
- c. Njohuri direkte apo të arsyeshme që bashkëngjitja në organizata terroriste do të rezultonte në trajnim ushtarak dhe/apo që pritshmëritë do të jenë që personi apo anëtarët e familjes së tij/saj të angazhohen në konflikt të armatosur.
- d. Njohuri direkte apo të arsyeshme se pjesëmarrja në një organizatë terroriste do të ketë ndikim në anëtarët e familjes, apo do të krijojë pritshmëri që anëtarët e familjes të marrin pjesë apo ofrojnë mbështetje për organizatën terroriste, apo edhe ti ekspozojë fëmijët në konflikt të armatosur.
- e. Shfletimi i materialeve ekstremiste (qoftë edhe shikim pasiv) posaçërisht nëse ato materiale glorifikojnë veprime të dhunshme apo inkurajojnë mbështetje të kryesve apo aktiviteteve të dhunshme.
- f. Motivimi ideologjik për angazhim në terrorizëm duke përfshirë edhe deklaratat publike që shprehin nivele të larta të ndjenjave kundër Kosovës dhe/ose vendeve të tjera perëndimore.
- g. Përpjekje të shumëfishta dhe shumë të kalkuluara për të kryer veprën penale dhe/ose përpjekje të vazhdueshme për të kryer aktivitete që lidhen me terrorizmin edhe pas përpjekjeve për ndërhyrje nga familja ose forcat ligj-zbatuese.
- h. Komunikimi me ekstremistë të tjerë (*duke përfshirë individë që janë pjesë e një organizate të huaj terroriste*). Fakti nëse kryesi kishte lidhje terroriste është i rëndësishëm pasi kjo do të shtonte seriozitetin dhe peshën e këtij faktori. Ky mund të jetë ose tregues i përkushtimit të shtuar të kryesit dhe aftësisë së tij/saj për tu kyçur në akte të dhunshme apo mund të paraqitet si tregues për tu ri angazhuar në këto veprime pas kryerjes së dënimit; apo edhe të të dyja rasteve.
- i. Përdorimi i metodave të sofistikuara të komunikimit me elementë tjerë kriminal për t'iu shmangur zbulimit.
- j. Përdorimi ose ofrimi i identifikimit të rremë ose mashtrues ose ndryshimi i emrit në një “emër luftarak”, tatuazheve ose posedimit të simboleve a objekteve të tjera ekstremiste.
- k. Përdorimi i qëllimshëm i komunikimeve të enkriptuara ose teknologjive të ngjashme për të lehtësuar kryerjen e veprës penale dhe/ose për të shmangur ose penguar zbulimin.
- l. Mosrespektimi i urdhrave aktuale të gjykatës.
- m. Mospranimi i përgjegjësisë për veprimet ose mosshfaqja e pendesës për pasojën e shkaktuar edhe pas konstatimit të përgjegjësisë.

---

<sup>158</sup> Përcaktimi i treguesve të renditur më poshtë mund të konsiderohet fare mirë si njëfarë vlerësimi i rrezikshmërisë që paraqet kryesi për shoqërinë duke analizuar secilin veprim/segment të veprimeve të kryesit për të përcaktuar dënimin adekuat.

- n. Ndryshimet në sjellje dhe ngushtimi i rrethit të miqve vetëm te persona me besime ideologjike të ngjashme apo shoqërimi me persona të identifikuar si mbështetës të ideologjive terroriste. Ky mund të jetë tregues edhe për pendim apo edhe tregues për mundësinë për rehabilitim të kryesit në të ardhmen.
- o. Posedimi ose qasja kohët e fundit dhe/ose e përsëritur në materiale ekstremiste në sasi të mëdha, apo materialeve të shpërndara nga organizata terroriste të caktuara. Është veçanërisht e rëndësishme nëse posedimi i materialeve tregon se përgatitjet e kryesit për aktivitet terrorist janë të plota ose pothuajse të plota, ose nëse angazhimi i kryesit në përgatitjen drejt veprimtarisë terroriste ka qenë i kufizuar. Është gjithashtu e rëndësishme nëse materiali ekstremist është menduar të përdoret në akt të caktuar terrorist. Shikimi i këtyre materialeve si akt i vetëm nuk paraqet indikacion të krimit por do të duhej të merret parasysh si tregues te matja e dënimit.
- p. Veprat penale të kryera gjatë periudhës së burgimit, dënimit me kusht, sprovimit apo mbikëqyrjes.
- q. Aktivitetet si shitja e pasurisë, mbledhja e parave ose marrja e pasaportës afër kohës së aktivitetit terrorist mund të jenë të gjitha tregues të nivelit të përfshirjes në mobilizimin për aktivitete ekstremiste/terroriste.
- r. Kontribute domethënëse për avancimin e terrorizmit. Financimi i terrorizmit është paraparë si vepër penale më vete sipas nenit 131 të KPRK-së, nenit 3 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit dhe nenit 57 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Prandaj, ai mund të përbëjë element të figurës së veprës penale, por nëse nuk është element, atëherë i shton peshë seriozitetit të veprimeve të kryesit. Duhet pasur parasysh se kontributi mund të jetë edhe jofinanciar i cili po ashtu mund të ndikojë në shtyrjen përpara të veprimeve terroriste. Andaj vlerësimi i kontributeve duhet bërë nga kënde të ndryshme.
- s. Mosdhënia e informacionit mbi aktivitetet terroriste organeve ligj-zbatuese. Neni 135<sup>159</sup> i KPRK-së trajton mos raportimin e terroristëve, grupeve terroriste ose aktiviteteve terroriste. Ndërsa kjo përbën element të veprës penale nëse një kryes akuzohet për këtë, është domethënëse që gjykata të dallojë vlerën e informacionit të mos dhënë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në informacionin që mund të kishte parandaluar një akt terrorizmi.
- t. Treguesit që lidhen me nxitjen për dhunë terroriste. Disa nga treguesit e mëposhtëm mund të jenë të rëndësishëm në përcaktimin e llojit dhe masës së angazhimit të kryesit për rastet që kanë të bëjnë me nxitjen e veprave terroriste:
- i. Vëllim domethënës i botimeve terroriste të botuara ose të shpërndara.
  - ii. Deklarata ose publikimi ofron udhëzime për aktivitete specifike terroriste për qëllim nxitjen e shkakimit të rrezikut për jetën.
  - iii. Sofistikimi i prezantimit në internet, duke përfshirë “etiketat/tags” që do ta lejonin atë të gjendej nga kërkuesit.
  - iv. Përdorimi dhe demonstrimi me armë të vërteta dhe municion të vërtetë, jo armë lodrash.
  - v. Deklarata publike që shprehin nivele të larta të ndjenjave kundër Kosovës dhe vendeve të tjera perëndimore.
  - vi. Përdorimi i platformave të shumta të mediave sociale për të arritur audiencë më të gjerë. Shembull, ky tregues dhe treguesi i mësipërm mund të shërbejnë për të përcaktuar peshën e kontributit të kryesit varësisht nga statusi që ka. Kështu nëse një person apo medie me

<sup>159</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 135, Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve apo grupeve terroriste, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

influcencë, që kanë ndjekës në numër të madh, përcjellin mesazhe të tilla atëherë edhe shkalla e dëmit të synuar apo të arrirë mund të jetë shumë më e lartë.

Për shkak se nxitja dhe glorifikimi i akteve terroriste në masë të madhe ndikon në rritjen dhe nxitjen e nivelit të diskriminimit, armiqësisë dhe dhunës duke bërë thirrje për urrejtje mbi baza kombëtare, racore ose fetare, inkriminimi i nxitjes së tillë është mjet i drejtpërdrejtë për implementimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, edhe kur dëmi që nxitet nuk ndodh.

Neni 134 i KPRK-së sanksionon shtytjen për kryerjen e veprave terroriste. Neni 3, paragrafi 4 i Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit gjithashtu sanksionon nxitjen përmes shkrimeve, xhirimeve audiovizuale, postimeve në rrjete sociale apo çfarëdo forme të komunikimit që thërret apo nxit të tjerët për kryerjen e akteve terroriste. Megjithatë, rrethanat e renditura më poshtë mund të jenë të dobishme gjatë caktimit të dënimit për të shpjeguar nivelin e angazhimit/pjesëmarrjes nga kryesi si rrethanë shumë e rëndësishme për nivelin e fajësisë dhe angazhimit.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pranuar prej kohësh se disa mënyra të identifikimit me një organizatë terroriste, veçanërisht thurja e lavdeve një organizate të tillë, mund të konsiderohen si manifestim i mbështetjes për terrorizmin dhe si nxitje për dhunë dhe urrejtje. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata pranon se përhapja e mesazheve që lavdërojnë kryesin e sulmit terrorist, përbuzja e viktimave të sulmeve të tilla, thirrjet për financimin e organizatave terroriste dhe veprime të tjera të ngjashme mund të përbëjnë nxitje për dhunë terroriste.<sup>160</sup>

*ii. Prania e dhunës reale ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale<sup>161</sup>*

Nuk është e rëndësishme nëse vepra është kryer apo ka qenë thjesht tentativë. Dallimi ndërmjet kanosjes me dhunë dhe dhunës reale është domethënës, megjithëse të dyja varen nga lloji i veprës penale dhe niveli i kanosjes së paraqitur/shkaktuar. Nganjëherë, kanosja me dhunë është aq e madhe sa që shkakton trauma të tilla te individët e kanosur që madje mund të tejkalojnë dhunën reale. Një faktor tjetër që duhet marrë parasysh është sfondi ose karakteristikat e kryesit. Për shembull:

- Kanosja që paraqitet nga personi me përvojë ushtarake ose ligj-zbatuese. Ekstremistët me trajnim lig-zbatues ose ushtarak, njohuri për eksplozivët dhe armët e zjarrit, përvojë nga burgjet dhe qasje në rrjetet dhe burimet ekstremiste sjellin nivele më të larta rrezikshmërie, pasi ata kanë aftësi më të mëdha për të kryer akte dhune.
- Sfondi kriminal i autorit (historia e dhunshme kriminale, individ i njohur si i radikalizuar, e kështu me radhë) ndikon në shkallën e seriozitetit të kërcënimit terrorist. Jo të gjithë individët e radikalizuar kryejnë krime, megjithatë, radikalizimi është shpesh pararendës i përfshirjes në vepra penale që lidhen me terrorizmin. Përcaktimi i nivelit të radikalizimit apo sa i dhunshëm është individ, është pararendës për të përcaktuar rrezikun për komunitetin, por

<sup>160</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Udhëzues për jurisprudencën lidhur me Konventën-Terrorizmi, f. 30, Azhurnuar më 31.08.2022.

<sup>161</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 2.3., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

edhe llojin e veprës penale më të përshtatshme, kushtet e nevojshme të mbikëqyrjes apo mundësinë për rehabilitim.

iii. Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal<sup>162</sup>  
Neni 136 i KPRK-së sanksionon veprimtarinë terroriste të kryer në kuadër të strukturës/grupit të organizuar. Nenet e tjera të kodit ndalojnë forma të tjera të bashkëpunimit si bashkëkryerja (neni 31), bashkimi kriminal (neni 34) dhe marrëveshja për të kryer vepër penale (neni 36).

Treguesit e renditur më poshtë mund të përdoren për të shpjeguar masën e angazhimit/pjesëmarrjes nga kryesi në një grup të organizuar kriminal, të cilët janë të rëndësishëm për të përcaktuar nivelin e përgjegjësisë së kryesit:

- a. Nëse kryesi është anëtar i shquar apo domethënës i organizatës kriminale terroriste.
- b. Përpjekje me ngulm për të fituar mbështetje të gjerë ose domethënëse për organizatën.
- c. Shpreh nivele të larta zotimi dhe përkushtimi ndaj grupit, ideologjisë ose kauzës terroriste.
- d. Përfshirje në konspiracion të sofistikuar dhe të gjatë në vijim/planifikim domethënës.
- e. Inkurajim ose rekrutim i të tjerëve për t'iu bashkuar grupit terrorist.
- f. Keqpërfaqësim i natyrës së organizatës terroriste.
- g. Mashtrim në vazhdimësi gjatë gjithë procesit për të mbrojtur anëtarët e grupit dhe kauzën.

iv. Keqpërdorimi i pushtetit ose pozitës zyrtare<sup>163</sup> ose dëshmi të shkeljes së besimit<sup>164</sup> nga ana e personit të shpallur fajtor

Të dy këto rrethana tregojnë fajësinë e kryesit dhe masën e rrezikshmërisë që i pandehuri mund të kryejë sërish vepër penale. Për të njëjtin kryes mund të aplikohen të dy faktorët: për shembull, kryesi që ishte polic dhe kreu akt terrorist, në një kompleks shkollor, abuzoi me pushtetin e tij si zyrtar publik dhe shkeli besimin e autoriteteve të shkollës të cilët kishin të gjitha arsyet të besonin se ai/ajo do të garantonte sigurinë e tyre.

Siç u tha më herët, edhe nëse pikënisja për personin zyrtar është më e lartë, kjo nuk përbën dyfishim për qëllimin e përdorimit të rrethanës nga paragrafi 2.9., pasi vlerësimi do të përqendrohet vetëm në rolin e personit zyrtar në hierarkinë e shërbimit publik apo ndjeshmërisë së pozitës që mban. Për shembull, personi zyrtar me qasje në informacione konfidenciale ose të klasifikuara, ose me qasje në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit ka nivel më të lartë fajësie në krahasim me zyrtarin me rol të vogël dhe qasje minimale ose aspak në burime të tilla. Këto që u thanë më sipër paraqesin disa nga shembujt ku mund të aplikohen faktorët e tillë.

v. Dënimet penale të mëparshme të personit të shpallur fajtor<sup>165</sup>

Siç u tha më lart, pikënisja për recidivistët është më e lartë. Gjykata do të duhej të vlerësojë llojin e krimeve për të cilat kryesi është dënuar më parë, për shembull, nëse ai/ajo është dënuar më parë për vepra penale që lidhen me terrorizmin, krime të tjera të dhunshme ose krime jo të

---

<sup>162</sup> Po aty, paragrafi 2.11.

<sup>163</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 2.9., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>164</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 2.10., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>165</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 2.13., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

dhunshme. Në përgjithësi, sa më të rënda të jenë veprat penale të mëparshme, aq më e lartë është rrezikshmëria, gjë që duhet të rezultojë në dënim më të lartë, duke përfshirë edhe ashpërsimin e dënimit sipas nenit 75 të KPRK-së. Kur vlerëson nëse nga dënimi i mëparshëm nuk ka kaluar shumë kohë, gjykata duhet të marrë parasysh distancën kohore nga dënimi i mëparshëm. Aty ku ka dënime të mëparshme, por ato janë qoftë të vjetra ose të natyrës jo të dhunshme, kjo tregon probabilitet më të ulët të recidivizmit dhe gjithashtu më shumë mundësi për rehabilitimin e kryesit. Përkundrazi, nëse koha ndërmjet dënimit të mëparshëm dhe veprës penale aktuale është rezultat i dënimit të gjatë me burgim, gjykatat nuk do të duhej të njohin kohën si faktor lehtësues. Në fakt, mund të jetë e përshtatshme që të merret si rrethanë rënduese (p.sh. nëse vepra është kryer shumë afër kohës prej kur është liruar nga burgimi).

Sa i përket dënimeve të mëparshme, të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

*vi. Rrethanat që lidhen me viktimën*

Rrethanat që lidhen me viktimën duhet të merren parasysh gjithmonë dhe të trajtohen kur caktohet dënimi për kryesit e veprave penale të terrorizmit. Më poshtë është dhënë lista e rrethanave të parapara me KPRK në nenin 70:

- ✓ Paragrafi 2.4., nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore.
- ✓ Paragrafi 2.5., nëse vepra penale përfshin disa viktima.
- ✓ Paragrafi 2.6., nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme.
- ✓ Paragrafi 2.7., moshë e viktimës, nëse është e re apo e moshuar.
- ✓ Paragrafi 2.8., shkalla e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes të viktimës, dëmin financiar apo kostot e pësuar nga viktima për të marrë trajtim, dëmin psikologjik dhe çdo dëm tjetër të shkaktuar ndaj viktimës ose familjes së saj.
- ✓ Paragrafi 2.12., nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo vepër penale të kryer ndaj personit, grupit të personave ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura.

Marrja në konsideratë e këtyre rrethanave është veçanërisht e rëndësishme duke marrë parasysh potencialin e lartë për dëm serioz dhe/ose kërcënim për komunitetin e gjerë dhe shëndetin publik. Kanosja me dhunë dhe dhuna reale ndaj numrit më të madh të viktimave janë shumë të zakonshme në rastet e terrorizmit dhe nuk do të duhej të anashkalohej gjatë përcaktimit të dënimit. Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Korrupsionin jep një shpjegim të zgjeruar se si korrupsioni mund të ketë ndikim serioz në shëndetin publik ose mjedisin. E njëjta logjikë në vlerësim të rrethanës nga par. 2.8 mund të aplikohet edhe për rastet e terrorizmit kur veprimet terroriste kanë si cak infrastrukturën ose burimet publike.

Rrethana rënduese nga paragrafi 2.12., ka të ngjarë të jetë i pranishëm në rastet e terrorizmit. Ekstremistët shpesh vënë në cak viktimat për shkak të orientimit të tyre seksual, kombësisë ose fesë. Kjo është arsyeja pse gjykatat do të duhej ta marrin parasysh dhe ta përfshijnë këtë faktor dhe

prokurorët do të duhej ta përfshijnë atë në argumentimin e tyre. Kjo është gjithashtu një rrethanë (motiv) që kërkohet sipas nenit 69,<sup>166</sup> nënparagrafi 3.2. i KPRK-së. Gjykatat do të duhej gjithashtu të marrin në konsideratë nëse kryesi ka diskutuar ose nxitur verbalisht ose me shkrim sulme kundër komuniteteve të caktuara brenda Kosovës, objekteve të përdorura nga vendet e tjera, apo ka planifikuar sulme në vende të tilla.

#### **E. Rrethanat lehtësuese relevante për veprat penale që lidhen me terrorizmin**

Neni 70, paragrafi 3 i KPRK-së ofron listë jo-shteruese të rrethanave lehtësuese. Përdorimi i tepërt i rrethanave lehtësuese, të cilat shpesh janë jo-relevante për veprën penale specifike, ka kontribuar në masë të madhe në zbutjen e tillë të dënimeve. Analiza e mëposhtme fokusohet në rrethanat lehtësuese që janë të përshtatshme për t'u marrë parasysh gjatë caktimit të dënimit për kryesit e veprave penale të terrorizmit.

i. *Rrethanat që nuk përbëjnë bazë për përjashtimin e përgjegjësive penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore.*

Edhe kur i pandehuri ka aftësinë mendore për t'u mbajtur penalisht përgjegjës për veprën penale terrorizmi, gjykata mund të shqyrtojë me rregull nëse i pandehuri lëngon nga aftësia e zvogëluar mendore. Përcaktimi i tillë duhet të mbështetet me prova nga eksperti, dhe vetëm pasi gjykata të ketë marrë parasysh dëmin e shkaktuar ndaj viktimës dhe rrezikshmërinë që i pandehuri të kryejë sërish veprën penale.

Paragrafi 2 i nenit 18 të KPRK përcakton qartë se “...Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.”<sup>167</sup> Së këndejmi, bazuar në këtë dispozitë është e qartë se aftësia e zvogëluar mendore mund të konsiderohet vetëm në zbutje që çon në ulje të dënimit dhe jo medoemos në dënim nën minimumin ligjor.

ii. *Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar*<sup>168</sup>

Provat se kryesi ka treguar karakter të mirë mund të jenë rrethanë për zbutje gjatë caktimit të dënimit, për shembull kur i pandehur bën punë bamirësie në komunitetin e tij/saj. Megjithatë, kjo rrethanë ka më pak gjasa të jetë relevante kur vepra penale është shumë e rëndë dhe kur kryesi ka përdorur “karakterin e mirë” ose statusin e tij për të lehtësuar ose fshehur veprën penale, atëherë kjo do të duhej të trajtohet si rrethanë rënduese.

Gjykatat rrallëherë do të duhej të marrin në konsideratë faktin që kryesi është i martuar ose ka fëmijë si rrethanë lehtësuese. Kryesit që përqafojnë ideologjitë ekstremiste janë gjithashtu me rrezikshmëri për radikalizimin e anëtarëve të familjes. Shumë nga luftëtarët e huaj terroristë që u kthyen i kishin vënë në rrezik të madh familjet e tyre duke i çuar në zonat e konfliktit. Prandaj,

---

<sup>166</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 69 - Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>167</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 18, Paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>168</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 3.3., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

fakti që i pandehuri ka fëmijë, zakonisht do të duhej të konsiderohet si faktor për ashpërsimin dhe jo zbutjen e dënimit. Heqja e lirisë së të pandehurit nuk do të duhej të shmanget me arsyetimin se “*prania e të pandehurit pranë fëmijëve të tij [...] është vendimtare për mirëqenien dhe rritjen e tyre.*”<sup>169</sup> Fakti që ai ka udhëtuar me ta në zonë konflikti dhe i ka vënë në rrezik, përfshirë këtu edhe faktin se ai në fakt paraqitet si element radikalizues në familje, do të duhej të merrej si rrethanë rënduese pikërisht për shkak të sjelljeve negative të kryesit.

*iii. Roli dhe kontributi i personit në kryerjen e veprës penale*<sup>170</sup>

Kjo kategori përfshin rrethanat e mëposhtme:

- Dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale.
- Fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por nëpërmjet ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin.

Të dyja arsyet e cekura më sipër janë diskutuar gjerësisht gjatë analizimit të rolit të kryesit në kontekstin e rrethanave rënduese. Paraqitet si rrethanë lehtësuese mjaft me rëndësi në rastet e bashkëkryerjes apo grupit të organizuar kriminal për të bërë individualizimin e dënimit bazuar në rolin që secili ka luajtur. Sa më i vogël roli, aq më shumë peshë ka në uljen e dënimit. Megjithatë, gjykatat do të duhej të jenë syçelë ndaj rrethanave që sugjerojnë se kryesi mund të ketë qenë subjekt i shtrëngimit, frikësimit ose shfrytëzimit. Kjo rrethanë mund të tregojë se kryesi është i cenueshëm dhe do ta kishte më të vështirë të përballlet me heqjen e lirisë ose të përmbushë urdhrin për punë në dobi të përgjithshme shoqërore.

*iv. Moshja e personit të dënuar, qoftë i ri apo i moshuar*<sup>171</sup>

Moshja dhe/ose mungesa e pjekurisë mund të ndikojnë në përgjegjësinë e kryesit për veprën penale dhe efektin e dënimit të kryesi. Këto konsiderata mund të justifikojnë uljen e dënimit duke pasur gjithmonë parasysh peshën e veprës penale.

Personat e rinj të moshës madhore janë ende duke u zhvilluar nga aspekti neurologjik dhe rrjedhimisht mund të jenë më pak në gjendje të vlerësojnë pasojat e veprimeve të tyre. Ata kanë më shumë gjasa të veprojnë me rrezikshmëri ose të sillen në mënyrë impulsive veçanërisht në prani të të tjerëve. Përvojat e pafavorshme të fëmijërisë duke përfshirë privimin dhe/ose abuzimin mund të ndikojnë në zhvillim. Një kryes i papjekur mund ta ketë veçanërisht të vështirë të përballojë kërkesat e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme shoqërore pa mbështetjen e duhur. Te kryesit e papjekur ekziston kapacitet më i madh për ndryshim dhe ata mund të jenë të hapur ndaj mundësive për të trajtuar sjelljen e tyre ndesh me ligjin dhe për të ndryshuar mënyrën e sjelljes.

---

<sup>169</sup> Teksti është marrë nga një vendim i gjykatave të Kosovës, ku për caktimin e dënimit gjykata, ndër të tjera, thotë se “Gjykata i ka konsideruar si rrethanë të jashtëzakonshme lehtësuese, rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit, përkatësisht faktin se është i martuar, baba i dy fëmijëve të mitur, të cilët jetojnë në kushte të këqija, duke pasur parasysh faktin se ata kanë jetuar për disa vite në Siri, dhe se puna e tij, përkatësisht çdo punësim eventual është burimi i vetëm për ekzistencën e tyre dhe se prania e të pandehurit pranë fëmijëve të tij, pas kthimit të tyre në Kosovë për t’i ndihmuar ata të përshiaten, është vendimtare për mirëqenien dhe rritjen e tyre...”

<sup>170</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafët 3.4. dhe 3.5., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>171</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 3.6., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

Argumenti i bazuar në papjekuri nuk do duhej të aplikohet për madhorët e as për të moshuarit. Ata do të duhej të jenë plotësisht të vetëdijshëm për veprimet e tyre. Arsyeja e vetme pse ky argument do të mund të aplikohet për zbutje është nëse pleqëria shoqërohet edhe me njëfarë gjendjeje të rëndë shëndetësore, e cila do ta bënte të paarsyeshme privimin e personit nga liria. Përndryshe, në raste të veprës penale të rëndë lidhur me terrorizmin dhe kur kryesi paraqet rrezikshmëri serioze, dënimi me burgim (madje edhe për periudha të gjata të burgimit) është i justifikuar.

*v. Rrethanat që lidhen me pendimin dhe bashkëpunimin e kryesit<sup>172</sup>*

Të gjitha rrethanat e mëposhtme janë grupuar me qëllim që të tregohet se këta kryes mund të kenë më pak gjasa për të kryer sërish veprë penale dhe gjasa më të mëdha për rehabilitim. Megjithatë, kjo nuk nënkupton ulje automatike të dënimit pasi ata duhet të analizohen dhe krahasohen me rrethanat e tjera të lëndës:

- ✓ Dëshmia se personi i dënuar ka bërë dëmshpërblimin apo kompensimin e viktimës.
- ✓ Bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar.
- ✓ Bashkëpunimi vullnetar i personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale.
- ✓ Keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar.
- ✓ Sjellja e personit të dënuar pas konfliktit.
- ✓ Në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 169, 191 dhe 193 të këtij Kodi, kontributi në mënyrë efektive për lirim ose për ta sjellë të gjallë personin e rrëmbyer, marrë apo ndalur ose dhënia vullnetare e informatave që kontribuojnë në identifikimin e përgjegjësve të tjerë për veprë penale.

Shprehja e lehtësimit për heqjen dorë nga zotimi ndaj kauzës ose ideologjisë ekstremiste mund të jetë gjithashtu tregues i zhvendosjes nga kauzat e tilla. Dëshmia në gjykatë si dëshmitar mund të jetë një nga testet më domethënëse, duke demonstruar legjitimitetin e ndryshimit për kryesin.

Bashkëpunimi dhe dëshmia në emër të prokurorisë janë akte që mund të përfaqësojnë ndryshim në mendësi dhe të rezultojnë në kufizimin e aftësisë së individit për t'u kthyer në grup në çdo nivel. Vlerësimi i domethënies së bashkëpunimit përfshin shqyrtimin e disa aspekteve. E para është të përcaktohet nëse kryesi ka dhënë dëshmi të drejtpërdrejta dhe të hollësishme dhe është i penduar për shkeljen e ligjit, por kjo nuk është e përgatitur fjalë për fjalë. E dyta janë provat se kryesi ka shoshitur në mendje veprimet e veta, përfshirë reflektimin mbi dëmin e shkaktuar të tjerëve, si për shembull familjes, komunitetit por edhe vetvetes. Edhe nëse kryesi pranoi të bashkëpunonte, vonesat në përcjelljen e mesazheve janë shenjë e besnikërisë së mbetur ndaj grupit dhe nivelit të radikalizimit edhe pas asaj që duket të ketë qenë pendim dhe ndryshim mendësie. Situata të tjera përfshijnë kur kryesi dënon publikisht grupin, kauzën ose ideologjinë ekstremiste në një mënyrë që do të zvogëlonte mundësinë për t'u kthyer në përfshirje me ekstremistët e tjerë. Kjo gjithashtu tregon zotim për të lënë pas ekstremizmin. Megjithatë, kryesit ndonjëherë janë përgatitur fjalë për fjalë për të dënuar kauzën e tyre si strategji ligjore për zbutjen e dënimit të tyre potencial. Konsistenca në tregime dhe ndershmëria duhet të monitorohen më nga afër në rastet e

---

<sup>172</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafët 3.7.-3.9., dhe 3.11.- 3.13., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.



ekstremizmit/terrorizmit. Gjykatat do të duhej të ushtrojnë kujdes me konsiderimin e heshtjes së të pandehurit në gjykatë si tregues të pendimit të vërtetë, pasi kjo nuk tregon medoemos pendim, por qëllimin e tij/saj për të mbajtur profil të ulët. Së këndejmi, heshtja e të pandehurit, veçanërisht në rastet kur i pandehuri nuk e ka pranuar fajin e tij/saj, nuk do të duhej të merrej parasysh për zbutje të dënimit.<sup>173</sup>

Tregues të tjerë në vlerësimin për zbutje të dënimit sipas faktorëve të mësipërm mund të përfshijnë:

- Mungojnë veprimet reale ose tentativat për të kryer aktivitetet.
- Shkëputja e hershme nga grupi.
- Pranimi i përgjegjësisë për veprimet e veta.
- Ndjekja e programeve dhe përpjekjeve rehabilituese pas arrestimit.
- Prova të qarta të ndryshimit të mendësisë përpara arrestimit.
- Nëse kryesi kthehet nga udhëtimi jashtë vendit dhe është zhgënjyer për shkak të përvojës së keqe ose shpreh pendesë dhe dënon grupin ose kauzën, ky mund të jetë hap pozitiv nëse është i verifikueshëm.

*vi. Rrethanë specifike lehtësuese për veprat e terrorizmit i ri në KPRK*

Në lidhje me veprat penale nga paragrafi 7 i nenit 3 të Ligjit parasheh dënime më të buta kur plotësohen të gjitha rrethanat e mëposhtme:

- a) fakti që kryesi i veprës penale heq dorë nga veprimtaria terroriste para se të ketë pasoja të rënda prej saj, dhe
- b) i ofron policisë, prokurorëve ose autoriteteve gjyqësore informata të cilat ato nuk do të kishin mundësi t'i siguronin.
- c) ndihmon në parandalimin ose zbutjen e efekteve të veprës penale.
- d) identifikon me detaje të mjaftueshme për të lejuar arrestimin ose ndjekjen penale të ndonjë terroristi apo grupi terrorist.
- e) gjen prova apo parandalon vepra të tjera terroriste.

Me sa duket, elementet e rrethanës së mësipërme përkojnë me situatat nga neni 30 i KPRK-së.<sup>174</sup> Këto elemente mund të plotësohen qoftë në formën e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ose si pjesë e bashkëpunimit të të pandehurit me autoritetet ligj-zbatuese.

Është e mundur që këta faktorë lehtësues do të dyfishonin ata të përcaktuar në elementet e figurës së veprës penale nga neni 3, paragrafi 7 i Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të

---

<sup>173</sup> Fatkeqësisht, siç është vënë re në praktikën e Kosovës, heshtja është marrë parasysh për zbutje. Në një nga aktgjykimet e shqyrtuara, gjykata kishte konstatuar se “*gjatë shqyrtimit kryesor, edhe pse ai nuk e ka pranuar fajësinë, sjellja dhe qëndrimi i tij ishte korrekt, duke shfaqur njëfarë pendimi, përkundër veprimeve të tij, por pa e pranuar shprehimisht fajin për asnjë nga veprat penale që i vihen në ngarkim.*” Ky justifikim, së bashku me justifikimin nga fusnota e mësipërme 26 u morën si rrethana të jashtëzakonshme lehtësuese që çuan në dënim nën minimumin ligjor.

<sup>174</sup> Neni 30 - Heqja dorë vullnetare nga tentativa, thotë: “Gjykata mund ta lirojë personin nga dënimi për tentativë të dënueshme të veprës penale nëse personi i tillë heq dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale të cilën e ka filluar, ndonëse është i vetëdijshëm se në pajtim me të gjitha rrethanat ai mund të vazhdonte veprën ose nëse pas kryerjes së një vepre të tillë parandalon shfaqjen e pasojave”.

armatosura jashtë territorit të vendit, dhe faktorët lehtësues më poshtë në nenin 70 të KPRK-së. Mundësia e dyfishimit të rrethanës me faktorë të tjerë lehtësues është shumë më e madhe dhe kjo me sa vijon:

- ✓ Bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar (neni 70, paragrafi 3.8.);
- ✓ Bashkëpunimi vullnetar i personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale (neni 70, paragrafi 3.9.);
- ✓ Sjellja e personit të dënuar pas konfliktit (neni 70, paragrafi 3.12.);
- ✓ Heqja dorë vullnetare nga tentativa sipas nenit 30 të Kodit Penal;
- ✓ Zbutja e dënimit për shkak të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Këta faktorë janë gjithmonë të veçantë sipas rastit dhe duhet të peshohen kundrejt rrezikshmërisë së të pandehurit për recidivizëm dhe shkallës së dëmit të shkaktuar ose të menduar.

*vii. Deklarimi i pranimi të fajësisë.<sup>175</sup>*

Deklarimi i pranimi të fajësisë është tregues i rëndësishëm se i pandehuri është duke u shkëputur me sukses nga aktiviteti kriminal i kaluar. Megjithatë, gjykatat do të duhej të kenë kujdes përpara se të trajtojnë pranimin e fajit si faktor lehtësues në caktimin e dënimit. Gjykatat duhet të bëjnë pyetje të kujdesshme drejtuar të pandehurve, përtej deklaratave të tyre të përgatitura fjalë për fjalë, për të vlerësuar nëse kryesi është me të vërtetë i penduar, e njëj gabimin e sjelljes së tij/saj dhe nuk është me rrezikshmëri për recidivizëm.

Shumica e kryesve deklarohen fajtor në seancën fillestare, që do të thotë se gjykatat nuk do të kenë informacion të mjaftueshëm për faktorët rëndues relevantë. Prandaj, gjykatat do të duhej të bëjnë përpjekje që sipas detyrës zyrtare të caktojnë seancat për caktimin e dënimit (përveç nëse palët tashmë kanë kërkuar seancë) sipas dispozitave të KPPRK-së dhe të kërkojnë informacion shtesë nga palët. Do të duhej të shmanget ulja automatike nën minimumet ligjore pa marrë parasysh faktorët e tjerë.

## **F. Përgjegjësia penale e personave juridikë në rastet që lidhen me terrorizmin**

Me rastin e caktimit të dënimit të të pandehurve për nxitje për terrorizëm, kur i pandehuri ka vepruar si person përgjegjës<sup>176</sup> i personit juridik, gjykatat duhet të kenë parasysh jo vetëm përgjegjësinë individuale të kryesit, por edhe të personave juridikë që kanë mundësuar krimin.<sup>177</sup> . Kjo parashikohet gjithashtu nga instrumentet ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Këshillit

---

<sup>175</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 3.10., Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>176</sup> Sipas përkufizimit në Ligj, personi përgjegjës – është personi fizik në kuadër të personit juridik, të cilit i janë besuar detyra të caktuara, ose i cili është i autorizuar për të vepruar në emër të personit juridik si dhe ekziston baza e lartë se është i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik.

<sup>177</sup> Kjo është e përcaktuar qartë në nenin 37 të KPRK-së, Ligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit.<sup>178</sup> Neni 11, paragrafi 3 i kësaj Konvente thekson nevojën për “...*sanksione penale ose jo penale efektive, proporcionale dhe dekurajuese, përfshirë sanksionet monetare*” për personat juridikë.

Kapitulli III i Ligjit parashikon sanksionimin e personave juridikë duke përfshirë gjoba, dënime me kusht dhe masa të tjera sigurie. Një shembull do të përfshinte veprimet që lidhen me nxitjen e urrejtjes në kryerje të terrorizmit. Këto vepra penale sanksionohen me nenin 134 të KPRK-së dhe paragrafin 4 të nenit 3 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Ka shumë raste të kompanive transmetuese dhe/ose botuese që janë sanksionuar pasi ato janë përdorur për të promovuar terrorizmin dhe aktivitetin terrorist ose për të nxitur urrejtje. Në shumë prej këtyre çështjeve gjyqësore, GJEDNJ-ja nuk gjeti shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së. Megjithatë, gjykatat duhet të sigurohen që masat e ndërmarra të mos prekin në mënyrë jo proporcionale mbi lirinë e shprehjes.

### **G. Aplikueshmëria e llojeve të tjera të dënimeve**

Përveç dënimit me burgim, është e rëndësishme të trajtohen edhe aspekte të tjera që lidhen me caktimin e dënimit, të cilat janë shumë të rëndësishme për arritjen e synimit të parandalimit individual.

*Dënimet plotësuese.* - Fatkeqësisht, KPRK-ja në nenin 59 ka parashikuar vetëm një listë shumë të kufizuar dhe shteruese të dënimeve plotësuese. Më të rëndësishmet përfshijnë:

- a. urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit.<sup>179</sup>
- b. ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik.<sup>180</sup>
- c. ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës<sup>181</sup>
- d. urdhri për publikimin e aktgjykimeve - kjo është masë shumë efektive.<sup>182</sup>
- e. dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.<sup>183</sup>

Siç u diskutua më lart, kur u referohemi pikënisjes dhe faktorëve përkatës rëndues që lidhen me personin *e pandehur që e kryen veprën penale në cilësinë e personit zyrtar*, dënimet për këta persona do të duhej të përfshijnë dënimet plotësuese qoftë nga neni 62 ose nga neni 63 i KPRK-së. Fatkeqësisht, këto dënime plotësuese shqiptohen rrallë në praktikën e Kosovës.

*Kompensimi ose zhdëmtimi i viktimave* - do të duhej të merrej parasysh gjatë caktimit të dënimit të të pandehurve (përfshirë rastet kur gjykata shqipton dënim me kusht) veçanërisht duke marrë

---

<sup>178</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e terrorizmit, Neni 10 - Përgjegjësia e personave juridikë, Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës Nr.196, Varshavë, 16.V.2005.

<sup>179</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 61, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>180</sup> Po aty. Fusnota e mësipërme, neni 62

<sup>181</sup> Po aty. Fusnota e mësipërme, neni 63.

<sup>182</sup> Po aty. Fusnota e mësipërme, neni 66.

<sup>183</sup> Po aty. Fusnota e mësipërme, neni 67.

parasysh mundësinë e madhe për dëmin e shkaktuar viktimave të terrorizmit. E njëjta gjë aplikohet edhe për personat juridikë.

*Në rastin e dëbimit të personit të huaj*- gjykata mund të urdhërojë dënimin e tillë, por duhet të sigurojë që arsyet e dëbimit të tij/saj të shpjegohen qartë pasi kjo mund të ngrejë shqetësime për shkeljen e nenit 1 të Protokollit 7 të KEDNJ-së. Së këndejmi, urdhërimi i dëbimit të tillë lejohet sipas legjislacionit të Kosovës, por do të duhej të jetë proporcional dhe i arsyeshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në parim, Shteteve duhet t'u lejohet, në kontekstin e luftës kundër terrorizmit, të deportojnë jo-shtetasit të cilët ata i konsiderojnë kërcënim për sigurinë kombëtare. Nuk është funksioni i Gjykatës të shqyrtojë nëse individit paraqet në fakt kërcënim të tillë; detyra e saj e vetme është të shqyrtojë nëse deportimi i atij individit do të ishte në përputhje me të drejtat e tij/saj sipas Konventës (shih, ndër të tjera, çështjet X kundër Suedisë, § 46, dhe W. kundër Francës, § 65).<sup>184</sup>

*Dënimi me kusht* - Para dhënies së dënimin me kusht, gjykatat duhet të marrin parasysh seriozisht llojin e veprës së kryer, fajësinë e të pandehurit dhe dëmin e kërcënuar ose shkaktuar. Shqiptimi i dënimin me kusht për të pandehurit me precedent penal ose kryes të tjerë me rrezikshmëri të lartë do të ishte i përshtatshëm vetëm si përjashtim kur ka rrethana të jashtëzakonshme që do ta justifikonin këtë si dënim.

Siç vërehet në raporte të ndryshme, këto dënime rrallë shoqërohen me detyrime për kryesin, përveç detyrimit të përgjithshëm për t'u përmbajtur nga kryerja e veprave penale. Neni 56 i KPRK-së parashikon një sërë detyrimesh që i bashkëngjiten dënimin me kusht, të cilat mund të përdoren në mënyrë shumë efektive në veprat penale që lidhen me terrorizmin. Rekomandohet shumë përfshirja e një ose më shumë prej detyrimeve të mëposhtme:

- mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor;
- nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;
- vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;
- mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues;
- heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;
- heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokale të caktuara;
- heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar;
- heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve;
- të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;
- të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;
- të mos posedojë apo përdorë kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata;
- të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata.

Faktorët e mësipërm lidhur me *heqjen dorë nga frekuentimi i vendeve të caktuara dhe/ose heqja dorë nga shoqërimi/kontaktimi me persona të caktuar* mund të jenë shumë efektive në sigurimin e shkëputjes së të pandehurit nga aktivitetet terroriste. Gjykatat duhet të kenë parasysh se shkëputja e kryesve nga terrorizmi shpesh kërkon më shumë se vetëm një dënim. Caktimi i

---

<sup>184</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Udhëzues për jurisprudencën lidhur me Konventën-Terrorizmi, f. 36, Azhurnuar më 31.08.2022.

detyrimeve të mësipërme për kryesit e herës së parë mund të çojë në rezultate afatgjata. Shqiptimi i dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues<sup>185</sup> është gjithashtu një konsideratë shumë e rëndësishme veçanërisht për kryesit e moshës së re.

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme - i parashikuar nga neni 57 i KPRK-së, do të ishte i përshtatshëm vetëm për format më të buta të veprave penale që lidhen me terrorizmin. Sipas paragrafit 1 të këtij neni “Gjykata mund t’ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dymijepesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar. Ky lloj i masës ndëshkuese mund të jetë më i përshtatshëm për kryesit e moshës së re, kur gjykata vlerëson se i pandehuri paraqet rrezikshmëri të ulët për recidivizëm, nuk ka pasur asnjë dëm të lidhur me veprën penale, dhe përveç kësaj ka faktorë të tjerë që çojnë në përcaktimin se ky urdhër do të ishte i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Konfiskimi i aseteve - Çdo konfiskim i aseteve duhet të parashikohet me ligj dhe të jetë në shërbim të interesit publik. Gjykatat do të duhej të urdhërojnë sipas rregullave konfiskimin e aseteve nga personat juridikë që mbështesin veprat penale të terrorizmit. Për sa i përket proporcionalitetit, Gjykata ka theksuar se konfiskimi i aseteve në çështjet penale është bërë më i përhapur, si në sistemet ligjore të disa shteteve kontraktuese ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, dhe se aktualisht po përdoret jo vetëm për prova, por edhe si masë ndëshkuese e veçantë për veprën penale (*Aboufadda kundër Francës (vendim)*, § 27).<sup>186</sup>

Gjobat si sanksion penal - Gjobat si sanksion penal rregullohen me Ligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, Kodin Penal dhe Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Gjobat parashikohen për veprat penale që kanë të bëjnë me lehtësimin dhe financimin e terrorizmit dhe personat juridikë të përfshirë në aktivitete që lidhen me terrorizmin. Gjatë përcaktimit të gjobës, gjykatat gjithmonë duhet të aplikojnë kërkesat ligjore në matjen e gjobës dhe në pajtim me Udhëzuesin e veçantë të Gjykatës Supreme për shqiptimin e gjobave si sanksion penal. Kjo do të siguronte që gjoba të arrijë efektin e saj parandalues. Shqiptimi i gjobës si sanksion penal në vend të dënimit me burgim nuk inkurajohet dhe nuk rekomandohet për kryesit që paraqesin rrezikshmëri të lartë.

---

<sup>185</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 55, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>186</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Udhëzues për jurisprudencën lidhur me Konventën-Terrorizmi, f. 30, Azhurnuar më 31.08.2022.

## **II. Kapitulli XV Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare**

Kapitulli në fjalë paraqet vepra të një rëndësie dhe dimensionit jo vetëm në nivel vendor por edhe ndërkombëtar. Kjo pasi shumë nga veprat e parapara me këtë kapitull gjejnë mbrojtje në Konventat e ndryshme të karakterit ndërkombëtar. Andaj edhe shumica e neneve të parapara në këtë kapitull parashohin minimume dhe maksimume të larta ligjore deri në burgim të përjetshëm.

Veprat që kanë të bëjnë me çështjet e sanksionuara me Konventën e Gjenevës sakaq bartin minimume dhe maksimume të larta ligjore (9 nenet e këtij Kapitulli). Andaj, për veprat e këtij kapitulli është shumë me rëndësi që matja e dënimit të fillojë nga mesatarja në mes minimumit dhe maksimumit ligjor duke pasur gjithnjë parasysh edhe masat tjera që mund të shpien në mënyrë adekuate në reduktimin e këtyre dukurive.

Sa i përket veprave të këtij kapitulli më të shprehura në praktikën tone janë Kontrabandimi me migrantë nga Neni 164 dhe Trafikimi me njerëz nga Neni 165. Veçanërisht kur flitet për Trafikimin me njerëz mënyra se si Republika e Kosovës trajton hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e kryesve të këtyre veprave është gjithnjë në llupën e disa prej raporteve më me peshë ndërkombëtare:


- Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Trafikimin me Qenie Njerëzore.
- Raporti i Këshillit të Evropës, Raporti i Greta-s.

Për vite me radhë këto dy raporte kanë vënë në dukje dënimet e ulëta të kryesve shpesh nën minimumin e paraparë ligjor dhe mungesën e konfiskimeve të dobisë pasurore.

Sipas Raportit të State Departamentit Republika e Kosovës nuk ka përmbushur standardet minimale për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, por ka bërë përpjekje domethënëse në këtë drejtim. Gjykatat duhet të kenë parasysh se dënimet e shqiptuara ndaj kryesve të këtyre veprave janë me peshë jo vetëm për rastet individuale para tyre, por kur akumulohen paraqesin bazë për vlerësimin e përgjithshëm për Republikën e Kosovës dhe renditjen e shtetit në hartën e shteteve që janë në përputhje me parimet e Konventave ndërkombëtare dhe përcaktimin e fondeve që dedikohen për Republikën e Kosovës. Andaj, në parim, shqiptimi i dënimeve alternative nuk janë të përshtatshme për veprat nga ky kapitull, njëllon sikurse nuk është i përshtatshëm edhe zbutja nën minimumin ligjor përveç në rastet kur gjykata gjen rrethana jashtëzakonisht lehtësuese dhe atë vetëm për veprat e një natyre më të lehtë brenda këtij kapitulli. Vetëm pranimit i fajësisë apo marrëveshja e pranimit të fajësisë, nuk duhet të shpien në mënyrë automatike në zbutje të dënimit nën minimumin ligjor, pasi kjo nuk është e drejtë automatike e fituar e të pandehurit. Gjykatat duhet të vlerësojnë dhe peshojnë shumë më tepër rrethanat nën të cilat është kryer vepra, shkallën e dëmit dhe shkallën e përgjegjësisë për të vlerësuar a mbi peshojnë këto të fundit pranimitin e fajësisë apo marrëveshjen mbi pranimitin e fajësisë.

## A. Pikënisja

Njësoj sikurse edhe në kapitullin paraprak, edhe në këtë rast në kuadër të këtij kapitulli gjejmë vepra me tre lloje të dënimit (minimal, mesatar dhe maksimal). Në përgjithësi dominojnë veprat me dënime mesatare dhe maksimale.



Grafiku i mësipërm jep pikënisjen e sugjeruar për veprat nga ky kapitull, duke bërë dallimin mes atyre me dënim më të ulët, mesatar dhe maksimal, si dhe veprat e kryera nga recidivistët dhe grupet e organizuara kriminale.

Recidivistët dhe kryesit që veprojnë si pjesë e grupit të organizuar kriminal paraqesin rrezikshmëri më të lartë, kështu që pikënisja është më e larta për këto kategori. Duhet qartësuar se kategoria e fundit është e sanksionuar me Nenin 154 dhe pikënisja prej 2/3 e vlen edhe për këtë nen.

Po ashtu, duhet bërë me dije se sa i përket veprave për të cilat si dënim është paraparë edhe burgimi i përjetshëm pikënisja NUK ZBATOHET nëse gjykata shqipton këtë dënim. Sa i përket kësaj çështjeje gjyqtarët udhëzohen të shqyrtojnë Pjesën I të këtij Udhëzuesi, më saktë Pikën III - Dënimet kryesore sipas KPRK-së.

Derisa në kohë paqe shumë nga veprat që lidhen me konfliktet e armatosura janë më të rralla, gjyqësori në Kosovë duhet të përqendrohet në ato që janë më të shpeshta dhe që dëmtojnë reputacionin e Republikës së Kosovës në prizmin ndërkombëtar. Duke qenë se trafikimi me qenie njerëzore dhe kontrabandimi edhe më tej mbeten vepra mjaft të shprehura në praktikë, kërkohet nga gjykatat që me rastin e trajtimit të këtyre lëndëve të kenë vëmendje të veçantë në trajtimin e tyre. Disa nga rekomandimet përqendrohen në pikat si në vijim:

- Me rastin e matjes së dënimit të vlerësohen rrethanat relevante lehtësuese dhe rënduese duke u siguruar që rrethanat që kanë të bëjnë me viktimat të kenë gjithnjë peshë më të madhe në matjen e dënimit në raport me rrethanat personale të të pandehurit.
- Në rastet kur gjykatat konsiderojnë se nuk kanë mjaftueshëm të dhëna lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese të caktojnë seancë të veçantë për matjen e dënimit në kuptim të Nenit 356 të Kodit të Procedurës Penale (edhe nëse palët nuk e kanë kërkuar një seancë të tillë) duke kërkuar më shumë të dhëna dhe fakte nga palët dhe/apo Shërbimi Sprovues për tu ndihmuar në matjen adekuate të dënimit.

## B. Rrethanat rënduese relevante

### *i. Rrethanat që ndërlidhen me veprat në konflikte të armatosura të analizuara nga praktika ndërkombëtare*

Si rregull krimet gjatë konflikteve të ndryshme të armatosura kanë dinamika shumë më të ndryshme sesa veprat e kryera në kohë paqeje. Tribunali për ish-Jugosllavi është i përshtatshëm për analizën e rrethanave rënduese apo lehtësuese për vepra të kësaj natyre. Më poshtë po shkëpusim vetëm disa nga ato referenca.

### *Shkalla e lartë e pjesëmarrës së personit të dënuar në veprën penale*

Ndonëse nuk ka ndonjë paralele të drejtpërdrejta në praktikën ndërkombëtare për këtë rrethanë, kjo mund të shqyrtohet në kontekst të pozitës udhëheqëse në strukturën hierarkike. Kjo është konform bindjes se udhëheqësit, veçanërisht ata në struktura të organizuara hierarkike, duhet të dënohen më ashpër sesa vartësit e tyre. Siç theksohet nga TNPJ-ja në rastin Stakiq:

*“...sikurse te krimet e jakës së bardhë, i pandehuri prapa të pandehurit të drejtpërdrejtë – i pandehuri me dorëza të bardha – mund të meritojë dënim më të lartë sesa ai i cili fizikisht ka marrë pjesë në kryerjen e veprës varësisht nga rrethanat specifike të rastit.”<sup>187</sup>*

Nuk është për t’u çuditur se kjo rrethanë citohet më së shpeshti nga tribunalet ndërkombëtare në raste të krimeve të luftës dhe gjenocidit. Në raste të tilla, ekzistimi i udhëheqësit, veçanërisht në strukturë formale hierarkike, konsiderohet i rëndësishëm thelbësor për përfundimin e veprës. Pa ekzistimin e strukturës formale ushtarake dhe të gjitha rrethanave që e shoqërojnë atë, veprat mund të mos kishin ndodhur kurrë. Andaj gjykatat kanë konsideruar që kjo duhet të merret si rrethanë rënduese. Ndonëse ka disa raste ndërkombëtare ku nuk merret si rrethanë rënduese, kjo është zbatuar në shumicën dërrmuese të rasteve në situatat në të cilat pozita udhëheqëse ka qenë element i veprës.

Është shumë interesant të shihen nuancat e arsytimit të TNPJ-së në rastin Plavsiq dhe mënyrën se si ata e kanë konsideruar rolin e saj në Presidencë si rrethanë rënduese. Në aktgjykimin e tij, Trupi Gjykyes kishte thënë: *“Trupi Gjykyes pranon se pozita superiore e të akuzuarës është rrethanë rënduese në këtë rast edhe pse ajo nuk ka qenë në radhët e para të udhëheqjes: të tjerët e kanë mbajtur atë pozitë. Ajo nuk e ka ideuar planin i cili ka çuar deri te ky krim dhe ka pasur rol më të vogël në ekzekutimin e tij se të tjerët. Pavarësisht kësaj, znj. Plavsiq ka qenë në Presidencë, organin më të lartë civil, gjatë fushatës, dhe e ka inkurajuar dhe mbështetur atë përmes pjesëmarrjes së saj në Presidencë dhe në deklaratimet e saj”*.<sup>188</sup>

Në anën tjetër, pjesëmarrja indirekte e të akuzuarit në kryerjen e veprave duhet të jetë e lidhur me një teori të formuluar më mirë të llojeve të përgjegjësisë, e jo të cilësohet si rrethanë lehtësuese. Për shembull, në mendimin e Dhomës së Apelit të TNPJ-së “dëshmia e pjesëmarrjes

<sup>187</sup> Rasti Nr.IT-97-24-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Milomir Stakiq, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (31 korrik 2003), Par.918.

<sup>188</sup> Rasti Nr.IT-00-39&40/1-S, Aktgjykimi për Dënim, Prokurori kundër Biljana Plavsiq, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (27 shkurt 2003) par. 57:



joaktive nga udhëheqësi në veprimet kriminale të vartësve të tij i shtohet shkallës së dështimit të udhëheqësit për të parandaluar apo ndëshkuar ato veprime dhe rrjedhimisht mund ta ashpërsojë dënimin...Dështimi për të parandaluar apo ndëshkuar veprat e kryera nga vartësit është sjellje relevante e fajësisë dhe mungesa e pjesëmarrjes aktive në kryerjen e veprave nuk e zvogëlon fajësinë”.<sup>189</sup>

Si i tillë, veprimi i ndihmës në kryerje të veprës është formë e pjesëmarrjes e cila shpeshherë konsiderohet si më pak e rëndë sesa pjesëmarrja personale apo kryerja e drejtpërdrejtë dhe, varësisht nga rrethanat, mund të meritojë dënim më të butë sesa dënimi i shqiptuar për kryerje të drejtpërdrejtë.

E njëjta vlen edhe për mosgatishmërinë në kryerjen e veprës penale. Mosgatishmëria në përgjithësi nuk do të duhej të kishte rol në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana e “gatishmërisë/entuziazmit” në kryerje ngërthen elemente të cilat më shumë janë të ndërlidhura me mens rea (dashjen) e nevojshme për veprat e kryera. Shkalla e përfshirjes së të akuzuarit veç është vlerësuar (dhe peshuar në mënyrë adekuate) në lidhje me elementin mendor dhe nuk ka nevojë që të merret parasysh sërish në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Lidhur me mundësinë që ekzistimi i urdhrit nga lart të merret si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin i cili është dashur ta zbatojë atë urdhër (me fjalë tjera, një formë e shtrëngimit), duhet të theksohet se një rrethanë e tillë jo domosdoshmërisht përbën rrethanë lehtësuese dhe qartazi nuk i garanton ushtarëve mbrojtje të plotë. Padyshim që në rastet kur i pandehuri ka qenë vartës, por në të njëjtën kohë ka qenë pjesëmarrës vullnetar në sjelljen kriminale, nuk do të ketë zbutje të dënimit të tij. Ekzistimi i urdhrit nga lart mund të cilësohet si rrethanë lehtësuese vetëm kur vartësi kryen veprë pa vullnetin e tij nën shtrëngim absolut, si rezultat i natyrës shtrënguese të urdhrit të pranuar nga eprori i tij, mosbindja ndaj të cilit do të mund ta rrezikonte jetën e vet të akuzuarit.

#### *Shkalla e lartë e dashjes nga ana e personit të dënuar*

Një nga rrethanat që përveç tjerash shpie në konkludimin e nivelit të dashjes për kryerjen e këtyre veprave është edhe kryerja me paramendim. Siç ceket në aktgjykimin e Trupit Gjykses të TNPJ-së në rastin Krstiq: “*Pjesëmarrja e paramenduar apo entuziaste në veprën penale domosdoshmërisht tregon një shkallë më të lartë të kriminalitetit në anën e pjesëmarrësit. Në përcaktimin e dënimit të përshtatshëm, duhet bërë dallim në mes të individëve të cilët i kanë lejuar vetes që të futen në vorbullën e dhunës, qoftë edhe pa dëshirë, dhe atyre të cilët e kanë iniciuar apo rënduar atë dhe rrjedhimisht kanë kontribuar në mënyrë substanciale në shkaktimin e dëmit të përgjithshëm*”.<sup>190</sup>

#### *Nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore*

Deri në një masë, ky faktor është trajtuar në shumë raste të Tribunalëve Ndërkombëtare lidhur me peshën e krimeve gjatë konflikteve. Për shembull, në rastin Blaskiq, Trupi Gjykses

<sup>189</sup> Rasti Nr.IT-96-21-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zejnil Delalij, Adravko Muciq, Hazim Deliq dhe Esad Landzo, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (20 shkurt 2001), Par.736-737, citohet Aktgjykimi i Apelit në rastin Aleksovski, par. 183.

<sup>190</sup> Rasti Nr.IT-98-33-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Radislav Krstiq, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (2 gusht 2001), Par.711.

kishte përfunduar: “Fakti që vepra ka qenë aq e tmerrshme është një kriter cilësor i cili mund të nxirret nga natyra e saj veçanërisht mizore apo poshtëruese”. “Mizoria e sulmit është qartazi një konsideratë e rëndësishme gjatë caktimit të dënimit përkatës. Në këtë rast, tmerrshmëria e veprave përcaktohet nga vetë shkalla dhe planifikimi i veprave të kryera të cilat kanë rezultuar në shkaktimin e qëllimshëm të vuajtjeve ndaj viktimave pavarësisht moshës, gjinisë apo statusit”.<sup>191</sup>

Përfshirja e anëtarëve të viktimës si viktimë në raste të vrasjeve është pranuar nga Trupi Gjykses i TNPJ-së, i cili thekson: “Së bashku me lëndimet fizike dhe emocionale të mbartura nga viktimat, vuajtjet e tyre për humbjen e më të dashurve dhe fakti që shumica e tyre ende nuk janë në gjendje të rikthehen në shtëpitë e tyre as sot e kësaj dite gjithashtu duhet të përmendet”.<sup>192</sup>

### Nëse vepra penale përfshin disa viktimë

Duke pasur parasysh potencialin e madh që këto vepra të përfundojnë në viktimizim në shkallë të gjerë, kjo paraqitet si një rrethanë e cila duhet gjithsesi të merret parasysh në ashpërsim. Në një vështrim mbi veprat e këtij kapitulli vërejmë se shumë nga këto nene (nenet 159-161) dënimi është më i lartë bazuar në dashjen e të pandehurit dhe shkallën e lëndimeve apo vdekjen e viktimave, por nuk bën dallim në bazë të numrit të viktimave. Pra, maksimumet ligjore janë të njëjtë pavarësisht nga numri i viktimave. Andaj, gjykata këtë konsideratë do e shqyrtojë me rastin e shqyrtimit të rrethanës nga Paragrafi 2.5 të Nenit 70 të KPRK-së.

### Çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale; dhe dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar

Referimi në këtë rrethanë është i shumë në praktikën ndërkombëtare, veçanërisht nga tribunalet ndërkombëtare. Një shembull më i thjeshtë i cili edhe pse i referohet krimeve të luftës, është shumë aktual dhe mund të jetë lehtësisht i aplikueshëm në praktikën e përditshme vendore për shkak të profesionit të të pandehurit si mjek rasti Ntakirutimana, ku Trupi Gjykses në përcaktimin e dënimit e kishte konsideruar si relevant statusin e të akuzuarit si mjek dhe faktin se ai kishte keqpërdorur pozitën e tij duke shkatërruar jetët në vend të shpëtimit të tyre dhe kishte shkelur detyrimin etik të cilin ia kishte borxh komunitetit.<sup>193</sup>

Arsyetimi ishte i ngjashëm kur Trupi Gjykses në rastin Todoroviq kishte observuar se “në vend se, në pozitën e tij si kryeshef i institucionit që është përgjegjës për zbatimin e ligjit, Stevan Todoroviq, aktivisht dhe drejtpërdrejt kishte marrë pjesë në veprat penale të cilat ai do të duhej t’i parandalonte apo t’i ndëshkonte...keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit të tij dhe besimit të popullit në institucion qartazi përbën rrethanë rënduese”.<sup>194</sup>

---

<sup>191</sup> Rasti Nr.IT-95-14-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Tihomir Baskiq, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (3 mars 2000), Par.783.

<sup>192</sup> Supra note 62, Par.787.

<sup>193</sup> Rasti Nr.ICTR-96-17-T, Aktgjykimi dhe dënimi, Prokurori kundër Elizaphan dhe Gorard Ntakirutimana, Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ruandë (TNPR), (21 shkurt 2003).

<sup>194</sup> Rasti Nr.IT-95-9/1-S, Aktgjykimi i caktimit të dënimit, Prokurori kundër Stevan Todoroviq, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (31 korrik 2001), Par.61, gjithashtu citohet Aktgjykimi i Apelit në rastin Aleksovski, par. 183; Aktgjykimi i Apelit në rastin Celebici, par.745.

Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar si rrethanë lehtësuese e cituar nga praktika ndërkombëtare

Rrethanat personale dhe karakteri i mirë i personit të dënuar në përgjithësi janë rrethana lehtësuese në strukturat e dënimit në mbarë botën. Rrethana e karakterit të mirë është trajtuar në shumë raste të Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavi qoftë për të arsyetuar apo edhe për të mos arsyetuar aplikimin e saj si rrethanë. Kështu në rastin Blaskiq, TNPJ (Tribunali i Hagës) ka theksuar se “*tiparet e karakterit nuk shqyrtohen aq shumë për të kuptuar arsytet e kryerjes së veprës por më shumë për të vlerësuar mundësinë e rehabilitimit të të akuzuarit*”. Pavarësisht kësaj, sikurse në rastin Furundija, kur gjykata po vlerësonte nëse duhej përfshirë moshën e re si rrethanë lehtësuese, në të dyja rastet Trupi Gjykes kishte deklaruar se “...në një rast serioz si ky dhe përderisa shumë të akuzuar kanë këto rrethana personale, Trupi Gjykes duhet të gjejë se pesha e tyre është e kufizuar apo madje edhe jo ekzistuese në përcaktimin e dënimit”.<sup>195</sup>

Vetitë e ‘karakterit të mirë’, ndërlidhen me vlerësimin e aspekteve siç janë reputacioni, kredibiliteti, personaliteti dhe sjellja shoqërore e të akuzuarit, zakonisht kanë për qëllim që të tregojnë se vepra e kryer është jashtë karakterit dhe, në tërësi, kanë për qëllim që t’i paraqesin gjyqtarit informacion më të plotë lidhur me jetën e të akuzuarit, të kaluarën dhe karakteristikat e tij. Në rastin Sikirica, Trupi Gjykes i TNPJ\_së kishte përfunduar se dëshmitë e karakterit të mirë duhet të shpërblehen: “*Trupi Gjykes ka shqyrtuar prova të mjaftueshme të përpjekjeve të Dragan Kolunxhisë për të lehtësuar kushtet e rënda në kampin Keraterm për shumë prej të ndaluarve...Në bazë të dëshmive për qasjen e tij dashamirëse ndaj të ndaluarve, Dragan Kolunxhija duhet të merr zbutje të konsiderueshme të dënimit*”.<sup>196</sup>

Mosha dhe gjendja shëndetësore e të pandehurit

Vështirësia me të dy këto rrethana është që nuk ka përkufizim të qartë të asaj që përbën të ri apo të moshuar si rrethanë lehtësuese. Disa nga vështirësitë në zbatimin e kësaj rrethane mund të shihen në praktikën e Tribunalit të Hagës, në adresimin e aspektit të qenit ‘i ri’. Në përgjithësi, dhomat e gjyqimit, mesatarisht, e kanë konsideruar që “i ri” është ndërmjet moshës 13 dhe 23 vjeçare në kohën e kryerjes së veprës penale. Derisa kjo mesatare mund të konsiderohet si kufiri i lartë e asaj që mund të konsiderohet i ri apo e re, nuk është vështirë që të pajtohemi me përdorimin e kësaj. Mirëpo ka pasur raste kur Gjykata ka shkuar aq larg sa e ka zbatuar zbutjen e dënimit për dikë që është mbi atë moshë. Andaj, përcaktimi i moshës së “re” varet nga lloji i veprës penale të kryer dhe sa pritët që një kryes ‘i ri’ ta kuptojë peshën e veprimeve të tij apo aftësinë për ta duruar presionin ekstrem nga një person më i lartë.

Në rastin Pllavshiq, mosha e shtyrë e të akuzuarit është marrë parasysh për dy arsye: E para, lodhja fizike që është e lidhur me vitet e shtyra e bënë vuajtjen e dënimit më të vështirë për

<sup>195</sup> Rasti Nr.IT-95-14-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Tihomir Baskiq, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (3 mars 2000), Par.782, citohet IT-95-17/1-T, Prokurori kundër Anto Furundija, Aktgjykimi, (10 dhjetor 1998) par. 284.

<sup>196</sup> Rasti Nr.IT-95-8-S, Aktgjykimi për caktimin e dënimit, Prokurori kundër Dusko Sikirica, Damir Dosen, Dragan Kolunxhija, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (13 nëntor 2001), par. 229.

një të akuzuar të moshuar se sa për një të ri. E dyta, të pandehurit të moshës së shtyrë mund t'i ketë mbetur pak jetë cilësore për ta jetuar pas lirimit.”<sup>197</sup>

Ndryshe nga rasti Pllavshiq, Tribunali i Hagës ka pasur qasje shumë interesante në rastin Simiq, duke vendosur nëse gjendja mjekësore ka ndikim në dënim, ka dhënë arsyetim shumë të gjerë për atë se përse një gjendje e tillë jo domosdoshmërisht konsiderohet si rrethanë lehtësuese. Në këtë rast, mbrojtja kishte paraqitur raport mjekësor ku theksohej që gjendja e z. Simiq do të kërkonte kujdes të plotë mjekësor për tërë pjesën e mbetur të jetës së tij, që ai do të kërkonte edhe ndihmë ditore për higjienën personale, përgatitjen e ushqimit, lëvizjen e karrocës së tij dhe bartjen e tij nga shtrati në karrocën e tij”. Përkundër raportit mjekësor të paraqitur, duke e marrë parasysh peshën e veprës së kryer nga i pandehuri, dhoma gjyquese ka vlerësuar që “... në raportin mjekësor (prova materiale a) nuk tregohet masa deri në cilën shkallë jetëgjatësia e Milan Simiqit do të ndikohej nga të qenit i burgosur. Sipas mendimit të dhomës gjyquese, gjendja mjekësore që në një të ardhme mund të ndikojë në jetëgjatësinë e tij, nuk shpie automatikisht në zvogëlimin e dënimit.” Ishte mendim i Dhomës që vetëm në rrethana përjashtuese apo raste të “të rralla” të qenit i sëmurë mund të konsiderohet si rrethanë lehtësuese.

Përveç kësaj, ndonëse dhoma gjyquese ishte e vetëdijshme që vendi i mbajtjes nuk do të mund t'i plotësonte nevojat e z. Simiq, kjo nuk kishte ndikuar në vendimin për burgim. Dhoma e kishte nxjerrë vendimin dhe kishte e konsideruar: “*të nevojshme që të theksojë se burgu në të cilin do të caktohet Milan Simiq, për aq sa është e mundshme, duhet të jetë në gjendje për t'i akomoduar nevojat e tij mjekësore .... Ndonëse ishte e ndjeshme ndaj komplikimeve mjekësore që, Milan Simiq, i kishte pasur, dhe gjendjen e tij aktuale mjekësore, Dhoma Gjyquese nuk u bind që problemet mjekësore janë të pranishme deri në atë masë sa për ta arsyetuar zvogëlimin e dënimit. Gjendja mjekësore e Milan Simiqit nuk duhet të merret parasysh si rrethanë lehtësuese në përcaktimin e dënimit.*”

#### *Bashkëpunimi i përgjithshëm me gjykatën i personit të dënuar, përfshirë dorëzimin vullnetar*

Kjo rrethanë ka pasur rëndësi parësore në shqiptimin e dënimeve në tribunalet ndërkombëtare për shkak të natyrës së qenësishme të procedurave. Duke qenë se suksesi i tyre varet shumë në bashkëpunimin ndërshtetëror, që mund të jetë problematik edhe në skenarët më të mirë, Gjykatat i kanë shpërblyer me zbutje të pandehurit, të cilët vullnetarisht i janë dorëzuar kompetencës së Gjykatës. Në rastin Erdemoviq, bashkëpunimi i të akuzuarit, dorëzimi i tij vullnetar dhe pranimi i fajësisë ishin konsideruar rrethana lehtësuese: “... *Prokurori ka theksuar që nuk ka gjetur papajtueshmëri në informatat që ai ua kishte dhënë atyre; hetimet e tyre i kanë konfirmuar shumicën e gjërave që ai ua kishte thënë, duke treguar që i pandehuri është me vullnet të sinqertë. Kjo mbështetet nga pranimi i tij dhe pranimi përputhshëm i fajit, në veçanti nga fakti që ai ka ardhur vullnetarisht dhe ka rrëfyer për rolin e tij në masakra para se përfshirja e tij t'i bëhet e ditur cilitdo autoritet hetimor.*”<sup>198</sup>

<sup>197</sup> Rasti nr. IT-00-39&40/1-S, Aktgjykimi gjyques, Prokurori kundër Biljana Plavsic, Tribunali Ndërkombëtar për Ish Jugosllavi, (27 shkurt 2003) par. 95-106.

<sup>198</sup> Rasti nr. IT-96-22-Tbis, Aktgjykimi Dënues, Prokurori kundër Drazen Erdemoviq, Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish Jugosllavi, (5 mars 1998), par.16.i.

Lidhur me veprat e kësaj natyre duhet pasur parasysh edhe *rrethanën e lirit të pengjeve* nga paragrafi 3.13<sup>199</sup> i Nenit 70 të KPRK-së e cila paraqitet si rrethanë shumë adekuate për tu marrë në konsideratë, si rrethanë posaçërisht lehtësuese duke plotësuar kushtin nga paragrafi 1.2 i Nenit 71 për zbutjen e dënimit nën minimumin e dënimit apo shqiptimin e një lloji më të butë të dënimit.

### Pranimi i fajësisë

Duke pasur parasysh në veçanti natyrën shumë të rëndë të veprave nga ky kapitull, pranimi i fajësisë duhet të përjashtohet nga llogaritja me automatizëm e dënimit nën minimumin ligjor. Gjykata duhet të vlerësojë përfitimet që ka nga ky pranim. Në rastin Sikirica, Dhoma e dha këtë vlerësim në lidhje me kohën e pranimit të fajësisë: “Derisa i pandehuri, i cili e pranon fajësinë për akuzat kundër tij para fillimit të gjykimit zakonisht do të pranojë dobinë e plotë të atij pranimi, ai i cili e pranon fajin në çfarëdo kohe pas kësaj, do të marrë pak dobi, por jo aq sa do të fitonte sikur pranimi i fajësisë të bëhej para fillimit të gjykimit.”<sup>200</sup>

#### *ii. Rrethanat kryesisht për veprat nga nenet 163-166*

### Rrethanat që i referohen veprave si dhunë në bazë gjinore me fokus në Trafikimin me qenie njerëzore

Kur flitet për rrethanat rënduese në rastet sidomos të trafikimit me qenie njerëzore, gjyqësori duhet të ketë parasysh se këto vepra bien kryesisht në kuadër të rregullimit të Konventës së Stambollit pasi konsiderohen edhe vepra të dhunës në bazë gjinore, kur dihet se në mënyrë disproporcionale preken më shumë gratë. Konventa e Stambollit<sup>201</sup> (e cila tashmë është integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës) në Nenin 46 liston një numër rrethanash të cilat mund të merren në konsideratë me rastin e matjes së dënimit për veprat që mbulohen nga kjo Konventë. Tabela e mëposhtme jep një kombinim/përshtatje të rrethanave nga KPRK-ja dhe nga Konventa e Stambollit duke sqaruar se si njëra rrethanë korrespondon me tjetrën. Siç shihet nga tabela e mëposhtme dhe siç është rasti me rrethanat nga KPRK-ja, edhe rrethanat nga Konventa mund të jenë si indikator apo rrethanë e cila mund të aplikohet në disa prej rrethanave rënduese të KPRK-së, andaj edhe i gjejmë të përsëritura në tabelë:

---

<sup>199</sup> Në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 169, 191 ose 193 të këtij Kodi, kontributi në mënyrë efektive për lëshimin ose për ta sjellë të gjallë personin e rrëmbyer, marrë apo ndalur ose dhënia vullnetare e informatave që kontribuojnë në identifikimin e përgjegjësve të tjerë për veprën penale.

<sup>200</sup> Rasti nr. IT-95-8-S, Aktgjykimi Dënues, Prokurori kundër Dusko Sikirica, Damir Dosen, Dragan Kolunxhija, Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish Jugosllavi, (nëntor 13, 2001), par. 150

<sup>201</sup> Konventa e Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje [Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence (CETS No. 210)], 01/08/2014.

Nga Neni 70 par. 2 i KPRK-së	Nga Neni 46 i Konventës së Stambollit
Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale. Shkallën e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar.	Vepra penale ose vepra penale të ngjashme janë kryer në mënyrë të përsëritur.
Prezencën e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale.	Vepra penale është paraprirë ose shoqëruar nga nivele të dhunës ekstreme. Vepra është kryer me përdorimin ose kërcënimin e armës. Vepra penale ose vepra penale të ngjashme janë kryer në mënyrë të përsëritur.
Nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore. Nëse vepra penale përfshin disa viktimë. Nëse viktimë e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme. Moshë e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar.	Vepra penale është kryer kundër një personi të pambrojtur për shkak të rrethanave të veçanta.  Vepra është kryer kundër ose në prani të një fëmije.
Shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar...	Vepra penale ose vepra penale të ngjashme janë kryer në mënyrë të përsëritur. Vepra penale ka shkaktuar dëmtim të rëndë fizik ose psikologjik të viktimës.
Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal.	Vepra penale është kryer nga dy ose më shumë njerëz që veprojnë së bashku.
Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar.	Vepra penale ose vepra penale të ngjashme janë kryer në mënyrë të përsëritur. Autori është dënuar më parë për vepra penale të një natyre të ngjashme.
Nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjare.	Vepra penale është kryer kundër një ish-bashkëshorti ose partneri ose bashkëshorti ose partneri aktual të njohur nga ligji i brendshëm, nga një anëtar familjeje, një person që bashkëjeton me viktimën ose një person që ka abuzuar me autoritetin e tij ose të saj;

Gjykatat duhet të kenë parasysh se rrethanat rënduese të rekomanduara në Konventën e Stambollit duhet të bëhen pjesë e praktikës gjyqësore tek ne pikërisht për shkak se e njëjta është bërë pjesë e legjislacionit tonë me vet inkuorporimin në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ajo që bie në sy si risi, krahasuar me rrethanat e parapara me KPRK janë kërkesa që të merren në konsideratë:

- Kur veprat penale janë kryer në mënyrë të përsëritur.
- Kur vepra penale është kryer në prani të një fëmije.

Marrja në konsideratë e ekzistimit të grupit të organizuar në këto veprimtari është e rëndësishme së veçantë me rastin e caktimit të dënimit, pasi jo vetëm tregon për një shkallë më të lartë të përgjegjësisë individuale, por edhe shkallë më të lartë të dëmit dhe dhunës së ushtruar apo

kërcënuar. Përgjigja e sistemit të drejtësisë gjithnjë duhet të jetë më e ashpër ndaj kësaj kategorie të kryesve si dhe recidivistëve.

Shkalla dhe forma e dhunës dhe shtrëngimit është ndër faktorët më me rëndësi në ashpërsim të dënimit andaj edhe duhet kushtuar vëmendje e veçantë. Me qëllim të identifikimit të formave të dhunës, por edhe të elementeve tjera të veprës penale të trafikimit, gjykatat udhëzohen që të marrin në konsideratë listën e indikatorëve<sup>202</sup> të miratuar nga Qeveria e Kosovës të cilat bazohen në standardet ndërkombëtare dhe të cilat i mundësojnë sistemit të drejtësisë të kuptojë më mirë cilat janë format në të cilat mund të shprehen këto elemente.

### **C. Rrethanat lehtësuese për veprat nga nenet 163-166**

Edhe pse të gjitha rrethanat nga paragrafi 3 i Nenet 70 mund të gjejnë zbatim te veprat e këtij kapitulli, gjykatat duhet të kenë kujdes të shtuar në matjen e peshës së tyre. Është e pamundur të bëhet një shabllonizim i rrethanave se cila ka peshë më shumë se tjetra, pasi aplikimi dhe pesha e tyre varet shumë nga lloji i veprës, shkalla e viktimizimit dhe/apo dëmit të shkaktuar dhe përgjegjësia e tij/saj. Tri rrethanat e fundit gjithnjë duhet të kenë rolin kryesor në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duhet potencuar se karakteri i mirë i të pandehurit apo edhe sjellja e mëparshme e tij/saj nuk do duhej të merrej në konsideratë te veprat e trafikimit, por edhe nëse do të merren pesha e tyre do të duhej të jetë minimale në raport me rrethanat tjera të këtyre veprave apo edhe faktorëve rëndues. Për më tepër, karakteri i të pandehurit, në asnjë rast nuk do duhej të merrej si rrethanë posaçërisht lehtësuese për zbutje të dënimit nën minimumin ligjor.

Edhe te pranimi i fajësisë, gjykata duhet të ketë kujdes që të mos zbatojë në mënyrë automatike zbutjen nën minimumin ligjor pasi natyra e rëndë e veprave në këtë kapitull në përgjithësi nuk e arsyeton uljen automatike pa pasur në konsideratë rrethanat tjera.

### **D. Aplikueshmëria e dënimeve dhe masave tjera**

*-Dënimi plotësues* - Në rast të përfshirjes së një personi zyrtar në veprat e trafikimit, gjykatat udhëzohen që krahas dënimit kryesor të shqiptojnë edhe dënimin plotësues nga Neni 62, respektivisht Neni 63 i KPRK-së të ketë fokus të veçantë në konfiskimin e pasurisë, dobisë pasurore dhe/apo mjeteve.

*-Dënimi me gjobë* - Duke qenë se, si neni 164 ashtu edhe ai 165 të KPRK-së, parashohin shqiptimin e dënimit me gjobë gjykata duhet të ketë parasysh gjithnjë që gjobat të shqiptohen në pajtim me gjendjen financiare të të pandehurit në pajtim ashtu siç kërkohet me par. 5 të Nenet 69 të KPRK-së dhe siç është zbërthyer në Udhëzuesin e veçantë për shqiptimin e gjobave penale.

---

<sup>202</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhëzim Administrativ nr . 01/2014 për identifikimin e hershëm të viktimave të trafikimit me njerëz nga shërbimet konsullore, policia kufitare dhe inspektorati i punës, 03.04.2014.

-Dëmshpërblimi i Viktimave - Dëmshpërblimi i viktimave duhet të jetë gjithnjë në qendër të vendimmarrjes së gjykatës, dhe të urdhërohet sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me zgjidhje alternative të rasteve. Në rastet kur përcaktimi i dëmit jomaterial nuk është i mundur në procedurë penale, gjykata duhet të bëjë përpjekje për urdhërimin e dëmshpërblimit të dëmit të arsyeshëm material. Dëmshpërblimi i viktimave ka prioritet ndaj shqiptimit të gjobës ndaj të pandehurve. Gjykatat duhen udhëzuar viktimat për mundësinë e paraqitjes së kërkesës për kompensim nga Programi për kompensimin e viktimave.

-Konfiskimi i pasurisë - Veprat brenda këtij Kapitulli që ndërlidhen me trafikimin, kontrabandimin me migrantë apo skllavërinë dhe punën e detyruar janë vepra që kryhen me qëllim të përfitimit, andaj gjykata duhet siguruar që krahas vendimit mbi dënimin të godet edhe aspektin financiar dhe profitin e të pandehurit/ve.

-Lirimi nga dënimi - Përkundër që këto vepra janë të natyrës së rëndë, KPRK-ja në nenin 154<sup>203</sup> par. 3 ka paraparë mundësinë e lirimit nga dënimi nëse anëtari i grupit kriminal e paraqet grupin kriminal të organizuar para kryerjes së cilësdo nga veprat nga nenet 142-150.

---

<sup>203</sup> Organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës.



### III. Kapitulli XVI Veprat penale kundër jetës dhe trupit

#### Shqyrtime të përgjithshme


Veprat penale nga ky kapitull janë vepra penale të cilave i është kushtuar një rëndësi e veçantë në të gjitha periudhat dhe vazhdohet t'i kushtohet një rëndësi e tillë edhe nga ligjdhënësi me qëllim të mbrojtjes së të mirave të mbrojtura. Përveç kësaj, duhet të theksohet se e drejta e jetës është e garantuar edhe me instrumentet ndërkombëtare të cilat janë inkorporuar edhe në Kushtetutën e Kosovës dhe si të tilla janë në zbatim të drejtpërdrejtë. E drejta e jetës është e drejtë absolute dhe e pakufizuar. Edhe Konventa për të drejtat dhe liritë e njeriut e vitit 1950 dhe neni 1 i Protokollit nr. 6 të vitit 1983, sugjeron që të abrogohet dënimi me vdekje, çka edhe është vendosur në vitin 1999 në Republikën e Kosovës kur dënimi me vdekje si dënim kapital është zëvendësuar, fillimisht me dënim me burgim afatgjatë e më vonë me dënim me burgim të përjetshëm. Vepra penale e vrasjes është vepër shumë e rëndë penale, ngase humbet vlera më e madhe njerëzore— jeta e njeriut. E drejta penale megjithatë njeh tri lloje të vrasjeve dhe atë:

- Vrasje të rëndomta apo forma themelore e vrasjes,
- vrasje të cilësuar apo të kualifikuara dhe
- vrasje të privileguara,

andaj edhe sa i përket dënimeve për këto vepra duhet të ketë dallime. Veprat e mbuluara nga ky kapitull mund të ndahen në tre grupe dhe atë në bazë të shkallës së rrezikshmërisë që paraqesin ato:

- Dënueshmëri maksimale me minime ligjore shumë të larta prej 5, 10, 15 vjet dhe maksimume prej 20 vjet apo edhe burgim të përjetshëm.
- Dënueshmëri mesatare me dënime deri në 10 dhe 15 vjet; dhe
- Dënim të ulët me dënime deri 6 muaj, 1, 3 dhe 5 vjet.

#### A. Pikënisja



- Për të sqaruar ndarjet e mësipërme, është e nevojshme të ritheksohet se sa i përket veprave për të cilat si dënim është paraparë edhe burgimi i përjetshëm pikënisja NUK ZBATOHET nëse gjykata e shqipton këtë dënim. Sa i përket kësaj çështjeje gjyqtarët udhëzohen të shqyrtojnë Pjesën I të këtij Udhëzuesi, më saktë Pikën III -Dënimet kryesore sipas KPRK-së.

## B. Rrethanat rënduese relevante

Me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese gjithmonë duhet të merret parasysh se çdo rrethanë rënduese dhe lehtësuese do të jetë e vlerësuar drejt vetëm atëherë kur vlerësohen në lidhmëri në mes veti dhe në raport me rrethanat tjera të cilat janë të rëndësishme me rastin e matjes së lartësisë së dënimit të shqiptuar. Vlerësimi i izoluar qoftë i rrethanave rënduese qoftë lehtësuese nuk mund të jep pasqyrën reale të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të kryesit, e që është kusht qenësor për matjen e drejtë të dënimit.

Me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjithmonë duhet të merren parasysh edhe rrethanat relevante të parapara me nenin 70 par. 2 të KPRKK-së, por duhet t'i kushtohet kujdes faktit që mos të merren si rrethana rënduese elementet e veprës penale e sidomos te veprat e vrasjes së rëndë nga neni 173 i KPRKK-së:

*-privon nga jeta fëmijën, neni 173 par. 1 nënpar. 1.1 i KPRKK-së, nuk mund të merret edhe si rrethanë rënduese nga neni 70 par. 2 nënpar. 2.7 që nënkupton moshën e viktimës, sepse shumë shpesh, gjykatat e shkallës së parë gabimisht e marrin elementin e veprës penale si rrethanë rënduese.*

*-Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar - Në rastet kur kemi të bëjmë sidomos me veprën penale të vrasjes sipas nenit 173 të KPRK-së, vrasjes së rëndë nga neni 174 i KPRK-së, lëndimit të lehtë nga neni 185 i KPRK-së dhe lëndimit të rëndë trupor nga neni 186 i KPRK-së, gjykata duhet të marrë parasysh rrethanat nga paragrafi 2.1 i nenit 70 gjithnjë duke peshuar se në çfarë mase është angazhuar personi në kryerjen e veprës penale, apo në rastet e bashkëkryerjes apo bashkimit kriminal. Anasjelltas, rrethana nga paragrafi 3.5 i po këtij neni mund të ndikojë në zbutjen e dënimit.*

*-shkalla e lartë e dashjes nga ana e personit të dënuar apo në fakt shkalla e përgjegjësisë penale po ashtu mund të merret si rrethanë rënduese por edhe si lehtësuese. Duhet të kemi parasysh se shkalla e përgjegjësisë penale vërtetohet me vet faktin e vërtetimit të fajësisë së tij. Meqenëse përgjegjësia penale përbëhet nga përgjegjësia dhe fajësia, rrjedhimisht personi i cili nuk është i përgjegjshëm nuk mund të jetë edhe fajtor. Mirëpo neni 17 i KPRK-së, parasheh se “kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”. Pra, varësisht nga kjo, edhe këto rrethana mund të merren si rënduese apo si lehtësuese. Kështu, fakti se një person e ka kryer veprën në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore nuk do të thotë se duhet të lirohet nga përgjegjësia penale, por ky fakt merret si rrethanë lehtësuese obligatore. Ndërsa, nëse një person i tillë konsiderohet si i rrezikshëm për rrethin, atëherë gjykata krahas dënimit mund t'i shqiptojë edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor (neni 85 i KPRK-së) apo trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri (neni 86 i KPRK-së). Kjo varet nga shkalla e rrezikshmërisë së kryesit të veprës penale. Në anën tjetër, ligji bënë dallimin në mes të dashjes (dashja direkt dhe dashja eventuale) dhe pakujdesisë, si për kah definicioni ashtu edhe për kah shkalla e përgjegjësisë penale dhe dënimi për këto forma të përgjegjësisë. Andaj, gjykata duhet të bëjë dallimin dhe gjithmonë të merr parasysh dashjen dhe llojin e dashjes si dhe pakujdesinë si formë më e lehtë e fajit e cila është e dënueshme vetëm kur është paraparë shprehimisht me ligj.*

- Edhe rrethanat tjera rënduese të parapara me Nenin 70 të KPRK-së mund të jenë të aplikueshme në veprat sipas këtij kapitulli gjithnjë duke pasur kujdes në mos dyfishim me elementet e veprës penale. Për qëllime elaborimi po marrim *shkallën e dëmit të shkaktuar* si rrethanë rënduese e paraparë me par. 2.8 të nenit 70 të KPRK-së duke u siguruar për mos dyfishim me elementet e veprës penale. Kjo për faktin se veprat nga ky kapitull gjithmonë si pasojë kanë jetën dhe trupin, andaj ky fakt e pamundëson përfshirjen e rrethanës nga neni 2.8 si rrethanë rënduese.

*-Rrethanat lidhur me viktimat-* Të gjitha rrethanat nga par. 2.4-2-7 mund të jenë relevante varësisht nga lloji i veprës së kryer. Shumë nga këto rrethana që i referohen Viktimave dhe shkallës më të lartë të rrezikshmërisë që i ekspozohen, tashmë janë të përfshira si elemente të veprës në Nenin 173 të KPRK-së, andaj duhet pasur kujdes për të mos e dyfishuar me rrethanat rënduese. Gjykatat duhet të kenë parasysh të mos bëjnë dyfishimin.

*Një rrethanë e përdorur nga tribunalet ndërkombëtare e në kohët e fundit edhe në praktikën gjyqësore në Kosovë është edhe ndikimi i vrasjeve në anëtarët e familjes së viktimës:*

*“Po ashtu, si rrethanë tjetër rënduese është marrë për bazë edhe ndikimi i veprës penale te viktimat (te të dëmtuarit, familjarët e të ndjerit), pasi që në rastin konkret viktimat ka lënë pas vetes bashkëshorten dhe dy vajzat, që jeta e tyre do të jetë më e vështirësuar pas vdekjes së tani të ndjerit e në veçanti për faktin se njëra nga vajzat e tij është e mitur, andaj në rastin konkret vepra penale ka krijuar pasoja dhe ka ndikuar edhe në persona të tretë, në familjarët e tani të ndjerit, e në veçanti në vajzën e tij të mitur.”<sup>204</sup>Një adresim i këtij elementi nuk duhet bërë vetëm në aspekt të caktimit të dëmshpërblimit të anëtarëve të familjes, por edhe në kontekstin e dëmit dhe peshës së veprës së kryesit. Ndikimi ndaj anëtarëve të familjes është njohur edhe me vet Direktivën e BE-së të 25 tetorit 2012, në të cilën potencohet se “Është e mundur që anëtarët e familjes së viktimave gjithashtu të dëmtohen si rezultat i veprës penale. Në veçanti, anëtarët e familjes së personit vdekja e të cilit është shkaktuar drejtpërdrejt nga vepra penale mund të dëmtohen si rezultat i veprës. Anëtarët e tillë të familjes, të cilët janë viktimat indirekte të veprës, gjithashtu duhet të përfitojnë nga garancitë e parapara në këtë Direktivë”.<sup>205</sup>*

*-edhe rrethanat nga par. 2.8-2.12 dhe 2.14 në shumicën e veprave të këtij Kapitulli janë po ashtu elemente të veprës penale dhe si të tilla nuk mund të merren si rrethana rënduese e sidomos sa i përket veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 i KPRK-së.*

E rëndësisë së veçantë është sidomos rrethana nga paragrafi 2.12 qoftë kur është e shprehur si element përbërës i veprës penale qoftë si rrethanë rënduese. Ky paragraf parasheh një mori bazash të cilat e rëndojnë peshën e kësaj vepre kur është kryer si akt i urrejtjes ndaj personave, grupit të personave ose pronës motivuar në bazë të shkaqeve si në vijim:

- a. racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore,
- b. gjinisë, identitetit gjinor,

<sup>204</sup> Marrë nga praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës.

<sup>205</sup> Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 25 tetor 2012 për përcaktimin e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, e cila zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/22/JHA (19).

- c. lidhjes me ndonjë komunitet, pronë,
- d. gjendjes ekonomike,
- e. orientimit seksual, lindjes,
- f. aftësisë së kufizuar ose
- g. ndonjë statusi tjetër personal,
- h. ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura.

Po trajtojmë në parim, për shembull vrasjen e motivuar nga gjinia. Vitet e fundit masivisht po përdoret termi “Dhunë në bazë gjinore” apo edhe “Femicid”. Termi 'Femicid' u përkufizua për herë të parë nga Kombet e Bashkuara (OKB) si “vrasjet e grave nga burrat të motivuara nga urrejtja, përbuzja, kënaqësia ose ndjenja e pronësisë ndaj grave”, dhe më vonë si "vrasja e femrave nga meshkujt sepse janë femra". Femicidi përfshin një gamë të gjerë aktesh të dhunshme, të tilla si vrasja në kontekstin e IPV, vrasje seksuale, vrasje të prostitutave, vrasje në emër të nderit, vrasje e foshnjave vajza dhe vdekjet e lidhura me pajën, edhe pse disa prej tyre nuk zbatohen drejtpërdrejt në kontekstin evropian.<sup>206</sup> Një tjetër përkufizim i përdorur nga Komisionari i OKB-së për të drejtat e njeriut konsideron Femicid: “Vrasja e grave sepse janë gra, pavarësisht nëse është kryer brenda familjes, një marrëdhënie familjare apo tjetër ndër personale ose nga kushdo në komunitet, ose nëse ajo është kryer dhe tolerohet nga shteti apo agjentët e tij”.<sup>207</sup> Përkufizime të tilla janë të panumërta dhe shumë shtete nëpër botë, por edhe në regjion kanë filluar të inkorporojnë këtë përkufizim në kuadër të legjislacioneve të tyre vendore. Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre kategorive të vrasjeve dhe me qëllim të parandalimit të përgjithshëm, gjykatat duhet ti kushtojnë vëmendjen e duhur vendimmarrjes në raste të tilla të motivuara nga gjinia. I njëjti parim vlen edhe për llojet e tjera të veprave brenda këtij kapitulli.

Një kujdes të posaçëm gjykatat duhet të kenë me rastin e shqiptimit të burgimit të përjetshëm, si dënimi më i rëndë i paraparë dhe kjo duhet të ketë një justifikim shumë të arsyetuar. Kështu edhe pse ky dënim parashihet me Kodin penal, megjithatë i njëjti mund të shqiptohet vetëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda (neni 41 i KPRK-së). Pra, nuk mjafton vetëm të theksohet se vepra penale është kryer në rrethana veçanërisht rënduese por edhe duhet të arsyetohen dhe të cekën se cilat janë ato rrethana apo pasoja shumë të rënda. Edhe pse në këtë drejtim praktika gjyqësore është shumë e pakët, sepse edhe këto dënime janë shqiptuar shumë rrallë, megjithatë është vërejtur se arsyetimi është i mangët dhe shumë herë nuk përkon me rrethanat veçanërisht rënduese ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

### C. Rrethanat lehtësuese relevante

*Pranimi i fajësisë* në veprat me dënime maksimale dhe mesatare sipas këtij Kapitulli, nuk duhet të konceptohet si zbutje automatike nën minimumin ligjor në rastet kur të njëjtat nuk shoqërohen me rrethana tjera jashtëzakonisht lehtësuese. Një shembull i rrethanës lehtësuese që

<sup>206</sup> Instituti Europian për Barazi Gjinore [European Institute for Gender Equality, EIGE], Përmbledhje e përkufizimeve të dhunimit, femicidit dhe dhunës nga partneri intim [Glossary of definitions of rape, femicide and intimate partner violence], 2.2.3 Përkufizime të propozuara të femicidit, fq.28, 2017

<sup>207</sup> Mu aty, faqe 18.

mund të merret si rrethanë jashtëzakonisht lehtësuese është p.sh. rrethana nga par. 3.2 dhe 3.8 , 3.9 të i nenit 70 të KPRK-së.

Duke pasur parasysh që kryerja e disa prej këtyre veprave penale shkakton çrregullim të ekuilibrit të personave të ndjeshëm si p.sh. ndërprerja e palejuar e shtatzënisë (neni 178) sterilizimi i detyruar (neni 179), gjymtimi i organeve gjenitale femërore (neni 180) ngacmimi (neni 182) dhe ngacmimi seksual (neni 183), gjykatat duhet pasur shumë kujdes në peshën që i japin rrethanave lehtësuese. Kjo sidomos i referohet rrethanave shumë subjektive e personale të kryesit, të cilat do të duhej të kenë peshë minimale në raport me rrethanat tjera rënduese apo edhe vetë përgjegjësisë dhe shkallës së dëmit të shkaktuar.

Edhe rrethanat tjera lehtësuese të cilat janë listuar në nenin 70 paragrafi 3 i KPRK-së, duhet të arsyetohen dhe të mos përshkruhen vetëm si rrethanë pa analizë të mirëfilltë. Sidomos duhet pasur kujdes me rastin e matjes së dënimit kur kemi të bëjmë me veprat penale të vrasjes nga nenet 172 dhe 173, ku shpesh nga aktgjykimet vërehet se gjykatat i marrin parasysh rrethanat personale (si p.sh. faktin që i pandehuri është i martuar, babë i x fëmijëve dhe gjendjen ekonomike të varfër) edhe pse ndoshta kemi rastin kur viktima është bashkëshorti/ja e të pandehurit.

#### **D. Aplikimi i dënimeve tjera**

*-Shqiptimi i dënimit me kusht -* mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët apo mesatare, por gjithnjë duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar. Ky dënim arsyetohet në rastet kur ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese, respektivisht në rastet nga neni 181,182,184 dhe 185 të KPRK-së apo kur roli i të pandehurit në kryerjen e veprës është minimal në raport me të tjerët.

*-Shqiptimi i urdhrit për punë me dobi të përgjithshme -* mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat arsyetojnë dënimin me burgim.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë-* Neni 181 paragrafët 1 dhe 2 paraqesin kategorinë e veprave më të lehta brenda këtij kapitulli andaj edhe është paraparë si mundësi shqiptimi i dënimit me gjobë si dënim kryesor. Njësoj është edhe me veprën nga Neni 182 paragrafi 1, neni 183 paragrafi 1, neni 184 paragrafi 1 i KPRK-së. Në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par. 5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.

*-Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 62 apo 63 -* rekomandohet të shqiptohet në të gjitha rastet kur personi zyrtar ka kryer veprën duke keqpërdorur funksionin e tij. Në shumë raste shqiptimi i këtij dënimi plotësues do të ketë efekt më të madh dhe mund të arrijë qëllimin e dënimit krahasuar me format tjera të dënimit. Po ashtu me dy plotësim-ndryshimet e KPRK-së (vitit 2019 dhe 2023), është zgjeruar gama e arsyeve për të cilat një personi mund ti ndalohet ushtrimi i funksionit. Kështu në paragrafin 4 të Nenit 62 parashihet që personit mund ti ndalohet ushtrimi i detyrës për 1-5 vjet nëse është dënuar për dhunë në familje. Edhe ndryshimet e vitit 2023 të KPRK-së kanë sjellë një numër risish në këtë aspekt. Megjithatë, për këto ndryshime do të bëhet fjalë më gjerësisht në

zbërthimin e kapitujve përkatës<sup>208</sup>. Duke qenë se shumë nga veprat penale të këtij kapitulli bien po ashtu në kuadër të përkufizimit të dhunës në familje sipas nenit 248, është bërë një referencë e shkurtër.

-Shqiptimi i dënimeve tjera plotësuese nuk është se mund të jetë i arsyeshëm duke pasur parasysh natyrën e veprave të këtij kapitulli. P.sh. Dëbimi i të huajve nga territori Republikës së Kosovës nga neni 67 i KPRK-së.

-*Vërejtja gjyqësore*- Në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Nenit 82 mund të shqiptohet për veprat më të lehta të këtij Kapitulli dhe nuk mund të aplikohet kur kryesi ka të kaluar kriminale. Kështu paragrafët 4 të neneve 184 dhe 185 parashohin se ky dënim mund të shqiptohet kur kryesi është provokuar nga sjellja çnjerëzore dhe e vrazhdë e të dëmtuarit.

-*Lirimi nga dënimi* mund të gjejë zbatim të veprat e këtij kapitulli, nëse janë plotësuar kushtet ligjore sipas pjesës së përgjithshme të KPRK-së.

Është shumë i specifikuar edhe paragrafi 3 i Nenit 187, i cili thekson se: “*Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij ose thjesht për të mbrojtur veten apo për t’i ndarë pjesëmarrësit e tjerë në rrahje.*”<sup>209</sup>

---

<sup>208</sup> Shih Kapitullin XX dhe XXI më poshtë.

<sup>209</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 187 Pjesëmarrja në rrahje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.

## **IV. Kapitulli XVII Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Republika e Kosovës në dispozitën e nenit 7 të Kushtetutës ka përcaktuar vlerat mbi të cilat bazohet rendi kushtetues, siç janë: parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. Ndërsa në nenin 21 (Parimet e Përgjithshme) përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 22 të Kushtetutës të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Në kapitullin XVII të Kodit Penal të veprave penale mbrohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Liria nënkupton mundësinë e individit që të sillet në një mundësi apo në një tjetër. Ndërsa të drejtat konceptohen si autorizime të cilat u njihen njerëzve dhe qytetarëve me kushtetutë, ligj apo ndonjë akt tjetër juridik kombëtar apo ndërkombëtar. Përmbajtja e objektit mbrojtës përcakton veprat penale kundër lirive ku bëjnë pjesë dhuna, privimi i kundërligjshëm i lirisë dhe rrëmbimi. Në grupin e veprave kundër të drejtave të njeriut bëjnë pjesë cenimi i barazisë së qytetarëve, cenimi i të drejtës në ushtrimin e mjeteve juridike. Në këtë kapitull janë përcaktuar 17 vepra penale, shumica prej të cilave mund të kryhen nga çdo person. Disa prej këtyre veprave mund të kryhen vetëm nga personat zyrtar, siç janë privimi i kundërligjshëm i lirisë i kryer nga personi zyrtar (193 par.3), marrja e deklaratës me shtrëngim (neni 193 par.3), (tortura neni 196) etj.

Në raport me fajësinë, veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut mund të kryhen vetëm me dashje, dhe nuk parashihet mundësia e kryerjes nga pakujdesia. Krahas dashjes për tu konsideruar se janë kryer, te disa prej këtyre veprave penale kërkohet edhe qëllimi i caktuar. Kryesit e veprave që cenojnë vlerat e mbrojtura në këtë kapitull nevojitet t'i nënshtrohen dënimeve të duhura, ngase natyra e këtyre veprave shkel liritë dhe të drejtat fundamentale me peshë të lartë siç janë: barazia, liria, liria e vullnetit për të dhënë deklaratat, e drejta për të mos iu nënshtuar torturës në çfarëdo rrethane si e drejtë absolute, e drejta e gëzimit të paprekshmërisë së banesës, mbrojtja e privatësisë, e drejta për tubim publik, e drejta e ushtrimit të mjeteve juridike, si e tillë,

kategoria e këtyre të drejtave dhe lirive është e garantuar me kushtetutë dhe instrumentet themelore ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Lartësia e dënimeve për vepra penale nga kapitulli XVII variojnë nga dënimi me gjobë për format më të lehta, dënim me burgim 1, 3, 5, 10, 12, 15 vjet, deri në dënim me burgim të përjetshëm, siç është paraparë për veprën penale rrëmbimi nga neni 191 par. 3 të KPRK-së.

Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut nga kapitulli XVII janë: Neni 190 Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës, neni 191 Rrëmbimi, neni 192 Shtrëngimi, neni 193 Privimi i kundërligjshëm i lirisë, neni 194 Marrja e deklaratave me anë të shtrëngimit, neni 195 Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, neni 196 Tortura, neni 197 Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve, neni 198 Kontrollimi i kundërligjshëm, neni 199 Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike, neni 200 Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial, neni 201 Përgjimi i paautorizuar, neni 202 Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara, neni 203 Shkelja e urdhrave për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit, neni 204 Parandalimi ose pengimi i tubimit publik, Neni 205 Cenimi i të drejtës për ushtrimin e mjetit juridik, Neni 206 Parandalimi i shtypjes ose i shpërndarjes së materialeve të shtypura dhe emetimit të programeve.

Sipas lartësisë së ndëshkueshmërisë veprat penale të sipër cekura mund të ndahen në tre grupe:

- Dënime të larta me minimum 5 dhe 15 vjet burgim dhe maksimum prej 15, 25 vjet (maksimumi i përgjithshëm) ose me burgim të përjetshëm;
- Dënime mesatare me dënime deri në 10 vjet; dhe
- Dënime të ulëta me dënimet me gjobë, 3 muaj, 6 muaj, 1, 3 dhe 5 vjet.

Siç shihet nga dënimi i veprave penale të këtij kapitulli ekziston një dallim i madh në mes dënitimit minimal me gjobë dhe minimeve prej 3 muaj burgim prej atyre veprave me burgim prej minimum 5 vjet<sup>210</sup> (deri 25 vjet si maksimum i përgjithshëm), maksimum 15 vjet burgim<sup>211</sup> e deri te dënimi me burgim të përjetshëm<sup>212</sup>.

Duke marrë parasysh peshën dhe seriozitetin e çdo veprave penale, gjykata me rastin e matjes së dënitimit duhet të ketë në konsideratë në veçanti shkallën e fajësisë së kryesit në kryerjen e veprës dhe të dëmit i cili është shkaktuar. Shkalla e fajësisë do të vlerësohet duke marrë parasysh rrethanat dhe karakteristikat që rrjedhin nga çdo rast si në raport me kryesin ashtu edhe në kontekst të rrethanave objektive të veprës. Shkalla e dëmit do të përcaktohet në varësi të çështjes, në çfarë

---

<sup>210</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 193 Privimi i kundërligjshëm i lirisë, paragrafi 3, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.,

<sup>211</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 196 Tortura, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.,

<sup>212</sup> Kodi nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 191 Rrëmbimi, paragrafi 3, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë.




mase ka pësuar i dëmtuari, cilat janë pasojat konkrete dhe në çfarë intensiteti dhe kohëzgjatjeje, a janë të riparueshme pasojat, etj.

### A. Pikënisja

Më poshtë do të gjeni disa rekomandime për kategoritë e veprave penale kundër lirive dhe të drejtave njeriut:

- Tabela e mëposhtme jep pikënisjen e sugjeruar për veprat nga ky kapitull, duke bërë dallimin mes atyre me dënim më të ulët, mesatare dhe maksimale si dhe veprat penale për të cilat parashihet dënimi me burgim të përjetshëm.
- Lartësia e dënimit të veprave penale është çështje e dispozitave ligjore, ky kategorizim është i thjeshtë, bazohet eskuzivisht në shkallën e dënimit, duke bërë një ndarje e cila ndihmon për të caktuar pikënisjen mbi të cilën do të orientohen gjyqtarët për të përcaktuar dhe shqiptuar dënimin e duhur.



Sic shihet nga grafiku, për veprat penale me dënim të ulët pikënisja në matjen e dënimit është 1/3 nga dënimi i përcaktuar, në varësi të rrethanave rënduese apo lehtësuese lëvizet nga ky pozicion. Për një numër të caktuar të veprave penale dhe për disa vepra për formën themelore dhe të privilegjuar përcaktohen dënime të ulëta.

Për veprat penale me dënime mesatare që përfshin veprat penale prej 5-10 vjet burgim ka përcaktuar pikënisjen prej 1/2 e dënimit, duke marrë parasysh peshën e veprës penale, në varësi të rrethanave të zbatueshme në situatën konkrete, gjykata do të lëvizë në drejtim të maksimumit apo minimumit të dënimit.

Për veprat penale me dënime maksimale vlen pikënisja prej 2/3. Sa i përket veprave për të cilat si dënim është paraparë edhe burgimi i përjetshëm pikënisja NUK ZBATOHET nëse gjykata e shqipton këtë dënim. Sa i përket kësaj çështjeje gjyqtarët udhëzohen të shqyrtojnë Pjesën I të këtij Udhëzuesi, më saktë Pikën III -Dënimet kryesore sipas KPRK-së.

Lëvizja nga pikënisja nuk nënkupton numërim mekanik sasior i rrethanave rënduese apo lehtësuese, por vendimtare dhe me ndikim në shkallën e dënimit është natyra dhe cilësia e rrethanave, të cilat do të kenë ndikim në përcaktimin e dënimit. Secila nga rrethanat peshohet si e vetme, pastaj në ndërlidhje me unitetin e rrethanave si tërësi, në këtë kontekst çmohet ndikimi i saj konkret dhe në dënim. Në përgjithësi, me rastin e ndërmarrjes së hapave në procesin e matjes

së dënimit, nga gjyqtarët kërkohet të ndërtojnë një qasje unike në përcaktimin e dënimit. Me këtë rast, hapi i parë që duhet ndërmarrë është identifikimi se, me kualifikimin e caktuar ligjor, në cilën kategori renditet vepra penale, në atë me dënim të ulët, të mesme apo të lartë. Pastaj do të ballafaqohen me një mori të rrethanave që ofron konteksti i veprës penale dhe faktorët që lidhen me kryesin e veprës penale. Identifikimi i tyre, më pas kombinimi i këtyre faktorëve, duhet të rezultojë në përshtatjen e dënimit i cili mund të jetë më i rëndë apo më i lehtë nga përcaktimi fillestar.

Qasja e unifikuar nuk paraqet edhe epilog të njëjtë të dënimeve, pasi kjo do të jetë e determinuar nga rrethanat e secilit rast konkret. Megjithatë, kjo do të sigurojë konsistencë në dënimet e shqiptuara, do të evitojë dallimet e pajustificuara për rastet analoge, duke pas hapësirë të mjaftueshme që dallimet në dënime të reflektojnë në mënyrë të arsyeshme veçoritë dhe karakteristikat e secilës çështje.

## **B. Rrethanat rënduese**

Në matjen e duhur të dënimit, rëndësi të posaçme nevojitet ti kushtohet rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, si atyre subjektive që i referohen kryesit, ashtu edhe atyre objektive.

**Shkalla e përgjegjësisë penale e të akuzuarit**- është një prej faktorëve më të rëndësishëm në këtë drejtim, nëse është i përgjegjshëm, apo ekzistojnë rrethana që ndikojnë në shkallën e përgjegjësisë penale, forma e fajësisë - dashja direkte. Faktorët të cilët tregojnë se i akuzuari kishte vepruar me paramendim, vendosmëri dhe këmbëngulësi në kryerjen e veprës penale, apo vendimi për të kryer veprën penale ishte aty për aty, dhe nuk bëhet fjalë për një dashje të paramenduar paraprakisht, motivet nga të cilat ishte kryer vepra penale, etj., do të kenë rolin dhe efektin e tyre në dënim.

**Shkalla e dëmit** të shkaktuar nga i akuzuari, është komponenti tjetër relevant në përcaktimin e dënimit, çfarë është lloji dhe madhësia e dëmit të shkaktuar nga kryesi i veprës penale, sa janë pasojat për viktimën dhe për komunitetin, a është dëmi i riparueshëm, a ka bërë ai përpjekje që ta minimizojë atë apo ta fshehë. Për rrjedhojë, gjykata do ti kushtojë kujdes të veçantë natyrës së dëmit, që do të varet nga karakteristikat personale dhe rrethanat e viktimës, në këtë kontekst çmohet ndikimi i një krimi të caktuar që ka pasur mbi viktimën në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Veprat penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut atakojnë vlerat themeltare mbi të cilat është ndërtuar një shoqëri, siç është shpjeguar më lart, në këtë aspekt është me rëndësi të vlerësohet konkretisht sa janë cenuar këto vlera.

Për të përcaktuar nivelin më të saktë të fajësisë, do të shqyrtohen faktorë të tillë si: *motivi, planifikimi dhe spontaniteti*. Pastaj në situatat *kur me dashje* shkakton më shumë dëm sesa është e nevojshme për kryerjen e një vepre të tillë, ose *kur synohet një viktimë e ndjeshme* (për shkak të pleqërisë ose rinisë së saj, paaftësisë ose për shkak të punës që bëjnë), rrethana e tillë duhet të vlerësohet.

Në praktikë mund të paraqiten situatat, kur rezulton dëm jashtëzakonisht serioz që është edhe përtej qëllimit të kryesit, fajësia do të ndikohet ndjeshëm nga shkalla në të cilën dëmi mund të jetë parashikuar. Nëse vepra penale ka shkaktuar shumë më tepër dëm, ose shumë më pak dëm sesa synonte ose parashikonte i akuzuari, në varësi të këtyre rrethanave mund të kenë peshë më të madhe ose më të vogël nën dritën e rrethanave të çështjes konkrete.

### Rrethanat rënduese veç e veç

*-Keqpërdorimi i pushtetit ose pozitës zyrtare* nga par. 2.9 i Nenit 70, duhet të merret parasysh në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me këto vepra penale. Megjithatë, për shumë nga veprat e këtij kapitulli është paraparë si vepër e cilësuar rasti kur vepra kryhet nga personi zyrtar, andaj duhet shmangur dyfishimi i elementit me rrethanën rënduese.

*- Në veçanti, në natyrën e veprave penale të kësaj kategorie, kryerja nga personat zyrtar* është mjaft shqetësuese për faktin se kemi të bëjmë me persona të cilët janë të thirrur në bazë të pozitës që mbajnë të kontribuojnë në forcimin e sundimit të ligjit dhe të drejtësisë në shoqëri. Në kuptim të rrethanave konkrete që ndërliken me llojin e autorizimeve të pozitës zyrtare, hierarkisë, autorët e rangut të lartë, me autorizime të rëndësishme e specifike, duhet të marrin dënime më të rënda, pastaj duhet të vlerësohen pasojat konkrete që mund të jenë të ndjeshme si për viktimën ashtu edhe për komunitetin.

*-Dënimet e mëparshme të të akuzuarit* – Është e nevojshme posaçërisht të analizohen lloji dhe natyra e veprave penale për të cilat ka qenë i dënuar më parë, si:

- a) natyra e veprës penale, lidhshmëria dhe rëndësia me veprën aktuale;
- b) koha që ka kaluar nga dënimi i mëparshëm.

Dënimet e mëparshme mund të jenë të justifikueshme që të merren parasysh precedentët e mëparshëm penal, dënimi duhet të mbahet në proporcion me seriozitetin e veprës/ve aktuale. Efekti i dënimeve të mëparshme varet nga karakteristikat e veçanta të çështjes së mëparshme penale të të akuzuarit. Rrjedhimisht, çdo efekt i kriminalitetit të mëparshëm duhet të zvogëlohet ose anulohet kur ka pasur një periudhë të konsiderueshme pa kriminalitet para veprës aktuale që është objekt i gjykimit, ose kur vepra aktuale është e natyrës së lehtë.<sup>213</sup>

*-Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar* - Në çfarë mase është angazhuar personi në kryerjen e veprës penale, apo në rastet e bashkëkryerjes apo bashkimit kriminal në çfarë shkalle dhe mënyre ka qenë i përfshirë personi në kryerjen e këtyre veprave. Anasjelltas, rrethana nga paragrafi 3.5 i po këtij neni mund të ndikojë në zbutjen e dënimit dhe vlerësohet si lehtësuese.

*- Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal* rrethana nga paragrafi 2.12 i nenit 70 të KPRK-së. Fakti se vepra penale është kryer në kuadër të aktivitetit të grupit të organizuar kriminal tregon për shkallë të lartë të rrezikshmërisë, cenim serioz të këtyre vlerave. Ky është indikator i qartë se dënimi duhet lëvizur mbi pikënisjen e caktuar në drejtim të ashpërsimit të dënimit, ekzistimi i kësaj rrethane padyshim se në parim ka karakter mbizotërues ndaj rrethanave lehtësuese që mund të ekzistojnë. Megjithatë, sikurse ishte rasti edhe

---

<sup>213</sup> Rekomandimi Nr. R (92) 17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me konsistencën në dënime (Miratuar nga Këshilli i Ministrave më 19 tetor 1992). D. Dënimet e mëparshme, 3.

te personi zyrtar, edhe te grupi i organizuar kriminal në disa vepra paraqitet si element i veprës penale, andaj duhet shmangur dyfishimi.

- *Vepra penale është kryer nga dy ose më tepër persona në bashkëpunim apo në grup* - konsiderohet rrethanë rënduese, i akuzuari i cili ka vepruar në bashkëpunim apo në grup ndikon në rritjen e shkallës së përgjegjësisë së tij penale. Kur viktima ballafaqohet me dy ose më tepër persona, është faktor domethënës se me gjasë do të jetë më e frikësuar dhe do të ndihet e pafuqishme për tu mbrojtur.<sup>214</sup>

-*Kryerja e veprës me brutalitet dhe egërsi*, duke i shkaktuar viktimës vuajtje dhe mundime të intensitetit të lartë.

-*Planifikimi dhe paramendimi i gjatë për kryerjen e veprës penale* - tregon për veprën e kryer me gjakftohtësi, me këmbëngulësi dhe mirë të menduar.

-*Anëtarë të familjes të pranishëm, në veçanti prezenca e fëmijëve/shqetësime serioze* - vepra penale është kryer në prezencën e anëtarëve të familjes, posaçërisht fëmijëve, rrethana do të merret si rënduese në rastet e prezencës së anëtarëve të familjes, e sidomos të fëmijëve, mund të pësojnë shqetësime serioze dhe kjo ngjarje stresuese mund të përcillet me pasoja traumatike për ta.

-*Kryerja e veprës penale i shtyrë nga motivet e dobëta* - si motive të tilla të cilat e shtyjnë autorin për kryerjen e veprës penale janë: egoizmi, xhelozia, karrierizmi, hakmarrja, gjakmarrja, zilia, sedra e prekur.

-*Ndikimi thelbësor në cenimin e lirisë apo të drejtës* – rrethana do të vlerësohet se ka pasur ndikim serioz, që nënkupton se ka ndikuar në atë masë që liria dhe e drejta e personit është dëmtuar në mënyrë domethënëse, duke vlerësuar edhe epilogun e saj, siç mund të jetë privimi nga ushtrimi i mjeteve juridike me çka viktimës i janë shkaktuar dëme të pariparueshme ose substanciale.

-*Nëse vepra është kryer përmes shtrëngimit, frikësimit ose shfrytëzimit* – Mund të përdoren me kusht që të mos jenë tipare të veprave penale.

Edhe rrethanat tjera rënduese të parapara me Nenin 70 të KPRK-së mund të jenë të zbatueshme në veprat sipas këtij kapitulli, gjithnjë duke pasur kujdes në mosdyfishim me elementet e veprës penale, si shkalla e dëmit të shkaktuar mund të merret si rrethanë rënduese.

*Rrethanat lidhur me viktimat* - Të gjitha rrethanat nga par. 2.4-2-7 mund të jenë relevante varësisht nga lloji i veprës së kryer. Rrethanat që kanë të bëjnë me viktimat, mund të merren si rënduese, duhet pasur kujdes për të mos i dyfishuar me rrethanat rënduese.

---

<sup>214</sup> Andrew Ashworth, Dënimi dhe Sistemi i drejtësisë penale [Sentencing and Criminal Justice Edition( Law in Context)]. Botimi i 5, 164-165, Publisher, Cambridge University Press (2010).

### C. Rrethanat lehtësuese

Rrethana lehtësuese mund të merren rrethanat e përcaktuara sipas nenit 70 par. 3 të KPRK-së. Duhet pasur parasysh natyrën dhe llojshmërinë e këtyre veprave, gjykatat duhet pasur kujdes në varësi të veprës konkrete edhe tua japë peshën e duhur rrethanave lehtësuese, në veçanti, shkallës së përgjegjesisë penale dhe dëmit konkret të shkaktuar.

*-Pranimi i fajësisë apo marrëveshja mbi pranimin e fajësisë* në veprat me dënime maksimale dhe mesatare sipas këtij Kapitulli, nuk duhet të konceptohet si zbutje automatike nën minimumin ligjor në rastet kur të njëjtat nuk shoqërohen me rrethana tjera jashtëzakonisht lehtësuese.

*-Dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në kryerjen e veprës penale.* Fakti se personi ka luajtur rol minor ose të varur nëse vepronte me të tjerët/kryente një rol të kufizuar nën drejtim.

*-Fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor* por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër. Në format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale na paraqiten ndihmës, shtytës dhe persona që ndihmojnë kryesin pas kryerjes së veprës, rrethana që nuk janë persona kyç në kryerjen e veprës penale, mund të konsiderohet si faktor lehtësues, por deri në cilën masë do të varet nga rrethanat specifike të secilit rast.

*-Bashkëpunimi i përgjithshëm* i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar. Bashkëpunimi me gjykatën duke përfshirë edhe dorëzimin duhet trajtuar si rrethanë lehtësuese, pasi që kjo e ndihmon gjykatën në bërjen e drejtësisë, kursen kohë dhe resurse të institucioneve, prandaj marrja e këtyre rrethanave duhet të ketë ndikimin e duhur, duke e bërë të qartë se bashkëpunimi me gjykatën dhe dorëzimi do të konsiderohen lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit.

*-Bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetim* ose në ndjekjen penale - Është jetike, zbulimi, hetimi dhe ndjekja efektive e kryesve të veprave penale, për rrjedhojë bashkëpunimi në fazat e hershme jo vetëm se është i rëndësishëm, por mund të jetë edhe vendimtar, në kapjen e kryesve dhe sigurimin e provave për ti ndëshkuar kryesit e përfshirë në këto veprime. Në çdo rast konkret, duhet çmuar bashkëpunimi dhe kontributi konkret që ka dhënë i akuzuari për interesat e drejtësisë, dhe është e arsyeshme që kjo të reflektohet në shkallën e dënimit.

*-Vepra është kryer në mënyrë të paplanifikuar dhe e kufizuar në shtrirje dhe kohëzgjatje* - kontakti me viktimën i kufizuar në aspektin kohor e përmbajtësor, që tregon për një veprim ad hoc dhe të pa përgatitur paraprakisht.

*-Përpjekjet për të minimizuar pasojat e veprës dhe mbështetur viktimën.* Sjellja e mirë dhe humane në raport me viktimën, si ofrimi i ushqimit, ulja e ndjenjës së frikës dhe pasigurisë në ato rrethana, ofrimi i mundësisë së komunikimit me familjarët e të afërmit.

*-Ndikim i kufizuar në cenimin e lirive dhe të drejtave* - ndikimi ka qenë i vogël, pa pasojat ose me pasojat të vogla.

*-Vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose nga veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër.*

*-Vepra është kryer nën ndikimin e urdhrave dhe udhëzimeve të padrejta të eprorit.*

*-Vepra e kryer gjatë kohës së lirimit me kusht ose dënimit alternativ të kushtëzuar - dhe gjatë kësaj periudhe ka kryer veprën penale, duke përfshirë shkeljen e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht.*

*-Moshë dhe/ose mungesa e pjekurisë - Moshë e shtyrë ka ndikim në përcaktimin e dënimit, nëse kemi të bëjmë me persona të moshës së shtyrë të cilët kanë kaluar pothuajse shekullin e jetës, në ndërlidhje edhe me rrethana tjera si mos ndëshkueshmërinë e mëparshme, andaj nevojitet që kjo rrethanë të ketë ndikim të caktuar në matjen e dënimit.*

*-Moshë e re dhe mungesa e pjekurisë mund të ketë ndikim të caktuar në përcaktimin e dënimit.*

*-Pendimi për veprën penale të kryer - Të konstatohet nëse kemi të bëjmë me pendim real dhe të sinqertë.*

*-Karakterit i mirë dhe/ose sjellje shembullore - e kaluara e personit dhe rrethanat e tjera tregojnë se i akuzuari kishte karakter të mirë dhe ishte i njohur për sjellje shembullore në shoqëri. Për vepra të caktuara, edhe përpjekjet e sinqerta të kryesit për normalizim të marrëdhënieve me viktimën mund të merren në konsideratë si rrethanë lehtësuese në kuadër të pasqyrimin të sjelljes së kryesit pas veprës.*

*-Paaftësia fizike ose kushte të rënda mjekësore - që kërkojnë trajtim urgjent, intensiv ose afatgjatë konsiderohet si rrethanë lehtësuese bazuar në parimin e humanitetit që nevojitet të përcjellë procedurën dhe drejtësinë penale.*

Duke pasur parasysh natyrën dhe llojshmërinë e këtyre veprave, gjykatat duhet pasur kujdes që në varësi të veprës konkrete tu japin peshën e duhur rrethanave lehtësuese.

#### **D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera**

*-Shqiptimi i dënimit me kusht - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët apo mesatare, por gjithnjë duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar. Nuk është i përshtatshëm si dënim për recidivistët.*

*-Shqiptimi i urdhrin për punë me dobi të përgjithshme - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat arsyetojnë dënimin me burgim. Mund të jetë më i përshtatshëm sidomos te kryesit e moshave të reja me potencial të risocializimit, natyrisht te veprat me dënim të ulët.*

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë - Për veprat më të lehta brenda këtij kapitulli është paraparë si mundësi shqiptimi i dënimit me gjobë si dënim kryesor. Në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të*

kryesit në pajtim me par. 5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>215</sup>

*-Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 62<sup>216</sup> apo 63<sup>217</sup>-* rekomandohet të shqiptohet në të gjitha rastet kur personi zyrtar është i përfshirë në kryerjen e veprave nga ky kapitull. Në shumë raste shqiptimi i këtij dënimi plotësues do të ketë efekt më të madh dhe mund të arrijë qëllimin e dënimit krahasuar me format tjera të dënimit.

*-Shqiptimi i dënimeve tjera plotësuese* - mund të jetë i arsyeshëm duke pasur parasysh natyrën e veprave të këtij kapitulli. P.sh. Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës nga neni 67 i KPRK-së.

*-Vërejtja gjyqësore* - Në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Nenit 82 mund të shqiptohet për veprat më të lehta të këtij Kapitulli. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një (1) vit ose dënimi me gjobë, në rastet kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat penale veçanërisht të lehta. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet edhe për vepra penale të caktuara për të cilat është paraparë dënimi deri në tri (3) vjet, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata veçanërisht merr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryesit në të kaluarën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat tjera në të cilat është kryer vepra penale. Megjithatë shqiptimi i vërejtjes gjyqësore nga ligjvënësi është paraparë për të bëhet ndaj kryesve të veprave më të lehta penale, me shkallë të ulët të përgjegjësisë penale dhe me rrezikshmëri të pakët, prandaj nevojitet të bëhet një analizë e duhur nëse shqiptimi i këtij sanksioni është mjaftueshëm dhe i duhuri në kuptim të gjitha rrethanave duke përfshirë në këtë tërësi edhe natyrën e veprës penale.

*-Lirimi nga dënimi* - nuk mund të aplikohet te ky lloj i veprave penale.

---

<sup>215</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>216</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 62 Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>217</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 63 Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

## V. Kapitulli XVIII Veprat penale kundër të drejtave të votimit

### Shqyrtime të përgjithshme

Ky kapitull përmban gjithsej 11 nene, të cilat tregojnë për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtës së individit për të votuar dhe për tu kandiduar. Zgjedhjet demokratike paraqesin pasqyrim të një shteti të së drejtës dhe bazë me të cilën vlerësohen demokracitë. Kështu me raportin e V-Dem për vitin 2023<sup>218</sup>, Kosova është renditur në tabelën e vendeve me demokraci elektorale, me një rritje domethënëse në indeks prej 30-40% në 10 vjetët e fundit, duke qenë në mesin e 15 shteteve që kanë treguar rritje të këtij indeksi. Jo rastësisht, mund të thuhet se zgjedhjet sipas këtij raporti dhe jo vetëm, janë vlerësuar si zgjedhje të lira dhe demokratike. Një sukses i tillë, në masë shumë të madhe i atribuohet edhe angazhimit pro aktiv të sistemit të drejtësisë në mbrojtjen e të drejtës së votës. Kështu duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2013, sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor kanë marrë një rol shumë të rëndësishëm për zhvillim të një procesi zgjedhor demokratik duke ndërmarrë masa ndaj kryesve të veprave nga ky kapitull.

Edhe pse dënimet e parapara në këtë kapitull janë të ulëta krahasuar me shumë nga kapitujt tjerë (maksimum 5 vjet burgim), ajo që vërehet është synimi i ligjvënësit që në çdo rast kur një person zyrtar është i përfshirë në keqpërdorim të detyrës zyrtare minimumi ligjor është gjithnjë më i lartë (2 dhe 3 vjet minimumi i dënimit). Ky paraqet një indikacion shumë me rëndësi për gjykatat të cilat duhet pasur parasysh që edhe veprat e këtij kapitulli, kur personat e përfshirë janë persona zyrtar, dënimi (lloji dhe lartësia e dënimit) do të duhej gjithnjë të jetë më ndryshe krahasuar me qytetarët e thjeshtë. Natyrisht edhe nga kjo rregull ka përjashtime kur kemi forma të organizuara të mashtrimeve gjatë votimit/zgjedhjeve, të cilat duhet të marrin dënim më të rëndë për shkak të këtij elementi.

Qasja që gjykatat marrin në trajtimin e këtyre veprave është shumë domethënëse për një shtet të ri siç është Kosova, kur mekanizmat e ndryshëm mbrojtës janë ende në zhvillim e sipër. Janë zgjedhjet ato që bëjnë ndryshimet në demokracitë e vendeve, andaj sistemi i drejtësisë duhet gjithnjë të ketë parasysh se kryerja e veprave nga ky kapitull nuk ka të bëjë vetëm më dënim individual të një individi, por se këto vepra kanë potencialin e madh të ndikojnë në perceptimin e përgjithshëm të demokracisë në një vend. Parandalimi i trendit që mashtrimet gjatë votimeve të kalojnë në dukuri të zakonshme është e rëndësishë së jashtëzakonshme edhe për faktin se një trend i tillë do të çonte në demotivimin e votuesve për të marrë pjesë aktive në votime. Andaj, gjykatat gjithnjë duhet ta kenë parasysh parimin shumë të rëndësishëm të proporcionalitetit me rastin e caktimit të dënimit.


---

<sup>218</sup> Evie Papada, David Altman, Fabio Angiolillo, Lisa Gastaldi, Tamara Köhler, Martin Lundstedt, Natalia Natsika, Marina Nord, Yuko Sato, Felix Wiebrecht, dhe Staffan I. Lindberg. Sfidat përballë autokratizimit [Defiance in the Face of Autocratization]. Democracy Report 2023. University of Gothenburg: Varieties of Democracy Institute (V-Dem Institute), Mars 2023.



## A. Pikënisja për veprat nga ky Kapitull

Me qëllim të harmonizimit të qasjes në matjen e dënimit për këto vepra, figura e mëposhtme ofron rekomandimin për pikënisjen e matjes së dënimit për tre situata të ndryshme:



Grafiku i mësipërm tregon qartazi dallimin në mes formave të ndryshme të matjes së dënimit për këto vepra bazuar në specifikat kyçe. Minimumet dhe maksimumet ligjore të parapara nga ligjvënësi janë dhënë pikërisht për të bërë diferencën në mes kryesve të ndryshëm, me rrethana të ndryshme dhe me dëme të ndryshme që mund të shkaktojnë.

Gjykatat duhet të kenë parasysh që në rastin kur një kryes bie brenda dy apo tri kategorive të mësipërme, atëherë si pikënisje do të merret pikënisja më e lartë për këtë kategori të veprave. Ndërkaq, rrethanat tjera do të merren si rrethana rënduese. P.sh. Nëse një person zyrtar është edhe pjesë e grupit të organizuar kriminal atëherë pikënisja llogaritet 2/3 e maksimumit të dënimit ndërkaq rrethana si person zyrtar merret si rrethanë rënduese (nëse tashmë nuk është edhe element i veprës penale). Nëse përveç kësaj, personi ka edhe ndonjë dënim të mëparshëm atëherë i njëjti merret si rrethanë rënduese nga par. 2.13 i Nenit 70 të KPRK-së. Nëse ka të shprehura në masë të madhe rrethana tjera rënduese gjykata mund të dënojë me maksimumin e dënimit.

Në rast të recidivizmit në kuptim të Nenit 75<sup>219</sup> të KPRK-së, si pikënisje merret 2/3 e maksimumit të dënimit e nëse kjo vepër është shoqëruar edhe me rrethana tjera veçanërisht rënduese gjithnjë me fokus të veçantë përfshirjen e kryesit në vepra të natyrës së njëjtë, përfshirjen në grupin e organizuar kriminal apo edhe shkallën e lartë të dëmit të shkaktuar atëherë rekomandohet ashpërsim i dënimit në suazat e Nenit 75.

## B. Rrethanat rënduese relevante

Pjesa e mëposhtme zbërthen disa nga rrethanat rënduese të parapara me par. 2 të Nenit 70 të KPRK-së dhe mënyra se si ato mund të peshohen dhe të zërthehen më tej.

<sup>219</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 75 Ashpërsimi i dënimit për recidivizëm të shumëfishtë par.1, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

a. Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale dhe rrethanat e ndërlidhura me të<sup>220</sup>

Kjo rrethanë në veprat e këtij kapitulli paraqitet mjaft relevante dhe atë në dy aspekte:

- Në rastet kur bëhet fjalë për individ; dhe
- Në rastet kur bëhet fjalë për grup të organizuar kriminal.

Pesha e kësaj si dhe cilësdo rrethanë varet nëse paraqitet e kombinuar me rrethana tjera rënduese sipas KPRK-së.




Figura e mësipërme jep një shembull se si, kjo rrethanë e kombinuar me rrethana tjera mund të peshojë më shumë jo vetëm në ashpërsim të dënimit kah maksimumi por edhe se si e njëjta mund të kombinohet me to. Natyrisht, recidivizmi nuk është përfshirë për shkak të konceptit të përgjithshëm që pikënisja në rastet e recidivizmit është më e lartë sesa te të pandehurit pa të kaluar kriminale. Po ashtu edhe përfshirja si pjesë e grupit të organizuar kriminal nuk është përfshirë për shkak se zërthehet më shumë në detaje më poshtë. Figura e mësipërme, pra i referohet rastit kur veprat kryhen nga individë. Në këto raste është me rëndësi të vlerësohet shkalla e përpjekjeve të ndërmarra nga i pandehuri në kryerjen e kësaj vepre. Kjo paraqitet si relevante jo vetëm në aspekt të pozitës apo funksionit që mban i pandehuri por edhe në formën e angazhimit në arritjen e qëllimit të kryerjes së veprës penale. Kështu përgjegjësia do të jetë shumë më e lartë nëse i pandehuri është në pozitën e zyrtarit të KQZ-së, Menaxherit të qendrës së regjistrimeve, Qendrës së Numërimeve, apo cilitdo zyrtar tjetër me kompetenca mbikëqyrëse dhe udhëheqëse që i japin mundësinë për keqpërdorim në masë sesa p.sh. një Komisioner zgjedhor. Megjithatë ky vlerësim nuk nënkupton se është i aplikueshëm vetëm për zyrtarët e përfshirë me ndonjë funksion

<sup>220</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 Rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit, paragrafi 2.1, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

zgjedor por është e aplikueshme për cilindo nga zyrtarët që mund të kenë rol në mbarëvajtjen e fushatës dhe procesit zgjedhor në përgjithësi. Siç është pasqyruar edhe në figurën e mësipërme edhe ky vlerësim gjithnjë duhet krahasuar edhe me shkallën e dëmit që personi mund të shkaktojë, pra në raport me rrethanën nga par. 2.8. Kjo për faktin se edhe një Komisioner mund të bëjë dëm mjaft të madh në një vendvotim nëse numri i votuesve është shumë i madh pasi dëmi i shkaktuar apo dëmi potencial ka shumë më tepër ndikim në rezultatin zgjedhor.

Shembujt e dhënë më sipër janë të gjithë të përshtatshëm për tu konsideruar në veprat që kanë të bëjnë me vet procesin e votimit. Megjithatë, si rrethanë mund të gjejë zbatim edhe në veprat e tjera të këtij kapitulli sidomos nëse vlerësimi bëhet në aspekt të rolit konkret që i pandehuri ka pasur në kryerjen e veprës. P.sh. vlerësimi duhet të bëhet nëse zyrtari ka kontribuar me mosveprim, ka ofruar ndihmë apo ka qenë person kyç në kryerjen e veprës apo duke nxitur të tjerët.

Në anën tjetër nëse fjala është për individ, i cili nuk është person zyrtar, por individ i cili nuk ka ndonjë rol zyrtar në procesin zgjedhor apo të ndërlidhur, pesha e kësaj rrethane mund të jetë më e ulët, por gjithnjë duke pasur parasysh shkallën e dëmit të shkaktuar apo synuar përmes pjesëmarrjes.

Sa i përket vlerësimit të shkallës së pjesëmarrjes kur bëhet fjalë për grupe kriminale, kjo do të trajtohet në kuadër të rrethanës nga paragrafi 2.11 më poshtë.

*b. Keqpërdorimi i pushtetit ose pozitës zyrtare<sup>221</sup>*

Duhet të merret parasysh në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me këto vepra penale, gjithnjë duke përjashtuar rastet kur kemi të bëjmë me ato nene, respektivisht paragrafë kur pozita e tillë paraqitet si element i veprës penale. Në ato raste mjafton që matja e dënimit të fillojë nga pikënisja e rekomanduar më sipër e më pas të procedohet me shqyrtimin dhe marrjen në konsideratë të rrethanave tjera të aplikueshme. Njëkohësisht siç u reflektua edhe në rrethanën nën par. 2.1 është me rëndësi të bëhet dallimi në mes funksionit që barti i pandehuri dhe shkallën e dëmit që ai/ajo mund të shkaktojë.

Në rastet kur pozita zyrtare paraqet element të veprës penale, kjo nuk ndalon gjykatën që të marrë parasysh rrethanat nga paragrafi 2.1 të Nenit 70 gjithnjë duke peshuar se në çfarë mase është angazhuar personi në kryerjen e veprës penale, apo në rastet e bashkëkryerjes apo bashkimit kriminal.

*c. Dëshmi të shkëljes së besimit nga ana e personit të dënuar<sup>222</sup>*

Edhe kjo rrethanë mund të merret si e fuzionuar me rrethanën nga par. 2.9. Kështu p.sh. një zyrtar zgjedhor, zyrtar policor etj., që i janë besuar p.sh. materialet zgjedhore, kur i njëjti keqpërdor këtë detyrë ai/ajo, njëkohësisht keqpërdor edhe besimin e dhënë. Andaj, në këto vepra kjo rrethanë mund të përdoret për të elaboruar pse është me rëndësi përfshirja e keqpërdorimit të

---

<sup>221</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 Rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit, paragrafi 2.9, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>222</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 Rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit, paragrafi 2.10, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

pushtetit kur bëhet fjalë për një detyrë të caktuar që një personi i është dhënë në besim për shkak të funksionit që e bart ai person.

Të gjitha ato që u thanë më sipër, për rrethanat rënduese, sa i përket të drejtës për të votuar dhe përcaktim të lirë, vlejnë edhe për rastet e kërcënimeve dhe veprave tjera nga ky kapitull të kryera ndaj kandidatëve dhe kanë po të njëjtën rëndësi dhe peshë sikurse është sqaruar më sipër.

*d. Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal*<sup>223</sup>

Parimet e theksuara për rrethanën nga par. 2.1 janë të aplikueshme edhe për këtë rrethanë. Dallimi qëndron në atë se roli i kryesit vlerësohet në raport me anëtarët e tjerë të grupit të organizuar kriminal, hierarkinë dhe rolin dhe kontributin e secilit në kryerjen e veprës penale. Veprat nga ky kapitull të kryera në formë të Krimin të organizuar, është e kuptueshme që rezultojnë në shkallë më të lartë të dëmit. Andaj, këto vepra, si të tilla duhet të kenë domosdoshmërisht edhe dënim më të lartë. Më shumë rreth kësaj rrethane është elaboruar edhe më sipër në Kapitullin V të këtij Udhëzuesi.

*e. Nëse vepra penale është akt i urrejtjes dhe e kryer ndaj personave për shkak të përkatësisë së caktuar*<sup>224</sup>

Kjo rrethanë mund të jetë shumë relevante për veprat e këtij Kapitulli nëse janë të drejtuara ndaj personave pikërisht duke i shënjestruar për shkak të prejardhjes kombëtare apo lidhjes me ndonjë komunitet. Ekzistimi i kësaj rrethane duhet të merret parasysh nga gjykatat sidomos nëse është e shoqëruar edhe me prani të dhunës. Megjithatë, duhet pasur parasysh se përdorimi i dhunës, forcës e kanosjes paraqitet si element i veprës penale andaj edhe nuk duhet të merret si rrethanë shtesë rënduese por thjesht ekzistimi i dhunës, kanosjes apo forcës i shton peshën e rrethanës nga par. 2.12 në matjen e dënimit.

### **C. Rrethanat lehtësuese relevante**

Rrethanat lehtësuese të parapara me Nenin 70 par. 3 mund të jenë të gjitha relevante për aplikim por gjithnjë varet se për cilën vepër bëhet fjalë.

*a. Rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore*<sup>225</sup>

Kur jemi te veprat e Kapitullit, kjo rrethanë rrallë herë mund të jetë e aplikueshme pasi këto vepra kryesisht janë të tilla që kanë një qëllim shumë specifik, si cenimin e procesit të zgjedhjeve andaj edhe zakonisht nuk do të shkaktohej nga personat me aftësi të zvogëluar mendore, përveç nëse persona të tillë do të keqpërdoshin në rrethana të jashtëzakonshme për kryerjen e veprave,

<sup>223</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 Rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit, paragrafi 2.11, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>224</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 Rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit, paragrafi 2.12, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>225</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 70 Rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit, paragrafi 3.1, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

shembull kanosja e ndonjë kandidati. Andaj, si rrethanë nuk është se do të gjejë shumë zbatim në këto vepra.

*b. Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar*<sup>226</sup>

Është bërë praktikë e rregullt në gjykatat tona që rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar merren parasysh në zbutjen e dënimit. Derisa këto rrethana mund të jenë të zbatueshme në këtë kapitull duhet pasur kujdes si zakonisht në peshën që u jepet atyre. P.sh. kur është fjala për persona zyrtar të cilët janë bartin përgjegjësinë për administrimin e zgjedhjeve, këto rrethana mund të kenë një peshë shumë të ulët në matjen e dënimit. Në anën tjetër, mund të merret si rrethanë me peshë më të madhe për kryesit të cilët për shembull të shtyrë nga gjendja ekonomike janë detyruar të marrin pjesë në kryerjen e kësaj vepre. Megjithatë edhe në këtë rast është me rëndësi që pesha e kësaj rrethane ti caktohet bazuar në ekzistimin e rrethanave rënduese domethënëse (p.sh. shkallën e dëmit të shkaktuar) si dhe se sa kjo rrethanë është e kombinuar me ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese me peshë në mënyrë që të ndikojë në zbutje të mëtutjeshme të dënimit.

- *Edhe moshja e të dënuarit*<sup>227</sup> mund të jetë po ashtu rrethanë relevante për aplikim në këto vepra me kushtin që arsyeshëm të krahasohet në raport me rrethanat tjera por edhe me kusht që të arsyetohet pse moshja luan rol në kontekstin e veprës së kryer.

Për më shumë zbërthim rreth përdorimit të këtyre rrethanave në matjen e dënimit këshilloheni ti referoheni Udhëzuesit të përgjithshëm.

*c. Rrethanat që tregojnë për një rol më të vogël të kryesit në kryerjen e veprës*<sup>228</sup>

Rrethanat nga paragrafet 3.4 dhe 3.5 të Nenit 70 të KPRK-së janë grupuar qëllimshëm në një paragraf për të qartësuar se të njëjtat kanë shumë ngjashmëri pasi flasin për një angazhim më të ulët të kryesit në kryerjen e veprës penale. Për nevojën e diferencimit të kontributit të kryesit individual është bërë fjalë edhe më lartë kur është folur për rrethanat rënduese të kësaj natyre.

*d. Rrethanat tjera lehtësuese për këtë kategori të veprave*

Sikurse ishte rasti edhe me rrethanat e mësipërme edhe këtu jo rastësisht është bërë grupimi i rrethanave nga par. 3.7-3.12<sup>229</sup> pasi të njëjtat gjithnjë kanë potencialin për dyfishim/trefishim mes veti me rastin e matjes së dënimit kur në fakt që të gjitha në një formë tregojnë pendim nga i pandehuri. E njëjta metodologji e tubimit të tyre në një grup është bërë edhe në pjesën e përgjithshme të Udhëzuesit kur flitet për rrethanat lehtësuese.

---

<sup>226</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 70 Rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit, paragrafi 3.3, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>227</sup> Neni 70 par. 3.6 (Moshja e personit të dënuar, i ri apo i moshuar);

<sup>228</sup> Neni 70 par. 3.4. (dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale) dhe par. 3.5 (fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër).

<sup>229</sup> Neni 70 par. 3.7. (dëshmia që personi i dënuar ka bërë dëmshpërblimin apo kompensimin e viktimës); par. 3.8. (bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar); par. 3.9. (bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale); par. 3.10. (pranimin e fajtit); par. 3.11. (keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar); par. 3.12. (sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit).

#### D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera

Asnjë nga dënimet e mëposhtme nuk konsiderohen të përshtatshme për tu shqiptuar në rastet e personave me të kaluar kriminale e veçanërisht në rastet e recidivizmit.

*-Shqiptimi i dënimit me kusht* - mund të jetë i përshtatshëm për veprat nga ky kapitull, por gjithnjë duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar.

*-Shqiptimi i urdhrit për punë me dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm për veprat brenda këtij kapitulli me maksimumin ligjor prej 1 viti dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat e arsyetojnë dënimin me burgim.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë* - Nenet 207 dhe 208 parashohin mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë si dënim kryesor<sup>230</sup> derisa Neni 211<sup>231</sup> parashihet shqiptimin e gjobës krahas dënimit me burgim. Megjithatë, në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par. 5 të Neni 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>232</sup>

*-Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 60<sup>233</sup>* - gjykata i shqipton dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për tu zgjedhur personave që ***me qëllim që të zgjedhet, kryen ndonjë nga veprat penale të parapara nga ky kapitull.*** Kjo normë në mënyrë shumë të qartë i vë obligimin gjykatës që krahas shqiptimit të dënimit kryesor të caktojë edhe dënimin plotësues nga ky nen për kandidatët aktual. Shqiptimi i këtij dënimi nuk është i arsyeshëm për zyrtarët tjerë, të cilët veprën nuk e kryejnë për qëllim që të gjedhen vetë por për llogari të tjetrit. Duhet theksuar se me plotësim- ndryshimet e fundit të KPRK-së, këtij paragrafi i është shtuar edhe një paragraf 2 i ri i cili parashihet ndalimin e kandidimit në çdo pozitë publike nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, personit i cili shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje.<sup>234</sup>

*-Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 62<sup>235</sup> apo 63<sup>236</sup>* - rekomandohet të shqiptohet në të gjitha rastet kur personi zyrtar është i përfshirë në kryerjen e veprave nga ky kapitull gjithnjë derisa nuk paraqet element të veprës penale. Në fakt Neni 211 i KPRK-së e kualifikon si vepër të veçantë keqpërdorimin e detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve. Nga ana tjetër paragrafët e veçantë në nenet 213-217 përfshirja e personit zyrtar konsiderohet si vepër e cilësuar. Shqiptimi i këtij dënimi është

<sup>230</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 207 Cenimi i të drejtës për të kandiduar par. 1, dhe Neni 208 Kanosja e kandidatit par. 1 dhe 2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>231</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 211 Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve par. 1, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>232</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>233</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 60 Heqja e të drejtës për tu zgjedhur, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>234</sup> Ligji nr. 08/L -188 për Plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, Neni 4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.23, 23 Nëntor 2023, Prishtinë.

<sup>235</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 62 Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>236</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 63 Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

sidomos me rëndësi kur nuk është i përshtatshëm shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 60. Në shumë raste shqiptimi i këtij dënimi plotësues do të ketë efekt më të madh dhe mund të arrijë qëllimin e dënimit krahasuar me format tjera të dënimit.

-Vërejtja gjyqësore - Në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Nenit 82 mund të shqiptohet për veprat më të lehta të këtij Kapitulli dhe nuk mund të aplikohet kur kryesi ka të kaluar kriminale.

## VI. Kapitulli XIX Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës

### Shqyrtime të përgjithshme

Veprat e mbuluara nga ky kapitull janë vepra penale me dënim të ulët dhe atë 6 muaj, 1, 3 dhe 5 vjet dhe për të njëjtat është paraparë edhe mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë. Edhe pse dënimet e parapara për këto vepra penale janë të ulëta megjithatë këto vepra penale janë të rëndësishme së veçantë sepse paraqesin vepra penale të drejtuara kundër të drejtave individuale të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet e punës në mes të punëdhënësit dhe punonjësit.

Këto vepra penale lehtë mund të ngatërrohen edhe me veprat penale, si shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimeve nga neni 414 i KPRKK-së, ngase kur kryesi është personi zyrtar duhet të dallohet qëllimi i kryerjes së veprës penale. Njëkohësisht, veprat si cenimi i të drejtës në grevë nga neni 221 i KPRK-së, njëkohësisht paraqesin edhe shkelje të një të drejte kushtetuese të personit<sup>237</sup>, andaj edhe duhet trajtuar me seriozitetin e duhur dhe atë varësisht nga forma e veprimit të kundërligjshëm dhe pesha e rrethanave.

#### A. Pikënisja



Grafiku i mësipërm jep pikënisjen e sugjeruar për veprat nga ky kapitull, duke paraparë pikënisje prej 1/3 për të gjitha veprat sipas këtij kapitulli, me përjashtim të veprave të kryera nga recidivistët për të cilët pikënisja llogaritet 1/2.

#### B. Rrethanat rënduese

- *Keqpërdorimi i pushtetit ose pozitës zyrtare nga par. 2.9 i Nenit 70*, duhet të merret parasysh në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me këto vepra penale, gjithnjë duke përjashtuar rastet kur kemi të bëjmë me ato nene, respektivisht paragrafë kur pozita e tillë paraqitet si element i veprës penale.
- *Shkalla e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar* – Kjo rrethanë mund të gjejë zbatim në rastet kur vepra kryhet prej disa kryesve duke peshuar masën dhe mënyrën si është angazhuar personi në kryerjen e veprës penale. Anasjelltas, rrethana nga paragrafi 3.5 i po këtij neni mund të ndikojë në zbutjen e dënimit.

<sup>237</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 43, Liria e tubimit, K-09042008, 9 Prill 2008.



- Edhe rrethanat tjera rënduese të parapara me Nenin 70 të KPRK-së mund të jenë të aplikueshme në veprat sipas këtij kapitulli gjithnjë duke pasur kujdes në mosdyfishim me elementet e veprës penale. Për qëllime elaborimi po marrim *shkallën e dëmit të shkaktuar* si rrethanë rënduese e paraparë me par. 2.8<sup>238</sup> duke u siguruar për mos dyfishim me elementet e veprës penale. Kjo për faktin se vepra penale nga neni 222 par. 2 i KPRK-së i referohet shkallës së dëmit të shkaktuar.
- *Rrethanat lidhur me viktimat* - Të gjitha rrethanat nga par. 2.4 deri 2.7 mund të jenë relevante varësisht nga lloji i veprës së kryer.

### C. Rrethanat lehtësuese

*Pranimi i fajësisë* në veprat sipas këtij Kapitulli, nuk duhet të konceptohet si zbutje automatike nën minimumin ligjor në rastet kur të njëjtat nuk shoqërohen me rrethana tjera jashtëzakonisht lehtësuese.

### D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera

*-Shqiptimi i dënimit me kusht* - mund të jetë i përshtatshëm për veprat sipas këtij kapitulli, gjithnjë derisa nuk kemi të bëjmë me recidivizëm apo me veprime të dhunshme si ato të përshkuara p.sh. në Nenin 221. Shoqërimi i këtij dënimi me detyrime plotësuese<sup>239</sup>, mund të jetë mjaft efektiv për format më të lehta.

*-Shqiptimi i urdhrat për punë me dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat arsyetojnë dënimin me burgim.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë* - Për të gjitha veprat nga ky kapitull përveç nenit 220 par. 2 dhe 3 është paraparë si mundësi shqiptimi i dënimit me gjobë si dënim kryesor. Në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par. 5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>240</sup>

*-Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 62<sup>241</sup> apo 63<sup>242</sup>* - rekomandohet të shqiptohet në të gjitha rastet kur personi zyrtar është i përfshirë në kryerjen e veprave nga ky kapitull. Në shumë raste shqiptimi i këtij dënimi plotësues do të ketë efekt më të madh dhe mund ta arrijë qëllimin e dënimit krahasuar me format tjera të dënimit.

*-Vërejtja gjyqësore* - Në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Nenit 82 mund të shqiptohet për veprat më të lehta të këtij Kapitulli dhe nuk mund të aplikohet kur kryesi ka të kaluar kriminale.

*-Lirimi nga dënimi* - nuk mund të aplikohet tek ky lloji i veprave penale.

<sup>238</sup> Shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes të viktimës apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar ndaj viktimës ose familjes së tij;

<sup>239</sup> P.sh. “të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale” nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr, 06/L-074, Neni 56, paragrafi 1.12, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>240</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>241</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 62 Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>242</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 63 Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

## VII. Kapitulli XX Veprat penale kundër integritetit seksual

### Shqyrtime të përgjithshme

Ndryshimet e KPRK-së të vitit 2019, kanë bërë shumë ndryshime në nenet e këtij kapitulli. Kjo ka të bëjë si me renditjen e neneve ashtu edhe me ashpërsimin në masë të dënimeve nga kjo kategori. Në vitin 2020 Kuvendi i Republikës së Kosovës votoi në favor të amendamentimit të Kushtetutës për të mundësuar zbatimin e drejtpërdrejtë në Kosovë të dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur botërisht si Konventa e Stambollit. Ky instrument ndërkombëtar tanimë është bërë pjesë e rregullimit ligjor të Kosovës dhe si e tillë edhe sistemi i drejtësisë duhet siguruar që mbrojtja e viktimave dhe sanksionimi i kryesve të jetë në linjë me standardet ndërkombëtare. Neni 45<sup>243</sup> i Konventës së Stambollit kërkon që veprat të dënohen me ndëshkime efektive, proporcionale dhe bindëse, duke marrë parasysh shkallën e rëndë të tyre. Neni 46 i Konventës përcakton gjithashtu një listë të rrethanave rënduese që duhet të merren parasysh me rastin e matjes së dënimit, rrethana këto që janë të përfshira edhe në udhëzuesin e përgjithshëm të Gjykatës Supreme.

Në kuadër të këtij Kapitulli janë renditur dhjetë vepra penale, ndërkaq vepra e Ngacimit seksual ka ngelur në kuadër të Kapitullit XVI për veprat penale kundër jetës dhe trupit. Ky kapitull është ndikuar edhe me plotësim-ndryshimet e fundit të KPRK-së në atë mënyrë që Neni 232 Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi ka kaluar në Kapitullin e ri XXIV/A titulluar Krimi kibernetik si nen i ri 277/I.<sup>244</sup> Një tjetër risi është shtimi i nenit të ri 236/A i cili sanksionon obligimin e një personi për të kryer testin e virgjërisë.

U tha edhe më herët se ky kapitull përmban dënime shumë të rënda e disa nga ato edhe dënime kapitale me burgim të përjetshëm. Të tilla janë veprat si në vijim për të cilat janë paraparë minimumet prej 10, 15 dhe 20 vjet deri në dënim të përjetshëm:

- Neni 227 Dhunimi par. 5 dhe 9
- Neni 228 Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit par. 5 dhe 8
- Neni 229 Sulmi seksual par. 4 dhe 8
- Neni 230 Degradimi i integritetit seksual par. 7

Në të gjitha rastet e sipërme ashpërsimi i dënimit lidhet me dy pasoja më të rënda të veprës: vdekjen e viktimës dhe moshën e mitur e viktimës (14 apo 16 vjeç).

Ajo që është karakteristikë e veprave nën këtë kapitull është se shumica e paragrafëve dhe nën paragrafëve kanë të përfshirë si element të veprës penale rrethanat rënduese nga Neni 70 i KPRK-së duke pamundësuar kështu përfshirjen e të njëjtave edhe në kuadër të rrethanave

---

<sup>243</sup> Konventa e Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje [Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence (CETS No. 210)], 01/08/2014.

<sup>244</sup> Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 06/L-074, Neni 277/I Materialet me përmbajtje të shfrytëzimit dhe keqpërdorimit seksual të fëmijëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.23, 23 Nëntor 2023, Prishtinë

rënduese. Nga ana tjetër dënimet minimale brenda këtij kapitulli sillen deri në 3 vjet dhe të njëjtat mund edhe të zëvendësohen me gjobë:

- Neni 229 Sulmi seksual par. 1
- Neni 230 Degradimi i integritetit seksual par. 1
- Neni 231 Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën 16 vjeç par. 1
- Neni 233 Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës par. 1
- Neni 236 Marrëdhëniet seksuale brenda familjes par. 1


Ndërkaq Neni 235 Ofrimi i lokaleve për prostitucion par. 1 është i dënueshëm me gjobë deri në 4 vjet.

Ngritja e minimumeve dhe maksimumeve të dënimit për veprat e kësaj natyre është kritikuar shpesh nga sistemi i drejtësisë, duke u arsyetuar në shmangien nga parimi i proporcionalitetit krahasuar me veprën e kryer. Për shkak të natyrës së këtyre veprave dhe për dallim nga shumë vepra tjera, ka vështirësi të mëdha në të dëshmuarit e kryerjes së veprës dhe gjetjen e provave adekuate për të provuar veprimet. Megjithatë, çështja e të provuarit të veprës është aspekt procedural në të cilin kërkohet angazhim shtesë nga ana e organeve të drejtësisë sidomos edhe duke u përqendruar më me zell në provat rrethanore. Kjo për faktin se veprat kundër integritetit seksual paraqesin njëherësh edhe shkelje të neneve 3 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Andaj, edhe përgjigja e sistemit të drejtësisë në përgjithësi ndaj këtyre akteve duhet të jetë adekuate dhe e fuqishme. Kështu në rastin *M.G.C kundër Rumanisë*<sup>245</sup>, Gjykata duke analizuar çështjen e përgjigjes së autoriteteve në vlerësimin e rrethanave në rastet e dhunimit të të miturve, nuk e kishte analizuar këtë vetëm në bazë të rastit në fjalë të dhunimit të 11 vjeçares, por për të dhënë përgjigje nëse shteti kishte bërë shkelje të obligimit pozitiv, kishte konsultuar edhe praktikën e gjykatave vendore në disa prej këtyre rasteve mbi ekzistimin apo jo të pëlqimit nga ana e viktimës së mitur. Gjykata kishte gjetur se hetimi i rastit të parashtrueses së kërkesës, dhe në veçanti, qasja e gjykatave vendore, në kontekst të mungesës së praktikës konsistente në këtë fushë, nuk kishte plotësuar kriteret që kërkohen me obligimin pozitiv të shteteve për një sistem efikas të drejtësisë penale për të dënuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve duke çuar kështu në shkeljen e Neneve 3 dhe 8 të Konventës. Gjykata po ashtu kishte konstatuar se gjykatat vendore kishin dështuar për të demonstruar një qasje me ndjeshmëri ndaj fëmijëve në analizimin e fakteve të rastit, duke keqinterpretuar si pëlqim faktin që fëmija nuk u kishte treguar prindërve për dhunimin apo se nuk kishte bërë titur për të kërkuar ndihmë, e jo duke konsideruar mundësinë se ky mund të ishte një reagim potencial i një fëmije ndaj një ngjarjeje traumatike. Gjykata po ashtu kishte potencuar dështimin e autoriteteve për të hetuar mjaftueshëm edhe provat rrethanore pikërisht për shkak se i kishin dhënë shumë pak apo aspak peshë ndjeshmërisë së shtuar të të miturve dhe faktorët e veçantë psikologjik prezent në rastin e dhunimit të të miturve.

---

<sup>245</sup> Case of *M.G.C. v. Romania*, Application no.61495/11, 15.06.2016, par.69-75, [https://hudoc.echr.coe.int/#{%22fulltext%22:\[%22sex%20crime%22\],\[%22documentcollectionid%22:\[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22\],\[%22itemid%22:\[%22001-161380%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/#{%22fulltext%22:[%22sex%20crime%22],[%22documentcollectionid%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22],[%22itemid%22:[%22001-161380%22]})

## A. Pikënisja

		
	1. Veprat e kryera nga individë që për herë të parë bien ndesh me ligjin	2. Veprat e kryera nga recidivistë apo anëtarë të grupit të organizuar kriminal
Pikënisja	1/3	1/2

Duke qenë se është e qartë se qëllimi i ligjvënësimit është dënimi shoqëror për veprat e kësaj natyre të shprehur në dënime jashtëzakonisht të larta dhe duke qenë se rrethanat rënduese janë shumica nga to pothuajse të mishëruara si elemente të veprës penale në shumë prej paragrafëve, janë bërë vetëm dy diferencime sa i përket pikënisjes për veprat nga ky Kapitull:

- Pikënisja prej 1/3 për të gjitha veprat e kryera nga individë jo-recidivistë.
- Pikënisja prej 1/2 për rastet kur vepra është kryer nga recidivistë si dhe nga anëtarë të grupit të organizuar kriminal.

Natyrisht kjo paraqitet vetëm si pikënisje pasi Gjykata gjithnjë duhet të vlerësojë edhe rrethanat tjera përtej atyre që tashmë janë të përfshira si element të veprës penale. Pjesa e rrethanave lehtësuese dhe rënduese përfshin më shumë detaje rreth rrethanave që mund të ndikojnë në dënimin final. Duhet bërë me dije se sa i përket veprave për të cilat si dënim është paraparë edhe burgimi i përjetshëm pikënisja NUK ZBATOHEM nëse gjykata e shqipton këtë dënim. Sa i përket kësaj çështjeje gjyqtarët udhëzohen të shqyrtojnë Pjesën I të këtij Udhëzuesi, më saktë Pikën III-Dënimet kryesore sipas KPRK.

## B. Rrethanat rënduese

Për qëllime ilustrimi po pasqyrojmë të dhënat nga Raporti i EULEX-it për Vlerësimin e trajtimit të rasteve të dhunimit,<sup>246</sup> ku gjatë analizimit të 20 aktgjykimeve fajësuese hartuesit kishin dhënë disa shembuj të rrethanave që gjykatat i vlerësuan si rënduese në këto raste:

- C. Pësia e veprës penale, mënyra e kryerjes së saj.
- D. Moshë e vogël e viktimës.
- E. E kaluara e mëparshme kriminale.
- F. Kryerja me dashje edhe pse është ditur moshë e viktimës.
- G. Njohuria për pasojat dhe rrezikshmërinë e krimit.
- H. Mungesa e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Shumë nga të mësipërmet tashmë paraqiten si element i veprës penale andaj përfshirja e tyre edhe si rrethanë do të nënkuptonte dyfishim, prandaj edhe duhet shmangur.

<sup>246</sup> EULEX, Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunimit nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, Raport i monitorimit, 4.2.3.2 Dënimet e buta, Fq.27, Korrik 2022.

Siç edhe u theksua më lart një numër i rrethanave rënduese nga Neni 70 i KPRK-së janë të përfshira si elemente të veprës penale. Tabela e mëposhtme ilustron cilat janë rrethanat më të përfshira si elemente.

Rrethana rënduese sipas Nenit 70 të shprehura si element i veprës penale		Shprehur në nenet
2.2	Shkallën e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar.	227,229,230
2.3	Prezencën e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale.	227,229,230
2.4	Nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore.	227,229,230
2.5	Nëse vepra penale përfshin disa viktime.	228
2.6	Nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme.	227-230
2.7	Mosha e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar.	227-236
2.8	Shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes te viktime apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar ndaj viktimës ose familjes së tij.	227-230
2.9	Çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale.	228
2.10	Dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar.	227,229,230
2.14	Nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjare.	227,229,230

Që të gjitha këto elemente/rrethana të sipërpërmendura kanë peshë mjaft të madhe në kryerjen e veprës penale andaj edhe ligjvënësi ka konsideruar rritjen e minimeve dhe maksimeve ligjore. Kështu paragrafët 2.4 dhe 2.8 kanë të bëjnë me lartësinë e dëmit të shkaktuar. Kjo mund të reflektohet ndryshe në veprat e ndryshme brenda kapitullit p.sh. niveli i dëmit psikologjik, shkallës së traumës, sëmundjet e transmetuara etj. Por ajo që nuk është përfshirë në mënyrë eksplicite në këtë rrethanë (por që duhet konsideruar si pjesë e saj) është shtatzënia si rezultat i dhunimit të viktimës e cila përfshinë pasojë shumë të rëndë dhe afatgjate jo vetëm për viktimën por edhe për frytin e ngjizur dhe rrjedhimisht edhe fëmijën. Andaj si pasojë gjithnjë duhet të merret parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Gjykata duhet të ketë parasysh se edhe vet brenda një rrethane ka variacione të ndryshme pasi në të shumtën e rasteve të sipër përmendurat gjenden të kombinuara në dy, tre apo më shumë rrethana dhe rrallë të izoluar. Andaj, në të tilla raste duhet bërë dallimi nga një rast në tjetrin. Pjesa tjetër e rrethanave në tabelën e sipërme bashkë me rrethanat e poshtëpërmendura bëjnë pjesë në rrethanat që tregojnë shkallën e përgjegjësisë së kryesit:

*Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal*

Duke qenë se kjo pjesë është marrë parasysh me rastin e caktimit të pikënisjes, përfshirja si rrethanë shtesë do të paraqiste dyfishim. Megjithatë, në këtë rast Gjykata këtë rrethanë duhet ta zbërthejë tutje në kontekst të kohëzgjatjes së anëtarësisë në këtë organizatë, pozitës në hierarki, llojin e aktivitetit kriminal etj.

Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale<sup>247</sup> kjo rrethanë është zbërthyer pothuajse në çdo kapitull dhe të njëjtat argumente sa i përket kryesit në rastin në fjalë vlejné edhe për këtë. Pra, dënimi për individin si pjesë e grupit kriminal duhet bazuar në formën e angazhimit në kryerjen e asaj vepre dhe angazhimi/roli më i madh duhet të reflektohet me dënim proporcional dhe adekuat me atë angazhim.

Nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo veprë penale të kryer ndaj personit, grupit të personave ose pronës, motivuar në bazë të...<sup>248</sup> nëse veprat kundër integritetit seksual janë kryer për motive të ndonjëres nga bazat e parapara sipas këtij paragrafi janë faktorë shumë relevant dhe duhet të kenë peshë në dënimin final. Si rrethanë hyn në kuadër të rrethanave që tregojnë përgjegjësi të shtuar të kryesit.

Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar<sup>249</sup> Dënimi i mëparshëm paraqet një nga elementet më me peshë në matjen e dënimit. Recidivizmi tashmë është përfshirë me rastin e caktimit të pikënisjes më të lartë për kryesit me të kaluar penale. Megjithatë, sa i përket dënimeve të mëparshme të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së. Përpos rrethanave të sipërpërmendura janë edhe një numër faktorësh dhe rrethanash tjera që nuk janë të përfshira në mënyrë eksplicite në KPRK, por që kanë po të njëjtin indikacion të shkallës së përgjegjësisë dhe të cilat do të duhej të merren në konsideratë me rastin e matjes së dënimit. Disa nga ato janë:

- Dhuna e mëparshme ndaj po të njëjtës viktimë.
- Hyrja me forcë në shtëpinë/banesën apo vendin ku gjendet viktimja.
- Planifikim domethënës në kryerjen e veprës penale.
- Nëse vepra është kryer në bashkëkryerje
- Përdorimi i alkoolit apo narkotikëve për kryerjen e veprës.
- Eksploatim për qëllime komerciale.
- Përdhosjen dhe turpërimin e viktimës si p.sh. përmes ekspozimit të fotove apo videove të aktit të dhunimit ose shpërndarjes së tyre në rrjete sociale.
- Mbajtja në izolim për kohë të zgjatur.
- Rrëmbimi etj.

Të gjitha këto nëse nuk mund të përfshihen si veprë e veçantë, duhet gjithsesi të merren parasysh me rastin e matjes së dënimit.

## **E. Rrethanat lehtësuese**

Sipas raportit të EULEX për Vlerësimin e trajtimit të rasteve të dhunimit,<sup>250</sup> gjatë analizimit të 20 aktgjykimeve fajësuese hartuesit kishin dhënë disa shembuj të rrethanave që gjykatat i vlerësuan si lehtësuese në këto raste:

- I pandehuri premtoi se nuk do ta shkel më kurrë ligjin;
- I pandehuri i kërkoi falje viktimës.

<sup>247</sup> Par. 2.1

<sup>248</sup> Par. 2.12

<sup>249</sup> Par. 2.13

<sup>250</sup> EULEX, Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunimit nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, Raport i monitorimit, 4.2.3.2 Dënimet e buta, Fq.27, Korrik 2022.

- Gjendja e dobët ekonomike e të pandehurit; statusi si mbajtës i vetëm në familje ose i papunë.
- Moshë e re e të pandehurit.
- Sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë.
- Pranimi i fajësisë së të pandehurit.
- I pandehuri nuk ka pasur të kaluar kriminale më parë në Kosovë.
- Dallimi i vogël në moshë ndërmjet viktimës dhe të pandehurit.
- I pandehuri kishte familje dhe fëmijë.
- Niveli i ulët arsimor i të pandehurit.
- Gjendja e keqe shëndetësore e të pandehurit.
- Mungesa e lëndimeve fizike të viktimës si pasojë e dhunimit.
- Stërzgjatja e procedurës dhe periudha kohore e kaluar nga ndodhja e krimit (d.m.th. 10 vjet).

Edhe pse si mostër nuk është e mjaftueshme për të bërë një vlerësim të saktë të praktikës së gjykatave në trajtimin e këtyre rasteve, megjithatë përdorimi i rrethanave të sipërpërmendura na jep një pasqyrim të përgjithshëm mbi atë se si gjykatat i konceptojnë këto rrethana. Janë disa çështje që duhet potencuar vetëm bazuar në rrethanat e mësipërme të përdorura:

- Derisa përdorimi i disa prej këtyre rrethanave mund të jetë i arsyeshëm, megjithatë dhënia e një peshe shumë të madhe nuk arsyetohet asnjëherë në rastet kur vepra ka qenë e rëndë dhe me pasojë të rënda për viktimën.
- Ka rrethana që janë plotësisht jo relevante. Shembull “*niveli i ulët arsimor i të pandehurit*” nuk arsyetohet fare si rrethanë lehtësuese, aq më tepër për veprat e kësaj natyre. Është e arsyeshme nëse Gjykata mundohet të arsyetojë marrjen parasysh të kësaj rrethane, vetëm në kontest të vlerësimit të aftësisë së kryesit për të kuptuar peshën e veprimeve të tij/saj, njësoj sikurse do të ishte rasti i marrjes parasysh të moshës<sup>251</sup>, por jo vetëm pse kryesi ka shkollim më të ulët. Andaj, arsyetimi i duhur i vendimit është më se i domosdoshëm për të kuptuar logjikën prapa vendimmarrjes së gjykatës.
- Ka edhe rrethana si “*mungesa e lëndimeve fizike të viktimës si pasojë e dhunimit*”, përfshirja e të cilës si rrethanë lehtësuese është jo vetëm e gabuar por edhe mjaft shqetësuese kur siç shihet qartazi një rrethanë e tillë është përdorur në veprën penale të dhunimit. Veprat si vrasja dhe disa vepra të integritetit seksual shkaktojnë dëme të cilat janë kualitativisht më ndryshe nga dëmet, nga mashtrimet apo veprat kundër pasurisë. Dëmet konstituojnë ndërhyrje thelbësore në integritetin fizik dhe seksual të viktimës dhe janë shumë më poshtëruese sesa të cilado vepër. Natyra e pariparueshme e dëmit ndaj viktimës mund të zgjerohet më gjerësisht edhe në familjen dhe shoqërinë.<sup>252</sup> Nuk mendohet se shumica e dhunimeve planifikohen paraprakisht në mënyrën siç planifikohen, për shembull grabitjet e armatosura, por pesha e përgjegjësisë zakonisht do të jetë e madhe për shkak se kryesi është plotësisht i vetëdijshëm për veprimet e

<sup>251</sup> Psh të rinjtë e moshës 18-25 vjeç janë ende duke u zhvilluar në aspektin neurologjik, andaj edhe mund të jenë më pak në gjendje të:

- Vlerësojnë pasojat e veprimeve të tyre.
- Të kontrollojnë impulsivitetin e tyre.
- Të kufizohen në ndërmarjen e rreziqeve.

Këto janë disa nga rrethanat e marra parasysh në kuadër të Udhëzuesve në Britaninë e Madhe kur arsyetohet moshë si rrethanë lehtësuese. Për më shumë shih: <https://www.sentencingcouncil.org.uk/offences/crown-court/item/rape/>

<sup>252</sup> Maslen, Hannah. Pendimi, Teoria penale dhe dënimi [Remorse, Penal Theory and Sentencing], Relevanca e llojit të veprës, Fq.141, Mbretëria e Bashkuar: Bloomsbury Publishing, 2015.

veta. Andaj, përdorimi i një rrethane të tillë si lehtësuese duhet ndaluar rreptësisht. Nga ana tjetër, ekzistimi i lëndimeve fizike shitesë krahas dhunimit paraqitet si element i veprës penale nëse ato lëndime janë të natyrës së rëndë.

- Njëjtë siç u theksua më sipër, edhe *kërkim falja* apo përgjithësisht edhe *shprehja e pendimit të pandehurit* te veprat kundër integritetit seksual duhen shikuar me një dozë të madhe të kujdesit, pikërisht për shkak të dëmit që rezulton prej tyre.<sup>253</sup>

Lidhur me ndikimin psikologjik, gjykata duhet të jetë e vetëdijshme për çfarëdo indikacioni që tregon se i pandehuri e ka poshtëruar, turpëruar apo degraduar viktimën duke bërë fotografi, video apo audio inçizime, duke postuar komente në rrjete sociale (në internet) apo duke kanosur për të zbuluar informata private apo personale lidhur me viktimën. Këto veprime mund të konsiderohen si rrethana rënduese pasi që kryhen për të poshtëruar viktimën edhe më shumë. Gjukata inkurajohet që t'i kushtojë vëmendje të veçantë nëse rasti specifik i poshtërimit përfshin viktimën e mitur, e cila do të rriste edhe më shumë peshën e veprës së kryer dhe pasojat e saj, duke pasur parasysh se në atë moshë personaliteti i viktimës nuk është krejtësisht i zhvilluar dhe ai apo ajo varet nga tjerët.<sup>254</sup>

## F. Aplikueshmëria e dënimeve tjera.

Ashtu siç është potencuar në kapitujt tjerë, Gjukata me rastin e matjes së dënimit duhet të ketë parasysh përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e dënimit me veprën e kryer.

*-Shqiptimi i dënimit me kusht* - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët apo mesatare, por gjithnjë duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar. Ky dënim nuk arsyetohet në rastet kur kryesi ka të kaluar kriminale apo vepron si pjesë e grupit të organizuar kriminal, përveç nëse ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese.

*-Shqiptimi i urdhrat për punë në dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat arsyetojnë dënimin me burgim.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë*

Janë vetëm 4 raste kur dënimi me gjobë parashihet si dënim kryesor nga dënimi me burgim dhe atë për veprat për të cilat dënimi maksimal i paraparë është deri në 3 vjet. Në të gjitha rastet kur gjykata e zëvendëson dënimin me burgim me dënim me gjobë, duhet pasur parasysh që për ta arritur efektin e duhur dënimi me gjobë duhet të jetë në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par. 5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>255</sup>

---

<sup>253</sup> Ashworth, Andrew., Kelly, Rory. Sentencing and Criminal Justice. Proportionality and Seriousness, Fq.128Mbretëria e Bashkuar: Bloomsbury Publishing, 2021.

<sup>254</sup> DCAF, Doracaku i Gjyqtarëve, Konsideratat për vlerësimin e dhunës në familje në Bosnjë dhe Hercegovinë, Sarajevë (2014), fq. 21.

<sup>255</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.



## -Dënimet plotësuese

Dënimet plotësuese nga nenet 62 dhe 63 - Shqiptimi i dënimit plotësues nga nenet 62 apo 63 paraqitet si mjaft i rëndësishëm për sanksionimin e kryesve të veprave nga ky kapitull. Derisa shqiptimi i dënimit nga Neni 62 i referohet vetëm të punësuarve në sektorin publik, Neni 63 është më i përgjithshëm pasi përfshin çfarëdo funksioni apo veprimtarie. Kështu paragrafi 1 i Neni 63 qartazi nënkupton shqiptimin e dënimit plotësues personit që ka keqpërdorur pozitën, veprimtarinë apo detyrën e tij me qëllim të kryerjes së veprës penale apo ekziston mundësia që ta bëjë këtë në të ardhmen. Për tu shqiptuar një dënim i tillë nuk është i domosdoshëm të plotësohet vetëm kushti që personi të ketë kryer veprën në keqpërdorim të detyrës. Përkundrazi, ky nen qartazi parasheh në paragrafin 1 se dënimi i tillë do të duhej shqiptuar edhe kryesve tjerë nëse ka arsye të pritët që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale në të ardhmen. Kohëzgjatja e dënimit mund të jetë nga 1-5 vjet. Megjithatë, paragrafi 5 i po të njëjtit nen parasheh kohëzgjatje shumë më të madhe nëse viktimja është fëmijë. Sipas këtij paragrafi, nëse kryesi ka kryer vepër penale nga Neni 165 apo nga kapitulli i veprave kundër integritetit seksual ndaj fëmijës, të njëjtit i shqiptohet masa e ndalimit të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës që përfshin kontaktin e rregullt me fëmijë. Ky dënim mund të shqiptohet edhe në kohëzgjatje të përhershme me kusht të shqyrtimit periodik prej 10 vitesh nga fillimi i ekzekutimit. Shembull, nëse një person është dënuar për veprën penale dhunim të një të mituri, Gjykata, përmes shqiptimit të këtij dënimi plotësues do sigurohej që personit të tillë ti kufizohet qasja në fëmijë (jo vetëm në detyrën aktuale që i njëjti ushtron, por edhe në cilindo funksion apo detyrë që përfshin punën me fëmijë) duke shmangur kështu edhe mundësitë për keqpërdorim të detyrës në të ardhmen. Ky dënim, padyshim që mund të ketë efekt më të madh parandalues andaj edhe konsiderohet i përshtatshëm.

Përpos dënimeve plotësuese të parapara me KPRK të vitit 2019, në vitin 2023 janë bërë edhe disa ndryshime në dënimet plotësuese me impakt kryesisht në veprat penale të dhunimit dhe dhunës në familje. Secila nga këto dënime plotësuese të shtuara shtojnë obligimin e gjykatës që të shqiptojë këto masa shtesë duke mos u fokusuar vetëm në dënimin kryesor. Për secilin nga dënimet plotësuese relevante do të flitet më poshtë më në detaje:

Ndalimi i të drejtës së kandidimit në pozitë publike<sup>256</sup> - Shtimi i këtij dënimi plotësues është bërë duke e ndryshuar nenin 59 të KPRK-së të 2019-ës, dhe po ashtu duke e zbrëthyer më gjerësisht në kuadër të Neni 60, heqja e të drejtës për tu zgjedhur dhe atë si paragraf i ri 2:

*“Gjykata ia ndalon të drejtën e kandidimit në çdo pozitë publike nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, personit i cili shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje.”*

Kjo nënkupton se në cilindo rast kur kryesi shpallet fajtor për ndonjërin nga dy veprat e sipërpërmendura gjykata duhet të shqiptojë edhe këtë dënim plotësues. Pra, përderisa Neni 60 ka pasur përqendrimin kryesor në veprat penale kundër të drejtave të votimit tanimë ky nen jo vetëm është zgjeruar më tutje edhe për këto dy kategori të veprave, por njëkohësisht ka paraparë kohëzgjatje më të madhe sesa për veprat tjera e po ashtu duke parandaluar që personi i tillë të mos kandidojë fare për pozitë publike.

---

<sup>256</sup> Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 06/L-074, Neni 3 dhe 4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.23, 23 Nëntor 2023, Prishtinë.

Ndalimi i punësimit në sektorin publik- Në të njëjtën frymë sikurse edhe dënimi paraprak, edhe ndalimi i punësimit në sektorin publik, në fakt paraqet një masë shtesë nga paragrafi 62 i KPRK-së duke sanksionuar jo vetëm zyrtarët publik që aktualisht ushtrojnë funksion publik. Ky nen i ri vetëm konfirmon atë që tashmë thekson par. 1 i Nenit 63 duke përmendur në mënyrë specifike ndalesën që personi i dënuar për dhunim apo dhunë në familje të mos mund të punësohet në të ardhmen në sektorin publik (në të gjitha nivelet) dhe atë për periudhën prej 1-5 vjet.

Ndalimi i të drejtës për drejtimin e automjetit për çdo lloj të kategorisë<sup>257</sup>, nga një (1) deri në pesë (5) vjet, personit që është shpallur fajtor për veprën penale të dhunimit në kohën kur ishte në ushtrimin e profesionit të vozitësit. Duket qartë se ky dënim plotësues i shtuar me plotësim ndryshimet, në fakt e zgjeron aplikimin e masës tashmë ekzistuese në KPRK-së, më saktësisht Neni 64 “Ndalimi i drejtimit të automjetit”. Derisa Neni 64 i referohet veprave që ndërliken me rrezikun në trafikun publik, Neni i ri 62B i prezantuar, paraqitet shumë më i ashpër pasi jo vetëm zgjeron gamën e aplikimit, por njëkohësisht aplikohet për të gjitha kategoritë e automjetit, e jo vetëm për kategoritë/mjetet e llojit të caktuar siç shënohet në Nenin 64. Dënimi i ri i paraparë, shënjestron në mënyrë specifike personat të cilëve u është besuar transporti i mallrave apo personave dhe të cilët në ushtrimin e këtij profesioni kryejnë veprën penale të dhunimit.

Me plotësim ndryshimet e KPRK-së janë shtuar edhe dy dënimet plotësuese<sup>258</sup> të mëposhtme për kryesit që gjenden fajtorë për veprën penale të dhunimit apo dhunës në familje:

- Ndalimi i blerjes në ankande të shitjes së pronave publike, asetëve publike apo licencave që jepen nga një autoritet publik në çfarëdo shërbimi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
- Ndalimi i aplikimit si investitor strategjik dhe çdo formë tjetër e përfitimit nga privilegjet që jepen nga legjislacioni në fuqi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

Edhe pse në fakt natyra e veprës nuk ka ndonjë lidhshmëri me këto dy sanksione, megjithatë qëllimi i ligjvënësit duket të ketë qenë që kryesve të veprave të kësaj natyre tu pamundësojë në mënyra të ndryshme përfitimin nga buxheti i shtetit. Andaj, gjykata duhet të ketë parasysh që me rastin e marrjes së vendimit për kryesit e veprave të sipërpërmendura të shqiptojë edhe dënimin plotësues.

-Vërejtja gjyqësore - Në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Nenit 82 mund të shqiptohet për veprat me dënimet minimale (si të listuara më sipër) të këtij Kapitulli dhe nuk mund të aplikohet kur kryesi ka të kaluar kriminale.

-Lirimi nga dënimi - Nuk është i paraparë për asnjërën nga veprat nga ky kapitull.

---

<sup>257</sup> Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr, 06/L-074, Neni 62B, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.23, 23 Nëntor 2023, Prishtinë.

<sup>258</sup> Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr, 06/L-074, Neni 2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.23, 23 Nëntor 2023, Prishtinë.

Duhet vënë në pah Neni 226 i cili thekson se “Kryesi nuk është penalisht përgjegjës për shkak të lajthimit në fakt nga neni 25 i këtij Kodi nëse për arsye të justifikueshme nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se viktima ka qenë nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare.”<sup>259</sup>

---

<sup>259</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 226, Lajthimi në fakt lidhur me moshën e viktimës, paragrafi 2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

## VIII. Kapitulli XXI Veprat penale me bazë gjinore, kundër martesës dhe kundër familjes

### Shqyrtime të përgjithshme

Veprat penale nga ky kapitull në veçanti në dekadën e fundit kanë marrë vëmendjen globale duke shtuar presionin në institucionet relevante për të ndryshuar praktikat e vjetruara dhe përshtatur ato me zhvillimet në arenën ndërkombëtare. Ky presion ka vazhduar të shtohet sidomos nga dy elemente:

- Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj),
- Mbrojtja që ofron Konventa e Stambollit<sup>260</sup>.

Edhe Republika e Kosovës, përkundër faktit se nuk është as nënshkruese e Konventës së Stambollit e as anëtare e Këshillit të Evropës, ka ndryshuar shumë nga politikat dhe ligjet përkatëse për tu përshtatur me këto zhvillime. Kjo për faktin se, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë, përfshirë edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) kanë zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës. Në vitin 2020 listës së këtyre dokumenteve ndërkombëtare i është shtuar edhe Konventa e Stambollit. Në anën tjetër, Neni 53 i Kushtetutës obligon institucionet e Republikës së Kosovës që interpretimin e dispozitave që lidhen me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore ta bëjë në pajtim me vendimet gjyqësore të GjEDNj.

Veprat e sanksionuara në këtë kapitull, lidhen ngushtë me bërthamën e shoqërisë - familjen dhe gjithçka që lidhet me të. Megjithatë, me plotësim ndryshimet e KPRK-së në vitin 2023, është ndryshuar edhe vet titulli i këtij kapitulli duke e zgjeruar, përveç veprave kundër familjes, edhe me veprat penale me bazë gjinore. Në këtë kontekst është shtuar edhe një nen i veçantë i cili ka të bëjë me *Dhunën kundër grave në jetën publike*.<sup>261</sup> Duket se përmes kësaj ndërhyrjeje ligjvënësi ka pasur për synim plotësimin e kërkesave të Konventës së Stambollit, përkundër faktit që Gjykata Supreme e konsideron se kjo vepër tashmë ka pasur mbulueshmëri të mjaftueshme në dispozitat e neneve ekzistuese apo edhe për faktin se nuk përkon shumë me natyrën e veprave tjera në këtë kapitull.

Nga të gjitha veprat e parapara në këtë kapitull, janë dy kategori të veprave të sanksionuara me sanksionin më të rëndë:

- Martesa e detyruar par. 5 dhe 6 të cilët parashohin minimumin prej 15 vjet burgim.
- Bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç me po ashtu minimume dhe maksimume të larta.

GREVIO, në raportin e parë vlerësues për Kosovën që nga inkorporimi i Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, te çështja e martesave të detyruara në disa nga raportet e vlerësimit ka theksuar dallimin në mes martesave të aranzhuara dhe të detyruara, duke vënë në dukje se ndërsa kategoria e parë nuk hyn në fushëveprimin e nenit 37 të konventës për shkak të ekzistencës së një pranimi “të nënkuptuar”, e dyta hyn në këtë fushëveprim. Për sa i

<sup>260</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11 maj 2011.

<sup>261</sup> Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 06/L-074, Neni 284/A Dhuna kundër grave në jetën publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.23, 23 Nëntor 2023, Prishtinë.

përket martesës së fëmijëve, GREVIO ka sjellë ndërmend se standardet botërore të të drejtave të njeriut të përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve ndalojnë fejesën dhe martesën e fëmijëve, sigurojnë të drejtën për të zgjedhur lirshëm bashkëshortin dhe për të lidhur martesë me pëlqim të lirë dhe të plotë, dhe martesën e hershme dhe të detyruar i konsiderojnë si një praktikë të dëmshme të cilës duhet t'i jepet fund.<sup>262</sup>

Një problematikë mjaft e shprehur në Kosovë, që ngrihet shpesh si shqetësim edhe nga vet sistemi i drejtësisë është bashkësia jashtëmartesore me persona nën moshën 16 vjeçare. Në shumicën e rasteve këto martesë janë të shprehura te komuniteti Rom, Egjiptas dhe Ashkali. Shumë faktorë që kontribuojnë në këtë fenomen kanë të bëjnë me kulturën e këtyre komuniteteve ku më së shumti theksohet mungesa e shkollimit. Nisur nga parimi i mbisundimit të normave ligjore ndaj normave shoqërore dhe me synimin e luftimit të këtyre normave, ligjvënësi ka paraparë dënime mjaft të ashpra.

Një tjetër vepër e rëndësishme jashtëzakonisht të madhe në këtë kapitull, është Dhuna në familje sanksionuar me Nenin 248 të KPRK-së. Kjo vepër për herë të parë është përfshirë në KPRK në vitin 2019 dhe që nga hyrja në fuqi janë ngritur një mori dilemash rreth zbatimit të këtij neni. Për këtë arsye në vitin 2020 Gjykata Supreme ka lëshuar një Udhëzim lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje<sup>263</sup>. Që nga koha e nxjerrjes së Udhëzimit, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore<sup>264</sup>. Me miratimin e këtij Ligji janë definuar disa çështje që ishin rregulluar me Udhëzim e që kryesisht kanë të bëjnë me përkufizimin e katër formave të dhunës (fizike, ekonomike, psikologjike dhe seksuale).

Megjithatë edhe vet miratimi i këtij Ligji len ende pikëpyetje rreth disa çështjeve që ka të bëjë me elementet e kësaj veprë penale dhe zbatimit të dispozitave tjera që ndërlidhen me Nenin 248. Kjo për faktin se nëse bëjmë një krahasim mes veprave tjera bazë dhe veprës nga Neni 248 i bie se për disa vepra, sanksioni është më i ulët nëse vepra kryhet brenda marrëdhënies familjare sesa po të kryhej nga një i huaj. P.sh. Lëndimi i rëndë trupor nga Neni 186 par. 1 parasheh dënimin prej maksimum 5 vjet, ndërkaq për Dhunë në familje sipas Nenit 248, dënimi maksimal për dhunë fizike është 3 vjet. Duke kuptuar se qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë dënimi më i ulët, por në fakt më i rëndë për këto raste, rrjedhimisht vijmë në përfundimin që qëllimi i Nenit 248 qysh në fillim ka qenë:

- Përcaktimi i dhunës në familje si vepër e veçantë në KPRK.
- Të siguruarit që format më të lehta të dhunës në familje të cilat nuk janë mbuluar me veprat tjera bazë në KPRK të mbulohej me këtë nen. Këto vepra nëse do të kryheshin jashtë kontekstit të marrëdhënies familjare do të përbënin kundërvajtje.

---

<sup>262</sup> Sekretariati i mekanizmit monitorues të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - Divizioni i Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore, Njësia e Projekteve për Ngritjen e Kapaciteteve dhe Bashkëpunimit, Vlerësimi i përafritimit i ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës\* me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), 5. Martesat e detyruara, fq.66

<sup>263</sup> Gjykata Supreme, Udhëzim lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Gj.A.113/2020, 12.06.2020.

<sup>264</sup> Ligji Nr.08/L-185, Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.22, 12 tetor 2023, Prishtinë.

Problematikë tjetër lidhur me rregullimin e dhunës në familje në këtë nen është mënyra e hartimit të dispozitës në paragrafët 1 dhe 3, pasi vërehet një dyfishim i paragrafëve, por me një ndryshim substancial sa i përket formave të dhunës në familje dhe qëllimit të kryerjes së veprës penale. Kështu sipas paragrafit 1 dhuna e ushtruar pasqyrohet në tre format e saj si dhunë apo keqtrajtim fizik, psikologjik dhe ekonomik, në paragrafin 3 të po këtij neni është shtuar edhe forma e katërt e dhunës e që është ajo seksuale. Një tjetër konfuzion në mes paragrafit 1 dhe 3 lidhet me atë se përderisa paragrafi 1 potencon se dhuna e ushtruar kryhet me qëllim " ... të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënie familjare ... " paragrafi 3 nuk përmend fare qëllimin e kryerjes së kësaj vepre. Në dukje, paragrafi 1 duket se përmban elemente të një vepre më të rëndë sesa ajo e paragrafit 3, pikërisht për shkak se paraqet një indikacion se veprimet e tilla mund të jenë kryer në vazhdimësi ndaj viktimës nga ana e kryesit për ta arritur qëllimin e cenimit të dinjitetit të viktimës, përderisa, paragrafi i 3 mund të nënkuptojë edhe një veprim të çastit pa një karakteristikë të ushtrimit të dhunës apo presionit të vazhdueshëm e cila do të përmbushte elementin e cenimit të dinjitetit. Megjithatë, nëse e analizojmë në aspekt të sanksionimit, atëherë vërehet se përkundër elementit rëndues në par. 1, sanksionimi mbetet i njëjtë.<sup>265</sup>

Në kohën e hartimit të këtij Udhëzuesi ka filluar edhe një tjetër revidim i disa neneve të KPRK-së dhe Neni 248 është një prej tyre. Do të ishte shumë më e lehtë edhe për organet ligj zbatuese dhe sistemin e drejtësisë nëse të gjitha veprat që kryhen ndaj personave në marrëdhënie familjare të trajtoheshin në kuadër të Nenit 248 për të shmangur dilemat rreth kualifikimit të veprës penale dhe atë ngjashëm me rregullimin që ligjvënësi ka bërë te Neni 128<sup>266</sup> paragrafi 1 i KPRK-së. Kjo mënyrë e rregullimit do të mundësonte që dhuna në familje të pasqyrohet në të gjitha format e saj ashtu që nëse plotësohen elementet e veprave bazë kualifikimi të bëhej sipas atij neni, por të mos mungojë ndërlidhja me Nenin 248 vetëm me qëllimin për të përfshirë në kuadër të përkufizimit Dhunë në familje, por duke ruajtur sanksionin sipas nenit përkatës. Natyrisht, po i njëjti Nen do të duhej ta ruajë edhe përkufizimin për format më të lehta të veprave në kuadër të marrëdhënies familjare për të demotivuar përshkallëzim të mëtutjeshëm të këtyre veprave. Megjithatë, ngelet të presim se si ligjvënësi do ta rregullojë përfundimisht këtë çështje e më pas të gjejnë mënyrën më të mirë të zbatimit në praktikë.

## A. Pikënisja

Për shkak të larmisë së çështjeve që rregullon ky kapitull me plotësim ndryshimet e fundit të KPRK-së, dhe dënimeve të parapara, por edhe për shkak të ndjeshmërisë së çështjeve të rregulluara, është mjaft e vështirë të tërhiqet një paralele e saktë në mes pikënisjes për veprat nga ky kapitull dhe përcaktimit të pikënisjes në mënyrë uniforme. ***Megjithatë pikënisja prej ½ paraqet kompromis adekuat për të gjitha veprat e kësaj natyre për të trajtuar më pas rrethanat shumë specifike për kategori të caktuara të këtyre veprave.*** Veprat brenda këtij kapitulli (me përjashtim të Nenit të ri 248/A) janë të një ndjeshmërie shumë të lartë duke pasur parasysh se prekin familjen që është celula e shoqërisë.

<sup>265</sup> Marrë nga Udhëzimi i Gjykatës Supreme lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Gj.A.113/2020, 12.06.2020.

<sup>266</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 128, Përkufizimet për dispozitat e terrorizmit në nenet 114-139, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

## B. Rrethanat rënduese

Kur është fjala për rrethanat rënduese lidhur me veprat e mbuluara në këtë kapitull, janë të aplikueshme shumica e rrethanave të cilat tashmë janë trajtuar edhe në Kapitullin e veprave kundër integritetit seksual më sipër, përfshirë edhe ato të shtuara me plotësim ndryshimet e KPRK-së.

Karakteristikë e v.p. nga ky kapitull është se përgjithësisht, shumica nga këto vepra kryhen nga anëtarët e familjes respektivisht nga personat me të cilët kryesi është në marrëdhënie familjare (si koncept më i gjerë sesa ‘Anëtari i familjes’) andaj me rastin e referimit në rrethana rënduese sidomos kur është fjala për rrethanën nga par. 2.14 i Nenit 70 të KPRK-së, gjykata duhet të ketë parasysh nëse marrëdhënia familjare mes kryesit dhe viktimës paraqitet si element i veprës penale pasi e njëjta nuk mund të dyfishohet me rrethanën e njëjtë rënduese. Ndryshe qëndron rasti kur në nene do të kishte referim në viktimën e ndjeshme të përkufizuar me Nenin 113 par. 39 të KPRK-së pasi ky përkufizim shtrihet përtej marrëdhënies familjare.

*Shkalla e dëmit të shkaktuar dhe ndikimi psikologjik.* - Vlerësimi adekuat i kësaj rrethane nuk duhet të kufizohet vetëm në lëndimet fizike, por duhet të përfshijë edhe lëndimet e natyrës psikologjike. Kjo mund të përfshijë edhe implikimet psikologjike afatshkurta apo afatgjata dhe aftësinë e viktimës së caktuar për t’u rimëkëmbur pas veprës. Dhuna psikologjike ndaj viktimës në marrëdhënie familjare ndonjëherë mund të përbëjë lëndimin më të rëndë për të. Megjithatë, gjykata duhet të ketë parasysh se në kuadër të nenit 248<sup>267</sup> është përfshirë edhe dhuna psikologjike si një nga katër format e dhunës ndaj anëtarit të familjes. Andaj, në rastet kur kemi të bëjmë me veprat e kualifikuara sipas Nenit 248, dhuna psikologjike e ushtruar nuk mund të dyfishohet edhe si rrethanë rënduese edhe si element. Në rastet tjera, kur vepra e ushtruar ndaj anëtarit të familjes është kualifikuar sipas ndonjëres nga veprat bazë p.sh. lëndim i lehtë trupor nga Neni 185, dhuna e vazhdueshme psikologjike e ushtruar ndaj viktimës mund të merret në konsideratë për ashpërsim, për faktin se përmes dhunës psikologjike si rrethanë faktike<sup>268</sup> shprehet edhe niveli i dashjes së të pandehurit.

Mjekësia bashkëkohore dhe sistemet e zhvilluara juridike e pranojnë se dëmi psikologjik me kalimin e kohës mund të ketë ndikim permanent dhe afatgjatë në viktimën. Dëmi psikologjik vazhdon edhe për shumë kohë pas zhdukjes së gjurmëve të dhunës fizike. Kjo mund të merr disa forma dhe të diagnostikohet si një mori e gjerë e gjendjeve mjekësore shumica prej të cilave janë të përhershme dhe me efekte të mëdha negative. Ndonëse kjo është e rrallë, ka raste kur dhuna fizike në historikun e marrëdhënies është minimale apo nuk ekziston fare. Kjo nuk nënkupton se historiku i marrëdhënies nuk duhet të merret parasysh. Ndikimi i dëmit psikologjik dhe emocional duhet të vlerësohet gjatë një periudhe më të gjatë kohore dhe të shqyrtohet me kujdes nga gjykata. Në fund, gjykata duhet të shqyrtojë implikimet psikologjike jo vetëm të veprës së kryer por edhe të marrëdhënies afatgjate dhe implikimeve psikologjike të saj.

*Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar* Dënimi i mëparshëm paraqet një nga elementet më me peshë në matjen e dënimit. Recidivizmi tashmë është përfshirë me rastin e caktimit të pikënisjes më të lartë për kryesit me të kaluar penale. Sa i përket dënimeve të

<sup>267</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 248 Dhuna në familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>268</sup> Kodi Penal, neni 22, shprehet se “*Dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike.*”

mëparshme të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

#### Shkelja e urdhrave të gjykatës

Kryerja e një veprë e cila përfshin edhe shkeljen e urdhrave apo masave mbrojtëse të shqiptuara nga gjykata si në procedurë penale ashtu edhe në procedurë civile mund të ashpërsojë dukshëm dënimin. Urdhrat për mos ngacim, mos kontaktim apo mos përsëritje të dhunës tashmë tregojnë se paraprakisht ka ekzistuar një sjellje e konfirmuar nga ana e të pandehurit, për të cilën sjellje gjykata ka vendosur një urdhër të tillë. Shkelja e urdhrave mund të shkaktojë dëm dhe/apo ankth të konsiderueshëm të viktimës. Kjo gjithashtu shpërfaq mosrespektim për autoritetin e gjykatës dhe rrezikon edhe bindjen ndaj urdhrave tjerë. Mos ashpërsimi i dënimeve për shkelje të urdhrave të gjykatës do ta zbehtë respektimin e përgjithshëm të urdhrave dhe në fakt inkurajon sjellje të tilla në të ardhmen nga ana e të pandehurit.

Përpos rrethanave të sipërpërmendura janë edhe një numër faktorësh dhe rrethanash tjera që nuk janë të përfshira në mënyrë eksplicite në KPRK, por që kanë po të njëjtin indikacion të shkallës së përgjegjësisë dhe të cilat do të duhej të merreshin në konsideratë me rastin e matjes së dënimit. Disa nga to janë:

- Dhuna e mëparshme ndaj po të njëjtës viktimë.
- Hyrja me forcë në shtëpinë/banesën apo vendin ku gjendet viktimja.
- Planifikim domethënës në kryerjen e veprës penale.
- Nëse vepra është kryer në bashkëkryerje
- Përdorimi i alkoolit apo narkotikëve për kryerjen e veprës.
- Eksploatim për qëllime komerciale.
- Përdhosjen dhe turpërimin e viktimës si p.sh. përmes ekspozimit të fotove apo videove të aktit të dhunimit ose shpërndarjes së tyre në rrjete sociale.
- Mbatja në izolim për kohë të zgjatur.
- Rrëmbimi etj.

Të gjitha këto nëse nuk mund të përfshihen si vepër e veçantë apo nëse nuk paraqesin element të ndonjë veprë penale, duhet gjithsesi të merren parasysh me rastin e matjes së dënimit.

#### Përsëritja e dhunës dhe kanosjeve për përdorim të dhunës

E kaluara e dëshmuar e dhunës apo kanosjeve nga i pandehuri në kontekst familjar apo edhe dhunës në baza gjinore është faktor kyç në vlerësimin e peshës së veprës. Dëshmitë për përsëritje të vazhdueshme të sjelljeve të njëjta apo të ngjashme të dhunshme apo kanosjes me dhunë paraqesin indikator si për karakterin e të pandehurit, ashtu edhe për një nivel të rritur të rrezikshmërisë. Sulmet e mëparshme janë të pranueshme për të treguar motivin apo dashjen në raste të dhunës në familje apo edhe dhunës tjetër në baza gjinore edhe kur ato janë kryer kohë më parë. Andaj, e kaluara e dhunshme shpesh është thelbësore në përcaktimin e dënimit adekuat. Kjo i referohet çfarëdo veprë që është kryer më shumë se një herë nga i pandehuri i njëjtë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Nëse personi është përfshirë në dhunë të vazhdueshme kundër partnerit intim përgjatë një kohe, viktimja mund ta ketë bindjen e arsyeshme se rreziku është i pashmangshëm në bazë të shenjave sado minimale të sjelljes të cilat nga perspektiva e gjykatës apo edhe publikut mund të duken plotësisht të parëndësishme. Shembull, nëse i pandehuri shfaq pendim në seancë dhe premtan se nuk do të përsërisë veprën, në anën tjetër në evidencë penale



figuron se i pandehuri është përfshirë në vazhdimësi në sjellje të dhunshme, atëherë për gjykatën mjafton kjo si rrethanë faktike për të kuptuar shkallën e pendesës së tij dhe nëse e njëjta duhet të merret për bazë në matje të dënimit.

Kështu p.sh. në një nga rastet e dhunës në familje të trajtuar nga gjykatat në Kosovë me rastin e vendosjes është marrë parasysh fakti se i pandehuri ka ushtruar dhunë edhe më herët ndaj bashkëshortes së tij:

*“Në rastin konkret kjo gjykatë vë theks në faktin se gjatë bastisjes në shtëpinë e të akuzuarit pas raportimit të dhunës në familje, janë gjetur armët e po ashtu duhet të ritheksohet fakti se i pandehuri nuk ka qenë hera e parë që ka përdorur armë në drejtim të bashkëshortes, pasi që në një rast të mëhershëm të njëjtës me përdorimin e armës ia ka këputur edhe gishtin. Andaj kjo gjykatë ka vlerësuar se pa një sanksion të drejtë penal, ka indikacione se mund të eskalonte situata deri në përfundim fatal.”*

Kjo është rrethanë shumë e rëndësishme pasi që e vë theksin në efektin veçanërisht shkatërrues në viktimën e cila vazhdimisht i nënshtrohet llojit të njëjtë të veprimit kriminal veçanërisht në rastet ku i pandehuri dhe viktima jetojnë në të njëjtën shtëpi.

#### *Përdorimi apo kërcënimi me armë apo mjete tjera të rrezikshme*

Prania e armës në shtëpi shpeshherë është komponent kyç në shkaktimin e frikës te viktima përmes ndjenjës së vazhdueshme të rrezikut. Arma mund të jetë përdorur në ndonjë incident të mëparshëm qoftë të dhunës apo të kanosjes, dhe prania e vazhdueshme e saj nënkupton mundësinë e përhershme që një veprim i tillë të ri përsëritet. Kjo gjithashtu shërben për të parandaluar viktimën që të mos largohet nga agresori apo raportimi i incidenteve të mëparshme pranë organeve kompetente. Hulumtimet tregojnë se përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm apo kanosja për përdorimin e tyre në kontekst të dhunës në familje paraqet indikator të qartë të eskalimit dhe është indikator vendimtar në përfundimet fatale. Andaj, prania e armës dhe/apo kërcënimi me të duhet të merret në konsideratë në ashpërsim, pa marrë parasysh nëse i pandehuri posedon leje për të. Njëkohësisht, gjykata duhet të ketë parasysh se natyra e veprës penale apo shkalla dhe natyra e lëndimit nuk është faktor relevant. Kjo duke marrë parasysh se edhe Konventa e Stambollit<sup>269</sup>, e cila nga viti 2020 është bërë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>270</sup>, në nenin 46 ka rekomanduar përfshirjen e rrethanës kur vepra është kryer me përdorimin apo kërcënimin e armës, si rrethanë rënduese te veprat penale të dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje.

#### *Përsëritja e veprave kundër së njëjtës viktimë*

Është me rëndësi të theksohet efekti veçanërisht shkatërrues në viktimën e cila vazhdimisht i nënshtrohet llojit të njëjtë të sjelljes apo veprimit kriminal përgjatë një periudhe të caktuar kohore. Përsëritja gjithmonë do të ketë ndikim të konsiderueshëm në ashpërsimin e dënimit, posaçërisht kur merret parasysh nëse rrethanat arrijnë nivelin e mënyrës posaçërisht mizore. Përsëritja më së shpeshti ndodh në raste të dhunës në familje, ku lëndimi dhe dëmi i përgjithshëm shkaktohet gjatë një periudhe të gjatë kohore, e cila mund të përfshijë zbrazëtira të konsiderueshme në kohë ndërmjet veprimeve të caktuara. Ndonëse kohëzgjatja ndërmjet veprimeve është relevante, ajo nuk duhet të merret për të ndarë apo përjashtuar dëmin e shkaktuar nga një episod prej tjetrit. Gjykata duhet të merr parasysh llojin e veprës, objektin e veprës dhe qëllimet e të pandehurit gjatë

<sup>269</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, Neni 46, pika g., 11 maj 2011.

<sup>270</sup> Amendament i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nr. 07-v-058, Amendamenti nr.26, 25 shtator 2020

vlerësimit nëse një veprim i caktuar duhet të konsiderohet në lidhje me veprën aktuale. Për më tepër, nëse një veprim nuk është teknikisht i mundur për të ashpërsuar dënimin si recidivist, kjo nuk do të thotë se veprimi i tillë duhet të injorohet. Ai mund të jetë i rëndësishëm për kualifikimin e veprës si formë e cilësuar.

#### Nëse vepra penale përfshin disa viktime

Ky faktor është domethënës në raste të dhunës në familje ku gjykatat shpeshherë përqendrohen vetëm në marrëveshjet për kujdesin e fëmijëve dhe i injorojnë ndikimin e dhunës në fëmijën i cili është i pranishëm në shtëpi. Nëse fëmija është i pranishëm në shtëpi gjatë veprës, gjykata duhet të shqyrtojë të kaluarën e marrëdhënies dhe ndikimin e saj te fëmija. Edhe nëse vepra për të cilën akuzohet i pandehuri nuk përfshin ndonjë veprim të drejtuar kundër fëmijës, vetë prania e fëmijës mund të konsiderohet si rrethanë rënduese sipas paragrafit 2.5 pasi që fëmija është viktimë shtesë. Me të vërtetuar praninë e fëmijës, gjykata duhet të përcaktojë shkallën e lëndimit dhe të merr parasysh shkallën e ashpërsimit të duhur (ngjashëm me rrethanat kundër viktimës primare). Një gjë e tillë është paraparë edhe me vet Konventën e Stambollit e cila në Nenin 46, te rrethanat rënduese parasheh edhe rastin kur “vepra është kryer kundër ose në prani të një fëmije”.

Është inkurajuese të shihet se edhe në gjykatat tona ka filluar të ndërtohet një praktikë e tillë kur prania e fëmijës merret parasysh në vlerësim të peshës së veprës dhe ndikimit që ajo veprë ka pasur edhe te fëmijët.

*“Në rastin konkret vepra penale është kryer në prani të dy fëmijëve të vegjël dhe për më tepër nga konflikti që ka ndodhur, i pandehuri është arratisur ndërsa e dëmtuara ka ikur nga shtëpia, me ç’ rast të dy fëmijët kanë pasur nevojë për përkujdesje të domosdoshme prindërore kanë mbetur të vetëm në shtëpi në një ambient ku ka pasur edhe armë. Kjo flet më së miri se deri në cilën shkallë ka arritur dhuna e ushtruar nga i pandehuri, me ç’ rast zyrtari policor që ka dëshmuar në shqyrtimin gjyqësor ka shpjeguar se ka qenë në gjendje të tmerrshme derisa kolegët e tij kanë arritur ti qetësojnë fëmijët.”*

Në rastin e sipërpërmendur, gjykata jo vetëm që ka vlerësuar faktin se fëmijët kanë qenë prezent gjatë ushtrimit të dhunës, po njëkohësisht, gjykata ka vlerësuar edhe faktin se fëmijët pikërisht për shkak të kësaj dhune kanë ngelur pa përkujdesje, duke ndikuar kështu në aspektin psikologjik të tyre.

Edhe nëse fëmija nuk i nënshtrohet dhunës fizike, ata shpesh pësojnë trauma emocionale dhe psikologjike nga të jetuarit në shtëpi me babain e tyre i cili keqtrajton nënën e tyre. Ata të cilët rriten duke parë nënën e tyre duke u keqtrajtuar, veçanërisht nga babai i tyre, rriten me këtë model të marrëdhënieve intime në të cilat njëri person përdor frikësimin dhe dhunën ndaj tjetrit për të arritur qëllimin e tij. Ekspertët besojnë se fëmijët të cilët rriten në shtëpi abuzive mësojnë se dhuna është një mënyrë efektive për të zgjidhur konfliktet dhe problemet. Ka gjasa të mëdha që ata do të përsërisin dhunën të cilën e kanë parë si fëmijë gjatë marrëdhënieve të tyre si adoleshentë dhe të rritur dhe përfundimisht edhe gjatë përvojave të tyre prindërore. Fëmijët nga shtëpitë e dhunshme të cilët i nënshtrohen dhunës apo janë dëshmitar të saj gjithashtu janë në rrezik më të lartë nga abuzimi me drogë apo alkool, çrregullimet post-traumatike, delikuenca e të miturve dhe aktiviteti kriminal si të rritur.

Gjykata duhet të shqyrtojë fuqishëm këtë rrethanë rënduese në rastet kur:

- Fëmija apo dëshmitarët (tjerë) kanë qenë fizikisht të pranishëm kur është shkaktuar dhuna.

- Fëmija apo dëshmitarët (tjerë) nuk kanë qenë fizikisht të pranishëm, por kanë qenë në gjendje të dëgjojnë dhunën/keqtrajtimin.
- Fëmija apo dëshmitarët (tjerë) nuk kanë qenë fizikisht të pranishëm dhe nuk kanë mundur të dëgjojnë dhunën/keqtrajtimin, por kanë parë pasojat e saj më vonë.

Gjykata gjithashtu duhet të merr parasysh ndikimin në familjen e viktimës. Kjo gjithashtu mund të jetë mjaft e gjerë. Nuk duhet të përfshijë vetëm lëndimet ndaj anëtarëve të familjes të cilët janë dëshmitarë të veprës (siç janë rastet e dhunës në familje), por gjithashtu duhet të përfshijë edhe ndikimin në anëtarët e familjes të cilët ballafaqohen me pasojat. Kjo mund të përfshijë lëndimin psikologjik, dëmin emocional dhe/ose humbjen e aftësive të mbajtësit të familjes. Kjo rrethanë gjithashtu mund të zbatohet edhe për fëmijët e pranishëm në shtëpi të cilët e shohin veprën siç sqarohet më hollësisht te rrethana 2.5. Përveç kësaj, keqtrajtimi afatgjatë i pranishëm në marrëdhënie mund të shkaktojë lëndim të përhershëm psikologjik, madje edhe në mungesë të lëndimit aktual fizik. Sërish, gjykata duhet të shqyrtojë tërë historikun e marrëdhënies për të arritur deri të niveli i përshtatshëm i ashpërsimit.

#### Keqpërdorimi i besimit në kontekst familjar apo të ngjashëm

Me përfshirjen e rrethanës së re rënduese “marrëdhënies familjare” sipas Kodit të ri penal, është zbehur në masë interpretimi i besimit si rrethanë që mund të konsiderohet në kontekst familjar pikërisht për shkak të mos dyfishimit mes këtyre dy rrethanave. Megjithatë, keqpërdorimi i besimit mund të nënkuptojë lidhje të cilat nuk hyjnë në kuadër të përkufizimit si marrëdhënie familjare po janë aq të ndërlidhura pikërisht për shkak të pritshmërisë dhe besimit që i kushtohet se personi do të ketë kujdes. P.sh. rastet kur i pandehuri mund të jetë kujdestar i fëmijës, dado, trajner, etj. Elementi i përbashkët i këtyre rasteve është që pozita e besimit të ketë një shkallë të lartë të lidhjes me dëmin specifik emocional i cili mund të shfaqet nga keqpërdorimi i këtij besimi.

Besimi nënkupton një pritshmëri të sjelljes së dyanshme e cila tregon konsideratë, ndershmëri, kujdes dhe përgjegjësi. Keqpërdorimi i besimit lidhet me keqpërdorimin e këtij mirëkuptimi i cili mund të bëhet përmes dhunës së drejtpërdrejtë apo keqtrajtimin emocional. Një konsideratë shtesë përfshin vlerësimin e keqpërdorimit të pushtetit në marrëdhënie përmes kufizimit të autonomisë së individit tjetër. Kjo është shpesh një komponentë e situatave të dhunës në familje dhe mund të përfshijë mbajtjen e kontrollit përmes mjeteve psikologjike, fizike, seksuale, financiare apo emocionale.

#### Provokimi në kontekst të abuzimit familjar

Abuzuesit shpesh thirren në provokim si rrethanë lehtësuuese. Gjykata duhet të shqyrtojë me kujdes pretendimin e provokimit në kontekst të dhunës në familje, duke marrë parasysh faktin se abuzuesit shpeshherë e konsiderojnë si provokim çfarëdo kërcënimi të aftësisë së tyre për të kontrolluar viktimën. Në anën tjetër, partneri i rrezikuar i cili është kundërpërgjigjur ndaj abuzuesit të saj mund ta ngritë çështjen e provokimit bazuar në historinë e kaluar të dhunës së abuzuesit. Konsiderata e parë është nëse pala e cila pretendon provokimin është abuzuesi apo partneri i rrezikuar i cili është kundërpërgjigjur. Pretendimet e tilla duhet të trajtohen me kujdes të madh, si në vërtetimin nëse ato pretendime kanë bazë faktike ashtu edhe në vlerësimin nëse sjellja e pretenduar përbën provokim të mjaftueshëm për ta zbutur seriozitetin e veprës. Kjo kërkon që gjykata të merr parasysh tërësinë e informacioneve lidhur me natyrën e marrëdhënies së dhunës në familje.

“Provokimi” i të pandehurit nga partneri i rrezikuar përmes refuzimit për t’iu bindur rregullave të të pandehurit, siç është përfshirja romantike me personin tjetër, apo përqeshja e të pandehurit, nuk përbën provokim. Gjithashtu, kanosja për t’u larguar nga marrëdhënia, mosbindja e viktimës, apo çfarëdo shkelje e “nderit” të abuzuesit, qoftë e vërtetë apo e perceptuar, nuk përbën provokim.

Për ta konsideruar provokimin si rrethanë lehtësuese për partnerin e rrezikuar i cili kundërpërgjigjet, zakonisht duhet të ketë dhunë të pranishme apo të prishme – përfshirë keqtrajtimin psikologjik. Provokimi është rrethanë lehtësuese më e fuqishme në këtë kontekst nëse provokimi ka zgatur për një periudhë të konsiderueshme kohore. Së fundi, gjykata duhet të përcaktojë nivelin e provokimit të përjetuar nga partneri i rrezikuar që është kundërpërgjigjur. Si shembull, paragrafi 4 i nenit 185 të Kodit Penal e ka paraparë ndikimin e provokimit ekstrem në raste të lëndimit trupor: “Gjykata mund të shqiptojë vërejtjen gjyqësore ndaj të pandehurit të veprës nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse kryesi është provokuar nga sjellja çnjerëzore apo e vrazhdë e të dëmtuarit”. Shembulli nga Neni 185 është paraqitur si ilustrim për rëndësinë e provokimit të paraparë nga vet ligjvënësi. Megjithatë, duhet kujdes të mos ketë dyfishim duke e përfshirë edhe si element por edhe si rrethanë lehtësuese.

### C. Rrethanat lehtësuese

Peshimi adekuat i rrethanave lehtësuese në raport me rrethanat rënduese dhe llojit dhe peshës së veprës penale është shumë me rëndësi tek veprat e kësaj natyre. Ka rrethana që përdoren në praktikë për veprat e këtij kapitulli por që të njëjtat janë plotësisht jo relevante.

*Kërkim falja apo përgjithësisht edhe shprehja e pendimit të* të pandehurit sikurse edhe te veprat kundër integritetit seksual duhen shikuar me një dozë të madhe të kujdesit, pikërisht për shkak të dëmit që rezulton nga to.

*Rrethanat personale, karakteri dhe bashkëpunimi me organet e drejtësisë* -Karakteri i mirë i të pandehurit, paraqitet si rrethanë shumë e shpeshtë në favor të zbutjes për të pandehurin në rastet e dhunës në familje. Gjykata duhet të jetë veçanërisht skeptike ndaj kërkesave për zbutje të dënimit për shkak të karakterit të mirë. Njëra nga dinamikat e këtyre marrëdhënieve që mundëson vazhdimin e pavërejtur të dhunës në familje për periudha të gjata është aftësia e të pandehurit për t’i pasur dy personalitete. Personaliteti i shfaqur në komunitet, zakonisht është plotësisht i ndryshëm në krahasim me personalitetin e shfaqur në kontekst të marrëdhënies. Gjykata duhet të merr parasysh vetëm karakterin e të pandehurit që ka të bëjë me marrëdhënien. Nëse ka incidente të vazhdueshme të dhunës në familje, kjo rrethanë nuk është fare relevante dhe nuk do të duhej të merret parasysh. Partnerët abuziv shpesh e paraqesin veten mirë, pasi që janë manipulativ dhe të shkathët në ruajtjen e kontrollit.<sup>271</sup>

Në praktikë ka raste kur për ulje të dënimit merret në konsideratë “*niveli i ulët arsimor i të pandehurit*”. Është e arsyeshme nëse Gjykata mundohet ta arsyetojë marrjen parasysh të kësaj rrethane, vetëm në kontest të vlerësimit të aftësisë së kryesit për të kuptuar peshën e veprimeve të tij/saj, njëjtë sikurse do të ishte rasti i marrjes parasysh të moshës, por jo vetëm pse kryesi ka shkollim më të ulët. Andaj, arsyetimi i duhur i vendimit është më se i domosdoshëm për të kuptuar logjikën prapa vendimmarrjes së tillë të gjykatës.

---

<sup>271</sup> Doracaku i dhunës në familje për gjyqtarë dhe prokurorë, Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, par.10.6.4. Prishtinë (2016), fq. 76.

#### D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera.

Ashtu siç është potencuar në kapitujt tjerë, Gjykata me rastin e matjes së dënimit duhet të ketë parasysh përshtatshmërinë dhe përpjesëtueshmërinë e dënimit me veprën e kryer.

- Shqiptimi i dënimit me kusht - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për disa nga format më të lehta të veprave nga ky nen. Duhet pasur parasysh gjithnjë çështjet që lidhen me shkallën e rrezikshmërisë kur është fjala për rastet e dhunës në familje. Dënimi me kusht nuk duhet të merret parasysh kur kemi shkelje të urdhrin mbrojtës, në veçanti kur akti që e përbën shkeljen është i natyrës së dhunshme. I pandehuri në këto raste tashmë ka shfaqur mosbindje ndaj urdhrave të gjykatës duke mos e respektuar Urdhrin Mbrojtës. Shkelja e dënimit me kusht/obligimeve të parapara me këtë dënim duhet gjithsesi të merret parasysh me rastin e vendosjes. Me rastin e shqiptimit të dënimit nga neni 244, gjykata duhet të ketë parasysh edhe paragrafin 4 i cili parasheh që, krahas shqiptimit të dënimit me kusht, gjykata mund të urdhërojë edhe kryesin të paguajë rregullisht dhe të përmbush detyrimet e kujdesit, arsimimit dhe mjeteve të jetesës.<sup>272</sup> I njëjti parim vlen edhe për Nenin 245 të KPRK-së përveç se në këtë të fundit shton edhe obligimin për pagimin e detyrimeve të papaguara.<sup>273</sup>
- Shqiptimi i urdhrin për punë me dobi të përgjithshme – po ashtu mund të gjejë zbatim nëse ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat e arsyetojnë dënimin me burgim.
- Shqiptimi i dënimit me gjobë - Shqiptimi i këtij dënimi, në të shumtën e rasteve, nuk është i arsyeshëm te veprat ku kryesi është anëtar i familjes nëse kjo ka ndikim në anëtarin (viktimën) i cili ka varësi financiare ndaj kryesit.
- Shqiptimi i dënimeve plotësuese – sa i përket shqiptimit të dënimeve plotësuese vlejné pothuajse të njëjtat parime sikurse janë elaboruar edhe në Kapitullin për veprat penale kundër integritetit seksual. Sa i përket veprave penale të dhunës në familje Neni 62 i KPRK-së ka paraparë po ashtu edhe ndalimin e ushtrimit të funksionit në administratë publike apo shërbime publike prej 1-5 vjet në cilindo rast kur këta zyrtarë dënohen për dhunë në familje. Ky dënim shqiptohet pa marrë parasysh nëse personi zyrtar dënohet me burgim efektiv apo me kusht.<sup>274</sup>
- Konfiskimi i armës - Sipas Ligjit për armë, një person nuk mund të marrë pëlqim për blerje të armës<sup>275</sup> dhe të pajisjet me leje<sup>276</sup> nëse, mes tjerash, ai paraqet rrezik për vetvete, rendin publik dhe sigurinë publike.<sup>277</sup> Po i njëjti Ligj sqaron përkufizimin e rendit dhe sigurisë publike sipas të cilit edhe dënimi i plotfuqishëm për dhunë në familje hyn në kuadër të këtij përkufizimi andaj në këto raste personit mund ti konfiskohet edhe leja valide, pikërisht për shkak të rrezikut që mund të paraqesë ky person.<sup>278</sup>

<sup>272</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 244 Shkelja e detyrimeve familjare paragrafi 4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>273</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 245 Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës paragrafi 4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>274</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 62 Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, paragrafi 4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>275</sup> Ligji Nr.05/L-022 për armë, Neni 7 Kërkesa e personit fizik për blerjen e armës; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.25, 19 gusht 2015, Prishtinë.

<sup>276</sup> Mu aty, Neni 18, Leja për armëmbajtje.

<sup>277</sup> Mu aty, Neni 10 Rreziku për rendin dhe sigurinë publike.

<sup>278</sup> Mu aty, Neni 38 Konfiskimi i licencës, lejes dhe armës.

## **IX. Kapitulli XXII Veprat penale kundër shëndetit publik**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Kodi Penal i Kosovës në Kapitullin e XXII ka përcaktuar veprat penale kundër shëndetit publik dhe objekt mbrojtës i këtyre veprave penale është shëndeti i njerëzve në përgjithësi, por edhe i personave veç e veç. Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Kodi Nr.06/L-074 ka përcaktuar format themelore të inkriminimit ligjor, kurse si pjesë përbërëse e veprave penale është përcaktuar përmes normave blankete të cilat mbështeten në disa ligje mes tyre: Ligjin për Shëndetësi –Ligji Nr. 04/L-125, Ligji për Veterinari- Ligji Nr.2004 / 21, Ligji për Ushqimin, NR. 08/L-120, Ligji për Produkte dhe Pajisje Mjekësore - Ligji NR. 04/L -190, si dhe një mori ligjesh nga kjo sferë. Përndryshe, në dispozitat ligjore të këtyre veprave penale janë vepra të cilat përfshijnë vepra penale që mbrojnë shëndetin e një grupi të njerëzve, por edhe të popullatës në tërësi, po ashtu përmes disa dispozitave ligjore në këtë kapitull mbrohet jeta dhe shëndeti i kafshëve dhe veprimtaria e pandërgjegjshme me rastin e trajtimit të tyre.

Në këtë kapitull përfshihen tetëmbëdhjetë vepra penale: Përhapja e sëmundjeve ngjitëse (neni 249 ), Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë ( neni 250), Përhapja e sëmundjeve venerike (neni 251), Përhapja e virusit HIV (neni 252), Punësimi i personave të infektuar me sëmundje ngjitëse (neni 253), Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor ( neni 254), Mosdhënia e ndihmës mjekësore (neni 255), Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike (neni 256), Eksperimentet e kundërligjshme mjekësore dhe testimi i barërave (neni 257), Përgatitja dhe dhënia e pandërgjegjshme e barërave (neni 258), Transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore (neni 259), Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore (neni 260), Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë (neni 261), Kontrolli i pandërgjegjshëm i produkteve shtazore të destinuara për konsumim (neni 262), Dhënia ose përdorimi i certifikatës së rreme të mjekut apo të veterinarit (neni 263), Ndotja e ujit të pijshëm (neni 264), Ndotja e artikujve ushqimorë që përdoren nga njerëzit apo kafshët (neni 265), Shërbimi me pije alkoolike i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 266).

Karakteristikën themelore të këtyre veprave penale e përbën fakti se pjesa dërmuese e tyre kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të popullatës në përgjithësi, por edhe të personave të ndonjë kategorie të caktuar apo të pacaktuar, kurse disa vepra penale kanë për qëllim ruajtjen e jetës apo të shëndetit të kafshëve. E veçantë e këtyre veprave penale paraqet fakti se mund të kryhet nga çdo person, mirëpo edhe nga persona të cilët kanë cilësi të caktuar, siç janë mjekët, apo personeli mjekësor, veterineri, farmacisti. Shumë nga veprat e këtij kapitulli kanë potencialin e shkaktimit të dëmit në shkallë të gjerë, andaj edhe trajtimi adekuat i tyre është mjaft me rëndësi. Po ashtu, veprat si p.sh. Ndotja e ujit të pijshëm nga neni 264 i KPRK-së ka mundësi të trajtohet edhe në aspekt të veprave terroriste nga Kapitulli XIV andaj edhe duhet trajtuar me seriozitetin e dëmit të pretenduar apo shkaktuar. Shumë nga këto vepra mund të kryhen si rrjedhojë e veprimeve

korruptive, andaj edhe Udhëzuesi për veprat penale të korrupsionit<sup>279</sup> të njëjtat çështje i ka trajtuar në kuadër të vlerësimit të shkallës së dëmit. Ka edhe vepra nga ky nen si p.sh. Neni 260 Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore të cilat për shkak se kanë të bëjnë pikërisht me produktet mjekësore, mund të konsiderohen si vepra shumë të ngjashme me veprat me narkotikë sipas Kapitullit XXIII, kjo për faktin se ekziston një potencial i lartë i keqpërdorimit të substancave mjekësore si zëvendësim të substancave narkotike apo për të manipuluar me efektin e këtyre të fundit. Andaj, si të tilla, duhen trajtuar me seriozitetin e duhur varësisht nga shkalla e rrezikshmërisë që këto vepra paraqesin.


Duke marrë parasysh se në këtë kapitull janë paraparë disa vepra penale të llojeve dhe karakteristikave të ndryshme, atëherë edhe përcaktimi i dënimeve është mjaft i ndryshëm si te dënimet me burgim gjithashtu edhe te dënimet me gjobë. Te dënimet e përcaktuara me gjobë është karakteristike se te të gjitha veprat penale nuk është përcaktuar as minimumi dhe as maksimumi ashtu që në këto raste aplikohet minimumi dhe maksimumi i përcaktuar ligjor.

Sa i përket dënimeve me burgim gjithashtu ka mjaft hapësirë të gjerë mes minimumit dhe maksimumit të tij dhe gjithashtu kryesisht paraqitet në dy forma dhe atë në formën ku nuk është përcaktuar fare minimumi ligjor por vetëm maksimumi i tij, kurse te disa vepra tjera është përcaktuar kufiri në mes minimumit dhe maksimumit që është një kufi mjaft i lartë e që për dy vepra penale është një margjinë e lartë e dënimit duke filluar nga tre (3) muaj e deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Duke analizuar këtë diversitet të lartë mes dënimeve të përcaktuara, si për dënime me gjobë e po ashtu edhe me burgim, atëherë del se gjykatat kanë një mundësi të madhe të shqiptimit të dënimeve jo konsistente dhe pa dyshim se aplikimi i udhëzuesit paraqet një domosdoshmëri.

#### A. Pikënisja

Me qëllim të harmonizimit të qasjes në matjen e dënimit për këto vepra penale, atëherë për tri situata të ndryshme ofron rekomandimin për pikënisjen e matjes së dënimit duke pasur parasysh shkallën e dënimit, specifikat dhe cilësitë e kryerësve të veprave penale:



<sup>279</sup> Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Gjykata Supreme, fq.34-38, 10 qershor 2021, Prishtinë, trajtuar edhe në Udhëzuesin e përgjithshëm për matjen e dënimit fq.86(te konfirmohet faqja pas finalizimit te tekstit

*-pikënisja nga 1/3 për rastet kur kryerësit e veprave penale nuk kanë të kaluar penale, përkatësisht nuk kanë qenë më parë të dënuar. Andaj, në këto situata konsiderojmë se do të ishte e përshtatshme pika nga 1/3 e maksimumit të dënimit.*

*-pikënisja nga 1/2 për rastet kur kryerësit e veprave penale kanë të kaluar penale, përkatësisht kanë qenë më parë të dënuar për vepra të kësaj natyre dhe në rastet kur kjo vepër penale kryhet me qëllim të përfitimit pasuror. I njëjti parim vlen edhe për rastet kur është fjala për personat juridik si kryes të veprave penale,<sup>280</sup> atëherë duhet pasur parasysh edhe kriteret e përcaktuara në nenin 10, paragrafi 2 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.<sup>281</sup> Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Gjatë caktimit të dënimit, gjykata në veçanti do të merr parasysh se a është dënuar personi juridik për vepër penale, vepra penale e kryer më parë, a është e njëllajtë me veprën e re penale dhe sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm”.*

*-kurse pikënisja nga 2/3 për rastet kur kryesit e veprave penale veprojnë si pjesë e grupit të organizuar kriminal, mirëpo duhet pasur parasysh që karakteristikat e lartë cekura të mos jenë të inkuorporuara në veprat e veçanta penale.*

Figura e mësipërme tregon qartazi dallimin mes formave të ndryshme të matjes së dënimit për këto vepra bazuar në dënimet që parashihen për këto vepra penale dhe varësisht nga natyra dhe pasojat që rezultojnë nga veprimet e ndërmarra përmes këtyre veprimeve.

## **B. Rrethanat rënduese**

Te këto vepra penale vijnë në shprehje disa nga rrethanat rënduese të parapara me nenin 70 par. 2 të KPRK-së, ngase siç është thënë edhe me lart disa nga këto vepra penale kryhen me dashje, por me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese duhet pasur parasysh faktin që të mos cilësohen si rrethana rënduese elementet e veprave penale të format kualifikuese të tyre. Me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese duhet pasur parasysh se ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e KPRK-së edhe në këtë Udhëzues se rrethanat rënduese nuk janë të natyrës shteruese dhe decidivisht të përcaktuara, andaj, gjykata ka diskrecion të paraqesë edhe rrethana të tjera varësisht nga kryerësi dhe vepra penale. Rrethanat rënduese për veprat penale sipas këtij kapitulli mund të jenë të natyrave të ndryshme dhe secili rast mund të ketë specifikat e veta.

Kurse duke pasur parasysh dispozitën e nenit 70 par. 2 të KPRK-së mund të konkludojmë se nga lista e këtyre rrethanave rënduese të përcaktuara disa nga ato mund të aplikohen edhe për këtë kapitull të veprave penale dhe atë:

- Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale- kjo rrethanë është zberthyer pothuajse në çdo kapitull dhe të njëjtat argumente sa i përket kryesit në rastin në fjalë

---

<sup>280</sup> Në nenin 112 të KPRK-së është parashikuar se “Veprat penale për të cilat personi juridik mund të jetë penalisht përgjegjës, përgjegjësia penale e personit juridik, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personit juridik dhe dispozitat e posaçme që rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik parashihen me ligj të veçantë”.

<sup>281</sup> Ligji Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale i datës 31.08.2011.



vlejnë edhe për këtë. Pra dënimi për individin si pjesë e grupit kriminal duhet bazuar në formën e angazhimit në kryerjen e asaj veprë dhe angazhimi/roli më i madh duhet të reflektohet me dënim proporcional dhe adekuat me atë angazhim.

- Shkallën e lartë të dashjes – Edhe pse dashja paraqitet si element i veprës penale në disa nga veprat nga ky kapitull, gjykata jo rrallë lëshohet në trajtimin e shkallës së dashjes për të përcaktuar edhe nivelin e përgjegjësisë së kryesit.
- Prezencën e dhunës dhe kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale - Kjo rrethanë paraqet bazë për t’u vlerësuar si rrethanë rënduese në rastet kur dhuna dhe kanosja paraqesin mjet për tu realizuar këto vepra penale dhe fakti se mjetet e përdorura për nga natyra dhe destinimi i tyre janë të rrezikshme, por kjo rrethanë nuk duhet të aplikohet në rastet kur këto rrethana paraqesin elementin kualifikues të veprave tjera penale, meqë do të dyfishohej rrethana rënduese.
- Nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore - Mënyra e kryerjes së veprës penale në këtë mënyrë mund të vjen në shprehje të disa vepra penale të caktuara penale dhe se veprimi i kryerjes duhet të jetë i natyrës mizore, pra të tejkalojë rrethanat e zakonshme përmes së cilave shkaktohet lëndimi i rëndë trupor apo vdekja e personit. Kjo rrethanë mund të paraqitet duke u bazuar në mënyrën e kryerjes dhe është e përcaktuar përmes përdorimit të metodave mjekësore dhe kjo me qëllim të shkakimit të vuajtjeve të cilat janë të një shkalle më të lartë se sa vuajtjet e zakonshme.
- Nëse vepra penale përfshinë disa viktime - Kjo rrethanë paraqet bazë për t’u vlerësuar si rrethanë rënduese në rastet kur përmes veprimtarisë së caktuar të veprat penale sipas këtij kapitulli përfshijnë një numër të madh të viktimave, natyrisht gjithnjë përderisa të mos jetë element i veprës. Megjithatë ka dallim të madh në mes rasteve kur dëmi ndikon masivisht në popullatë nga rastet kur ndikon në një numër të kufizuar. Si rrethana tjera rënduese mund të konsiderohen nëse vepra është kryer në vazhdimësi ndaj viktimës së njëjtë, shkallën e vuajtjes dhe poshtërimit të shkaktuar, si dhe pamundësia e mbrojtjes së viktimës.
- Nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndieshme - Kjo rrethanë paraqet bazë për t’u vlerësuar si rrethanë rënduese në rastet kur përmes këtyre veprave penale ndërlihet me personat e pambrojtur dhe të ndjeshëm dhe kjo si rezultat i veprimtarisë së caktuar të veprat penale sipas këtij kapitulli dhe kjo mund të vjen në shprehje të personat me cilësi të caktuara, përkatësisht fëmijë të moshës së mitur, gra shtatzëna, persona të shtyrë në moshë dhe gjithashtu edhe ndonjë kategori të njerëzve të cilët kanë predispozita për të qenë të pambrojtur apo të ndjeshëm.
- Mosha e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar - Mosha e viktimës, gjegjësisht mosha e tij e re apo e moshuar, paraqet rrethana të cilat mund të aplikohen të ky kapitull i veprave penale, posaçërisht duke pasur parasysh faktin se këto kategori shpesh herë mund të dëmtohen apo rrezikohen përmes këtyre veprave penale, si rrethanë rënduese mund të aplikohet kur dënohet shëndeti apo jeta e foshnjave apo personave nën përkuajtje që janë të moshës së shtyrë.
- Shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes të viktimeve apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar ndaj viktimës ose familjes së tij - Kjo rrethanë mund të aplikohet vetëm në rastet kur këto rrethana nuk paraqesin elemente kualifikuese të kësaj veprë penale, meqë shumica e këtyre rrethanave janë pjesë përbërëse e veprave penale.
- Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar – Recidivizmi është përfshirë në kuadër të llogaritjes së pikënisjes si më sipër. Megjithatë, sa i përket dënimeve të mëparshme të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të

KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

- Nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo veprë penale të kryer ndaj personit, grupit të personave ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale - Këto rrethana janë mjaft specifike dhe mund të aplikohen te ky kapitull i veprave penale në raste kur veprat penale janë kryer me qëllim të ndonjë motivi të përcaktuar apo karakteristikave të theksuara te kjo formë e rrethanave që merren parasysh. Si rrethanë hyn në kuadër të rrethanave që tregojnë përgjegjësi të shtuar të kryesit.

### C. Rrethanat lehtësuese relevante

Disa nga rrethanat lehtësuese të parapara me nenin 70 par. 3 të KPRK-së janë relevante për aplikim për këtë kategori të veprave penale dhe këto rrethana duhet të çmohen varësisht nga personaliteti i kryesit dhe rrethanat e tilla specifikisht mund të aplikohen për këtë kapitull të veprave penale:

- rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar - Kjo rrethanë mund të çmohet si rrethanë lehtësuese në rastet kur ekzistojnë rrethana të mira personale dhe posaçërisht vjen në shprehje me rastet e pendimit për veprën penale të kryer dhe kjo e shoqëruar me premtimin e tij se nuk do të përsëritë vepra të kësaj natyre e as vepra tjera penale. Karakteri i mirë, vlerësohet nga vlerësimi i aspekteve siç janë reputacioni, kredibiliteti, personaliteti dhe sjellja shoqërore e të akuzuarit, zakonisht kanë për qëllim që të tregojnë se vepra e kryer është jashtë karakterit dhe kjo ndërlihet me informacionet lidhur me jetën e të akuzuarit, të kaluarën dhe karakteristikat e tij.
- dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale - Përcaktimi i kësaj rrethane duhet të ndërlihet me shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit tjetër dhe me rastin e vlerësimit të veprimeve mes këtyre personave përcaktohet edhe roli i tij më i ulët dhe i cili mund të manifestohet edhe përmes sjelljes së tij duke shprehur një dozë të pendimit.
- fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër - Gjithashtu edhe kjo rrethanë gjen aplikim në rastet kur pjesëmarrja e tij nuk është si kryerës kryesor, por në mënyra të ndryshme kontributi i tij është më i vogël në kryerjen e veprës penale. Mirëpo kjo rrethanë nuk vlen në rastet kur kryes të këtyre veprave penale janë persona me këtë cilësi, si p.sh. personi tjetër i autorizuar, punonjësi tjetër shëndetësor etj.
- mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar - Mosha e personit duhet çmuar si rrethanë lehtësuese në rastet kur i njëjti është person i ri, meqë kjo zakonisht paraqet një papjekuri të tij për të kuptuar natyrën e këtyre veprave penale, kjo rrethanë mund të çmohet edhe te personat e moshuar duke e ndërlihet vlerësimin edhe me gjendjen shëndetësore.
- bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar; bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale - Bashkëpunimi mund të çmohet si rrethanë lehtësuese por ky kontribut duhet të jetë i konkretizuar dhe të

rezultojë me pranimin e përgjegjësisë dhe njëkohësisht pendimin e tij. Nëse gjykata e përcakton që bashkëpunimi ka qenë substancial, kjo rrethanë në përgjithësi konsiderohet si e rëndësishme për zbutje pasi që e ndihmon një gjykim më të shpejtë. Në anën tjetër, kur gjyqtarët e përcaktojnë që bashkëpunimi është bërë me ngurrim, sporadik apo i ndërlidhur me ndonjë faktor të jashtëm, zbutja do të jetë më e vogël.

- Pranimin e fajit - Pranimi i fajit, zakonisht çmohet si rrethanë lehtësuese për faktin se përmes kësaj mënyre përfundohet më shpejt gjykimi, pastaj nuk është e nevojshme administrimi i provave që ulë koston kohore dhe materiale të një gjykimi. Mirëpo duhet dalluar fazat e pranimin të fajësisë dhe natyrisht se pranimi i bërë në fazat fillestare paraqet bazë për zbutje më të madhe, kurse pranimi i fajit në fazat e më vonshme paraqet një bazë për zbutje, por që duhet çmuar në masë më të vogël të zbutjes. Gjithashtu duhet vlerësuar se ky pranim a përcillet me pendim të plotë dhe të sigurtë të kryesit, kjo rrethanë duhet gjithashtu të ndërlidhet edhe me një sërë faktorësh tjerë, siç janë sjellja e kryerësit në raport me viktimën, keqardhja e tij apo edhe kompensimi i dëmit të shkaktuar. Sipas praktikës gjyqësore, kjo rrethanë shpesh herë është mbivlerësuar dhe është jo proporcionale në krahasim me rrethanat tjera që tregojnë edhe për llogaritjen e dyfishtë dhe mbivendosjen e saj. Duhet ritheksuar se vet pranimi i fajësisë nuk e zbut me automatizëm dënimin, pa ekzistimin edhe të rrethanave tjera përcjellëse.
- Keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar - Kjo rrethanë mund të çmohet si rrethanë lehtësuese dhe duhet të manifestohet jo vetëm përmes deklaratimit verbal por duhet të argumentohet përmes sjelljeve të kryerësit. Ky vlerësim është qartazi i vështirë, duke e pasur parasysh që kjo rrethanë është e natyrës subjektive, besueshmëria e së cilës varet vetëm nga kryesi. Kërkon nga gjykata që t'i merr parasysh jo vetëm fjalët e kryerësit por edhe provat rrethore dhe konkludimet që mund të nxirren nga veprimet dhe sjellja.
- Sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit - Sjellja e kryerësit pas kryerjes së veprës penale mund të çmohet si rrethanë lehtësuese kur kryerësi manifeston sjellje të mira, qoftë ndaj viktimës apo edhe komunitetit në përgjithësi, duke shprehur pendim për veprimin e kryer dhe si rezultat i pendimit vijon me sjellje të mira duke ndihmuar apo përkrahur një kategori të caktuar të personave apo një institucion përkatës që merret me rehabilitimin e njerëzve të caktuar.

#### **D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera**

Asnjë nga dënimet e mëposhtme nuk konsiderohen të përshtatshme për tu shqiptuar në rastet e personave që edhe me parë kanë kryer vepra penale të natyrës së njëjtë apo është cenuar rëndë shëndeti i një numri të madh të popullatës apo pasojat e këtyre veprave penale kanë lënë pasojat të përhershme të viktimat.

-Shqiptimi i dënimit me kusht - dënimi me kusht mund të shqiptohet te shumica e veprave penale të përcaktuara nga ky kapitull (përjashtojë veprat penale ku maksimumi i dënimit është i përcaktuar me burgim deri në 12 vjet), andaj duke aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit ekziston mundësia e shqiptimit të dënimit me kusht (neni 49 par. 2 i KPRK-së), por edhe për veprat tjera penale për të cilat parashihet dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet, dënimi i kushtëzuar mund të shqiptohet pa aplikimin e dispozitave të zbutjes së dënimit (neni 49 par. 1 i KPRK-së). Mirëpo në këto raste duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe pasojat e shkaktuara me këtë veprë penale. Me rastin e aplikimit të dënimit me kusht, gjithashtu mund të aplikohet edhe detyrimi i përcaktuar me dispozitën e nenit 56 par. 1 nënpar. 1.12 i KPRK-së të

kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale dhe 1.13 të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;

*-Shqiptimi i urdhërit për punë me dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm për veprat brenda këtij kapitulli me maksimumin ligjor prej një (1) viti dhe nëse gjykata për ato vepra penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë* - Në disa vepra penale të përcaktuara në këtë kapitull, parashohin mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë si dënim kryesor dhe atë si dënim alternativ karshi dënimit me burgim. Megjithatë, në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që lartësia e gjobës së caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me dispozitën e nenit 69 par. 5 të KPRK-së dhe po ashtu edhe duke aplikuar Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>282</sup>

*-Shqiptimi i dënimit plotësues<sup>283</sup>* - me përjashtim të dënimeve plotësuese të përcaktuara me nenin 64 dhe 65 të KPRK-së, kryesit të veprave penale nga ky kapitull gjykata mund të i shqiptojë të gjitha dënimet e përcaktuara nga neni 59 i KPRK-së dhe se të gjitha dënimet plotësuese janë të përshtatshme të shqiptohen sipas periudhës së caktuar kohore duke zbatuar dispozitat përkatëse për secilin dënim të përcaktuar. Është veçanërisht i rëndësishëm shqiptimi i dënimeve plotësuese nga nenet 62 dhe 63 kur kryesi kryen veprat nga ky kapitull në keqpërdorim të detyrës zyrtare.

*-Vërejtja gjyqësore* - te ky kapitull i veprave penale mund të shqiptohet në rastet kur parashihet dënim deri në një (1) vit burgim dhe duhet pasur parasysh se vepra penale të kryhet në rrethana veçanërisht lehtësuese.

*-Lirimi nga dënimi* - në këtë kapitull të veprave penale nuk është paraparë me dispozitat e këtij kapitulli, megjithatë duke pasur parasysh se disa nga veprat penale kryhen edhe nga pakujdesia, mund të gjejë zbatim dispozita e Nenit 74 të KPRK-së.

*-Konfiskimi* - në disa vepra penale të këtij kapitulli është përcaktuar konfiskimi obligativ i sendeve, përkatësisht barërave, produkteve mjekësore apo artikujve dhe sendeve të dëmshme.

---

<sup>282</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>283</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 64 e 65, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

## X. Kapitulli XXIII Veprat penale të narkotikëve

### Shqyrtime të përgjithshme

Trafiku me substanca narkotike e në veçanti përzierjet me substanca të reja të rrezikshme të pa listuara në listën e substancave apo prekursorëve, ka pasur rritje në këto vitet e fundit. Fillimi i luftës në Ukrainë në 2022, po ashtu ka bërë ndër të tjera edhe ndryshimin e rrugës së lëvizjes së narkotikëve. Vendet e Ballkanit me këto lëvizje po ashtu janë ndikuar në masë të madhe. Andaj, është shumë e rëndësishme përgjigja e sistemit të drejtësisë ndaj pengimit të këtyre rrjeteve dhe dukurive.


Rritja e konsumit, marketingu, trafikimi dhe kultivimi i substancave narkotike gjatë viteve determinon edhe rritjen e angazhimit dhe përgjigjes adekuate të sistemit të drejtësisë ndaj këtyre dukurive. Kështu për qëllime krahasimi, më poshtë janë dhënë disa shifra ku vërehet trefishim i kallëzimeve penale të pranuara nëpër prokurori përgjatë dekadës së fundit:

2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
374	511	438	725	1061	1556	1328	906	1105	1172

Statistikat e sipërme përfshijnë të gjitha veprat nga Kapitulli XXIII.

Përcaktimi i disa çështjeve parimore dhe kornizave për veprat penale që kanë të bëjnë me narkotikë paraqet një domosdoshmëri sidomos në këtë kohë kur çdo ditë e më tepër dalin në treg variacione të shumta të narkotikëve. Andaj, përmes kësaj pjese do të synohet të tërhiqen disa linja:

- Dallimi në mes llojit të veprës.
- Diferencimi në mes substancave të llojeve të ndryshme bazuar në nivelin e rrezikshmërisë dhe përhapjes.
- Sasia e substancave narkotike, psikotrope apo analoge.
- Çështje tjera përcjellëse që kategorizojnë këto vepra e të cilat janë me rëndësi për matjen e dënimit nga ana e gjykatës.




Për të sqaruar të sipërpërmendurat, Gjykata Supreme do e bazojë praktikën e vet në praktikën e shteteve më të zhvilluara të cilat tashmë kanë ndërtuar një kornizë e cila mund të jetë adekuate edhe për Republikën e Kosovës.

## A. Pikënisja

Natyra e veprës është një përcaktues kritik në caktimin e pikënisjes dhe dënimit final. Është shumë me rëndësi të dallohet nëse vepra është kryer për:

- Posedim personal.
- Kultivim apo prodhim, shpërndarje apo financim të substancave narkotike; apo
- Kultivim, prodhim, shpërndarje apo financim të substancave narkotike me përzierje të rrezikshme.

Edhe brenda secilës nga rrethanat e mësipërme, ka elemente të caktuara të cilat e bëjnë veprën më të rëndë sesa në rastet tjera. Andaj, tri ndarjet e mësipërme janë marrë vetëm në korniza të trasha si faktor me rëndësi në caktimin e pikënisjes.



- Për posedimin personal në sasi të vogla, është caktuar një pikënisje më e ulët krahasuar me kategoritë tjera (1/3).
- Kultivimi/prodhimi/shpërndarja/financimi i substancave fillon me pikënisjen në mesin  $\frac{1}{2}$  e dënimit.
- Pikënisja e tretë është përcaktuar me  $\frac{2}{3}$  pasi këtu fjala është për substanca apo përzierje të substancave të cilat bartin rrezikshmëri më të lartë. Më poshtë, do të gjeni më shumë të dhëna mbi zbërthimin e këtyre elementeve si dhe shembuj se si prezenca e këtyre substancave apo përzierjeve mund të ndikojë në lartësinë e dënimit.

### 1. Llojet e narkotikëve

Lloji i narkotikëve duhet të shërbejë për përcaktimin e dënimit. Kjo pjesë inkorporon në vete disa çështje me shumë rëndësi për tu adresuar më në detaje.

*a. Diferencimi mes drogave me rrezikshmëri të ndryshme*

Në shtetet e zhvilluara dënimi për substanca narkotike përveç tjerash varet nga lloji i substancës dhe rrezikshmëria që ajo bart. Sa i përket KPRK-së, vetëm te Neni 272<sup>284</sup> pasqyron tre llojet të substancave: bimën e hashashit, shkurren e kokainës ose bimën e kanabisit duke paraparë dënimet për kultivimin e tyre. Megjithatë KPRK-ja nuk jep një pasqyrim mbi të gjitha llojet e substancave narkotike që hasen në Kosovë. Ligji për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë<sup>285</sup> ka integruar në shtojcë klasifikimin e barnave dhe substancave narkotike në pajtim me Konventën e vetme të Kombeve të Bashkuara për substancat narkotike<sup>286</sup> të vitit 1961, Konventës për Substanca Psikotrope të vitit 1971<sup>287</sup> dhe Konventës kundër Trafikimit Ilegal të Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope të vitit 1988<sup>288</sup>. Ligji dhe Konventat kanë ndarë kategoritë e substancave në 4 kategori:

- Tabela I - Substancat që kanë rrezikshmëri të lartë dhe që nuk kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë dhe veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë.
- Tabela II- Substancat që kanë rrezikshmëri të lartë dhe që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë dhe veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë.
- Tabela III - Barnat narkotike dhe substancat psikotrope<sup>289</sup> të rrezikshme dhe prekursorët<sup>290</sup> e barnave narkotike, që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë.
- Tabela IV - Substancat që përdoren në prodhimin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope – prekursorët.

*b. Substancat e palistuara dhe lëvizjet në tregun botëror të trafikimit të narkotikëve*

Tabelat e sipërshënuara përfshijnë grupime të përgjithshme të substancave narkotike të cilat më së shpeshti hasen në kuadër të tregut të substancave narkotike si për tregun vendor ashtu edhe në rastet kur Kosova përdoret si vend tranzit për këto substanca. Një problematikë globale e paraqitur në këto vitet e fundit është paraqitja e drogave të reja- opioidë sintetik, të cilët nuk janë të listuara në tabelat e konventave respektive. Edhe te ne në Kosovë, është përcjellur po e njëjta problematikë duke qenë se Ligji i sipërpërmendur nuk është përditësuar që nga viti 2008 kur është miratuar. Duhet ritheksuar se për shkak se lista e substancave është pjesë e Ligjit i cili kërkon një procedurë të tejzgjatur të aprovimit, Republika e Kosovës po mbetet shumë mbrapa sa i përket përfshirjes së substancave të reja të cilat qarkullojnë në treg dhe të cilat paraqesin rrezik për

<sup>284</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 272 Kultivimi i bimës së hashashit, shkurren së kokainës ose bimëve të kanabisit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>285</sup> Ligji nr. 02/L-128, për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë, UNMIK/Reg/2008/10, 19.02.2008.

<sup>286</sup> Konventa e vetme e Kombeve të Bashkuara për substancat narkotike (1961) e ndryshuar me Protokollin e vitit 1972 [United Nations Single Convention on Narcotic Drugs, 1961 as amended by the 1972 Protocol].

<sup>287</sup> OKB, Konventa për substancat psikotrope, 1971 [Convention on Psychotropic Substances, 1971].

<sup>288</sup> OKB, Konventa e OKB kundër Trafikimit Ilegal të Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope të vitit 1988 [UN Convention Against Illicit Traffic in Narcotic Drugs and Psychotropic Substances, 1988].

<sup>289</sup> Ligji nr. 02/L-128, për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë, Neni 2: “Substancë psikotrope nënkupton çdo substancë, natyrore ose sintetike, të paraqitur në Tabelën 3 si shtojcë e këtij ligji të bazuar në Listat I, II, III dhe IV të Konventës mbi Substancat Psikotrope të vitit 1971.”

<sup>290</sup> Ligji nr. 02/L-128, për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë, Neni 2: “Prekursor nënkupton çdo substancë, natyrore ose sintetike, që mund të përdoret për përfitimim e barit narkotik ose substancës psikotrope, të paraqitura në Tabelën IV, të bazuar në Listat I dhe II të Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1988, „Kundër Trafikimit Ilegal të Barnave Narkotike dhe Substancave Psikotrope”, dhe në Rregulloren (EC) Nr 273/2004 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian të datës 11.02.2004 mbi prekursorët. Çdo substancë tjetër e paraqitur në Tabelën IV të këtij Ligji konsiderohet si prekursor;”

shëndetin. Në Evropë, në vit regjistrohen mesatarisht diku rreth 60 substanca të reja dhe që të gjitha ngelen ende pa u regjistruar në Republikën e Kosovës, duke i pamundësuar në këtë formë edhe organeve ligj zbatuese dhe të drejtësisë luftimin efikas të trafikut të tillë.

Tregjet ilegale të drogave të paligjshme po ndryshojnë me shpejtësi, me drogat sintetike të cilat po zëvendësojnë drogat me bazë bimore sa i përket prodhimit, trafikimit, marketingut dhe konsumit. Në këtë kontekst, prodhuesit e drogave të paligjshme kanë zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme mundësitë e tyre për të siguruar burimet e kimikateve që përdorin. Sistemi i krijuar sipas nenit 12 të Konventës së 1988-ës u krijua për të monitoruar tregtinë ndërkombëtare dhe, si i tillë, është një sistem reaktiv kundrejt ritmit të ndryshimit të shpejtë të prodhimit të paligjshëm të drogës sot, si pararendës ose prekursorë të bërë me porosi po përdoren gjithnjë e më shumë për të anashkaluar kontrollat. Përveç kërkimit të mundësive për të zëvendësuar prekursorët e kontrolluar me prekursor të pakontrolluar, industria e paligjshme e drogës po shfrytëzon gjithashtu boshllëqet në tregjet e ligjshme për të rikuperuar prekursorët nga produktet e pakontrolluara që bien jashtë fushës së kontrollit të Konventës së 1988-ës.<sup>291</sup> Rritja e sofistikutimit, diversifikimit dhe shkalla e operacioneve të prodhimit të drogave të paligjshme ka tejkaluar pritshmëritë dhe parashikueshmëritë në kohën e 1988-ës kur u hartua Konventa. Si rezultat, tani nuk ka pothuajse asnjë kufi për gamën e kimikateve dhe metodave të prodhimit që mund të përdoren në prodhimin e paligjshëm të drogës, duke përfshirë ato që më parë konsideroheshin se nuk mund të përdoren në tregun e paligjshëm. Në përgjithësi, kimikatet e përdorura janë marrë nga dy burime furnizimi, secila me implikimet e veta për kontrollat që mund të aplikohen:

- Kimikatet që mund të gjenden në treg dhe që rregullisht tregtohen për qëllime legjitime, si benzaldehidet, methylaminet dhe esteret e acidit fenilacetik; apo,
- Prekursorët e “dizajnuesit” të prodhuara qëllimshëm si të afërm kimik të prekursorëve të kontrolluar dhe që lehtë mund të konvertohen në prekursorë të kontrolluar.<sup>292</sup>

Sipas OKB-së një numër shtetesh kanë vendosur të zgjerojnë listën e substancave të përmendura në mënyrë specifike në ligjin që trajton narkotikët për të përfshirë konceptin e ngjashmërisë “kimike” dhe/apo “farmakologjike” me një drogë të kontrolluar, e cila strukturalisht është e ngjajshme dhe/apo ka efekt të ngjashëm apo më të madhe në sistemin nervor qendror si substancë e kontrolluar, duke e trajtuar kështu si substancë analoge andaj i nënshtrohet të njëjtit kontroll.<sup>293</sup> Edhe vet Komentari i Konventës së 1988-ës kur i referohet Nenit 13 jep shpjegimin si në vijim: “Sipas Nenit 13, palët janë të obliguara të ndërmarrin aso masa që janë të domosdoshme për parandalimin e tregtimit dhe diversionit të materialeve dhe paisjeve për prodhimin e drogave të paligjshme... As fjala “material” as fjala “pajsje” nuk janë të definuara në Konventë, por ato mund

---

<sup>291</sup> Kombet e Bashkuara: Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve; Prekursorët dhe kimikatet që përdoren shpesh në prodhimin e paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope; Raporti i Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve për vitin 2023 mbi zbatimin e nenit 12 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope të vitit 1988, Fjala e Presidentit Jallal Toufiq, fq.iii, janar 2024, Zyra e Kombeve të Bashkuara në Vjenë.

<sup>292</sup> Raporti i Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve (INCB), IV. Opcionet për adresim të proliferimit të prekursorëve jo të listuar të dizajnuesit Options to address the proliferation of nonscheduled “designer” precursors at the international level, The issue #218, 2018

<sup>293</sup> Kombet e Bashkuara, Doracak i OKB mbi drogat sintetike (UN Toolkit on Synthetic Drugs), <https://syntheticdrugs.unodc.org/syntheticdrugs/en/legal/national/analogueleg.html> last accessed on March 21, 2024.



të interpretohen gjerësisht për të përfshirë një spektër të gjerë të mirave,<sup>294</sup> kimikatet jo të listuara dhe prekursorët e rinj.<sup>295</sup> Përkufizimi i substancave analoge është bërë edhe në KPRK, ku shprehja “*analog nënkupton çfarëdo substance e cila nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope dhe i riprodhon efektet e tyre.*”<sup>296</sup>

Në përgjigje të trendëve të shpejtë edhe BE është munduar në forma të ndryshme të adresojë çështjen e drogave të cilat nuk janë të listuara në mënyrë specifike në tabelat e miratuara. Sipas Regullores së BE ... “*substancë jo e listuar*” nënkupton cilëndo substancë e cila edhe pse nuk renditet në Aneks, është identifikuar se është përdorur për prodhim të paligjshëm të drogave narkotike apo substancave psikotrope.<sup>297</sup> Natyrisht, duhet pasur parasysh edhe një nga konsideratat se kontrolli analog mund të ketë pasoja negative të paqëllimta për prodhuesit dhe furnizuesit legjitim të substancave për qëllime mjekësore dhe/ose kërkimore, sepse ata nuk mund të verifikojnë me siguri nëse një substancë që ata prodhojnë ose shesin konsiderohet të jetë një substancë analoge, gjë që i vë në rrezik, në konstatimin nëse substancat e caktuara hyjnë në substanca të rrezikshme.<sup>298</sup>

### c. *Shembuj të përzierjeve të substancave të ndryshme*

Është e rëndësishme që gjykata të jetë gjithashtu e vetëdijshme për shkallën e rrezikshmërisë që mund të bartin disa përzierje substancash, në dukje me rrezik minimal në sasi individuale. Kohët e fundit, ka një shqetësim në rritje në mbarë botën për “drogat e përziara”.<sup>299</sup> Drogat e përziara përfaqësojnë përzierjen e dy ose më shumë substancave, ku një substancë në përgjithësi është një substancë më e lirë. Substancat që “përzihen” në substancat më të shtrenjta quhen përgjithësisht si “agjentë lidhës” ose “adulterants”. Këta agjentë lidhës përgjithësisht përfshijnë kimikate të fuqishme që, në fakt, mund të prodhojnë efekte të ngjashme psikoaktive si ilaçi. Agjentët lidhës mund të variojnë nga sendet shtëpiake (d.m.th., helmi i miut, detergjenti i rrobave, acidi borik, soda e bukës dhe pluhuri i talkut) deri te barnat e tjera (d.m.th., kafeina, fenciklidina<sup>300</sup> (PCP ose “Pluhuri i engjëjve”) dhe fentanoli).

Prodhuesit e drogave përziejnë agjentët lidhës me substancën më të shtrenjtë (d.m.th. “maskimi” i substancës më të shtrenjtë) për të rritur sasinë e produktit origjinal dhe kështu të shesin

<sup>294</sup> OKB, Komentari i Konventës të OKB kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope 1988, Neni 13, par.13.1, fq.289, New York, 1998.

<sup>295</sup> Raporti i Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve (INCB), IV. Opcionet për adresim të proliferimit të prekursorëve jo të listuar të dizajnesit, Udhëzimet e dhëna me Konventën e 1988tës, fq.40, 2018

<sup>296</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 267 Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, par.4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>297</sup> Regullorja e Këshillit të BE-së Nr.111/2005 e datës 22 dhjetor 2004 që vë rregullat për monitorimin e tregtisë mes Komunitetit dhe vendeve të treta në prekursorët e drogave, Kapitulli I, Përmbajtja dhe përkufizimet, Neni 2 par.(2), Gazeta zyrtare e Unionit European, L 22/1, 26.01.2005.

<sup>298</sup> Kombet e Bashkuara, Doracak i OKB mbi drogat sintetike (UN Toolkit on Synthetic Drugs),

<https://syntheticdrugs.unodc.org/syntheticdrugs/en/legal/national/analogueleg.html> last accessed on March 21, 2024.

<sup>299</sup> Për më shumë rreth drogave të përziara shih [What are Laced Drugs? | Turnbridge.](#)

<sup>300</sup> I shitur si pluhur i bardhë ose në formë të lëngshme, PCP shkakton varësi, Phencyclidine (PCP), i njohur zakonisht me emrin e saj të rrugës, “Pluhuri engjell”, është një anëtar i familjes halucinogjene të drogës, që mund të shkaktojë efekte që ndryshojnë mendjen të përdoruesit, të tilla si konfuzioni, lëvizjet e humorit dhe shikimi i gjërave ose dëgjimi i zhurmave që nuk janë aty. Efektet më serioze shëndetësore, të tilla si krizat, koma dhe vdekja e mundshme, mund të vijnë nga doza të larta. Shihni PCP: Çfarë duhet të dini (webmd.com)

më pak produkt për më shumë fitim. Në raste të tjera, trafikantët e drogës përziejnë drogën për të rritur efektin psikoaktiv të substancës, duke çuar kështu në një kombinim vdekjeprurës. Për shembull, në Kosovë, prodhuesit e drogës do ta lidhin marihuanën, një substancë më e lirë dhe një drogë e zakonshme në vend, me substanca të tjera, si:

- *Marihuanë-Fentanol*. Një dukuri mjaft e shprehur kohëve të fundit nëpër botë paraqitet marihuana e cila në treg gjendet e përzier me sasi shumë të vogla të fentanolit. Mjafton edhe 1gr fentanol që të kalojë në mbidozë apo edhe të rezultojë me fatalitet. Ka shumë raste kur konsumuesit nuk janë në dijeni se substanca është e përzier.
- *Marihuanë- Formaldehid*. Zakonisht përzierja me këtë substancë bëhet me qëllim që të ngrihet potencia e marihuanës. Megjithatë, kjo përzierje është e njohur të prodhojë efekte të dëmshme kognitive, si humbje të kujtesës për shkak të dëmtimeve neurologjike e po ashtu edhe me efekt fatal.
- *Marihuanë-Heroin*. Një përzierje e këtyre dy substancave mund të rezultojë në dëmtim të shëndetit si në frymëmarrje dhe në ritëm të zemrës të ngadalësuar, konfuzion etj. Personat mund të bëhen letargjik dhe në rastet kur personat nuk konsumojnë këtë substancë rregullisht kanë edhe tolerancë më të ulët. Andaj për disa persona, për shkak të potencës së heroinës shumë më lehtë mund të rezultojnë në mbidozë dhe probleme më të rënda të shëndetit.
- *Marihuanë-Kokainë*. Përzierja e këtyre substancave zakonisht gjendet më rrallë në treg megjithatë efektet e përzierjes së marihuanës (si substancë me efekt sedativ) dhe kokainës (si substancë me efekt stimulativ) mund të shkaktojnë probleme serioze për shëndetin. Ka mjaft përdorues që mund të përjetojnë halucinacione, paranojë, probleme kardiovaskulare, sulme epileptike etj.
- *Marihuanë-LSD*. Kjo substancë është halucinogjen i fuqishëm edhe nëse konsumohet në doza mjaft të vogla. Zakonisht gjatë procesit të djegies së marihuanës ky efekt dobësohet thuajse plotësisht, megjithatë nëse marihuana e përzier me LSD konsumohet përmes përtypjes, atëherë efekti është shumë më i madh dhe ndikon në çorientimin e personit dhe si rezultat edhe gjykim të dobët për veprimet e konsumuesit të kësaj substance.
- *Methamfetaminë*- këto dy substanca të përziara bashkë mund të rezultojnë në efekte të fuqishme si konfuzion, halucinacione, deluzion e potencialisht edhe sulme epileptike.

Përpos rasteve të dhëna më sipër të përzierjes me substanca narkotike, psikotrope dhe tjera analoge ka shumë raste kur marihuana por edhe substancat tjera si heroina, kokaina e të tjera përzihen me përbërës, kimikate tjerë që po ashtu shtojnë rrezikshmërinë për pasojë shumë të dëmshme për shëndetin e konsumuesve të tyre. Kështu p.sh. marihuana e përzier me detergjent për larjen e rrobave, kërpudha, xham apo plumb mund të rezultojë në komplikime të shëndetit si vjellje, kollitje, dhimbje të mprehtë në gjoks apo fyt, vështirësi në frymëmarrje, diare, marramendje etj. Ka edhe raste të tilla kur substancat narkotike përzihen me përbërës tjerë të padëmshëm vetëm për të shtuar sasinë (psh. miell, qumësht pluhur, sheqer etj.). Natyrisht që pastërtia e produktit ka shumë peshë në matjen e dënimit pasi jo vetëm ndërlihet me përfitimin, por shpesh edhe me efektet që prodhon ajo substancë si, p.sh. shkallën e varësisë. Megjithatë, nuk është një kufi i qartë pasi edhe pse disa substanca me pastërti më të lartë mund të krijojnë më shumë varësi, shpesh produktet e përziara mund të kenë pasojë shumë më të rënda për shëndetin për shkak të rrezikut nga përbërësi shtesë.

*d. Fentanoli dhe rreziqet që vijnë nga kjo substancë*

Një plagë e paprecedentë e varësisë dhe vdekjes, e nxitur nga trafikimi, shitja, shpërndarja dhe abuzimi i paligjshëm i fentanolit dhe opioideve të tjera sintetike, ka mbërthyer sot komunitetet nëpër pjesë të ndryshme të botës. Për shembull, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë aktualisht të bllokuara në "valën e katërt" të krizës së fentanolit – e cila nisi në fillim të dhjetëvjetëshit të fundit të shekullit XX.<sup>301</sup> Kjo valë e krizës përmban statistika tronditëse: Mbi 300 amerikanë vlerësohet se vdesin çdo ditë nga helmimi me fentanol.<sup>302</sup> Këto shifra vazhdojnë për një periudhë rekord 12-mujore, nga prilli 2022 deri në prill 2023, ku 111,355 njerëz vdiqën nga mbidoza e drogës, me fentanol dhe opioidë të tjerë sintetikë të përfshirë në gati 70 për qind të këtyre vdekjeve.<sup>303</sup> Që nga fundi i vitit 2015, Agjencia Evropiane për monitorimin e drogave dhe varësisë nga drogat (EMCDDA) kanë kryer një sërë hetimesh të përbashkëta me Europolin për fentanilet e rinj që kanë shkaktuar shqetësime serioze në nivel evropian. Fentanoli dhe derivatet e tij (fentanilet) janë një grup shumë potent i opioidëve sintetikë. Në disa raste këto substanca përdoren në mjekësi dhe veterinar, në anestezi dhe për menaxhim të dhimbjes. Megjithatë, fentanilet janë po ashtu të sintetizuara në mënyrë ilegale për tu transportuar më lehtë, sepse sasi të shumë të vogla mund të prodhohen me mijëra doza shumë të fuqishme që shiten në rrugë. Kjo i bën shumë atraktive për krimin e organizuar dhe paraqet sfida për agjencitë për kontrollimin e drogave. Opioidët e rinj, që nuk janë të kontrolluar nga Konventa e OKB-së, mund të prodhohen dhe tregtohen lirshëm dhe haptazi nga kompanitë kimike dhe farmaceutike që shpesh janë me bazë në Kinë, por jo vetëm.<sup>304</sup>

*e. Vdekshmëria nga fentanoli*

Duke i ndërlikuar gjërat në mënyrë thelbësore, fentanoli është i pakrahasueshëm me barnat e mëparshme. Për shkak të përbërjes kimike e tij unike dhe kapacitetit të varur nga përdoruesit në mënyra që nuk janë parë më parë. Kjo për shkak se fentanoli, një analgjezik opioid sintetik (ose një opioid i prodhuar në laborator), është më i lirë dhe mund të prodhohet më shpejt se drogat e tjera, dhe afërsisht 50 herë më i fuqishëm se heroina dhe 100 herë më i fuqishëm se morfina.<sup>305</sup> Në fakt, arsyeja që fentanili ka qenë historikisht i kudo ndodhur në kujdesin pas operacionit ambulator është sepse përbërja e tij kimike shpërbëhet shumë shpejt në trup.<sup>306</sup> Me fjalë të tjera, siç shpjegon Dr. Caleb Banta-Green, një studiues në Institutin e Varësive prej Drogave dhe Alkoolit në Shkollën e Mjekësisë të Universitetit të Uashingtonit në SHBA, fentanoli "ju bën të ndiheni vërtet mirë" shumë shpejt.<sup>307</sup> Por, po aq shpejt, largohet edhe kënaqësia, që do të thotë se përdoruesit "duhet të përdorin [fentanol] përsëri dhe përsëri dhe përsëri" për të marrë të njëjtën kënaqësi.<sup>308</sup> Natyra e varur dhe fuqia e drogës, nga ana tjetër, shpjegon pse përdoruesit janë më të

<sup>301</sup> Claire Klobucista, [The U.S. Fentanyl Crisis: What to Know | Council on Foreign Relations \(cfr.org\)](#); Department of Justice, *Strategic Goal 2: Keep Our Country Safe*, 2023, [Department of Justice | Objective 2.5: Combat Drug Trafficking and Prevent Overdose Deaths | United States Department of Justice](#) (2023).

<sup>302</sup> The White House, [Dr. Rahul Gupta Releases Statement on CDC's New Overdose Death Data Showing a Full Year of Flattening Overdose Deaths | ONDCP | The White House](#) (July 12, 2023).

<sup>303</sup> Deidre McPhillips, [Overdose deaths continue to rise in the US, reaching another record level, provisional data shows | CNN](#) (Sept. 13, 2023).

<sup>304</sup> European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction, Vëmendja në... fentanilet dhe opioidët e tjerë të rinj (përditësuar së fundmi me 04.10.2023), [https://www.emcdda.europa.eu/spotlights/fentanils-and-other-new-opioids\\_en](https://www.emcdda.europa.eu/spotlights/fentanils-and-other-new-opioids_en), vizituar herën e fundit me datë 25 mars 2024.

<sup>305</sup> Melinda Wenner Moyer, [What to Know About Fentanyl and Why It's So Dangerous - The New York Times \(nytimes.com\)](#) (May 19, 2022).

<sup>306</sup> Mu aty.

<sup>307</sup> Mu aty.

<sup>308</sup> Mu aty.

ndjeshëm ndaj mbidozave, të cilat, siç shtjellon Dr. Banta-Green, "mund të ndodhin në sekonda deri në minuta". Për krahasim, mbidozat nga opioidet më pak të fuqishme me recetë, të tilla si oksikodoni ose droga si heroina, "zakonisht do të zgjasin shumë minuta deri në orë".<sup>309</sup> Ajo që nënkupton është e thjeshtë: Ekziston një afat kohor dukshëm i reduktuar për të ndërhyrë dhe për të shpëtuar një përdorues që përjeton një mbidozë me fentanol në krahasim me një përdorues që përjeton një mbidozë me heroinë.<sup>310</sup>

*f. Motivët e ndryshme të blerësve dhe qasja në treg*

Një faktor tjetër që e bën krizën e fentanolit kaq të vështirë është se motivimet e përdoruesve për të marrë drogën ndryshojnë ndjeshëm. Për shembull, ndërsa disa kërkojnë fentanol sepse shpie në ndjenjë kaq të fuqishme, të tjerët që marrin fentanol (përfshirë ata që mbidozojnë) mund të mos kenë synuar kurrë të konsumojnë ilaçin. Kjo është klasa e fundit e përdoruesve, të cilët mund të helmohen pa dashje pasi kanë blerë barna, të parregulluara me recetë, përmes internetit ose nga tregtarë të palicencuar në aplikacionet e mediave sociale (Snapchat, TikTok, etj.) ose në rrugë.<sup>311</sup> Ka kaluar koha e viteve 80-ta dhe 90-ta kur dilerët e drogës përdornin peyxherë dhe telefona një përdorimesh për të shitur drogë në mënyrë sekrete.<sup>312</sup> Transaksionet përmes mediave sociale kanë plotësuar zbrazësinë, ku trafikuesit, tani përdorin mundësitë e mbrojtjes së privatësisë, si p.sh. me mesazhe të enkriptuara dhe që fshihen, të gjitha në dispozicion në media sociale, për të komunikuar me blerësit e tyre.<sup>313</sup> Sipas Tim Mackey, një profesor në Universitetin e Kalifornisë në San Diego në SHBA, i cili drejton një start-up të financuar nga federata që zhvillon softuer të inteligjencës artificiale për të zbuluar shitjet e paligjshme të drogës në internet: "Ka shitës droge në çdo platformë kryesore të mediave sociale. — që përfshin Instagram, Facebook, Twitter, Snapchat, Pinterest, TikTok dhe platforma në zhvillim si Discord dhe Telegram."<sup>314</sup>

Sipas testimeve laboratorike nga Agjencia kundër narkotikëve (DEA) SHBA, 7 nga 10 tabletat e sekuestruara nga autoritetet përmbajnë doza vdekjeprurëse të fentanolit.<sup>315</sup> Dr. Nora Volkow, Drejtoreshë e Institutit Nacional kundër Abuizimit me drogë në SHBA ka sqaruar se "Kur vendosni fentanil në pilula që shiten si benzodiazepina ose për dhimbje, po arrini një grup të ri klientësh që nuk do t'i kishit nëse do të shisnit vetëm pluhur fentanil."<sup>316</sup> Rezultati është që ka një demografi të re të të varurve nga drogat me qasje të shpejtë online në drogat e preferuara.

Problemi është se prevalenca e barnave të lidhura me, ose të përbëra tërësisht nga fentanil, kalon pa u ditur nga shumë njerëz, duke pasur parasysh se këto pilula të falsifikuara duken "legjitime" - zakonisht vijnë në një shishe të përshtatshme të barnave me recetë, dhe ku pilulat i ngjajnë me ngjyrë dhe madhësi një pilule autentike me recetë.<sup>317</sup>

---

<sup>309</sup> Mu aty

<sup>310</sup> Mu aty.

<sup>311</sup> Jan Hoffman, [Fentanyl Tainted Pills Cause Drug Fatalities Among Youth to Soar - The New York Times \(nytimes.com\)](https://www.nytimes.com/2022/05/19/us/politics/fentanyl-tainted-pills-cause-drug-fatalities-among-youth-to-soar) (May 19, 2022).

<sup>312</sup> Mu aty.

<sup>313</sup> Mu aty.

<sup>314</sup> Mu aty.

<sup>315</sup> Drug Enforcement Administration (DEA), [One Pill Can Kill | DEA.gov](https://www.dea.gov/one-pill-can-kill) (2024).

<sup>316</sup> Mu aty.

<sup>317</sup> Mu aty.

## 2. Përcaktimi i sasisë së substancave narkotike

Siç u potencua disa herë më lartë, një nga çështjet më të rëndësishme për matjen e dënimit është definimi i sasisë së substancave narkotike, psikotrope dhe analoge në raport me llojin e substancës bazuar edhe në shkallën e rrezikshmërisë dhe/apo varësisë. Gjykatat duhet të kenë parasysh se sasia e njëjtë e substancave të ndryshme nuk ka të njëjtin nivel të rrezikshmërisë andaj edhe dënimi nuk duhet të jetë e njëjtë. Në KPRK është dhënë vetëm një referencë sa i përket dënimit bazuar në sasinë e substancës narkotike. Më saktësisht, Neni 269<sup>318</sup> par. 2 i KPRK-së ka paraparë se për posedues deri në tre (3) gr të substancave narkotike, psikotropike apo analoge personi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Problemi me mënyrën se si është i hartuar ky nen është se nuk bën dallimin në mes substancave të ndryshme narkotike. Aplikimi i maksimumeve uniforme prej 3 gr me të njëjtin dënim është problematik, pasi që siç u cek edhe më sipër disa substanca në sasi shumë më të vogël sesa 3gr janë vdekjeprurëse. Po ashtu një sasi shumë e vogël e substancave më të rrezikshme si heroina, kokaina e drogat tjera sintetike mund të shërbejnë për konsum të një numri më të madh të individëve duke qenë se të njëjtat konsumohen në sasi shumë të vogla por me efekt shumëfish më të mëdha se p.sh. marihuana apo llojet tjera të ngjashme.

Një tjetër mangësi në legjislacion qëndron në atë se Neni 275 nuk ka paraparë se çfarë nënkupton me “*sasi të mëdha*” e as nuk jep ndonjë shkallëzim të këtij përkufizimi në kontekst të potencës së një substance të caktuar. Shembull. 100 gr. kokainë apo heroinë nuk është njëjtë me 100 gr. marihuanë/hashash. Andaj, diferencimi në mes substancave narkotike nuk vlen vetëm për shkak të shkallës së rrezikshmërisë por edhe për faktin se çmimi/përfitimi ndryshon në masë nga njëra substancë në tjetrën.

Aktualisht, ka një sërë llojesh të ndryshme të substancave narkotike që janë shpërndarë në mbarë botën. Megjithatë, narkotikët sintetikë janë më shqetësuesit për shkak të potencialit të tyre të lartë të rrezikshmërisë dhe varësisë së jashtëzakonshme të përdoruesve, e cila, nga ana tjetër, prek komunitete të tëra. Në Kosovë, por edhe në të gjithë Ballkanin, trafikimi i marihuanës/kanabisit mbetet një nga fenomenet më të përhapura dhe shërben si burim financimi për shumë aktivitete të tjera të paligjshme. Por kjo formë trafikimi nuk lë pas trafikimin e llojeve të tjera të substancave.

Më poshtë do të gjeni një shembull se si në SHBA ndryshon dënimi për *kultivimin, eksportin, importin apo trafikimin e këtyre substancave* varësisht se për cilin lloj të substancave bëhet fjalë. Natyrisht përpos llojit dhe sasisë janë një numër rrethanash tjera (si p.sh. edhe pastërtia dhe përzierja e substancës) që merren në konsideratë për dënimin përfundimtar dhe që ndikojnë dukshëm në lartësinë e dënimit të reflektuar në tabelë por të mëposhtmet janë paraqitur për qëllime të ilustrimit.

---

<sup>318</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 269 Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

Tabela A: Tabela e shkallëzuar e dënimeve në SHBA sipas substancave specifike narkotike

Sasia	Lloji i substancës narkotike						
	Kokainë	Ekstazi	Heroinë	LSD	Methemfetamine	Fentanoli	Marihuana Kanabis
100gr	21-27m	27-33m	51-63m	151-188m	97-121m	97-121m	0-6m
1kg	51-63m	63-78m	97-121m	235-293m	151-188m	151-188m	0-6m
100kg	151-188m	188-235m	235-293m	235-293m	235-293m	235-293m	51-63m

Përpos tabelës së shkallëzuar në SHBA lidhur me llojin dhe sasinë së substancave (Tabela A) një tabelë e ngjashme e shkallëzuar aplikohet edhe në Britaninë e Madhe por në mënyrë më specifike. Për shembull, në BM, kombinimi i llojit dhe sasisë specifike të substancës narkotike ndahet në kategori të ndryshme (me kategorinë 1 si dëm më i madh dhe kategoria 4 si dëm më i vogël) të cilat paraqiten si indikatorë të shkallës së dëmit dhe rrjedhimisht që ndikojnë në kategorizim edhe të dënimeve. Më poshtë është dhënë një shembull për rastet e importit të këtyre substancave, nga të cilat më pas secila kategori krahasohet me shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit për të përcaktuar pikënisjen por edhe kornizën e dënimit.<sup>319</sup>

Tabela B: Tabela e shkallëzuar në BM sipas substancave specifike narkotike

Kategoria 1	Kategoria 2	Kategoria 3	Kategoria 4
Heroinë, kokainë- 5kg	Heroinë, kokainë- 1kg	Heroinë, kokainë- 150gr	Heroinë, kokainë- 5gr
Ekstazi – 10,000tableta	Ekstazi – 2,000tableta	Ekstazi – 300 tableta	Ekstazi – 20 tableta
LSD 250,000 katrorë	LSD 25,000 katrorë	LSD 2,500 katrorë	LSD 170 katrorë
Amfetaminë-20kg	Amfetaminë- 4kg	Amfetaminë-750gr	Amfetaminë- 20gr
Kanabis-200kg	Kanabis- 40kg	Kanabis- 6kg	Kanabis- 100gr
Ketaminë- 5kg	Ketaminë-1kg	Ketaminë- 150gr	Ketaminë- 5gr.

Në mungesë të një table me sasi referente si orientim për matjen e dënimit, Gjykata Supreme ka hulumtuar për një bazë të tillë në botë. Si tabelë më e përshtatshme orientuese ka dalë të jetë tabela nga Australia. Për sqarim, krahasuar me tabelat e marra si shembull nga SHBA dhe Britania e Madhe, tabela e mëposhtme ndërlidhet vetëm me përkufizimin e kuptimit të nivelit të ndryshëm të sasive të substancave narkotike për qëllime krahasuese. Megjithatë, për sistemin e drejtësisë kjo tabelë mund të shërbejë si burim mjaft i mirë për të bërë dallimin nga njëra substancë në tjetrën. Një ndarje e tillë e sasive të ndryshme është bërë pikërisht bazuar në shkallën e rrezikshmërisë që paraqesin substancat me përbërje të ndryshme. Duhet bërë të qartë se tabela nga shteti i Australisë në fakt përmban një gamë shumë më të gjerë të substancave narkotike duke i klasifikuar ato në disa kolona me sasi të ndryshme. Megjithatë për qëllime të udhëzimit sa më të saktë dhe sa më praktik, Gjykata Supreme ka marrë vetëm të dhënat nga tabela për disa nga substancat për t'ua bërë më të lehtë gjykatave të kuptojnë se sa një substancë orientimisht dhe për qëllime krahasimi do mund të kualifikohet si sasi e vogël apo sasi e madhe. Edhe kolonat janë thjeshtësuar nga tabela (duke u përfshirë më pak ndarje për të shmangur konfuzitetin në leximin e tyre. Kjo e fundit mund të ndihmojë gjykatat në vendimmarrje sidomos kur bëhet fjalë për sasi të substancave në kuptim të nenit 275. Një tjetër arsye është fakti se substancat e përfshira në atë tabelë jo të gjitha janë të

<sup>319</sup> Këshilli për politikën ndëshkimore, Udhëzuesi për veprat me narkotikë [Drug Offences Definitive Guideline], Importi, fq.4. Britani e Madhe.

përfshira në kuadër të listës së substancave sipas Ligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët andaj edhe tabela e mëposhtme përmban vetëm disa nga substancat më të përdorura

Tabela C: Substancat narkotike më të përdorura

Lloji i substancës	Sasi e vogël	Sasi e konsiderueshme	Sasi e madhe
Amphetamine	3.0g	250.0gr	1.0kg
Gjethet e Kanabis /Marihuana	300.0g	25.000gr	100.0kg
Vaj Kanabis	5.0g	500.0gr	2.0kg
Bima e Kanabis e kultivuar në mënyrë të avancuar në hapësira të brendshme	5bimë	50	200bimë
Bima e Kanabis- tjera	5bimë	250	1 000bimë
Rrëshirë Kanabisi/ Hashash	30.0g	2.500gr	10.0kg
Shkurre Kokaine	30.0g	2.500gr	10.0kg
Kokainë	3.0g	250.0gr	1.0kg
Fentanilet	0.0075g	1.25gr	0.005kg
Heroinë	3.0g	250gr	1.0kg
LSD apo Acidi Lisergik dhe derivatet e tyre edhe nëse ato derivate kanë halucinogjen	15 DDU apo 0.003g	0.5gr	0.002kg
3,4-Methylenedioxyamphetamine (MDMA) Extazi <sup>320</sup>	0.75g	125gr	0.5kg
Koncentrat i kashtës së lulëkuqes	30.0g	2.500gr	10.0kg

## B. Rrethanat rënduese relevante

Siç edhe u përmend më sipër, janë një numër të rrethanave lidhur me veprat me narkotikë të cilat gjykatat duhen ti marrin parasysh me rastin e matjes përfundimtare të dënimit. Duke iu referuar tabelës së mësipërme të llogaritjes së dënimit në SHBA (Tabela A), tabela e mëposhtme është dhënë për qëllime krahasimi se si ndryshon dënimi kur i shtohen disa faktorë tjerë.

<sup>320</sup> Dozimi standard për Ekstazi është 140mg për tabletë, që nënkupton që 1kg=7143 tableta. Megjithatë duhet pasur parasysh se madhësia e tabletave mund të variojë në madhësi dhe peshë varësisht nga procesi i prodhimit, lloji i tabletës që presohet dhe përbërësve tjerë (njohur si adulterants) që mund t'iu jenë shtuar si p.sh. metamfetaminë, ketamine anestetike, kafeina, efedrina, heroina, kokaina, phencyclidine (PCP) apo dextromethorphan (sirup për kollitje) etj.



Tabela D: Rritja e dënimit për substancat narkotike me shtimin e faktorëve tjerë

Sasia						
1kg	Kokainë	Ekstazi	Heroinë	Metemfetamine	Fentanoli	Marihuana Kanabis
Pa ndonjë rrethanë shtesë	51-63m	63-78m	97-121m	151-188m	151-188m	0-6m
Përdorim i armës apo dhunës	63-78m	78-97m	121-151m	188-235m	188-235m	6-12m
Rrezik substancial për ambientin	70-87m	87-108m	135-168m	210-262m	210-262m	70-87m
Të gjitha rrethanat e mësipërme bashkë	108-135m	135-168m	210-262m	324-405m	324-405m	70-87m

Shumë nga rrethanat rënduese të parapara me Nenin 70 të KPRK-së janë të përfshira si element i v.p. të cilat shpesh menjëherë në një dënim më të rëndë duke u kualifikuar sipas Nenit 275 të KPRK-së. Andaj më poshtë, fillimisht do të shtjellojmë rrethanat të cilat janë të aplikueshme për veprat sipas këtij Kapitulli e më pas edhe ato sipas Nenit 275. Ka disa nga rrethanat rënduese nga Neni 70 që nuk janë të përmendura në mënyrë taksative në Nenin 275, si element kualifikues por që kanë ndërlidhje të ngushtë me ato rrethana andaj edhe pjesa e mëposhtme ka për synim të vë në pah gërshetimet e tilla. Po ashtu shumë nga shpjegimet e sipërpërmendura japin sqarim edhe të rrethanave të mëposhtme por janë paraqitur më lartë për qëllim të një pasqyrimi sa më adekuat të rrezikshmërisë së këtyre veprave.

- Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar. Pjesëmarrja në grup të organizuar tashmë është e sanksionuar me Nenin 275. Është me rëndësi të potencohet se gjen zbatim si rrethanë rënduese në të gjitha nenet, përfshirë edhe Nenin 275. Kështu në të gjitha veprat tjera si rrethanë përdoret për të bërë individualizimin e dënimit mbi shkallën e angazhimit të secilit nga kryesit veç e veç. I njëjti parim përdoret edhe në Nenin 275 veçse në kontekst të atij neni përdoret për të diferencuar veprimet e secilit pjesëtar të grupit të organizuar kriminal.
- Shkalla e lartë e dashjes. Në bazë të përsëritjes të sipërpërmendur mbi llojet e substancave të ndryshme, përzjerjeve të ndryshme që po paraqiten në treg me rrezikshmëri mjaft të lartë është shumë me rëndësi të vihet në pah përpjekja e madhe e kryesve të kësaj kategorie qoftë për përzjerje të substancave, shmangie nga substancat e zakonshme vetëm për ti ikur substancave të listuara por edhe vet gjetja e formave të komunikimit online, mesazheve të enkriptuara e gjer te pagesat përmes kriptovalutave për ti ikur detektimit. Të gjitha këto paraqesin nivel të lartë të dashjes së kryesit dhe qëllimit për kryerjen e veprave dhe si rrethanë ka peshë mjaft të madhe në lartësinë e dënimit. Si rrethanë gjen zbatim edhe në Nenin 275 të KPRK-së.
- Vepra penale është kryer në mënyrë posaçërsisht mizore. Duke pas parasysh trendin e përzjerjeve të substancave sintetike, në fakt kjo rrethanë mund të konceptohet se plotëson elementin nga neni 275 par. 1.6 duke qenë se shumë nga këto përzjerje dhe substanca të reja kanë efekt shkatërrues dhe mund të thuhet edhe “mizor” në shëndetin e njeriut. Për ta kuptuar më së miri është të përcillen trendet botërore dhe epidemitë e drogave sintetike që disa nga to edhe kanë kthyer përdoruesit në një gjendje vegjetative. Por në kontekst të kësaj rrethanë mund të nënkuptohet edhe kur kryesit, përdorin një gjendje të caktuar të viktimave duke i injektuar substanca kundër vullnetit të tyre. Kështu p.sh. kjo zakonisht mund të ndodhë te viktimat e trafikimit me qenie njerëzore (apo edhe kontrabandimit me emigrantë) të cilave u injektohet substanca narkotike shpesh me qëllim të transportimit të tyre pa pengesa përtej kufijve dhe në



makina apo kontejnerë të dedikuar për mallra. Andaj, një situatë e tillë paraqet ekstremet e mizorisë dhe që do të duhej të merret parasysh në lartësinë e dënimit. Varësisht edhe nga statusi i viktimës p.sh. nëse është fëmijë, apo person i varur nga kryesi, atëherë kualifikimi mund të bëhet edhe në kuadër të viktimës së ndjeshme kualifikuar me Nenin 275 par. 1.4.

- Shkallën e dënimit të shkaktuar. Kjo rrethanë është ngushtë e lidhur me shpjegimet e sipërpërmendura lidhur me llojet e substancave dhe sasinë e tyre andaj edhe kur vlerësohet lartësia e dënimit duhet pasur parasysh të gjitha të sipërpërmendurat. Në fakt, kur janë në pyetje përzierjet e substancave të rrezikshme, sidomos ato sintetike, në ato raste në mënyrë automatike veprën do të duhej trajtuar sipas Nenit 275 par. 1.6. Në rastet kur nuk kemi të bëjmë me përzierje por me substanca narkotike tradicionale, për qëllime të neneve tjera në këtë kapitull, vlerësimi mund të bëhet në kontekst të klientelës së arritur krahasuar me sasinë e narkotikëve.
- Ndonjë dënim të mëparshëm. Si rrethanë është vetë shpjeguese dhe përfundimisht si një faktor me shumë ndikim në lartësinë e dënimit. Kur bëhet fjalë për veprat e këtij kapitulli, dënimi duhet të jetë më i lartë sesa për kryes për herë të parë. Situata është më ndryshe te personat e varur nga substancat narkotike e të cilët hasen me sasi minimale për konsum personal, edhe pse të njëjtit duhen trajtuar nga sistemi i drejtësisë, megjithatë trajtimi i tyre është më ndryshe nga recidivistët që merren me këtë veprimtari të paligjshme dhe përqendrimi në këtë kategori duhet të jetë më shumë në programet rehabilituese.

### C. Rrethanat sipas Nenit 275

Siç u përmend edhe më sipër, Neni 275 parasheh dënim dukshëm më të lartë për veprat nga nenet 267, 268, 269, 270 ose 272 të KPRK-së në rast të prezencës së rrethanave të mëlutjeshme. Pra përmes këtij neni ligjvënësi ka shtuar elemente shtesë të veprave penale nga nenet e përmendura. Mjafton prezenca e një nga rrethanat për tu kualifikuar për dënim sipas këtij Nenit 275. Ekzistimi i dy apo më shumë, apo edhe të gjitha rrethanave të poshtëshënuara i shton peshën dhe me këtë edhe lartësinë e dënimit. Shumë nga këto rrethana janë të paraparë edhe me legjislacionin e vendeve të ndryshme si rrethana që ndikojnë në lartësinë e dënimit. P.sh. Zvicra ka paraparë dënime më të ashpra për furnizuesit me substanca narkotike nëse: kryesi e din se substancat paraqesin rrezikshmëri për një grup të madh të njerëzve, është anëtar i grupit të organizuar kriminal, ka përfitim substancial në tregtinë me substanca, apo nëse shpërndan në afërsi të institucioneve edukativo-arsimore. Një qasje të ngjashme e kanë edhe vendet si Spanja, Norvegjia, Portugalia etj.

- Paragrafi 1.1 kryesi vepron si anëtar i grupit - Sipas raportit të Qendrës Evropiane për monitorimin e drogave dhe varësisë nga drogat rrjetet kriminale të organizuara nga Ballkani Perëndimor duket të jenë polikriminale, domethënë ato janë të angazhuara kryesisht në trafikun e drogave, por marrin pjesë gjithashtu në aktivitete të tjera të paligjshme, duke përfshirë kontrabandën me armë dhe emigrantë, trafikimin me njerëz, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit etj. Disa nga këto rrjete duket se kanë zgjeruar praninë e tyre operacionale në tregun e drogave të BE-së. Prania e tyre është e lidhur me një përfshirje më të madhe në zinxhirin e furnizimit të kokainës, i cili përfshin tashmë aktivitete në Amerikën Latine, por gjithashtu

duket të jetë i lidhur me një përfshirje në prodhimin e kanabisit në disa vende të BE-së.<sup>321</sup> Sipas po të njëjtit raport këto rrjete përdorin tregjet online dhe krypto-monedhat duke përfutur kështu në prodhimin dhe trafikimin e drogave dhe në pastrimin e parave. Për shkak të rrezikshmërisë që bartin këto grupe kriminale, dënimet ndaj anëtarëve të tyre duhen dalluar në masë nga kryesit individual. Andaj edhe dënimet për këto kategori duhet të shkojnë gjithnjë mbi 2/3, përveç nëse plotësohen kushtet e parapara me ligj për një dënim më të ulët. Gjykatat, po ashtu duhet të kenë parasysh shkallën e pjesëmarrjes nga par. 2.1, 3.4 dhe 3.5 i Nenit 70 të KPRK-së është një rrethanë me rëndësi për të përcaktuar dënime të ndryshme të anëtarëve të grupit varësisht nga roli i personit në grupin e organizuar kriminal.

- Paragrafi 1.2. kryesi është person zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij - Për shkak të besimit të publikut që i vishet personave zyrtarë në ushtrimin e autorizimeve publike, në linjë edhe me zbërthimin e kësaj rrethane përgjatë Udhëzuesit, duhet bërë dallimi në mes funksionit të personit zyrtar dhe shkallën e përgjegjësisë që ai person bart. Sa më e ndjeshme pozita aq më i rëndë duhet të jetë dënimi. Duhet të jetë e qartë se sipas rrethanës, vet funksioni person zyrtar pa ndonjë autorizim zyrtar që lidhet me mundësimin e veprimtarive të paligjshme lidhur me substanca narkotike nuk e kualifikon zbatimin e Nenit 275. Shembull i këtij skenari është nëse i pandehuri është nëpunës në një nga institucionet shtetërore për çështje të regjistrimit civil, kulturës etj., veprimtaria e të cilit pra nuk lidhet me ushtrimin e autorizimit lidhur me cilëndo nga aktivitetet që lidhet me substanca narkotike (për cilëndo kategori të substancave në tabelën e paraparë me Ligj). Andaj, fakti se i pandehuri është person zyrtar mund të përdoret si rrethanë rënduese në kuadër të Nenit 70 (për shkak të keqpërdorimit të besimit që i është dhënë në ushtrim të një funksioni publik) dhe të rezultojë edhe në shqiptimin e dënimit plotësues nga Neni 62. Ky dënim bazohet vetëm në aplikimin e nenit bazë e jo në bazë të kualifikimit sipas Nenit 275.
- Paragrafi 1.3. kryesi përdor ose kanos se do ta përdorë dhunën ose armën - Kjo rrethanë është identike me rrethanën nga par. 2.3 i Nenit 70 i KPRK-së, e mund të jetë e shoqëruar edhe me rrethana tjera po ashtu rënduese si ato nga par. 2.4 dhe 2.5 i Nenit 70 të KPRK-së. Përdorimi i kanosjes dhe dhunës është rrethanë tipike për kryesit të cilët bëhen pjesë e veprimtarive të kësaj natyre. Në shumicën e rasteve, dhuna shoqëron rastet e shpërndarjes/trafikimit të substancave narkotike. Përdorimi i armës nuk është i pazakontë dhe jo rrallëherë mund të rezultojë edhe me fatalitet. Andaj, gjykatat gjithnjë duhet të marrin në konsideratë përdorimin e dhunës nga ana e të pandehurit në matjen finale të dënimit.
- Paragrafi 1.4. vepra kryhet në dëm ose duke e shfrytëzuar viktimën e ndjeshme - Cilado rrethanë kur kryesi dëmton apo shfrytëzon një viktimë të ndjeshme në kryerjen e veprës duhet të ketë peshë në matjen e dënimit. Kjo rrethanë paraqitet e njëjtë me rrethanën nga par. 2.6 i Nenit 70 të KPRK-së, por edhe me par. 2.7 të po të njëjtit nen. Megjithatë, specifikat e kësaj rrethane variojnë. Kështu p.sh. viktima mund t'i nënshtrohet dhunës nga trafikuesit. Nga ana tjetër, trafikuesit, në mënyrë të dhunshme dhe kundër vullnetit të tyre mund t'i përfshijnë viktimat në aktivitete ilegale të shpërndarjes së drogës p.sh. viktimat e trafikimit me qenie njerëzore nën presionin e trafikuesve mund të përfshihen pa vullnetin e tyre në këto aktivitete.

Trafikuesit mundën gjithashtu të përdorin fëmijët për të shpërndarë rrjetin e tyre të drogës, duke iu imponuar me dhunë fëmijëve përdorimin e drogave. Andaj, rrethana ka ngjashmëri me

<sup>321</sup> Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat, Raporti rajonal për shëndetin dhe sigurinë lidhur me drogat në Ballkanin Perëndimor 2022, Raport rajonal, fq.9, 2023

rrethanën tjetër nga par. 1.7 i po të njëjtit nen (vepra është kryer brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga cilido institucion i edukimit). Sipas Organizatës Labyrinth në Kosovë<sup>322</sup>, përderisa nuk ka shifra të sakta për ta kapur këtë situatë, numri i përgjithshëm i përdoruesve në Kosovë vlerësohet të kalojë 30,000, dhe mosha 16 vjeç është mosha mesatare e përdorimit për herë të parë të narkotikëve. Për shkak të popullatës relativisht të re në Kosovë, trafikantët janë të vetëdijshëm se tregu më i madh gjendet te gjeneratat e reja. Kjo bazohet në vlerësimin e trafikuesve se të rinjtë janë në fazën e mos zhvillimit të plotë mental krahasuar me të rriturit. Për fund, gjykata duhet të ketë konsiderata serioze për rastet kur mund të përfshihen potencialisht edhe kur të moshuarit, duke u përdorur si objekt eksperimentimi për të testuar substancat e reja. Edhe pse gjasat për një skenar të tillë mund të jenë të pakta në Kosovë, megjithatë paraqesin një rrethanë që nuk duhet anashkaluar nëse haset në to.

- Edhe rrethana nga par. 2.14 i Nenit 70 të KPRK-së kur vepra kryhet brenda marrëdhënies familjare ka një ndërlidhje me këtë kusht. Kjo për shkak se jo rrallëherë anëtarët e familjes përfshihen në krimet me narkotikë pikërisht për shkak të lidhjes së gjakut ose varësisë tjetër ndaj kryesit.

Për këto arsye të dyja rrethanat e sipërpërmendura duhet të kenë peshë të rëndësishme në matjen e dënimit.

- Paragrafi 1.5. dërgesa, ngarkesa, kontejneri ose mjeti i planifikuar për një operacion humanitar është përdorur për transportimin e paligjshëm të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge - Rrethana në fjalë po ashtu na paraqitet si relevante duke marrë parasysh substancat për përdorim mjekësor nga tabela II, III dhe IV e Ligjit mbi substancat narkotike të përkrahur më sipër dhe në Udhëzuesin për veprat penale të korrupsionit<sup>323</sup>. Sipas po të njëjtit Udhëzues edhe kur është fjala për veprat e korrupsionit keqpërdorimi i fondeve të asistencës sociale apo fondeve tjera për kategoritë e ndjeshme duhet të merret parasysh në ashpërsim. E njëjta logjikë duhet zbatuar edhe në rastin kur substancat apo barnat janë me destinim për kategori të caktuara dhe të njëjtat keqpërdoren nga kryesit. Shumë herë kjo rrethanë shoqërohet edhe me përfshirjen e personit zyrtar për shkak të qasjes që të njëjtit kanë në këto furnizime. Andaj, si e tillë mund të ketë peshë të madhe në matjen e dënimit.
- Paragrafi 1.6. personi ka përzier substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge me substanca të tjera të cilat e rrisin rrezikun për shëndetin - Kjo rrethanë po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi. Sot, për fat të keq, jemi dëshmitarë të shfaqjes së substancave narkotike me përzierje të substancave të ndryshme sintetike që rrisin shumë rrezikun. Gjatë llogaritjes së dënimit, gjykata duhet të vlerësojë nëse substanca e përdorur ka një efekt shkatërrues mbi përdoruesin ose shpesh paraqet rrezik për shëndetin. Në shumë vende të zhvilluara, problemi i përzierjes së substancave narkotike nga autorët po çon në pasoja shkatërruese për komunitete të tëra.

<sup>322</sup> Shih <https://www.evropaelire.org/a/rritet-perdorimi-i-drogave-ne-kosove/31869646.html>

<sup>323</sup> Gjykata Supreme, Udhëzues i veçantë për korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, fq. 37, Ndikim në kategori të ndjeshme të shoqërisë dhe fondeve që ndërlidhen me këto kategori, Prishtinë, 2021.

- Paragrafi 1.8. vepra penale kryhet brenda institucionit korrektues - Si rrethanë na paraqitet mjaft e rëndësishme për shkak të problematikave që sjell jo vetëm në agresivitetin dhe sëmundjet e varësitetë që mund të shfaqen brenda institucionit korrektues, por edhe problemet që mund të sjellë brenda institucionit korrektues. Zakonisht, sikurse edhe rrethana paraprake, këtë e gjejmë të shoqëruar edhe me përfshirje të personit zyrtar që mund të tolerojë veprime të tilla.
- Paragrafi 1.9. vepra penale përfshin sasi të mëdha të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge - Siç u diskutua edhe më sipër, ky paragraf thekson se sasi të mëdha të narkotikëve paraqesin bazë për kualifikim sipas Nenit 275 dhe rrjedhimisht edhe dënim më të lartë. I njëjtë është rasti edhe me Nenin 273<sup>324</sup> të KPRK-së i cili në paragrafin 2 parasheh dënim të barabartë me dënimet nga Neni 275 kur është fjala për sasi të mëdha pa e specifikuar se çfarë nënkuptojmë me këtë sasi. Në mungesë të një tablele të veçantë për caktimin e sasisë relevante të substancave, gjykatat kryesisht dënojnë në bazë të praktikës së ndërtuar, duke lejuar interpretime të ndryshme dhe një larmi në qasjen ndaj dënimit.

#### **D. Rrethanat lehtësuese**

Rrethanat lehtësuese të parapara me Nenin 70 par. 3 KPRK-së mund të jenë të gjitha relevante për aplikim, por gjithnjë varet se për cilën vepër bëhet fjalë.

- Rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësive penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore - Veprat nga ky Kapitull mund të përfshijnë rrethana që aplikohen për personat të cilët kanë krijuar varësi nga substancat narkotike. Por, domosdoshmërisht duhet kujdes i shtuar për veprat me rrezikshmëri më të lartë brenda këtij kapitulli.

- Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar - Është bërë praktikë e rregullt në gjykatat tona që rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar të merren parasysh në zbutjen e dënimit. Përderisa këto rrethana mund të jenë të zbatueshme për veprat në këtë kapitull duhet pasur kujdes, si zakonisht në peshën që u jepet rrethanave personale dhe karakterit të kryesit në vlerësimin e veprave të natyrave më të rënda. Megjithatë, edhe në këtë rast, është me rëndësi që pesha e kësaj rrethane të caktohet bazuar në ekzistimin e rrethanave rënduese domethënëse (p.sh. shkallën e dëmit të shkaktuar) si dhe se sa kjo rrethanë është e kombinuar me ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese me peshë në mënyrë që kjo rrethanë të ndikojë në zbutje të mëtutjeshme të dënimit.

- Mosha e të dënuarit - mund të jetë po ashtu rrethanë relevante për aplikim në këto vepra sidomos kur bëhet fjalë për posedues në sasi të vogla të substancave të dedikuara për konsum individual. Aplikueshmëria e kësaj rrethane duhet krahasuar arsyeshëm me ekzistencën e rrethanave tjera që kanë të bëjnë me veprën penale. Kjo me kushtin, që arsyeshëm të krahasohet në raport me rrethanat tjera.

- Rrethanat që tregojnë për një rol më të vogël të kryesit në kryerjen e veprës - Rrethanat nga paragrafët 3.4 dhe 3.5 të Nenit 70 të KPRK-së paraqiten si e kundërta e rrethanës rënduese nga

<sup>324</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Neni 273 Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

paragrafi 2.1. Kjo rrethanë mund të paraqitet si shumë me rëndësi për rastet e grupeve të organizuara kriminale për të bërë dallimin në mes kryesve kryesorë dhe të tjerëve me shkallë më të ulët të angazhimit.

- *Rrethanat tjera lehtësuese për këtë kategori të veprave* - Sikurse ishte rasti edhe me rrethanat e mësipërme edhe këtu, jo rastësisht është bërë grupimi i rrethanave nga par. 3.7 deri 3.12 pasi që ekziston mundësia për dyfishim/trefishim e tyre me rastin e matjes së dënimit. Kjo për faktin se që të gjitha, në një formë, tregojnë pendim nga i pandehuri. E njëjta metodologji e tubimit të rrethanave në një grup është bërë edhe në pjesën e përgjithshme të Udhëzuesit kur flitet për rrethanat lehtësuese. Bashkëpunimi vullnetar nga par. 3.9 do të duhej të jetë nga rrethanat më të rëndësishme kur është fjala për zbulimin e rrjetit të kësaj veprimtarie. Andaj, në këto raste kjo rrethanë do të kishte peshë më të madhe në matjen e dënimit nga gjykata, varësisht se sa ndihma e tillë rezulton në zbulimin e personave të përfshirë në këto rrjete.

#### **E. Aplikueshmëria e dënimeve tjera**

- *Shqiptimi i dënimit me kusht* - mund të jetë i përshtatshëm zbatimi i këtij dënimi nga gjykata për veprat nga ky kapitull. Por, gjykatat duhet gjithmonë të marrin parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar nga kryesi. Shqiptimi i dënimit me kusht mund të jetë i arsyeshëm për kryesit që për herë të parë bien ndesh me ligjin dhe atë për format më të lehta të veprimtarive kriminale siç është posedimi apo shpërndarja në sasi të vogla kur nuk janë të shoqëruar nga rrethana tjera posaçërisht rënduese. Te kjo e dyta duhet pasur kujdes të shtuar te e kaluara kriminale e të pandehurit pasi që i njëjti mund të ketë shumë instanca kur është zënë duke shpërndarë substanca në sasi minimale, por kjo nuk e bën që atij automatikisht ti zbutet dënimi, por gjykata në caktimin e lartësisë së dënimit duhet ta bazojë vlerësimin në veprimtarinë e tij në tërësi. Duke qenë se gjykata e ka diskrecionin e caktimit të dënimit, sidomos në mes minimumit dhe maksimumit ligjor, andaj vlerësimi për lartësinë e dënimit duhet bërë bazuar mbi shkallën e rrezikshmërisë dhe përgjegjësisë që bart ai person.

Në rastet kur kryesi është përdorues i substancave, gjykata udhëzohet të caktojë edhe Nenin 54<sup>325</sup> të KPRK-së apo edhe obligime shtesë nga Neni 56<sup>326</sup> i KPRK-së. Shembull, obligimet e mëposhtme mund të jenë më adekuate për një kryes që për herë të parë bie ndesh me ligjin apo për personat e varur nga këto substanca:

- mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor (par.1.1).
- nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit (par.1.2).
- vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre (par.1.3).
- heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës (par.1.8).
- heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara (1.9).
- heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar (1.10).

<sup>325</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 54 Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>326</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 56 Llojet e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

- heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve (par.1.11)-nëse është relevante për rastin konkret.
- Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 62 apo 63 – Gjykata rekomandohet të shqiptohet në të gjitha rastet kur personi zyrtar është i përfshirë në kryerjen e veprave nga ky kapitull.
- Shqiptimi i urdhërit për punë me dobi të përgjithshme - mund të jetë e përshtatshme që të shqiptohet urdhri për punë në dobi të përgjithshme për kryesit që kanë kryer format më të lehta të veprave brenda këtij Kapitulli. Shembull, puna në dobi të përgjithshme mund të jetë e përshtatshme për përdorues të substancave apo kryesin i cili është i akuzuar për posedim të substancave në sasi të vogla dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat e arsyetojnë dënimin me burgim.
- Shqiptimi i dënimit me gjobë - Neni 269 paragrafi 2 parasheh mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë si dënim kryesor. Shumica e neneve tjera brenda këtij kapitulli parashohin shqiptimin e gjobës krahas dënimit me burgim. Në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me paragrafin 5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale. Nuk rekomandohet zëvendësimi i dënimit me burgim me dënimin me gjobë, në veprat më të rënda brenda këtij kapitulli me theks të veçantë në Nenin 275 të KPRK-së.
- Vërejtja gjyqësore - në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Nenit 82, vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për veprat më të lehta të këtij Kapitulli dhe nuk mund të aplikohet kur kryesi ka të kaluar kriminale.

## XI. Kapitulli XXIV Krimi i organizuar

### Shqyrtime të përgjithshme

Është interesant trajtimi që i ka bërë ligjvënësi krimit të organizuar duke e përfshirë në një kapitull të ndarë dhe atë vetëm me një nen në kuadër të KPRK- më saktë Neni 277.

Rastet e krimit të organizuar kërkojnë konsiderata të veçanta gjatë matjes së dënimit për shkak të natyrës shpesh të vazhdueshme dhe serioze të krimeve dhe faktit që shumë kryes janë recidivistë apo kriminel të karrierës. Shqyrtimi i kujdesshëm i seriozitetit të krimit, veprimtarisë së grupit kriminal dhe përgjegjësisë së kryesit në kuadër të grupit të organizuar është thelbësor për përcaktimin e dënimit adekuat. Krimi i organizuar dhe kriminelët e rëndomtë ndryshojnë në atë që krimi i organizuar është produkt i kriminelëve të karrierës me marrëdhënie kriminale shpesh më afatgjata, të cilët kryejnë krime që përfshijnë planifikim dhe organizim paraprak. Andaj edhe duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë që këta persona paraqesin, kërkohet edhe përgjigje adekuate.

Dënimi i duhur në rastet e krimit të organizuar është shumë i rëndësishëm për disa arsye:

- ✓ **Parandalim:** Dënimi efektiv ka efekt për ata që mund të mendojnë të angazhohen në krim të organizuar. Nëse ndëshkimet janë të rënda dhe të aplikuara në mënyrë të qëndrueshme, kriminelët e mundshëm do të jenë më pak të prirur të marrin pjesë ose të mbështesin aktivitete të tilla të paligjshme për shkak të frikës nga pasojat e rënda.
- ✓ **Drejtësia për viktimat:** Krimi i organizuar shpesh ka efekte të gjera dhe më të rënda në viktimat e tij, komunitetet dhe bizneset. Dënimi i duhur ndihmon për të siguruar që ata që janë përgjegjës për këto dëme të mbajnë përgjegjësi, duke ofruar një ndjenjë drejtësie për viktimat dhe familjet e tyre.
- ✓ **Shkatërrimi i rrjeteve kriminale:** Dënimi mund të përdoret strategjikisht për të shpërbërë rrjetet e krimit të organizuar. Duke shqiptuar dënime të përshtatshme ndaj anëtarëve të këtyre grupeve kriminale e sidomos të figurave kryesore, dobësohet aftësia e grupit për të kryer aktivitete të paligjshme dhe rrjedhimisht edhe zvogëlon ndikimin e tij të përgjithshëm.
- ✓ **Besimi i publikut:** Dënimi efektiv në rastet e krimeve të organizuara nxit besimin e publikut në sistemin e drejtësisë penale. Kur njerëzit shohin se krimet e rënda përballen me pasojat të përshtatshme, ata janë më të prirur të besojnë dhe të mbështesin sistemin e drejtësisë, si shtyllë kryesore për ruajtjen e rendit shoqëror. Kjo përmbush parimin se të gjithë individët, pa marrë parasysh statusin apo lidhjet e tyre, trajtohen njësoj në raport me standardet dhe pasojat e njëjta ligjore për veprimet e tyre.

#### A. Pikënisja

Në pajtim edhe me pikënisjet e parapara në secilin nga kapitujt e veçantë, pikënisja për pjesëmarrje ose organizim të grupit kriminal të organizuar **fillon nga 2/3 ndërmjet minimumit dhe maksimumit të dënimit të paraparë në Nenin 277.**

## B. Rrethanat rënduese relevante

Me rastin e matjes së dënimit për pjesëtarë të grupeve kriminale gjykata duhet të ketë parasysh një numër rrethanash të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit.

Duhet bërë një dallim në mes matjes së dënimit dhe vlerësimit të faktorëve me rëndësi për të përcaktuar dënimin për pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal me rastet kur vepra bazë parasheh dënim më të rëndë nëse ajo është kryer nga pjesëtarë të grupit të organizuar kriminal.

Përderisa për rrethanat rënduese e lehtësuese, lidhur me veprat bazë, është bërë fjalë në kapitujt përkatës, elaborimi i mëposhtëm ndërlihet kryesisht me rrethanat lidhur me veprën nga Neni 277, por që nuk kufizohet vetëm në to:

- Niveli i pjesëmarrjes: Natyrisht se grupet e organizuara kriminale operojnë në bazë të një strukture dhe hierarkie. Andaj është me rëndësi që në trajtim, gjykatat të konsiderojnë edhe rolin e individit në grupin e organizuar kriminal, si: a është i pandehuri udhëheqës, anëtar kyç apo një pjesëmarrës periferik. Gjykata duhet pasur parasysh se në rast se bëhet fjalë për personin që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtarinë e grupit kriminal, më nuk bëhet fjalë për rrethanë rënduese pasi kjo përbën element shtesë të figurës së veprës penale dhe trajtohet sipas paragrafit 2 të Nenit 277 e jo më si rrethanë rënduese nga neni 70 i KPRK-së në mënyrë që të shmanget dyfishimi.
- Niveli i angazhimit kriminal është po ashtu me rëndësi. Nëse për shembull një individ si pjesëtar i grupit ka marrë pjesë aktive dhe domethënëse në kryerjen e disa veprave, kjo në një formë tregon edhe për dashjen dhe vullnetin e tij për të kryer aktivitetet kriminale. Përkrahim bën nëse konstatohet se i njëjti ka kryer aktivitetet e tilla nën presion dhe kanosje për arsye të ndryshme me ç'rast fajësia e tij do të zvogëlohej proporcionalisht.
- Vlerësimi i natyrës së aktivitetit kriminal.- Serioziteti i aktiviteteve kriminale në të cilat është përfshirë organizata kriminale dhe pjesëtarët e saj duhet të vlerësohet me kujdes. Njëjtë vlen edhe për qëllimin për të cilin janë themeluar organizatat. Për shembull, nëse organizata është përfshirë në krime të dhunshme, trafikim me njerëz, trafik droge, terrorizëm ose mashtrime financiare në shkallë të gjerë, mund të marrë një dënim më të rëndë, pikërisht sipas shkallës së dëmit (financiar apo tjetër) të shkaktuar ndaj viktimave.
- Qëllimi i themelimit apo operimit të grupit kriminal.- përpos natyrës së veprave të kryera apo tentuara të grupit kriminal, është po aq e rëndësishme edhe qëllimi themelimit të një grupi të tillë. Kjo për faktin se ka dallim në mes natyrës së veprave penale me të cilat mund të fokusohet një organizatë kriminale krahasuar me tjetrën pasi veprat mund të jenë të natyrës mjaft të rëndë dhe me ndikim në masë. Andaj, kjo rrethanë duhet të merret në konsideratë e kombinuar me rrethanat tjera të listuara.
- Kamufliimi i aktiviteteve kriminale të organizatës.- paraqet një indikator me rëndësi për vlerësim nga gjykata. Ka organizata të cilat regjistrohen si persona juridik me veprimtari të rregullt, por që në fakt qëllimi i organizimit të tyre është kryesisht marrja me aktivitetet kriminale. Organizatat e tilla, kryesisht merren me shpërlarjen e parave nga aktivitetet e



paligjshme. Në anën tjetër, ka organizata që janë qartazi kriminale dhe janë themeluar për veprimtari kriminale, andaj si të tilla janë shumë të rrezikshme. Megjithatë, vlerësimi i gjykatës si në njërin ashtu edhe në rrethanën tjetër, duhet bazuar ekskluzivisht duke marrë në konsideratë edhe të gjitha rrethanat tjera.

- Pjesëmarrja ose lidhja me grupe tjera kriminale - Pjesëmarrja e të pandehurit në grupe tjera kriminale ose lidhja me to tregon për vendosmërinë e të tij në kryerjen e veprave dhe shkallën e lartë të dashjes, andaj rrjedhimisht, për shkak të lartësisë së dëmit që këto organizata mund të shkaktojnë, edhe dënimi duhet të jetë më i lartë.
- E kaluara kriminale e të pandehurit - është rrethanë mjaft me rëndësi si indikator të një modeli të vazhdueshëm të sjelljes kriminale që rrjedhimisht kërkon dënim më të lartë, veçanërisht veprat e natyrës së ngjashme dhe të dhunshme.

Natyrisht edhe rrethanat tjera të parapara me KPRK, të cilat mund të jenë specifike për vepra të caktuara të kryera nga grupi kriminal po ashtu janë të aplikueshme në kontekst të atyre veprave dhe kombinuar edhe me rrethanat për këtë kapitull.

### C. Rrethanat lehtësuese relevante

Neni 277 në paragrafin 4 ka paraparë në mënyrë specifike se “Gjykata mund të zbusë dënimin e anëtarit të grupit kriminal të organizuar i cili, para se grupi kriminal i organizuar të ketë kryer veprën penale, raporton në polici ose prokurori, ekzistimin, formacionin dhe jep informata për grupin kriminal të organizuar në detaje të mjaftueshme për të mundësuar arrestimin apo ndjekjen e grupit të tillë.” Kjo qartazi paraqet një rrethanë e cila lejon uljen e dënimit edhe nën minimumin ligjor nëse kontributi i të pandehurit në këtë aspekt është domethënës. Si rrethanë paraqitet në të njëjtat linja me rrethanën nga Neni 70 nën paragrafi 3.14<sup>327</sup> e cila vetëm se është më e detajuar për veprat e terrorizmit. Kështu nëse çështja ka të bëjë me kryerjen apo tentimin e kryerjes së veprave të terrorizmit nga grupi në këto raste do të gjente zbatim nën paragrafi 3.14 i Nenit 70 për ta vlerësuar si rrethanë jashtëzakonisht lehtësuese dhe do zbatohet paragrafi 4 në kuptim të lejimit të zbutjes së dënimit sipas vlerësimit edhe nën minimumin ligjor.

Rrethanat tjera me rëndësi në kuptim të pjesëmarrjes së një personi në grup të organizuar kriminal mund të jenë, por edhe të mos kufizohen me sa vijon:

- I pandehuri nuk ka të kaluar kriminale - Kjo mund të jetë një faktor i rëndësishëm lehtësues, duke treguar se krimi mund të jetë një ngjarje e izoluar.
- Pendimi dhe pranimi i përgjegjësisë - Tregimi i pendimit të sinqertë për krimin dhe marrja e përgjegjësisë për veprimet e veta mund të shihet si një shenjë e pendesës dhe mund të çojë në

---

<sup>327</sup> “Në lidhje me veprat penale të terrorizmit të përcaktuara në këtë Kod, fakti që kryesi i veprës penale heq dorë nga veprimtaria terroriste para se të ketë pasojë të rënda prej saj dhe i ofron policisë, prokurorëve ose autoriteteve gjyqësore informata të cilat ato nuk do të kishin mundësi t’i siguronin; ndihmon në parandalimin ose zbutjen e efekteve të veprës penale; identifikon me detaje të mjaftueshme për të lejuar arrestimin ose ndjekjen penale të ndonjë terroristi apo grupi terrorist; gjen prova apo parandalon vepra të tjera terroriste.”

një dënim më të ulët edhe pse duhet vlerësuar në raport me rrethanat tjera pasi përndryshe paraqet një element shumë subjektiv.

- Dhuna ose Kërcënimi - Nëse i akuzuari ishte i detyruar, kanosur apo shtrënguar të kryente veprën kjo mund të jetë një rrethanë lehtësuese me rëndësi, gjithnjë përderisa plotësohen kushtet që kërkohen me Nenin 14<sup>328</sup> dhe 15<sup>329</sup> të KPRK-së.
- Aftësia e zvogëluar mendore - Nëse kapaciteti mendor ose kognitiv i të akuzuarit ishte esencialisht i dobësuar duke çuar në një aftësi të zvogëluar për të kuptuar ose kontrolluar veprimet e tij/saj, kjo mund të jetë një rrethanë lehtësuese, gjithnjë në kuadër të vlerësimit të kësaj paaftësie sipas paragrafit 2 të Nenit 18 të KPRK-së.
- Abuzimi me substanca - Kur i pandehuri është person i varur nga droga apo alkooli mund të jetë një indikator i kufizuar në vlerësim të dënimit sa i përket pjesëmarrjes së tij/saj në grup kriminal. Kjo për faktin se i pandehuri në episodet kur nuk është nën ndikim të tillë, mund të gjykojë veprimet dhe vendimet e veta për bashkëngjitje në një grup të tillë. Nga ana tjetër nëse vlerësohet në aspekt të gjendjes së tij/saj në momentin e kryerjes së veprës atëherë vlerësohet sa është dëmtuar gjykimi i tij në momentin e kryerjes së veprës dhe gjithnjë duke pasur në konsideratë rrethanat tjera që lidhen me rolin, dashjen e tij/saj dhe rrethanat tjera të diskutuara më lartë e kurrsesi si e izoluar.
- Mosha e të pandehurit - Nëse i akuzuari është i mitur, madhor i ri apo në moshë të shtyrë, atëherë mund të merret si rrethanë lehtësuese, gjithnjë duke reflektuar potencialin e tij për rehabilitim ose kapacitetin e zvogëluar për të kuptuar veprimet e tij/saj me vet pjesëmarrje në grup kriminal dhe aktivitetet e atij grupi.
- Përpjekjet për Rehabilitim - Nëse i pandehuri ka bërë përpjekje për rehabilitim, si për shembull duke marrë pjesë në këshillim, trajtim për abuzimin me substanca ose programe edukative, kjo mund të shihet pozitivisht.
- Rrethanat personale pozitive të pandehurit - Dëshmia për atributet pozitive të pandehurit, si: një punë e qëndrueshme, lidhje të forta familjare, shërbim në komunitet ose kontribute në shoqëri, mund të ndikojnë në një dënim më të lehtë në kuadër të kufijve ligjorë dhe atë vetëm nëse mbizotërojnë rrethanat lehtësuese.

#### **D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera**

Dënimi me kusht - nuk është dënim i rekomanduar për anëtarë të grupeve kriminale përveç rasteve të jashtëzakonshme dhe kur plotësohen kushtet ligjore duke vlerësuar rrethanat në secilin rast.

Dënimi me gjobë - Neni 277 ka paraparë gjobat maksimale prej 250.000€ për anëtarë dhe 500.000€ për udhëheqës të grupeve kriminale. Natyrisht, kjo logjikë është përdorur duke pasur parasysh dispozitat edhe të pjesës së përgjithshme të KPRK-së, më saktësisht Nenit 43 paragrafi 2 i KPRK-

---

<sup>328</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 14 Dhuna dhe kanosja, Kodi Nr. 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>329</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 15 veprat e kryera nën shtrëngim, Kodi nr, 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

së. Llogaritja e gjobave më saktësisht, bazuar në këtë parim duhet bërë në pajtim edhe me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme lidhur me caktimin e gjobave penale.

Dënimet plotësuese - mund të gjejnë aplikim varësisht nga rasti në rast dhe nga natyra e pjesëmarrjes dhe kryerjes së veprave. Për organizatat kriminale që operojnë nën ombrellën e personit juridik vlejnë sanksionet sipas Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik.

Konfiskimi - është jashtëzakonisht me rëndësi duke qenë se u merr burimet dhe dobinë pasurore për të cilën edhe e kanë themeluar apo iu kanë bashkëngjitur organizatës kriminale.

Zbutja e dënimit - tashmë është diskutuar te rrethanat lehtësuese dhe është e lejuar nëse plotësohen kushtet sipas paragrafit 3 të Nenit 277.

## **XII. Kapitulli XXIV/A Krimet kibernetike**


### **Shqyrtime të përgjithshme**

Tani më e gjithë bota, sikurse edhe vendi ynë ka bërë përparime të mëdha drejt kalimit në një shoqëri të informacionit. Interneti, teknologjia e informacionit dhe komunikimit tani përshkon pothuajse çdo aspekt të jetës së njerëzve. Fakti që shoqëria po mbështetet në tërësi, e si rrjedhojë, po varet nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit e bën atë cak i sulmeve, si: krimi kibernetik, domethënë krimi i kryer kundër të dhënave dhe sistemeve kompjuterike ose nëpërmjet tyre. Krimi Kibernetik ka të bëjë me veprimtarinë kriminale të zhvilluar në rrjet, gjithashtu duke përdorur kompjuterin si cak ose si vegël, krimi kibernetik përveç veprave penale të veçanta që hyjnë në fushën e krimit kibernetik mund të përfshijë dhe mashtrimin, falsifikimet e ndryshme, zhvatjen, krimin financiar, spiunazhin, terrorizmin, krimin e organizuar, spiunazhin kibernetik, terrorizmin kompjuterik etj. Përveç një numri të madh veprash penale kundër teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ose nëpërmjet saj, një numër gjithmonë e më i madh i çështjeve të tjera që trajtohen në gjykatë po ashtu përfshijnë provat elektronike që janë ruajtur në një sistem kompjuterik ose në pajisje të tjera elektronike. Veprat penale të krimit kibernetik janë vepra që në shumicën e rasteve kanë karakter ndërkombëtar pra janë veprat më transnacionale të mundshme duke qenë se kryesisht këto vepra penale kryhen në, apo përmes teknologjisë-internetit.

Fusha e krimit kibernetik në Kosovë ka qenë e rregulluar me ligjin Nr. 03/L-166 Ligji për parandalimin dhe Luftimin e krimit kibernetik, i cili Ligj ka pësuar ndryshime pas hyrjes në fuqi të Ligji 08/L-173 Ligji për Sigurinë Kibernetike me të cilin janë hequr disa dispozita të Ligjit Nr. 03/L-166 . Kodi Penal i Republikës së Kosovës, më herët nuk ka paraparë Kapitull të veçantë për këto vepra penale. Në nëntor të vitit 2023, janë miratuar disa ndryshime të Kodit Penal me Ligjin Nr.08/L-188 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074 dhe me këto ndryshime është shtuar Kapitulli XXIV/A të KPRK-së si nënkaptull i Krimit të Organizuar dhe ky Kapitull emërtohet si “Krimet Kibernetike” në të cilin parashihen veprat penale që sanksionojnë veprat e krimit kibernetik, po ashtu me këtë ligj janë shfuqizuar veprat penale ekzistuese nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074, pra janë hequr Neni 232 Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi, Neni 327 Hyrja në sistemet kompjuterike dhe Neni 336 Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes. Duhet përmendur se fusha e krimit kibernetik rregullohet me Konventën e Këshillit të Evropës e quajtur si Konventa e Budapestit për krimin kibernetik e cila ende nuk është nënshkruar nga Republika e Kosovës pasi që ende nuk është anëtare e Këshillit të Evropës.

### **A. Pikënisja**

Me qëllim të harmonizimit të qasjes në matjen e dënimit për këto vepra penale, KPRK për tri situata të ndryshme ofron rekomandimin për pikënisjen e matjes së dënimit:



*-pikënisja nga 1/3 kur kryesit e veprave penale nuk kanë të kaluar penale, përkatësisht nuk kanë qenë më parë të dënuar, apo ka qenë laik në përdorimin e teknologjisë përkatësisht rrjeteve sociale, apo aplikacioneve dixhitale të ndryshme. Kryesit fillestar shpesh paraqesin rrezikshmëri më të ulët për përsëritje të kryerjes në krahasim me kryesit e tjerë me të shkuar të dhunshme ose ata që veprojnë në grupe. Për këto arsye, pikënisja është më e ulët për kryesit që për herë të parë bien ndesh me ligjin, megjithatë, kjo nuk do të thotë se ata nuk mund të jenë të rrezikshëm, prandaj vlerësimi i nivelit të dëmit dhe fajësisë është vendimtar për të përcaktuar dënimin e duhur.*

**Shënim me rëndësi:** Pikënisja prej 1/3 **NUK** vlen për matjen e dënimit të vepra nga neni 277/I<sup>330</sup> për shkak të ndjeshmërisë së këtyre rasteve. Për këto raste vlen pikënisja 1/2 pa marrë parasysh të kaluarën kriminale të kryesit.

*-pikënisja nga 1/2 kur kryerësit e veprave penale kanë të kaluar penale, përkatësisht kanë qenë më parë të dënuar për vepra të kësaj natyre dhe në rastet kur kjo vepër penale kryhet me qëllim të përfitimit pasuror, si dhe kanë pasur njohuri solide në përdorimin e teknologjisë përkatësisht rrjeteve sociale, apo aplikacioneve dixhitale të ndryshme.*

- pikënisja nga 1/2 për veprën nga Neni 277/I pa marrë parasysh nëse kryesi ka apo nuk ka të kaluar kriminale. Këto vepra janë të natyrës më të rëndë andaj edhe forma më e lehtë e tyre ka pikënisje më të lartë krahasuar me veprat tjera nga ky kapitull. Natyrisht se pikënisja pasuese prej 2/3 si më poshtë vlen edhe për këtë vepër nëse është shprehur në forma si më poshtë.

*-kurse pikënisja nga 2/3 për veprat e kryera nga personat pjesë e grupit të organizuar kriminal dhe/apo me shtrirje ndërshtetërore. Zakonisht kryesit janë ekspertë të teknologjisë dhe kjo vepër penale kryhet me qëllim të përfitimit pasuror të shumave të mëdha apo duke vepruar në disa shtete apo brenda një shteti por në disa vende të ndryshme dhe me qëllim të kryerjes së veprave penale me rrezikshmëri të lartë. Pikënisja sipas kësaj kategorie për shkak të këtyre karakteristikave do të*

<sup>330</sup> Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 06/L-074, Neni 277/I Materialet me përmbajtje të shfrytëzimit dhe keqpërdorimit seksual të fëmijëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.23, 23 Nëntor 2023, Prishtinë

ishite e përshtatshme nga 2/3 e maksimumit të dënimit, mirëpo duhet pasur parasysh që karakteristikat e lartë cekura të mos jenë të inkorporuara në veprat e veçanta penale.

Figura e mësipërme tregon qartazi dallimin mes formave të ndryshme të matjes së dënimit për këto vepra bazuar në natyrën dhe specifikat e këtyre veprave penale dhe varësisht nga natyra dhe pasojat që rezultojnë nga veprimet e ndërmarra përmes këtyre veprimeve.

Duke marrë parasysh se në këtë kapitull janë paraparë disa vepra penale specifike të karakteristikave të ndryshme përkatësisht veprimet kryese mund të cilësohen si të ndryshme, atëherë edhe përcaktimi i dënimeve është mjaft i ndryshëm si te dënimet me burgim gjithashtu edhe te dënimet me gjobë. Te dënimet e përcaktuara me gjobë për disa nga këto vepra penale, nuk është përcaktuar as minimumi dhe as maksimumi andaj llogaritja e gjobës, për të pasur efektin e duhur duhet llogaritur në pajtim me Udhëzuesin për matjen e gjobës.

Sa i përket dënimeve me burgim për disa nga veprat penale të natyrës së rëndë është paraparë vetëm minimumi i dënimit me burgim e për të cilat vlen maksimumi ligjor i dënimit me burgim, kurse te disa vepra tjera është përcaktuar kufiri në mes minimumit dhe maksimumit ligjor. Në përgjithësi, te këto vepra penale kufiri në mes minimumit dhe maksimumit ligjor të dënimit me burgim nuk është shumë i lartë përveç disa veprave specifike ku është një kufi mjaft i lartë e që për dy vepra penale është një margjinë e lartë e dënimit duke filluar nga tri (3) vjet e deri në dhjetë (10) vjeje, si dhe nga pesë (5) vjet e deri pesëmbëdhjetë (15) vjet.

## **B. Rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese**

Me rastin e caktimit të dënimit për vepra penale në përgjithësi, gjykata duhet që të ketë parasysh, përveç çështjeve tjera, edhe rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese. Për shkak të natyrës specifike të veprave penale që bëjnë pjesë në këtë Kapitull është vështirë që të përcaktohet se cila nga rrethanat mund të kenë peshë më të madhe se sa rrethanat tjera të kësaj natyre. Sikurse edhe te kapitujt tjerë të pjesës së posaçme të KPRK-së, edhe te ky Kapitull i veprave penale, rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese mund të jetë të shumta dhe të natyrave të ndryshme, varësisht nga natyra e veprës penale, cilësive personale të kryesit të veprës penale dhe të viktimës, si dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra penale, por jo vetëm. E rëndësishme është që gjykatat të kenë në konsideratë edhe rrethanat tjera rënduese dhe lehtësuese, përveç atyre të parashikuara në nenin 69, paragrafi 3 dhe nenin 70, paragrafët 2 dhe 3 të KPRK-së, duke i pasur parasysh specifikat e secilit rast veç e veç, pasi që në këto dispozita ligjore janë parashikuar lista jo shteruese të rrethanave përkatëse rënduese dhe lehtësuese.

## **C. Rrethanat rënduese**

Te veprat penale të krimit kibernetik rrethanat rënduese mund të jenë të natyrave të ndryshme sidomos duke pasur parasysh natyrën specifike të këtyre veprave penale dhe kjo varet nga secili rast veç e veç.

Rrethanat potenciale rënduese nga neni 70 i KPRK-së do ti zbërthejmë si më poshtë:

- *shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, duke ndërmarrë veprime të shumta me qëllim të kryerjes së veprave penale të caktuara;*
- *shkallën e lartë të dashjes nga ana e personi të dënuar, duke vepruar me dashje direkte dhe me një paramendim të theksuar me qëllim të kryerjes së veprës penale dhe realizimit të pasojave të saj;*
- *nëse veprat penale janë kryer në mënyrë të vazhdueshme, pasi që te këto vepra penale veprimet, në shumicën e rasteve, kryhen në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë të gjatë kohore. Ky paraqitet si faktor me rëndësi jo vetëm për të treguar nivelin e dashjes së kryesit dhe këmbëngulësinë e tij, por edhe për të treguar seriozitetin e veprës. Andaj, si rrethanë duhet të ketë peshë mjaft të madhe në matjen e dënimit;*
- *qëllimin dhe motivin për kryerjen e veprave penale të caktuara, pasi që në shumë raste këto vepra penale nga ky Kapitull në fund të fundit kryhen me qëllime dhe motive të përfitimit të kundërligjshëm pasuror;*
- *shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përkatësisht intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur është një rrethanë që duhet të merret në konsideratë duke qenë se dëmi apo pasojat e shkaktuara me këto vepra penale mund të jenë katastrofike jo vetëm për individin por edhe për vet shtetin. Kjo rrethanë është reflektuar edhe më sipër në listën e indikatorëve. E kombinuar me rrethanat nga paragrafët 2.5-2.7 të Nenit 70 duhet të kenë peshë të madhe në matjen e dënimit, duke qenë se veprat e kësaj natyre kanë potencialin e ndikimit edhe ndaj viktimave të moshave të ndryshme dhe me ndjeshmëri të ndryshme. Natyrisht kur është fjala për veprën nga Neni 277/I fakti se viktima është fëmijë automatikisht përfshin si element të veprës si moshën ashtu edhe ndjeshmërinë. Megjithatë, duke qenë se neni në fjalë nuk kualifikon me saktësi moshën e fëmijës, përdorimi i rrethanave nga paragrafët 2.6 dhe 2.7 arsyetohet në kuptim të elaborimit të rrethanave për kontestin në të cilin është kryer vepra. Po ashtu, kur bëhet fjalë edhe për persona të moshuar, edhe ata hyjnë në kategorinë e viktimave të ndjeshme dhe jo rrallë mund të bien pre e krimeve të ndryshme kibernetike me theks në rastet e vjedhjes së identitetit apo kredencialeve, me pasoja shkatërruese për jetën dhe të ardhmen e tyre. Për fund duhet rikujtuar se te pikënisja më sipër është trajtuar konteksti i shtrirjes transnacionale andaj e njëjta nuk mund të rillogaritet edhe si rrethanë rënduese. Nëse sjellja kriminale ndërlihet me veprimet që përbëjnë krim kibernetik, sipas Ligjit për Sigurinë Kibernetike<sup>331</sup>, gjyqtari duhet të ketë parasysh, mes tjerash, edhe rrethanat rënduese si në vijim:*
  - numri i përdoruesve të prekur nga incidenti kibernetik, në veçanti përdoruesit që mbështeten në shërbimin, për ofrimin e shërbimeve të tyre.
  - kohëzgjatjen e incidentit kibernetik.
  - shtrirjen gjeografike në lidhje me zonën e prekur nga incidenti kibernetik;
  - shtrirja e ndërprerjes së funksionimit të shërbimit.
  - shtrirja e ndikimit në aktivitetet ekonomike dhe shoqërore.

<sup>331</sup> Ligji nr.08/L-173 për sigurinë kibernetike, Neni 8 Detyrimi i ofruesit të shërbimeve digjitale për të njoftuar për incidentin kibernetik, paragrafi 2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.4, 27 shkurt 2023, Prishtinë.

- nëse vepra penale është kryer si pjesë e një grupi apo veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal tashmë është llogaritur në kontekst të pikënisjes andaj edhe nuk do të duhej rillogaritur edhe si rrethanë rënduese;
- ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar - recidivizmi është llogaritur te përcaktimi i pikënisjes më lartë. Megjithatë, sa i përket dënimeve të mëparshme të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së;
- rrethanat konkrete në të cilat është kryer vepra penale përkatëse – Kjo rrethanë në një formë është integruar në kuadër të shkallës së dëmit dhe indikatorëve të listuar më sipër por mund të ekzistojë edhe ndonjë rrethanë tjetër që e bën të aplikueshme;
- rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, si dhe ndonjë rrethanë tjetër rëndësuese, që vlerësohet si e tillë nga ana e gjykatës;
- Si rrethanë që nuk është paraparë në kuadër të KPRK-së, por që mund të gjej zbatim edhe në këtë kategori të veprave, *mund të jetë edhe kryerja e krimit kibernetik në emër të një shteti tjetër* për qëllime të ndryshme, përfshirë edhe ato për përfitime ekonomike. Në këto raste mund të paraqitet si rrethanë rënduese me peshë të konsiderueshme përveç nëse nuk është akuzuar ka elemente të një vepre të veçantë si për shembull kapitulli XIV.

#### **D. Rrethanat lehtësuese**

Natyra specifike e veprave të krimit kibernetik e bën të vështirë përcaktimin e ndonjë rrethane të veçantë lehtësuese kështu që është vështirë që të përcaktohet se cila nga rrethanat lehtësuese mund të ketë peshë më të madhe se sa rrethanat tjera të kësaj natyre.

Megjithatë, bazuar edhe në praktikën tonë gjyqësore, sikurse te veprat tjera penale edhe te këto vepra penale pranimi i fajësisë është njëra prej rrethanave që merret për bazë si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit për kryerjen e veprave penale nga ky Kapitull. Por, siç është potencuar edhe në kapitujt tjerë, pranimi i fajësisë nuk duhet ta ulë dënimin me automatizëm nën minimumet ligjore. Në rastet kur pranimi i fajësisë shoqërohet edhe me rrethana tjera 225 lehtësuese (p.sh. sjellja e mëparshme e kryesit, keqardhja e shfaqur, kompensimi i dëmit apo shprehja e gatishmërisë për kompensimin, gjendja ekonomike gjendja e rëndë shëndetësore e kryesit apo e ndonjë anëtarit të ngushtë të familjes së tij, etj.), atëherë një dënim më i butë mund të jetë i justifikuar, kuptohet duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret.

Edhe rrethanat personale dhe karakteri i kryesit të veprës penale; dëshmia që kryesi ka luajtur rol relativisht të vogël në kryerjen e veprës penale; fakti që kryesi ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor, por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër, mandej moshja e kryesit (i ri apo i moshuar); bashkëpunimi i kryesit të veprës penale me gjykatën dhe organet e ndjekjes, si dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale mund të



trajtohen si rrethana lehtësuese, normalisht duke i pasur në konsideratë specifikat e secilit rast veç e veç.

Bazuar në faktin se këto vepra janë të natyrës së tillë që kryesisht kryhen me ngulm dhe me një përvojë dhe aftësi të veçantë nga ana e kryesit pasi rrallëherë ndodh të zhvillohen në një instancë të vetme, arsyeton konstatimin se rrethanat lehtësuese në këtë rast, nuk duhet në asnjë rast të mbizotërojnë rrethanat rënduese.

## **E. Aplikueshmëria e dënimeve tjera**

Pa dyshim se edhe kur është fjala për vepra penale të krimit kibernetik duke pasur parasysh dënimin që parashihet për këto vepra penale, në situata të caktuara duhet pasur në konsideratë edhe shqiptimin e disa dënimeve tjera.

*Dënimi me kusht* - është i përshtatshëm që të zbatohet në rastet e caktuara, duke i zbatuar dispozitat e nenit 47, 48, dhe 49 KPRK-së. Nën rrethana të caktuara, është në veçanti e rëndësishme që gjykatat ta shqiptojnë dënimin me kusht, duke vendosur që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar kryesi i veprës penale nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenson dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet tjera, sidomos detyrimin nga *neni 56 par. 1 pika 1.14 të KPRK-së (të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata).*

*Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës* - më saktësisht paragrafi 5 i këtij neni ka paraparë që gjykata kryesit të veprës penale ndaj fëmijës nga neni 165 apo Kapitulli XX i këtij Kodi t'i shqiptojë ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës që përfshin kontaktin e rregullt me fëmijë dhe atë në kohëzgjatje të përgjeshme duke iu nënshtuar shqyrtimit periodik gjyqësor nga gjykata pas skadimit të dhjetë (10) vjetëve nga fillimi i ekzekutimit të masës së shqiptuar. Me plotësim ndryshimet e KPRK-së të vitit 2023, Neni 232<sup>332</sup> i Kodit të kaluar, është fshirë dhe përmbajtja e ngjashme e këtij neni ka kaluar në kapitullin e ri XXIV/A si nen i ri 277/I i titullar tashmë si “Materiallet me përmbajtje të shfrytëzimit dhe keqpërdorimit seksual të fëmijëve”. *Rrjedhimisht, në logjikën e kësaj, do të duhej që gjykata të ketë mundësi të shqiptojë masën e tillë edhe për kryesit e veprave nga neni 277/I.*

*Dënimi me gjobë* – Për disa nga veprat penale të këtij kapitulli parashihet në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe dënimi me burg, andaj gjoba detyrimisht duhet të shqiptohet duke i pasur në konsideratë kriteret e parashikuara me ligj. Në këtë aspekt, duhet theksuar se me rastin e caktimit të dënitimit me gjobë, gjykata duhet të merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Andaj, është e rëndësishme që me rastin e shqiptimit të dënitimit me gjobë, gjykatat të kenë në konsideratë Udhëzuesin specifik të Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Ndërsa, me rastin e caktimit të dënitimit me gjobë ndaj personave juridik për vepra penale nga ky Kapitull, gjykatat

<sup>332</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Kapitulli XX, Neni 232 Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

duhet t'i kenë parasysh rrethanat e parashikuara me Ligjin për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.

Konfiskimi – Te veprat penale të krimit kibernetik konfiskimi është i detyrueshëm, në bazë dispozitave të nenit 277/L të Ligjit Nr.08/L-188 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, i cili parasheh Konfiskimin e pajisjeve elektronike dhe ky nen përcakton se Pajisjet dhe programet elektronike që përdoren për kryerjen e veprave penale të këtij Kapitulli, konfiskohen sipas Kodit të Procedurës Penale.

Lirimi nga dënimi nuk mund të aplikohet te veprat e këtij kapitulli.

## **XIII. Kapitulli XXV Veprat penale kundër ekonomisë**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Ekonomia dhe sistemi ekonomik i një vendi janë segmente me rëndësi vitale të jetës shoqërore. Bazuar në rëndësinë, që ka ekonomia për mirëqenien shoqërore, shteti angazhohet që të krijojë politikë ekonomike e cila i përshtatet nevojave dhe interesave shoqërore. Paralelisht me politikën ekonomike, nxirren edhe norma juridiko-penale, që parashohin masa ndëshkuese për veprime të caktuara më të cilat rrezikohen marrëdhëniet ekzistuese në ekonominë e një vendi.

Kriminalitetin ekonomik mund ta përkufizojmë si forma të llojllojshme të sjelljeve (veprimeve ose mosveprimeve) kriminale të personave fizik dhe juridik në sferën e qarkullimit financiar dhe në afarizëm, të drejtuara kundër sistemit ekonomik, të cilat rrezikojnë të atakojnë dhe të dëmtojnë sistemin ekonomik dhe marrëdhëniet ekonomike të një vendi.

KPRK-ja në Kapitullin e XXV ka përcaktuar tridhjetë e pesë (35) vepra penale kundër ekonomisë. Këto vepra penale janë të drejtuara kundër interesave ekonomike të një vendi. Sa i përket motivit për kryerjen e këtyre veprave penale, më së shumti, ato janë të motivuara për përfitim pasuror për veti ose për tjetrin. Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Kodi Nr.06/L-074 ka përcaktuar format themelore të inkriminimit ligjor, gjithashtu në kuadër të këtyre veprave penale është e përfshirë edhe vepra penale e Shpërlarjes së parasë dhe Financimit të terrorizimit e cila dënohet sipas Ligji nr. 05/l -096 për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Karakteristikë kryesore të veprave penale në fushën e ekonomisë janë përfitimi material ose të mirat tjera. Si kryes të këtyre veprave penale mund të paraqiten personat fizik dhe juridik, personat me përgjegjësi të caktuar apo secili person. Andaj edhe elaborimi i mëposhtëm do të përfshijë diskutim ndaras për personat fizik nga ata juridik.

### **1. Matja e dënimit për personat fizik**

#### **A. Pikënisja**

Kur është fjala për pikënisjen për persona fizik, është bërë dallimi në mes veprave penale me dënim më të ulët, mesatare dhe maksimale.

Lartësia e dënimit së veprave penale është çështje e dispozitave ligjore. Ky kategorizim është i thjeshtë dhe bazohet eskuzivisht në shkallën e dënimit, duke bërë një ndarje e cila ndihmon për të caktuar pikënisjen mbi të cilën do të orientohen gjyqtarët për të përcaktuar dhe shqiptuar dënimin e duhur.



Siç shihet nga grafiku veprat penale me dënim të ulët pikënisja në matjen e dënimit është 1/3 nga dënimi i përcaktuar, në varësi të rrethanave rënduese apo lehtësuese lëvizet nga ky pozicion dhe përfshin dënimin deri në 5 vjet burgim.

Për veprat penale me dënime mesatare, që përfshin veprat penale prej 5-10 vjet burgim, ka përcaktuar pikënisjen prej 1/2 e dënimit, duke marrë parasysh peshën e veprës penale, në varësi të rrethanave lehtësuese apo rënduese gjykata do të lëvizë në drejtim të maksimumit apo minimumit të dënimit.

Të vetmet vepra me dënim më të lartë (mbi 10 vjet) janë veprat nga nenet 294<sup>333</sup>, 306<sup>334</sup>, dhe nenin 302<sup>335</sup> të cilët referojnë në dënimin sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe për të cilin parashihet dënimi nga 5 deri në 15 vjet burgim.

## B. Rrethanat rënduese

Në matjen e duhur të dënimit, rëndësi të posaçme nevojitet ti kushtohet rrethanave rënduese në të cilat është kryer vepra penale, të përcaktuara edhe në nenin 70 par. 2 të KPRK-së:

- **Keqpërdorimi i pushtetit apo autorizimeve** të kryesit të veprës penale qoftë ai personi zyrtar apo personi përgjegjës, merren si rrethane rënduese, edhe pse në shumë nga veprat penale sipas këtij kapitulli personi zyrtar apo personi përgjegjës paraqiten si element i veprës penale, andaj edhe në këto raste duhet shmangur dyfishimi.
- **Shkalla e dëmit ekonomik**- karakteristikë e shumë prej veprave të këtij kapitulli është përfshirja e shkallëve të ndryshme të dëmit për të lëvizur në dënim andaj edhe shkalla e dëmit (dhe atë kryesisht sa i përket dëmit të kuantifikueshëm financiar) është e shënuar. Megjithatë, edhe brenda të njëjtës kategori ekziston mundësia e dallimit në mes shkallës së dëmit duke pasur parasysh edhe dëme tjera, përtej financiare, që mund të jenë të ndërlydhura. Marrim shembull veprën penale Lidhja e kontratës së dëmshme nga Neni 285 i KPRK-së, ku në paragrafin 2 përmendet shkaktimi i dëmit mbi 100.000€ e që sipas Neni 113 të KPRK-së i bie të jetë dëm në shkallë të madhe. Megjithatë me rastin e vendosjes

<sup>333</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 294 Organizmi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, paragrafi 3, Kodi nr, 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>334</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 306 Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë, paragrafi 3, Kodi nr, 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>335</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 302 Shpërlarja e parave, Kodi nr, 06/L-074, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

duke qenë se ky paragraf parasheh vetëm pragun e ulët, i bie që dëmi i shkaktuar mund të arrijë shifra shumë më të larta andaj edhe gjykata në bazë të kësaj mund të vendosë nëse cakton dënim kah minimumi apo maksimumi i paraparë. Natyrisht, gjykata po ashtu me konsiderimin e shumës së dëmit financiar duhet të ketë parasysh edhe dëmet tjera si p.sh. Ndikimi në shëndetin publik, mjedisin, kategori të caktuara etj. që të përcaktojë në mënyrë adekuate dëmin apo shkatërrimin si rezultat i kësaj vepre.

- **Periudha e veprimit të kundërligjshëm** – nëse veprimet e kundërligjshme kane zgjatur një periudhë të gjatë kohore kjo tregon jo vetëm një këmbëngulje dhe dashje të kryesit, por edhe paraqitet si një indikator që domosdoshmërisht do të duhej të çonte në dënim më të lartë.
- **Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar** - në çfarë mase është angazhuar personi në kryerjen e veprës penale, apo në rastet e bashkëkryerjes apo bashkimit kriminal në çfarë shkalle dhe mënyre ka qenë i përfshirë personi në kryerjen e këtyre veprave.
- **Numri i viktimave** – nëse vepra penale ka prekur siç u tha edhe më sipër edhe një numër të madh individësh ose subjekte ekonomike, paraqet rrethanë rënduese.
- **Ndikimi në tregun ekonomik**- nëse vepra penale ka shkaktuar destabilizim ose ka ndikuar negativisht në tregun ekonomik e rrjedhimisht ato viktimat finale të një destabilizimi të tillë janë qytetarët pasi ndikon në ekonominë e tyre familjare.
- **Përfitimi personal** – lartësia apo shuma e përfituar nga kryesi i veprës penale është rrethanë rënduese në rastet kur vetë lartësia e dëmit nuk është element kualifikues i veprës penale.
- **Dënimet e mëparshme apo recidivizimi** – te personat të cilët janë recidivistë e sidomos të veprave penale të natyrës së njëjtë duhet të merret si rrethanë rënduese. Ndërkaq sa i përket dënimeve të mëparshme të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizimit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

### C. Rrethanat lehtësuese

Rrethana lehtësuese mund të merren rrethanat e përcaktuara sipas nenit 70 par. 3 të KPRK-së. Duhet pasur natyrën dhe llojshmërinë e këtyre veprave, gjykatat duhet pasur kujdes në varësi të veprës konkrete edhe t'i japin peshën e duhur rrethanave lehtësuese, në veçanti, shkallës së përgjegjësisë penale dhe dëmit konkret të shkarkuar.

- **Pranimi i fajësisë apo marrëveshja mbi pranimin e fajësisë** në veprat me dënime maksimale dhe mesatare sipas këtij kapitulli, nuk duhet të konceptohet si zbutje automatike nën minimumin ligjor në rastet kur të njëjtat nuk shoqërohen me rrethana tjera jashtëzakonisht lehtësuese.
- **Rehabilitimi apo kthimi i dëmit** – nëse kryerësi ka kthyer vlerat e përvetësuar ose ka riparuar dëmin ekonomik të shkaktuar, mund ti merret si rrethanë lehtësuese.
- **Dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël** në kryerjen e veprës penale - Fakti se personi ka luajtur rol minor ose të varur nëse vepronte me të tjerët/kryente një rol të kufizuar nën drejtim. Fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor, por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër.

- **Rrethanat personale** – gjendja e vështirë personale ose familjare e kryesit të veprës penale.

Rrethana lehtësuese mund të merren rrethanat tjera të përcaktuara sipas nenit 70 par. 3 të KPRK-së.

Duhet pasur natyrën dhe llojshmërinë e këtyre veprave, gjykatat duhet pasur kujdes në varësi të veprës konkrete edhe ti japë peshën e duhur rrethanave lehtësuese, në veçanti, shkallës së përgjegjësisë penale dhe dëmit konkret të shkaktuar.

#### **D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera**

-Shqiptimi i dënimit me kusht - mund të jetë i përshtatshëm zbatimi i këtij dënimi nga gjykata për veprat nga ky kapitull. Por, gjykatat duhet gjithmonë të marrin parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar nga kryesi. Shqiptimi i dënimit me kusht mund të jetë i arsyeshëm për kryesit që për herë të parë bien ndesh me ligjin dhe atë për format më të lehta të veprave penale kur nuk janë të shoqëruar nga rrethana tjera posaçërisht rënduese.

-Shqiptimi i dënimit me gjobë - Në disa vepra penale të përcaktuara në këtë kapitull, parashihet mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë si dënim kryesor dhe atë si dënim alternativ karshi dënimit me burgim. Megjithatë, në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që lartësia e gjobës së caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me dispozitën e nenit 69 par. 5 të KPRK-së dhe po ashtu edhe duke aplikuar Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale. Nuk rekomandohet zëvendësimi i dënimit me burgim me dënimin me gjobë, në veprat më të rënda brenda këtij kapitulli. Gjykata duhet po ashtu të ketë parasysh caktimin e dëmshpërblimit duke qenë se veprat nga ky kapitull kanë potencialin e shkaktimit të dëmeve pasurore të mëdha.

-Shqiptimi i dënimit plotësues - kryesit të veprave penale nga ky kapitull është veçanërisht i rëndësishëm shqiptimi i dënimeve plotësuese nga nenet 62 dhe 63 kur kryesi kryen veprat nga ky kapitull me keqpërdorim të detyrës zyrtare apo autorizimeve si person përgjegjës te personat juridik.

-Vërejtja gjyqësore - te ky kapitull i veprave penale mund të shqiptohet në rastet kur parashihet dënim deri në një (1) vit burgim dhe duhet pasur parasysh se vepra penale të kryhet në rrethana veçanërisht lehtësuese.

-Lirimi nga dënimi - në këtë kapitull të veprave penale nuk është paraparë mundësia që kryerësi mund të lirohet nga dënimi, andaj dispozita e nenit 74 të KPRK-së nuk mund të aplikohet.

-Konfiskimi - në disa vepra penale të këtij kapitulli është përcaktuar konfiskimi obligativ i sendeve apo mallrave.

## 2. Matja e dënimit për Personin Juridik

Duke qenë se veprat e kësaj natyre kryesisht ndërliohen me personat juridik, është e rëndësishë vitale caktimi i sanksionit edhe për personin juridik. Sipas Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale<sup>336</sup>, personit juridik për vepra penale mund të shqiptohen këto sanksione:

- Dënimet,
- Dënimet me kusht dhe
- Masat e sigurisë.

Llojet e dënimeve që mund të shqiptohen për vepra penale të personit juridik janë: dënimi me gjobë dhe pushimi i personit juridik.

### A. Dënimi me gjobë

Dënimi me gjobë te personat juridik mund të shqiptohet nga 1000 Euro deri në 100000 Euro. Sa i përket dënimit me gjobë Neni 9 i Ligjit jep minimumin dhe maksimumet e dënimit me gjobë, varësisht nga lartësia e dëmit të shkaktuar. Si gjithnjë, duhet rikujtuar se caktimi i dëmshpërblimit duhet gjithnjë të ketë përparësi krahasuar me dënimin me gjobë.

*Rrethanat me ndikim në matjen e dënimit me gjobë për personat juridik*

Caktimi i gjobës adekuate për personat juridik është kyç në heqjen e motivit për të cilin këto subjekte angazhohen në aktivitete të paligjshme. Sikurse edhe te dënimi me burgim për persona fizik, Ligji në fjalë në Nenin 10 ka përcaktuar edhe rrethanat që mund të ndikojnë në lartësinë e gjobës andaj edhe gjykata është e obliguar ti merr parasysh:

- matjen e veprës penale, të kryer.
- pasojat që kanë lindur ose që kanë mundur të lindin.
- rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.
- fuqinë ekonomike dhe madhësinë e personit juridik.
- pozitën dhe numrin e personave përgjegjës në personin juridik të cilët kanë kryer veprën penale.
- sjellja e personit juridik pas kryerjes së veprës penale.
- masat të cilat i ka ndërmarrë personi juridik me qëllim të pengimit dhe zbulimit të veprës penale.
- raporti ndaj viktimës së veprës penale.
- sjellja e personit juridik ndaj veprës së kryer penale, duke përfshirë dhe pranimin e përgjegjësisë për veprën e kryer penale.

Sipas paragrafit 2 të po të njëjtit nen Gjykata do të konsiderojë posaçërisht:

- nëse personi juridik është dënuar më parë për veprën penale,
- vepra penale e kryer më parë a është e njëllotë me veprën e re penale, dhe
- sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm.

<sup>336</sup> Ligji Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.16/14 shtator 2011, Prishtinë.

Ligji po ashtu lejon edhe zbutjen e dënimit nëse këtë e parashikon ky ligj apo ligji me të cilin është paraparë vepra penale, apo në qoftë se ekzistojnë rrethanat veçanërisht lehtësuese.

Për fund, ligji parasheh edhe ashpërsimin e dënimit me gjobë për recidivizëm jo vetëm për personin juridik por edhe personin përgjegjës dhe atë me të njëjtat parime sikurse të KPRK, pra deri dyfishin e shumës së masës më të lartë të dënimit, në qoftë se kryesi është recidivist i shumëfishtë. Më pas Ligji trajton edhe rastet kur konsiderohet recidivizëm i shumëfishtë.

#### *Llogaritja e dënimit me gjobë për persona juridik në SHBA*

Për të ilustruar edhe praktikën dhe rregullativën e vendeve tjera, ky titull i dedikohet mënyrës se si në SHBA është paraparë llogaritja e gjobave për persona juridik. Krahas Udhëzuesve për matjen e dënimit, Komisioni i SHBA-ve për matjen e dënimit (tutje Komisioni) ka paraparë edhe mënyrën e matjes së dënimit me gjobë. Kështu sipas Publikimit “Gjobat për Organizatat”<sup>337</sup>Konsiderata kryesore për gjykatën është diferencimi nëse:

- **Organizata që vepron kryesisht për qëllime kriminale ose kryesisht me mjete kriminale**, me ç’rast gjykata shqipton gjobën në një shumë deri në maksimumin e paraparë ligjor, të mjaftueshme për ta zhveshur organizatën nga të gjitha asetet neto të saj. Ky dokument po ashtu jep përkufizimin e shprehjes “Asete neto” si asetet të mbetura pas pagesës së të gjitha kërkesave legjitime të kreditorëve bona fide. Ndërkaq, në rastet kur nuk dihet vlera e përgjithshme e aseteve të organizatës, atëherë gjykata cakton gjobën maksimale të lejuar me ligj, në mungesë të kreditorëve me mirëbesim.
- **Organizatat tjera të cilat nuk operojnë kryesisht për qëllime kriminale apo përmes mjeteve kriminale**, ku në këto raste caktimi i gjobës varet nga dëmi i cili është i kuantifikueshëm.

Sa i përket rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit me gjobë, sipas Komisionit, lartësia e gjobës varet nga niveli i përgjegjësisë/fajësisë së organizatës. Rrethanat që reflektojnë këta faktorë janë:

- Niveli i personelit - nëse bëhet fjalë për personel të nivelit të lartë në Organizatë ose njësi organizative (si p.sh Udhëheqësit e organizatës apo njësisë organizative apo bëhet fjalë për nivel të mesëm) që marrin pjesë, tolerojnë apo me dashje injorojnë veprimtarinë kriminale.
- E kaluara e organizatës.
- Nëse organizata ka shkelur një urdhër paraprak të gjykatës.
- Pengimin e drejtësisë.

Nga ana tjetër si rrethana lehtësuese që merren në konsideratë për të ulur nivelin e përgjegjësisë dhe atë:

---

<sup>337</sup> Gjobat për organizata, Zyra e Këshilltarit të përgjithshëm, Komisioni për matjen e dënimit [*Premier, Fines for Organizations, Office of the General Counsel, United States Sentencing Commission*], Washington DC, May 2023, vizituar së fundmi më 10 korrik 2024 <https://www.ussc.gov/guidelines/primers/fines-organizations>



- nëse vepra është raportuar paraprakisht.
- nëse organizata ka një program efektiv të Etikës.

### **B. Pushimi i personit juridik**

Sipas Ligjit në fuqi, për personin juridik që është themeluar me qëllim të kryerjes së veprave penale apo veprimtarinë e ka shfrytëzuar kryesisht për kryerjen e veprave penale shqiptohet dënimi për pushimin e personit juridik. Përfundim nga kjo përbëjnë njësitë e vetëqeverisjes lokale apo partitë politike.

### **C. Dënimi me kusht për personin juridik**

Personit juridik për vepër penale gjykata mund t'ia caktojë dënimin me kusht deri në 50.000 Euro për një periudhë kohore jo më pak se dy vjet. Ky dënim është paraparë me Nenin 12 të Ligjit. Sa i përket kushteve për shqiptimin e dënimeve, efektit të tij dhe revokimit të dënimit zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e KPRK-së. Në dënimin me kusht gjykata mund të caktojë se dënimi do të zbatohet edhe nëse personi juridik i dënuar në afatin e caktuar:

- nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale,
- nuk e kompenson dëmin të cilin e ka shkaktuar me veprën penale apo
- nuk i plotëson detyrimet tjera të parapara në dispozitat penalo-juridike.

### **D. Masat e sigurisë**

Ligji në Nenin 13 ka paraparë edhe disa masa të sigurisë të cilat mund ti shqiptohen personit juridik duke dhënë detaje më tutje edhe për secilën prej tyre:

- Ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të caktuara,
- Marrja e sendit, konfiskimi i dobisë pasurore dhe
- Shpallja publike e aktgjykimit.

## XIV. Kapitulli XXVI Veprat penale kundër pasurisë

### Shqyrtime të përgjithshme

Veprat penale kundër pasurisë konsiderohen një ndër kapitujt më të rëndësishëm të pjesës së posaçme të KPRK-së. Këto vepra penale bëjnë pjesë në kuadër të të ashtuquajturit “kriminalitet klasik”, ngase shumica e tyre kanë qenë të njohura edhe në ligjet më të vjetra penale. Ky Kapitull i veprave penale është i njohur, me disa ndryshime të vogla, në të gjitha ligjet penale të shteteve bashkëkohore.<sup>338</sup>

Në përgjithësi, objekt mbrojtës primar i këtij Kapitulli të veprave penale është pasuria. Me termin “pasuri” kuptojmë sendet e paluajtshme, sendet e luajtshme, si dhe të drejtat dhe interesat pasurore të cilat i takojnë subjekteve të së drejtës (personave fizik dhe juridik). Mirëpo, duhet theksuar se pasuria mbrohet edhe me kapitujt tjerë të KPRK-së, p.sh. Kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë; Kapitullin korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare; Kapitullin e veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, etj. Ndryshe nga Kapitujt tjerë të KPRK-së, në të cilët gjithashtu në mënyrë indirekte garantohet dhe mbrohet pasuria, në Kapitullin e veprave penale kundër pasurisë garantohet mbrojtja parësore dhe e drejtpërdrejtë e pasurisë.<sup>339</sup>

Pasuria, përveç me dispozitat ligjore të KPRK-së, është e mbrojtur edhe me akte tjera juridike. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se pasuria mbrohet dhe garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 46), pastaj me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,<sup>340</sup> si dhe me ligje tjera civile.

Duhet theksuar, se shteti mbrojtjen e pasurisë, parimisht e realizon me dispozitat e ligjeve civile dhe ekonomike, kurse me dispozitat e ligjeve penale vetëm atëherë kur rrezikimi, dëmtimi apo marrja e pasurisë, bëhet duke e përdorur dhunën, kanosjen, mashtrimin dhe veprimet tjera të rrezikshme.

Shumicën e veprave penale të këtij Kapitulli mund t’i kryejë çdo person (*delicta communia*). Mirëpo, disa prej këtyre veprave penale mund t’i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara, kështu p.sh. vepra penale “Shpërdorimi i pasurisë së huaj”, nga neni 318, paragrafi 2 i KPRK-së dhe vepra penale “Keqpërdorimi i besimit”, nga neni 330, paragrafi 2 të KPRK-së mund të kryhet vetëm nga kujdestari, avokati apo ndonjë person tjetër që ka detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë (*delicta propria*).

<sup>338</sup> SHALA, AFRIM, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, Gjilan, 2010, f. 225;

<sup>339</sup> Po aty.

<sup>340</sup> Ligji Nr. 03/L-154 Për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, i datës 25.06.2009.

Veprat penale kundër pasurisë mund të kryhen vetëm me formën më të rëndë të fajësisë, përkatësisht vetëm me dashje. Për asnjë vepër penale që bënë pjesë në këtë Kapitull nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore se mund të kryhet edhe nga pakujdesia.<sup>341</sup>

Karakteristikë themelore e shumicës së veprave penale kundër pasurisë është se pjesa dërmuese e tyre kryhen me “qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm për vete apo për persona të tjerë” (p.sh. veprat penale: “Vjedhja”,<sup>342</sup> “Vjedhja e rëndë”,<sup>343</sup> etj.). Mirëpo, disa vepra penale të këtij Kapitulli kryhen edhe me qëllime tjera, p.sh. vepra penale “Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme”,<sup>344</sup> kryhet me “qëllim të mbajtjes në posedim të pasurisë”, por jo të përvetësimit, ose vepra penale “Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër”,<sup>345</sup> kryhet “me qëllim të pengimit të realizimit të kërkesave pasurore, përkatësisht me qëllim të pengimit të pagimit të borxhit”, etj. Te disa vepra tjera penale të këtij Kapitulli, “qëllimi i kryesit është që vetëm të dëmtohet pasuria e personit tjetër”, p.sh. vepra penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”.<sup>346</sup>

Ndjekja penale për shumicën e këtyre veprave penale ndërmerret sipas detyrës zyrtare (*ex officio*). Mirëpo, për disa vepra penale, ndjekja ndërmerret sipas propozimit të palës së dëmtuar, p.sh. vepra penale “Shpërdorimi i pasurisë së huaj” nga neni 318, paragrafi 7 i KPRK-së, etj. Kurse, në nenin 335 të KPRK-së, është parashikuar se kur veprat penale nga nenet 313, 314, 315 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., 320, 321 paragrafi 1, 330 paragrafi 1 dhe 332 i këtij Kodi kryhen ndaj personit të cilin kryesi e ka anëtar të familjes, procedura penale fillohet sipas propozimit, kur shumica e përfshirë është më pak se dyqindpesëdhjetë (250) euro.

Karakteristikë tjetër e Kapitullit të veprave penale kundër pasurisë është edhe parashikimi i dënimit me gjobë për shumicën e veprave penale. Dënimi me gjobë është parashikuar në mënyrë kumulative me dënimin me burgim,<sup>347</sup> mirëpo për disa vepra penale është parashikuar edhe në mënyrë alternative me dënimin me burgim. Kurse, duhet theksuar se për asnjë vepër penale të këtij Kapitulli nuk është parashikuar dënimi me gjobë, si dënim i vetëm, por çdo herë, dënimi me gjobë

---

<sup>341</sup> SHALA, AFRIM, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, f. 226. Megjithatë, në shkencën e së drejtës penale, mbizotëron qëndrimi se vepra penale “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale” nga neni 333, paragrafi 2 të KPRK-së mund të kryhet me të ashtuquajturën “formë të përzier të fajit”, e cila përfshin aspekte të caktuara të pakujdesisë dhe të dashjes eventuale.

<sup>342</sup> Neni 313 i KPRK-së.

<sup>343</sup> Neni 315 i KPRK-së.

<sup>344</sup> Neni 319 i KPRK-së.

<sup>345</sup> Neni 332 i KPRK-së.

<sup>346</sup> Neni 321 i KPRK-së.

<sup>347</sup> Nëse për një vepër penale të caktuar parashihet se kryesi i saj do të dënohet me dënim me gjobë dhe dënim me burgim, atëherë në rastet e tilla është fjala për mundësinë e shqiptimit të dy lloje të dënimeve në mënyrë kumulative. Sipas KPRK-së, zakonisht mundësia e shqiptimit të dy llojeve të dënimeve në mënyrë kumulative është paraparë për rastet e veprave penale të cilat kryhen me qëllim të fitimit të dobisë pasurore. Lidhëza “dhe” që përdoret në mes të dënimit me gjobë dhe dënimit me burgim është kriter përcaktues në këtë drejtim, pra, me fjalë të tjera, nëse në mes të dënimit me gjobë dhe dënimit me burgim është përdorur lidhëza “dhe”, atëherë mund të konstatojmë se për veprat penale përkatëse janë parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim. Kurse, në rastet tjera, kur në mes të dënimit me gjobë dhe dënimit me burgim është përdorur lidhësja “ose”, atëherë mund të konstatojmë se për veprat penale përkatëse dënimet janë parashikuar në mënyrë alternative. Në këto raste, dënimet e parapara në mënyrë alternative janë të barabarta dhe gjykata është e autorizuar ta shqiptojë njërin apo tjetrin lloj të dënimit, kurse te rastet e parashikimit të dënimeve në mënyrë kumulative, atëherë gjykata duhet që njëkohësisht t’i shqiptojnë të dyja këto dënime. SHALA, AFRIM, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, f. 34.

është parashikuar ose në mënyrë kumulative me dënimin me burgim ose në mënyrë alternative me dënimin me burgim.

Pavarësisht faktit se dënimi me gjobë është parashikuar për shumicën e veprave penale kundër pasurisë, është e rëndësishme që të theksohet se nuk është përcaktuar fare minimumi dhe maksimumi i posaçëm i dënimit me gjobë për këto vepra penale. Në këto situata, duhet të vjen në shprehje zbatimi i dispozitës ligjore nga neni 43, paragrafi 1 të KPRK-së, në të cilën është parashikuar se dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) euro (*minimumi i përgjithshëm*) dhe as të tejkalojë njëzetepesëmijë (25.000) euro, ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizimin, trafikimin me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë pesëqindmijë (500.000) euro (*maksimumi i përgjithshëm*). Në këtë mënyrë, bazuar në këto që u theksuan më lart, rezulton se minimumi i përgjithshëm i dënimit me gjobë prej njëqind (100) euro, i parashikuar në dispozitën e lartcekur ligjore është njëkohësisht edhe minimum i posaçëm i dënimit me gjobë për vepra penale të caktuara kundër pasurisë, ndërsa maksimumet e përgjithshme të dënimit me gjobë të parashikuara në dispozitën e lartcekur ligjore janë edhe maksimume të posaçme të këtyre veprave penale. Kështu, për vepra penale kundër pasurisë të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, maksimumi i posaçëm i dënimit me gjobë është pesëqindmijë (500.000) euro, kurse për vepra penale tjera kundër pasurisë, maksimumi i posaçëm i dënimit me gjobë është njëzetepesëmijë (25.000) euro.

Në kontekst të nivelit të rrezikshmërisë së veprave penale, në këtë Kapitull të veprave penale janë parashikuar vepra penale me nivel të ulët të rrezikshmërisë, vepra penale me nivel të mesëm të rrezikshmërisë dhe vepra penale me nivel të lartë të rrezikshmërisë. Pikërisht, duke u bazuar në këtë kriter, veprat penale kundër pasurisë mund të sistemohen në tre (3) grupe:

1. *Vepra penale me nivel të ulët të rrezikshmërisë*, për të cilat janë parashikuar dënime me gjobë dhe/ose me burgim, ku maksimumi i dënimit me burgim është parashikuar deri në gjashtë (6) muaj; një (1) vit; dy (2) vjet; tre (3) vjet; katër (4) vjet dhe pesë (5) vjet;
2. *Vepra penale me nivel të mesëm të rrezikshmërisë*, për të cilat janë parashikuar dënime me gjobë dhe/ose me burgim, ku maksimumi i dënimit me burgim është parashikuar deri në shtatë (7) vjet; tetë (8) vjet dhe dhjetë (10) vjet, si dhe
3. *Vepra penale me nivel të lartë të rrezikshmërisë*, për të cilat janë parashikuar dënime me gjobë dhe/ose me burgim, ku maksimumi i dënimit me burgim është parashikuar deri në dymbëdhjetë (12) vjet; pesëmbëdhjetë (15) vjet dhe deri në njëzetepesë (25) vjet<sup>348</sup> ose me dënim me burgim të përjetshëm. Dënimi me burgim të përjetshëm është parashikuar për këto vepra penale: “Vjedhja grabitqare”,<sup>349</sup> “Grabitja”<sup>350</sup> dhe “Zjarrvënia”.<sup>351</sup>

<sup>348</sup> Për format e kualifikuara të veprave penale: “Vjedhja grabitqare”, nga neni 316, paragrafi 4 të KPRK-së dhe “Grabitja” nga neni 317, paragrafi 5 i KPRK-së janë parashikuar dënime me gjobë dhe me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm. Meqenëse për këto forma të kualifikuara të këtyre dy (2) veprave penale nuk është parashikuar maksimumi i posaçëm i dënimit me burgim, atëherë aplikohet dispozita ligjore e nenit 42, paragrafi 1 i KPRK-së (*maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim*), nga e cila rezulton se maksimumi i posaçëm i dënimit me burgim për këto forma të kualifikuara është njëzetepesë (25) vjet.

<sup>349</sup> Neni 316, paragrafi 4 i KPRK-së.

<sup>350</sup> Neni 317, paragrafi 5 i KPRK-së.

<sup>351</sup> Neni 322, paragrafi 4 i KPRK-së. Duke qenë se për këto vepra penale është parashikuar dënimi me burgim të përjetshëm, atëherë duke u bazuar në nenin 42, paragrafi 3 të KPRK-së, gjykata mund të shqiptojë dënim me burgim deri në tridhjetepesë (35) vjet.

## A. Procesi i caktimit të dënimit

Siç është theksuar edhe më lart, në kapitullin e veprave penale kundër pasurisë janë parashikuar dënime të ndryshme me burgim ose/dhe me gjobë, duke filluar nga dënimet më të buta e deri tek ato më të rënda.

Ngjashëm sikurse edhe në kapitujt tjerë të KPRK-së, edhe me rastin e caktimit të dënimeve, për vepra penale kundër pasurisë, gjykatat duhet që të kenë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprat penale përkatëse, si dhe duhet të marrin në konsideratë qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara me dispozitat ligjore të KPRK-së, si dhe rrethanat përkatëse lehtësuese dhe rënduese.<sup>352</sup>

Gjithashtu, është e rëndësishme që të theksohet se edhe sa i përket veprave penale kundër pasurisë, kur gjykatat vendosin që ta caktojnë dënimin, duhet ta kenë parasysh njërin prej parimeve kryesore të së drejtës penale që *“dënimi të jetë në proporcion me peshën e veprës penale nga ky Kapitull, si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit”*.<sup>353</sup>

Në këtë aspekt, dënimi duhet të jetë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit. Përveç këtyre, përpjesëtueshmëria dhe drejtësia e dënimit, shprehet duke marrë parasysh jo vetëm peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale, por edhe rrethanat tjera objektive dhe subjektive, siç janë: p.sh. jeta e mëparshme e kryesit, sjellja pas kryerjes së veprës penale, qëllimet e përgjithshme dhe speciale të dënimit, etj.<sup>354</sup>

Duke qenë se për shumicën e veprave penale kundër pasurisë është parashikuar edhe dënimi me gjobë, atëherë gjykatat, me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, duhet që të marrin parasysh edhe gjendjen pasurore të të pandehurit dhe posaçërisht shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjithashtu, duhet theksuar se gjykatat nuk duhet që të caktojnë gjobën në lartësinë që është mbi mundësitë e të pandehurit.<sup>355</sup>

Kur është fjala për shqiptimin e dënimit me gjobë për vepra penale kundër pasurisë, por jo vetëm, gjykatat do të duhej pasur parasysh edhe disa aspekte të rëndësishme që janë shtjelluar në mënyrë të hollësishme në Udhëzuesin Specifik të Gjykatës Supreme të Kosovës - Caktimi i gjobës si sanksion për vepra penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.<sup>356</sup>

---

<sup>352</sup> Neni 69, paragrafi 1 i KPRK-së.

<sup>353</sup> Neni 69, paragrafi 2 i KPRK-së.


<sup>354</sup> SHALA, AFRIM, *Hyrje në të drejtën penale*, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023, f. 202.

<sup>355</sup> Neni 69, paragrafi 5 i KPRK-së.

<sup>356</sup> Udhëzuesi Specifik i Gjykatës Supreme të Kosovës, Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Shkurt 2020. <https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2020/06/Udhezues-per-shqiptimin-e-gjebes-penale.pdf>

## B. Pikënisja

Me qëllim të harmonizimit të qasjes në matjen e dënimit për veprat penale kundër pasurisë, figura e mëposhtme ofron rekomandimin për pikënisjen e matjes së dënimit për tri (3) situata të ndryshme që kanë parasysh specifikat e këtyre veprave penale, cilësitë e kryesve të veprave penale dhe rastet nga praktika gjyqësore:



Ky grafik tregon qartazi dallimin në mes formave të ndryshme të matjes së dënimit për këto vepra penale, bazuar në specifikat kyçe të paraqitura më lart. Në këtë mënyrë, duke iu referuar edhe figurës së lartcekur rezultojnë se të ky Kapitull i veprave penale kemi tre (3) pikënisje të ndryshme për matjen e dënimit dhe atë:

*- Një e treta (1/3) e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale përkatëse* do të mund të zbatohet në rastet e veprave penale me nivel të ulët të rrezikshmërisë, nëse të pandehurit nuk kanë të kaluar penale, përkatësisht nuk kanë qenë të dënuar më parë për vepra penale. Siç është theksuar edhe më lart, vepra penale me nivel të ulët të rrezikshmërisë, në kuadër të Kapitullit të veprave penale kundër pasurisë, do të mund të konsideroheshin ato vepra penale për të cilat janë parashikuar dënime me gjobë dhe/ose me burgim, ku maksimumi i dënimit me burgim është parashikuar deri në gjashtë (6) muaj; një (1) vit; dy (2) vjet; tre (3) vjet; katër (4) vjet dhe pesë (5) vjet; Në situatat të tilla, si pikënisje do mund të merret një e treta (1/3) e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale përkatëse.

- Nëse bëhet fjalë për vepra penale me nivel të mesëm dhe të lartë të rrezikshmërisë, të kryera nga të pandehurit që nuk kanë të kaluar kriminale, përkatësisht të cilët nuk kanë qenë të dënuar më parë, atëherë, si pikënisje do të mund të merret *një e dyta (1/2) e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale përkatëse*. Siç është theksuar edhe më lart, vepra penale me nivel të mesëm të rrezikshmërisë, konsiderohen veprat penale për të cilat janë parashikuar dënime me gjobë dhe/ose me burgim, ku maksimumi i dënimit me burgim është parashikuar deri në shtatë (7) vjet; tetë (8) vjet dhe dhjetë (10) vjet. Kurse, vepra penale me nivel të lartë të rrezikshmërisë, do të mund të konsiderohen veprat penale për të cilat janë parashikuar dënime me gjobë dhe/ose me burgim, ku maksimumi i dënimit me burgim është parashikuar deri në dymbëdhjetë (12) vjet; pesëmbëdhjetë (15) vjet dhe deri në njëzetepesë (25) vjet ose me dënim me burgim të përjetshëm.

- Ndërsa, në rastet kur si kryes të veprave penale paraqiten të pandehurit që edhe më parë kanë qenë të dënuar për vepra penale (recidivistët), atëherë si pikënisje do të mund të merret dy të tretat (2/3) e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale përkatëse. Sigurisht, që në rastet e tilla, kur është fjala për personat fizik si kryes të veprave penale, atëherë duhet pasur parasysh edhe kriteret e përcaktuar në nenin 69, paragrafi 4 të KPRK-së. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se *“Kur gjykata cakton dënimin për recidivistin, posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer vepër penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur”*. Ndërsa, në rastet e tilla, kur është fjala për personat juridik si kryes të veprave penale,<sup>357</sup> atëherë duhet pasur parasysh edhe kriteret e përcaktuara në nenin 10, paragrafi 2 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.<sup>358</sup> Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se *“Gjatë caktimit të dënimit, gjykata në veçanti do të merr parasysh se a është dënuar personi juridik për vepër penale, vepra penale e kryer më parë, a është e njëlllojtë me veprën e re penale dhe sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm”*.

Është e rëndësishme që të sqarohet se një pikënisje e tillë mund të aplikohet vetëm në situatat kur nuk mund të zbatohet instituti i ashtuquajtur “recidivizëm i shumëfishtë”.

Kushtet të cilat duhet të përmbushen që të vjen në shprehje zbatimi i të ashtuquajturit “recidivizëm i shumëfishtë” janë të parashikuara në nenin 75, paragrafi 1 të KPRK-së dhe në nenin 10, paragrafët 4 dhe 5 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.

### C. Rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese

Siç është cekur edhe më parë, me rastin e caktimit të dënimit për vepra penale në përgjithësi, gjykata duhet që të ketë parasysh, përveç çështjeve tjera, edhe rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese.<sup>359</sup>

Gjithashtu, sikurse edhe te kapitujt tjerë të pjesës së posaçme të KPRK-së, edhe te ky Kapitull i veprave penale, rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese mund të jenë të shumta dhe të natyrave të ndryshme, varësisht nga natyra veprës penale, cilësive personale të kryesit të veprës penale dhe të viktimës, si dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra penale, por jo vetëm.

Përveç tjerash, është e rëndësishme që gjykatat të kenë në konsideratë edhe rrethanat tjera rënduese dhe lehtësuese, përveç atyre të parashikuara në nenin 69, paragrafi 3 dhe nenin 70, paragrafët 2 dhe 3 të KPRK-së, duke i pasur parasysh specifikat e secilit rast veç e veç, pasi që në këto dispozita ligjore janë parashikuar lista jo-shteruese të rrethanave përkatëse rënduese dhe

---

<sup>357</sup> Në nenin 112 të KPRK-së është parashikuar se *“Veprat penale për të cilat personi juridik mund të jetë penalisht përgjegjës, përgjegjësia penale e personit juridik, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personit juridik dhe dispozitat e posaçme që rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik parashihen me ligj të veçantë”*.

<sup>358</sup> Ligji Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.16/14 shtator 2011, Prishtinë.

<sup>359</sup> Neni 69, paragrafi 1 i KPRK-së.

lehtësuese. Në kuadër të këtyre rrethanave, gjenden rrethana objektive, që i referohen veprës penale dhe rrethana subjektive, që i referohen kryesit të veprës penale.<sup>360</sup>

#### **D. Rrethanat rënduese relevante**

Rrethanat rënduese të veprës penale nga ky Kapitull mund të jenë të natyrave të ndryshme dhe kjo varet nga specifikat e secilit rast veç e veç.

Bazuar edhe në specifikat e veprave penale nga ky Kapitull dhe duke iu referuar rasteve nga praktika jonë gjyqësore, gjykatat do të duhej pasur parasysh rrethanat e mëposhtme rënduese, por jo vetëm:

- *shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale*, duke ndërmarrë veprime të shumta me qëllim të kryerjes së veprave penale të caktuara;
- *shkallën e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar*, duke vepruar me dashje të drejtpërdrejtë dhe me një paramendim të theksuar me qëllim të kryerjes së veprës penale dhe realizimit të pasojave të saj;
- *prezencën e dhunës apo të kanosjes me dhunë për kryerjen e veprës penale*, kuptohet nëse një aspekt i tillë nuk përbën element të figurës së veprës penale, pasi që të disa vepra penale në kuadër të Kapitullit të veprave penale kundër pasurisë “dhuna” ose “kanosja për përdorimin e dhunës” konsiderohen elemente të figurës së veprës penale;
- *nëse veprat penale janë kryer në mënyrë të vazhdueshme*, pasi që nga praktika gjyqësore është parë që disa vepra penale nga ky Kapitull kryhen në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë të gjatë kohore;
- *shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përkatësisht intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur* dhe një rrethanë e tillë duhet pasur kujdes që të merret për bazë si rrethanë rënduese, vetëm nëse nuk përbën element të figurës së veprës penale përkatëse;
- *nëse vepra penale është kryer si pjesë e një grupi apo veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal*;
- *ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar*; Recidivizmi është llogaritur në përcaktimin e pikënisjes. Megjithatë, sa i përket dënimeve të mëparshme të të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.
- rrethanat konkrete në të cilat është kryer vepra penale përkatëse;

---

<sup>360</sup> SHALA, AFRIM, *Hyrje në të drejtën penale*, f. 259-260.



- rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, si dhe ndonjë rrethanë tjetër rënduese, që vlerësohet si e tillë nga ana e gjykatës.

## E. Rrethanat lehtësuese relevante

Për shkak të natyrave të ndryshme të veprave penale që bëjnë pjesë në këtë Kapitull është vështirë që të përcaktohet se cila nga rrethanat lehtësuese mund të kenë peshë më të madhe se sa rrethanat tjera të kësaj natyre.

Megjithatë, bazuar edhe në praktikën tonë gjyqësore, pranimi i fajësisë është njëra prej rrethanave që merret për bazë si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit për kryerjen e veprave penale nga ky Kapitull. Nëse pranimi i fajësisë shoqërohet edhe me rrethana tjera lehtësuese (p.sh. sjellja e mëparshme e kryesit, keqardhja e shfaqur, kompensimi i dëmit apo shprehja e gatishmërisë për kompensimin, kthimi i sendeve të vjedhura, gjendja e rëndë shëndetësore e kryesit apo e ndonjë anëtarit të ngushtë të familjes së tij, etj.), atëherë një dënim më i butë mund të jetë i justifikuar, kuptohet duke i pasur parasysh edhe rrethanat tjera të rastit konkret.

Gjithashtu, edhe rrethanat personale dhe karakteri i kryesit të veprës penale; dëshmia që kryesi ka luajtur rol relativisht të vogël në kryerjen e veprës penale; fakti që kryesi ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor, por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër, mandej moshja e kryesit (i ri apo i moshuar); bashkëpunimi i kryesit të veprës penale me gjykatën dhe organet e ndjekjes, si dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale mund të trajtohen si rrethana lehtësuese, normalisht duke i pasur në konsideratë specifikat e secilit rast veç e veç.

## F. Aplikueshmëria e sanksioneve dhe masave tjera

Edhe te veprat penale kundër pasurisë, në situata të caktuara duhet pasur në konsideratë edhe shqiptimin e disa dënimeve dhe masave tjera.

Në këtë drejtim, duke e pasur parasysh natyrën e veprave penale kundër pasurisë, atëherë në radhë të parë, *konfiskimi* - është një mjet i rëndësishëm që duhet zbatuar në rastet e kryerjes së veprave penale nga ky Kapitull.<sup>361</sup>

*Dënimi me gjobë* - është i rëndësishëm dhe i përshtatshëm që të shqiptohet në rastet të caktuara, duke i pasur në konsideratë edhe kriteret e parashikuara me ligj dhe faktin se veprat penale kundër pasurisë kryhen në të shumtën e rasteve me qëllime dhe motive të përfitimit të dobisë pasurore.

---

<sup>361</sup> Në nenin 92 të KPRK-së është parashikuar se “Pasuria ose mjete që është përfituar me vepër penale konfiskohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kur konfiskimi nuk është i mundur në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, Gjykata urdhëron kryesin e veprës për të paguar një shumë të barasvlershme ose Gjykata do të konfiskojë çdo pasuri të të pandehurit me vlerë të barasvlershme siç është përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës”.

*Dënimi me kusht* - gjithashtu, është i përshtatshëm që të zbatohet në rastet e caktuara, duke vendosur që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar kryesi i veprës penale nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenson dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me nenin 56 të KPRK-së.<sup>362</sup>

Mandej, edhe *dënimi alternativ - urdhri për punë në dobi të përgjithshme* mund të jetë i përshtatshëm për vepra penale të caktuara, duke e urdhëruar gjithashtu kryesin e veprës penale që të kryejë një apo më shumë detyrime të parapara me paragrafin 3 të nenit 48 ose me nenin 56 të KPRK-së.<sup>363</sup>

Përveç këtyre, në raste të caktuara, do të mund të shqiptohet edhe *dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues*<sup>364</sup> apo *dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues*.<sup>365</sup>

Duke e pasur parasysh natyrën e veprave penale kundër pasurisë, atëherë, për raste të caktuara duhet shqyrtuar edhe çështjen e shqiptimit të dënimit plotësues - “*Urdhri për kompensimin e humbjes apo të dëmit*”, që është i parashikuar në nenin 61 të KPRK-së. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se në rastet kur gjykata e dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo veprë penale që përfshinë vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, atëherë gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale. Dëmshpërblimi përfshin vlerën e shpenzimeve që janë të barabarta me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, humbur, dëmtuar apo shkatërruar. Gjithashtu, bazuar në këtë dispozitë ligjore, dëmshpërblimi do të urdhërohet edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktimat i përjeton si rezultat i veprës penale dhe procedurave hetimore dhe gjyqësore lidhur me atë vepër.

Kurse, *vërejtja gjyqësore* do të mund të shqiptohet për vepra penale më të lehta,<sup>366</sup> duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën penale dhe kryesin, si dhe kushtet tjera të parashikuara me ligj, nëse vlerësohet se një sanksion i tillë është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Dënimet alternative mund të arrijnë shumë lehtë efektin e duhur sidomos për shembull në rastet e vjedhjes së shërbimeve nga Neni 314, natyrisht gjithnjë përderisa vlera e përfitimit apo dëmit nuk është i konsiderueshëm. Nëse rastet e tilla nuk kanë gjetur zgjidhje në procedurë të ndërmjetësimit, atëherë edhe shqiptimi i dënimit alternativ do të jetë efektiv. E njëjta logjikë vlen edhe për shqiptimin e dënimit me gjobë nëse shqiptohet në pajtim me gjendjen financiare të kryesit siç parashihet edhe me Udhëzuesin për gjobat.

---

<sup>362</sup> Neni 48, paragrafi 3 i KPRK-së.

<sup>363</sup> Neni 57, paragrafi 4 i KPRK-së.

<sup>364</sup> Neni 54 i KPRK-së.

<sup>365</sup> Neni 55 i KPRK-së.

<sup>366</sup> Nenet 81 dhe 82 të KPRK-së.

## **XV. Kapitulli XXVII Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Në një epokë ku ndotja e mjedisit është bërë një sfidë globale, mbrojtja e tij ka fituar një rëndësi të jashtëzakonshme në botën bashkëkohore. Studimet dhe hulumtimet e kësaj sfide tregojnë se përpjekjet për të ruajtur dhe promovuar mjedisin janë të domosdoshme për të garantuar të ardhmen tonë dhe të brezave të ardhshëm.<sup>367</sup>

Në përpjekje për të arritur këtë synim të rëndësishëm, shumë shtete bashkëkohore kanë penalizuar një mori veprimesh që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit, duke i parashikuar si vepra të kundërligjshme, qoftë në formë të veprave penale (kundërvajtjeve penale), kundërvajtjeve, shkeljeve administrative dhe shkeljeve të tjera. Këto masa kanë për qëllim të kujdesen për të drejtën e qytetarëve për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Përveç masave juridiko-penale, janë ndërmarrë edhe masa të tjera, duke përfshirë ato me karakter edukativo-arsimor, politik, ekonomik dhe social, etj., që synojnë të ndikojnë në sjelljen dhe qëndrimin e individëve dhe shoqërisë në përgjithësi ndaj mjedisit.

Gjithashtu, janë krijuar edhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, parti politike, agjencione, ministri të posaçme dhe institucione të tjera, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.<sup>368</sup>

Ky angazhim, është shprehje e kujdesit global ndaj shëndetit të njerëzve, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore dhe për shkak të rëndësisë së madhe, çështja e mbrojtjes së mjedisit është e garantuar edhe me dispozitat kushtetuese të shteteve të ndryshme dhe me shumë marrëveshje dhe instrumente juridike ndërkombëtare.<sup>369</sup>

Sipas këtyre marrëveshjeve dhe instrumenteve juridike ndërkombëtare, shtetet janë detyruar që në legjislacionet e tyre penale të parashohin si vepra penale një mori të veprimesh që ndërmerren ndaj mjedisit, e me të cilat dëmtohet apo rrezikohet shëndeti i njerëzve, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

---

<sup>367</sup> SHALA, AFRIM, *Mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale*, Tiranë, 2023, f. 4. <http://jus.igjk.rks-gov.net/844/>

<sup>368</sup> SHALA, AFRIM, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, f. 253.

<sup>369</sup> Në planin ndërkombëtar, mbrojtja e mjedisit, në përgjithësi, garantohet dhe mbrohet me konventa dhe instrumente të ndryshme, si në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe në kuadër të organizatave të ndryshme kontinentale dhe rajonale. Në këtë aspekt, numri i Konventave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi mjedisin është i shumtë, por ndër konventat më të rëndësishme janë: Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e shtresës së Ozonit; Konventa e Baselit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbeturinave të Rrezikshme dhe Depozitimin e tyre; Konventa e Aarhusit; Protokollin e Montrealit; Protokollin e Kiotos, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimaterike, etj. Në kuadër të Këshillit të Europës është e rëndësishme që të përmenden dy (2) konventa: Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale dhe Konventa mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmin që rezultojnë nga Aktivitetet e Rrezikshme për Mjedisin. Kurse, në kuadër të Bashkimit European, vlen të përmendet Direktiva e Parlamentit European dhe Këshillit “Mbi Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet të Drejtës Penale”.

Përveç me dispozita të ligjeve dhe akteve tjera, mjedisi në përgjithësi mbrohet edhe me dispozitat juridike penale, përkatësisht me të drejtën penale.<sup>370</sup>

Është e ditur se funksionin mbrojtës në përgjithësi, e drejta penale e realizon duke parashikuar se cilat vepra apo sjellje konsiderohen vepra penale, kushtet për përgjegjësi penale dhe duke parashikuar sanksione penale, si dhe masa tjera ndaj kryesve të veprave penale.<sup>371</sup>

Andaj, edhe funksionin e mbrojtjes së mjedisit, e drejta penale e realizon duke parashikuar se cilat vepra apo sjellje të drejtuara kundër mjedisit konsiderohen vepra penale, kushtet për përgjegjësi penale dhe duke parashikuar sanksione penale, si dhe masa tjera ndaj kryesve të veprave penale të tilla.

Këto dispozita ligjore të cilat parashohin veprat penale kundër mjedisit, kushtet për përgjegjësi penale, si dhe sanksionet penale dhe masat tjera që mund të shqiptohen ndaj kryesve të veprave të tilla penale e përbëjnë “të drejtën penale mjedisore”.<sup>372</sup>

Veprat e tilla penale janë të parashikuara në Kapitullin XXVII të KPRK-së dhe ky Kapitull emërtohet si “Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore”.<sup>373</sup>

Ky Kapitull i veprave penale, gjatë viteve të fundit ka pësuar disa ndryshime dhe plotësime, si në drejtim të parashikimit të disa veprave penale të reja, duke u harmonizuar me dokumentet dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, ashtu edhe në drejtim të ndryshimeve të disa elementeve tjera të veprave penale ekzistuese.

Përveç kësaj, ky Kapitull i veprave penale, gjatë viteve të fundit, ka pësuar ndryshime edhe në këto aspekte:

- te disa vepra penale është ndryshuar struktura e veprimeve të kryerjes;
- te disa vepra penale janë shtuar disa paragrafë në të cilët janë parashikuar disa forma të veprave penale përkatëse;
- për disa vepra penale është parashikuar që gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmerr masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor;
- për disa vepra penale krahas dënimit me burgim në mënyrë alternative është parashikuar edhe mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë;
- për disa vepra penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim;
- te disa vepra penale është ndryshuar lartësia e dënimit, etj.

---

<sup>370</sup> SHALA, AFRIM, *Mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale*, f. 11.

<sup>371</sup> SHALA, AFRIM, *Hyrje në të drejtën penale*, f. 20.

<sup>372</sup> SHALA, AFRIM, *Mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale*, f. 11.

<sup>373</sup> Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr.7895, i datës 27.01.1995), këto vepra penale janë të parashikuara në Kreun IV-të dhe emërtohen si “*Vepra penale kundër mjedisit*”.

Objekt mbrojtës i këtij Kapitulli të veprave penale janë: mjedisi, kafshët, bimët dhe objektet kulturore.<sup>374</sup>

Shprehja “*mjedis*” ka një domethënie të gjerë dhe të përgjithshëm, që nënkupton rrethinën natyrore: ajrin, tokën, ujin, klimën, florën, faunën dhe trashëgiminë kulturore, si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu.

Pasojë e shumicës së veprave penale që janë të parashikuara në këtë Kapitull, është rrezikimi konkret dhe abstrakt i mjedisit. Mirëpo, për të ekzistuar disa forma të këtyre veprave penale duhet që të jetë bërë edhe dëmtimi i të mirës juridike që është e mbrojtur me anë të këtyre veprave penale.

Shumica e veprave penale të këtij kapitulli janë të karakterit mbulues, ngase lidhur me përcaktimin e tipareve të figurës së këtyre veprave penale, duhet aplikuar edhe ligjet tjera që rregullojnë çështje të caktuara nga fushat përkatëse mjedisore.<sup>375</sup>

Kryes i veprave penale të këtij Kapitulli në të shumtën e rasteve mund të jetë çdo person, si personat fizik, ashtu edhe personat juridik. Pra, shumica e veprave penale kundër mjedisit janë të ashtuquajtura “*delicta communia*”<sup>376</sup> - vepra penale të cilat mund t’i kryejë çdo person.

Veprat penale të këtij Kapitulli, mund të kryhen me dashje, kurse format e lehta të disa veprave penale mund të kryhen edhe nga pakujdesia.

Gjithashtu, përveç me këtë Kapitull të KPRK-së, mjedisi në përgjithësi, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë indirekte mbrohet edhe me kapitujt e tjerë të KPRK-së. Mirëpo, te kapitujt e tjerë të KPRK-së, bëhet fjalë për vepra penale që kanë si objekt mbrojtës, disa vlera dhe të drejta tjera, por që në një mënyrë, mbrohen edhe shumë aspekte mjedisore.

Në këtë drejtim, vlen të përmenden këto vepra penale:<sup>377</sup>

- “*Kryerja e veprës terroriste*”, nga neni 129 lidhur me nenin 128, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6. i KPRK-së;
- “*Trajnimi për terrorizëm*”, nga neni 133, paragrafi 2 i KPRK-së;

<sup>374</sup> SHALA, AFRIM, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, f. 253.

<sup>375</sup> Mbrojtja e mjedisit është rregulluar dhe parashikuar edhe me ligje të veçanta, varësisht nga fushat specifike që ndërlidhen me këtë çështje. Në këtë drejtim, si ligje më të rëndësishme që i referohen mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi e të cilat duhet që t’i kenë parasysh gjyqtarët kur vendosin në çështjet që ndërlidhen me veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore janë: Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, i datës 23.06.2022; Ligji Nr.03/L-043 Për Parandalimin dhe Kontrollimin e Integruar të Ndotjes, i datës 26.03.2009; Ligji Nr.08/L-025 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i datës 25.02.2010; Ligji Nr.03/L-233 Për Mbrojtjen e Natyrës, i datës 30.09.2010; Ligji Nr.04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, i datës 19.03.2013; Ligji Nr.03/L-163 Për Minierat dhe Minerale, i datës 22.07.2010; Ligji Nr.04/L-060 Për Mbeturina, i datës 24.05.2012; Ligji Nr.2004/21 Për Veterinarinë, i datës 16.06.2004; Ligji Nr.08/L-137 Për Pyjet, i datës 09.03.2023; Ligji Nr.02/L-53 Për Gjuetinë, i datës 16.12.2005; Ligji Nr.02/L-85 Për Peshkatari dhe Akuakulturë, i datës 10.10.2006; Ligji Nr.02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore, i datës 09.10.2006; Ligji Nr.04/L-110 Për Ndërtimin, i datës 31.05.2012; Ligji Nr.04/L-197 Për Kimikate, i datës 27.02.2014; Ligji Nr.06/L-029 Për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, i datës 30.03.2018, etj.

<sup>376</sup> SHALA, AFRIM, *Hyrje në të drejtën penale*, f. 54.

<sup>377</sup> SHALA, AFRIM, *Mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale*, f. 12.

- “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar”, nga neni 145, paragrafi 2, nën paragrafi 2.4. i KPRK-së;
- “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar”, neni 147, paragrafi 2, nën paragrafi 2.15 i KPRK-së;
- “Përvetësimi, pranimi, shfrytëzimi, prodhimi, posedimi, transferi, ndryshimi, asgjësimi, shpërndarja ose dëmtimi i paaautorizuar i materialeve nukleare apo radioaktive”, nga neni 170 i KPRK-së;
- “Kanosja për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo të grabitjes së materialit nuklear ose radioaktiv”, nga neni 171 i KPRK-së;
- “Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike”, nga neni 357 i KPRK-së;
- “Ndërtimi pa leje”, nga neni 359 i KPRK-së, etj.

Përveç këtyre, mbrojtja e mjedisit në kuptimin juridiko penal është e parashikuar edhe me nenin 80 të Ligjit për Miniera dhe Minerale,<sup>378</sup> që në praktikën tonë gjyqësore kemi pasur disa raste tilla, kur personat fizik dhe juridik janë akuzuar dhe shpallur fajtor/përgjegjës sipas kësaj dispozite ligjore.

#### A. Procesi i caktimit të dënimit

Në Kapitullin e veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore janë të parashikuara në përgjithësi dënime të ulëta, përveç rasteve kur pasojat e veprave penale rezultojnë me vdekje, lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi, me dëm substancial material të pasurisë, kafshëve apo bimëve ose me keqësimin substancial material të cilësisë së ajrit, ujit ose tokës.

Ngjashëm sikurse, edhe në kapitujt tjerë të KPRK-së, edhe me rastin e caktimit të dënimeve, për vepra penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, gjykatat duhet që të kenë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprat penale përkatëse, si dhe duhet të marrin në konsideratë qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara me dispozitat ligjore të KPRK-së, si dhe rrethanat përkatëse lehtësuese dhe rënduese.<sup>379</sup>

Gjithashtu, është e rëndësishme që të theksohet se edhe sa i përket veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, kur gjykatat vendosin që ta caktojnë dënimin, duhet ta kenë parasysh njërin prej parimeve kryesore të së drejtës penale që “*dënimi të jetë në proporcion me peshën e veprës penale nga ky Kapitull, si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit*”.<sup>380</sup>

Në këtë drejtim, dënimi duhet të jetë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit. Përveç këtyre, përpjesëtueshmëria dhe drejtësia e dënimit shprehet duke marrë parasysh jo vetëm peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale,

<sup>378</sup> Ligji Nr.03/L-163 Për Minierat dhe Minerale, i datës 22.07.2010, i ndryshuar dhe plotësuar me disa ligje të mëvonshme.


<sup>379</sup> Neni 69, paragrafi 1 i KPRK-së.

<sup>380</sup> Neni 69, paragrafi 2 i KPRK-së.

por edhe rrethanat tjera objektive dhe subjektive, siç janë: p.sh. jeta e mëparshme e kryesit, sjellja pas kryerjes së veprës penale, qëllimet e përgjithshme dhe speciale të dënimit, etj.<sup>381</sup>

## B. Pikënisja

Me qëllim të harmonizimit të qasjes në matjen e dënimit për veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, figura e mëposhtme ofron rekomandimin për pikënisjen e matjes së dënimit për tri (3) situata të ndryshme që kanë parasysh specifikat e këtyre veprave penale, cilësitë e kryesve të veprave penale dhe rastet nga praktika gjyqësore:



Ky grafik tregon qartazi dallimin në mes të formave të ndryshme të matjes së dënimit për këto vepra penale bazuar në specifikat kyçe të paraqitura më lart.

Bazuar në praktikën tonë gjyqësore, në një numër të konsiderueshëm të rasteve, sidomos te veprat penale “*Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit*”, nga neni 338 i KPRK-së dhe vepra penale sipas nenit 80 të Ligjit për Miniera dhe Minerale, kryes të veprave penale paraqiten personat juridik dhe personat përgjegjës, ndërsa në anën tjetër, në një numër të konsiderueshëm të këtyre rasteve, por edhe të veprave tjera penale (“*Shkretërimi i pyjeve*”, nga neni 248; “*Vjedhja e pyllit*”, nga neni 349, etj.), personat e akuzuar/dënuar kanë të kaluar penale, përkatësisht edhe më parë kanë qenë të dënuar për vepra penale.

Në këtë mënyrë, duke iu referuar edhe figurës së lartcekur rezulton se te ky Kapitull i veprave penale kemi tri (3) pikënisje të ndryshme për matjen e dënimit dhe atë:

- *Një e treta (1/3) e maksimumit të dënimit për veprat penale të kryera nga individë/kryes pa ndonjë të kaluar kriminale;*
- *Një e dyta (1/2) e maksimumit të dënimit për veprat e kryera nga persona juridik dhe persona përgjegjës; dhe*
- *Dy të tretat (2/3) e maksimumit të dënimit për veprat e kryera nga recidivistët.*

<sup>381</sup> SHALA, AFRIM, *Hyrje në të drejtën penale*, f. 202.

- a. Një e treta (1/3) e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale përkatëse do të mund të zbatohet në rastet kur personat fizik paraqiten si kryes të veprave penale dhe të njëjtit nuk kanë të kaluar penale, përkatësisht nuk kanë qenë të dënuar më parë për vepra penale. Në situatat të tilla, si pikënisje të merret 1/3 (një e treta) e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale përkatëse.
- b. Nëse si kryes të veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, paraqiten personat juridik dhe personat përgjegjës, atëherë si pikënisje të merret 1/2 (një e dyta) e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale përkatëse. Janë së paku dy (2) arsye që janë marrë për bazë kur është përcaktuar një pikënisje tjetër për personat juridik dhe personat përgjegjës, në raport me personat fizik dhe atë:
- E para, bazuar në rastet nga praktika gjyqësore, veprat penale të këtij Kapitulli të kryera nga personat juridik dhe personat përgjegjës shkaktojnë dëme të mëdha për mjedisin në përgjithësi dhe
  - E dyta, me kryerjen e veprave penale të këtij Kapitulli, gjenerohen përfitime të mëdha materiale për personat juridik dhe personat përgjegjës.
- c. Ndërsa, në rastet kur si kryes të veprave penale paraqiten personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës që edhe më parë kanë qenë të dënuar për vepra penale (recidivistët), atëherë si pikënisje të merret 2/3 (dy të tretat) e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale përkatëse. Sigurisht, që në rastet e tilla, kur është fjala për personat fizik si kryes të veprave penale, atëherë duhet pasur parasysh edhe kriteret e përcaktuar në nenin 69, paragrafi 4 të KPRK-së. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer vepër penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur”. Ndërsa, në rastet e tilla, kur është fjala për personat juridik si kryes të veprave penale,<sup>382</sup> atëherë duhet pasur parasysh edhe kriteret e përcaktuara në nenin 10, paragrafi 2 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.<sup>383</sup> Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Gjatë caktimit të dënimit, gjykata në veçanti do të merr parasysh se a është dënuar personi juridik për vepër penale, vepra penale të kryera më parë, a është e njëllajtë me veprën e re penale dhe sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm”.

Është e rëndësishme që të sqarohet se një pikënisje e tillë mund të aplikohet vetëm në situatat që nuk mund të zbatohet instituti i ashtuquajtur “recidivizëm i shumëfishtë”.

Kushtet të cilat duhet të përmbushen që të vjen në shprehje zbatimi i të ashtuquajturit “recidivizëm i shumëfishtë” janë të parashikuara në nenin 75, paragrafi 1 të KPRK-së dhe në nenin 10, paragrafët 4 dhe 5 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.

<sup>382</sup> Në nenin 112 të KPRK-së është parashikuar se “Veprat penale për të cilat personi juridik mund të jetë penalisht përgjegjës, përgjegjësia penale e personit juridik, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personit juridik dhe dispozitat e posaçme që rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik parashihen me ligj të veçantë”.

<sup>383</sup> Ligji Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.16/14 shtator 2011, Prishtinë.



### C. Rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese

Siç është cekur edhe më parë, me rastin e caktimit të dënimit për vepra penale në përgjithësi, gjykata duhet që të ketë parasysh, përveç çështjeve tjera, edhe rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese.<sup>384</sup>

Megjithatë, në këtë drejtim, është e rëndësishme që paraprakisht të sqarohen dy (2) aspekte që ndërlidhen me rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat duhet që t'i kenë parasysh gjyqtarët kur vendosin që të caktojnë dënimin për vepra penale nga ky Kapitull dhe atë:

- 1) *Së pari*, që rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese janë rrethana që ndikojnë që dënimi të jetë më i rëndë apo më i butë brenda kufijve të parashikuar me ligj (minimumi dhe maksimumi i posaçëm i dënimit) për veprën penale konkrete.<sup>385</sup> Pra, me fjalë të tjera, rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese kanë ndikim që dënimi të jetë më i ashpër ose më i butë vetëm në kuadër të minimumit dhe të maksimumit të posaçëm të dënimit të parashikuar për vepra penale konkrete. Kjo për faktin se nga praktika gjyqësore është vërejtur se në disa raste është shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm të dënimit, vetëm duke u bazuar në rrethana lehtësuese. Në lidhje me këtë çështje, është me rëndësi të theksohet se në nenin 70, paragrafi 1 të KPRK-së është parashikuar se “*Kryesit të veprës penale i shqiptohet dënimi i paraparë për veprën e kryer penale, ndërsa dënimi më i butë ose më i rëndë mund të shqiptohet vetëm në pajtim me kushtet e parapara me këtë Kod*”. Me dispozitat ligjore të KPRK-së janë të njohura dy (2) institute juridike penale, mbi bazën e të cilave mund të caktohet dënimi nën minimumin e posaçëm të dënimit dhe atë :
  - a) “**Zbutja e dënimit**” (nenet 71 dhe 72 të KPRK-së)<sup>386</sup> dhe
  - b) “**Lirimi nga dënimi**”, duke e zbatuar nenin 73, paragrafi 2 të KPRK-së.

Ndërsa, gjykata mund të caktojë dënimin mbi maksimumin e posaçëm të dënimit vetëm nëse zbatohet dispozitën ligjore e “**Ashpërsimit të dënimit për recidivizëm të shumëfishtë**”, nga neni 75 i KPRK-së.<sup>387</sup>

- 2) *Së dyti*, që elementet përkatëse subjektive dhe objektive të figurave të veprave penale<sup>388</sup> nga ky Kapitull nuk mund të trajtohen edhe si rrethana përkatëse rënduese apo lehtësuese. Me fjalë të tjera, rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese mund të merren parasysh me rastin e matjes së dënimit, vetëm nëse nuk janë parashikuar si elemente subjektive dhe objektive të figurave të veprave penale nga ky Kapitull. Kjo për faktin se nga praktika

<sup>384</sup> Neni 69, paragrafi 1 i KPRK-së.

<sup>385</sup> SHALA, AFRIM, *Hyrje në të drejtën penale*, f. 260.

<sup>386</sup> Në nenin 10, paragrafi 3 të Ligjit përgjegjësive e personave juridik për vepra penale është parashikuar se “*Gjykata mund të japë dënimin edhe nën masën e parashikuar për veprën penale (zbutja e dënimit) kur këtë gjë e parashikon ky ligj ose dispozita me të cilën caktohet vepra penale, apo në qoftë se ekzistojnë rrethanat veçanërisht lehtësuese. Dënimi mund të zbutet deri në masën më të vogël të parashikuar në nenin 12 paragrafi 1. të këtij ligji*”.

<sup>387</sup> Instituti i “*Ashpërsimit të dënimit për recidivizëm të shumëfishtë*” është parashikuar edhe në Ligjin për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale. Në nenin 10, paragrafi 4 të këtij Ligji është parashikuar se “*Gjykata mund t’ia ashpërsojë dënimin personit juridik ose personit përgjegjës të parashikuar për veprën penale të kryer në dyfishin e shumës së masës më të lartë të dënimit, në qoftë se kryesi është recidivist i shumëfishtë*”.

<sup>388</sup> Në lidhje me figurën e veprave penale në përgjithësi, shih më gjerësisht: *Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional* (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, 2021, f. 23-24 dhe f. 119-124. <http://jus.igjk.rks-gov.net/801/>

gjyqësore është vërejtur se në disa raste, rrethanat rënduese apo lehtësuese, gjykatat po i trajtojnë edhe elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprave penale për të cilat edhe është caktuar dënimi.<sup>389</sup>

Gjithashtu, sikurse edhe te kapitujt tjerë të pjesës së posaçme të KPRK-së, edhe te ky Kapitull i veprave penale, rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese mund të jenë shumta dhe të natyrave të ndryshme, varësisht nga natyra e veprës penale, cilësive personale të kryesit të veprës penale dhe të viktimës, si dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra penale, por jo vetëm.

Përveç tjerash, është e rëndësishme që gjykatat të kenë në konsideratë edhe rrethanat tjera rënduese dhe lehtësuese, përveç atyre të parashikuara në nenin 69, paragrafi 3 dhe nenin 70, paragrafët 2 dhe 3 të KPRK-së, duke i pasur parasysh specifikat e secilit rast veç e veç, pasi që në këto dispozita ligjore janë parashikuar lista jo shteruese të rrethanave përkatëse rënduese dhe lehtësuese. Kështu, në nenin 69, paragrafi 3 të KPRK-së është parashikuar se “*Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh, por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme...*”, kurse në nenin 70, paragrafin 2 të KPRK-së është parashikuar se “*Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese...*”, ndërsa në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar se “*Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme lehtësuese...*”. Sipas këtyre dispozitave ligjore, përveç rrethanave që janë cekur në mënyrë taksative, gjykata ka autoritet që në çdo rast konkret të ketë mundësi që të marrë parasysh edhe rrethana tjera, të cilat mund të ndikojnë që të caktohet një dënim më i rëndë apo më i butë. Në kuadër të këtyre rrethanave, gjenden rrethana objektive, që i referohen veprës penale dhe rrethana subjektive, që i referohen kryesit të veprës penale.<sup>390</sup>

#### **D. Rrethanat rënduese relevante**

Rrethanat rënduese te veprat penale nga ky Kapitull mund të jenë të natyrave të ndryshme dhe kjo varet nga secili rast veç e veç.

Bazuar edhe në specifikat e veprave penale nga ky Kapitull dhe duke iu referuar rasteve nga praktika jonë gjyqësore, gjykatat do të duhej pasur parasysh rrethanat e mëposhtme rënduese, por jo vetëm:

- *shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, duke ndërmarrë veprime të shumta me qëllim të kryerjes së veprave penale të caktuara;*
- *shkallën e lartë të dashjes nga ana e personi të dënuar, duke vepruar me dashje të drejtpërdrejtë dhe me një paramendim të theksuar me qëllim të kryerjes së veprës penale dhe realizimit të pasojave të saj;*
- *nëse veprat penale janë kryer në mënyrë të vazhdueshme, pasi që nga praktika gjyqësore është parë që disa vepra penale nga ky Kapitull, siç janë: “Ndotja, degradimi ose*

---

<sup>389</sup> Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin Pml.nr.579/2023, të datës 06.12.2023, por edhe në disa raste tjera nga praktika e saj gjyqësore ka theksuar se elementet subjektive dhe objektive të figurave të veprave penale nuk mund të trajtohen edhe si rrethana rënduese apo lehtësuese, me arsyetimin se rrethana e njëjtë nuk mund të merret parasysh dy (2) herë, së pari nga ligjdhënësi, e më pas edhe nga gjykata.

<sup>390</sup> SHALA, AFRIM, *Hyrje në të drejtën penale*, f. 259-260.

*shkatërrimi i mjedisit*”, nga neni 338 i KPRK-së kryhen në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë të gjatë kohore;<sup>391</sup>

- *qëllimin dhe motivin për kryerjen e veprave penale të caktuara*, pasi që në shumë raste edhe nga praktika gjyqësore është vërejtur se disa nga veprat penale nga ky Kapitull janë kryer me qëllime dhe motive të përfitimit të kundërligjshëm pasuror;
- *shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përkatësisht intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe një rrethanë e tillë duhet pasur kujdes që të merret për bazë si rrethanë rënduese, vetëm nëse nuk përbën element të figurës së veprës penale përkatëse. P.sh. nëse si rezultat i kryerjes së veprës penale “Shkretërimi i pyjeve”, nga neni 348 i KPRK-së është shkatërruar pylli në një sipërfaqe të madhe, për të cilën nevojitet kohë e gjatë për t’u riparuar.*
- nëse vepra penale është kryer si pjesë e një grupi<sup>392</sup> apo veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal,<sup>393</sup>
- ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar;<sup>394</sup> Recidivizmi është përfshirë në kuadër të përcaktimit të pikënisjes prej 2/3. Megjithatë, sa i përket dënimeve të mëparshme të të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.
- rrethanat konkrete në të cilat është kryer vepra penale përkatëse;
- rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, si dhe ndonjë rrethanë tjetër rënduese, që vlerësohet si e tillë nga ana e gjykatës.

## **E. Rrethanat lehtësuese relevante**

Për shkak të natyrave të ndryshme të veprave penale që bëjnë pjesë në këtë Kapitull është vështirë që të përcaktohet se cila nga rrethanat lehtësuese mund të kenë peshë më të madhe se sa rrethanat tjera të kësaj natyre.

---

<sup>391</sup> Duke iu referuar rasteve nga praktika gjyqësore, është vërejtur që edhe vepra penale sipas nenit 80 të Ligjit për Miniera dhe Minerale, shpeshherë është kryer në mënyrë të vazhdueshme.

<sup>392</sup> Në nenin 113, paragrafi 12 të KPRK-së është parashikuar se “Grup njerëzish nënkupton tre (3) ose më shumë persona”.

<sup>393</sup> Në nenin 113, paragrafi 13 të KPRK-së është parashikuar se “Grup kriminal i organizuar nënkupton bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore”.

<sup>394</sup> Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin Pml.nr.395/2023, të datës 29.08.2023, përveç tjerash ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që të marrë parasysh si rrethanë rënduese faktin se ndaj të dënuarit vetëm është zhvilluar apo është duke u zhvilluar procedura penale për vepra penale tjera, pasi që një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, i cili parim është i garantuar edhe me nenin 31, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Jo vetëm në këtë çështje penale, por edhe në raste tjera, Gjykata Supreme e Kosovës ka theksuar se vetëm dënimet e shqiptuara me aktgjykime të formës së prerë, nën rrethana të caktuara dhe nën supozimin e përmbushjes së kushteve të caktuara, mund të merren për bazë si rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit, por në rastin e lartcekur është konstatuar se “nuk duhet të merret në konsideratë fakti se i dënuari paska qenë i dyshuar për disa vepra penale, pasi që kjo nuk do të thotë se i njëjti është fajtor për këto vepra penale”.

Megjithatë, bazuar edhe në praktikën tonë gjyqësore, pranimi i fajësisë<sup>395</sup> është njëra prej rrethanave që merret për bazë si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit për kryerjen e veprave penale nga ky Kapitull. Nëse pranimi i fajësisë shoqërohet edhe me rrethana tjera lehtësuese (p.sh. sjellja e mëparshme e kryesit, keqardhja e shfaqur, kompensimi i dëmit apo shprehja e gatishmërisë për kompensimin, gjendja e rëndë shëndetësore e kryesit apo e ndonjë anëtari të ngushtë të familjes së tij, etj.), atëherë një dënim më i butë mund të jetë i justifikuar, kuptohet duke i pasur parasysh edhe rrethanat tjera të rastit konkret.

Gjithashtu, edhe rrethanat personale dhe karakteri i kryesit të veprës penale; dëshmia që kryesi ka luajtur rol relativisht të vogël në kryerjen e veprës penale; fakti që kryesi ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor, por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër, mandej moshja e kryesit (i ri apo i moshuar); bashkëpunimi i kryesit të veprës penale me gjykatën dhe organet e ndjekjes, si dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale mund të trajtohen si rrethana lehtësuese, normalisht duke i pasur në konsideratë specifikat e secilit rast veç e veç.

## F. Aplikueshmëria e dënimeve tjera

Sikurse edhe për veprat penale tjera, edhe kur është fjalë për vepra penale që bëjnë pjesën në kuadër të Kapitullit të veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, në situata të caktuara duhet pasur në konsideratë edhe shqiptimin e disa dënimeve tjera.

Në këtë drejtim, duhet përmendur edhe *detyrimin e kryesit (personit fizik dhe juridik) që të ndërmer masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor*. Një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në nenin 340, paragrafi 5 dhe nenin 341, paragrafi 7 të KPRK-së. Në këto dispozita ligjore është parashikuar se “Kur shqipton dënimin për veprë penale nga ky nen, gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmer masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor”. Përndryshe, edhe me nenin 7 të Konventës për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale është parashikuar si sanksion penal “*rivendosja e mjedisit*”.<sup>396</sup>

*Konfiskimi* - është një mjet i rëndësishëm që duhet zbatuar në rastet e kryerjes së veprave penale nga ky Kapitull.<sup>397</sup> Në nenin 13, paragrafët 3 - 6 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale është rregulluar çështja e konfiskimit të sendeve dhe të përfitimit pasuror në rastet e veprave penale për të cilat përgjegjës janë personat juridik, ndërsa këto dispozita ligjore do të mund të zbatohen edhe në rastet kur personat juridik kryejnë vepra penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

<sup>395</sup> Neni 70, paragrafi 3, nën paragrafi 3.10. i KPRK-së.

<sup>396</sup> Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale është një dokument i Këshillit të Evropës që është nënshkruar në Strasburg më datën 04.11.1998. <https://rm.coe.int/168007f3f4>

<sup>397</sup> Në nenin 92 të KPRK-së është parashikuar se “Pasuria ose mjete që është përfituar me veprë penale konfiskohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kur konfiskimi nuk është i mundur në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, Gjykata urdhëron kryesin e veprës për të paguar një shumë të barasvlershme ose Gjykata do të konfiskojë çdo pasuri të të pandehurit me vlerë të barasvlefshme siç është përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës”.

Dënimi me kusht - është i përshtatshëm që të zbatohet në rastet e caktuara, duke e zbatuar nenin 48, paragrafët 2 dhe 3 të KPRK-së. Nën rrethana të caktuara, është në veçanti e rëndësishme që gjykatat ta shqiptojnë dënimin me kusht, duke vendosur që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar kryesi i veprës penale nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenzon dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me nenin 56 të KPRK-së.<sup>398</sup>

Dënimi me gjobë - është i rëndësishëm që të shqiptohet në rastet të caktuara, duke i pasur në konsideratë edhe kriteret e parashikuara me ligj. Në këtë aspekt, duhet theksuar se me rastin e caktimit të dënitimit me gjobë, gjykata duhet të merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjykata nuk duhet që të caktojë gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit.<sup>399</sup> Po ashtu, është e rëndësishme që me rastin e shqiptimit të dënitimit me gjobë, gjykatat të kenë në konsideratë Udhëzuesin specifik të Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.<sup>400</sup> Ndërsa, me rastin e caktimit të dënitimit me gjobë ndaj personave juridik për vepra penale nga ky Kapitull, gjykatat duhet të kenë në parasysh rrethanat e parashikuara në nenin 10, paragrafi 1 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.

Për vepra penale nga ky Kapitull për të cilat janë përgjegjës personat juridik, gjykatat duhet ta kenë parasysh edhe shqiptimin e dënitimit - pushimi i personit juridik<sup>401</sup> ose caktimin e masës së sigurisë - ndalimi i kryerjes së veprimtarive dhe punëve të caktuara<sup>402</sup>.

Për vepra penale të caktuara (p.sh. vepra penale “Dhënia e ndihmës veterinarë në mënyrë të pandërgjegjshme”, nga neni 343, paragrafi 2 i KPRK-së, etj.), të kryera nga pakujdesia dhe duke i marrë për bazë edhe rrethanat specifike të rastit, gjykatat mund të shqiptojnë edhe vërejtjen gjyqësore, nëse duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vlerësohet që vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënitimit.<sup>403</sup>

Gjithashtu, edhe dënimi alternativ - urdhri për punë në dobi të përgjithshme mund të jetë i përshtatshëm për vepra penale të caktuara, duke e urdhëruar gjithashtu kryesin e veprës penale që të kryejë një apo më shumë detyrime të parapara me paragrafin 3 të nenit 48 ose me nenin 56 të KPRK-së.<sup>404</sup>

- Lirimi nga dënimi - mund të aplikohet te ky lloj i veprave penale vetëm nëse plotësohen kushtet nga Neni 74 nënparagrafi 1.2 i KPRK-së.

<sup>398</sup> Neni 48, paragrafi 3 i KPRK-së.

<sup>399</sup> Neni 69, paragrafi 5 i KPRK-së.

<sup>400</sup> [https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/legalOpinions/83258\\_Udhezues%20per%20logaritjen%20e%20gjobes\\_final.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/legalOpinions/83258_Udhezues%20per%20logaritjen%20e%20gjobes_final.pdf)

<sup>401</sup> Neni 11 i Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.

<sup>402</sup> Neni 13, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.

<sup>403</sup> Neni 81 i KPRK-së.

<sup>404</sup> Neni 57, paragrafi 4 i KPRK-së.

## **XVI. Kapitulli XXVIII Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Në jetën e përditshme kryerja e punëve të caktuara dhe përdorimi i mjeteve të caktuara paraqet mundësi apo bart në vete rrezik për jetën, integritetin trupor dhe pasurinë e njerëzve. Mbrojta e jetës, integritetit trupor dhe pasurisë nga këto veprime të rrezikshme bëhet përmes marrjes së masave adekuate preventive, por edhe përmes përcaktimit të normave të caktuara juridiko penale, të cilat vijnë në shprehje në rastet e shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm për njerëzit dhe pasurinë, ngase ndërmarrja e veprimeve të përgjithshme të rrezikshme dhe përdorimi i mjeteve të rrezikshme mund të jetë mënyrë për kryerjen e shumë veprave penale në drejtim të jetës, integritetit trupor dhe pasurisë.

Në këtë kapitull përfshihen shtatë vepra penale: shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm (neni 356); asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike (neni 357); asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës (neni 358); ndërtimi pa leje (neni 359); punimet ndërtimore të kundërligjshme (neni 360); dërgimi apo transportimi i kundërligjshëm i lëndëve eksplozive ose lëndëve ndezëse (neni 361); mos evitimi i rrezikut (neni 362); dhe keqpërdorimi i sinjalit të fatkeqësisë apo të rrezikut (363).

Karakteristikat e veprave penale nga ky kapitull janë:

- me kryerjen e këtyre veprave penale shkaktohet një rrezik i përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe për pasurinë në vëllim të madh;
- rreziku i përgjithshëm si pasojë e veprimit të rrezikshëm qëndron në rrezikimin e jetës apo trupit të një rrethi të papërcaktuar të njerëzve apo sendin e papërcaktuar;
- rreziku i përgjithshëm si pasojë e veprës penale kundër sigurisë së përgjithshme mund të jetë konkret dhe abstrakt.

Dashja është forma themelore e fajit të këto vepra penale, mirëpo disa nga këto vepra penale ekzistojnë edhe kur kryhen nga pakujdesia.


Varësisht nga forma e fajit dashja apo pakujdesia dhe pasojat e shkaktuara në pasuri, njerëz dhe vendin ku kryhen, për këto vepra penale parashihen:

- Dënime të ulëta me maksimumet deri 1,3 vjet
- Dënime mesatare me maksimumet deri 5, 8 dhe 12 vjet.

Zakonisht kur këto vepra penale kryhen në vendin ku janë të pranishëm një numër i madh i njerëzve, apo kur këto vepra rezultojnë me lëndime të rënda trupore, dëm substancial pasuror apo me vdekje dënimet janë prej 8 deri në 12 vjet.

### **A. Pikënisja**

Me qëllim të harmonizimit të qasjes në matjen e dënimit për këto vepra, figura e mëposhtme ofron rekomandimin për pikënisjen e matjes së dënimit:



- 1/3 për veprat me dënime më të ulëta
- 1/2 për veprat me dënime mesatare dhe me dënime maksimale
- 2/3 për veprat penale të kryera nga recedivistët

Grafiku i mësipërm tregon qartazi dallimin në mes të formave të ndryshme të matjes së dënimit për këto vepra bazuar në dënimet që parashihen për këto vepra penale.

### **B. Rrethanat rënduese relevante**

Te këto vepra penale vijnë në shprehje disa nga rrethanat rënduese të parapara me par. 2 të Nenit 70 të KPRK-së.

*a) nëse vepra penale përfshin disa viktime* Në fakt pasojat e këtyre veprave penale që rezultojnë me vdekjen e një apo me shumë personave, janë element cilësues, por kjo rrethanë e paraparë me nenin 70 par. 5 të KPRK-së duhet të merret parasysh në të gjitha rastet kur si pasojë e këtyre veprave penale humbin jetën me shumë se tre persona

*b) shkalla e dëmit të shkaktuar nga personi i akuzuar* Edhe pse shkalla e dëmit dhe vdekja e një apo më shumë personave janë elemente të këtyre veprave penale, shkalla e dëmit të këto vepra penale, si rrethanë rënduese duhet vlerësuar duke u bazuar në dëmin e shkaktuar familjareve të viktimave (personave të vdekur) veçanërisht, kur kemi të bëjmë me disa viktime, dëmi i shkaktuar për shkak të pasojave e lëndimeve në rastet kur kemi të bëjmë me lëndime të përhershme, numrin e personave të rrezikuar etj.

*c) ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar* Recidivizmi është përfshirë në kuadër të përcaktimit të pikënisjes prej 2/3. Megjithatë, sa i përket dënimeve të mëparshme të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

### **C. Rrethanat lehtësuese**

Disa nga rrethanat lehtësuese të parapara me nenin 70 par. 3 të KPRK-së janë relevante për aplikim por varësisht se për cilën vepër penale bëhet fjalë.

- a. *Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar.*
- b. *pranimi i fajit.*
- c. *keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar.*
- d. *sjellja e personit të dënuar pas kryerjes së veprës penale.*
- e. *dëshmia që personi i akuzuar ka bërë dëmshpërblimin apo kompensimin e viktimës.*

#### **D. Dënimet tjera që mund të shqiptohen**

Dënimet e mëposhtme nuk konsiderohen të përshtatshme për tu shqiptuar në rastet e personave që edhe me parë kanë kryer vepra penale të natyrës së njëjtë.

*-Shqiptimi i dënimit me kusht* - vjen në shprehje për veprat nga ky kapitull (përjashtim bëjnë veprat penale për të cilat parashihet dënimi me burgim deri në 12 vjet), gjithnjë duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe pasojat e shkaktuara. Dënimi me kusht mund të përfshijë edhe urdhrin për të përmbushur një apo më shumë detyrime sipas dispozitës së nenit 56 të Kodit Penal. Në këtë drejtim gjykata mund të urdhërojë kryesin që të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale, aftësimin profesional në një profesion të caktuar ( nënpar. 1.4 dhe 1.13 i nenit 56). Ndërsa, te vepra penale asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës (neni 358) shprehimisht dispozita parasheh që gjykata mund t'ia shqiptojë kryesit të veprës penale kushtin që të instalojë pajisjet e sigurisë brenda afatit kohor të caktuar (par. 8 i nenit të lartcekur).

*-Shqiptimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm për veprat brenda këtij kapitulli me maksimumin ligjor prej 1 viti dhe nëse gjykata për ato vepra penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë shqipton dënim me gjobë në shumë prej 2500€.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë* - Neni 356 par. 6, neni 359 par. 1, neni 361 par. 1, 2 e 4, neni 362 par. 1, dhe 363 par. 1 parashohin mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë si dënim kryesor. Megjithatë, në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par. 5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>405</sup>

*-Shqiptimi i dënimit plotësues neni 61<sup>406</sup>* - te këto vepra penale kryesit të veprës penale, gjykata mund t'ia shqiptojë dënimin plotësues urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit.

*-Vërejtja gjyqësore* - vërejtja gjyqësore te këto vepra penale vjen në shprehje në rastet kur parashihet dënim deri në 1 vit burgim dhe vepra penale kryhet në rrethana veçanërisht lehtësuese.

*-Lirimi nga dënimi* - te këto vepra penale nuk parashihet shprehimisht se kryesi mund të lirohet nga dënimi, mirëpo, meqë edhe këto vepra penale mund të kryhen nga pakujdesia, te këto vepra penale mund të vjen në shprehje lirimi nga dënimi konform nenit 74 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2

<sup>405</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>406</sup>Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 64 e 65, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.



i KPRK-së, në rastet kur kryesi menjëherë pas kryerjes së veprës penale ka bërë përpjekje për evitimin ose zvogëlimin e pasojave të asaj vepre dhe nëse në tërësi apo në një pjesë të madhe e ka kompensuar dëmin e shkaktuar me atë vepër.

## **XVII. Kapitulli XXIX Veprat penale të armëve**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Kodi Penal tradicionalisht ka përcaktuar një kapitull të posaçëm të veprave penale të armëve dhe kjo për shkak të faktit se armët zakonisht paraqesin mjete të rrezikshme dhe nuk janë në posedim të lirë të qytetarëve, por nevojitet të merret leja e lëshuar nga organet kompetente. KPRK-ja, Kodi Nr.06/L-074 ka përcaktuar format themelore të inkriminimit ligjor, kurse me qëllim të qartësimit se çka konsiderohet armë dispozita e nenit 113 par. 1 nënpar. 40 i KPRK-së ka përkufizuar, përcaktuar dhe kategorizuar armët dhe llojet e tyre, kurse si pjesë përbërëse e veprave penale është përcaktuar përmes normave blankete të cilat mbështeten në Ligjin për Armët –Ligji Nr.05/L-022, si dhe në Udhëzimet Administrative të nxjerra nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Përndryshe në dispozitat ligjore janë përfshirë disa aspekte të rëndësishme të veprimtarive me armë duke filluar nga Importi, eksporti, mbajtja e tyre përdorimi dhe prodhimi i tyre dhe të cilat inkriminime ligjore janë sistemuar përmes dispozitave përkatëse ligjore.

Në këtë kapitull përfshihen gjashtë vepra penale: Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse (neni 364), Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion (neni 365), Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve (neni 366), Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm (neni 367), Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme (neni 368) dhe Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale (369).

Karakteristikë themelore të këtyre veprave penale përbën fakti se pjesa dërmuese e tyre kanë të bëjnë me mbajtjen në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve dhe përdorimi i tyre, kurse veprat tjera të përcaktuara në këtë kapitull janë më të rralla që paraqiten në praktikën gjyqësore. E veçantë e këtyre veprave penale paraqet fakti se mund të kryhen edhe nga personat të cilët posedojnë leje për armën, mirëpo nuk u përmbahen lejeve përkatëse të lëshuara apo edhe skadimin e lejeve për afatin e përcaktuar.

Veprat penale nga ky kapitull kryhen vetëm me dashje, kurse mënyra e kryerjes së këtyre veprave penale kryhet me veprim. Duke marrë parasysh faktin se veprat penale të armëve janë vepra penale me të cilat edhe ndërlihen me përfitim pasuror dhe se armët shpesh herë paraqesin mjete për kryerjen e veprave tjera penale, te shumica dërmuese e këtyre veprave janë përcaktuar dy dënime dhe atë dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim. Dënimet me gjobë dhe me burgim te disa vepra penale janë paraparë të shqiptohen në formë kumulative, kurse në disa të tjera në formë alternative dhe atë varësisht prej natyrës dhe rrezikshmërisë së tyre.

Duke marrë parasysh se në këtë kapitull janë paraparë disa vepra penale të llojeve dhe karakteristikave të ndryshme, atëherë edhe përcaktimi i dënimeve është mjaft i ndryshëm si te dënimet me burgim gjithashtu edhe te dënimet me gjobë. Te dënimet e përcaktuara me gjobë është karakteristike se te disa vepra penale nuk është përcaktuar as minimumi dhe as maksimumi ashtu që në këto raste aplikohet minimumi dhe maksimumi i përcaktuar ligjor. Kurse në disa vepra


penale është përcaktuar vetëm maksimumi ligjor dhe atë duke filluar nga dymijë e pesëqind (2.500) Euro në (dhjetëmijë)10.000 Euro.

Sa i përket dënimeve me burgim gjithashtu ka mjaft hapësirë të gjerë në mes minimumit dhe maksimumit të tij dhe kryesisht paraqitet në dy forma dhe atë në formën për ku nuk është përcaktuar fare minimumi ligjor por vetëm maksimumi i tij, kurse te disa vepra tjera është përcaktuar kufiri në mes të minimumit dhe maksimumit që është një kufi mjaft i lartë e që për dy vepra penale është një margjinë e lartë e dënimit duke filluar nga një (1) vit e deri në dhjetë (10) vjet.

Duke analizuar këtë diversitet të lartë në mes dënimeve të përcaktuara, si për dënime me gjobë e po ashtu edhe me burgim, del se gjykatat kanë një mundësi të madhe të shqiptimit të dënimeve jo konsistente dhe pa dyshim se aplikimi i udhëzuesit paraqet një domosdoshmëri. Gjithsesi është e rëndësishme të potencohet fakti se KPRK-ja ka përcaktuar si formë kualifikuese përdorimin e armës apo mbajtjen me vete të saj në hiq më pak se tridhjetë (30) vepra penale që tregon faktin se veprat penale nga ky kapitull duhet konsideruar si vepra penale me rrezikshmëri të lartë.

#### A. Pikënisja

Me qëllim të harmonizimit të qasjes në matjen e dënimit për këto vepra penale, atëherë për tri situata të ndryshme ofron rekomandimin për pikënisjen e matjes së dënimit duke pasur parasysh shkallën e dënimit, specifikat dhe cilësitë e kryesve të veprave penale:



*-pikënisja nga 1/3 për veprat kur kryerësit e veprave penale nuk kanë të kaluar penale, përkatësisht nuk kanë qenë më parë të dënuar, apo kanë qenë të pajisur me leje paraprakisht por nuk e kanë vazhduar brenda afatit kohor lejen përkatëse. Pikënisja sipas kësaj kategorie do të ishte e përshtatshme edhe në rastet kur kryesi nuk i përmbahet lejes së armës, përkatësisht vepron jashtë kësaj leje. Andaj, në këto situata konsiderojmë se do të ishte e përshtatshme pika nga 1/3 e maksimumit të dënimit.*

*-pikënisja nga 1/2 për veprat kur kryesit e veprave penale kanë të kaluar penale, përkatësisht kanë qenë më parë të dënuar për vepra të kësaj natyre dhe në rastet kur kjo vepër penale kryhet me qëllim të përfitimit pasuror.*

*-kurse pikënisja nga 2/3 për rastet kur kryesit e veprave penale kanë të kaluar penale, përkatësisht kanë qënë më parë të dënuar disa herë për vepra të kësaj natyre dhe kjo vepër penale kryhet me qëllim të përfitimit pasuror të shumave të mëdha* apo duke vepruar në disa shtete apo brenda një shteti por në disa vende të ndryshme dhe me qëllim të kryerjes së veprave penale me rrezikshmëri të lartë. Pikënisja sipas kësaj kategorie për shkak të këtyre karakteristikave do të ishte e përshtatshme nga 2/3 e maksimumit të dënimit, mirëpo duhet pasur parasysh që karakteristikat e lartë cekura të mos jenë të inkorporuara në veprat e veçanta penale.

Figura e mësipërme tregon qartazi dallimin në mes të formave të ndryshme të matjes së dënimit për këto vepra bazuar në dënimet që parashihen për këto vepra penale dhe varësisht nga natyra dhe pasojat që rezultojnë nga veprimet e ndërmarra përmes këtyre veprimeve.

## **B. Rrethanat rënduese relevante**

Te këto vepra penale vijnë në shprehje disa nga rrethanat rënduese të parapara me nenin 70 par. 2 të KPRK-së, ngase siç është thënë edhe me lart këto vepra penale kryhen me dashje, por me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese duhet pasur parasysh faktin se përdorimi i armës apo mbajtja e saj është inkriminuar si formë kualifikuese në tridhjetë (30) vepra penale të ndryshme, andaj në këto raste nuk mund të përdoret si rrethanë rënduese fakti se kryesi ka përdorë apo ka pasur me vete armë, meqë kjo paraqet element kualifikues të veprës penale konkrete dhe njëkohësisht dyfishim të rrethanave rënduese. Me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese duhet pasur parasysh se ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Kodit Penal edhe në këtë Udhëzues rrethanat rënduese nuk janë të natyrës shteruese dhe të përcaktuara në mënyrë të prerë, andaj, gjykata ka diskrecion të paraqesë edhe rrethana të tjera varësisht nga kryesi dhe vepra penale. Rrethanat rënduese për veprat penale sipas këtij kapitulli mund të jenë të natyrave të ndryshme dhe secili rast mund të ketë specifikat e veta.

Kurse duke pasur parasysh dispozitën e nenit 70 par. 2 të KPRK-së mund të konkludojmë se nga lista e këtyre rrethanave rënduese të përcaktuara disa nga to mund të aplikohen edhe për këtë kapitull të veprave penale dhe atë:

*Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të akuzuar në veprën penale* - Pjesëmarrja e lartë mund të përkufizohet në rastet kur kryesit e veprave penale veprojnë duke i ndarë rolet e tyre dhe me këtë rast njëri nga kryesit dominon veprën penale në krahasim me pjesëmarrësit e tjerë. Ky dominim mund të shprehet si person kyç i organizimit të trafikimit të armëve, krijimit të rrjetit të trafikantëve të armëve, organizimi të jetë për një kohë më të gjatë, të përfshihen një apo më shumë shtete në këtë veprimtari. Si rrethana tjera mund të çmohen edhe shkalla e planifikimit dhe veçanërisht kohën e përfshirë në përgatitjen e veprës deri te realizimi i saj.

*Shkalla e lartë e dashjes - kamuflimi, kalimi përmes disa shteteve etj.* - Të gjitha këto, por edhe indikatorë tjerë janë me rëndësi në përcaktimin e nivelit të dashjes respektivisht këmbëngulësisë së kryesit në kryerjen e veprës penale e rrjedhimisht edhe në përcaktimin e lartësisë së dënimit.

*Prezencën e dhunës dhe kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale* - Kjo rrethanë paraqet bazë për tu çmuar si rrethanë rënduese në rastet kur dhuna dhe kanosja paraqesin mjet për tu

realizuar këto vepra penale dhe fakti se armët paraqesin mjete të rrezikshme apriori paraqesin rrethana rënduese, por kjo rrethanë nuk duhet të aplikohet në rastet kur arma paraqet elementin kualifikues të veprave tjera penale dhe ku përcaktohet përdorimi apo mbajtja e armës si formë e kualifikuar e veprës penale, meqë do të dyfishohej rrethana rënduese.

Nëse vepra penale përfshinë disa viktime - Kjo rrethanë paraqet bazë për tu çmuar si rrethanë rënduese në rastet kur përmes veprimtarisë së caktuar të veprat penale sipas këtij kapitulli përfshijnë një numër të madh të viktimave. Si rrethana tjera rënduese mund të konsiderohen nëse vepra është kryer në vazhdimësi ndaj viktimës së njëjtë, shkallën e vuajtjes dhe poshtërimit të shkaktuar dhe pamundësia e mbrojtjes së viktimës.

Nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndieshme - Kjo rrethanë paraqet bazë për tu çmuar si rrethanë rënduese në rastet kur përmes këtyre veprave penale ndërlihet me personat e pambrojtur dhe të ndjeshëm dhe kjo si rezultat i veprimtarisë së caktuar të veprat penale sipas këtij kapitulli dhe kjo mund të vjen në shprehje të shpeshë të armëve një kategorie të njerëzve të cilët kanë predispozita për të sulmuar këto kategori të viktimave.

Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal - Kjo rrethanë paraqet bazë për tu çmuar si rrethanë rënduese në rastet kur nuk është paraparë si inkriminim i veçantë.

Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar - Kjo rrethanë mund të çmohet si rrethanë rënduese në rastet kur kryeri kryen vepra penale brenda këtij kapitulli, por edhe vepra penale të tjera të cilat janë tregues se i njëjti ka prirje për kryerjen e veprimeve penale të cilat ndërlihen me personalitetin e tij. Recidivizmi është përfshirë në kuadër të llogaritjes së pikënisjes, megjithatë, sa i përket dënimeve të mëparshme të të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

Nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjare - Kjo rrethanë mund të çmohet si rrethanë rënduese në rastet kur kryesi kryen vepra penale brenda marrëdhënies familjare dhe ndërlihet me faktin se në përgjithësi veprat penale që kryhen brenda familjes paraqesin rrezikshmëri më të lartë pasi që çrregullojnë këto relacione e kjo shpesh herë mund të kryhet kundër fëmijëve apo në prezencë të tyre, ndaj anëtarit tjetër të familjes i cili është i pambrojtur dhe se ndikimi i këtyre veprave penale të viktimat ka për pasojë aspektin psikologjik të tyre.

### **C. Rrethanat lehtësuese relevante**

Disa nga rrethanat lehtësuese të parapara me nenin 70 par. 3 të KPRK-së janë relevante për aplikim për këtë kategori të veprave penale dhe këto rrethana duhet të çmohen varësisht nga personaliteti i kryesit dhe specifikisht mund të aplikohen për këtë kapitull të veprave penale:

Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar - Kjo rrethanë mund të çmohet si rrethanë lehtësuese në rastet kur ekzistojnë rrethana të mira personale dhe posaçërisht vjen në shprehje me rastet e pendimit për veprën penale të kryer dhe e shoqëruar me premtimin e tij se nuk do të përsëritë vepra të kësaj natyre e as vepra tjera penale. Karakteri i mirë, vlerësohet nga vlerësimi i

aspekteve siç janë reputacioni, kredibiliteti, personaliteti dhe sjellja shoqërore e të akuzuarit, zakonisht kanë për qëllim që të tregojnë se vepra e kryer është jashtë karakterit dhe kjo ndërlihet me informacionet lidhur me jetën e të akuzuarit, të kaluarën dhe karakteristikat e tij.

Dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale -Përcaktimi i kësaj rrethane duhet të ndërlihet me shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit tjetër dhe me rastin e vlerësimit të veprimeve në mes këtyre personave përcaktohet edhe roli i tij më i ulët dhe i cili mund të manifestohet edhe përmes sjelljes së tij duke shprehur një dozë të pendimit.

Fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër - Gjithashtu edhe kjo rrethanë gjen aplikim në rastet kur pjesëmarrja e tij nuk është si kryes kryesor, por në mënyra të ndryshme kontributi i tij është më i vogël në kryerjen e veprës penale.

Mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar - Mosha e personit duhet çmuar si rrethanë rënduese në rastet kur i njëjti është person i ri, meqë kjo zakonisht paraqet një papjekuri të tij për të kuptuar natyrën e këtyre veprave penale, kjo rrethanë mund të çmohet edhe te personat e moshuar të cilët nuk kanë ndonjë përkufizim kohor se cila moshë konsiderohet e moshuar.

Bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar; bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale - Bashkëpunimi mund të çmohet si rrethanë lehtësuese, por ky kontribut duhet të jetë i konkretizuar dhe të rezultojë me pranimin e përgjegjësisë dhe njëkohësisht pendimin e tij. Nëse gjykata e përcakton që bashkëpunimi ka qenë substancial, kjo rrethanë në përgjithësi konsiderohet si e rëndësishme për zbutje pasi që e ndihmon në gjykim më të shpejtë. Në anën tjetër, kur gjyqtarët e përcaktojnë që bashkëpunimi është bërë me ngurrim, ishte sporadik apo i ndërlihet me ndonjë faktor të jashtëm, zbutja do të jetë më e vogël.

Pranimin e fajit - Pranimi i fajit zakonisht çmohet si rrethanë lehtësuese për faktin se përmes kësaj mënyre gjykimi përfundohet më shpejt, pastaj nuk është e nevojshme administrimi i provave që ulë koston kohore dhe materiale të një gjykimi. Mirëpo duhet dalluar fazat e pranimin të fajësisë dhe natyrisht se pranimi i bërë në fazat fillestare paraqet bazë për zbutje më të madhe, kurse pranimi i fajit në fazat e më vonshme paraqet një bazë për zbutje, por që duhet çmuar në masë më të vogël të zbutjes. Gjithashtu duhet vlerësuar se ky pranim a përcillet me pendim të plotë dhe të sinqertë të kryesit. Kjo rrethanë duhet gjithashtu të ndërlihet edhe me një sërë faktorësh tjerë, siç janë sjellja e kryerësit në raport me viktimën, keqardhja e tij apo edhe kompensimi i dëmit të shkaktuar. Sipas praktikës gjyqësore, kjo rrethanë shpesh herë është mbivlerësuar dhe është jo e përpjestueshme në krahasim me rrethanat tjera që tregojnë edhe për llogaritjen e dyfishtë dhe mbivendosjen e kësaj rrethane.

Keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar - Kjo rrethanë mund të çmohet si rrethanë lehtësuese dhe duhet të manifestohet jo vetëm përmes deklaramit verbal por duhet të argumentohet përmes sjelljeve të kryesit. Ky vlerësim është qartazi i vështirë, duke e pasur parasysh që kjo rrethanë është e natyrës subjektive, besueshmëria e së cilës varet vetëm nga kryesi. Kërkon nga gjykata që t'i merr parasysh jo vetëm fjalët e kryesit, por edhe provat rrethanore dhe konkludimet që mund të nxirren nga veprimet dhe sjellja.

*Sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit* - Sjellja e kryesit pas kryerjes së veprës penale mund të çmohet si rrethanë lehtësuese kur ai manifeston sjellje të mira qoftë ndaj viktimës apo edhe komunitetit në përgjithësi duke shprehur pendim për veprimin e kryer dhe si rezultat i pendimit vijon me sjellje të mira duke ndihmuar apo përkrahur një kategori të caktuar të personave apo një institucion përkatës që merret me rehabilitimin e njerëzve të caktuar.

#### **D. Dënimet tjera që mund të shqiptohen**

Asnjë nga dënimet e mëposhtme nuk konsiderohen të përshtatshme për tu shqiptuar në rastet e personave që edhe me parë kanë kryer vepra penale të natyrës së njëjtë.

*-Shqiptimi i dënimit me kusht* - dënimi me kusht mund të shqiptohet te të gjitha veprat penale të përcaktuara nga ky kapitull (pasi që maksimumi i dënimit është i përcaktuar me burgim deri në 10 vjet), andaj duke aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit ekziston mundësia e shqiptimit të dënimit me kusht (neni 49 par. 2 i KPRK-së), por edhe për veprat tjera penale për të cilat parashihet dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet, dënimi i kushtëzuar mund të shqiptohet pa aplikimin e dispozitave të zbutjes së dënimit (neni 49 par. 1 i KPRK-së). Mirëpo në këto raste duhet pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe pasojat e shkaktuara me këtë veprë penale. Me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, Gjykata duhet të ketë parasysh edhe mundësinë e caktimit të urdhrave shtesë sipas Nenit 56. Një nga obligimet shumë specifike në këtë nen që domosdoshmërisht është e përshtatshme për aplikim te ky kapitull është edhe obligimi sipas paragrafit 1.11 - heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve. Natyrisht, varësisht nga rrethanat e rastit konkret zbatim mund të gjejnë edhe obligimet tjera sipas këtij Neni.

*-Shqiptimi i urdhërit për punë në dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm për veprat brenda këtij kapitulli me maksimumin ligjor prej një (1) viti dhe nëse gjykata për ato vepra penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë shqipton dënim me gjobë në shumë prej 2500 €.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë* - Pothuajse në të gjitha veprat penale të përcaktuara në këtë kapitull (me përjashtim të veprave penale të përcaktuara me nenin 366 par. 2 të KPRK-së, dhe veprës penale të paraparë me dispozitën e nenit 369 par. 1 dhe 2 të KPRK-së), parashohin mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë si dënim kryesor dhe atë në dy forma: si dënim kumulativ dhe si dënim alternativ. Megjithatë, në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që lartësia e gjobës së caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me dispozitën e nenit 69 par. 5 të KPRK-së dhe po ashtu edhe duke aplikuar Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>407</sup>

*-Shqiptimi i dënimit plotësues<sup>408</sup>* - me përjashtim të dënimeve plotësuese të përcaktuara me nenet 64 dhe 65 të KPRK-së, kryesit të veprave penale nga ky kapitull gjykata mund ti shqiptojë të gjitha dënimet e përcaktuara nga neni 59 i KPRK-së dhe të gjitha dënimet plotësuese janë të përshtatshme

<sup>407</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>408</sup>Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 64 e 65, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

të shqiptohen sipas periudhës së caktuar kohore duke zbatuar dispozitat përkatëse për secilin dënim të përcaktuar.

-Vërejtja gjyqësore - te ky kapitull i veprave penale mund të shqiptohet në rastet kur parashihet dënim deri në një (1) vit burgim dhe duhet pasur parasysh se vepra penale të kryhet në rrethana veçanërisht lehtësuese.

-Lirimi nga dënimi - në këtë kapitull të veprave penale nuk është paraparë mundësia që kryesi mund të lirohet nga dënimi, meqë veprat penale kryhen me dashje, andaj dispozita e nenit 74 të KPRK-së nuk mund të gjejë zbatim.

-Konfiskimi - me përjashtim të veprës penale prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale (neni 369) në të gjitha veprat tjera penale të këtij kapitulli është përcaktuar konfiskimi obligativ i armëve. Për më tepër, në disa vepra penale konfiskimi përfshin edhe mjetet për prodhimin e armëve dhe gjithashtu mjetet për transportin e armëve që paraqet një detyrim të veçantë të gjykatave që të bëjnë konfiskimin e tyre në mënyrë automatike.



## **XVIII. Kapitulli XXX - Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Trafiku publik është veprimtari e rëndësishme ekonomike, por në të cilën gjithherë ekziston mundësia që të sillet në rrezik jeta, integriteti trupor dhe pasuria. Mbrojta e jetës, integritetit trupor dhe pasurisë në trafikun publik bëhet nëpërmjet veprave penale respektivisht përcaktimit të veprimeve inkriminuese ndaj atyre që shkelin rregullat e trafikut publik dhe qëllimi i tyre është sigurimi i zhvillimit të trafikut publik në përputhje me dispozitat e tij.

Në këtë kapitull përfshihen gjashtë vepra penale: rrezikimi i trafikut publik (neni 370), ngasja në gjendje të dehur (neni 371), rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme (neni 372), mbikëqyrja e pandërgjegjshme e trafikut publik (neni 373), mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e komunikacionit (neni 374) dhe keqpërdorimi i sinjaleve ndërkombëtare të komunikacionit (375).

Karakteristike e këtyre veprave penale është se ato kryhen me sjellje të paligjshme të pjesëmarrësve në trafik, përkatësisht me shkelje të dispozitave përkatëse të trafikut publik duke venë në rrezik jetën ose integritetin trupor të njerëzve apo pasurisë. Prandaj, me rastin e aplikimit të këtyre dispozitave ato duhet të plotësohen me norma të përfshira në dispozitat që kanë të bëjnë me (ligjin) sigurinë e trafikut publik.


Të gjitha veprat penale kryhen me dashje dhe nga pakujdesia dhe varësisht nga forma e fajit dashja apo pakujdesia dhe pasojat e shkaktuara në pasuri dhe në njerëz për këto vepra penale parashihen:

- Dënime të ulëta me maksimume deri 1, 3 vjet
- Dënime mesatare me maksimume deri 5, 8 dhe 12 vjet.

Zakonisht, kur këto vepra penale kryhen me dashje dhe shkaktojnë pasojë vdekjeprurëse apo dëme pasurore prej 20.000€ dënimet maksimale janë deri në 12 vjet.

### **A. Pikënisja**

Me qëllim të harmonizimit të qasjes në matjen e dënimit për këto vepra, figura e mëposhtme ofron rekomandimin për pikënisjen e matjes së dënimit:



Grafiku i mësipërm tregon qartazi dallimin në mes të formave të ndryshme të matjes së dënimit për këto vepra bazuar në dënimet që parashihen për këto vepra penale dhe varësisht nga fakti se a janë marrë veprimet me dashje apo nga pakujdesia dhe çfarë pasojash kanë rezultuar nga këto veprime.

## B. Rrethanat rënduese

Te këto vepra penale vijnë në shprehje disa nga rrethanat rënduese të parapara me par. 2 të Nenit 70 të Kodit Penal ngase siç është thënë edhe më lartë shumica e këtyre veprave penale kryhen me dashje (eventuale) apo nga pakujdesia, pra, nuk janë vepra penale të kryera me paramendim apo të drejtuara ndaj personit të caktuar apo pasurisë së caktuar.

Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të akuzuar në veprën penale - Si kryes i numrit më të madh të këtyre veprave penale janë pjesëmarrësit në trafik dhe meqë këto vepra penale kryhen me shkelje të dispozitave përkatëse të trafikut publik nuk janë të rralla rastet kur vepra penale kryhet me kontributin e të dy pjesëmarrësve në trafikun publik, apo kontributi i njërit pjesëmarrës është parësor dhe i tjetrit dytësor. Prandaj, kjo rrethanë rënduese vjen në shprehje në të gjitha rastet kur deri te aksidenti vjen me lëshimet ekskluzive të personit të akuzuar apo njërit pjesëmarrës në trafik.

Nëse vepra penale përfshin disa viktime - Në fakt pasojat e këtyre veprave penale që rezultojnë me vdekjen e një apo me shumë personave, është element cilësues, por kjo rrethanë e paraparë me nenin 70 par. 5 të KPRK-së duhet të merret parasysh në të gjitha rastet kur si pasojë e shkeljes së rregullave të trafikut publik humbin jetën disa persona, sepse nuk janë të rralla rastet kur si pasojë e këtyre veprave penale vdesin apo lëndohen rëndë më shumë se tre persona.

Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar - Kjo rrethanë vjen në shprehje veçmas në rastet kur i akuzuari është dënuar me parë për vepra penale të kësaj natyre. Sa i përket dënimeve të mëparshme të të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

### C. Rrethanat lehtësuese relevante

Disa nga rrethanat lehtësuese të parapara me Nenin 70 par. 3 të KPRK-së janë relevante për aplikim por varësisht se për cilën veprë penale bëhet fjalë.

- *Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar* - Pesha e rrethanave personale dhe karakteri i të dënuarit varet nga dënimi që shqiptohet me gjobë apo me burgim.
- *pranimi i fajit*
- *keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar*
- sjellja e personit të dënuar pas kryerjes së veprës penale - kompensimi i shpenzimeve, ofrimi i ndihmës menjëherë pas kryerjes së veprës etj.

### D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera

Asnjë nga dënimet e mëposhtme nuk konsiderohen të përshtatshme për tu shqiptuar në rastet e personave që edhe më parë kanë kryer vepra penale të natyrës së njëjtë.

*-Shqiptimi i dënimit me kusht* - vjen në shprehje për veprat nga ky kapitull (përfashtim bëjnë veprat penale për të cilat parashihet dënimi me burgim deri në 12 vjet), gjithnjë duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe pasojat e shkaktuara. Krahas dënimit me kusht, gjykata duhet të konsiderojë shqiptimin e dënimit me kusht konform Nenit 46 par. 2.2.<sup>409</sup> dhe llojet e detyrimit me kusht konform Nenit 56<sup>410</sup>, adekuate për këtë kategori.

*-Shqiptimi i urdhrat për punë në dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm për veprat brenda këtij kapitulli me maksimumin ligjor prej 1 viti dhe nëse gjykata për ato vepra penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë shqipton dënim me gjobë në shumë prej 2500€.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë* - Nenet 370 par. 1 dhe 7, neni 371 par. 1dh e 2, neni 372 par. 2 dhe 6, neni 373 par. 1, 2 dhe 3 parashohin mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë si dënim kryesor. Megjithatë, në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par. 5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale.<sup>411</sup>

*-Shqiptimi i dënimit plotësuese - neni 64 e 65<sup>412</sup>* - te këto vepra penale gjykata mund të shqiptojë dënimet plotësuese, si ndalimi i drejtimit të automjetit (neni 64) dhe marrja e lejes së vozitjes (neni 65). Sipas nenit 64 të KPRK-së – kryesit të veprës penale, i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar. Kurse,

<sup>409</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 46 paragrafi 2.2. Urdhëri për mbikqyrje nga Shërbimi sprovues, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>410</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 56 Llojet e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

<sup>411</sup> Udhëzues specifik: Caktimi i gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Miratuar më 27 shkurt 2020 nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, Prishtinë.

<sup>412</sup>Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr, 06/L-074, Neni 64 e 65, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

sipas nenit 65 të KPRK-së kryesit të veprës penale, i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar, po ashtu gjykata mund t'ia marrë lejen e vozitjes për llojin apo kategorinë e caktuar të automjetit dhe mund t'ia ndalojë kryesit marrjen e lejes së re gjatë periudhës prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Nëse kryesi nuk ka leje të vozitjes, gjykata ia ndalon kryesit marrjen e lejes së vozitjes brenda afatit prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Por, dënimin plotësues – marrja e lejes së vozitjes gjykata mund ta shqiptojë vetëm nëse kryesi ka kryer vepër penale duke shkaktuar lëndim të rëndë trupor apo vdekjen e personit ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e kryesit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit.

*-Vërejtja gjyqësore* - vërejtja gjyqësore te këto vepra penale vjen në shprehje në rastet kur parashihet dënim deri në 1 vit burgim dhe vepra penale kryhet në rrethana veçanërisht lehtësuese.

*-Lirimi nga dënimi* - sipas kodit penal, gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale vetëm kur kjo parashihet me ligj. Te këto vepra penale nuk parashihet shprehimisht se kryesi mund të lirohet nga dënimi, mirëpo, meqë këto vepra penale kryhen edhe nga pakujdesia, për to vjen në shprehje baza e posaçme fakultative e liritimit nga dënimi për veprat penale të kryera nga pakujdesia- nenit 74 par. 1 nënpar. 1.1 e 1.2 të KPRK-së. Te vepra penale e rrezikimit të trafikut publik nga pakujdesia nuk janë të rralla rastet kur pasojat e godasin aq rëndë kryesin sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij, apo rastet kur kryesi menjëherë pas kryerjes së veprës penale ka bërë përpjekje për evitimin ose zvogëlimin e pasojave të asaj vepre dhe nëse në tërësi apo në një pjesë të madhe e ka kompensuar dëmin e shkaktuar me atë vepër.

## **XIX. Kapitulli XXXI - Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Veprat penale që cenojnë administrimin e drejtësisë godasin në thelb funksionimin e sistemit të drejtësisë. Është më se e rëndësishme, të ekzistojë besueshmëria në sistemin tonë të drejtësisë, për këtë qëllim, duhet të mbrohet nga cenimet, sulmet dhe ndërhyrjet e tilla të natyrës kriminale.

Kryesit e veprave që ndërhyjnë në rrjedhën e drejtësisë duhet t'i nënshtrohen dënimeve serioze, veprat penale në lidhje me administrimin e drejtësisë nuk i ndikojnë vetëm te individët, por në komunitetin në përgjithësi, shoqëria ka interes për të siguruar që drejtësia është duke u zbatuar në mënyrën e duhur. Sjelljet e tilla të keqbërësve kanë për pasojë që shkelësit të shmangin ndjekjen penale, ose njerëzit e pafajshëm të hetohen ose të akuzohen pa të drejtë, madje edhe të dënohen. Këto vepra ndër të tjera përfshijnë presionin ndaj dëshmitarëve për të tërhequr dëshminë e tyre ose për ti qëndruar në gjykatë, duke përdorur dhunë ose kërcënime, që mund të ndikojnë deri në atë masë sa të ndryshojë në tërësi epilogu i një rasti në një proces gjyqësor, në këtë mënyrë do të vjen deri te dështimi i drejtësisë. Për rrjedhojë, veprat penale në këtë kapitull mbrojnë aktivitetin e organeve të drejtësisë dhe administratës publike, funksioni i të cilave është jetik për një shoqëri në të cilën sundon ligji.

Numri më i madh i veprave penale që përfshihen në këtë grup është i orientuar kundër organeve të drejtësisë, që kanë të bëjnë me ndjekjen dhe gjykimin e kryesve të veprave penale, d.m.th. kundër funksioneve që i ushtrojnë gjykatat dhe prokuroria. Të tilla janë, p.sh: moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale, moslajmërimi i veprave penale dhe kryesve, ndihma kryesit të veprës penale pas kryerjes së saj, lajmërimet e rreme etj. Ndërsa veprat pengimi i të provuarit në procedurën zyrtare, falsifikimi i dokumenteve, rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve, shkelja e fshehtësisë së procedurës, legalizimi i përmbajtjes së rreme, ofrojnë mbrojtje në përgjithësi të mirëfunksionimit të administratës dhe rendit juridik në përgjithësi. Te veprat penale që kanë të bëjnë me gjykatat, është mospërfillja e gjykatës dhe mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

Përfundimisht, veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike nga kapitulli XXXI, mund të përmbliidhen në katër grupe:

1. Veprat penale të moslajmërimin dhe lajmërimin të rremë:

- a) moslajmërimi për përgatitjen e veprës penale (neni 377 i KPRK-së)
- b) moslajmërimi i veprave penale apo kryesve (neni 378 i KPRK-së)
- c) moslajmërimi i personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal (neni 379 i KPRK-së)

2. Veprat penale që lidhen me procedurën penale:

- a) deklarimi i rremë nën betim (neni 383 i KPRK-së)
- b) deklarimet e rreme (neni 384 KPRK-së)
- c) deklaratat e rreme të dëshmitarëve bashkëpunues (neni 385 i KPRK-së)

- d) pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare (386 KPRK-së)
- e) frikësimi gjatë procedurës penale (neni 387 KPRK-së)
- f) hakmarrja (neni 388)
- g) manipulimi me prova (neni 389)
- h) shkelja e fshehtësisë së procedurës (neni 392)

### 3. Veprat penale të personave të privuar nga liria:

- a) rebelimi i personave të privuar nga liria (neni 396 KPRK-së)
- b) arratisja e personit të privuar nga liria (neni 397 KPRK-së)
- c) mundësimi i arratisjes së personit të privuar nga liria (neni 398 i KPRK-së)
- d) lirimi i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria (neni 399 KPRK-së)

### 4. Vepra të tjera penale:

- a) dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (neni 380 KPRK-së)
- b) dhënia e ndihmës personit të akuzuar nga Tribunali i Hagës (neni 381 i KPRK-së)
- c) mundësimi i kundërligjshëm i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (neni 400 KPRK-së)
- d) mospërfillja e gjykatës (neni 393 KPRK-së)
- e) mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore (neni 394 KPRK-së)
- f) legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë (neni 395 KPRK-së)
- g) falsifikimi i dokumenteve (neni 390)
- h) rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve (neni 391)
- i) mundësimi i kundërligjshëm i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (neni 400 KPRK-së)

Sipas lartësisë së ndëshkimit veprat penale të sipër cekura mund të ndahen në tre grupe:

1. Dënime të larta me minimum prej 10 dhe 15 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm;
2. Dënime mesatare me dënime deri në 10 vjet; dhe
3. Dënim të ulët me dënime me gjobë, 3 muaj, 6 muaj, 1, 3 dhe 5 vjet burgim.

Siç shihet dënimi te veprat penale që i referohen pengimit drejtësisë dhe administratës ekziston një dallueshmëri e lartë prej dënimit minimal me gjobë e deri te dënimi me burgim prej 15 vite-25 vjet (maksimumi i përgjithshëm) ose me burgim të përjetshëm.

Rrjedhimisht, në kuadër të këtij kapitulli përshihen edhe vepra më të rënda që kanë të bëjnë me vrasjen e zyrtarëve, si vepra penale hakmarrja nga neni 388 par. 3 të KPRK-së, e cila inkriminon situatat kur me qëllim të hakmarrje vritet personi zyrtar për ndonjë vepër të kryer gjatë ushtrimit të detyrës së tij zyrtare, si dhe vepra penale shkelja e fshehtësisë së procedurës 392 par. 3 të KPRK-së, në rastet e zbulimit të informacionit të dhënave për identitetin apo të dhënat personale të personit të mbrojtur në procedurë penale apo në programin e veçantë të mbrojtjes, dhe rezulton me vdekjen e personit të mbrojtur, kryesit e këtyre veprave dënohet me burgim prej së paku 15 pesëmbëdhjetë dhe dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.


Duke marrë parasysh seriozitetin e çdo vepre penale, gjykata duhet të ketë në konsideratë shkallën e fajësisë së kryesit në kryerjen e veprës, dëmi i cili është shkaktuar. Natyra e dëmit do të varet nga karakteristikat personale dhe rrethanat e viktimës. Në disa raste mund të mos ketë rezultuar ndonjë dëm real, gjykata do të merret me vlerësimin e rrezikshmërisë së sjelljes së kryerësit, si dhe do të shqyrtojë mundësinë e shfaqjes dhe shkallës së dëmit që mund të kishte ndodhë.

Në këtë kapitull do të ndiqet struktura e përcaktuar në udhëzues, duk filluar nga pikënisja, rrethanat rënduese, lehtësuese dhe mundësia për të aplikuar dënime të tjera.

## A. Pikënisja

Tabela e mëposhtme jep pikënisjen e sugjeruar për veprat nga ky kapitull, duke bërë dallimin mes atyre me dënime më të ulëta, mesatare dhe maksimale si dhe veprat penale më të rënda për të cilat parashihet edhe dënimi me burgim të përjetshëm.

Lartësia e dënimit të veprave penale është çështje e dispozitave ligjore, ky kategorizim është i thjeshtë, bazohet ekskluzivisht në shkallën e dënimit, duke bërë një ndarje e cila ndihmon për të caktuar pikënisjen mbi të cilën do të orientohen gjyqtarët për të përcaktuar dhe shqiptuar dënimin e duhur.



Siç shihet nga grafiku veprat penale me dënim të ulët pikënisja në matjen e dënimit është 1/3 nga dënimi i përcaktuar, në varësi të rrethanave rënduese apo lehtësuese lëvizet nga ky pozicion.

Për shumicën e veprave penale nga ky kapitull përcaktohen dënime të ulëta, ndërsa ekziston përjashtim i përgjegjësisë penale për veprat penale në vijim, moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale (neni 377), moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre (neni 378), moslajmërimi i personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal (neni 379), dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (neni 380) dhënia e ndihmës personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal (neni 381) nëse personi është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore, e përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje

Për veprat penale me dënime mesatare që përfshinë veprat penale prej 5-10 vjet burgim ka përcaktuar pikënisjen prej 1/2 e dënimit, duke marrë parasysh peshën e veprës penale, në varësi të rrethanave të zbatueshme në situatën konkrete, gjykata do të lëviz në drejtim të maksimumit apo minimumit të dënimit.

Është e rëndësishme të theksohet, se lëvizja nga pikënisja nuk është thjeshtë një numërim mekanik sasior i rrethanave rënduese apo lehtësuese, por thelbësore dhe me ndikim në shkallën e dënimit është natyra dhe cilësia e rrethanave, të cilat do ta kenë ndikimin në përcaktimin e dënimit, kjo nënkupton, se secila nga rrethanat peshohet si e vetme, pastaj në ndërlidhje me unitetin e rrethanave si tërësi, në këtë kontekst çmohet ndikimi i saj konkret dhe në dënim.

Veprat me dënim të lartë përfshijnë veprat penale të ndëshkueshme prej 10 dhe 15 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dhe në kuadër të këtij kapitulli janë dy vepra të tilla: hakmarrja nga neni 388 par. 3 i KPRK-së e dënueshme me 15 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dhe Shkelja e fshehtësisë së procedurës nga neni 392 paragrafi 4 e dënueshme me 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. Duhet bërë me dije se sa i përket veprave për të cilat si dënim është paraparë edhe burgimi i përjetshëm pikënisja NUK ZBATOHEM nëse gjykata e shqipton këtë dënim. Sa i përket kësaj çështje gjyqtarët referohen të shqyrtojnë Udhëzuesin e përgjithshëm, më saktësisht Pika III (Dënimet kryesore sipas KPRK-së).

Në përgjithësi me rastin e ndërmarrjes së hapave në procesin e matjes së dënimit nga gjyqtarët kërkohet të ndërtojnë një qasje unike në përcaktimin e dënimit, ashtu që hapi i parë është identifikimi se vepra penale me kualifikimin e caktuar ligjor në cilën kategori të veprave penale renditet, në kategorinë me dënim të ulët, të mesëm apo të lartë.

Pastaj do të ballafaqohen me një mori të rrethanave që ofron konteksti i veprës penale dhe faktorët që lidhen me kryesin e veprës penale. Identifikimi e më pas kombinimi i këtyre faktorëve, duhet të rezultojë në përshtatjen e dënimit i cili mund të jetë më i rëndë apo më i lehtë nga përcaktimi fillestar.

Qasja unike nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe epilog të njëjtë të dënimeve, pasi kjo do të jetë e determinuar nga rrethanat e secilit rast konkret, megjithatë, do të sigurojë konsistencë në dënimet e shqiptuara, do të evitohen dallimet e paarsyeshme për rastet e ngjashme, duke pas hapësirë të mjaftueshme që dallimet në dënime të reflektojnë arsyeshem veçoritë dhe karakteristikat e secilës çështje.

## **B. Rrethanat rënduese**

Në matjen e duhur të dënimit, rëndësi të posaçme nevojitet ti kushtohet rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, si ato subjektive që i referohen kryesit, ashtu edhe atyre objektive. Shkalla e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është një prej faktorëve më të rëndësishëm në këtë drejtim, nëse është i përgjegjshëm, apo ekzistojnë rrethana që ndikojnë në shkallën e përgjegjësisë penale, forma e fajësisë - dashja direkte apo eventuale, ose pakujdesi në ato raste kur sanksionohet pakujdesia. Faktorët të cilët tregojnë se i akuzuari kishte vepruar me paramendim, vendosmëri dhe këmbëngulësi në kryerjen e veprës penale, apo vendimi për të kryer veprën penale ishte aty për



aty, dhe nuk bëhet fjalë për një dashje të paramenduar paraprakisht, motiveve nga të cilat ishte kryer vepra penale, etj, do të kenë rolin dhe efektin e tyre në dënim.

Shkalla e dëmit, është komponenti tjetër relevant në përcaktimin e dënimit, çfarë dëmi dhe në mase është shkaktuar me kryerjen e veprës penale, cilat janë pasojat si për viktimën dhe për komunitetin, a është dëmi i riparueshëm, a ka bërë përpjekje i akuzuari që ta minimizojë dëmin apo ta fshehë.

Gjykata do të kushtojë kujdes në veçanti natyrës së dëmit, që do të varet nga karakteristikat personale dhe rrethanat e viktimës, vlerësimi i dëmit nga gjykata do të jetë një mënyrë për të marrë parasysh ndikimin e një krimi të caktuar që ka pasur mbi viktimën.

Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë çdo herë i shkaktojnë dëm edhe komunitetit, në këtë relacion, paraqitet me rëndësi të çmohet sa është cenuar dhe dëmtuar administrimi i drejtësisë si vlerë e përgjithshme, duke përfshirë në tërë komponentët e saj, nga funksionimi për të kryer misionin kushtetues-ligjor, e deri e te çështja e integritetit dhe besueshmërisë së saj.

Në vlerësimin e seriozitetit të çdo vepre penale konkrete duhet të marrë në konsideratë jo vetëm çdo dëm real i shkaktuar nga vepra, por gjithashtu çdo dëm që synohet të shkaktohet ose mund të parashikohet nga kryesi që do të rrjedhë nga vepra penale.

Ky vlerësim është një detyrë e vështirë, posaçërisht kur ka një disbalancë midis fajit dhe dëmit, ndonjëherë dëmi që rezulton është më i lartë, se dëmi i synuar nga kryesi, në rrethana të tjera, fajësia e kryesit mund të jetë në një nivel më të lartë se dëmi që rezulton nga vepra penale. Në këtë aspekt, dëmi duhet të gjykohet gjithmonë në dritën e fajësisë. Për të përcaktuar nivelin më të saktë të fajësisë, do të shqyrtohen faktorë të tillë si: motivi, planifikimi, spontaniteti. Pastaj në situatat kur me dashje shkakton më shumë dëm sesa është e nevojshme për kryerjen e një vepre të tillë, ose kur synohet një viktimë e ndjeshme (për shkak të pleqërisë ose rinisë së tyre, paaftësia ose për shkak të punës që bëjnë).

Në praktikë mund të paraqiten situatat, kur rezulton dëm jashtëzakonisht serioz që ishte i paqëllimshëm dhe jashtë kontrollit të kryesit, fajësia do të ndikohet ndjeshëm nga shkalla në të cilën mund të jetë parashikuar dëmi. Nëse vepra penale ka shkaktuar shumë më tepër dëm, ose shumë më pak dëm sesa synonte ose parashikonte i akuzuari, në varësi të këtyre rrethanave mund të kenë peshë më të madhe ose më të vogël në dritën e rrethanave të çështjes konkrete.

### Rrethanat rënduese më tipike

*-Keqpërdorimi i pushtetit ose pozitës zyrtare* nga par. 2.9 i Nenit 70 të KPRKK-së, do të merret parasysh në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me këto vepra penale, gjithnjë duke përjashtuar rastet kur kemi të bëjmë me ato nene, respektivisht paragrafë kur pozita e tillë paraqitet si element i veprës penale. Në jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar të Hagës abuzimi me pozitën e ndikimit dhe autoritetit në shoqëri mund të merret parasysh si një faktor rëndues në dënimin e shqiptuar. Në veçanti, në natyrën e veprave penale të kësaj kategorie, kryerja nga personat zyrtar është mjaft shqetësuese për faktin se kemi të bëjmë me persona të cilët janë të thirrur në bazë të pozitës që mbajnë të kontribuojnë në forcimin e sundimit të ligjit dhe drejtësisë në shoqëri, jo të shndërrohen në sulmues të saj e cila ndikon në rritjen e jo besueshmërisë së

qytetarëve në këtë sistem. Në kuptim të rrethanave konkrete që ndërlidhen me llojin e autorizimeve të pozitës zyrtare, hierarkisë, autorët e rangut të lartë, me autorizime të rëndësishme e specifike, duhet të marrin dënime më të rënda, pastaj duhet të vlerësohen pasojat konkrete që mund të jenë të ndjeshme si për viktimën ashtu edhe për komunitetin.

*-Dënimet e mëparshme –* Është e nevojshme posaçërisht të analizohen lloji dhe natyra e veprave penale për të cilat ka qenë i dënuar më parë, si :

- a) natyra e veprës penale, lidhshmëria dhe rëndësia me veprën aktuale;
- b) koha që ka kaluar nga dënimi i mëparshëm.

Dënimet e mëparshme, në asnjë fazë të sistemit të drejtësisë penale, nuk duhet të përdoren në mënyrë automatike si një faktor kundër të akuzuarit. Edhe pse mund të jetë e justifikueshme që të merren parasysh precedentët e mëparshëm penal, dënimi duhet të mbahet në përpjesëtim me seriozitetin e veprës (ve) aktuale. Efekti i dënimeve të mëparshme varet nga karakteristikat e veçanta të çështjes së mëparshme penale të të akuzuarit. Rrjedhimisht, çdo efekt i kriminalitetit të mëparshëm duhet të zvogëlohet ose anulohet kur ka pasur një periudhë të konsiderueshme pa kriminalitet para veprës aktuale që është objekt i gjykimit ose kur vepra aktuale është e natyrës së lehtë. Sa i përket dënimeve të mëparshme të të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

*-Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar -* në çfarë shkalle dhe mënyre ka qenë i përfshirë personi në kryerjen e veprave penale, si individ apo si anëtar i bashkimit kriminal. Anasjelltas, rrethana nga paragrafi 3.5 i po këtij neni mund të ndikojë në zbutjen e dënimit dhe çmohet si lehtësuese. Praktika e Tribunalit Ndërkombëtar, në Aktgjykimi Kupreshkiq, thekson “dënimet që do të shqiptohen duhet të pasqyrojnë peshën e qenësishme të sjelljes kriminale të të akuzuarit. Për përcaktimin e peshës së krimit, kërkohet që të merren parasysh rrethanat e veçanta të rastit, si dhe forma dhe shkalla e pjesëmarrjes së të akuzuarit në krim”.

*-Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal -* rrethana nga paragrafi 2.12 i neni 70 të KPRK-së. Fakti se vepra penale është kryer në kuadër të aktivitetit të grupit të organizuar kriminal tregon për shkallë të lartë të rrezikshmërisë dhe cenim serioz të administrimit të drejtësisë. Andaj, ky është indikator i qartë se dënimi duhet kalojë mbi pikënisjen e caktuar në drejtim të ashpërsimit të dënimit dhe ekzistimi i kësaj rrethane, padyshim se në parim, ka karakter mbizotërues ndaj rrethanave lehtësuese që mund të ekzistojnë.

*Vepra penale është kryer nga dy ose më tepër persona në bashkëpunim apo në grup -* konsiderohet rrethanë rënduese, i akuzuari i cili ka vepruar në bashkëpunim apo në grup ndikon në rritjen e shkallës së tij të përgjegjësisë penale. Kur viktimë ballafaqohet me dy ose më tepër persona, është faktor domethënës se me gjasë do të jetë më e frikësuar dhe do të ndihet e pafuqishme për tu mbrojtur.

*- Fëmija i pranishëm/shqetësime serioze -* vepra penale është kryer në prezencën e fëmijëve, rrethana do të merret si rënduese në rastet e prezencës së fëmijëve, pasi ata mund të pësojnë shqetësime serioze dhe kjo ngjarje stresuese mund të ketë pasojat traumatike ta.

*-Kontakti i bërë në shtëpi apo në afërsi të saj ose në vendin e punës së viktimës - kontakti me viktimën i bërë në shtëpi apo në vendin ku banon, apo në vendin e tij të punës, duke e bërë që të vihet në pozitë të vështirë dhe të mos ndihet i sigurt edhe në këto vende.*

*-Ndikimi serioz në administrimin e drejtësisë – rrethana do të vlerësohet se a ka pasur ndikim serioz, që ka ndikuar administrimin e drejtësisë në mënyrë domethënëse, duke përfshirë këtu edhe epilogun e saj, por pa u kufizuar në të, gjithashtu ndikimi i cili edhe mund të mos jetë substancial, por gjithsesi ka pasur ndikim mund të trajtohet si rrethanë rënduese.*

*-Nëse vepra është kryer përmes shtrëngimit, frikësimit ose shfrytëzimit – këto rrethana mund të përdoren, me kusht që të mos jenë tipare të veprave penale.*

*- Nëse në kryerjen e veprës është përdorur arma – mund të përdoret si rrethanë rënduese me kusht të mos jetë tipar i veprës penale.*

*-Vepra e kryer gjatë kohës së lirimit me kusht ose i dënuar me dënim alternativ të kushtëzuar - dhe gjatë kësaj periudhe ka kryer veprën penale, duke përfshirë shkeljen e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht.*

Edhe rrethanat tjera rënduese të parapara me Nenin 70 të KPRK-së mund të jenë të aplikueshme në veprat sipas këtij kapitulli, gjithnjë duke pasur kujdes në mos dyfishim me elementet e veprës penale, si: shkalla e dëmit të shkaktuar që mund të merret si rrethanë rënduese

*Rrethanat lidhur me viktimat - të gjitha rrethanat nga par. 2.4-2-7 mund të jenë relevante varësisht nga lloji i veprës së kryer. Rrethanat që kanë të bëjnë me viktimat, mund të merren si rënduese, por duhet pasur kujdes që të mos dyfishohen me rrethanat rënduese.*

### **C. Rrethanat lehtësuese**

Rrethana lehtësuese mund të merren rrethanat e përcaktuara sipas nenit 70 par. 3 të KPRK-së. Gjykatat duhet pasur parasysh natyrën dhe llojshmërinë e këtyre veprave, në varësi të veprës konkrete edhe t'i japin peshën e duhur rrethanave lehtësuese. Në veçanti, shkallës së përgjegjësisë penale dhe dëmit konkret të shkaktuar.

*-Pranimi i fajësisë apo marrëveshja mbi pranimin e fajësisë - në veprat me dënime maksimal dhe mesatar sipas këtij kapitulli, nuk duhet të konceptohet si zbutje automatike nën minimumin ligjor në rastet kur të njëjtat nuk shoqërohen me rrethana tjera jashtëzakonisht lehtësuese.*

*-Dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në kryerjen e veprës penale - Fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër. Në format bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale na paraqiten ndihmës, nxitës dhe persona që ndihmojnë kryesin pas kryerjes së veprës, rrethana që nuk janë persona kyç në kryerjen e veprës penale, mund të konsiderohet si faktor lehtësues, por deri në çfarë mase do të varet nga rrethanat specifike të secilit rast.*

*-Bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar - bashkëpunimi me gjykatën duke përfshirë edhe dorëzimin duhet trajtuar si rrethanë lehtësuese, pasi që kjo ndihmon gjykatën në bërjen e drejtësisë, kursen kohë dhe resurse të institucioneve, dhe ndihmon në bërjen e drejtësisë, prandaj marrja e këtyre rrethanave duhet të ketë ndikimin e duhur, duke e bërë të qartë se bashkëpunimi me gjykatën dhe dorëzimi do të konsiderohen rrethana lehtësuese për dënimin.*

*- Bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale - është jetike, zbulimi, hetimi dhe ndjekja efektive e kryesve të veprave penale. Për rrjedhojë, bashkëpunimi në fazat e hershme jo vetëm që është i rëndësishëm, por mund të jetë edhe vendimtar, në kapjen e kryesve dhe sigurimin e provave për ti ndëshkuar personat që kryejnë dhe janë përfshirë në këto aktivitete. Në çdo rast konkret, duhet çmuar bashkëpunimi dhe kontributi konkret që ka dhënë i akuzuari për interesat e drejtësisë, dhe varësisht se sa ka qenë ky kontribut, është e arsyeshme që të reflektojë në shkallën e dënimit.*

*- Kontakti i paplanifikuar me dëshmitarin dhe i kufizuar në shtrirje dhe kohëzgjatje - kontakti me dëshmitarin ishte i paplanifikuar, rastësor dhe i kufizuar në aspektin kohor, që tregon për një veprim *ad hoc* dhe të pa përgatitur paraprakisht.*

*- Përgjegjësia e shkelësit reduktohet ndjeshëm nga çrregullimi mendor ose pa aftësi mendore - nëse konstatohet se te kryesi ekziston çrregullim mendor ose pa aftësi mendore do të ketë ndikimin e duhur si rrethanë lehtësuese.*

*- Ndikim i kufizuar ose i parëndësishëm në administrimin e drejtësisë - ndikimi ka qenë i vogël ose i papërfillshëm në administrimin e drejtësisë.*

*-Shqetësim /ose ndikim i kufizuar i shkaktuar ndaj viktimës - shqetësimi ose ndikimi ka rezultuar të jetë i limituar dhe jo domethënës.*

*-Mosha dhe/ose mungesa e pjekurisë - Mosha e shtyrë ka ndikim në përcaktimin e dënimit si rrethanë lehtësuese, sidomos për personat e moshës së shtyrë që nuk kanë të kaluar kriminale. Po ashtu mosha e re dhe mungesa e pjekurisë mund të ketë ndikim të caktuar në përcaktimin e dënimit.*

*-Pendimi për veprën penale të kryer - të konstatohet nëse kemi të bëjmë me pendim real dhe të sinqertë.*

*-Karakter i mirë dhe/ose sjellja shembullore - e kaluara e personit dhe rrethanat e tjera tregojnë se i akuzuari kishte karakter të mirë dhe ishte i njohur për sjellje shembullore në shoqëri.*

*-Paaftësia fizike ose kushte të rënda mjekësore që kërkojnë trajtim urgjent, intensiv ose afatgjatë - konsiderohet si rrethanë lehtësuese bazuar në parimin e humanitetit që nevojitet të përcjellë procedurën dhe drejtësinë penale.*

Rrethana lehtësuese mund të merren rrethanat tjera të përcaktuara sipas nenit 70 par. 3 të KPRK-së.

Duhet pasur parasysh natyrën dhe llojshmërinë e këtyre veprave, gjykatat duhet pasur kujdes në varësi të veprës konkrete edhe ti jap peshën e duhur rrethanave lehtësuese. Në veçanti, shkallës së përgjegjësisë penale dhe dëmit konkret të shkaktuar.

#### **D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera**

*-Shqiptimi i dënimit me kusht* - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët apo mesatar, por gjithnjë duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar. Krahas dënimit me kusht, mund të caktohen edhe detyrimet e caktuara konform Neni 56 të KPRK-së, par. 1.9-1.11.

*-Shqiptimi i urdhrit për punë me dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat e arsyetojnë dënimin me burgim.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë* - Për veprat më të lehta brenda këtij kapitulli është paraparë si mundësi shqiptimi i dënimit me gjobë si dënim kryesor. Është karakteristike se për dy nga veprat në këtë kapitull<sup>413</sup> janë paraparë shuma specifike të gjobave, për dallim nga shumica e neneve të KPRK-së përgjithësisht vetëm parashohin gjobën si dënim. Në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par. 5 të Neni 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale, kjo sidomos kur bëhet fjalë për gjobën prej 125.000€ siç është paraparë me nenin 387 të KPRK-së.

*-Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 62 apo 63* - rekomandohet të shqiptohet në të gjitha rastet kur personi zyrtar është i përfshirë në kryerjen e veprave nga ky kapitull. Në shumë raste shqiptimi i këtij dënimi plotësues do të ketë efekt më të madh dhe mund të arrijë qëllimin e dënimit krahasuar me format tjera të dënimit.

*-Shqiptimi i dënimeve tjera plotësuese* - mund të jetë e arsyeshme, duke pasur parasysh natyrën e veprave të këtij kapitulli p.sh. dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës nga neni 67 i KPRK-së.

*-Vërejtja gjyqësore* - në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Neni 82 mund të shqiptohet për veprat më të lehta të këtij Kapitulli. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burgim deri në një (1) vit ose dënim me gjobë, në rastet kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat penale veçanërisht të lehta. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet edhe për vepra penale të caktuara për të cilat është paraparë dënim deri në tri (3) vjet, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata veçanërisht merr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryesit në të kaluarën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale. Megjithatë shqiptimi i vërejtjes gjyqësore nga ligjvënësi është paraparë për të shqiptuar ndaj kryesve të veprave më të lehta penale, me shkallë të ulët të përgjegjësisë penale dhe me rrezikshmëri të pakët, prandaj nevojitet të bëhet një analizë

---

<sup>413</sup> Neni 385 paragrafi 2, Deklaratat e rreme të dëshmitarëve bashkëpunues parasheh dënimin prej 500€ për deklaratë apo dëshmi të rreme, ndërkaq neni 387 Frikësimi gjatë procedurës penale parasheh shqiptimin e gjobës prej 125.000€.

e duhur nëse shqiptimi i këtij sanksioni është i mjaftueshëm dhe i duhuri në kuptim të gjitha rrethanave duke përfshirë në këtë tërësi edhe natyrën e veprës penale.

*-Lirimi nga dënimi* - është paraparë si mundësi për disa vepra penale, që është rrjedhojë e natyrës së këtyre veprave për të cilat ligjvënësi ka paraparë mundësinë e lirimit siç janë për veprat penale Rebelimi i personave të privuar nga liria - Neni 396 par. 4 (Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni heq dorë vullnetarisht nga rebelimi para se të ketë ushtruar forcën apo kanosjen serioze, gjykata mund ta lirojë nga dënimi), Neni 385 Deklaratat e rreme të dëshmitarëve bashkëpunues par. 2, gjykata mund ta lirojë nga dënimi kur ekzistojnë rrethana lehtësuese. Lirimi nga dënimi parashihet edhe në bazë dispozitës së nenit 127 par. 3 të KPRKK-së e cila përcakton që anëtari i grupit apo bashkimit e lajmëron grupin para kryerjes së veprës penale mund të lirohet nga dënimi.

## **XX. Kapitulli XXXII Veprat penale kundër rendit publik**

### **Shqyrtime të përgjithshme**

Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike janë ato vepra që prekin sferën e sigurisë së rendit publik, forcimi dhe mbrojtja e të cilave ka rëndësi të madhe, sepse lidhen me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut të sanksionuara me instrumente të së drejtës ndërkombëtare, si: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Karta e të Drejtave Politike dhe Civile, por edhe në aktet themelore të shtetit tonë, si Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke parashikuar një funksionim normal të sistemit gjyqësor, të organeve të tjera të ngarkuara me ligj, të cilat ndihmojnë në realizimin e drejtësisë penale dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, që zënë një vend të veçantë në dispozitat e Kodit Penal.

Për të gjitha veprat penale të sistemuara në një grup, e përbashkëta është objekti grupor unik i mbrojtur. Kjo paraqet lidhjen kohezive në mes të veprave të ndryshme penale në kuadër të grupit të njëjtë. Ndërkaq, kur bëhet fjalë për veprat penale kundër rendit publik, e vetmja “karakteristikë e përbashkët” e tyre është mungesa e këtij objekti të përbashkët të mbrojtur. Në këtë grup janë radhitur veprat penale me objekte të mbrojtura shumë të ndryshme (p.sh., pengimi i personit zyrtar në ushtrimin e detyrës zyrtare, falsifikimi i dokumentit, thirrja për rezistencë, pengimi i ceremonive fetare, dëmtimi i varreve a kufomave etj.), kështu që nuk është e mundur të nxirret asnjë unifikim minimal për të gjitha këto vepra penale përkitazi me objektin grupor të mbrojtur.

Heterogjeniteti i veprave penale të këtij grupi ka për pasojë që kuptimi dhe përmbajtja e disa veprave penale në këtë rast nuk mund të caktohet as në pikëpamje të sistematikës së tyre në ligjin penal, një gjë që për veprat e tjera jo vetëm që është e mundur, po shpesh është edhe shumë e rëndësishme. Përpos kësaj, është e vështirë edhe sistematika e brendshme e këtyre veprave. Arsyet e një strukture të këtyre veprave penale, para së gjithash, janë të natyrës tekniko-juridike. Nuk është e panjohur dukuria në të drejtën penale krahasuese që veprat e ndryshme penale, të cilat, sipas kriterëve të pranuar të klasifikimit, nuk mund të radhiten në një grup të caktuar, të ndahen në grupe të posaçme të mëdha heterogjene, siç është vepruar edhe në Kodin tonë Penal. Kjo zgjidhje ka edhe anën e vet pozitive, ngase në këtë mënyrë shmangim krijimin e grupeve të shumta të veprave penale numerikisht të vogla. Mirëpo, kjo nuk përjashton mundësinë dhe as nevojën që ky grup i veprave penale të ndahet në dy ose më shumë grupe, siç ka vepruar Republika e Sllovenisë, e cila me Ligjin Penal të saj këto vepra i ka ndarë në dy grupe: veprat penale kundër qarkullimit juridik dhe veprat penale kundër rendit dhe qetësisë publike.

Objekt i mbrojtur i këtij grupi të veprave penale është rendi dhe qetësia publike. Vetë shprehja rendi dhe qetësia publike është vështirë të përcaktohet në mënyrë të saktë. Zakonisht me këtë shprehje nënkuptojmë gjendjen ekzistuese të qarkullimit juridik dhe të sigurisë juridike, përkatësisht përshtypjen e qytetarëve se ekzistojnë siguria juridike dhe siguria personale. Rëndin publik e përbëjnë raportet e ndërsjella të qytetarëve, të cilat janë në harmoni me rregullat e mirësjelljes (me mënyrën normale të jetës) dhe disiplinën shoqërore. Nga kjo rezulton që çdo vepër penale, në një mënyrë të caktuar, rrezikon këtë ndjeshmëri të sigurisë juridike dhe sigurisë personale të qytetarëve. Mirëpo, për dallim nga veprat e tjera penale, me të cilat, parimisht


rrezikohet siguria personale e personit të caktuar e tërthorazi rendi dhe qetësia publike, në përgjithësi, me veprat penale të këtij grupi, para së gjithash, rrezikohen rendi dhe qetësia publike e të gjithë qytetarëve. Forcimi dhe mbrojtja e rendit dhe sigurisë publike kanë rëndësi të madhe, sepse me to lidhet drejtpërdrejt realizimi në praktikë i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të sanksionuara me Kushtetutë.

Sipas lartësisë së ndëshkimit veprat penale të sipër cekura mund të ndahen në tre grupe:

- Dënime të ulëta prej 3 muaj, 1, 3 dhe 5 vjet.
- Dënime mesatar prej 5 deri në 8 vjet; dhe
- Dënime maksimale me minimume ligjore shumë të larta prej 8, 10 dhe 12 vjet

### A. Pikënisja

Tabela e mëposhtme jep pikënisjen e sugjeruar për veprat nga ky kapitull, duke bërë dallimin në mes atyre me dënim më të ulët, mesatar dhe maksimal. Lartësia e dënimit të veprave penale është çështje e dispozitave ligjore, ky kategorizim është i thjeshtë, bazohet ekskluzivisht në shkallën e dënimit, duke bërë një ndarje e cila ndihmon për të caktuar pikënisjen mbi të cilën do të orientohen gjyqtarët për të përcaktuar dhe shqiptuar dënimin e duhur.



Siç shihet nga grafiku për veprat penale me dënime të ulëta pikënisja në matjen e dënimit është 1/3 nga dënimi i përcaktuar, dhe në varësi të rrethanave rënduese apo lehtësuese lëvizet nga ky pozicion.

Për veprat penale me dënime mesatare, që përfshin veprat penale prej 5-8 vjet burgim, ka përcaktuar pikënisjen prej 1/2 e dënimit. Duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe në varësi të rrethanave të zbatueshme në situatën konkrete, gjykata do të shqiptojë dënimin maksimal apo minimal.

Është e rëndësishme të theksohet, se lëvizja nga pikënisja nuk është thjeshtë një numërim mekanik sasior i rrethanave rënduese apo lehtësuese. Megjithatë, rëndësinë dhe ndikimin e madh në shkallën e dënimit e ka natyra dhe cilësia e rrethanave. Kjo nënkupton, se secila rrethanë, së pari peshohet si e vetme, pastaj në ndërlidhje me të gjitha rrethanat tjera si tërësi, dhe në këtë kontekst vlerësohet ndikimi i saj konkret në dënim.



Në përgjithësi, me rastin e ndërmarrjes së hapave në procesin e matjes së dënimit nga gjyqtarët kërkohet të ndërtojnë një qasje unike në përcaktimin e dënimit, ashtu që hapi i parë është identifikimi nëse vepra penale me kualifikimin e caktuar ligjor renditet në kategorinë e veprave penale me dënim të ulët, të mesëm apo të lartë. Pastaj, do të ballafaqohen me një mori të rrethanave që ofron konteksti i veprës penale dhe faktorët që lidhen me kryesin e veprës penale. Identifikimi i këtyre faktorëve, e më pas kombinimi i tyre, duhet të rezultojë në përshtatjen e dënimit i cili mund të jetë më i rëndë apo më i lehtë nga përcaktimi fillestar. Qasja unike nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe epilog të njëjtë të dënimeve, pasi kjo do të jetë e përcaktuar nga rrethanat e secilit rast konkret, megjithatë, do të sigurojë konsistencë në dënimet e shqiptuara, do të evitohen dallimet e pajustificuara për rastet analoge, duke pas hapësirë të mjaftueshme, që dallimet në dënime të reflektojnë arsyeshëm veçoritë dhe karakteristikat e secilës çështje.

## **B. Rrethanat rënduese**

Në matjen e duhur të dënimit, rëndësi të posaçme nevojitet ti kushtohet rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, si ato subjektive që i referohen kryerësit, ashtu edhe atyre objektive.

*Shkalla e përgjegjësisë penale të të akuzuarit*, është një prej faktorëve më të rëndësishëm në këtë drejtim, nëse është i përgjegjshëm, apo ekzistojnë rrethana që ndikojnë në shkallën e përgjegjësisë penale, forma e fajësisë - dashja e drejtpërdrejtë apo eventuale ose pakujdesia në ato raste kur sanksionohet pakujdesia.

Faktorët të cilët tregojnë se i akuzuari kishte vepruar *me paramendim, vendosmëri dhe këmbëngulësi* në kryerjen e veprës penale, apo vendimi për të kryer veprën penale ishte aty për aty, dhe nuk bëhet fjalë për një dashje të paramenduar paraprakisht, motiveve nga të cilat ishte kryer vepra penale, etj., do të kenë rolin dhe efektin e tyre domethënës në dënim.

Gjykata po ashtu, do ti kushtojë kujdes në *veçanti natyrës së dëmit*, që do të varet nga karakteristikat personale dhe rrethanat e viktimës, vlerësimi i dëmit nga gjykata do të jetë një mënyrë për të marrë parasysh ndikimin e një krimi të caktuar që ka pasur mbi viktimën.

Në vlerësimin e seriozitetit të çdo veprë penale konkrete duhet të marrë në konsideratë jo vetëm çdo dëm real i shkaktuar nga vepra, por gjithashtu çdo dëm që synohet të shkaktohet ose mund të parashikohet nga kryesi që do të vinte nga vepra penale.

### *Rrethanat rënduese më tipike*

Neni 70 i KPRK-së parashikon listë jo shteruese të rrethanave rënduese për t'u konsideruar në caktimin e dënimit. Është e rëndësishme të kuptohen dhe aplikohen siç duhet rrethanat më relevante në një kontekst të lidhur me veprat penale kundër rendit publik. Më poshtë është dhënë një analizë e rrethanave të parapara me KPRK por, edhe disa tregues/indikatore që (pikërisht për shkak se KPRK-ja parasheh listë jo shteruese) mund të shërbejnë për sqarim të rrethanave të parapara me KPRK.

*Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal* - duke qenë se kjo pjesë është marrë parasysh me rastin e caktimit të pikënisjes, përfshirja si rrethanë shtesë do të paraqiste dyfishim. Megjithatë, në këtë rast, Gjykata këtë rrethanë duhet ta zbërthejë

tutje në kontekst të kohëzgjatjes së anëtarësisë në këtë organizatë, pozitës në hierarki, llojin e aktivitetit kriminal etj.

*Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale* - kjo rrethanë është zbrërthyer pothuajse në çdo kapitull dhe të njëjtat argumente sa i përket kryesit në rastin në fjalë vlejnë edhe për këtë. Pra, dënimi për individin si pjesë e grupit kriminal duhet bazuar në formën e angazhimit në kryerjen e asaj vepre dhe angazhimi/roli më i madh duhet të reflektohet me dënim të përpjestueshëm dhe adekuat me atë angazhim.

*Nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo vepër penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës* - veprat kundër rendit publik janë kryer për motive të ndonjë nga bazat e parapara sipas këtij paragrafi janë faktorë shumë relevant dhe duhet të kenë peshë në dënimin final. Kjo hyn në kuadër të rrethanave që tregojnë përgjegjësi të shtuar të kryesit andaj te veprat ku mund të vjen në shprehje si rrethanë, duhet të ketë peshë domethënëse në matjen e dënimeve.

*Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar* - Dënimi i mëparshëm paraqet një nga elementet më me peshë në matjen e dënimin. Recidivizmi tashmë është përfshirë me rastin e caktimit të pikënisjes më të lartë për kryesit me të kaluar penale. Megjithatë, sa i përket dënimeve të mëparshme të pandehurit që nuk përmbushin konceptin e recidivizmit të shumëfishtë sipas Nenit 75 të KPRK-së, kjo më së miri është sqaruar në pjesën e parë të Udhëzuesit, më saktësisht në Pikën V-Ashpërsimi dhe zbutja sipas nenit 70 të KPRK-së.

### **C. Rrethanat lehtësuese**

Edhe pse të gjitha rrethanat nga paragrafi 3 i Nenit 70 mund të gjejnë zbatim te veprat e këtij kapitulli, gjykatat duhet të kenë kujdes të shtuar në matjen e peshës së tyre. Është e pamundur të bëhet një shabllonizim i rrethanave se cila ka peshë më të madhe se tjetra, pasi aplikimi dhe pesha e tyre varet shumë nga lloji i veprës, shkalla e viktimizimit dhe/apo dëmit të shkaktuar dhe përgjegjësia e tij/saj. Andaj, tri rrethanat e fundit gjithnjë duhet ta kenë rolin kryesor në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimin.

Si rrethana lehtësuese që mund të merren parasysh por pa u kufizuar janë:

- Pendimi i të pandehurit dhe premtimi se nuk do të bie ndesh me ligjin;
- I pandehuri i ka kërkuar falje viktimës.
- Moshë e re e të pandehurit.
- Pranimi i fajësisë së të pandehurit.
- I pandehuri nuk ka pasur të kaluar kriminale më parë në Kosovë.
- Niveli i ulët arsimor i të pandehurit.
- Mungesa e lëndimeve fizike të viktimës si pasojë e sulmit

Pra, pranimi i fajësisë në veprat me dënime maksimale dhe mesatare sipas këtij kapitulli, nuk duhet të konceptohet si zbutje automatike nën minimumin ligjor në rastet kur të njëjtat nuk shoqërohen me rrethana tjera jashtëzakonisht lehtësuese. Deklarimi i pranimit të fajësisë është

tregues i rëndësishëm se i pandehuri është duke u shkëputur me sukses nga aktiviteti kriminal i shkuar. Megjithatë, gjykatat do të duhej të ushtrojnë kujdes përpara se të trajtojnë pranimin e fajit si faktor lehtësues në caktimin e dënimit. Gjykatat duhet të bëjnë pyetje të kujdesshme drejtuar të pandehurve, përtej deklaratave të tyre të përgatitura fjalë për fjalë, për të vlerësuar nëse kryesi është me të vërtetë i penduar, e njëj gabimin e sjelljes së tij/saj dhe nuk është me rrezikshmëri për recidivizëm. Shumica e kryesve deklarohen fajtor në seancën fillestare, që do të thotë se gjykatat nuk do të kenë informacion të mjaftueshëm për faktorët rëndues relevantë. Prandaj, gjykatat do të duhej të bëjnë përpjekje që sipas detyrës zyrtare të caktojnë seancat për caktimin e dënimit (përveç nëse palët tashmë kanë kërkuar seancë) sipas dispozitave të KPPRK-së dhe të kërkojnë informacion shtesë nga palët. Do të duhej të shmanget ulja automatike nën minimumet ligjore pa marrë parasysh faktorët e tjerë.

Më tej, në format e *bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale na paraqiten ndihmës, inkurajues* dhe persona që ndihmojnë kryesin gjatë kryerjes së veprës, rrethana se nuk janë persona kyç në kryerjen e veprës penale, mund të konsiderohet si faktor lehtësues, por deri në çfarë mase do të varet nga rrethanat specifike të secilit rast dhe përderisa nuk paraqitet si vepër e veçantë apo element i veprës penale.

Po ashtu edhe *bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën*, përfshirë dorëzimin vullnetar duhet trajtuar si rrethanë lehtësuese, pasi që kjo ndihmon gjykatën në bërjen e drejtësisë, kursen kohë dhe resurse të institucioneve dhe ndihmon në bërjen e drejtësisë, prandaj marrja e këtyre rrethanave duhet të ketë ndikimin e duhur, duke e bërë të qartë se bashkëpunimi me gjykatën dhe dorëzimi do të konsiderohen lehtësuese për dënimin.

Edhe *mosha* mund të përdoret si faktor në përcaktimin e dënimit, sidomos për personat e moshës së shtyrë pa të kaluar kriminale. Po ashtu mosha e re dhe mungesa e pjekurisë mund të ketë impakt të caktuar në përcaktimin e dënimit.

*Pastaj, pendimi për veprën penale të kryer* nëse konstatohet se pendimi është real dhe i sinqertë, karakteri i mirë dhe/ose sjellja shembullore, nëse e kaluara e personit dhe rrethanat e tjera tregojnë se i akuzuari kishte karakter të mirë dhe ishte i njohur për sjellje shembullore në shoqëri.

Duke pasur parasysh natyrën dhe llojshmërinë e këtyre veprave, gjykatat duhet pasur kujdes, në varësi të veprës konkrete t'u japë peshën e duhur rrethanave lehtësuese. Në veçanti, shkallës së përgjegjësisë penale dhe dëmit konkret të shkaktuar.

#### **D. Aplikueshmëria e dënimeve tjera**

*Shqiptimi i dënimit me kusht* - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët apo mesatar, por gjithnjë duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë së kryesit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar.

*-Shqiptimi i urdhrin për punë me dobi të përgjithshme* - mund të jetë i përshtatshëm vetëm për veprat me dënim të ulët dhe nëse nuk ka rrethana rënduese të cilat arsyetojnë dënimin me burgim p.sh. te vepra penale nga neni Neni 405-Mospjesëmarrja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm, Neni 409 - Prezantimi i rremë si person zyrtar apo Neni 410 - Vetëgjyqësia.

*-Shqiptimi i dënimit me gjobë* - Për veprat më të lehta brenda këtij kapitulli është paraparë si mundësi shqiptimi i dënimit me gjobë, si dënim kryesor. Në mënyrë që dënimi me gjobë të ketë efektin e duhur duhet siguruar që gjoba e caktuar të shqiptohet në raport me gjendjen financiare të kryesit në pajtim me par. 5 të Nenit 69 të KPRK-së dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për gjobat penale. P.sh., te vepra penale nga neni Neni 405-Mospjesëmarrja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm, Neni 409 - Prezantimi i rremë si person zyrtar, Neni 410 - Vetëgjyqësia, Neni 412 - Pengimi i ceremonive fetare apo Neni 413 - Dëmtimi i varreve apo kufomave.

Vlen të vihet në theks të veçantë Neni 404 - Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizëm. Në paragrafin 4 të po këtij neni është paraparë dënimi me gjobë prej 200-10.000€ për huliganizëm me pasoja të vogla. Kjo vepër është e vetmja në KPRK që parasheh në mënyrë gjobën si sanksion të vetëm për person fizik.

*-Shqiptimi i dënimit plotësues nga Neni 62 apo 63* - rekomandohet të shqiptohet në të gjitha rastet kur personi zyrtar është i përfshirë në kryerjen e veprave nga ky kapitull. Në shumë raste shqiptimi i këtij dënimi plotësues do të ketë efekt më të madh dhe mund të arrijë qëllimin e dënimit krahasuar me format tjera të dënimit. P.sh., te vepra penale nga Neni 407 - Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare. Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës është edhe një dënim tjetër plotësues, i cili është i përshtatshëm për tu shqiptuar për veprat nga ky kapitull.

*-Vërejtja gjyqësore* - në pajtim me parimet e paragrafit 2 dhe 5 të Nenit 82 mund të shqiptohet për veprat më të lehta të këtij Kapitulli. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një (1) vit ose dënimi me gjobë, në rastet kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat penale veçanërisht të lehta. P.sh., te vepra penale nga neni Neni 405 - Mospjesëmarrja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm apo te par. 1 i nenit 410 të KPRK-së. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet edhe për vepra penale të caktuara për të cilat është paraparë dënimi deri në tre (3) vjet, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata veçanërisht merr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryesit në të kaluarën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale.

Megjithatë shqiptimi i vërejtjes gjyqësore nga ligjvënësi është paraparë për të shqiptuar ndaj kryesve të veprave më të lehta penale, me shkallë të ulët të përgjegjësisë penale dhe me rrezikshmëri të pakët, prandaj nevojitet të bëhet një analizë e duhur nëse shqiptimi i këtij sanksioni është i mjaftueshëm dhe i duhuri në kuptim të të gjitha rrethanave, duke përfshirë në këtë tërësi edhe natyrën e veprës penale.

